

BIBLIOTEKË
948.65
H57

Reginald Hibbert

**Fitorja
e
hidhur**

**LUFTA
NACIONALÇLIRIMTARË
E SHQIPERISE**



949.65.088.5

94865

457

Reginald Hibbert

FITORJA E HIDHUR

Lufta
nacionalçlirimtare
e Shqipërisë



<i>Kreu 12</i> Fundi i lojës	297
<i>Kreu 13</i> Përfundimi i luftës partizane; fillimi i sundimit komunist	321
<i>Kreu 14</i> Fundi i misionit Stables	340
<i>Kreu 15</i> Jehona pas luftës	356
<i>Shtojcë 1</i> Parashpresa e Muharrem Bajraktarit e shkurtit 1944	374
<i>Shtojcë 2</i> Raporti i nënkolonelit Maklin i 18 qershorit 1944	380
<i>Shtojcë 3</i> Shënimi i kapitenit Vito Menegaci i korrikut 1944 rreth veprimeve të baterisë së tij malore me Brigadën e Parë partizane ...	384
<i>Shtojcë 4</i> Një shënim rreth dërgimit të arit nga oficerët ndërlidhës britanikë në Shqipëri	386
Bibliografi	389
Treguesi tematik	393
Treguesi i emrave	405
Shënime për përkthimin	417

Shkurtime

- AFHQ Kuartieri i Forcave Aleate, Mesdheu, në Algjer dhe më pas në Kazertë
- UNÇSH Ushtria Nacionalçlirimtare Shqiptare
- BAF Forcat Ajrore të Ballkanit në Bari
- BK Balli Kombëtar, krijuar në vjeshtë 1942
- BLO Oficer ndërlidhës britanik
- PKSH Partia Komuniste e Shqipërisë (Partia e Punës e Shqipërisë)
- PKJ Partia Komuniste e Jugosllavisë
- FANY Vullnetarët e Ndhmës së Parë Infermiere (të cilët dërgonin njerëz për pikat ndihmëse të M. O. 4/Forcës 133/266/399 në Kajro e Bari)
- FNÇ Fronti Nacionalçlirimtar. LNÇ u kthye në FNÇ nga fundi i majit 1944 e më pas
- GHQME Shtabi i Përgjithshëm, Lindja e Mesme, Kajro
- LNÇ Lëvizja Nacionalçlirimtare, themeluar në Pezë në shtator 1942
- LRDG Grupi i Shkretëtirës i Distancave të Largëta
- MO4 Personeli i SOE në Kajro, seksionet e të cilit për Shqipërinë dhe vendet e tjera të Ballkanit kaluan nën ko-

ntrollin ushtarak nga fundi i vitit 1943 dhe u bënë
pjesë të Forcave 133, 266 e 399

PWB
PWE

Dega e Luftës Psikologjike në AFHQ
Drejtoria e Luftës Politike

Parathënie

Pikënisja e këtij libri ka qenë ditari që kam mbajtur i Shqipëri më 1944. Ditari mund të botohej me sukses si një histori aventurë e kohës së luftës, por me kalimin e viteve e pastaj të dhjetëvjeçarëve, doli se kishte nevojë për një analizë më të gjerë e më të thellë rreth ngjarjeve të viteve 1943 e 1944 për ta bërë të kuptueshëm. Si përfundim, analiza mori epërsi mbi tregimin dhe tre kapituj të rrëfimit janë tani të ndërthurur në dymbëdhjetë kapituj analize e historie. Në një kohë kur Shqipëria po del ngadalë prej izolimit të gjatë të vetimponuar, ky libër përpiqet të lidhë së bashku ngjarjet që ndodhën në prag të shkëputjes së plotë të Shqipërisë. Shpresoj se përvoja ime si një dëshmitar dhe pjesëmarrës në ato ngjarje ka ndihmuar për të vënë në fokus disa nga ndodhitë që kërkimi i ka nxjerrë në dritë.

Një nga vështirësitë për të ndërtuar historinë e kohës së luftës është mungesa e hartave të mira e të besueshme për Shqipërinë. Më të mirat kanë qenë ato që patëm ne në luftë ose sidoqoftë ato që patën personeli në Kajro dhe Bari. Ata prej nesh që ishin brenda vendit e patën po aq të vështirë të mbanin hartat sa edhe për çdo gjë tjetër. Hartat e mira (1:200.000) janë kopjuar nga një hartë austriake e vitit 1925 e cila, përsa i përket verilindjes dhe jugut të vendit, ishte bazuar në rilevimet e bëra për qeverinë shqiptare në mes të viteve 1920, ndërsa për zonat e tjera të vendit, në rilevimet ushtarake austrohungareze, italiane dhe franceze, të bëra gja-

të luftës 1914-1918. Në të vërtetë ishin shënuar mirë gjithë fshatrat si emra, por të dhënat për konturet dhe për veçoritë e tjera gjeografike ishin më tepër të përafërta se sa plotësisht të përpikta. Hartat e sotme të botuara në Shqipëri japin relativisht pak informacion. Hartat e sotme të botuara jashtë Shqipërisë japin një paraqitje të mirë të përgjithshme për veçoritë gjeografike, por kanë pak identifikime për vendet më të vogla.

Emrat e vendeve janë të vështira. Gjatë luftës shpesh ne i mësonim emrat e vendeve me vesh dhe rrallë i kemi parë të shkruar. Me sa duket, kishte disa variante për disa emra. Unë jam përpjekur të përdor drejtshkrimin e shqipes, por disa herë kam përdorur trajtat e huaja (p.sh. Scutari, Durazzo, Kosovo), kur kam shkruar për to nga pikëpamja e një të jashtmi ose një të huaji, ose kur dukej e përshtatshme nga ana historike.

Kur nuk e njeh gjuhën, është e vështirë që nga shkrimi ta gjesh se si duhen shqiptuar disa fjalë shqipe. Kujt ia merrte mendja, për shembull, se si do të shqiptohej emri Koci Xoxe? Xh shqiptohet si «j» e anglishtes, si në mbiemrin që del gjithandej Hoxha, duke qenë *xh* çifti i zëshëm i ç të shurdhët. Dh është bashkëtingëllorja e zëshme kundrejt *th* të shurdhët dhe *zh* është bashkëtingëllorja e zëshme kundrejt *sh* të shurdhët. Vështirësinë më të madhe e paraqet *q*. Anglezët priren për ta shqiptuar si *ch* të anglishtes, por në fakt ajo është si një *ch* shumë e rrafshuar e gjermanishtes. E zëshmia çift me të është *gj*. *C* pa bisht poshtë shqiptohet si *ts*. *J* shqiptohet si *u* dhe *y* si *oo* (frengjisht *u*). Shkronja *ë* e patheksuar zakonisht e pazëshme dhe që shpesh bie, i bën shumë fjalë të tingëllojnë më të shkurtra se sa duken. Kurse emrat e vendeve (shumë prej tyre mbarojnë me *ë*) zakonisht dalin në trajtën e pashquar, por disa herë dalin në trajtën e shquar me një zanore të plotë në fund (p.sh. Tiranë/Tirana, ose Shkumbin/Shkumbini). Këto shpjegime në vija të trasha ndoshta do t'i ndihmojnë lexuesit për ta kuptuar se emërtimet shqipe nuk janë të pakapshme. Shpresoj se ata lexues që e dinë shqipen, do të më falin për gabimet që kam bërë me emrat ose me fjalët shqipe kur t'i ndeshin dhe do të më përligjin për luhatjet e burimeve shqipe.

U detyrohem shumë disa prej atyre që shërbyen si oficerë ndërlihdës britanikë në Shqipëri dhe që patën mirësinë të më lejojnë të punoj me materialet e tyre të shkruara. Gë i kishin ruajtur privatisht prej kohës së luftës: Richard

Riddell, Tomy Simcox dhe Michael Lis nga misioni ynë Stables, Norman Wheeler, Marcus Lyon dhe Jack Dumoulin të misioneve në Jug. Ata gjithashtu më kanë dhënë këshilla të vlefshme, kujtime dhe inkurajim. Alan Palmer dhe Victor Smith kanë biseduar me mua për kujtimet e tyre dhe ata bashkë me Norman Wheeler dhe Marcus Lyon kanë lexuar variantin e parë të tekstit, më kanë drejtuar në rrugën e drejtë në mjaft vende lidhur me ngjarjet në Jug dhe marrëdhëniet me udhëheqësit e partizanëve. Marcus Lyon dhe Norman Wheeler më dhanë me bujari fotografitë. Donald McDonald, që e kishim «fqinjin» tonë në Maqedoni, ka biseduar me mua dhe më ka ndihmuar për ngjarjet në ato ditë gjatë vizitave në Londër dhe në Skoci duke ardhur nga Afrika e Jugut. Detyrimi që u kam librave të shkruar nga Afrikanët e BLO — «Trotsky» Davies, David Smiley, Julian Amery, Peter Kemp, Anthony Quayle dhe Bill Tilman — mund të shihet nga faqet e tekstit tim dhe nga shënimet. Materialet që i nënshtrohen së drejtës së autorit për Kurorën, në Arkivin Qendror, janë riprodhuar me leje të Kontrolluesit të Zyres administrative të Madhërisë së Saj.

Natyrisht, interpretimi i gjithë këtij materiali është imi dhe vetëm unë jam përgjegjës për të.

I jam mirënjohës profesorit Geoffrey Stern të Shkollës Ekonomike të Londrës, i cili interesave të tij të shumta u ka shtuar edhe Shqipërinë e sotme. Ai e lexoi tekstin tim, diskutoi mjaft çështje me mua dhe më dha shumë këshilla të dobishme.

Së fundi, vijnë falenderimet më të mëdha për gruan time, e cila me durim kreu detyrën e vështirë për ta shtypur tekstin tim në disa forma e variante, më thoshte se ku ishte e nevojshme ta thjeshtoja dhe përgjithësisht më ka ndihmuar për ta bërë të lexueshëm, siç shpresoj të jetë.

Reginald Hibbert
Frondeg
Pennal
Shtator 1990

Hyrje: Historia dhe Gjeografia e Shqipërisë

Shqiptarët janë një nga popujt më të vjetër të Europës, por vendi i tyre është një nga shtetet më të reja të Europës. Të jesh kaq i vjetër dhe njëkohësisht kaq i ri është një farë fati i keq. Kjo ka sjellë shumë keqkuptime. Ata jashtë vazhdimisht e kanë nënçmuar fuqinë, qëndrueshmërinë dhe rëndësinë e ndjenjës kombëtare të shqiptarëve. Shqiptarët vetë vazhdimisht e kanë mbiçmuar gatishmërinë, ose siç e shohin nga ana e tyre, detyrimin e të tjerëve për t'i lejuar vetëve ndosjes shqiptare fushë të lirë e të plotë veprimi. Shqipëria e sotme, sipas vështrimit të shqiptarëve, është vetëm një copë, jo më shumë se gjysma e asaj që duhej të ishte Shqipëria, pjesa tjetër ka mbetur në Jugosllavi. Madje edhe kjo gjysmë ose aty afër që u lejua të ekzistojë si Shqipëri e pavarur, ka pasur një jetë të pasigurtë për pjesën më të madhe gjatë tri të katërtave të shekullit, në të cilin u njoh si shtet. Mbi të vërshuan disa fuqi gjatë Luftës së Parë Botërore dhe ekzistencën e saj e fshiu Italia më 1939. Për dy ose tre vjetët e parë të Luftës së Dytë Botërore nuk ishte aspak e sigurtë nëse do të rindërtohej një Shqipëri e pavarur. Pika e kthesës ndodhi më 1943 dhe 1944, kur lufta partizane dhe interesimi për të nga ana e Britanisë dhe e Shteteve të Bashkuara e bënë të sigurtë se vendi do të ringjallej brenda kufijve para vitit 1939, i shndërruar në një shtet

komunist, i goditur nga varfëria, i shkatërruar tejprtej dhe pothuaj pa asnjë mik në botë e aq më pak pa asnjë mik të pasur ose të besueshëm.

Ngjarjet e viteve 1943 dhe 1944 ishin vendimtare gjithashtu për përcaktimin e marrëdhënieve të Shqipërisë së ringjallur me fqinjën e vet, Jugosllavinë, dhe përmes tyre e në lidhje me Jugosllavinë, edhe me Bashkimin Sovjetik dhe pjesën tjetër të vendeve komuniste, duke përfshirë Kinën. Për shkak se marrëdhëniet e Shqipërisë me Jugosllavinë vijonë rrotull një realiteti të rëndë, siç e përmendëm, sepse një pjesë shumë e madhe e asaj që shqiptarët mendojnë se duhet të jetë Shqipëria në fakt përbën pjesë të republikave të Serbisë e të Maqedonisë në Jugosllavi, shqetësimi i parë i udhëheqësve komunistë të Shqipërisë në vitet e para pas luftës, ose të paktën shqetësimi i kryesorit ndërmjet tyre, i Enver Hoxhës, ishte që të shmangte përqafimin dhe gëlltitjen nga Jugosllavia. Shqipëria e re i trajtoi të gjitha vendet e tjera jokomuniste, «kapitaliste», si vende armiqësore të përcaktuara. Kur erdhi dita dhe ajo e pa se mjedisi komunist ndërkombëtar i saj ishte armiqësor ose në rastin më të mirë nuk mund t'i zihej besë për shkak të peshës më të madhe që i jepej Jugosllavisë në politikën afatgjatë, atëherë ajo i hyri rrugës për ta izoluar veten hap pas hapi nga çdo ndikim i huaj. Kështu ndodhi për katër dhjetëvjeçarë. Kjo periudhë e gjatë e mbështetjes në forcat e veta, e rëndë, e ashpër, duke iu kthyer vetes, me sa duket i siguroi Shqipërisë mbijetesën e pavarur. Por kjo siguroi gjithashtu që si vend të mbetej pothuaj i panjohur. Tani ajo po e hedh tej ngadalë rrobën e oshënarit dhe po e lë veten të bëhet pak më mirë e njohur. Asgjëkundi më, me sa duket, askush nuk e vështron Shqipërinë si të papërfillshme. Si shtet ajo tashmë ka ardhur në maturë dhe mund të pritët që, gradualisht, të zërë një vend dhe pozitë më normale, konvencionale në bashkësinë e kombeve. Duke bërë këtë ajo ndoshta do të shtrojë një sfidë të dyfishtë, së pari për Jugosllavinë, por përtej saj edhe për ata që, me venitjen e fuqisë së Bashkimit Sovjetik, do të përpiqen të sjellin në Europën Lindore dhe në Ballkan po atë rregullim të drejtpeshuar të pasluftës, i cili dështoi si pasojë e drejtpërdrejtë e luftës.

Ky libër përqendrohet në përpjekjet për të hedhur dritë mbi ngjarjet e viteve 1943 e 1944 dhe mbi rrethanat e rilindjes së Shqipërisë si një shtet komunist. Letërsia për ato vite përbëhet nga njëra anë, nga kujtime personale të pjes-

shme, të shkruara kryesisht nga një pikëpamje tejet anti-komuniste, nga ana tjetër, nga një histori e shtrembëruar, e gatuar me një pikëpamje komuniste, tejet të anshme dhe personale, me pikëpamjen e Enver Hoxhës. Nuk ka arkiva të mirëfillta për Shqipërinë në vitet 1943 e 1944. Materialet shqiptare janë falsifikuar. Nuk janë të hapura as dokumentet e Drejtorisë së Operacioneve të Posaçme Britanike, që ishte agjencia e kohës së luftës e Anglisë për të nxitur rezistencën në Europë dhe që ishte angazhuar drejtpërdrejt në Shqipëri në ato ditë. Ka vetëm një përmbledhje modeste materialesh lidhur me Shqipërinë në Arkivin Qendror Britanik (PRO). Ka një zbrazëti në letërsinë e botuar lidhur me peripecitë e oficerëve anglezë që rastisën të punonin me lëvizjen partizane të udhëhequr nga komunistët më 1943 dhe 1944. Shumë nga kjo turmë e vogël janë ende gjallë, por me sa duket asnjëri nuk ka ndërmend të shkruajë diçka. Unë jam përpjekur ta mbush këtë zbrazëti. Kam qenë në kontakt me ata oficerë, me të cilët kam qenë koleg shumë i ri për atë kohë të luftës, dhe kam përfituar nga këshillat, komentet dhe kujtimet që ata qenë në gjendje të përmbledhnin. Gjithashtu kam mundur të mbështetem në ditarin, të cilin e kam mbajtur vetë në Shqipëri. Krahasoni i kujtimeve me ditarin dhe me materialin e shfrytëzueshëm rreth politikës angleze e të aleatëve, si dhe me historinë që tregohet në shkrimet e vëllimshme të Enver Hoxhës, mund të ndihmojë për të sqaruar çështjen përse Shqipëria eci në atë rrugë dhe përse Shqipëria deri më sot mbeti i përjashtuari i Europës. Atyre që u pëlqen të filozofojnë rreth historisë, ai mund t'u japë një shembull veçanërisht të gjallë për kontrastin ndërmjet dukjes dhe realitetit në çështjet publike. Ata që do të dëshironin të kuptonin fenomenin shqiptar sot, duhet ta dinë se si feniksi u ringjall nga flakët më 1944 dhe cilat qenë rrethanat që e bënë të ringjallej në një formë kaq të cenosur — të cenosur brenda vendit nga fanatizmi i udhëheqjes komuniste, nga spastrimet staliniste dhe kulti i individit i imponuar nga Enver Hoxha, dhe jashtë vendit nga lavdërimi i përcudnuar i izolimit ndërkombëtar.

Përpara se të nisim me historinë e kohës së luftës, nevojiten disa shpjegime të shkurtra për aspekte të historisë e të gjeografisë, që u kanë dhënë mundësinë shqiptarëve të mbijetonin që nga lashtësia si një popull i qëndrueshëm, pa u bërë politikisht i organizuar. Është një fakt interesant që

ata kanë një ndjenjë shumë të zhvilluar të identitetit të vet kombëtar e megjithatë për dy mijëvjeçarë nuk ia kanë dalë të ndërtojnë një shtet që të përputhet me trevat e tyre. Si pasojë është vënë në pikëpyetje aftësia e tyre shtetformuese deri në kohët e fundit, ndonëse ata kanë jetuar në Ballkan shumë më gjatë se sa Serbët e Bullgarët e madje më gjatë se sa grekët. Me sa duket kjo shpjegohet në këtë mënyrë: shqiptarët janë banorët e vjetër rrënjës, të cilët janë përfshirë në perandori të ndryshme që nga kohët më të hershme dhe të cilët asnjëherë nuk e kanë përcaktuar veten përmes një procesi pushtimi dhe invadimi, siç bënë fiset dhe hordhitë barbare kur depërtuan në Ballkan nga Veriu.

Mendohet se shqiptarët e kanë prejardhjen nga ilirët, fiset e të cilëve banonin në Ballkan përpara se të ngrihej Roma. Ata ranë nën sundimin e romakëve në shekullin e dytë para erës së re. Kur Perandoria Romake u nda në shekullin e tretë të erës sonë, ata u përfshinë në Perandorinë Lindore. Dyrhachium (sot Durrësi, i njohur ndoshta më mirë jashtë si Durazzo) ka qenë pikënisja e një rruge romake shumë të rëndësishme, e cila përmes Gadishullit Ballkanik të çonte deri në Selanik, duke u bashkuar me rrugën jug-veri, që ngjitej përpjetë luginës së Vardarit drejt Danubit dhe që vazhdonte më tej në Trakë dhe përmes Dardaneleve e Bosforit arrinte te provincat romake të Azisë (Turqia Perëndimore). Në fushën bregdetare të Shqipërisë ka pasur edhe dy qytete të tjera të rëndësishme: Apolonia në Jug, e cila kishte lulëzuar si qytet grek para ngritjes së Romës dhe u bë qendër e kulturës greke në epokën e artë të Romës, ndërsa sot prej saj kanë mbetur vetëm rrënojat, dhe Auloni (Vlorë ose Valona) në bregdet pak më në jug, e cila i zuri vendin nga rëndësia Apolonisë në shekullin e pestë; në Veri ishte Scodra (Shkodra ose Scutari), e cila ashtu si dhe Durrësi, mbetet deri më sot një nga qytetet kryesore të Shqipërisë. Romakët pak interes mund të kenë pasur për të ndërhyrë në punët e brendshme të fiseve ilire nëpër malësi, mjaftonte që ato të pranonin nënshtrimin dhe të mos ndërhynin në ngulimet bregdetare dhe në rrugët strategjike. Lulëzimi romak dhe *Pax Romana* pa dyshim u sillnin të mira popullëve të malësive, pa përmendur mundësinë që njerëzit e aftë dhe energjikë mund të bënin përpjetë në administratën dhe në ushtrinë perandorake.

Nga fundi i shekullit të gjashtë perandoria nisi të tronditej dhe të copëtohej nga vërshimi në Ballkan i popujve

barbarë prej veriut mbi Danub. Rruga e natyrshme e vërshimit ishte përgjatë luginave të Moravës e të Vardarit drejt Selanikut, duke kaluar pastaj drejt perëndimit, nga Traka dhe te muret e Konstantinopolit. Perandoria ende kontrollonte gjerësisht detin dhe mbante të lirë kalimin për në qytetet bregdetare. Fiset rrënjëse në trevat e Shqipërisë së sotme ishin mbledhur në malet e larta që ndajnë detin Adriatik nga brendësia e Ballkanit. Invadimet barbare nuk u ngjiten dot në malet e larta dhe t'i përulanin, ndërsa qytetet e fushës bregdetare ende qëndronin si poste të përparuara të qytetërimit romak e bizantin. Avarët endacakë, që u përhapën nga mesi i Danubit, e shtrinë mbretërinë e tyre në Ballkan në shekullin e gjashtë, por pastaj shkuan drejt tatëpjetës dhe u përmbysën nga Karli i Madh, duke iu hapur rruga për në Ballkan valëve në rritje të sllavëve dhe të bullgarëve. Mbretëria bullgare u bë forca mbisunduese në shekullin e tetë, të nëntë e të dhjetë dhe përsëri në shekullin e trembëdhjetë, por nga shekulli i katërmëdhjetë mbretëria serbe mori epërsinë. Populli bullgar dhe populli serb përftuan identitetin e tyre historik në këta shekuj dhe trevat në të cilat u ngulitën nëpërmjet një lufte të zgjatur me Perandorinë Bizantine nisën procesin e gjatë të evolimit drejt vendeve të sotme të Bullgarisë e të Serbisë.

Gjatë kësaj kohe, me përjashtim të periudhave të rastit të pushtimeve sllave, Shqipëria mbeti një avanpost i Perandorisë. Ajo nuk fitoi një identitet politik të vetin. Kur Perandoria u copëtua pas grabitjes së Konstantinopolit më 1204 prej Kryqëzatës së Katërt, bregdeti jugor i Shqipërisë ishte një nga fragmentet e Perandorisë që mbeti grek duke iu kundërvënë latinëve dhe bëri pjesë në Despotatin e Epirit. U përfshi sërish në Perandori kur kjo u rimëkëmb në Konstantinopol më 1261 dhe mbeti një avanpost i Bizantit në shekullin e katërmëdhjetë. Ndërkaq Venediku ishte bërë fuqia sunduese në Adriatik dhe zona veriore e Shqipërisë rreth Shkodrës ra brenda sferës së Venedikut. Pjesa qendrore rreth Durrësit për një kohë u mbajt nga princat Anzhuinë të Sicilisë. Viset e brendshme të verilindjes u përfshinë në mbretërinë serbe dhe monarku i madh serb Stefan Dushani, u përpoq ta shtrinte perandorinë e tij mbi gjithë Shqipërinë në mes të shekullit të katërmëdhjetë.


Kur u shemb Perandoria Serbe pas vdekjes së Stefan Dushanit dhe kur Konstantinopoli kishte marrë të tatëpjetën, Shqipëria gjatë një periudhe të shkurtër u sundua nga

krerët e vet vendas, por kjo periudhë ishte tepër e shkurtër për shqiptarët që të fitonin personalitet politik dhe nga fundi i shekullit të katërbëdhjetë pushtimi turk i Ballkanit kishte ecur shumë përpara. Serbët u mposhtën në fuqinë e Kosovës më 1389 dhe pavarësia e Bullgarisë mori fund më 1393. Përparimi i Turqisë në malësitë e Shqipërisë u pengua deri në shekullin e pesëmbëdhjetë dhe Shqipëria më në fund ra në duart e turqve pak kohë pas rënies së vetë Konstantinopolit. Pikërisht në këtë kohë i vetmi hero kombëtar i Shqipërisë, Gjergj Kastrioti, doli në dritë dhe u bë i famshëm me emrin Skënderbe. Turqit e kishin marrë peng në rini dhe e kishin futur në shërbim të sulltanit, ku u shqua si ushtarak. Ishte ende i ri kur u këthye kundër zotërve dhe mësuesve të tij, hoqi dorë nga islamizimi dhe e udhëhoqi popullin e vet në një qëndresë të ashpër e të suksesshme kundër ushtrive turke nga viti 1444 deri më 1467, kur ra më në fund kështjella e tij e Krujës. Pak kohë më vonë venedikasit u dëbuan nga pikat që kishin në bregdet. Gjatë katër shekujve pasues shqiptarët jetuan nën sundimin e sulltanëve osmanë dhe sërisht u ndodhën të varur nga Konstantinopoli. Fijet e vazhdimësisë më të madhe në historinë e Shqipërisë mund të ndiqen duke shkuar prapa nga varësia prej një sulltani në Stamboll te varësia prej një perandori të krishterë në Konstantinopol e te varësia prej një perandori pagan në Romë.

Një rrjedhë e tillë lë pak vend për histori «kombëtare». Skënderbeu është i vetmi hero kombëtar i Shqipërisë. Për ta kuptuar se çfarë do të thotë kjo për një shqiptar, duhet mbajtur para sysh se i vetmi hero në historinë e Anglisë ka qenë Henriku V, bëmat e të cilit vijnë para atyre të Skënderbeut vetëm rreth njëzet e pesë vjet. Ky krahasim është ndoshta i mjaftë për të treguar përse shqiptarët, ndryshe nga fqinjët e tyre, nuk arritën të krijonin një shtet. Sikur historia e Anglisë të kish nisur e të kish mbaruar me Henrikun V dhe asme një kometë tjetër e krahasueshme të mos kishte kaluar përmes kupolës së qiellit anglez as më parë e as më pas, nuk do të kishin pasur shumë shanse për të mbijetuar si shtete as Anglia e as Britania. Një krahasim tjetër domethënës mund të bëhet me historinë e Uellsit. Edhe ata janë një popull rrënjës. Edhe atyre u duhet të kthehen e të shohin prapa në fillimet e shekullit të pesëmbëdhjetë për heroin e fundit kombëtar, Owain Glyndwr. Më pas edhe ata bënë pjesë në një mbretëri më të gjerë e sipas rësttit edhe perandori, duke

shërbyer në ushtrinë dhe administratën e tyre, duke dhënë herë pas here njerëz si Henry Tudor ose Llojd Xhorxhi (Lloyd Georges) për t'u vënë në shërbim të tyre e madje deri edhe mbajtës të kurorës, por gjithmonë mbetën për vete në një gjendje të turbullt, duke ruajtur vetëdijen kombëtare në gjuhën e tyre, në këngët epike, në vargjet, në poemat e folklorit të tyre, si dhe në mënyrën baritore të jetës nëpër kodrina.

Shqiptarët mbetën nën sundimin turk nga shekulli i pesëmbëdhjetë deri më 1912. Ata nuk u administruan si një njësi e vetme, por u ndanë ndërmjet vilajeteve të Janinës, Manastirit, Kosovës dhe Shkodrës. Nga këto qendra vetëm Shkodra është në Shqipërinë e sotme. Ndarjet administrative thelloheshin me ndarjet fetare. Gjatë mijëvjeçarit të parë grekët, bullgarët dhe serbët pranuan ritet e krishterimit bizantin dhe, natyrisht, ky ka qenë edhe besimi i tokave shqiptare nën sundimin bizantin. Sllavët e Ballkanit veriperëndimor, kroatët dhe sllovenët ishin të orientuar nga veriu e perëndimi drejt Bohemisë, Gjermanisë (Perandorisë së Shenjtë Romake) dhe Italisë, kishin pranuar ritet e kishës romake. Ndikimi i Romës, i përforcuar nga fuqia e Venedikut, u përhap teposhtë bregdetit dalmat dhe ka arritur deri në Shkodër e te fiset veriore të Shqipërisë. Nën sundimin turk rreth dy të tretat e popullit shqiptar u kthyen në islamizëm, mund të mendohet se ishte një ndërrim feje për leverdi, sepse shumë shqiptarë u ngjitën në poste të larta në shërbim të sulltanëve osmanë. Kjo ndoshta nuk ishte e vështirë për një popull që ishte mësuar të pranonte një sundimtar në Konstantinopol, duke pranuar heshturazi besimin që sundonte në Konstantinopol. Si pasojë, shumë nga shqiptarët e jugut (toskët), në veçanti ata të vilajetit të Janinës, mbetën ortodoksë, kurse shqiptarët e zonave më veriore (gegët) në Shkodër dhe në malësitë përreth mbetën katolikë, dhe shqiptarët e zonave të qendrës, të verilindjes e të Kosovës, e gjithashtu shumë gegë ose shqiptarë të veriut, duke përfshirë rreth dy të tretat e kombit, u bënë në masë myslimanë. Lidhur me qëndrimin e turqve, për ta ishin grekë ata që ishin të fesë ortodokse, ishin turq ata që ishin myslimanë, kurse ata që ishin katolikë dyshoheshin se ishin aleatë të mundshëm të armiqve të Perandorisë Turke, në Austro-Hungari dhe Itali. Atje ku kishte shkolla, ishin turqisht, ndërsa për ortodoksit greqisht. Në Jug dhe në zonën e bregdetit familjet e dyerve të mëdha



u bënë pronarë të mëdhenj tokash duke pranuar islamizmin, kurse të tjerët u shërbenin si bujq, disa herë si myslimanë, por më shpesh si ortodoksë. Në Veriun malor, ku pronësia e tokës kishte më pak rëndësi, njerëzit vijuan të jetonin sipas mënyrës së lashtë në bashkësitë fisnore, duke ndjekur krerët e tyre tradicionalë dhe duke iu shmangur çdo lloj administrimi efektiv në një shoqëri që mbahej e bashkuar nga ligji tradicional i vendit. Ky ligj kishte marrë autoritet si Kanuni i Lek Dukagjinit. Leka kishte qenë kodifikuesi i tij në kohën e mesjetës. Ai përcaktonte rregulla të rrepta për mikpritjen kundrejt të huajve dhe hakmarrje kanunore kundër shkelësve, me gjakmarrjen si sanksion i skajshëm, që impononte një lloj paqeje primitive ose sidoqoftë një armëpushim me ndërprerje nëpërmjet vrasjes nga të dy palët me përzgjedhje. Sundimtarët osmanë, siç duket, e kanë parë Shqipërinë si një burim taksash, ushtarësh, rekrutësh për administratën në vise të largëta të Perandorisë dhe grash të shëndosha për shtëpitë e tyre. Herë pas here ndonjë nga krerët shqiptarë e ngrinte kryet lart dhe ngjallte një lloj kërcënimi për autoritetin perandorak dhe atëhere ai e pasuesit e tij shtypeshin pa mëshirë. Për katër shekuj tokat shqiptare mbetën në amulli dhe kombi shqiptar vijoi të ishte i copëtuar. Ndonëse gjithnjë ishte në një farë mënyre i panështruar, ai u përshtat gjerësisht me sistemin e imponuar nga fuqia pushtuese.

Edhe gjeografia ka luajtur rolin e saj në vonesën e zgjimit të kombit shqiptar. Shqipëria zë shpatin perëndimor të një masivi të madh malor, që ndërpret anën perëndimore të Gadishullit të Ballkanit. Masivi malor vijon drejt jugut në vargmalin e Pindit, i cili përbën kreshtën kurrizore të Greqisë veriore, dhe vijon drejt veriut në Malin e Zi e në Hercegovinë, duke ndarë fushat e Danubit e të degëve, të tij prej bregut të Dalmacisë. Shkrepat e lartë të masivit malor përbëjnë një kufi të egër ndërmjet Shqipërisë e Maqedonisë, ku lugina e Vardarit shërben si rrugë kryesore ndërmjet Beogradit mbi Danub dhe Selanikut në Detin Egje. Luginat lumore të Shqipërisë janë të gjitha relativisht të shkurtra dhe zbresin drejt perëndimit nga masivi malor në detin Adriatik. Luginat janë shumë të thella e të thikta, lumenjtë janë të rrëmbyer në rrëzat e maleve, por gjarpërojnë dhe kënetëzojnë kur arrijnë në fushën bregdetare. Tri luginat më të rëndësishme janë e Drinit në Veri, e Shkumbinit në mes dhe e Vjosës në Jug. Lugina e Shkumbinit është shtegu nëpër të cilin depërtoante

përmes gardhit të maleve rruga ndërmjet Romës e Bizantit. Lugina e Vjosës jep një rrugë kryesore nga Greqia për Shqipëri (ose po ta themi më romantikisht, nga Epiri në Iliri). Drini përfshin dy lumenj që bashkohen. Drini i Zi del nga liqeni i Ohrit në zemër të masivit malor dhe është lumi i malësisë shqiptare të veriut e të lindjes, që çan gryka të thella përmes masivit malor dhe shërben më tepër si pengesë se sa si kanal komunikimi. Drini i Bardhë është lumi i Kosovës, që bashkohet me Drinin e Zi fare pak larg kufirit të Shqipërisë. Roli natyror gjeografik i bashkimit të Drinit të Zi dhe të Bardhë është të shërbejë si porta ndërmjet dy grupeve kryesore të gegëve ose të shqiptarëve të Veriut, atyre të malësive qendrore e veriore dhe atyre të Kosovës. Këtij roli i kundërvihet kufiri shqiptaro-jugosllav, i cili e shkëput Kosovën dhe e ndan pellgun e Drinit të Bardhë nga pjesa tjetër e sistemit të lumit.

Shqipëria është përshkruar si Zvicra e Ballkanit, profili i saj shumë i thyer, shpatet malore të rrëpirëta, kreshtat e thikëta, grykat shkëmbore të thella dhe përrënjtë e rrëmbyer nuk kishin ndonjë forcë të veçantë tërheqëse për hordhitë barbare që u dyndën dhe jepnin shumë mundësi për t'u mbrojtur nga këmbësoria dhe kalorësia e zakonshme. Fusha e saj bregdetare e kënetëzuar mund të kthehej e shfrytëzueshme nga një qytetërim i përparuar si i Romës ose i Bizantit, por kishte tokë më të mirë gjatë për pushtuesit e Ballkanit më pak të stërholluar, si bullgarët, sllavët ose të tjerë. Përmes shekujve shqiptarët kanë qenë mbrojtur nga natyra e thyer dhe e ashpër e truallit të tyre. Njëkohësisht ai i ka ndarë në bashkësi e grupime të vogla dhe kështu nuk u arrit shkrirja dhe bashkërendimi i burimeve, nga të cilat mund të ishte zhvilluar një komb modern. Toka u ka imponuar një ekzistencë të vështirë. Nëpër malësi ata kishin pronat e tyre të vogla, delet e dhitë, lopët e pulat; mezi bënë pak misër, fasule e duhan në rripat e shpateve të maleve dhe nga kumbullat e nga rrushi zienin një pije që ndryshonte mjaft. Në luginat më të gjera dhe në fushat më të ulëta drejt bregdetit ata merreshin më shumë me bujqësi e më pak me blegtori, por popullsia e përgjithshme mbetej në nivelin e urisë, analfabete dhe pa gëzimet e jetës.

Me ardhjen e shekullit të nëntëmbëdhjetë dhe me rënien e fuqisë së Turqisë, në krahasim me fqinjët e tjerë ballkanikë, shqiptarët nuk ishin të përgatitur mirë për të përfitur nga ndryshimi i rrethanave. Ata nuk kishin ndonjë mik ose

përkrahës ndërmjet fuqive që i vinin rrotull Perandorisë Osmane. Greqia u bë shteti i parë i Ballkanit që arriti pavarësinë e plotë nga turqit dhe e arriti këtë me përkrahjen e Britanisë e të Francës. Bullgaria fitoi në fillim autonominë dhe pastaj pavarësinë me mbështetjen e Ruisë. Serbia eci përpara hap pas hapi drejt pavarësisë së plotë, disa herë me përkrahjen e Ruisë, disa herë të Austro-Hungarisë, disa herë të Britanisë ose të Francës. Perandoria Austro-Hungareze aneksoi Bosnjën dhe Hercegovinën, kurse principata e pavarur e Malit të Zi, e mbetur si rrishtë ndërmjet Hercegovinës e Shqipërisë, na u zgjerua. Të gjitha këto ndryshime u ratifikuan në Kongresin e Berlinit më 1878. Tani Shqipëria e pa veten se shtrihej në cepin perëndimor të një korridorit të Turqisë, që zgjatej përmes Ballkanit nga Traka dhe të ngushtuar nga të dy anët prej vendesh të pavarura, që mbështetshin nga fuqi të mëdha të ndryshme.

Fatkeqësisht për shqiptarët, këta fqinjë të sapobërë të pavarur kërkonin t'i «çlironin» territoret shqiptare duke i gëlltitur për vete. Greqia dhe Serbia kishin ambicje territoriale në drejtim të Shqipërisë, Perandoria Austro-Hungareze ishte më tepër e interesuar ta shtrinte autoritetin e vet mbi sllavët e jugut dhe të pengonte influencën ruse në Ballkan, se sa të gjente një zgjidhje të drejtë për një grup etnik të palidhur, që përbëhej kryesisht prej myslimanësh. Në kohën e Kongresit të Berlinit një grup shqiptarësh të shquar u mblodhën në Prizren të Kosovës dhe formuan Lidhjen Shqiptare, për të mbrojtur interesat e tyre kombëtare pranë fuqive të mëdha, por ata po hynin në këtë fushë shumë vonë dhe nuk kishin shpresë për sukses. Turqit nisën të dyshonin për ta dhe Lidhja u shtyp më 1881, por në mënyrë paradoksale lëvizja e reformave në Turqi, duke kërkuar autoritetin turk dhe duke premtuar ta bënte atë më të efektshëm, i bëri shqiptarët që të mendoheshin më seriozisht se si të arrinin vetëqeverisjen dhe pavarësinë. Lufta ballkanike e vitit 1912 i bashkoi Greqinë, Serbinë, Bullgarinë dhe Malin e Zi në një front të përbashkët të suksesshëm kundër Turqisë dhe i vuri shqiptarët përballë problemit për të shmangur gëlltitjen nga fitimtarët. Në Vlorë u mbajt një kuvend i delegatëve nga të gjitha anët e Shqipërisë dhe u shpall pavarësia e Shqipërisë. Me mbështetjen e Austro-Hungarisë kjo u pranua nga fuqitë e mëdha, por Shqipëria e re u ngrit pa Kosovën. Kosova iu aneksua Serbisë, ashtu si edhe krahinat me popullsi shqiptare gjatë kufirit maqedon.

Sapo e fitoi pavarësinë Shqipëria, përsëri e humbi. Gjatë Luftës së Parë Botërore Shqipëria u zhduk dhe tokat e saj u pushtuan sipas rastit nga trupat greke, italiane, serbe, malazeze, austro-hungareze dhe franceze. Nga fundi i luftës u shemb Perandoria Austro-Hungareze, e cila kishte dalë si mbrojtëse e Shqipërisë së pavarur më 1913. Gjatë luftës Italia, Greqia dhe Serbia kishin marrë zemër që të mendonin për rrëmbimin e tokave shqiptare. Shqiptarët krijuan edhe një herë një bashkim kombëtar dhe mbajtën një Kongres në Lushnjë më 1920. U ngrit një qeveri dhe kërkoi njohjen ndërkombëtare, duke u pranuar nga fundi i vitit në Lidhjen e Kombeve. Ndërkaq kombi i ri u ngrit me armë dhe arriti dëbimin e forcave italiane nga jugu i vendit. Nga fundi i vitit 1921 u rikonfirmuan kufijtë e vitit 1913, me disa ndryshime të vogla në favor të Jugosllavisë. Kjo është Shqipëria, ekzistenca e së cilës u rivendos pas Luftës së Dytë Botërore dhe që ekziston edhe sot — një Shqipëri pa shqiptarët e Kosovës dhe të zonave kufitare të Maqedonisë.

Historia e Shqipërisë ndërmjet dy luftërave është në pjesën më të madhe një histori e ngritjes dhe e rënies së Ahmet Zogut. Ai u bë kryeministër, pastaj president, më pas mbret, me një a dy grushte shteti e kundërgrushte gjatë kësaj rruge. Në fillim ai kërkoi ndihmë nga jashtë në Jugosllavi, por shpejt u kthye nga Italia e atëhere pa se si vendin e mori në dorë gradualisht Italia deri sa e aneksoi përfundimisht më 1939. Atëhere Ahmet Zogu mori arratinë. Asnjëra nga fuqitë nuk mori qëndrim kundër Italisë ose në favor të pavarësisë së Shqipërisë. Ndërmjet dy luftërave pak gjë ishte bërë për të zhvilluar ekonominë ose shoqërinë e Shqipërisë. Shqetësimi kryesor i qeverisë ishte përpjekja për të mbijetuar e për të mbetur e pavarur dhe kjo dështoi. Shqipëria ishte jo vetëm e prapambetur dhe e pazhvilluar; kishte një pikëpyetje për aftësinë e saj për të mbijetuar si shtet i pavarur.

Nga pikëpamja kluturore kishte pasur një përparim të habitshëm. Gjuha shqipe ishte ngritur më këmbë si gjuhë e shkruar dhe e botimeve, e pajisur me alfabetin latin të përshtatur. Kishte një letërsi që po gjallërohej dhe botohej në gazeta e revista. Për herë të parë fëmijët shqiptarë po mësonin shqip nëpër shkolla. U ngrit një administratë kombëtare, ushtria kombëtare dhe *xhandarmëria*. Një brez të rinjsh shqiptarë po mësonin mjeshtritë (dhe veset) e kohës moderne në vende të ndryshme të Europës. Një vetëdije e fshehur ko-

mbëtare nisi të shprehej hapur. Qëndrimi që zbatoi ajo prirej drejt një mosbesimi të thellë ndaj të huajve, veçanërisht po të ishin fqinjë të afërt, duke u ndërthurur me një besim pak naiv se drejtësia e çështjes shqiptare do të ishte po aq e qartë për udhëheqësit botërorë sa edhe për vetë shqiptarët.

Kur shpërtheu Lufta e Dytë Botërore, Shqipëria ishte një zotërim italian. Nuk do të ishte pa arsye të mendoje se shqiptarët do të tregonin një shkallë rezistence kundër italianëve dhe me kalimin e kohës ata ashtu vepruan. Por italianët nuk ishin i vetmi kërcënim që ndienin shqiptarët. Grekët e vështronin pjesën jugore të Shqipërisë si Epirin e Veriut, që duhej të ribashkohej një ditë me Epirin e Jugut në Greqi. Kjo e bëri të vështirë për grekët që, kur ata e zmrapsën ushtrinë italiane më 1940, ta paraqisnin veten bindshëm si çlirimtarë të Shqipërisë. Serbët dhe malazeztë kishin gllabëruar pjesë të rëndësishme të viseve të banuara nga shqiptarët brenda kufijve të tyre dhe si pasojë, ndërsa Jugosllavia nuk kishte pretendime territoriale kundër Shqipërisë, shqiptarët e vështronin Jugosllavinë si fuqinë sllave e cila i mbante të nënshtuar shqiptarët. Kur Jugosllavia u mund dhe u shkatërrua nga Gjermania më 1941, italianët e gjermanët qenë në gjendje të mbillnin përçarje, mosmarrëveshje dhe ngatërresa, duke i dhënë Shqipërisë Kosovën dhe trevat e Dibërës në Maqedoni, duke kënaqur kështu aspiratat shqiptare për të ndërtuar Shqipërinë e Madhe. Pas rënies së Italisë më 1943, gjermanët qenë në gjendje t'i dhuronin një pseudopavarësi kësaj Shqipërie të Madhe.

Në këtë mënyrë ëndrra nacionaliste e shqiptarëve u realizua në kohën kur Europa ishte mbërthyer nga një makt, ishte një realizim pervers por njëkohësisht shumë tundues. Natyrisht, shqiptarët do të donin ta mbanin Shqipërinë e Madhe edhe pas luftës. Qëllimet e tjera të luftës, siç ishte qëllimi i thjeshtë i luftës së aleatëve për të thyer Gjermaninë, u bënë të dorës së dytë kundrejt tij. Paaftësia e fuqive aleate për t'u marrë vesh rreth krijimit ose ekzistencës së Shqipërisë së Madhe e ftohën entuziazmin nationalist të shqiptarëve për çështjen e aleatëve, duke i bërë më pasivë kundrejt Gjermanisë dhe më mercenarë kundrejt të dyja palëve, se sa do ta kishin dashur aleatët. Kishte, natyrisht, edhe faktorë të tjerë që ndikonin, mbi të gjitha frika nga dhuna e egër, të cilën ushtritë e Boshtit ishin përgatitur ta përdornin kundër çdo shfaqje të rezistencës. Por e vetmja arsye, e cila ndoshta do të mund ta ngrinte gjithë popullin shqiptar për të rezistuar me vendosmëri dhe për të përballuar terrorin gjerman, do të ishte

pranimi i hapur nga aleatët për ta bërë të përhershme Shqipërinë e Madhe. Kjo ishte e pakonceptueshme për qeveritë aleate, të cilat kishin angazhime për fqinjët e Shqipërisë.

Brenda Shqipërisë, madje edhe Partia Komuniste, të cilën shumica e shqiptarëve jo komunistë e shihnin si dorën e fshehtë të sllavëve dhe që ishte krijuar me ndihmën e nxitjen jugosllave, ushqenin shpresën se parimi i vetëvendosjes do të respektohej nga partitë komuniste të Ballkanit kur të vinin në pushtet e të mbaronte lufta, dhe se Kosova atëhere do të bashkohej përgjithnjë me Shqipërinë e të gjithë shqiptarët më në fund do të bashkoheshin. Marrëdhëniet e turbulluara që kanë ekzistuar ndërmjet Jugosllavisë dhe Shqipërisë gjatë gjithë periudhës pas luftës burojnë nga fakti se Partia Komuniste e Shqipërisë e pa veten të detyruar të pranojë më 1943 dhe 1944 që parimi i vetëvendosjes nuk do të zbatohet në Kosovë dhe në zonën e Dibrës kur Partia Komuniste e Jugosllavisë do të fitonte. Preteksti për këtë ishte se të gjitha popullsitë në Jugosllavinë komuniste do të ishin të barabarta, por në të vërtetë arsyeja ishte se Kosovën serbët e vështronin si pjesë thelbësore të trashëgimisë së tyre që nga koha e Perandorisë Serbe të mesjetës dhe Mareshali Tito e kolegët e tij nuk mund të kundërviheshin me serbët për hir të një parimi abstrakt, aq më pak për hir të shqiptarëve.

Ndërsa lufta po shkonte drejt fundit, Partia Komuniste e Shqipërisë, duke punuar nëpërmjet Lëvizjes Nacionalçlirimtare, që në gjendje ta bënte veten të vetmen lëvizje efektive të qëndresës në Shqipëri, në një shkallë të madhe për shkak të hezitimeve të nacionalistëve. Këta të fundit këmbëngulnin për ta parë komunizmin sllav si armikun më të madh dhe e bindën veten se aleatët perëndimorë do të dëshironin ta mbanin më këmbë Shqipërinë e Madhe si një ledh kundër këtij kërcënimi, kurse shqiptarët vetë nuk do të duhej të paguanin një çmim të rëndë gjaku e shkatërrimesh duke i sulmuar gjermanët vetëm në çastin e fundit. Hesapet e tyre të gabuara ishin të pacipa dhe tragjike. Aleatët, të dhënë pas luftës për të mposhtur Gjermaninë, ndihmuan të vetmen lëvizje aktive të rezistencës, partizanët e Lëvizjes Nacionalçlirimtare, të kontrolluar nga Partia Komuniste. Dështimi i nacionalistëve për t'u bashkuar aktivisht me palën fituese, u hapi rrugën komunistëve për të ardhur në pushtet dhe ishte Partia Komuniste me Enver Hoxhën që e rithemeloj vendin brenda kufijve të vet të vitit 1921. Jugosllavia fqinje, e rithemeluar nga Mareshali Tito dhe Partia Komuniste e Jugosllavisë, jo vetëm ku-

ndërshtoi çfarëdo mendimi për t'i lejuar popullsisë shqiptare të Kosovës e të Dibrës që të zgjidhte bashkimin me Shqipërinë, por edhe tregoi shenja se donte që Shqipëria të zgjidhte bashkimin me Jugosllavinë. Ndoshta kjo do të kishte qenë një rrugë e pastër për ta bërë të zdukej problemin shqiptar, por nuk ishte një rrugë që e tërhiqte Enver Hoxhën. Përveç gjithë të tjerave, kjo do ta eliminonte atë politikisht e ndoshta personalisht. Gjithashtu kjo nuk dukej se e tërhiqte popullin shqiptar në përgjithësi, për aq sa mund të vështrohet se një popull ka aftësinë të ushtrojë të drejtën e zgjedhjes nën një regjim komunist. Enver Hoxha, që shpëtoi më 1948 nga grindja e Stalinit me Titon, që në gjendje të luante me ndjenjat shqiptare me shkathtësi të madhe, për ta mbajtur veten në pushtet dhe popullin të nënshtruar sundimit të vet.

Për botën e jashtme produkti me peshë i diktaturës së Enver Hoxhës është se tani Shqipëria përfundimisht dhe patundshmërisht ekziston si shtet më vete dhe është konfirmuar ekzistenca e një irredentizmi të ri në Ballkan. Shqipëria nuk e shpreh këtë hapur, por nuk ka dyshim se ai ekziston. Tani për tani ai e bën veten të ndihet si një kërkesë e shqiptarëve të Kosovës për të drejtat në Jugosllavi, kundrejt së cilës serbët kundërshtojnë, duke ngulmuar se Kosova duhet të jetë serbe. Është e pamundur të parashikohet se si do të gjejnë dalje këto tensione, por ekzistenca e një shteti shqiptar të qëndrueshëm, të stabilizuar, të mbështetur në burimet e brendshme dhe të pranuar nga ana ndërkombëtare, na garanton se ato do të vazhdojnë. Me sa duket, Shqipëria ka nisur të dalë gradualisht nga izolimi. Duke e bërë këtë, problemi i Kosovës do të prekë më gjallërisht vetëdijen e të gjithë atyre që mendojnë ose merren me çështjet ballkanike. Tashmë çështja e minoritetit shqiptar në Serbi po i shtohet dramatikisht gërryerjes së Federatës Jugosllave. Nëse ai do të vijojë të trajtohet keq nga serbët, mund të bëhet një forcë shpërthyesë. Dhe nëse Shqipëria e Serbia do të kalojnë procesin e përmbysjes së diktaturës së partive komuniste që po përshkon Europën Lindore, ndjenjat nacionaliste që do të çlirohen ndoshta do t'i keqësojnë më tepër problemet midis tyre. Shkëmbinjtë e nacionalizmit po dalin mbi ujë nëpër Europën Lindore me tërheqjen e baticës komuniste. Kosova premtion të jetë një shkëmb tepër me thepa. Do të duhet një takt i madh politik për të lundruar rreth tij.

Ky libër përqendrohet në hollësitë e dy viteve, 1943 e

1944, dy vitet që kanë daljen në dritë përfundimtare e të patundur të një shteti shqiptar dhe shënuan fillimin e një problemi të ri, që i shtohet listës së gjatë të problemeve ndërkombëtare, të cilat përbëjnë indin e historisë politike të Europës.

Kreu I

Partia Komuniste e Shqipërisë

Në fillim të Luftës së Dytë Botërore, më 1939, nuk kishte ndonjë parti komuniste në Shqipëri. Kur gjermanët pushtuan Jugosllavinë dhe Greqinë në pranverën e vitit 1941, ende nuk kishte parti komuniste në Shqipëri. Partia Komuniste e Shqipërisë nuk u formua deri në nëntor 1941, pasi Gjermania kishte sulmuar Bashkimin Sovjetik nga fundi i qershorit. Ky nuk është një rast i pasojës që vjen nga një shkak, por me sa duket hyrja në luftë e Bashkimit Sovjetik e thjeshtoi situatën për marksistët shqiptarë, siç e thjeshtoi për komunistët kudo gjetkë. Lufta pushoi së qeni imperialiste dhe u bë antifashiste komuniste mund ta identifikonte veten me patriotizmin dhe madje grupimet marksiste, të shpërndara e të brejtura nga fraksionet në qytetet e Shqipërisë, fituan një çështje rreth së cilës mund të bashkoheshin.

Veprimtaria marksiste-komuniste në Shqipëri nis që nga fillimet e viteve 1920¹) dhe që në ditët e saj të hershme ajo edhe është ndihmuar, edhe është penguar nga shkëputja e Kosovës prej Shqipërisë dhe përfshirja e saj në Jugosllavi. Federata Komuniste Ballkanike, një organizëm i bazuar në Moskë për bashkërendimin e veprimtarive të partive komuniste në vendet e Ballkanit, kishte kërkuar rishikimin e kufijve të Ballkanit në përputhje me parimin e vetëvendosjes së kombeve. Kjo nuk mund të mos ishte tërheqëse për veshët e disa shqiptarëve, që aspironin të krijonin një Shqipëri më të madhe dhe ta sillnin popullsinë shqiptare të Kosovës në vathën kombëtare. Të tillë ishin, për shembull, anëtarët e Komitetit

të Bashkuar për Kosovën e Çamërinë (Çamëria është një brez toke në Epir në Greqi, të cilën shqiptarët e shihnin si shqiptare). Ata hynë në lidhje me përfaqësues të Kominternit në Jugosllavi në vitet 1920. Bashkimi i Shqiptarëve të Rinj u themelua më 1922 dhe u bë një pikësynim i dukshëm për propagandën komuniste që luante letrën e çështjes kombëtare. Qeveria sovjetike kërkoi kredi në Shqipëri për veprimin e Leninit, i cili botoi përmbajtjen e Traktatit të fshehtë të Londres të vitit 1915, sipas të cilit territoret e Shqipërisë do të copëtoheshin nga fuqitë aleate ndërmjet Italisë, Greqisë e Serbisë.

Më 1924 qeveria sovjetike nuk vonoi të shprehte përkrahjen për qeverinë jetëshkurtër «liberale», «të majtë» të Fan Nolit. Erdhi një mision diplomatik sovjetik, që u përpoq të vendoste marrëdhëniet diplomatike në dhjetor 1924, por u lejua të qëndronte vetëm dy ditë. Rrëzimi i Fan Nolit dhe ardhja në fuqi në fund të vitit 1924 e Ahmet Zogut, 29 vjeç por tashmë një nga krerët e njohur në pjesën veriore ose në Gëgëri dhe që gëzonte mbështetjen e familjeve kryesore të Shqipërisë së Mesme, i dha fund periudhës së parë të turbullirave në shtetin e ri. Ato veprimtari, nga të cilat në fund të fundit do të lindte lëvizja komuniste në Shqipëri, duhej të bëheshin ilegalisht dhe jashtë shtetit. Të mërguarit formuan Komitetin Nacional Çlirimtar (KONARE) në Gjenevë dhe Bashkimin Kombëtar. Në Francë dhe në Vjenë u themeluan shoqata për të përkrahur çështjen revolucionare. Më 1925 KONARE zgjodhi nja dy dyzina të rinjsh shqiptarë që të shkonin për t'u përgatitur në Moskë, dhe nga viti 1928 ajo ishte një organizatë e kontrolluar nga komunistët.

Grupet dhe celulat marksiste-komuniste brenda në Shqipëri ushqeheshin nga pakënaqësia shoqërore dhe ekonomike në qytetet e këtij vendi të prapambetur. Politika shqiptare ishte përqendruar në arritjen e pavarësisë kombëtare, duke luftuar kundër mjaft mosmarrëveshjeve, dhe kishte pasur fare pak mundësi për të përmirësuar fatin e njerëzve. Rruga e reformave sociale u diskreditua me rrëzimin e qeverisë së Fan Nolit më 1924 dhe Ahmet Zogu, i cili mori titullin e mbretit më 1928, nuk ishte një sundimtar liberal, reformator. Turbullirat ndërmjet grupeve fillestare në Shqipëri të punëtorëve (rrobaqepësve, minatorëve, zanatçinjve, punëtorëve të naftës) u krijonin një truall praktik pune aktivistëve të rinj marksistë. «Historia e Partisë së Punës të Shqipërisë»²⁾, botuar me porosi të Komitetit Qendror më 1971, pohon se celula e parë komuniste u formua më 1928 në Korçë dhe se më 1929, kur celulat

e qyteteve të ndryshme bënë një përpjekje pa sukses për të ngritur një komitet bashkërendimi të veprimtarive, nuk kishte më shumë se tetë celula të ngritura në gjithë vendin, secila prej tyre përqijej të drejtonte tre ose katër grupe «edukimi» dhe të gjitha ato përfaqësonin një përzjerje ideologjike eklektike (troçkistë, anarkistë, si edhe pasues të vijës së Moskës). Me sa duket, rezultati praktik i veprimtarisë së tyre agjitative ka qenë kufizuar me nxitjen e disa grevave (për shembull, të punëtorëve të ndërtimit dhe të gurorëve).

Më 1928 Kominterni e hodhi një nga vështrimet në drejtim të Shqipërisë³). Konferenca e 8-të e Komunistëve të Ballkanit, në të cilën shpirti lëvizës ishte Gjergj Dimitrovi nga Bullgaria, pa mundësinë për të ardhmen që të ngrihej një parti komuniste në Shqipëri. Për këtë u formua një Grup Komunist Shqiptar në Moskë dhe u bë seksioni shqiptar i Internacionales Komuniste.

Me sa duket, shqiptari më i rëndësishëm që u rrit në Komintern ka qenë Ali Kelmendi, i cili kishte qenë anëtar i «Bashkimit» dhe përkrahës i Fan Nolit në fillim të viteve 1920. Ai u kthye nga Moskë në Shqipëri më 1930, pikërisht kur Fan Noli i mërguar po e linte jetën politike për t'u bërë kryetar i Kishës ortodokse shqiptare në Shtetet e Bashkuara. Kelmendi i hyri punës për të ngritur e nxitur celulat në qytetet e ndryshme të Shqipërisë: Vlorë, Krujë, Elbasan. Më 1932 ai u internua në Korçë, ku i dha jetë të re Grupit Komunist të Korçës. Më 1933 ky ngriti një shoqatë për punëtorët me emrin «Puna», që thuhet se arriti të ketë 500 anëtarë. U krijuan sindikatat për këpucarët, rrobaqepësit, shoferët dhe studentët e liceut. Në mesin e viteve 1930 patën aktivitet grupime të vogla komunistësh në Tiranë, Shkodër, Vlorë, Elbasan dhe Gjirokastrë, ato u përpoqën gjithashtu për të bërë agjitacion ndërmjet punëtorëve. Të gjitha ato, edhe aq të vogla sa ishin, përsëri breheshin nga mosmarrëveshjet ideologjike. Ashtu siç e ka pranuar vetë Partia e Punës në historinë e vet të botuar zyrtarisht, këto grupe përbëheshin kryesisht nga mikroborgjezë, që me sa duket do të thotë qytetarë me një farë niveli shkolle, por pa mundësinë për të zënë pozita me përgjegjësi, me autoritet ose me pasuri, pra që nuk premtinin ndonjë lëndë revolucionare. Grupet komuniste nuk qenë të afta të përfitonin nga komplotet kundër mbretit Zog më 1934-1935, të cilat arritën kulmin me kryengritjen e Fierit të vitit 1935, që u shtyp menjëherë. Grevat dhe demonstratat për bukë nuk arritën ndonjë sukses praktik.

Në korrik 1935 Kongresi i 7-të i Internacionales Komuniste bëri një thirrje nga Moskë për formimin e një fronti të bashkuar kundër fashizmit dhe imperializmit. I duhej dhënë fund sektarizmit (domethënë grindjeve të brendshme, mosmarrëveshjeve me Moskën, mohimit të prerë për të bërë kompromise taktike me jekomunistët dhe për të mënjeluar ekstremizmin ose fanatizmin) dhe kudo komunistët duhej të vendosnin lidhje me masat. Këto ide ishin të vështira për t'u përvehtësuar nga komunistët në Shqipëri. Masat në Shqipëri i përbenin fshatarët. Thelbi i gjithë veprimtarisë komuniste në qytetet e vogla ishin diskutimet, përçarjet dhe rivalitetet personale. Në Shqipëri nuk kishte asnjë parti politike me të cilën Komunist i Shkodrës kishte fituar ndikim mbi grupet e tjera, por ideologjikisht shmangej nga vija e Moskës. Një ndikim tjetër fraksionist vinte nga Greqia nëpërmjet një njeriu si Andrea Zisi, i cili drejtonte Grupin e Zjarrit dhe pretendonte se ishte kryetar i një Partie Komuniste Shqiptare. Grupi i Korçës kritikohet se kishte rënë në «nacionalizëm» dhe se e përçante lëvizjen në tërësi. Qeveria e Zogut e shtoi konfuzionin ndërmjet komunistëve duke i arrestuar, duke i mbajtur në burg e duke i dëbuar.

Ali Kelmendi një pjesë të kohës ndërmjet viteve 1932 e 1935 e kaloi në burg. Kur e liruan, vajti në Greqi e në Turqi me qëllimin për të takuar përfaqësuesit e Kominternit, që të siguronte një mbështetje në një përpjekje për të vënë rregull në çështjet e komunistëve në Shqipëri. Me sa duket, ky ka qenë hapi i parë drejt një spastrimi në radhët e komunistëve shqiptarë. Por **spastrimit** nga Kelmendi nuk iu dha kohë që të bëhej. Shpejt pasi u kthye në Shqipëri, atë e arrestuan dhe më 1936 e dëbuan nga vendi. Së pari ai vajti në Paris dhe që atje u nis për në Moskë me një komunist tjetër shqiptar nga Korça, Koço Tashkon. Në Moskë ata mund t'i merrnin drejtpërdrejt udhëzimet për vijën e re taktike të Kominternit për një «front të bashkuar».

Ndërkëq, pikërisht kur Ali Kelmendi po ikte nga Shqipëria, erdhi në Shqipëri njeriu që do të bëhej udhëheqësi i saj. Më 1936 Enver Hoxha, në moshën 28 vjeç, u kthye në Shqipëri nga Franca. Thuhet se ka pasur një takim të shkurtër ndërmjet tij dhe Kelmendit në Gjirokastër përpara se Kelmendi të ikte jashtë. Disa herë e kanë përshkruar Enver Hoxhën sikur ka qenë përgatitur nga Moskë⁴). Në fakt kontakti i tij kalimtar me Kelmendin më 1936 dhe çfarëdo takimesh

individuale që ai mund të ketë pasur përpara këtij në Paris me komunistë të përgatitur në Moskë, ndoshta do të kenë qenë në kontakti dhe komunikimi më i afërt me Kominternin që ai ka pasur gjatë viteve të brumosjes së vet. Shkollën e ka bërë në Liceun e Korçës deri rreth të njëzetave dhe pastaj e vijoi në Francë e në Belgjikë⁵). Në Paris ka punuar për gazetën «L'Humanité» gjatë kohës që ndiqte mësimet në Francë. Siç duket, ka qenë një nga ata studentët që kurrë nuk arrijnë të diplomohen, sepse e shpenzojnë shumicën e energjive për gjëra të tjera, në rastin e tij për politikë. Ai u regjistrua në një shkollë inxhinierie në Montpellier më 1931 dhe atje hyri në Partinë Komuniste Franceze. Bursa iu ndërpre më 1934, për shkak të veprimtarisë politike, dhe atëhere u regjistrua për të studiuar drejtësi në Paris, duke e ndarë kohën për studimet, për të punuar për gazetën «L'Humanité» dhe për të shërbyer për pak kohë si sekretar privat i konsullit shqiptar në Bruksel. Përvoja e Hoxhës në Francë, me sa duket, e bëri të ketë fare pak respekt për veprimtarinë politike të shokëve të tij të mërguar. Historia zyrtare e Partisë së Punës të Shqipërisë përmban një koment therës për ta, që duhet pranuar se përçon mendimin e tij. Lidhur me Komitetin e Çlirimit Nacional (KONARE) aty thuhet: «Puna ilegale nën regjimin shtypës të Zogut kërkonte sakrifica dhe për këtë nuk ishin treguar shumë të gatshëm drejtuesit e organizatës»⁶).

Një komunist tjetër i ri u kthye gjithashtu në Shqipëri më 1936. Ky ishte Mehmet Shehu, në atë kohë 23 vjeç. Atë e kishin dëbuar nga Akademia Ushtarake e Napolit, sepse ishte marrë me veprimtari politike komuniste. Shkollën e mesme e kishte bërë në Shkollën Teknike Amerikane në Tiranë, që e kishte mbaruar në 1932. U kthye përsëri në Tiranë më 1936 dhe u pranua në shkollën e oficerëve; por shpejt e la atë për të shkuar në Spanjë si vullnetar me forcat republikane në luftën civile. Atje ai hyri në Partinë Komuniste Spanjolle dhe arriti të bëhej komandant i Batalionit të 4-t të Brigadës Garibaldi ose të 12-të Ndërkombëtare. Pas luftës civile atë e internuan në Francë e Itali dhe hyri në Partinë Komuniste Italiane. Nuk u kthye në Shqipëri deri më 1942, në atë ndërkohë kur Enver Hoxha, pesë vjet më i madh se ai, tashmë e kishte vendosur veten në krye të Partisë Komuniste Shqiptare të themeluar siç kërkohet. Që nga ajo kohë e më tej për katër dhjetëvjeçarë këta dy burra, Enver Hoxha si manipulues politik dhe Mehmet Shehu si njeri i dorës së fortë, do të luanin role dominuese, me të vërtetë dominuese në historinë e Shqipërisë.

Në Moskë Ali Kelmendi dhe Koço Tashkoja i kishin dhënë njoftime Seksionit Ballkanik të Kominternit. Kominterni vendosi që grupet dhe fraksionet ekzistuese në Shqipëri duhej të shpërndareshin dhe duhej të ngriheshin celula të reja me nga pesë anëtarë, të cilat do të kishin si detyrë të themelonin një parti komuniste të organizuar siç kërkohesh. Celula duhej të tërhiqte individët dhe jo aq grupet, me qëllimin për të krijuar një front «nacional» dhe «demokratik». Ali Kelmendit dhe Koço Tashkos iu ngarkua kjo barrë për ta sjellë në Shqipëri, por vetëm Koço Tashkoja arriti të vinte në Shqipëri. Ali Kelmendi nuk mundi të largohej përtej Parisit dhe vdiq atje nga tuberkulozi më 1939. Në Paris ai pati shqetësime me revolucionarët e tjerë shqiptarë të mërguar, që kishin mendimet e tyre për nevojat e Shqipërisë.

Një nga njerëzit me të cilët Kelmendi u ndesh në Paris ishte Llazar Fundo, i cili gjithashtu kishte qenë në Moskë por ishte ngritur kundër vijës staliniste dhe ishte bërë, sipas terminologjisë komuniste, një trockist ose buharinist. Emri i Llazar Fundos do të dalë përsëri në këtë histori nga fundi i kohës së luftës si viktimë e një incidenti të egër, që shkaktoi shumë hidhësi ndërmjet oficerëve britanikë dhe Enver Hoxhës me partizanë. Rrënjët e këtij incidenti shkojnë pas deri te kundërshtimi i Fundos ndaj vijës staliniste të Kominternit në ditët para luftës. Një shqiptar tjetër që banonte në Moskë përpara lufte ka qenë Sejfulla Malëshova, i cili kur erdhi rasti u kthye në Shqipëri dhe u bë një nga shokët e Enver Hoxhës në udhëheqjen e lartë të Partisë Komuniste Shqiptare gjatë luftës. Sipas Fundos (i cili ia ka treguar këtë histori Xhulian Emerit / Julian Amery) Sejfulla Malëshova ishte përpjekur që Fundon ta nxirrte në Gjirokastër në Moskë, por ai, Fundoja, u lirua dhe u lejua të largohej nga Bashkimi Sovjetik falë marrëdhënieve të mira personale me Gjergj Dimitrovin. Pasi u largua nga Bashkimi Sovjetik dhe pati fërkime me Ali Kelmendin në Paris, ai u kthye në Shqipëri dhe për një kohë u tregua aktiv në Korçë, para se ta arrestonin italianët. Edhe Enver Hoxha veproi në Korçë dhe, me sa duket, që të dy këta kanë qenë rivalë e armiq aty për një periudhë të shkurtër më 1938-1939). Fundoja vështrohej si një tradhtar mjaft i rrezikshëm nga Moska dhe Kominterni, aq sa Titoja e ka përmendur atë se meritonte të shtypej, në një letër që i dërgonte Partisë Komuniste Shqiptare të sapoformuar në shtator 1942 (shih në faqet më poshtë). Vrasja e egër e Fundos nga par-

tizanët në Shqipërinë e Veriut më 1944 (shih kreun XII) duhet të shihet si një akt shpagimi për ndeshjen e Fundos para lufte me Malëshovën e të tjerët në Moskë, me Kelmendin në Paris, me Hoxhën në Korçë dhe në përgjithësi me Kominternin. Enver Hoxha në momentin e përshtatshëm vendosi ta shohë veten si ai që mori përsipër mantelin e udhëheqjes nga Kelmendi: atëherë Kelmendi kishte, nga pikëpamjet e Hoxhës, meritën e madhe se kishte dalë nga skena dhe prandaj nuk do të ishte rivali i tij. Që në krye Enver Hoxha e tregoi veten se ishte një manovrues i shkathët në aspektet e ngjashme me mafien të politikës komuniste. Ngjarja me Fundon do të tregonte se ai kishte edhe një kujtesë të gjatë e të pamëshirshme.

Koço Tashkoja u kthye në Shqipëri më 1937 pa Ali Kelmendin. Mesazhi që solli me vete nga Kominterni u mor në dorë nga Grupi Komunist i Korçës, në të cilin Tashkoja ishte në anëtar udhëheqës dhe ku vepronte aktivisht Enver Hoxha. Nga ana tjetër, grupet në Shkodër e në Tiranë e hodhën poshtë atë. Komunistët e Shkodrës e mohonin se ekzistonin kushtet ekonomike e shoqërore në Shqipëri, që do të lejonin të ndiqej një politikë e frontit popullor. Megjithatë fati (apo mos ka qenë ndonjë tradhti?) ndërhyri dhe shumica e Grupit të Shkodrës u arrestuan e u futën në burg në janar 1939. Ndërkohë Grupi Komunist i Korçës (ndonëse siç duket, me lëkundje) e kishte prishur strukturën e vet formale, duke menduar për ta kaluar në ilegalitet, dhe i kishte përqendruar përpjekjet në ndihmën për të organizuar një opozitë me bazë më të gjerë, që pati një farë suksesi në zgjedhjet bashkiake.

Kur Italia e pushtoi Shqipërinë më 7 prill 1939, komunistët shqiptarë me sa duket ishin tepër të dobët, të shpërndarë e të përçarë, kështu që nuk mund të ndërmerrnin ndonjë veprim të efektshëm. Grupi i Korçës bëri thirrje për një luftë nacionalçlirimtare me pjesëmarrjen e gjithë klasave dhe ideve, pra duke zbatuar një vijë të drejtë lidhur me udhëzimet e Kominternit, por ata nuk mund të bënin asgjë nga ana e veprimeve praktike, me përjashtim të disa demonstratave në rrugë. U ndërmor një hap drejt unitetit nëpërmjet një marrëveshjeje midis grupeve të Korçës e të Shkodrës për të ngritur një Komitet Qendror të përbashkët, të përbërë nga dy përfaqësues për secilin grup, por shpejt kjo u prish dhe mosmarrëveshjet u rikthyen, duke pasur kundërshtime si brenda shumicës së grupeve komuniste të vendit, ashtu edhe ndërmjet tyre.

Në fillim të vitit 1940 karriera e Enver Hoxhës bëri një hap përpara. Korça shtriu një krah drejt Tiranës, kryeqytetit, dhe ngriti atje një grup me Hoxhën (tashti në moshën 32 vjeç) si drejtues të tij. Ai kishte gjetur punë si mësues në gjimnazin e Tiranës dhe në Liceun e Korçës që kur ishte kthyer në Shqipëri. Pas vitit 1940 nuk përmendet më që të ketë dhënë mësim. Enver Hoxha-ashtu si Titoja në Jugosllavinë e paraluftës, zuri një vend në tregtinë e duhanit. Tregtia e duhanit i jepte një mbulesë të shkëlqyer për të ngritur një rrjetë të fshehtë kontaktesh.

Gjatë vitit 1940 proceset e bashkëlindura të përçarjes brenda grupeve dhe midis tyre në Shqipëri, që e shihnin veten si komuniste, me sa duket u bënë edhe më të theksuara. Grupi i të Rinjve në Korçë u shkëput nga vija e drejtuesve të tyre. Grupi i Shkodrës edhe një herë ishte në marrëveshje me Grupin e Korçës. Grupi i Zjarrit e çoi shmangien nga vija deri në atë pikë, sa të sugjeronte se shpresa më e mirë në rrethanat e Shqipërisë do të ishte të punonte me regjimin fashist italian me qëllim që ta minonte atë nga brenda. Nga ana tjetër, forcat jashtë lëvizjes komuniste pënisnin të lidheshin për të krijuar një situatë, në të cilën madje edhe komunistët e përçarë e të brejtur nga fraksionet ta gjenin të vështirë të mos bashkëpunonin. Ndjenjat dhe interesat kombëtare dhanë një forcë lidhëse të mundshme.

Italianët nisën të pësojnë fatin e gjithë pushtuesve dhe gjithnjë e më tepër po ngjallnin pakënaqësi. Në qershor Italia hyri në luftë dhe në tetor sulmoi Greqinë. Nga nëntori forcat greke i kishin dëbuar italianët nga Korça e Gjirokastra. Por grekët, me pretendimet e tyre për Epirin e Veriut nuk kishin asgjë se çfarë t'u ofronin shqiptarëve, gjë që nuk ishte aspak më tërheqëse se sa prania italiane. Komunistët e Korçës nisën të vepronin kundër grekëve, ndërsa agjitacioni kundër italianëve preku telat e popullit. Në maj 1941 u bë një atentat për vrasjen në Tiranë të mbretit Viktor Emanuelit III. Afërsisht po në atë kohë Myslim Peza, një udhëheqës i njohur ose një nga «krerët» e vendit, po nxishte kujtesën kombëtare për qëndresën kundër pushtuesve nëpërmjet fillimit të aksionit të parë të armatosur kundër italianëve. Italianët shpresonin ta bënin sundimin e tyre më popullor, duke krijuar Shqipërinë e Madhe nëpërmjet bashkimit të trojeve nga Jugosllavia e Greqia, por përpjekjet e tyre bënë efekt të kundërt. Ndjenja kombëtare shqiptare ishte ndezur. Por qenë gjermanët dhe jo italianët ata që bënë më shumë për të krijuar kushtet e fa-

vorshme që të rritej komunizmi në Shqipëri. Disfata që i shkaktuan Jugosllavisë në prill 1941 dhe vërshimi në Greqi e marrja e saj e shkatërruan rendin e vjetër në Ballkan. Këtu, ashtu si edhe në pjesën tjetër të Europës, ata çelën një periudhë mizorish, dhune dhe përmbysjesh, nga të cilat nuk mund të mos përfitonte edhe grupi komunist më i dobët. Dhe duke sulmuar Bashkimin Sovjetik më 22 qershor 1941 e duke ngjallur kështu luftën antifashiste, rreth së cilës mund të grumbulloheshin komunistët kudo në botë, gjermanët i dhanë rrugë një procesi, që shumë shpejt ndihmoi për lindjen e një force të re organizuese në Shqipëri — të një Partie Komuniste Shqiptare të vetme, të bashkuar.

Enver Hoxha thotë⁹⁾ se u takua me Myslim Pezën kur ky kishte nisur qëndresën e armatosur kundër pushtuesit. Ai thotë gjithashtu se kishte pasur kontakte me elementet «e mirëndërmjet komunistëve të Shkodrës dhe e paraqet veten si ura lidhëse ndërmjet Korçës, Tiranës e Shkodrës, duke hedhur kështu konturet e një lëvizjeje komuniste të bashkuar për gjithë vendin. Në gusht 1941 u arrit marrëveshja ndërmjet këtyre grupeve për të bashkëpunuar në veprimet antifashiste dhe u organizuan demonstrata e manifestime në Korçë e në Tiranë. Më e rëndësishmja ishte marrëveshja e arritur në gusht për të organizuar një takim të të gjitha grupeve me qëllim për të themeluar një Parti Komuniste të Shqipërisë.

Në këtë pikë hyn në valle Partia Komuniste e Jugosllavisë (PKJ), dhe bashkë me këtë çështja e pazgjidhshme e Kosovës (sipas serbëve, Kosovo) doli në sipërfaqe sërish. Sipas Vladimiri Dediçerit,¹⁰⁾ PKJ u interesua për të nxitur një farë veprimtarie komuniste në Shqipëri në verën e vitit 1939. Miladin Popoviçi, një malazias (në atë kohë Kosova ishte e grupuar me Malin e Zi në Strukturën e brendshme të PKJ), u dërgua të hynte në kontakt me Grupin Komunist të Shkodrës, më të afërtin me Malin e Zi, me synimin të hetonte se çfarë hapash mund të ndërmerreshin për të formuar një parti komuniste në Shqipëri. Mund të supozohet se PKJ kishte si motiv vështirësitë që kishte pasur për të ngritur në këmbë një lëvizje ndërmjet popullsisë shqiptare në Kosovë. Nëse mund të krijohesh në Shqipëri një parti bijë ose ndoshta një parti motër më e re, mund të bëhej më e lehtë që me ndihmën e një partie të tillë, të hidhej fara e komunizmit në Kosovë. Misioni i Popoviçit nuk pati sukses. Historia e Partisë së Punës të Shqipërisë nuk e përmend këtë gjë: nga pikëpamja e Enver Hoxhës të bazuar në Korçë, ishte shkuar në adresë të gabuar duke vajtur në Shkodër.

Kongresi V i Partisë Komuniste të Jugosllavisë u mbajt në verë të vitit 1940 dhe Miladin Popoviçi mbajti një raport për situatën në Shqipëri¹¹). Kongresi riafirmoi një rezolutë që ishte pranuar më 1938 me idenë se Kosova duhej t'i për-
fiste Shqipërisë siç i takonte, në përputhje me porosinë e Kominternit, që kufijtë e Ballkanit duhej të rishikoheshin në pajtim me parimin e vetëvendosjes. Ishte madhësia e distancës në të cilën ndodhej më 1940 PKJ larg pushtetit, e cila e bëri të nënshkruante një formulë të tillë aq fisnike, dhe, siç do ta tregonin shumë shpejt ngjarjet, aq jorealiste (jorealiste sepse asnjë parti ose udhëheqës jugosllav nuk mund ta përballonte që t'i largonte serbët nga vetja duke e lëshuar Kosovën, të cilën serbët e shohin si pjesë të mbretërisë së tyre historike). Kongresi i PKJ vendosi ta shkëpuste Kosovën prej Komitetit Krahinor të Malit të Zi dhe të ngrihej një Komitet Krahinor i veçantë për Kosovën e Metohinë (Kosmet)¹²) drejtpërdrejt i varur nga Komiteti Qendror. Komitetit Krahinor të Kosmetit iu kërkua që të ndërmerre hapa të menjëhershëm për të ndihmuar komunistët shqiptarë që të krijonin një parti komuniste dhe të hidhnin bazat për një lëvizje të rezistencës.

Për një periudhë pas kësaj nuk ndodhi asgjë, sepse Miladin Popoviçi, i cili duhej ta kryente këtë mision, u kap nga italianët, afër Mitrovicës (ndërkohë Kosova ishte bërë pjesë e Shqipërisë së Madhe të ngritur nën kontrollin italian pas rënies së Jugosllavisë) dhe kështu doli jashtë veprimit. Në shtator 1941 një emisar tjetër nga PKJ u dërgua në Shqipëri, një anëtar i Komitetit Qendror të PKJ, Dushan Mugosha. Edhe një herë Grupi i Shkodrës, u bë pikësynimi i parë. Ai mori kontakte edhe me Grupin e Korçës, por me sa duket ata ia prenë me sëpatë të madhe. Kur ai u kthye në Jugosllavi, Grupi i Korçës e mendoi edhe një herë punën dhe hyri përsëri në lidhje me të. Në tetor ai u kthye në Shqipëri dhe u bashkua me komunistët shqiptarë për të çliruar Miladin Popoviçin nga internimi. Ky është varianti që japin jugosllavët për këtë ngjarje¹³). Versioni shqiptar e paraqet lirimin e Popoviçit si meritë vetëm të shqiptarëve dhe nuk e përmend Mugoshën¹⁴).

Megjithatë varianti shqiptar dhe varianti jugosllav pajtohen në një gjë, që në Tiranë më 7 nëntor 1941 u mbajt një mbledhje e përfaqësuesve të grupeve të ndryshme komuniste, duke marrë pjesë edhe Miladin Popoviçi e Dushan Mugosha. Pohimet e shqiptarëve (domethënë pohimet e Enver Hoxhës) ua japin iniciativën për këtë mbledhje vetë shqiptarëve, duke quajtur si pikënisje marrëveshjen e tyre të gushtit për të ba-

shkëpunuar në veprimet antifashiste. Pohimet jugosllave ia japin iniciativën PKJ, pra Mugoshës dhe Popoviçit. Në mbledhje u mor vendimi për të themeluar Partinë Komuniste të Shqipërisë dhe u caktua një Komitet Qendror i Përkohshëm prej shtatë anëtarësh. Sipas marrëveshjes, asnjë nga krerët ose zëvendësit e tyre të grupeve themeluese nuk do të pranohesh si udhëheqës. Komiteti Qendror nuk caktoi një sekretar, por Enver Hoxha do të bashkërendonte punën. Në këtë mbledhje themeluese pati vetëm pesëmbëdhjetë pjesëmarrës, një fakt që të bën të mendosh se PKSH në këtë etapë ekzistonte vetëm si një embrion dhe madje edhe si embrion ishte e dobët. Në këto rrethana nuk është për t'u habitur që PKJ në një kohë të përshtatshme do të pretendonte se ajo ishte krijuesja e PKSH. Gjithashtu kuptohet lehtë se Enver Hoxha, i cili e pa veten në shkallinën e fundit të shkallës së re partiake, do të ngulmonte që iniciativa ishte e shqiptarëve, ndërsa jugosllavët vetëm sa ndihmuan. Nga komunistët udhëheqës, emrat e të cilëve do të dalin më pas në këtë libër, anëtarët themelues të partisë në nëntor 1941 kanë qenë këta: Enver Hoxha, Ymer Dishnica, Ramadan Çitaku, Koçi Xoxe, Nako Spiru, Tuk Jakova, Liri Gega, Bedri Spahiu, Kadri Hoxha dhe Hysni Kapo¹⁵).

Edhe në këtë etapë të hershme, me sa duket Enver Hoxha kishte një përfytyrim të qartë për rëndësinë e ideologjisë, të një vije partie të përcaktuar mirë, si mjet të disiplinës dhe armë në luftën për pushtet. Llazar Fundoja, përgjithësisht trokistët, ekshponentët e kompromisit politik dhe Grupi i Zjarrit, të gjithë u denoncuan në mbledhjen themeluese. Menjëherë pas kësaj u vu në rend të ditës një detyrë e madhe organizative. Miladin Popoviçi ndenji në qendër me Enver Hoxhën, ndërsa Dushan Mugosha dhe dy-tre kolegë shqiptarë u ranë rrotull qyteteve kryesore të Shqipërisë¹⁶). Nga janari 1942 ishin zgjedhur rreth 200 komunistë nga anëtarët e grupeve të vjetra dhe u grupuan në tetë komitete krahinore, që mbulonin gjithë vendin. Anëtarët e padëshiruar të grupeve të vjetra u përjashtuan ose u hoqën mënjanë. Secili lidhej lart me Komitetin Qendror të Përkohshëm. U pranuan disa anëtarë të rinj. Në nëntor 1941 u formua Organizata e Rinisë Komuniste. Nga fillimi i vitit 1942 u krijuan njësitet e para të vogla guerilje dhe ndërmorën disa aksione të vogla. U bënë plane për të ngritur në kohë njësite partizane.

Mund të shquhej një tipar i punës së mëvonshme të Enver Hoxhës. Baza nga e cila ai nisej për të vepruar ishte

e ngushtë si numër, e pasigurtë ideologjikisht dhe pa dyshim laramanë si cilësi, por kjo nuk i pengoi atë dhe kujdestarët e tij jugosllavë që të shtronin detyra shumë ambicioze, madje pretenduese, duke konturuar një strukturë organizative të qartë për t'i kryer ato detyra dhe duke u kërkuar atëhere me ashpërsi përpjekje të paprera dhe sakrifica kolegjëve e vartësve të tij për t'i kthyer në realitet aspiratat e veta. Rritja e shpejtë e partisë në vitin e parë të jetës së saj, me Hoxhën në qendër, paralajmëronte kursin e patundur që ai do t'i impononte Shqipërisë për dyzet vjetët e ardhshme.

Si qëllim i partisë së re u shpall: «Të luftohet për pavarësinë kombëtare të popullit shqiptar dhe për qeverinë demokratike popullore në një Shqipëri të lirë prej fashizmit». Partia duhej «të bashkohej me të gjithë nacionalistët që duan me të vërtetë Shqipërinë e lirë...» Këto parulla përmbanin farën e frontit nacionalçlirimtar. Prapa tyre mund të shihet lehtë frymëzimi jugosllav. Ato nuk ishin në mospërputhje me vijën e paraluftës për frontin popullor të Kominternit ose me çështjen e luftës së madhe patriotike që po dëgjohej nga Bashkimi Sovjetik. Ato patën meritën se e vunë PKSH të sapoformuar në rymën kryesore të ngjarjeve bashkëkohore dhe i dhanë të drejtën për të folur për kombin shqiptar. Kjo kërkesë ishte përtej shpatullave të vetë partisë, po të mbahet parasysh prejardhja e saj prej fraksioneve dhe qenia e brishtë, por ishte një pretendim, të cilin Enver Hoxha do ta shfrytëzonte me energji të madhe dhe që përbënte një shfaqje të palëkundur për drejtësinë e tij këtej e tutje.

Nga prilli i vitit 1942 organizimi kishte përparuar në mënyrë të mjaftueshme për të bërë një mbledhje konsultative të aktivitetit të partisë. Ajo vendosi që partia të bënte kërkesë për t'u bërë anëtare e Internacionales Komuniste. I dërguari jugosllav, Dushan Mugosha, i cili kishte qenë në Shqipëri që nga fundi i tetorit 1941, u nis për në vendin e vet me një kërkesë që PKJ do t'ia transmetonte Kominternit. Me sa duket nuk u ngrit çështja e një komunikimi të drejtpërdrejtë ndërmjet PKSH dhe Moskës. Dushan Mugosha mori me vete një drejtues komunist shqiptar, që iu atashua për këtë mision, por ia doli mbanë ta linte prapa përpara se të arrinte në Jugosllavi. Miladin Popoviçi mbeti me PKSH. Është e qartë nga akuzat që u bënë kundër Enver Hoxhës në Plenumin e Beratit në vjeshtë 1944 (për të cilin shih hollësisht më poshtë), se Popoviçi ishte shumë i afërt me të dhe ka marrë pjesë plotësisht në udhëheqjen e partisë.

PKSH iu desh të priste gjatë deri sa Dushan Mugosha të sillete përgjigjet nga PKJ dhe Kominterni. Duke pritur dokumentet e gradimit, ajo e drejtoi më 1942 veprimtarinë e vet në dy drejtime kryesore: nga njëra anë, në pastrimin, ripërbërjen dhe konsolidimin e vet, nga ana tjetër, në krijimin e Lëvizjes Nacionalçlirimtare (LNÇ). Procesi i spastrimeve duhet ta ketë bërë partinë më të përshtatshme për ta drejtuar Enver Hoxha. Në një konferencë të jashtëzakonshme, që u mbajt në Tiranë më 28 e 29 qershor, u përjashtuan dy anëtarë të udhëheqjes, të cilët e kishin vënë në dyshim mundësinë që, në kushtet e Shqipërisë së prapambetur, të mobilizoheshin masat dhe të formohej një aleancë e frytshme ndërmjet punëtorëve e fshatarëve. Dy personalitete të tjera të shquara, emrat e të cilëve do të bëheshin të njohur mirë për oficerët britanikë që do të shërbenin me partizanët më 1943 e 1944, Mustafa Gjinishi dhe Koço Tashkoja, morën vërejtje sepse kritikuan direktivat e partisë (ndoshta të Hoxhës). Që të dy kishin një cilësim të rrezikshëm, sepse kishin një përvojë më të gjerë se Hoxha, kështu Tashkoja që nga përgatitja e tij në Moskë me Kominternin dhe Gjinishi nga veprimtaria e paraluftës në gazetari e në agjitacionin politik në Shqipëri e në Jugosllavi. Sipas Hoxhës, ata ishin të pakënaqur sepse nuk u preferuan në parti. asnjëri prej tyre nuk u përfshi as në Komitetin Qendror dhe as në Komitetet e Qarqeve. Komiteti i Qarkut të Gjirokastrës u shpërnda (sekretari i tij, Bedri Spahiu, kishte një njollë të hershme nga simpatia për Grupin e Zjarrit dhe ai ishte një tjetër nga ata, me të cilët oficerët britanikë do të kishin të bënin më 1943 e 1944). Ndonëse partia ishte e re, ajo iu nënshtrua një pastrimi të përgjithshëm në shkallë vendi, pas spastrimeve më të rëndësishme të bëra në Konferencën e Jashtëzakonshme të partisë. Në gusht Hoxha dhe udhëheqja siguruan një mjet të rëndësishëm për të imponuar një vijë partie uniforme: nisi botimin për herë të parë gazeta e partisë «Zëri i popullit».

Më 16 shtator 1942 Enver Hoxha dhe kolegët e tij ndërmorën një hap me rëndësi shumë të madhe për veten dhe për Shqipërinë. Në Pezë, në zonën e Myslim Pezës, u mbajt Konferenca Nacionalçlirimtare Shqiptare. Ajo nuk ishte një konferencë e partive politike, por pjesëmarrësit nga PKSH natyrisht ndiqnin vijën politike të partisë dhe PKSH që nga ajo kohë e më pas ia atribuoi vetes udhëheqjen e LNÇ, Lëvizjes Nacionalçlirimtare. Duke e mbajtur Konferencën në Pezë, partia e lidhi veten me njeriun, që i pari e kishte ngritur

flamurin e qëndresës së armatosur. Morën pjesë edhe pak «nacionalistë», domethënë personalitete të shquara jo komuniste, krerë dhe udhëheqës lokalë. Më i njohuri prej tyre ishte Abaz Kupi nga Mati, i cili kishte një numër me rëndësi pasuesish në veri të Shqipërisë, mbështeste mbretin Zog dhe u kishte rezistuar me forcë italianëve për disa orë kur e pushuan Shqipërinë më 1939. Ishin ftuar të vinin, por nuk kishin pranuar, udhëheqës të tjerë «nacionalistë» më të rëndësishëm, bejlerët pronarë të Shqipërisë së Jugut dhe njerëz me ngjyrimë republikane e liberale, që kishin luajtur rol me rëndësi në Shqipëri që nga fillimet e pavarësisë. Shumë më vonë, në Plenumin e Beratit më 1944, një nga akuzat e ngritura kundër Enver Hoxhës, me inkurajimin dhe përkrahjen e jugosllavëve, ishte se ai ishte treguar shumë «sektar» gjatë përgatitjes së Konferencës së Pezës dhe kështu i kishte larguar shumë figura udhëheqëse të Shqipërisë. Me sa duket, në Pezë dhe më pas puna ishte se Enver Hoxha ishte më tepër i shqetësuar që të siguronte rolin drejtues të PKSH në rezistencën shqiptare, se sa të tërhiqte në një shkallë sa më të gjerë ndjenjat nacionaliste kundër pushtuesit. Nga kjo kohë ai tashmë do ta ketë pasur idenë për të marrë pushtetin me PKSH në fund të luftës dhe, si gjithnjë, ai po vinte në kartë një lojë shumë më të madhe se sa mund të përlligjej në atë kohë. Në Pezë ai nisi rrugën drejt pushtetit nga një bazë relativisht e ngushtë: duket qartë që ai parapëlqente më mirë këtë se sa ta ndante pushtetin me të tjerët.

Konferenca e Pezës zgjodhi një Këshill të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar dhe miratoi propozimet e bëra nga PKSH lidhur me zhvillimin e Luftës Nacionalçlirimtare dhe krijimin e këshillave nacionalçlirimtarë. Ata do të ishin përgjegjës për mobilizimin e popullit në luftë dhe do të përbënin bazën e qeverisjes nga «pushteti i popullit» në zonat e çliruara. Energjitë e PKSH tani drejtoheshin kryesisht nga formimi i njësiteve partizane dhe organizimi i luftës partizane. Ky proces përshkruhet në këtë mënyrë në Historinë e Partisë: «... komitetet qarkore të partisë dërguan nga qyteti në fshat (në mal) një numër anëtarësh partie, të rinjsh komunistë dhe simpatizantësh, të sprovuar në luftën e njësiteve guerile, me detyrë që të organizonin çetat. Rreth kësaj bërthame çetat u rritën kryesisht me fshatarë»¹⁷).

Lidhur me komandimin: «Komandanti në shumicën e rasteve nuk ishte anëtar partie, kurse komisari ishte përfaqësues

i partisë në çetë. Në çdo çetë kishte një celulë partie, që për-
bënte zemrën e saj»¹⁸).

Nga fundi i vitit 1942 llogaritet se kishte rreth 2.000 parti-
zanë të organizuar në njësite, plus një numër më i madh for-
cash territoriale ose rezervistësh lokalë. Ata ishin partizanë
të LNÇ (Lëvizjes Nacionalçlirimtare), jo partizanë të PKSH,
por siç e tregojnë pa mëdyshje citimet e mësipërme nga His-
toria e Partisë, ata ishin nën drejtimin e PKSH. Me aq sa
ishite e mundur, komandantët ishin njerëz me një farë përvoja
që e kishin marrë më tepër nga burime «kombëtare» se sa ko-
muniste, komisarët ishin kuadro partie; oficerët më të ulët
dhe ata pa detyra ishin kryesisht djem të rinj nga qytetet dhe
me një farë shkolle, ushtarët ishin fshatarë. Ata mbanin
yllin e kuq me pesë cepa. Enver Hoxha e kishte gjetur mjetin
për ta shumëfishuar fuqinë e partisë së vet komuniste fosh-
njore, të dobët, pa pasur nevojë të priste që ajo të rritej qoftë
numerikisht, qoftë ideologjikisht.

Në vjeshtën e vitit 1942 veprimtaria e gueriljeve parti-
zane ishte bërë e gjallë në atë masë, sa t'i detyronte italianët
të ndërmerrnin një dy sulme kundër forcave dhe qendrave
të partizanëve. Kështu nisi procesi i një cikli, që do të përsë-
ritej këtej e tutje: një aksion partizan herë serioz e herë më
i vogël, kundërveprim i italianëve i rëndë, represiv, por zako-
nisht pa e arritur qëllimin; përndjekje ndëshkimore kundër
fshatarëve shqiptarë; katandisje e më shumë fshatarëve shqip-
tarë në shkallën e varfërisë e pa shtëpi, gjë që nuk u lë atyre
shteg tjetër veçse të dalin partizanë.

Në dhjetor, pas një mungese prej gjashtë a shtatë muajsh,
Dushan Mugosha u kthye në Shqipëri me përgjigjet e PKJ
e të Kominternit për kërkesën e PKSH që të njëhej. Ai sho-
qërohej nga Bllazho Jovanoviçi, sekretar i PKJ në Malin e Zi.
Ata sollën një letër nga vetë Titoja, të muajit shtator.¹⁹) Nga-
dalësia e komunikimeve i jep një ngjyrë këmbënguljes së
mëvonshme të Hoxhës, se PKSH nuk ishte një kukull e PKJ
por i drejtonte vetë punët e saj, ndonëse pa ndihmën dhe
këshillat e një partie më me përvojë. Jovanoviçi ishte caktuar
si përfaqësues zyrtar i PKJ në Konferencën e Parë Kombëtare
të PKSH. Mbledhja e kësaj konference ishte parashikuar në
Konsultën e Aktivit në prillin e shkuar, por ajo nuk mund të
mbahej siç duhej deri sa të merrej njohja nga vëllezërit më të
mëdhenj jashtë Shqipërisë për të ngritur lart prestigjin e
udhëheqjes shqiptare. Nga fundi i dhjetorit, pas bisedimeve me
Bllazho Jovanoviçin dhe shqyrtimit të materialeve të shkruara

e këshillave gojore, që ai kishte sjellë me vete, Komiteti Qendror i PKSH (që ende ishte formalisht «i përkohshëm») vendosi të thërrasë Konferencën e Parë të Vendit të partisë në mars 1943.

Direktivat që i solli PKSH Jovanoviçi, të cilat përshkruhen nga Hoxha si direktiva të Kominternit, por që duket se mbanin vulën e Titos, bënin thirrje që populli të bashkohej në një front të vetëm për luftën antifashiste nacionalçlirimtare. Partisë i kërkohesh që të tërhiqte sa më shumë patriotë e nacionalistë të ndershëm në luftë dhe në drejtimin e luftës, të kujdesej që parullat e hedhura nga partia të mos kapërcenin përtej kërkesave të luftës (domethënë, që tani për tani ato të drejtoheshin për luftën çlirimtare kombëtare dhe jo për luftën e klasave). Ky ishte një mesazh jo aq i mirëpritur, sepse udhëheqësit «nacionalistë», të cilët kishin qëndruar larg Konferencës së Pezës dhe kështu kishin qëndruar jashtë LNC, në vjeshtë kishin formuar një organizatë të tyre, Ballin Kombëtar. Kjo nuk ishte një organizatë e centralizuar si LNC dhe programi i saj ishte më tepër pasiv se sa aktiv: të shmangej shkatërrimi i panevojshëm, të pritej dita për kryengritjen kombëtare kur fuqia pushtuese të ndodhej përballë disfatës përfundimtare, të ruhej Shqipëria për shqiptarët dhe të mbrohej ajo nga komunizmi. Historia zyrtare e PKSH pranoi në mënyrë të tërthortë se «Dalja e Ballit e ndërlikoi shumë situatën brenda vendit»²⁰).

Enver Hoxha e pa të nevojshme të jepte disa shpjegime. Në një letër për Komitetin e Qarkut të Korçës në janar 1943 ai ka shkruar për Ballin Kombëtar: «... me të vërtetë është një pengesë e madhe, sepse s'duhet me harrue influencën e tyre individuale në Shqipëri, dhe këta kanë mundur të krijojnë një psikozë në popull që ekziston një organizatë nacionaliste dhe që komunistët duhet të merren vesh me të e të bien dakord...»²¹)

Përfundimi i Hoxhës ishte se theksi duhej vënë në zhvillimin e luftës së armatosur kundër pushtuesve: kjo do t'i detyronte «nacionalistët» e Ballit Kombëtar ose të bashkoheshin me çështjen e LNC, ose të diskreditoheshin si bashkëpunëtorë të armikut. Ai e kishte zgjedhur me mprehtësi vijën e tij, por në vend që t'i rregullonte, ajo i rëndoi pasojat e dëmshme të dështimit për ta bërë LNC një lëvizje më të gjerë në fillimet e saj. Hoxha nuk ishte i gatshëm të pranonte çfarëdo parti tjetër politike si partner të barabartë dhe ngulmonte që jekomunistët të bashkoheshin me LNC si individë, ndërsa PKSH,

që funksiononte si parti e disiplinuar, të vepronte si udhë-
heqëse e saj. Ishte ky qëndrim që i dha shumicën e lëndës
atij pështjellimi, i cili gjatë dy vjetëve të mëpastajmë e bëri
më të lehtë për gjermanët ta mbanin Shqipërinë dhe në fund
shkaktoi që «çlirimi» të merrte kuptimin e diktaturës e të re-
presionit. Me qëndrimin e tyre didaktik, duke e parë PKS
si nxënësen dhe të përkujdesurën e tyre, PKJ dhe përfaqësue-
sit e saj së shpejti do ta kritikonin Hoxhën se po e çonte PKS
drejt një politike të papërshtatshme dhe se po zbatonte një që-
ndrim tepër të ngushtë në formimin e LNÇ. Marrëdhëniet e
vështira të Hoxhës me çdo komunist jugosllav me pozitë, për-
veç Miladin Popoviçit, këshilltarit dhe shokut jugosllav «të
përhershëm» të tij, nisin që nga kjo periudhë e hershme.

Nga fundi i vitit 1942 ngjarjet në Shqipëri ishin të lar-
gëta nga shqetësimet e fuqive të mëdha. Forcat anglo-ameri-
kane ende ishin të angazhuara për të siguruar Afrikën e Ve-
riut dhe nuk ishin në gjendje për të goditur drejt veriut për-
mes Mesdheut deri në gjysmën e dytë të vitit 1943. Ushtritë
sovjetike po jepnin e po merrnin goditje në betejën e Stalin-
gradit. Viti 1943 do të ishte viti në të cilin lufta mori një
kthesë vendimtare kundër Gjermanisë e Italisë dhe përsëri
filloi të vinte më afër Shqipërisë. PKS nën Enver Hoxhën,
bëri një karrierë spektakolare brenda Shqipërisë gjatë një viti
të ekzistencës së saj. Në vitin 1943 ajo do të vepronte në një
kontekst më të gjerë, meqë hyri në kontakt me forca nga
bota e jashtme.

Ndërkaq PKS i duhej të përfundonte procesin për t'u
bërë një parti plotësisht e organizuar. Këtë ajo e bëri në
Konferencën e Parë të Vendit, që u mbajt në Labinot nga
17 deri më 23 mars 1943, ku morën pjesë 70 delegatë dhe të
ftuar nga gjithsej 700 anëtarë partie. Ajo ishte ende e vogël
si numër dhe vuante nga ana ideologjike, por kjo nuk është
për t'u çuditur, pasi kishte lindur vetëm një vit më parë nga
rrënuja e fraksioneve në grindje, kishte pasur pak mundësi
për të përgatitur kuadro dhe i tërhiqte anëtarët e vet nga një
përzierje aspiruesish të papërvojë, të cilët mund ta besonin
veten se ishin marksistë në zemër, por shumë pak prej tyre do
të bëheshin ndonjëherë marksistë në mendjet e tyre.

Në krye të marsit, pikërisht para se të fillonte konfe-
renca, Enver Hoxha më në fund i lau hesapet me fraksionin e
Zjarrit dhe i përjashtoi heretikët «trockistë», ndërsa në kon-
ferencë bëri nja dy vërejtje për deviacionet ideologjike. Një
gështjë qendrore e konferencës ishte problemi i qëndrimit ndaj

Ballit Kombëtar. U përdorën shumë fjalët «sektarizëm» dhe «oportunizëm», ndër to «sektarizëm» do të thoshte një që ndrim që i largonte shqiptarët e zakonshëm e kështu e forconte Ballin Kombëtar, ndërsa «oportunizëm» do të thoshte qëndrime që do të çonin në kompromise me Ballin Kombëtar dhe kështu do të dobësohej kontrolli i PKSH mbi LNÇ. Vija që u miratua, dhe nuk ka dyshim se kjo ka qenë vija e Hoxhës, ishte që të mos bëheshin bisedime ose marrëveshje me Ballin Kombëtar, ndërsa lufta e armatosur (lufta nacionalçlirimtare) duhej të zhvillohej e fuqishme, duke shpresuar që kjo do t'i shkëpuste masat nga krerët «nacionalistë». Si një zgjerim logjik i këtij përfundimi, u pranua se shndërrimi i forcave partizane në një ushtri të rregullt ishte tani pikë e parë e rendit të ditës dhe se kjo ushtri do të bëhej sektori kryesor i punës së partisë në periudhën e mëtejshme. Konferenca zgjodhi një Komitet Qendror prej 15 anëtarësh dhe 5 kandidatësh dhe një Byro politike me Enver Hoxhën si sekretar të përgjithshëm.

Gjatë Konferencës Blazho Jovanoviçi bëri një fyerje (të paktën kundër Hoxhës), duke thënë se PKSH ishte krijuar nga dy komunistë jugosllavë. Miladin Popoviçi, që ishte njëri ndër ta, tregoi një ndjeshmëri më të madhe ndaj vetërespektit të shqiptarëve dhe ndaj ndjenjave të Hoxhës, duke kundërshtuar. Hoxha nuk ishte nga ata që mund t'i trembje. Titoja ndoshta në emër të Kominternit, kishte kërkuar informacionin e nevojshëm rreth anëtarëve të Komitetit Qendror (KQ). Hoxha sqaron se, për arsye sigurimi, emrat e atyre që u zgjodhën në KQ nuk u shpallën. Cilësitë e tyre u përshkruan dhe delegatët u ftuan të votonin për njerëzit pa u dhënë emrat, po që kishin ato cilësi. Kjo e bënte të pamundur t'i jepej përgjigje kërkesës së Titos për hollësi rreth tyre. Me sa duket, partia e re dhe me moshë të vogël, që tani po piquej pavarësisht nga foshnjëria, po niste të jepte shenja se ishte jo vetëm një fëmijë i jashtëzakonshëm, por edhe një fëmijë i vështirë.

Në maj, shumë shpejt pas Konferencës së Parë të Vëndit të partisë, u formuan batalionet e para të ushtrisë partizane nga grupet partizane ekzistuese, me shtabe zonash për të kontrolluar batalionet. Nga korriku ishin ngritur njëzet batalione. Është interesante se emri i Mehmet Shehut del për herë të parë në Historinë e Partisë në këtë pikë, por jo në një kontakt ushtarak. Pasi ishte kthyer në Shqipëri më 1942, ai ishte caktuar si sekretar partie i Qarkorit të Vlorës dhe u mor me

shtypjen e një fraksioni atje, duke pasur ndihmën e një vize të Enver Hoxhës.

Breth po kësaj kohe, fundi i prillit -- fillimi i majit 1943, të parët oficerë britanikë ndërlihdhës, major, Bill Maklin (Billy McLean) i trupave të Dragonëve Mbretërorë, dhe kapiteni David Smajli (David Smiley) i Rojeve të Kalorësisë Mbretërore, erdhën në Shqipërinë e Jugut, pasi ishin hedhur me parashutë në Greqi. Ata takuan udhëheqësit e PKSHE të LNÇ kur arritën në Labrinot, në verilindje të Elbasanit, në korrik. As ata, as personeli i SOE (Drejtoria e Operacioneve të Posaçme) në Kajro që i kishte dërguar, as Ministria e Jashtme Britanike dhe as SOE në Londër nuk ishin në dijeni të ngjarjeve që u përshkruan në këtë kapitull. Ata dhe oficerët e tjerë britanikë që i ndoqën pas, fituan gjatë detyrës së tyre në Shqipëri vetëm një përfytyrim të turbullt për rrugët nëpër të cilat Shqipëria kishte arritur në atë gjendje, në të cilën e gjetën. Enver Hoxha ka qenë dorëlëshuar me shkrimet e tij në vitet e fundit, por vetëm kur i pa rivalët e vet të përmbysur dhe «armiqtë» e tij në rrugë pa krye. Komunikimi, informimi sqarimi i aleatëve janë bërë në mënyrën më të njerë nga nevoja për të ditur gjatë luftës. Shpesh oficerët britanikë në Shqipëri në të vërtetë as lejoheshin të dinin madje edhe atë që duhej të dinin për të dhënë ndihmën e kërkuar. Ata detyroheshin të krijonin përfytyrimin për çështjet shqiptare, duke shfrytëzuar mendjemprehtësinë e tyre dhe hamendjet se çfarë kombinimesh njerëzore fshiheshin prapa dukurive të çuditshme me të cilat ndesheshin. Për këtë do të bjerë fjala në kapitujt e mëposhtëm.

Edhe dy pika kanë nevojë të trajtohen në këtë vështrim hyrës për fillimet e PKSHE të LNÇ.

Këshilli i Përgjithshëm Nacionalçlirimtar u thirr në Labrinot më 4 korrik dhe funksioni kryesor që iu kërkua ishte të miratonte krijimin e Ushtrisë Nacionalçlirimtare për të cilën PKSHE kishte vendosur në mars. U formua Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare me Enver Hoxhën si komisar. Komandant u bë një njeri që nuk bënte përshtypje, me emrin Spiro Mojsiu, i zgjedhur pa dyshim nga Hoxha si dikush që nuk kishte gjasë t'i sillte shqetësime. Shtabet e qarqeve u vunë nën komandën e Shtabit të Përgjithshëm. U vendos të vazhdohej me formimin e brigadave nga batalionet, që ishin ngritur në tre muajt e mëparshëm. Brigada I u formua më 15 gusht nën komandën e Mehmet Shehut.

Shumë shpejt pas Konferencës i të Vendit të PKSHE në mars, një kthesë të re morën marrëdhëniet ndërmjet PKSHE

dhe PKJ me ardhjen në Labinot të Svetozar Vukmanović Tempos, i dërguari kryesor i PKJ dhe i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare Jugosllave për Maqedoninë. Diskutimet me Tempon²⁾ e përqendruan vëmendjen në çështjen e Kosovës dhe të zonave kufitare të Maqedonisë, veçanërisht të Dibërës, ku popullsia ishte kryesisht shqiptare. Pasi u shpallua, Jugosllavia ishte copëtuar prej Gjermanisë e Italisë dhe shqiptarëve u ishte plotësuar ëndrra e tyre për të përfshirë në një atdhe të vetëm shqiptar Kosovën e Metoninë (ose, siç ngulmon t'i quajë Hoxha, duke përdorur termin shqiptar, Kraishin e Dukagjinit) dhe kraninën e Dibërës. Ishte e vështirë për shqiptarët, madje edhe për shqiptarët komunistë, të mos e miratonin, ndonëse ushqenin mosbesim. Shqiptarët e trojeve të sapobashkuara ishin të gëzuar që kishin shpëtuar nga sundimi serb dhe nuk kishin ndërmend të bënin asgjë për të lehtësuar rivendosjen e tij. Kjo e bënte Kosovën një çështje mjaft delikate ndërmjet PKSH dhe PKJ dhe si pasojë, një errësirë edhe më e madhe se sa zakonisht i rrethon trajtimet e saj. Botimet nga të dyja palët e bëjnë të mundur që të zbulohen prirjet e përgjithshme të ngjarjeve por vetë ngjarjet mund të rindërtonen vetëm si skelet.

Që nga viti 1942 Tempoja kishte pasur si detyrë të përpikëj të ngrinte rezistencën kundër italianëve dhe gjermanëve ndërmjet maqedonëve dhe shqiptarëve në Kosovë-Metohi, në Maqedoni dhe në zonat kufitare ndërmjet Maqedonisë jugosllave e Shqipërisë, Greqisë dhe Bullgarisë. Maqedonët nuk e kishin më shumë qejf sundimin serb se sa shqiptarët e Kosovës. Ata nuk kishin ndonjë arsye për një kryengritje kombëtare kundër italianëve e gjermanëve dhe ishin të pasigurtë se ku bënin pjesë. Bullgarisë i ishte dhënë një pjesë e madhe e Maqedonisë Jugosllave gjatë copëtimit të Jugosllavisë. Partia Komuniste Bullgare, ashtu si kushdo tjetër në Bullgari, ishte e prirur t'i vështronte maqedonët si të ishin në të vërtetë bullgarë dhe rrjedhimisht si një lëndë të përshtatshme më tepër për çlirimin nacional të maqedonëve se sa të jugosllavëve. Partia Komuniste Greke (KKE) po ashtu ishte e rezervuar për çdo hap që mund t'u krijonte përshtypjen grekëve se komunizmi ishte për ta humbur Greqia Maqedoninë greke. Detyra e Tempos ishte e vështirë. Ai zhvilloi idenë për t'i bindur partitë komuniste të Shqipërisë, Greqisë dhe Bullgarisë që të bashkoheshin me PKJ në krijimin e një Shtabi të Përgjithshëm Ballkanik që të bashkërendohej rezistenca në Maqedoni dhe rrotull saj. Në shkallën më të ulët, kjo përfshinte një skemë praktike për të siguruar

prejme të përbashkëta ushtarake në zonat kufitare, por në nivelet më të larta ajo dukej se ishte konceptuar si një parathënie për Federatën Ballkanike, me qëllimin e lartë për të kapërcyer problemet e pazgjidhshme të kombësive e të kufijve në «macédoine» të popujve, që karakterizonte Ballkanin e Jugut. Kishte një dyshim, më të fortë në PK të Bullgarisë, se ky ishte një komplot për të siguruar hegjemoninë jugosllave dhe pa dyshim për ta bërë të garantuar që Jugosllavia do ta rifitonte Maqedoninë. Ajo u shoqërua me një kërkesë që komunistët shqiptarë, grekë dhe bullgarë duhej të kopjonin modelin jugosllav të rezistencës nacionale, duke i çlirimtare dhe të pranoheshin shkatërrimet fizike masive dhe polarizimet sociale e politike brenda çdo vendi që do t'i sillte kjo me vete.

Kështu ndodhi që nga të tre vendet, Shqipëria, Greqia e Bullgaria, ishte vetëm Shqipëria ajo, në të cilën ideja e Tempos për një Shtab të Përgjithshëm Ballkanik preku një tel që i bënte jehonë. Kjo ndodhi sepse ai e mbështolli atë me një bisedë shumë ideale për vetëvendosjen. Pasi e kishte parë vetë gjendjen në Kosovë-Metohi dhe në zonën e Maqedonisë rreth Dibrës, ai ishte bindur se atje kishte pak shpresë për ta bashkuar popullsinë shqiptare në ato vise me çështjen e çlirimit nacional, me përjashtim vetëm të rastit që LNÇ shqiptare e udhëhequr nga PKSË të futej për të luajtur një rol atje. Një lëvizje rezistence e udhëhequr nga komunistët mund të ndizej madje edhe në Kosovë, nëse PKSË dhe PKSË do të punonin së bashku, e po ashtu lëvizja nacionalçlirimtare shqiptare dhe jugosllave, si dhe po të bindeshin njerëzit se fitorja në luftën për çlirim do t'u sillte të drejtën për të vendosur zgjidhjen e ardhshme të çështjes kombëtare. Ky propozim ishte shumë tërheqës për PKSË: ai u hapte komunistëve perspektivën për të arritur ndoshta çmimin e pakapshëm të bashkimit kombëtar të shqiptarëve. Nëse hapi i parë në këtë drejtim ishte formimi i një Shtabi të Përgjithshëm Ballkanik, ai ishte një hap që e vlente të bëhej.

Tempoja erdhi për vizitë të Enver Hoxha dhe udhëheqja komuniste shqiptare tri herë më 1943: në mars, në qershor dhe nga fundi i korrikut - fillimi i gushtit. Duke qenë një njeri i rrëmbyer dhe i hapur, ai shpejt arriti ta bënte të pakënaqur Enver Hoxhën me kritikën kundër përgatitjeve të LNÇ për luftën nacionalçlirimtare. Njerëzit nuk ishin mobilizuar në shkallë të mjaftueshme dhe formacionet partizane ishin ngritur më tepër mbi baza territoriale se sa si ushtri, duke

qenë larg nga ajo që ishte arritur në Jugosllavi. Tempoja i jep vetes meritën që ka dhënë udhëheqjes së PKSH shtytësën për të formuar brigada e më pas divizione të rregullta; një proces që nisi pak kohë më pas në korrik me formimin e Brigadës I. Nuk ka dyshim se Tempoja ka pasur një ndikim, por me sa duket ai merr si shumë gjëra për vete. Vendimi për të ngritur një ushtri me brigada e më pas divizione tashmë ishte marrë në Konferencën e Vendit të PKSH në mars, pikërisht para se të dilte në skenë Tempoja.

Tempoja pretendon se udhëheqja komuniste shqiptare po i zvarriste këmbët lidhur me mobilizimin dhe zhvillimin e luftës, sepse ishte tepër e zënë me përpjekjet për të arritur një marrëveshje me Ballin Kombëtar. Kursi i drejtë do të ishte rruga jugosllave, të intensifikohet lufta kundër pushtuesve, në mënyrë që elementët nacionalistë të detyroheshin ose të bashkoheshin me partizanët, ose të dilnin si bashkëpunëtorë të pushtuesit. Në fakt, kjo ishte strategjia që Enver Hoxha dhe kolegët e tij po përpiqeshin të ndiqnin, por situata politike dhe ushtarake në Shqipëri ishte shumë më pak «e pjekur» nga pikëpamja e komunistëve se sa në Jugosllavi. Balli Kombëtar ishte relativisht i fortë në mes të vitit 1943, PKSH ishte e re dhe ushtria partizane ishte në një fazë fillestare të rritjes. Kushdo që do të mendonte vetëm për kushtet ekzistuese në Shqipëri, do të kujtonte se një marrëveshje me Ballin Kombëtar do të kishte qenë rruga më e mirë përpara LNC, kështu që do të ndreqej «sektarizmi» i tepruar, që kishte shkaktuar të mbeteshin larg Konferencës së Pezës në shtator 1943 shumë krerë nacionalistë. Por Tempoja, si përfaqësues i PKJ, mund të mendohet se nuk ishte i interesuar në radhë të parë për atë çka ishte e mirë për Shqipërinë. Me siguri ai nuk ishte i interesuar për asgjë që do të inkurajonte nacionalistët dhe aspiratat e tyre lidhur me Kosovën. Kjo u bë plotësisht e qartë gjatë vizitës së tij në fillim të gushtit, kur ai luajti një rol për hedhjen poshtë nga LNC të marrëveshjes së Mukjes me Ballin Kombëtar, siç do ta shohim në kreun e katërt.

Për çështjen e Shtabit të Përgjithshëm Ballkanik megjithatë Tempoja dhe Enver Hoxha arritën në marrëveshje pa ndonjë vështirësi. Tempoja thotë se ishte Hoxha ai që e hartoi tekstin e përfundimeve të tyre për këtë çështje. Sipas tyre, kërkohej që LNC e Shqipërisë do të dërgonte dy detashmente në Veri të Shqipërisë për të bashkëpunuar me forcat e Kosmetit në drejtimin e Fadil Hoxhës, një koleg i vjetër i Miladin Popoviçit, i cili ishte caktuar nga Ushtria Nacional-

çlirimtare e Jugosllavisë të merrte komandën në Kosovë. Gjithashtu i kërkohej LNÇ të dërgonte një detashment për të bashkëpunuar me komandën maqedone në zonën Dibër-Kërçovë. Me këtë njësit do të ngarkohej një nga figurat udhëheqëse të PKSH, Haxhi Lleshi, i cili ishte nga krahina e Dibërës. Ishte vënë një qëllim i qartë për të inobilizuar masat e shqiptarëve, të cilët për shkak të urrejtjes shoviniste të serbëve në këto zona, rrinin mënjanë nga lufta nacionalçlirimtare. Gjithashtu u pohua qartë se pjesëmarrja në luftë do të ishte një garanci për popullin e Kosovës e të Metohisë që do ta përcaktonte vetë të ardhmen e tij. Veç kësaj u shtua që Shtabi i Kosovës do të duhej të vihej nën komandën eprore shqiptare, nëse kjo manovër do të shërbente për të ngjallur besim ndërmjet popullsisë shqiptare, por Tempoja e kundërshtoi këtë me arsyetimin se një propozim i tillë nga vetë natyra duhej të diskutohet me Komandën eprore jugosllave, meqë mund të shkaktonte pakënaqësi të madhe ndërmjet serbëve. Nuk është për t'u habitur që Enver Hoxha i pranoi me gëzim këto propozime dhe bashkë me to pranoi idenë e një Shtabi të Përgjithshëm Ballkanik.

Nga Shqipëria Tempoja bëri dy vizita në Greqi, duke u përpjekur të sigurojë miratimin e Partisë Komuniste Greke (KKE) për propozimin e tij rreth Shtabit të Përgjithshëm Ballkanik. Të dyja herët ai mori me vete Koçi Xoxen, anëtar i Byrosë Politike të sapozgjedhur të PKSH, i cili meqë ishte nga Korça, mund të shpresohej se do të kishte interesa më të afërta në lidhjet me Greqinë. Ky ishte fillimi i marrëdhënieve të ngushta ndërmjet Koçi Xoxes e jugosllavëve, që pas lufte do të arrinin kulmin duke u bërë Xoxja kandidati i favorizuar i PKJ për të rrëzuar Enver Hoxhën. Xoxja duhet të ketë qenë ai shqiptari i pidentifikuar, të cilin gjenerali i brigadës E.C.W. Myers e përmend që merrte pjesë bashkë me Tempon në një takim me udhëheqësit e KKE në Cotili të Maqedonisë Greke nga fundi i qershorit 1943²³). Udhëheqja e KKE nuk tregojë entuziaste për idenë e Shtabit të Përgjithshëm Ballkanik dhe kishte mosbesim ndaj ndërlikimeve që sillnin planet për Maqedoninë të Tempos lidhur me Maqedoninë Greke, megjithatë një farë bashkëpunimi në zonat kufitare u arrit. Tempoja dështoi në përpjekjet për t'i bindur grekët që të zbatonin rrugën jugosllave për zhvillimin e luftës nacionalçlirimtare dhe iu mbush mendja se kjo ishte arsyeja përse KKE dhe EAM (Lëvizja Nacionalçlirimtare Greke e kontrolluar nga komunistët) dështuan në marrjen e pushtetit në Greqi nga fundi i luftës. Me Partinë Komuniste Bullgare

Tempoja pati edhe më pak sukses se me grekët. Edhe bullgarët gjithashtu nuk donin të merrnin mësim nga PKJ dhe vazhduan të ndiqnin rrugën e tyre bullgare lidhur me të dyja çështjet, me luftën nacionalçlirimtare dhe me marrëdhëniet me Maqedoninë. Shpejt shpresat që pati zgjuar Tempoja në udhëheqjen e PKSË lidhur me Kosovën, u bënë pak të thatuara. Nga dhjetori vetë Titoja ia mblodhi frerët Tempos. Atij iu tha të braktiste si idenë e Shtabit të Përgjithshëm Ballkanik, edhe mendimin se po të bashkoheshin shqiptarët e Kosovës me luftën nacionalçlirimtare, mund të ishin në gjendje të zgjidhnin shkëputjen nga Jugosllavia. Kjo teza e fundit, iu tha Tempos, do të ishte një kartë në duart e armiqve të luftës nacionalçlirimtare në Jugosllavi.

Komunikimi ishte i ngadalshëm dhe u desh disa kohë para se për PKSË të bëhej e qartë që PKJ po e mbyllte derën e vetëvendosjes për minoritetin e saj shqiptar. Megjithatë nga fundi i vitit 1943 Enver Hoxha tashmë kishte arsye t'i vlerësonte hapat e jugosllavëve më me kujdes. Nga njëra anë, Koci Xoxja dhe të tjerët po tregonin shenja se kishin më shumë dyshime se sa u vinte për inbarë qëndrimeve kritike të jugosllavëve për ecjen e punëve në Shqipëri dhe nga ana tjetër, jugosllavët po tregonin shenja se ishin mjaft të gatshëm për t'i përdorur shqiptarët pa u bërë ndonjë koncesion real aspiratave themelore të Shqipërisë. Për fat të keq, për Hoxhën dhe për PKSË, LNC Shqiptare nuk ishte në mes të vitit 1943 aq e fortë, sa të përfitonte me shpejtësi nga hapja që u ofroi Tempoja. Haxhi Lleshi mori një forcë partizane për në Dibër dhe përkohësisht e pushtoi qytetin pas kapitullimit të Italisë, por u dëbua nga gjermanët në nëntor (shih kreun 5). Partizanët shqiptarë u dukën në kufirin me Kosovën në dhjetor dhe ngritën një komandë të Kosmetit së bashku me partizanët jugosllavë, por ata u dëbuan nga gjermanët në shkurt 1944 (shih kreun 6). Sipas Enver Hoxhës, marrëdhëniet e tij me Tempon ishin ftohur nga vjeshta e vitit 1943. Letrat nga Tempoja ndërkohë po e akuzonin se po bënte mëkatin ideologjik të shovinizmit shqiptaromadh. Duket se edhe sjellja e Haxhi Lleshit në Dibër gjithashtu po quhej se ishte lyer me po atë ngjyrë. Kur Enver Hoxha i kërkoi Miladin Popoviçit t'i dërgonte një thirrje Titos rreth rëndësisë për të mbajtur shpresë te vetëvendosja e Kosovës, iu kthye vetëm një përgjigje negative me terma të një burri shteti. Një reagim tjetër kundërshtues erdhi nga Ivan Milutinoviçi, një anëtar i Byrosë Politike të Komitetit

Qendror të PKJ, i cili ishte në atë kohë në Malin e Zi dhe mbante kontakte me PKSH për mbështetjen e operacioneve partizane në Malin e Zi.

Kosova mbeti një zonë problematike për PKJ dhe PKSH vazhdoi të kishte nevojën e bashkëpunimit të PKSH në përpjekjet për trajtimin e saj. Nga ana e vet, PKSH vijoi të ishte e interesuar për bashkëpunimin, sepse kjo ishte e vetmja rrugë e mundshme për të fituar merita dhe për të treguar nëpërmjet punës organizuese aktive se popullsia shqiptare e Kosovës e meritonte vetëvendosjen. Enver Hoxha e kishte Miladin Popoviçin nga ana e vet dhe fusha fillestare e përgjegjësisë së Miladinit kishte qenë zona e Kosmetit. Siç duket, Miladini ka qenë i një pikëpamjeje me Enver Hoxhën, se rezistenca në Kosovë duhej të drejtohej nga Shqipëria dhe jo nga Jugosllavia (Serbia). Nga viti 1944 ai e humbi përkrahjen e udhëheqjes së PKJ dhe më 1945, pasi e thirrën në Jugosllavi, vdiq (siç e thotë historia zyrtare e PKSH, u vra në mars 1945 nga shërbimet sekrete jugosllave: një shënim në fund të faqes i botuesit Zoran Jovanoviç të librit të Tempos «Lufta për Ballkanin»²⁴), thotë se u vra në Kosovë më 1945 nga anëtarët e Ballit Kombëtar).

Miladin Popoviçi qëndroi në Shqipëri deri në shtator 1944. Dushan Mugosha del se ka qëndruar vetëm deri në prill 1944, duke kryer një mision si këshilltar dhe stërvitës endacak me Brigadën I dhe me brigadat e tjera të ushtrisë partizane, që ishte në procesin e formimit. Në një letër lamtumire me falenderime për të, të datës 22 prill 1944, Mehmet Shehu e përmend atë si «mësuesi ynë»²⁵). Por ka pasur një zbrazëti në komunikimin personal ndërmjet udhëheqjes shqiptare dhe asaj jugosllave gjatë kohës gusht 1943 (vizita e fundit e Tempos) dhe gusht 1944, kur erdhi një i dërguar tjetër i nivelit të lartë, i armatosur me një vijë kundër Hoxhës, ose të paktën me një vijë të papëlqyeshme për Hoxhën. Në kapitujt e mëpasëm do të trajtohet evoluimi i mëtejshëm i marrëdhënieve midis PKSH dhe PKJ lidhur me Kosovë-Metohinë dhe Dibrën. Pika që do përcaktonim këtu është se PKJ, pasi u bë kumbarë në pagëzimin e PKSH dhe në ngritjen më këmbë më 1941 e 1942, tashmë më 1943 po dilte se vështrohej, të paktën nga Hoxha, se ndoshta ishte e aftë të kthehej në një lloj tjetër «kumbarë». Kjo po ndodhte përpara se cilado nga fuqitë aleate, e në veçanti Britania, të niste të interesohej vetë gjallërisht për gjendjen e punëve në Shqipëri. Dhe si shumë gjëra të tjera që u paraqitën në këtë kapitull, edhe kjo mbeti

e fshehur për Britaninë e Amerikën edhe shumë kohë pasi at
do të shfaqnin interesimin e tyre.

Shënimet

1. Informacioni për periudhën para vitit 1928 është marrë nga Pano (1968).
2. Pas luftës Partia Komuniste e Shqipërisë mori emrin Partia e Punës e Shqipërisë. Unë e kam quajtur Partia Komuniste e Shqipërisë (PKSH) gjatë gjithë librit.
3. Informacioni për periudhën pas vitit 1928 është marrë nga «Historia e Partisë së Punës të Shqipërisë», botimi i dytë, 1982, si edhe nga Pano (1968).
4. Shih, për shembull, Foot (1976; 184).
5. Marmullaku (1975; 67-68, 72) jep biografitë e përmbledhura të Enver Hoxhës e të Mehmet Shehut.
6. «Historia e Partisë së Punës të Shqipërisë» (1982; 27).
7. Amery (1948; 151).
8. Dedijer (1949; 13).
9. «Historia e Partisë së Punës të Shqipërisë» (1982; 50). Unë e quaj si të pranuar që «Historia» është konceptuar nga Enver Hoxha.
10. Dedijer (1949; 10, 11) dhe Griffith 1963; 13) që citon Dedijerin.
11. Dedijer (1949; 11).
12. Në literaturën për marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave krahina e Kosmetit përmendet shumë, por pothuaj kurrë nuk përcaktohet. Kjo zonë shtrihet pa ndërprerje në verilindje të Shqipërisë së sotme ndërmjet Shar Planina (ose vargmali) nga jugu dhe Mokra Planina drejt veriut dhe hapet drejt lindjes në zonën e Prishtinës e të Mitrovicës. Nganjëherë e gjithë zona quhet shkurt Kosovë, disa herë quhet më me përpikëri Kosova dhe (trafshi) Metohia (Kosmeti).
13. Dedijer (1949; 12).
14. Hoxha (1982 b; 22).
15. Dedijer (1949; 18).
16. Dedijer (1949; 19).
17. «Historia e Partisë së Punës të Shqipërisë» (1982; 96).
18. Po aty.
19. Teksti i letrës gjendet te Dedijeri (1949; 32).
20. «Historia e Partisë së Punës të Shqipërisë» (1982, 100).
21. Po aty.
22. Mjaft nga pjesa e fundit e këtij kreu është nxjerrë nga Vukman

viç-Tempoja (1990). As Hoxha, as «**Historia e Partisë së Punës të Shqipërisë**», as Dedijeri dhe as Vukmanoviç-Tempoja nuk japin një rrëfim të plotë, me vijueshmëri për punët ndërmjet PKSH dhe PKJ. Është e nevojshme të ndërtohet historia duke bashkuar njoftimet e copëzuara, anekdotike, referimet dhe aluzionet në të gjitha shkri-
met e tyre.

23. Myers (1955, 211).

24. «**Historia e Partisë së Punës të Shqipërisë** (1982; 167) dhe Vuk-
manoviç-Tempo (1990; 67).

25. Dedijer (1942; 42).

Kreu 2

Qëndrimi britanik ndaj Shqipërisë

Në fillim të Luftës së Dytë Botërore Shqipëria kishte pak peshë në hesapet e cilësdo Fuqi, me përjashtim të Italisë. Britania ishte e interesuar ta mbante Italinë asnjënjëse dhe shpresonte të ishte e aftë për të arritur të një farë Billoku Ballkanik, duke përfshirë edhe Turqinë, që do të ishte në gjendje t'u qëndronte presioneve gjermane dhe do të plotësonte diplomatikisht, në rast se nuk e bënte dot ushtarakisht, garantitë që u ishin dhënë Greqisë dhe Rumanisë. Franca, duke qenë më e shkujdesur për reagimet e mundshme të Italisë dhe më ambicioze, u përpoq të nxiste një plan për një front ushtarak në Ballkan të bazuar në Selanik. Kjo ishte diçka jorealiste, po të mbahet parasysh shpartallimi që i kërcënonte armët franceze më 1940, por lufta e re në këtë fazë ende bëhej me idetë e vjetra. Bashkimi Sovjetik ishte i zënë kryekëput me përpjekjet për të vjelë frytet e agresionit gjerman në Europën Qendrore e Lindore, e ndërkaq e shmangte përziejën në luftë, me përjashtim të luftës kundër kundërshtarëve të vegjël e të izoluar siç ishin finlandezët. Duke i pasur sytë si gjithmonë, të hedhur nga ngushticat e Turqisë, Bashkimi Sovjetik u përpoq pa sukses ta shtynte Turqinë të nënshkruante një traktat, por i vetmi traktat që nënshkroi Turqia ishte me Britaninë dhe Francën. Bashkimi Sovjetik u tregua i pa aftë për një vizion dhe shpirtmadhësi që do të ishin të nevojshme për të ndihmuar qeveritë ballkanike në Rumania, Bullgari e Jugosllavi që t'u rezistonin presioneve gjermane. Vendet e Ballkanit, pasi e kishin parë çfarë u kishte ndodhur shteteve balltike, Polonisë e Finlandës si pasojë e faktit që

e kishin fqinjë Bashkimin Sovjetik, kishin më shumë frikë nga Bashkimi Sovjetik se sa nga Gjermania. Nëse frika e tyre kishte nevojë për t'u përligjur, Bashkimin Sovjetik e dha atë duke aneksuar Besarabinë dhe Bukovinën e Veriut në mes të vitit 1940, si mënyra sovjetike me të cilën u krentua Rënia e Francës.

Në përpjekjet për të trajtuar rrëmujën e Ballkanit, Britania dhe Franca përpara se të pushtohej ishin kështu të preokupuara me problemet që dilnin nga marrëdhëniet me Italinë, Greqinë, Jugosllavinë, Bullgarinë dhe Rumaninë. Shqipëria hynte në hesapet e tyre vetëm për atë sa cilido nga këto vende kishte interesa në Shqipëri. Shqipëria ishte një faktor i dorës së dytë në çdo drejtim. Ndonëse pak vjet më pas u bë e zakonshme të flitej për Shqipërinë si një nga viktimat e para të agresionit fashist, më 1939 nuk flitej me këtë gjuhë. Roli i Italisë si «mbrojtëse» e regjimit të mbretit Zog nuk ishte vështruar si në kundërshtim me interesat e Shqipërisë. Pavarësia e Shqipërisë që nga viti 1912 kishte pasur një histori të pasigurtë e të ndërprerë dhe vitaliteti i saj ishte vënë në dyshim. Për t'i rënë shkurt, interesi kryesor i Britanisë në Mesdhe gjatë vitit 1939 e 1940 ishte ta mbante Italinë që të mos hynte në luftë. Nga kjo del në dukje se, si pjesë e politikës shtetërore, ishte të pranohej heshturazi marrja e Shqipërisë nga Italia. Qeveria britanike e dha shenjën për këtë pranim, duke caktuar një konsull të përgjithshëm të ri në Durrës.

Kur Italia hyri në luftë si aleate e Gjermanisë më 11 qershor 1940 dhe Franca e mareshalit Petën kërkoi armëpushimin me Gjermaninë disa ditë më vonë, situata ndryshoi. Më 19 qershor qeveria britanike, duke u përgjigjur për një pyetje në parlament¹⁾, deklaroi se ruante të drejtën e veprimit lidhur me zotimet që i ishin dhënë në të kaluarën qeverisë italiane nërsa u përket zonave të Mesdheut, Afrikës Veriore ose Lindore dhe Lindjes së Mesme. Kjo do të thoshte *inter alia*, se tërhiqej pranimi i pushtimit të Shqipërisë nga Italia dhe se qeveria tashti ishte e lirë të përcaktonte një pozitë të re lidhur me të ardhmen e Shqipërisë, në rast se do të dëshironte. Për arsye të ndryshme, qeveria nuk e ndjeu të detrueshme ta bënte këtë. Mbreti Zog dhe mbretëresha Geraldina erdhën nga Franca në Angli, por vetëm si emigrantë privatë, jo si monarkë në mërgim, të dëbuar nga fuqitë e Boshtit prej një vendi aleat. Nuk kishte asnjë qeveri shqiptare në mërgim dhe asnjë plan për ta formuar. Ajo që ka më tepër rëndësi është se interesimi i Britanisë në Ballkanin Jugperëndimor ishte

tani shumë më tepër se kurdoherë për Greqinë dhe Jugosllavinë. Dihej se Greqia kishte pretendime për territorin e Epirit të Veriut në Shqipërinë e Jugut dhe mendohej se Jugosllavia do të paraqiste një pretendim në veri, nëse Greqia do të paraqiste të vetin në jug. Askush nuk mund ta parashikonte se çfarë do të bëhej me Shqipërinë. Edhe po të mendonim ndokush për interesat e Shqipërisë, ose më saktë për interesat e shqiptarëve, me që nuk ishte më një shtet shqiptar, ishte e pamundur ta gjeje me mend se ku do të mbështeteshin këto interesa në analizë të fundit. Sidoqoftë, interesat e Greqisë e të Jugosllavisë, që ndodheshin përballë kërcënimeve ushtarake të Italisë e të Gjermanisë, ishin shumë e shumë herë më imediatisht të rëndësishme.

Italia e sulmoi Greqinë më 23 tetor 1940. Në nëntor ushtria greke i dëboi italianët nga Korça në jug të Shqipërisë dhe në dhjetor nga Gjirokastra. Suksesi i Greqisë kundër italianëve ishte një arritje e madhe, por vetëm me përmasa lokale. Në prapaskenë fshihej rreziku më i madh për një mësymje drejt jugut të ushtrisë gjermane. Britania ishte e shqetësuar për të gjetur rrugët që të forcohej Greqia, po të ishte e mundur duke arritur një aleancë balikanike me pjesëmarrjen e Jugosllavisë e të Turqisë dhe, po të ishte e nevojshme me mbështetjen e drejtpërdrejtë ushtarake britanike. Sasia e burimeve që Britania mund të ofronte për një fushatë në Ballkan ishte tepër e vogël që t'i bindte Jugosllavinë dhe Turqinë ta përballonin Gjermaninë. Më në fund iu dha Greqisë mbështetje e drejtpërdrejtë ushtarake britanike, në kurriz të suksesit në Afrikën e Veriut dhe pa e shpëtuar Greqinë.

Në manovrimet për të ndihmuar Greqinë, për të goditur italianët dhe për ta tërhequr Jugosllavinë në aleancë të hapur, Shqipëria hyri në vetëdijen e britanikëve nga një kënd i ri. Agjentët britanikë të drejtuar nga MI(R), që ishte një degë e Ministrisë së Luftës, me detyrën për të nxitur luftime të parregullta, si dhe /ose Seksioni D (një seksion për masat aktive) i Shërbimit Informativ Sekret (SIS), po vendosnin kontakte me synimin për një depërtim të mundshëm në Shqipëri nga Jugosllavia që nga pranvera e vitit 1940. Përprjekjet e tyre u bënë me interes më të gjerë pasi hyri Italia në luftë në qershor dhe aq më tepër pasi italianët submuan Greqinë në tetor. Historia e kësaj ngjarjeje gjendet kryesisht në librin e Xhulian Emerit «Marshi i afrimit»²), e gjithashtu në librin e tij «Bijtë e shqiponjës» dhe në të Sër Aleksandër Glenit «Pikëmbështetjet kundër një shakulline». Në kreun e mëposhtëm jepet një analizë më e plotë. Këtu ka nevojë ve-

tëm të vihet në dukje se kjo sipërmarrje përfundoi me dështim. Qeveria jugosllave nuk qe e mundur të shtyhej për të lëvizur, madje edhe pas grushtit që rrëzoi regjencën e princit Pavël në mars 1941. Një forcë e vogël shqiptarësh, e cila në fund u udhëhoq për në Shqipëri nga një oficer britanik, nënkoloneli Oukli Hill (Oakley Hill, i cili më parë kishte ndihmuar për të drejtuar xhandarmërinë e mbretit Zog), u godit pa vështirësi nga italianët.

Ndonëse kjo aventurë britanike ishte bazuar në Kosovë, askush nga pala britanike në atë kohë nuk duket të ketë qenë i ndjeshëm për natyrën me thepa të çështjes së Kosovës, ose madje as ta ketë vështruar si një çështje që duhej marrë para sysh. Në fakt, gjatë luftës ajo do të provohej se ishte një çështje themelore ndarëse ndërmjet Shqipërisë e Jugosllavisë, një pengesë e madhe për rezistencën e efektshme kundër gjer-manëve në krahinat e Jugosllavisë të banuara nga shqiptarët dhe një truall diplomatik i paqëndrueshëm për të gjithë të jashtmit, që u përpoqën të luanin një lojë atje. Në vitet e para të luftës u nënvleftësuan nacionalizmi shqiptar dhe domethënia e tij në raport me Jugosllavinë. Malësori shqiptar ende pikurohej siç e kishte përvijuar Bajroni, besnik vetëm ndaj familjes e fisit të vet, pjesëtar i një race luftarake të pavarur me kokëfortësi dhe që pranonte vetëm ligjin e kanunit të maleve, sipas të cilit rregullat e rrepta të mikpritjes e bënin më të lehtë mbijetesën në mjedisin e ashpër, ndërsa rregullat e pamëshirshme të gjakmarrjes i mposhtnin llojet më të egra të krimeve ndërmjet grupeve e nëngrupeve fisnore. Kjo pikëpamje për shqiptarin ishte përfortuar në shekullin tonë nga shkrimet me simpati të Edith Durhamit dhe të miqve e pasuesve të saj, prej të cilëve njëra, Margaret Hezllak (Hasluck), e njohur në rrethin e saj si Fani Hezllak, ka luajtur një rol kryesor për grupet e veprimeve të posaçme që kishin të bënin me Shqipërinë në pjesën e parë të luftës. Ishte një pikëpamje që e kishin të gjithë ata, të cilët kishin jetuar e punuar në Shqipërinë e paraluftës të mbretit Zog, se fati politik i Shqipërisë përcaktohej më tepër nga malësorët e veriut, gegë, se sa nga toskët e jugut. Si pasojë, çelësi për një kryengritje kundër italianëve në Shqipëri më 1941 mendohej se ishte në Veri, ndër krerët dhe fiset gege, të nxitura nga Jugosllavia. Kjo llogari doli se ishte e gabuar në çdo aspekt, qoftë për mundësinë që të arrihej diçka përmes Kosovës, qoftë për aftësinë dhe përshtatshmërinë e malësorëve gegë të zakonshëm që të bënin një luftë gueriljesh moderne, si edhe për peshën politike që do të kishin fiset gege në Shqipëri kur

vendi do të hapej për fërkimet e botës moderne të motorizuar.

Në analizën e saj të shkëlqyer të «Politikës britanike në Europën Juglindore gjatë Luftës së Dytë Botërore» Elizabeth Barker e nis kapitullin rreth përpjekjeve për të nxitur një kryengritje në Shqipëri më 1941, duke thënë se ishte e natyrshme që Shqipëria duhej të ishte zgjedhur për eksperimentin e parë të Britanisë që të inkurajohej lufta partizane në Europën Juglindore; «ai vend i vogël malor, i largët... duke pikërisht vendi më i përshtatshëm». Ky koment pasqyron më përpikëri atë që mund të quhet pikëpamja romantike për Shqipërinë, së cilës i përmbaheshin një grusht britanikësh që e kishin njohur, kishin punuar dhe e kishin ndihmuar luftën e Shqipërisë për t'u konsoliduar si një shtet i pavarur që nga përfundimi i sundimit turk e deri më 1939. Për fat të keq për ata, të cilëve u pëlqen historia të jetë e thjeshtë dhe heroike me një dell nga natyra, kjo pikëpamje për Shqipërinë tashmë ishte e vjetruar kur nisi lufta dhe ky vjetrim u shpejtua në mos u gremis nga pushtimi italian. Por ky ndryshim vetëm ngadalë u imponua në vetëdijen e vëzhguesve të jashtëm, të cilët për qëllime praktike në atë kohë përfshinin vetëm vëzhguesit britanikë, dhe ndërlikimet e ndryshimit u bënë të qarta vetëm nga 1944 ose 1945. Jo vetëm që nuk ishte «pikërisht vendi më i përshtatshëm» për luftën guerilje më 1941 e më pas, por Shqipëria ishte ndoshta edhe më pak e përgatitur ose e përshtatshme se sa fqinjët e vet. Zhvillimi politik i vendit ishte tepër i prapambetur, ndjenja e fortë kombëtare e popullit të tij nuk ishte farkëtuar ende si një armë politike; marrëdhëniet e interesave ndërmjet krerëve dhe popullit nuk ishin të forta aq sa është e mjaftueshme për të mbështetur një luftë popullore dhe malet si kështjella, që u kishin dhënë mundësi shqiptarëve t'u qëndronin turqve në kohët e kalorësisë e të ushtarëve këmbësorë, nuk do të përmbaheshin lehtë nga rekrutët e pastërvitur dhe të pamësuar me bombardimet moderne në ditët e forcave ajrore e të kolonave të motorizuara.

Në kohën që plani i Seksionit D dhe MI(R) për një kryengritje shqiptare dështoi, Drejtorja e Operacioneve të Posaçme (SOE) tashmë ishte ngritur në Londër me Z. Hugh Dalton në krye, duke marrë përsipër veprimet e MI(R) dhe të Seksionit D. Kjo u bë në vjeshtën e vitit 1940. Të menduarit e SOE për Shqipërinë prirej të ishte edhe më aventuror se ai i Ministrisë së Jashtme (FO). Kur përfaqësuesit e SOE në Beograd po përpunonin planet e tyre për një kryengritje në

Shqipëri më 1940 dhe në fillim të 1941, ata u përpoqën të sillnin në skenë mbretin Zog. Ata u përpoqën të bindnin SOE në Londër që të kërkonte një intervistë me mbretin Zog, e cila mund të botohej dhe mund të ndihmonte për të kapërcyer rivalitetet ndërmjet të mërguarve në Stamboll³). Kur u konsultua qeveria greke për këtë ide, një përgjigje e 12 shkurtit 1941 nga z. Koricis, që ishte bërë kryeministër i Greqisë pas vdekjes së gjeneralit Metaksa, në procesverbalet e FO është përshkruar si «e hapur». Ajo e kritikonte mbretin Zog si një persekutues çnjerëzor të kundërshtarëve politikë, kundrejt të cilëve ai kishte treguar «une haine irréductible», si persekutues i minoritetit grek në Shqipëri dhe si njeriu që kishte shkaktuar «la plus cruelle déception» madje dhe midis shokëve të tij më të afërt. Ajo shtronte pyetjen se çfarë donte të thoshte Zogu kur u referohej, siç dihej se kishte bërë, «kufijve ligjorë e të ligjësuar» të Shqipërisë. Ajo pohonte prerazi se minoriteti grek në Shqipëri ishte i rëndësishëm dhe nuk mund të krahasohej nga pesha e vogël me minoritetin shqiptar në Greqi.

Kjo përgjigje ishte e mjaftë për ta bërë Ministrinë e Jashtme që të braktiste çfarëdo mendimi për mobilizimin e mbretit Zog dhe ky e mesazhet e tjera të ndryshme nga Athina, si para edhe pas saj, sollën që të hiqej dorë nga ideja për nisma të çfarëdolloji lidhur me Shqipërinë. Gjatë disa javëve të mëpasme, rastësisht edhe gjatë vitit 1941 vendimet e Departamentit Jugor të Ministrisë së Jashtme vazhduan ta linin mënjane Shqipërinë. Më 17 shkurt Filip Nikolsi (Philip Nichols)⁴, shefi i departamentit, ka shkënuar: «Prej kohësh ka qenë një pikë kardinale e politikës sonë kundrejt Shqipërisë që të ecë në një hap me grekët»⁵). Më 1 mars zëvendësi i nënsekretarit të shtetit mbikëqyrës, Sër Orme Sarxhent (Sargent)⁶ ka shkruar:

«Kemi marrë tani një telegram tjetër nga Athina, me nr. 277, që e bën fare të qartë se qeveria greke është në kundërshtim si kurdoherë me sugjerimet tona, domethënë se nuk duhet t'i japim inkurajim e popullaritet mbretit Zog dhe Qeveria e Madhërisë së Tij duhet të bëjë një deklaratë rreth Shqipërisë... e meqë po ashtu është e qartë se në këtë çështje nuk mund të dalim kundër dëshirave të qeverisë greke, unë jam i sigurtë se gjëja më e drejtë që duhet të bëjmë është t'i lëmë mënjane të dyja këto ide. Në të vërtetë shanset tona që të jemi në gjendje për të ngritur një lëvizje shqiptare më tepër po bien se sa po përmirësohen. Një ngritje e tillë është në realitet e kapërcyeshme»

vetëm si pjesë e një ofensive të suksesshme greke në Shqipëri dhe perspektivat e një ofensive të tillë me siguri që po bien me shpejtësi. Për mendimin tim, është krejt e pamendueshme që ne do të jemi në gjendje t'i bëjmë shqiptarët të ngrihen në një kohë kur grekët do të jenë në mbrojtje ose në tërheqje»⁷).

Edhe pa këtë ngacim nga Greqia, mendimi i Ministrisë së Jashtme ishte i pafavorshëm për mbretin Zog. Më 4 shkurt 1941 Sër Robert Hoxhson (Hodgson), i cili kishte qenë ministër britanik dhe konsull i përgjithshëm në Tiranë nga 1928 deri më 1936, i paraqiti Ministrisë së Jashtme një vlerësim për mbretin Zog me këto shprehje:

«Në kohën e Kongresit të Lushnjës (1920) ai ka qenë një figurë e madhe e vendit e ka shumë të ngjarë se po të kishte qenë një njeri më i zgjuar, se sa është, ai do ta kishte ruajtur pushtetin që zotëronte atëhere e do ta kishte sot vendin të bashkuar pas vetes. Por siç janë gjërat, është e dyshimtë nëse po të kthehej ai në Shqipëri do të mund të komandonte besnikërinë e ndonjë pjese të gjerë të popullsisë. Është e sigurtë të themi se toskët, ndonëse marrëdhëniet e tij me ta ishin përmirësuar kohët e fundit, nuk do të grumbulloheshin gjerësisht rreth ndonjë thirrjeje, që do të lëshonte ai. Është e pasigurt se sa do të jetë ai në gjendje të ndikojë te gegët, të cilët janë faktori vendimtar në çështjet shqiptare. Fisi i tij, matjanët, pa dyshim do ta ndiqnin pas dhe, nëse vlerësimi i pozitës së tij është i përpiktë, ai do të kishte mbështetjen jo vetëm të Gjon Markagjonit dhe të Mirditës, por edhe të gjitha fiseve të veriut. Në të vërtetë është mjaft e dyshimtë nëse ndikimi i tij personal do të mjaftonte për të ngritur Veriun në një lëvizje nacionaliste kryengritëse... le të inkurajojë bashkimin e rezistencën dhe ta lërë he për he çështjen e këhimit»⁸).

Sa herë që Shqipëria dhe mbreti Zog tërhiqnin vëmendjen në Londër, rryma e opinionit zyrtar dilte fort kundër tyre. Në mars 1941 nga Beogradi erdhën në Londër njoftime për aksione të ndërmarra në Shqipëri kundër italianëve (këto, me sa duket, do të kenë qenë veprimet e para nën drejtimin e Myslim Pezës, që u përmendën më sipër). Ministria e Jashtme u vu në lëvizje për të shqyrtuar nëse BBC do të thoshte diçka për t'u dhënë zemër shqiptarëve. Ambasadori britanik në Athinë, sër Majkëll Palere (Michael Palairt) u përgjigj nga Athina me telegramin nr. 527 se «do të ishte një gabim shkatërrimtar po të hynim në premtime rreth së ardhmes (së Shqipërisë) në këtë fazë»⁹). Nja dy simpatizues të shquar brita-

nikë për Shqipërinë dhe / ose për mbretin Zog, e konkretisht zonzj. Obrej Herbert (Aubrey Herbert), z. Filip Noel Bejker (Philip Noel Baker) dhe Lordi Cecil i shkruan Ministrisë së Jashtme, duke argumentuar se duhej bërë një lloj deklarate për t'u dhënë zemër shqiptarëve dhe se i duhej dhënë një farë inkurajimi mbretit Zog, por ata morën përgjigje pa ndonjë zotim.

Qeveria jugosllave ishte më pak e prerë kundrejt Shqipërisë se sa qeveria greke, por qëndrimi i saj në pjesën e parë të vitit 1941 ishte po ashtu negativ. Hapi më i skajshëm që ishin të përgatitur grekët ta bënin duke u shprehur rreth Shqipërisë, u tha në një pohim të gjeneralit Metaksa, në atë kohë, më 1940, kryeministër i Greqisë. Duke folur në radio më 22 nëntor 1940 me rastin e rënies së Korçës në duart e forcave greke, ai tha (sipas një versioni të botuar në një gazetë frëngjisht në Athinë, të njoftuar nga ambasada britanike): «Nous luttons non seulement pour notre existence mais pour les autres peuples Balkaniques aussi et pour la libération de l'Albanie»¹⁰). Kjo ishte shumë larg nga njohja e të drejtës së Shqipërisë për pavarësi dhe aq më tepër nga pranimi i kufijve të Shqipërisë së paraluftës. Kur qeveria britanike sugjeroi që qeveria jugosllave të bënte një deklaratë që të thoshte po aq sa gjenerali Metaksa, nga Beogradi erdhi përgjigjja (telegram nga Beogradi nr. 602, prill 1941) se jugosllavët nuk do të bënin një njoftim të tillë përpara se të futeshin në luftë. Katër ditë më vonë, më 6 prill nisi sulmi me bombardimin e gjermanëve kundër Beogradit. Jugosllavia u mposht shpejt dhe u copëtua. Pak më vonë po atë vit ministri i jashtëm i Qeverisë Mbretërore Jugosllave në mërgim, Monçillo Ninçiq e ndjeu veten të aftë që të merrte një pozë më të afërt me një burrë shteti. Më 1 nëntor sër Xhorxh Rendel, ambasadori britanik pranë qeverisë në mërgim, e citoi atë se kishte thënë që qeveria greke dhe jugosllave duhet të merren vesh së bashku për integritetin dhe pavarësinë e Shqipërisë e të bien dakord që ta vënë nën proteksionin e përbashkët grek dhe jugosllav.

Ndërkohë ndjeshmëria kombëtare greke, duke përfshirë edhe ndjenjat kundrejt Shqipërisë, ishte acaruar nën ndikimin e dështimit përballë gjermanëve. Në një fjalim të transmetuar më 22 qershor, z. Cuderis, kryetar i Këshillit të Ministrave të qeverisë greke në mërgim, përmendi «njerëzit gjysmë të egër të Shqipërisë» dhe i përshkroi ata si «pasues të papërmendshëm të Italisë»¹¹). Pak më vonë ai nxori një pretendim grek për Epirin e Veriut gjatë rregullimit even-

tual pas lufte. Kjo shkaktoi si efekt që opinioni në Ministri-
në e Jashtme Britanike të tërhiqej pak nga detyrimet ndaj
Greqisë. Më 8 korrik Pierson Dikson (Dixon)¹²) i Departamentit
të Jugut ka shënuar: «Ne asnjëherë nuk e kemi përkrahur
gështjen e pavarësisë së Shqipërisë dhe aq më pak jemi të
predispozuar për ta bërë tani... se sa... para rënies së Ball-
kanit»¹³). Megjithatë më 9 tetor ai ka bërë një shënim pak
më të ndryshëm:

«...tani për tani është krejt e pamundur të vendoset nëse do të
jetë e këshillueshme të rindërtohet një Shqipëri e pavarur ose jo...
nëse do të ketë parimi i kombësisë ende ndonjë rëndësi në fund të
kësaj lufte, ndoshta ne do të kemi dëshirë ta rindërtojmë Shqipërinë në
ndonjë formë ose në një tjetër. Çështjen shqiptare e rrethojnë kaq
shumë faktorë të pasigurtë, sa që jam i sigurtë se ne duhet t'i mbajmë
plotësisht të lira duart tona dhe të mos pranojmë që të lidhemi në
çfarëdo mënyre me detyrime ndaj qeverisë greke tani për tani»¹⁴).

Pikëpamjet e Diksonit u miratuan nga Sër Orme Sarxhent
dhe nga sër Aleksandër Kadogan (Cadogan), nënsekretar i për-
hershëm i shtetit.

Nga fundi i vitit 1941 Ministria e Jashtme Britanike pati
një përvojë që e kthjelloi dhe ndikoi mbi mënyrën e saj të të
menduarit madje edhe për një problem kaq të vogël sa Shqi-
përia. Antoni Ideni (Anthony Eden), ministër i jashtëm, vi-
zitoi Moskën dhe u bë i pari burrë shteti nga Perëndimi, të
cilit iu dha një panoramë e përgjithshme e kërkesave ambi-
cioze të Bashkimit Sovjetik dhe të shpresave të tij në fushën
e punëve të jashtme, si dhe pati një kontakt të drejtpërdrejtë
me intransigjencën e pakompromis të teknikave diplomatike
sovjetike. Më 16 dhjetor, kur Stalini po paraqiste projektet për
një aleancë ndihme ushtarake gjatë luftës, dhe për një marrë-
veshje lidhur me rindërtimin e Europës pas luftës dhe me
përmbajtjen eventuale të traktateve të paqes, ai propozoi që
të kishte një lloj protokollit sekret për nja dhjetë pika që do
t'i bashkangjiteshin marrëveshjes së mëvonshme. Këto pika ki-
shin të bënin me ndryshimet tokësore në favor të Bashkimit
Sovjetik në Europën Lindore dhe me modifikime të rëndësi-
shme që do të preknin Çekosllovakinë, Hungarinë, Jugoslla-
vinë, Italinë, Turqinë, Bullgarinë, Austrinë e madje edhe ve-
ndet e Europës Perëndimore. Një nga pikat ishte se Shqipëria
duhej të ishte një shtet i pavarur.

Bisedimet për një Traktat Anglo-Sovjetik vijuan për ka-

tër muaj pas vizitës në Moskë dhe u përfunduan në maj 1942, kur z. Vjaçesllav Molotov vizitoi Londrën. Teksti për të cilin u morën vesh dhe u nënshkrua më 26 maj ishte një pakt njëzetvjeçar për ndihmë reciproke, por që linte jashtë çdo përmendje të problemeve e të kufijve territorialë. Ai ishte hartuar nga pala britanike vetëm dy ditë më parë, pas një hezitimi të gjatë për kërkesat e Stalinit lidhur me ish shtetet Balltike, Poloninë, Finlandën dhe Rumaninë (kërkesa për të pranuar kufijtë e Bashkimit Sovjetik të vitit 1941). Ministri i Jashtëm dhe Ministria e Jashtëm mbetën me përshtypje të forta të ndryshme pas këtij angazhimi të parë me aleatin sovjetik dhe këto përshtypje nuk pajtoheshin lehtë njëra me tjetrën. Ishte e qartë se ambicjet sovjetike ishin të vështira dhe tepër të papranueshme por gjithashtu ato duhej të merreshin shumë seriozisht. Njëkohësisht duhej gjetur ndonjë rrugë për t'u përpjekur që udhëheqësit sovjetikë të angazhoheshin më me zgjuarsi dhe me frymë bashkëpunimi për t'u përgatitur për rregullimin e pasluftës, në të cilin çështjet kryesore pritej që të ishin parandalimi i një agresioni tjetër gjerman dhe rindërtimi ekonomik e politik i vendeve të çliruara. Tani për tani kërkesa e parë ishte që Bashkimi Sovjetik të vazhdonte të ishte një forcë luftarake plotësisht e efektshme kundër Gjermanisë, pavarësisht nga dështimet që kishte pësuar dhe nga ndihma ose përkrahja e menjëhershme tepër e kufizuar që mund t'i jepnin Britania dhe Amerika.

Britania po vepronte si mikpritëse për qeveritë e mërguara dhe atje ku i kishin, për mbretërit e Greqisë, të Jugosllavisë, të Cekoslovakisë e të Polonisë. Këto qeveri duhej të rivendoseshin në vendet e tyre pas mundjes së Gjermanisë, kjo ishte hipoteza nga e cila nisei çdo mendim për rindërtimin pas luftës të këtyre vendeve. Një ide e re për të ardhmen e tyre, ide që qarkullonte gjerësisht ndërmjet zyrtarëve më 1941 dhe 1942, ishte se duhej të formoheshin bashkime ose konfederata ndërmjet Greqisë e Jugosllavisë dhe Polonisë e Çekoslovakisë¹⁵). Në prani të Ministrit të Jashtëm Iden në 15 janar 1942¹⁶) u nënshkrua një marrëveshje ndërmjet Qeverisë Mbretërore Greke dhe Qeverisë Mbretërore Jugosllave në mërgim lidhur me ndërtimin e një Bashkimi të Ballkanit. Ajo ishte konceptuar me terma tepër të përgjithshëm dhe parashikonte ngritjen e një organi politik, e një organi ekonomik e financiar dhe të një organi të përhershëm ushtarak që do të përbënte një shtab të përgjithshëm të përbashkët, i cili do të funksiononte krahas shtabeve të përgjithshme kombëtare. Kishte dhe një shpresë të nënkuptuar se Rumania dhe Bull.

garia eventualisht mund të hynin në bashkim, por ky as
i idesë u përçua me kujdes, me qëllim që të mos ngjallej
miqësia e sovjetikëve dhe gjithashtu Rumania e Bullg
ishin vende armike, kështu që nuk mund të ofrohej pers
tiva për ta kapërcyer me lehtësi pajtimin me aleatët. Mir
i Jashtëm, Antoni Iden e tregoi se i kuptonte mirë nde
met e mundshme me Bashkimin Sovjetik. Ideja e Bashk
Ballkanik ose e një konfederate dhe për një tjetër para
të Europës Qendrore (Poloni-Çekoslovakia) lidhej mendën
me politikën e paraluftës për *entente* ose *cordon sanitaire*.
kishin dështuar dhe francezët nuk ishin më të pranishëm.
t'i rikujtuar secilit terminologjinë e përpiktë diplomat
shpresa dukej të ishte se duke përforcuar *ententes* dhe d
i bërë më organike, ato mund të bëheshin më të afta për
kthyer në tërësi me forcë gjallese, të zonja për t'u mbro
kundër fuqive sunduese të Europës, Gjermanisë, dhe, siç
niste të bëhej frikësues, Bashkimit Sovjetik.

Një Bashkim Ballkanik me Greqinë e Jugosllavinë si an
tarë themelues dhe së fundi me Bullgarinë që do të hyn
natyrisht, do të jepte një rrugë të lehtë për të trajtuar pr
blemin e Shqipërisë ashtu siç shihej në Ministrinë e Jashtë
Britanike. Është tjetër çështje nëse kjo do të jepte një zg
dhje të problemit shqiptar ashtu siç e shihnin vetë shqiptar
Shqipëria kishte nevojë në radhë të parë të konsolidohej
një shtet kombëtar, që të mund të cilësohej me terma të b
rabartë për t'u futur në një grupim më të gjerë mbikomb
tar. Në një kuptim, ishte fat për diplomacinë britanike q
kurrë nuk kishte qenë e detyruar të ballafaqohej me këtë ç
shtje në praktikë dhe që me këtë çështje në fund të fundit
të ballafaqoheshin krejt pa sukses qeveritë komuniste të pas
luftës në Ballkan. Nga fundi i vitit 1942 z. Bogomolov, amb
sadori sovjetik pranë disa qeverive të mërguara në Londër
kishte shprehur qëndrimin kundërshtues sovjetik ndaj ma
rrëveshjeve të arritura midis qeverive mbretërore të Greqis
e të Jugosllavisë dhe qeverive në mërgim të Polonisë e Çeko
slovakisë¹⁷). Si pasojë, zhvillimi i luftës i bëri pa ndonjë pa
shë marrëveshjet ndërmjet qeverive në mërgim.

Ndërlikimet e pafavorshme për politikën në Ballkan ng
fillimi i vitit 1942 janë përmbledhur nga Pirson Diksoni n
një protokoll të 8 janarit:

«Ne në fakt ndodhemi përballë një dileme të pakënaqshme. N
njëra anë, për nevojat tona të tanishme strategjike ka rëndësi jetik
që të mos bëhet e të mos thuhet asgjë që do të dëmtonte marrëdhë

niet anglo-sovjetike; nga ana tjetër, është në interesin tonë përfundimtar që të parashtrijmë planet tona për të kundërshtuar planet ekspansioniste nga ana e Bashkimit Sovjetik, që t'u dilet përpara në fund të luftës»¹⁸).

Më 30 mars Diksoni përfundoi një analizë të gjerë për çështjen shqiptare. Materiali i tij jep një vështrim të qartë e të gjithanshëm për qëndrimin e qeverisë britanike ndaj Shqipërisë më 1942. Ai nis me ritregimin e hapave nëpërmjet të cilëve Mbretëria e Bashkuar rifitoi lirinë e veprimit lidhur me Shqipërinë pas hyrjes së Italisë në luftë dhe pastaj rendit arsytet përse qëndrimi britanik megjithatë kishte mbetur negativ. Këto ishin, së pari, se një Shqipëri e pavarur gjithmonë për të ruajtur ekzistencën e vet do të kishte nevojë për mbështetjen e një fuqie më të madhe të çdonjëri nga fqinjët e saj, por tani për tani askush nuk mund të dinte cila do të ishte kjo fuqi; së dyti, ishte e dyshimtë nëse mbreti Zog do të pranohej në Shqipëri, por do të ishte e vështirë, duke qenë se mbreti Zog ishte i pranishëm në Britaninë e Madhe, të bëhej një deklaram për të ardhmen e Shqipërisë pa ngjallur dyshimin se fshehurazi atij po i jepej mbështetje; dhe së treti, një deklaratë në favor të pavarësisë së Shqipërisë do të ngrinte çështjen e integritetit territorial, gjë që do të shkaktonte kundërshti me qeveritë greke e jugosllave në mërgim. Megjithatë kishin lindur disa faktorë të rinj. Së pari, ishte Karta e Atlantikut e gushtit 1941, e cila u pasua nga Deklarata e Uashingtonit e Njëzet e Gjashtë Vendeve e 1 janarit 1942. E para premtonte vetëvendosjen dhe rivendosjen e sovranitetit e të vetëqeverisjes për ato vende që u ishin rrëmbyer me forcë, ndërsa e dyta ftonte të bashkoheshin me të kombet e tjera që mund të jepnin ndihmesën e tyre për fitoren. Së dyti, një viktme tjetër të agresionit italian. Abisinisë, ia kishin rikthyer pavarësinë, e ndonëse çështja e Shqipërisë ishte e ndryshme, shumë njerëz do të bënin një paralelizëm me të. Së treti, ministri i oborrit i mbretit Zog e kishte parashtruar me forcë dhe mirë çështjen e pavarësisë së Shqipërisë pa i përmendur pretendimet e mbretit Zog. Së katërti, po zinte vend ideja e konfederatës në Europën Qendrore e Juglindore dhe kishte një arsye *prima facie* për të synuar që të përfshihej në një konfederatë të tillë një Shqipëri e pavarur, por e dobët nga ana ekonomike e ushtarake. Pas kësaj Diksoni u kthehej përparësive ushtarake për të bërë një deklaratë në favor të pavarësisë së Shqi-

përisë. Kjo do t'u krijonte shqetësime italianëve, do t'u jepte zemër shqiptarëve për t'u bërë rezistencë më të madhe se sa kishte ndodhur deri atëhere dhe në një shkallë më të gjerë kur veprimet guerilje në Jugosllavi e ndoshta në Greqi do të kishin ecur përpara, kjo mund të lehtësonte nxitjen e veprimeve guerilje gjithashtu edhe në Shqipëri. Sidoqoftë, do të ishte e dëshirueshme që të kishte një popullsi me qëndrim miqësor në Shqipëri kur të rivendosej paqja. Kishte gjithashtu një interes politik për të mos e lënë të ardhmen e Shqipërisë plotësisht të hapur, meqë kjo mund t'i ngacmonte Greqinë e Jugosllavinë kur të çliroheshin që të kapnin territoret e lakmuara prej tyre, gjë që mund të ishte shumë e rrezikshme për marrëdhëniet greko-shqiptare. Më pas vijonte një pjesë e gjatë për kufijtë e Shqipërisë, përfundimi i së cilës ishte se Greqisë duhej t'i lejohej ta merrte Epirin e Veriut pjesërisht për arsyen se balanca e argumenteve historike dhe etnologjike anonte lehtëzi nga Greqia, pjesërisht për arsye se kjo do ta bënte Greqinë të mbrohej më lehtë, dhe pjesërisht sepse aspiratat greke gjetkë (në Dodekanez dhe në Qipro) ndoshta nuk do të kënaqeshin, ose të paktën nuk do të kënaqeshin plotësisht. Pranohej se Jugosllavia do të shprehte që të merrte territore në Shqipërinë e Veriut, nëse Greqia do të merrte Epirin e Veriut. Meqë pranohej se Shqipëria nuk mund të qëndronte vetëm si një shtet i pavarur, pavarësisht nga kufijtë që do të kishte, arrihej në përfundimin se aftësia e Shqipërisë për t'u mbajtur brenda kornizës së një Konfederate Ballkanike nuk do të pësonte goditje nga që vendi do të gjymtohej. Lidhur me qeverinë e ardhshme të një Shqipërie të pavarur, kjo gjë do të vendosej nga populli shqiptar pas luftës. Tani për tani, Qeveria e Madhërisë së Tij nuk duhej të mbështeste mbretin Zog, por edhe nuk duhej t'ia mbyllte atij derën plotësisht. Ajo duhej të merrte qëndrim të vendosur kundër formimit të çfarëdo qeverie shqiptare të përkohshme ose të një Komiteti apo të një lëvizjeje për Shqipërinë e Lirë. Rekomandimet përfundimtare të materialit ishin këto:

- I. Qeveria e Madhërisë së Tij duhej të bënte një deklaratë publike lidhur me të ardhmen e Shqipërisë sapo të botohej zotimi ndaj qeverisë sovjetike lidhur me kufijtë e vitit 1941.
- II. Kjo deklaratë duhej bërë në formën e një pyetjeje dhe të një përgjigjeje në Parlament me këto fjalë: Qeve-

ria e Madhërisë së Tij, që e shoh me simpati fatin e Shqiptarëve, një popull ndër viktimat më të para të agresionit fashist, dëshiron ta shohë Shqipërinë të çlirohet nga zgjedha italiane dhe të rifitojë pavarësinë e vet. Forma e regjimit dhe qeveria që do të vendosen në Shqipëri do të jenë një çështje që do ta vendosë vetë populli shqiptar në fund të luftës.

III. Para se të bëhet kjo deklaratë, duhet të informohen qeveria greke dhe jugosllave për qëllimin tonë dhe nëse, ashtu siç mund të pritët, ato do të ngulmojnë për pretendimet e tyre ndaj pjesëve të territorit të Shqipërisë, atyre u duhet thënë se Qeveria e Madhërisë së Tij do të jetë e përgatitur për të hyrë në diskutime paraprake lidhur me këtë çështje.

IV. Sapo të bëhet deklarata, duhet të informohet mbreti Zog nëpërmjet sër A. Rajanit (Rayan), se Qeveria e Madhërisë së Tij nuk është e përgatitur për të dalë në mbështetje të rivendosjes së tij në fron, ndonëse natyrisht do të jetë e hapur ndaj tij që të paraqitet vetë para popullit shqiptar në fund të luftës.

V. Në programet e radios të Korporatës Britanike të Radio-përhapjes (BBC) duhet të ndërmerret një propagandë intensive në drejtim të Shqipërisë dhe për këtë një personel i vogël tashmë ekzistues, ndërsa SOE i duhet kërkuar të shqyrtojë mundësitë e veprimeve subversive me qëllim që të nxitet rezistenca kundër italianëve¹⁹).

Raporti i Diksonit u miratua nga Sër Orme Sarxhent dhe nga Sër Aleksandër Kadogan, duke shprehur ky i fundit një parapëlqim të fortë për të mos i ngritur çështjet e kufijve me qeverinë greke dhe jugosllave, në një masë të madhe për shkak të bisedimeve me Stalinin lidhur me shtetet e Balltikut dhe kufijtë e Bashkimit Sovjetik të vitit «1941», si dhe për shkak të precedenteve të rrezikshme, që mund të krijohehin. Ai shkruante: «Do të më pëlqente shumë që gjatë luftës ta mbajmë në minimum caktimin e hartave nga ana jonë». Ministri i Jashtëm ka shënuar në protokoll më 12 prill:

«Përkujtesa e z. Dikson është e mirë dhe ne mund ta pranojmë atë si politikën tonë ndaj Shqipërisë lidhur me amendamentin e Sër Orme Sarxhentit (dmth për përfundimin II, që grekëve e jugosllavëve duhej t'u thuhej se pretendimet e tyre do të ruheshin për një diskutim në të ardhmen). Mbetet çështja se kur duhet shpallur qëndrimi ynë. Ka dy

argumente në favor për të vepruar kështu... (Z. Dikson e ka fjalë për t'u hequr Greqisë e Jugosllavisë tundimin që të mendojnë për kapur këtë territor, dhe për interesat e Drejtorisë së Luftës Politike Nuk e di se deri në ç'skallë do të ndihmohet nga kjo deklaratë z. Brian Lokhart (Lockhart) i DLP. Ndoshta do të na e thotë.

Do-të më pëlqente që ta shqyrtonim në çastin e përshtatshëm të hën kur duhet bërë një njoftim, atëherë kur të mund të gjykojmë se ka ecur marrëveshja me Rusinë dhe kur të kemi pikëpamjet e z. Brian Lokhart»²⁰).

Më 7 prill Lokharti shënonte se «Shqipëria është në fund të listës për prioritetet tona në Europë»²¹). se shtimi i programeve të radios për Shqipërinë nuk do të nxiste shprehje për të rritur rezistencën kundër Boshtit dhe se, po të kërkohej që të ngriheshin shqiptarët, SOE duhej t'i kërkohej që «të fitonte besimin e fiseve». Duke parë këtë këshillë, z. Iden t'i shënuar: «Po të peshohen argumentet e DLP, ato janë kundër një deklaratë, e cila mund të presë»²²). Kështu që çështja Shqipërisë përsa i përket interesimit të Londrës mbeti me krahun deri nga fundi i vitit 1942.

Raporti i Pirson Diksonit shoqërohej me një hartë të përgatitur nga shërbimi i shtypit dhe i kërkimeve për vendet tona pranë Institutit Mbretëror për çështjet Ndërkombëtare që kishte në krye profesorin Arnold Toynbi (Toynbee. Një prodhim i kësaj harte jepet këtu në faqen përmbri). Harta ilustron pasigurinë që ekzistonte jashtë Shqipërisë rreth madhësisë dhe formës së Shqipërisë, pra edhe për aftësinë e Shqipërisë për të jetuar si një shtet i pavarur. Ajo gjithashtu ilustron diçka me të cilën u njohën fare nga afër oficerët britanikë, që shërbyen në Shqipëri më 1943 e 1944, pra madhësinë e ambicjeve kombëtare dhe pretendimet territoriale të shqiptarëve, me të cilat u treguan të shkathët të luajnë italianët e gjermanët, duke krijuar Shqipërinë e Madhe. Në polin e kundërt me skepticizmin zyrtar britanik rreth Shqipërisë, ishte besimi i shumicës së shqiptarëve se bota u detyrohej t'u linte një Shqipëri shumë më të madhe se sa kishte njohur kush deri atëherë. Ndoshta hendeku midis këtyre dy qëndrimeve të kundërta u zvogëlua pak me vazhdimin e luftës, por ai asnjëherë nuk u kapërcye dhe luajti një rol të rëndësishëm në shpëtimin më nga keqkuptimet dhe dështimet që i ndoqën përpjekjet britanike për të mbështetur rezistencën kundër fuqive të Boshtit në Shqipëri.

Më në fund u bë një deklaratë për politikën britanike

ndaj Shqipërisë në fund të vitit, më 17 dhjetor, duke iu përgjigjur një pyetjeje në Parlament. Deklarata ishte kjo:

«Qeveria e Madhërisë së Tij shpreh simpatinë për fatin e shqiptarëve, të një populli ndër viktimat e para të agresionit fashist. Ajo dëshiron ta shohë Shqipërinë të çliruar nga zgjedha italiane dhe të rivendoset pavarësia e saj. Forma e regjimit dhe e qeverisë që do të vendoset në Shqipëri do të jetë një çështje që do ta vendosë vetë populli shqiptar në fund të luftës. Ajo që thashë në asnjë mënyrë nuk e paragjykon çështjen e pozitës së Shqipërisë lidhur me marrëveshjet e ardhshme që mund të arrihen ndërmjet shteteve të ndryshme të Ballkanit. Qeveria e Madhërisë së Tij e sheh çështjen e kufijve të shtetit shqiptar pas luftës si një çështje që do të duhet të merret në shqyrtim në konferencën e paqes»²³).

Deklarata afërsisht të ngjashme u bënë njëkohësisht nga qeveritë e SHBA e të BS, për të cilat ishin bërë konsultime me Londrën që më parë. Vetëm qeveria britanike përfshiu fjalët me rezervat për kufijtë, si një çështje që do të merrej në shqyrtim pas lufte, dhe me aluzionin e papërcaktuar se vendi i drejtë i Shqipërisë do të ishte në një farë konfederate ose bashkimi ballkanik.

Vonesa me të cilën çështja e vogël djegëse e Shqipërisë u kap në kryeqytetet e aleatëve përcaktohej nga rritja me vonesë e çfarëdo force reale të rezistencës në Shqipëri. Konferenca e Pezës që ngriti Lëvizjen Nacionalçlirimtare (LNC) ishte mbajtur vetëm pak kohë më parë se të bëhej deklarata, pra në shtator, dhe Balli Kombëtar (BK) ishte formuar si rival i saj vetëm nja dy muaj më vonë. Partia Komuniste e Shqipërisë nuk do ta mbante Konferencën e parë të Vendit pa ardhur marsi 1943 dhe vetëm pas kësaj nisi të mernte formë ushtria partizane, ndonëse italianët e kishin ndërmarrë mësymjen e tyre të parë të organizuar kundër çetave partizane që në vjeshtë 1942. Deklarata e bërë nga qeveria britanike në dhjetor 1942 u përftua shumë më tepër nga logjika e luftës në përgjithësi, se sa nga diçka e njohur se po ndodhte në Shqipëri ose nga ndonjë kërkesë imperative që ndihej në Londër nga fundi i vitit 1942 lidhur me politikën kundrejt Shqipërisë. Protokollin e Pirson Diksonit në mars e kishte përgatitur rrugën për deklaratën dhe forcat e plogëtisë që e kishin penguar më në fund i çelën rrugën. Nga mbarimi i vitit 1942 lufta në Afrikën e Veriut po shkonte drejt fundit. Nga fillimi i nëntorit u fitua beteja e Alameinit dhe më 2 nëntor nisi zbarkimi

i Aleatëve në Afrikën Veriore Franceze. Dorëzimi përfundimtar i forcave të Boshtit në Afrikën e Veriut u shty deri në maj 1943, por tashmë që nga fundi i vitit 1942 po shiheshin mundësitë për të kaluar veprimet ushtarake përmes Mesdheut në Itali dhe në Ballkan. Ngjarjet në Greqi kishin treguar çfarë mund të arrihej me veprimet e gueriljeve (në 25 nëntor u krye hedhja në erë e viaduktit të Gorgopotamosit). Gjenerali Mihajloviç në Serbi, pasi kishte bërë për vete imagjinatën e publikut britanik dhe amerikan, sikur ishte i pari udhëheqës i rezistencës më 1941, ishte kthyer në një farë enigme më 1942, por kjo enigmë ishte dyfishuar nga njoftimet që vinin prej Bosnjës, Malit të Zi dhe Kroacisë për një udhëheqës partizan të quajtur Tito. E parë në tërësi, kishte ardhur koha për të lëvizur në Ballkan. Deklarata për Shqipërinë e hapi rrugë për ta përket autoriteteve britanike, që ishin të interesuar për ta përfshirë Shqipërinë në një lëvizje të tillë në çfarëdo mënyre që do të ishte e përshtatshme ose e pashmangshme. Veç kësaj, grupe të ndryshme dhe individë entuziastë për Shqipërinë po e ngacmonin Ministrinë e Jashtme që të thoshin diçka pozitive për Shqipërinë. Përgjigjja për pyetjen parlamentare më 17 dhjetor e vuri qeverinë në pozitë të drejtë.

Në janar dhe shkurt 1943 z. G. le M. Mander, anëtar parlamentar, që shtronte me këmbëngulje, pyetjet për çështjen shqiptare, u bind nga letrat e z. Riçard Lou (Richard Law) nënsekretar i shtetit për parlamentin²⁴), që të tërhiqte pyetjet e regjistruara për të marrë përgjigje në Dhomën e Komuneve lidhur me mundësinë që Shqipëria të futej në radhët e Kombeve të Bashkuara dhe se sa e shihte të dëshirueshme qeveria e Madhërisë së Tij të trajtonte me interes e simpati çdo lëvizje, që tregonte unitetin e shqiptarëve si në Shqipëri edhe jashtë saj. Diksoni ka shënuar më 18 shkurt në protokoll argumentet e njohura për të mos ngacmuar grekët dhe për të mos pranuar çfarëdo zotimesh ndaj mbretit Zog ose elementës tjerë nga emigracioni shqiptar. Mund të pritej që brenda Shqipërisë në kohën e duhur do të krijoheshin një qeveri e aftë për ta përfaqësuar Shqipërinë në një konferencë eventuale për paqen. Së fundi, meqë z. Mander i ishte drejtuar një deklaratë të bërë më 1940, që shprehte gatishmërinë për të bashkëpunuar me grupet e shqiptarëve jashtë vendit, Diksoni bënte këtë koment: «Ne kemi pasur më pak përvojë se sa kemi tani me lëvizjet e të mërguarve» dhe se në atë kohë «organizatat tona sekrete» po ushtronin presion që të bëheshin përpjekje për të ngritur shqiptarët kundër italianëve. Në

rrethanat e tanishme nuk do të kishte ndonjë përparësi po të përsëritej deklarata e vitit 1940. Sër Orme Sarxhenti shënonte se ai pajtohej me gjithë zemër dhe kështu iu këshillua z. Richard Lou.

E kështu më 1943 Ministria e Jashtme mbeti duke iu shmanngur çështjeve të Shqipërisë. Një shkurtësë për Sekretarin e Shtetit, e hartuar nga Pirson Diksoni në fillim të majit 1943, e jep vulën e kohës. Ajo shënonte se deklaratat për Shqipërinë të bëra nga tre Aleatët e mëdhenj në dhjetor kishin sjellë shtimin e veprimtarisë ndërmjet shqiptarëve jashtë vendit dhe ushqenin mendimet se Shqipëria duhej pranuar në radhët e Kombeve të Bashkuara: «Megjithatë ne e interpretojmë deklaratën tonë se do të thotë që, ndërsa ne do të përpiqemi të rivendosim një shtet të pavarur shqiptar pas lufte, nuk e quajmë se një shtet shqiptar ekziston tani. Kështu që nuk lind ndonjë çështje për të njohur çfarëdo qeverie shqiptare në mërgim tani për tani». Raporti shënonte se mbreti Zog po mendonte për të ngritur një qeveri të përkohshme «me qëllim që t'u kundërvihet pretendimeve greke e jugosllave me një front të bashkuar shqiptar». Raporti vijonte:

«Edhe po të krijohet kjo situatë, do të ishte shumë e papërshtatshme për ne që të njihnim mbretin ose një qeveri të caktuar prej tij. Një hap i tillë mundet që do të kishte pak vlerë për të nxitur rezistencën në shumë qarqe shqiptare. Ai me siguri do t'u sillte dëme të ndjeshme marrëdhënieve tona me qeverinë greke.

Mund të mendohet se brenda Shqipërisë do të krijohet një lloj qeverie kur të dëbohen forcat e Boshtit. Kjo qeveri mund të lidhet me emigrantët shqiptarë dhe ndoshta nuk duhet përjashtuar kthimi i mbretit Zog në fron. Në fakt mund të ketë avantazhe nga kthimi i tij, nëse shqiptarët do të duan ta pranojnë, meqë vendi me siguri do të ketë nevojë për një sundimtar të fortë në periudhën pas lufte».²⁵

Madje edhe kaq me vonesë sa i binte në shtatorin e vitit 1943, Departamenti Jugor i Ministrisë së Jashtme (FO) përsëriste politikën e përcaktuar në shënimet e hershme të protokollit të Diksonit (tani Diksoni ishte në çastin që do të transferohej nga Departamenti Jugor në zyrën private të sekretarit të shtetit). Në një shkurtësë për sekretarin e shtetit të 27 shtatorit, ata i kanë përditësuar faktet e tyre duke pranuar ekzistencën e dy grupeve të rezistencës në Shqipëri që nga fundi i vitit 1942, të LNC dhe të BK, si dhe veprimta-

rinë e shtuar të grupeve të shqiptarëve jashtë vendit, vecanërisht në Shtetet e Bashkuara²⁶). Ata përsëritën vijën e FO (të Ministrisë së Jashtme) për Shqipërinë, por për herë të parë bëheshin të vetëdijshëm se kjo mund të mos ishte e përshatshme. Fjalja e fundit e tyre thoshte: «Me kapitullimin e Italisë dhe me afrimin e mundësisë për një operacion të Aleatëve në bregdetin e Shqipërisë, shpejt mund të bëhet e nevojshme që ta rishikojmë politikën tonë». Qëndrimi zyrtar ndaj mbretit Zog ishte, siç dukej qartë, një nga çështjet që mund të rishikohej. Përkujtesa shënonte se: «Deri më tani lufta nuk ka nxjerrë ndonjë udhëheqës të shquar që të zë vendin e tij». Kërkesa për unitetin ndërmjet shqiptarëve në mërgim po jepte si efekt ndryshimin e qëndrimit armiqësor të shumë prej tyre ndaj elementëve zogistë dhe gjithashtu ndaj Zogut, si dhe sugjerohej se po e njëjta gjë mund të ndodhte edhe brenda Shqipërisë: «Mundësia për rivendosjen eventuale të mbretit Zog nuk është aspak për t'u përjashtuar».

Në kohën kur kjo shkurtesë e kujdesshme po hartohej në Ministrinë e Jashtme, tashmë SOE i ishte futur një politike aktive për të ngritur një rrjet të misioneve të vogla britanike në Shqipëri me qëllim që të ndizej rezistenca. Nënkomandanti Billi Maklin dhe majori David Smajli tashmë e kishin përfunduar në fakt misionin e tyre të parë në Shqipëri për SOE, pasi kishin qenë atje që nga qershori; shtatë misione të reja të oficerëve ndërlidhës britanikë (BLO) ishin hedhur me parashutë gjatë gushtit e shtatorit dhe vetëm pak ditë më vonë në tetor gjeneral-brigadieri «Trocki» Dejvis do të hidhej me parashutë me një personel të madh për të ngritur një mision shtabi për të drejtuar veprimtarinë e gjithë misioneve të tjera. Nga shtatori 1943 Britania, nëpërmjet agjencisë së SOE, kishte një prani ushtarake të rëndësishme në truallin e Shqipërisë, ndonëse ajo ende nuk kishte një politikë të rëndësishme ose ndoshta më saktë, kishte një mospolitikë lidhur me ekzistencën e këtij vendi si shtet, me kufijtë e tij të ardhshëm me qeverinë e tij të ardhshme dhe me vendin e tij në të ardhmen në Ballkan. Oficerët britanikë që u hodhën në Shqipëri më 1943 nuk dinin asgjë për zbrazëtinë politike prapa kurrit të tyre, ashtu siç nuk dinin asgjë për ngritjen e shpejtë të Partisë Komuniste Shqiptare dhe për marrjen nga ana e saj të udhëheqjes së rezistencës. Ata ishin, po të shprehemi këtu shtu, në gjendjen natyrore përsa i përket politikës. Ata kishin marrë për detyrë të ndiqnin luftën kundër Italisë e Gjermanisë dhe t'i shmangeshin politikës. Ata do ta shihnin se politikës nuk mund t'i shmangeshe.

Shënimet

1. Hansard, vëll. 362 HC Deb. 5s, Col. 139.
2. Amery (1948; 24-43), Amery (1973, 158-165, 171-185, 225-229), Glen (1975; 41-60).
3. PRO, FO 371/29711.
4. Më pas Sër Philip Nichols i dekoruar me urdhrin e Komandantit të Kalorësve të Shën Majkllit dhe Shën Gjergjit (KCMG), Ambasador në Pragë dhe në Hagë.
5. PRO, FO 371/2918.
6. Më vonë nënsekretar i përhershëm i shtetit.
7. PRO, FO 371/29718.
8. PRO, FO 371/29712.
9. PRO, FO 371/29711.
10. PRO, FO 371/24866.
11. PRO, FO 371/29715.
12. Më vonë Sër Pierson Dixon i dekoruar me urdhrin e Kalorësit të Kryqit të Madh të Shën Majkllit dhe të Shën Gjergjit (GCMG), ambasador në Pragë, në Kombet e Bashkuara dhe në Paris.
13. PRO, FO 371/29715.
14. Po aty.
15. PRO, FO 371/33134.
16. PRO, FO 371/33133.
17. PRO, FO 371/33154.
18. PRO, FO 371/33133.
19. PRO, FO 371/33113.
20. Po aty.
21. Po aty.
22. Po aty.
23. Hansard, vëll. 385 HC Deb. 5s. Col 2114.
24. PRO, FO 371/37138.
25. PRO, FO 371/37138.
26. PRO, FO 371/37144.

Kreu 3

SOE dhe Shqipëria deri më 1943

Fillimet e veprimtarive të SOE lidhur me Shqipërinë janë të dokumentuara jashtëzakonisht qartë në një memorandum të shkruar nga Seksioni D i SIS (Shërbimi Informativ Sekret) që ruhet në dosjen e Ministrisë së Jashtme në Arkivin Shtetëror Qendror¹⁾ (PRO). Ato nisën në prill 1940 para se Italia të hynte në luftë. MI(R) i Ministrisë së Luftës, që kishte si detyrë të posaçme zhvillimin e veprimeve luftarake të parregullta, kishte një plan të rrethanave të paparashikuara për të nxitur një kryengritje kundër pushtimit italian në Shqipëri dhe i kishte kërkuar Seksionit D të SIS të bënte një punë paraprake. Seksioni D e bëri shumicën e kësaj pune në Jugosllavi duke mbledhur informata të drejtpërdrejta për kushtet në Shqipëri, duke hetuar qëndrimet dhe prirjet e të mërguarve shqiptarë, duke marrë kontakte me grupimet shqiptare që eventualisht mund të bashkëpunonin dhe duke kërkuar të vendoste kanale komunikimi e ndoshta për furnizime eventuale në Shqipëri. Pasi të përfundohej puna paraprake, synimi ishte që përgjegjësia për shfrytëzimin e tyre t'u kalonte përsëri autoriteteve ushtarake në trajtën e MI(R).

Përfaqësuesit e Seksionit D në Beograd (një nga të cilët ishte Xhulian Emeri²⁾) mbledhën mjaft informacion të dobishëm dhe ai i kaloi MI(R). Ata gjithashtu vendosën kontakte me tri organizata që tashmë punonin në Jugosllavi dhe nga Jugosllavia brenda në Shqipëri. Njëra prej tyre drejtohej nga ish ministri jugosllav në Tiranë, Jovan Gjonoviçi, dhe e kishte kuartierin në Podgoricë të Malit të Zi, duke punuar në Shkodër dhe në pjesën më veriore të Shqipërisë. Një tjetër

drejtohej nga kolonel Kokoshi, që e kishte kuartierin në Dibër në kufirin e Maqedonisë dhe punonte në zonën në jug të liqenit të Ohrit. E treta kryesohej nga Gani Beg Kryeziu dhe vepronte në Kosovë ose duke u nisur prej andej. Grupin e tretë e bënte më të rëndësishëm ndër të tria organizatat prestigjii e ndikimi i familjes Kryeziu ndërmjet popullsisë shqiptare në Kosovë dhe lidhjet e fuqishme kombëtare ndërmjet kosovarëve e shqiptarëve të vetë Shqipërisë.

Nga fundi i qershorit 1940 (Italia kishte hyrë në luftë më 11 qershor) njerëzit e Seksionit D në Beograd kishin përparuar në mënyrë të mjaftueshme që të nisin të mendonin për veprim. Nëse mund të furnizoheshin 5.000 pushkë ose të jepeshin para për blerjen e tyre, ata njoftonin në një telegram se mund të përgatitej një diversion i efektshëm në Shqipërinë e Veriut. Megjithatë, ndërkohë idetë e MI(R) për veprim në Shqipëri ishin futur në sirtar dhe kur iu kërkua mendimi kryekomandantit për Lindjen e Mesme, gjeneralit Archibald Uejvell (Archibald Wavell, më vonë feldmaresali lord Uejvell), ai tha se nuk donte aspak që të nxitej një kryengritje në Shqipëri në atë kohë. Në krye të korrikut iu dërguan udhëzime njerëzve të Seksionit D në Beograd për të mbajtur kontaktet e tyre dhe punën e informimit, por të mos bëhej asgjë për të krijuar incidente, aq më pak për një kryengritje në Shqipëri.

Në qershor Seksioni D kishte nisur një farë veprimtarie lidhur me Shqipërinë në Athinë. Në atë kohë disa oficerë të MI(R) erdhën në Athinë. Njoftimi që iu dërgua operativëve të Seksionit D në Greqi ishte që të hynin në kontakt dhe të mblidhnin informacion për të mërguarit shqiptarë në Greqi e në Turqi, të krijoheshin disa depo fushore me materiale shpërthyesë në Greqi afër kufirit me Shqipërinë dhe të studiohej mundësia për të rekrutuar agjentë që mund t'i futnin lëndët shpërthyesë brenda në Shqipëri, për t'i pasur të gatshme që të përdoreshin kundër italianëve, në rast të një sulmi italian kundër Greqisë. Një depo u krijua me sukses në Janinë. Në fillim të korrikut po ai udhëzim iu dërgua njerëzve të Seksionit D në Greqi, si dhe kolegëve të tyre në Jugosllavi: të mbahen kontaktet dhe puna informative, por të mos bëhet asgjë për të nxitur ndonjë aksion, që mund t'u jepte italianëve një pretekst për të goditur Greqinë.

Nga fundi i gushtit iu paraqit një program për veprimet lidhur me Shqipërinë kryekomandantit për Lindjen e Mesme dhe ai e miratoi atë. Oficerët e MI(R) në Beograd, Athinë e Stamboll do të ishin të gatshëm të merreshin me këto çështie.

nëse do të vinte koha për veprime ushtarake. Veprimet përgatitore dhe mbështetëse të Seksionit D do të vazhdonin po në ato drejtime si edhe më parë në Beograd e në Athinë por do të bashkërendoheshin nga Stambolli.

Puna e kontakteve ndërmjet të mërguarve shqiptarë drejtohej përgjithësisht për t'i bashkuar ata që të punonin, një ndërmarrje kjo që nuk ishte aspak e lehtë. Kontaktet individuale duket se ishin mjaft premtuese, në një masë të madhe sepse detyra u ishte besuar oficerëve që tashmë i njihnin të mërguarit, pasi kishin ndihmuar për të drejtuar xhandarmërinë e mbretit Zog para vitit 1939. Koloneli Frank Stirling e kishte bazën në Stamboll, nënkoloneli Ouklej Hill në Beograd dhe majori Krips në Kajro. Në Athinë e jepte përvojën e nevojshme për Shqipërinë Margaret Hezllaku.

Në gusht 1940 Ministria e Jashtme, për shkak të shqetësimit të saj nga kërcënimi i Italisë kundër Greqisë, nisi të interesohet për mundësinë që t'u shkaktoje turbullira italianëve në Shqipëri. Po në atë muaj Gladuin Xhebb³⁾ (Gladwyn Jebb) kishte kaluar nga Ministria e Jashtme në Ministrinë e Ekonomisë së Luftës për të ndihmuar Hju Daltonin për të ngritur më këmbë SOE. Nga mesi i shtatorit Diksoni i Departamentit Jugor në FO pati një takim me Xhebin dhe me një përfaqësues të Seksionit D për të diskutuar veprimtarinë në të cilat ishte angazhuar seksioni lidhur me Shqipërinë. Në një protokoll të 18 shtatorit⁴⁾ Diksoni ka shkënuar se ndërsa kishte shprehur miratimin e ngrohtë të FO që të ecej përpara me përgatitjen e planeve për veprime subversive në Shqipëri, ai kishte dhënë një shenjë paralajmërimi. Italianëve nuk u duhej dhënë një pretekst për të sulmuar Greqinë. Nga pikëvështrimi i britanikëve, si rezultat mund të humbiste Kreta e të binte në duar të italianëve. Qeveria greke dhe jugosllave kishin shumë frikë se do të mund të përballonin Italinë e Gjermaninë, po të mësonin për veprimet e Seksionit D dhe po të ankoheshin për to në Beograd e në Athinë. Atëherë do të ishte e vështirë të mbroheshin e të mbështeteshin sic duhej njerëzit e Seksionit D.

Kur diskutimi preku çështjen e bashkimit të emigrantëve shqiptarë, përfaqësuesi i Seksionit D tha se njeriu i tyre në Stamboll, koloneli Stirling, lidhur me këtë i kishte telegrafuar se do të ishte e dobishme të kishte një letër nga mbreti Zog e cila t'i jepte bekimin për çdo komitet, që mund të formonin shqiptarët në Turqi. Stirlingu e kishte njohur mirë mbretin Zog meqë kishte drejtuar oficerët britanikë, të cilët kishin stërvitur xhandarmërinë e mbretit. Diksoni parashtroi

pikëpamjen së cilës i përmbahej fort FO në atë kohë, se do të ishte gabim t'i drejtoheshin Zogut. Mbledhja u mor vesh që do të ishte e dëshirueshme të rregullohej formimi i një komiteti qendror të shqiptarëve në Londër për të bashkërenduar veprimtaritë e elementëve shqiptarë jashtë Shqipërisë, për shembull në Stamboll, Kajro dhe SHBA, por kreu i komitetit të Londrës të mos ishte një shqiptar. Mbreti Zog duhej të ftohej të bashkohej jo si ish-mbreti, por thjesht si një patriot shqiptar. Një kryetar i përshtatshëm mund të ishte Sër Xhoslin Përsi (Jocelyn Percy), i cili kishte qenë inspektor i përgjithshëm i xhandarmërisë së Zogut. Nuk duhej të publikohej ekzistenca e këtij Komiteti, të paktën jo në këtë fazë të hershme, sepse do të ishte e padëshirueshme që çështjet lidhur me Shqipërinë të acaroheshin para kohe.

Ideja për një komitet kryesor në Londër për bashkërendimin e veprimtarive të komiteteve të ndryshme ndërmjet bashkësive të shqiptarëve jashtë vendit më pas u miratua në FO. Koloneli Stirling bëri vërejtje kundër tij nga Stambolli, sepse ai mendonte që një komitet në Londër ishte i detyruar të bëhej tepër zogist nga përbërja⁵), por ai eventualisht i tërhiqte kundërshtimet me kusht që komiteti të mos shpallej publikisht, të mos kishte funksion drejtues ose bashkërendues lidhur me komitetet e tjera shqiptare gjatë dhe të shihej kryesisht si një mjet për të ushqyer propagandën. Në praktikë, ideja për të formuar një komitet në Londër u kapërcye nga ngjarjet. Më 28 tetor 1940 Italia e sulmoi Greqinë dhe u krijua një situatë e re. Që nga ajo kohë u bënë mbizotëruese interesat e Greqisë si një aleat në luftë dhe Greqia nuk kishte ndonjë dëshirë për të ngritur aspiratat kombëtare të shqiptarëve.

Në Beograd puna paraprake e Seksionit D, që kishte qenë ngadalësuar në korrik, mori një shtysë të re në gusht, kur kryekomandanti për Lindjen e Mesme miratoi programin për punën përgatitore të veprimit në Shqipëri dhe, kur Italia sulmoi Greqinë nga fundi i tetorit, njerëzit e përfshirë në program kishin arsye të prisnin që t'u jepej lejë për të kaluar në një fazë veprimesh aktive. Ndërkohë lëvizja e Gani Beg Kryeziut në Kosovë kishte fituar një farë rëndësie dhe force lëvizëse. Me ndihmën e Seksionit D, ose siç ishte bërë tani, të SOE, me Gani Begun ishte bashkuar tani Abaz Kupi nga Stambolli, duke fituar kështu një lidhje me Zogun (Abaz Kupi do të bëhej udhëheqës i lëvizjes zogiste në Shqipëri më 1943). Me të ishte bashkuar edhe Mustafa Gjinishi, një komunist me tipare udhëheqësi, i cili i kishte kaluar vitet para

luftës në Shqipëri herë duke botuar gazeta e herë duke vuajtur dënimet me burgim në birucat e mbretit Zog. Dhe Ganiu kishte krijuar një lidhje përmes kufirit të Shqipërisë me Muharrem Bajraktarin, një nga krerët më të rëndësishëm e më të pavarur të Shqipërisë së Veriut. Dukej se ishin në dorë mjetet për të organizuar një kryengritje në Shqipërinë e Veriut dhe një «front» që mund ta bënte këtë ishte i gjerë nga pikëpamja politike. Organizuesit në Beograd kërkuan dy gjëra nga Londra. Ata shpresonin se mund të gjendeshin aeroplanë për të mbajtur furnizimet për një forcë në Shqipëri dhe ata parashikonin formimin e një qeverie të përkohshme, kur të hynin brenda në Shqipëri dhe të siguronin shprehjen publike në favor të mbështetjes së kësaj qeverie nga qeveria britanike. Ministria e Jashtme u përgjigj duke hartuar një deklaratë të mundshme dhe duke u përpjekur ta pranonte qeveria greke⁶⁾. Ata zgjodhën me kujdes fjalët, që ishin të afërta me ato të përdorura nga gjenerali Metaksa rreth «çlirimit» të Shqipërisë (shih më lart, kreu 2). Nga Athina erdhi një përgjigje shkruajuese. Gjenerali Metaksa nuk ishte për një kryengritje të përgjithshme në Shqipërinë e Veriut, por më tepër për veprimet të bashkërenduara të disa çetave të vogla. Sër Majkëll Palere njoftonte nga Athina, se ai kishte të gjitha arsyet të mendonte që qeveria greke ishte kundër ngritjes së një qeverie të përkohshme shqiptare. Zyrtarët në FO ishin prirur të mendonin se autoritetet greke ishin të gatshme të lejonin që të transportoheshin armë dhe municione nga Selaniku në Jugosllavi për një kryengritje në Shqipëri. Edhe kjo doli se nuk ishte e saktë. Për ta plotësuar këtë varg negativ, nuk kishte aeroplanë të mundshëm për qëllimet e furnizimit me anë të hedhjes nga ajri. Pikërisht para krishtlindjeve të vitit 1940 SOE i udhëzoi njerëzit e vet në Beograd që kryengritja e Gani Begut duhej të mos nxitej. Kur iu paraqit një raport i shkurtër për këto ngjarje z. Iden menjëherë pas krishtlindjeve të vitit 1940, ai ka shënuar: «SO2 me sa duket është ngutur përpara pa e menduar mirë»⁷⁾ (termi SO2 përdorej në atë kohë për SOE në FO). Tri javë më vonë Ideni ka shkruar një koment kritik për SOE në kontekstin e Shqipërisë: «SO2 nuk e drejton dhe nuk duhet ta drejtojë politikën tonë të jashtme. Ata janë vegla jonë dhe jo ne e tyrja. Kam dyshime për këtë projekt dhe jam gati gjithmonë të mbështes departamentin (nëse pajtohem me ta!) për t'u qëndruar presioneve nga SO2 ose nga kushdo tjetër.»⁸⁾

Disa ditë më pas erdhi komenti i ashpër nga pasardhësi

i gjeneralit Metaksa, që e dënonte idenë për të aktivizuar mbretin Zog (shih më lart në kreun 2). Letrat ishin ndërthurur prerazi kundër ekipit të SOE për Shqipërinë.

Edhe një herë planet për një kryengritje në Shqipërinë. e Veriut u futën në sirtar. Përveç se nuk u mirëpritën nga grekët, ato nuk u mirëpritën edhe nga princi Pavël i Jugosllavisë, i cili po kërcënohej gjithnjë e më shumë nga Fugitë e Boshtit. Përmbysja e regjencës në mars 1941 i dha kurajë të re qelizës së SOE në Beograd dhe bashkëpunëtorëve të saj shqiptarë, por regjimi i ri në Jugosllavi ishte i paaftë të jepte ndonjë mbështetje efektive. Më 6 prill Luftwaffe nisi sulmin e saj mbi Beogradin. Më 7 prill Gani Beg Kryeziu dhe vëllezërit e kolegët e tij, të shoqëruar nga Oukli Hilli, marshuan në Shqipëri nga Kosova me një forcë të vogël prej 300 vetash dhe pa pasur të siguruar ndonjë mbështetje ose furnizim nga askush. Ata grumbulluan pak qindra simpatizues, por Jugosllavia u shemb prapa tyre dhe ata u detyruan të shpërndahen si të arratisur. Shpejt Oukli Hilli ra rob i gjermanëve dhe vëllezërit e Kryeziut u kapën nga italianët. Abaz Kupi gjeti strehim ndërmjet njerëzve të vet në Krujë, në veri të Tiranës. Mustafa Gjinishi çau rrugën për në Korçë, ku Enver Hoxha tashmë ishte një figurë udhëheqëse në lëvizjen e copëtuar komuniste të Shqipërisë.

Bërthamat e seksioneve për Shqipërinë të SOE, që vepronin në Beograd e Athinë, gjithashtu u shpërndanë nga pushtimi i Jugosllavisë dhe Greqisë prej Gjermanisë. Veprimtaria e SOE lidhur me Shqipërinë ra mjaft poshtë. Gjatë pjesës që mbeti të vitit 1941 dhe më 1942 ajo u mor pothuajse vetëm me grupet rivale të të mërguarve në Stamboll e Kajro dhe u përpoq që të grumbullonte copa-copa informacionin që depërtonte jashtë nga Shqipëria në formën e rrëfimeve të udhëtarëve. Informacionin e filtronin nja dy miq të Shqipërisë të kohës së paraluftës, që ishin marrë në punë nga SOE. Më i vjetri prej tyre në ditët e para ishte koloneli Stirling, por ishte Margaret Hezllaku ajo që mbeti e përhershme me SOE dhe siguroi vazhdimësinë gjatë muajve të parë të vitit 1944. Pa burime ose kontakte të besueshme në Shqipëri dhe me informacionin e zakonshëm që dilte nga kufijtë e vendit e që shqyrtohej nëpërmes syzeve të paraluftës, të ngjyrosura me pikëpamjen «romantike», vizioni informativ i SOE për Shqipërinë u bë shumë i paplotë dhe i vjetruar. Kur autoritetet më të larta ushtarake patën një interesim të përtëritur në Shqipëri më 1943 dhe vendi përsëri u përfshi në fushën e veprimeve të aleatëve, për oficerët që u dërguan atje nga SOE

varfëria e pamjes informative u kthye në një pengesë të madhe për ta.

Pasi Gjermania e mposhti Ballkanin, vëmendja e SOE u drejtua nga Greqia e Jugosllavia, jo nga Shqipëria e pushuar prej italianëve. Sukseset më të mëdha gjatë vitit 1942 në Ballkan SOE i pati në Greqi. Më 1944 do t'i kishte në Jugosllavi. Viti 1943 ishte kalimtar. Në Greqi EAM-ELAS, lëvizjet e rezistencës të kontrolluara nga komunistët, kërkuan që të bëheshin forca mbizotëruese ushtarake dhe politike në vend, por ia arritën vetëm të shkaktonin që qeveria britanike të renditej në përkrahje të mbretit të Greqisë dhe të qeverisë së tij në mërgim, kështu që u bë e qartë se e ardhmja e Greqisë nuk do të përcaktohej në male, por nga një rivendosje në fron që përtej detit. Në Jugosllavi përkundrazi, Titoja dhe lëvizja e tij çlirimtare bashkë me ushtrinë të udhëhequra nga komunistët, u «zbuluan» nga koloneli Bill Dikin (Deakin) kur u hodh me parashutë në kuartierin e Titos nga fundi i majit, dhe kur gjeneral-brigadieri Ficroj Maklin (Fitzroy Maclean) vajti të bashkohej me Titon më 17 shtator 1943, peshorja u apua kundër qeverisë jugosllave në mërgim dhe u bë e qartë se e ardhmja e Jugosllavisë në të vërtetë po përcaktohej në malet.

Pasoja me rëndësi për SOE pati një rrëmujë në Kajros gjatë gushtit e shtatorit 1943, e shkaktoar nga kërkesa e EAM-ELAS për t'u bërë sunduese dhe që ndërlikoi EAM-ELAS, mbretin e Greqisë, qeverinë greke në mërgim dhe qeverinë britanike. Që atëhere Operacionet e Posaçme në Lindjen e Mesme dhe në Ballkan u futën në vartësi të kryekomandantit për Lindjen e Mesme dhe për vitin e ri i kaluar Komandantit Suprem të Aleatëve në Mesdhe, duke marrë një profil pak më shumë ushtarak dhe diçka më pak klandestin. Varësia e re hyri në fuqi më 10 dhjetor 1943⁹⁾. Ajo që kishte qenë më parë dega e Kajros e SOE, e njohur me emërtim MO4, u bë Forca 133 nën varësinë e GHQ të Lindjes së Mesme.

Në kohën që ndodhi ky ndryshim, operacionet e posaçme në Ballkan po rriteshin me shpejtësi. Ky ishte rrjedhimi i vendimeve strategjike, që kishin qenë në diskutim ndërmjet Britanisë e SHBA qysh kur zbarkimi i Aleatëve në Afrikën Veriut më 1942 kishte hapur rrugën për operacione që do të flaknin Italinë jashtë lufte. Në konferencën e Kazablankës të janarit 1943 ishte zgjedhur Sicilia si pikësynimi i parë për zbarkimet gjatë Mesdheut. Në atë kohë një raport i Komandantit të Bashkuara anglo-amerikane përmbante një pohim op

timist se «Gjermania nuk do të jetë në gjendje të ndërmarrë dy barrë për të mbajtur me trupa të dy krahët bashkë, Ballkanin dhe Italinë në gjendje shpartallimi»¹⁰). Në kohën e Konferencës së Uashingtonit në mes të majit 1943 një memorandum i Komandave të Bashkuara sugjeronte që operacioni Husky (zbarkimi dhe marrja e Sicilisë) mund të bënte të mundur që të hidhej një kryeurë në Durrës për të furnizuar grupet e depërtimit në thellësi të Ballkanit, duke pasur si qëllim të shfrytëzohej shpartallimi i Italisë mbi një bazë afatshkurtër fleksibël nëpërmjet përdorimit të forcave anglo-amerikane tashmë të siguruara në teatrin e Mesdheut. Më në fund u mor vendimi në Uashington që të përqendroheshin burimet aleate në operacionin Overlord (zbarkimi në Francë duke kaluar Lamanshin) më 1944, të kufizohej shkalla e operacioneve në Itali dhe të mos jepeshin forca të konsiderueshme për operacionet në Ballkan. Pas Konferencës së Uashingtonit Uinston Curcilli ka shënuar:

«Ne nuk duhet t'i angazhojmë trupat në ndonjë operacion serioz atje (dmth përtej Adriatikut) dhe Qeveria e Madhërisë së Tij nuk parashikon dhënie e ndonjë force të armatosur të organizuar për teatrin e Ballkanit as këtë vit dhe për asnjë periudhë për të cilën ne jemi të interesuar tani»¹¹).

Në bisedimet e nivelit të lartë në Kuebek dhe në Uashington nga fillimi i gushtit, mbizotëroi edhe një herë pikëpamja strategjike e SHBA se Mesdheu duhej të zinte tërësisht një vend të dytë kundrejt operacionit Overlord. Koncepti strategjik për shpartallimin e Boshtit në Europë, bashkangjitur bisedimeve, i datës 19 gusht 1943, jepte këtë mendim të kundërt për Ballkanin: «Operacionet në Ballkan do të kufizohen për të furnizuar gueriljet e Ballkanit nëpërmjet detit e ajrit dhe për të bombarduar Ploeshtin e objektiva të tjerë strategjike nga bazat në Itali».

SOE në Londër dhe MO4 në Kajro ishin përgatitur për një veprimtari të zgjeruar në Ballkan, meqë vatra e luftës në Mesdhe u zhvendos nga Afrika e Veriut në Europën e Jugut, ndonëse ata nuk mund ta dinin me përpikëri se çfarë do t'u kërkohet atyre deri sa të merreshin vendimet për strategjinë më të lartë. Në fund, meqë u bë e qartë gjatë gjysmës së dytë të vitit 1943 se operacionet e posaçme do të ishin e vetmja formë, të cilën Aleatët do t'ia kushtonin Ballkanit, SOE pati një grup të mirë oficerësh dhe ushtarakësh të tjerë që erdhën duke kaluar nëpër shkollat e kurset stërvitore (për

parashutim, për përgatitjen paraushtarake, për radio etj.) që ishin të gatshëm për t'u dërguar nëpër vendet e Ballkanit. Ishte më tepër një çështje fati se ku oficerëve të veçantë ushtarakëve të tjerë u ra rasti të caktoheshin në Jugosllavi në Greqi apo në Shqipëri. Për shumicën e tyre vajta në tre vendet ishte një udhëtim i mistershëm, por Shqipëria ishte ajo më e mistershmja, më pak e njohura nga të gjitha.

Paraqitja e skenografisë së SOE më 1943 nuk do të ishte e plotë pa llogaritjen e mjeteve relativisht të kursyera. Kishte SOE në dispozicion për të mbështetur operacionet posaçme në Ballkan. Deri në verën e vitit 1943 për misionin mbi Ballkan ishte në dispozicion vetëm një fluturim i këmbësor me aeroplanëve Liberator¹²). Skuadrilja 148 e Forcave Ajrore Mbretërore (RAF) u formua në fund të marsit 1943 me detyrues të skuadriljes Blekbërnin (Blackburn)¹³), i thithi aeroplanët Liberator, u vendos në aerodromin e Derna Mahometit në Cirenajkës në fillim të prillit dhe, duke iu shtuar disa avione Halifax, iu rrit fuqia së pari në dhjetë avionë e më pas në katërmbëdhjetë. Numri i aeroplanëve Liberator në dispozicion mbeti gjithnjë katër, numri i Halifax u shtua në dymbëdhjetë nga fundi i korrikut dhe arriti në gjashtëmbëdhjetë në fillim të gushtit.

Në këtë mënyrë, SOE nuk e pati dot në dispozicion në verën e vitit 1943 një mjet si skuadrilja 148 për të furnizuar forca të rëndësishme gueriljesh në vendet e ndryshme të Ballkanit, gjë që dallohet nga depërtimi me parashutim të grupeve të vogla të oficerëve britanikë për të kryer misione të veçanta rikonjicioni ose sabotimi. Por edhe kështu në verën e vitit 1943 rruga e furnizimit që siguronte skuadrilja 148 kishte aftësi të kufizuar dhe skuadrilja u ndesh me shumë vështirësi për ta ndërtuar atë. Për shembull, në maj u kryer kuan 98 fluturime nga MO4/SOE dhe 90 prej tyre u kryer nga skuadrilja 148, por vetëm 57 ose 58 prej tyre janë rezultuar se patën sukses. Dështimet vinin nga përzierja e shprehjeve të ndryshme: moti i keq, difekte mekanike, mungesa e pajisjeve për sinjalizim në zonat e hedhjes, rrëzimet e avionëve e kështu me radhë. Në qershor, me shtimin e programit të veprimeve, u planifikuan 167 fluturime, 137 u kryen dhe rezultuan të suksesshme. Në korrik shifrat ishin 158 fluturime të planifikuara, 137 të kryera dhe 109 1/2 me sukses, ndërsa në maj 196 fluturime të planifikuara, 183 të kryera dhe 145 1/2 me sukses (gjysmë suksesi do të thoshte se një avion për të kryer misionin kishte qenë në gjendje të hidhte vetëm një paraqitje të ngarkesës). Ngarkesa e bartur në çdo fluturim ndrysh

sipas largësisë nga Derna Main: një Halifax me dy rezervuarët e mbushur nuk mund të merrte më shumë se 1500 kg materiale. Dokumentet tregojnë se ngarkesat me Halifax të destinuara për Shqipërinë lëkundeshin rreth 4.000 paund, 2 tonë pa pak¹⁴). Siç do të shihet, Shqipëria nisi të dalë në planet e operacioneve të Skuadriljes 148 nga qershori 1943 e më pas.

Përppjekjet për zgjerimin e furnizimeve vijuan. Në shtator 1943 u formua Regjimenti ajror 334 i RAF me komandant kapitenin e grupit Rankin, të dekoruar me Urdhrin për Shërbim të Shkëlqyer¹⁵), dhe e ngriti kuartierin në aerodromin e Tokrës në Cirenajkë nga fillimi i nëntorit 1943, duke e marrë nën komandë edhe skuadriljen 148 (skuadrilja 148 ishte zhvendosur nga Derna Main në Tokra nga fillimi i shtatorit). Edhe skuadrilja 624 e RAF, e pajisur po ashtu me Halifax, u vu nën komandën e Regjimentit 334 dhe mori pjesë në përppjekjet për operacionet e posaçme, por Italia dhe Franca tani kishin rivalitet për Ballkanin si zonë e shënuar për operacione të posaçme në Mesdhe. Skuadrilja 148 mbeti si përgjegjëse për furnizimet në Shqipëri më 1943 dhe Shqipërisë iu desh të ishte në konkurrencë me klientë të tjerë më me peshë, që e mbanin Skuadriljen të zënë, si Jugosllavia që kërkonte në rritje, Greqia dhe vende të ndryshme të largëta, ku bëheshin përppjekje dhe operacione të posaçme. Me afrimin e dimrit nga fundi i vitit 1943 ra edhe numri i fluturimeve që mund të bëheshin dhe përpjesëtimi i fluturimeve me sukses. Në janar 1944, për shembull, Skuadrilja 148 bëri vetëm 92 dalje, nga të cilat 56 1/2 ishin me sukses. Më vonë gjatë vitit 1944 u vu re një zgjerim i shpejtë i përppjekjeve nga ajri, por në gjysmën e dytë të vitit 1943 Shqipëria mund të merrte vetëm një pjesë të vogël të rrugëve nga një skuadrilje e RAF, ndërsa rrethanat në të cilat i kërkohej kësaj skuadriljeje që të vpronte e bënin sasinë mujore të fluturimeve të suksesshme të lëkundej nga caku i poshtëm afër 50 në mes të dimrit deri te caku i sipërm më i lartë në verë rreth 150.

Në fillim të gushtit 1943 drejtuesi i skuadriljes Blekbërn u kthye nga një vizitë në Britaninë e Madhe dhe është shënuar në dokumentet e Skuadriljes 148 se ka thënë që z. Çurçill dëshironte që çdo muaj të hidheshin 500 tonë furnizime për forcat e rezistencës në Ballkan. Blekbërn i ka komentuar këtë duke thënë se mund ta bënte me 22 Halifax. Gjatë muajve të fundit të vitit 1943, me më pak Halifax se sa kjo shifër ai arriti të hidhte një çikë më pak se gjysma e kësaj shifre në muajt më të mirë. Këto sasi relativisht të vogla në

tonë nuk mund të ishin të mjaftueshme për t'u dhënë ngjarjeve në Ballkan një kthesë nga ky ose nga ai drejtim. Ishin popujt e këtyre vendeve, njerëzit e veçantë të vendosur ose grupet e organizuara me bindje ndërmjet tyre, që do të përcaktonin nëse do t'u bëhej rezistencë efektive gjermanëve dhe se si do të dilnin vendet e tyre nga kjo luftë (natyrisht, kjo varej nga lëvizjet e ushtrive të fuqive të mëdha, ushtrive britanike dhe amerikane në përfundim e jug dhe ushtrive sovjetike në lindje).

Së fundi, Shqipëria ka qenë i vetmi vend në Europën e pushtuar nga gjermanët, në të cilin as u fut dhe as kaloi përmes ndonjëra nga ushtritë e Aleatëve. Kështu që fati i saj mbeti në duart e atyre që ia dolën të ndërtojnë një lëvizje masive rezistence brenda vendit. Oficerët ndërlihdës britanikë që u dërguan nga SOE në përgjithësi (kapiteni Xhulian Emeri më 1944 dukej që ishte një përjashtim i shënuar) kishin pak ose aspak ide për historinë laramane të përpjekjeve të hershme të SOE për të arritur diçka në Shqipëri, ose për atë rritje pak të rastit të organizimit të SOE në Kajron e kohës së luftës, ose për burimet relativisht të kursyera që i mbështetnin përpjekjet e tyre në Ballkan. Po të shtohet padija e tyre për rrugën në të cilën ishte rritur Partia Komuniste e Shqipërisë dhe për natyrën në formë tentativash të politikës britanike ndaj Shqipërisë, kjo do të thotë se ata ishin lënë me diçka pak më tepër se sa zgjuarsia e tyre për t'i udhëhequr. Pjesa tjetër e këtij libri shqyrton se si ata dhe Shqipëria gjëllinin, kur kishin kaq pak informacion rreth rrethanave në të cilat do të duhej të vepronin.

Shënime

1. PRO. FO. 371/24806.
2. Shih shënimin 2 te kreu 2.
3. Më vonë Sër Gladwin Jebb, i dekoruar me urdhrin e Kalorësit të Kryqit të Madh të Shën Majklit dhe të Shën Gjergjit (GCMG) dhe të Kalorësit të Kryqit të Madh të Urdhrit Mbretëror Viktorian (GCVO) dhe më në fund Lord Gladwyn, përfaqësues i përhershëm britanik në OKB dhe ambasador në Paris.
4. PRO. FO. 371/24866.
5. Po aty.

6. Po aty.
7. PRO, FO. 371/24867.
8. PRO, FO. 371/29711.
9. PRO, WO. 204/10392.
10. Deakin (1974; 102).
11. Churchill (1951; IV, 736-37).
12. Anty dhe Clogg (1974; 254-55).
13. PRO, Air 27/955 dhe 956, ditaret e operacioneve të skuadriljes 148, RAF.
14. Peshat e hedhjeve nga ajri jepen në dokumentet e RAF me masën e dyfishtë të tonëve e të paundëve. Një ton metrik është pak më i lehtë se një ton me paund (rreth 45 paund).
15. PRO, Air 26/441 dhe 442, ditaret e operacioneve të Regjimentit 334, RAF.

Kreu 4

Misionet britanike në Shqipëri, 1943

Majori (më vonë nënkolonel) Billi Maklin, kapiteni (më vonë major) David Smajli dhe togeri (më vonë kapiten) Gerri Dafi (Garry Duffi), një specialist për shkatërrimet i Xhënierëve Mbretërorë, hynë në Shqipëri prej Greqisë nga fundi i prillit — fillimi i majit 1943¹). Ata menjëherë u ndeshën me disa njësite partizane. I pari partizan me rëndësi që takuan më 1 maj ishte Bedri Spahiu, i cili mbajti qëndrim shumë mosbesues dhe u kërkoi të prisnin në Greqi, ndërsa ai do të kërkonte udhëzime prej kuartierit të LNC pas disa ditësh. Ndërsa Maklini priti siç duhej, Smajli hyri përsëri në Shqipëri dhe shpejt u takua me Nexhip Vinçanin, i cili gjithashtu kishte mosbesim por nxirrte më pak pengesa se Bedri Spahiu. Në këtë kohë, çetat e shpërndara partizane po formonin batalionet partizane dhe po ngriheshin shtabe ushtarake të qarqeve për t'i drejtuar. Spahiu dhe Vinçani duhej të ishin angazhuar në jug me këtë hap të parë organizimi drejt formimit të Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Nexhipi e rregulloi shpejt që Smajli të takonte një figurë më të lartë të LNC dhe ky doli se ishte Koço Tashkoja, i cili e prezantoi veten duke folur për shkollimin në Harvard dhe me përvojën tjetër të tij në Amerikë, për punën në të kaluarën me peshkopin Fan Noli dhe për njohjen me z. Hëzllak, po siç shihet duke lënë pa përmendur qëndrimin në Moskë dhe shërbimet e rëndësishme si i dërguar i Kominternit. Koço Tashkoja ishte si komunist në një shkallë të mjaftë më lart, kështu që mund të tregonte më shumë besim se Bedriu e Nexhipi në takimet me Smajlin, por ai nuk hynte në rrethin e ngushtë të udhëheqësve më të lartë (ai dhe

Spahiu ishin mënjënjë qe të dy në Konferencën e Jashtëzakonshme të PKSH në qershor 1942). Pas disa ditësh dhe pas lëvizjeve të ndryshme nga një fshat në tjetrin, Tashkoja e paraqiti Smajlin të njëri nga rrethi i brendshëm më i lartë, dr. Ymer Dishnica, anëtar i Komitetit Qendror të sapongritur, i cili ishte zgjedhur rreth dy muaj më parë në Konferencën e Parë të Vendit të PKSH në Labinot. Dishnica e kishte bërë shkollën e lartë (për mjekësi) në Francë dhe ishte një nga shokët më të afërt të Enver Hoxhës. Dishnica i tha se dyshimet e LNC për Maklinin dhe Smajlin ishin shpërndarë dhe i premtoi bashkëpunimin e LNC për të rregulluar hedhjet me parashutë të armëve dhe të furnizimeve të tjera.

Nga fundi i qershorit Maklini arriti të bashkohej me Smajlin dhe ata u vendosën në Leshnjë, të gatshëm për të pritur hedhjet e furnizimit. Maklini bëri një rrugë deri në Labinot, ku u takua dhe bisedoi me Enver Hoxhën e me Këshillin e Përgjithshëm të LNC dhe u morën vesh që të armatosej e të pajisej bërthama e Brigadës së Parë Partizane. Këshilli i Përgjithshëm Nacionalçlirimtar kishte për të bërë një mbledhje në Labinot nga ditët e para të korrikut për të miratuar e për t'i kthyer në vendime formale e publike planet e PKSH për një Ushtri Nacionalçlirimtare, me një Shtab të Përgjithshëm në krye dhe me batalionet e sapoformuara të përfshira në brigada dhe së fundi (1944) në divizione. Përputhja e veprimtarisë së britanikëve dhe të PKSH në këtë ndërthurje rrethanas ishte jashtëzakonisht dhe tërësisht e rastësishme, por megjithatë ishte reale.

I pari mision britanik i SOE që erdhi në Shqipëri hasi me një ushtri rishtarësh në fazat e para të formimit, të gatshme për t'u pajisur, dhe PKSH i ra drejt e në prehër një burim i gatshëm furnizimesh për ta veshur e për ta pajisur formacionin e vet të parë me prestigj dhe, në një kuptim më të figurshëm, për të veshur me respektimin e «aleatëve» planet e veta ambicioze për zgjerimin e rrezikshëm në fushën ushtarake. Këto ishin në të vërtetë plane të PKSH, por ato kishin nevojë të paraqiteshin e të visheshin me petkun si plane të Nacionalçlirimtares.

Maklini dhe Smajli e ngritën bazën e tyre në Shtyllë dhe aty morën disa hedhje me furnizim. Çdo mision i SOE në Shqipëri kishte emrin e vet të koduar dhe po ashtu çdo fluturim e çdo hedhje për një mision mbante emrin e koduar të misionit në fjalë dhe një numër në vazhdim. Dokumentet e RAF në këtë rast ditari i Skuadriljes 149²) tregojnë se Concen-sus 2 dhe 3 u hodhën më 29 maj (me sa duket, këto kanë qenë

hedhje për Maklinin përpara se të bashkohen me Smajlin në Shqipëri). Concensus 4.5 dhe 6 më 22 e 24 qershor në Leshnë, Concensus 7, 8 e 9 në Shtyllë dhe Concensus 10, 11, 12 e 13 në gusht, përsëri në Shtyllë. Pësia e përgjithshme e furnizimeve të hedhura për Maklinin dhe Smajlin në qershor, korrik e gusht ishte 44.242 paund ose 19.5 tonë. Një pjesë e vogël e këtij tonazhi duhet të ketë qenë për vetë misionin (ar. paisie për radistët, ushqim dhe sende personale) dhe duhet të ketë përfshirë herë pas here edhe furnizime të papërshtatshme ose të hedhura gabimisht (këpucë vetëm për këmbën e majtë, veshje ushtarake për njerëz me trup shumë të vogël ose shumë të madh, të mbathura aq të mëdha sa i mbajnë mundësit e ndeshjeve sumo, municione për kalibra të papërshtatshëm, armë pa municione dhe anasjelltas, si dhe teprica lëndësh shpërthyesë dhe produkte të tjera, për gabime administrimi). Kapasur gjithashtu edhe humbje në sheshet e hedhjeve, për shembull, ngarkesa që janë shkatërruar sepse nuk u hapën parashutat, ose ngarkesa që janë shpërndarë tepër ngaqë avionët i kanë hedhur nga një lartësi shumë e madhe, duke u dhënë kështu mundësi fshatarëve grabitës që të rrëmbenin gjithçka që u zinte dora. Por pjesa themelore e tonazhit duhet të ketë qenë armë, municione, eksplozivë, uniforma, batanije etj. të përgatitura si ngarkesa pak a shumë sipas kërkesave të partizanët, kryesisht për pajisjen e Brigadës J, e cila grumbulloi rreth 800 partizanë në paradën e vet të përrurimit pranë Vithkuqit në mes të gushtit. Komandanti i saj ishte Mehmet Shehu, i cili që nga ajo kohë u bë një figurë qendrore e luftës në Shqipëri, pa qenë në fillim një figurë qendrore në PKSH.

Nga gjysma e dytë e vitit një fushatë rekrutimi, të cilën SOE e kishte ndërmarrë në pranverë brenda radhëve të ushtrisë e të Forcës Ajrore Mbretërore për të gjetur vullnetarë të detyrave të posaçme në Europë, po siguronte ardhjen e vazhdueshme të oficerëve që do të dërgoheshin në Ballkan, kryesisht në Jugosllavi e Greqi, por gjithashtu edhe në Shqipëri. Në korrik e gusht edhe gjashtë oficerë të tjerë, secili i pajisur me një radist dhe një a dv nënoficerë jo të karrierës me përgatitje paraushtarake, u hodhën te Maklini dhe Smajli.

I pari nga të rinjtë BLO (Oficerët Ndërlidhës Britanikë) që u hodh ishte togeri i aviacionit Andi Hendz (Andy Hands) më 13-14 korrik, që e kishte emrin e koduar të misionit Spins-ter (Veiu-sha). I dyti, më 17-18 korrik, ishte drejtuesi i skuadriljes Tomi Nil (Tomy Neel), me emrin e koduar Slender (Thatimi). Hendzi u dërgua në zonën e Dibres për të vendosur

kontakte me krerët dibranë dhe me grupet partizane atje. Nili u dërgua në zonën në veri të Tiranës, ku Abaz Kupi, tashmë i njohur përgjithësisht si mbështetësi kryesor i mbretit Zog në Shqipëri, për edhe si anëtar themelues i LNC që nga koha e Konferencës së Pezës, kishte pasuesit e tij në Mat dhe në Krujë. Më 9-10 gusht u hodhën edhe katër misione të tjera Majori Bill Tilman (Skulptori), majori Gerri Fild (Fidani), majori Xhorxh Sejmur (George Seymour, Qypi) dhe majori Peter Kemp (Njerka). Ata erdhën në kohën e duhur për të qenë dëshmitarë të ceremonisë së përrimit të Brigadës I dhe pastaj tre të parët u dërguan për në zonat e operacioneve. Tilmani vajti në zonën në jug të Gjirokastrës, ku lëvizja partizane (LNC) ishte e fortë. Fildi u dërgua në krahinën në jug-perëndim të Vlorës, ku lëvizja partizane ishte më e dobët, ndërsa shumica e fshatrave kishin pasues të nacionalistëve, të Ballit Kombëtar, dhe ku atij do t'i kërkohej të përpicej që të kapej një bazë bregdetare për furnizimet nga deti. Sejmur u dërgua në veri për në zonën qendrore pranë Tiranës, ku ishte Myslim Peza personaliteti kryesor i LNC dhe prej kohësh drejtonte një grup gueriljesh të rezistencës, që tani ishte i paracaktuar të thithej në ushtrinë e re partizane ose nacionalçlirimtare. Kempin denji për pak kohë me Maklinin dhe Smajlin, ndërsa libri i tij «Pa ngjyra e pa kreshtë» jep një paraqitje të ngjarjeve në ditët e fundit të gushtit dhe të parat të shtatorit (të cilat përshkruan edhe në librin e Smajlit³).

Ndërkaq Maklini dhe Smajli kishin fituar një përvojë prej tre muajsh për Shqipërinë, pothuaj gjithë kohën me partizanët. Ata ishin zhgënjyer për vlerën e punës me partizanët dhe ishin shumë të pakënaqur me sjelljet e qëndrimet e udhëheqësve partizanë. Kishte shumë arsye për këtë. Qëndrimi i udhëheqësve partizanë nuk kishte qenë i hapur ose mirëseardhës: ai kishte qenë dyshimtar, shpesh gërricës dhe, sipas vetë paraqitjes që jep Hoxha, gjithmonë i paracaktuar për të treguar se LNC ishte zot i Shqipërisë, gjë që në atë kohë nuk ishte ashtu. Hoxha lëvdohet në kujtimet e tij për gardhin e sigurimit që ai arriti të ngrinte rreth misionit britanik, duke u kufizuar atyre mundësitë për kontakte, duke u ngushtuar mundësitë për të marrë informacion rreth punëve të brendshme të LNC dhe aq më tepër për ato të PKSH, duke e dhënë me pika currilin e lajmeve që u vinte për ngjarjet në Shqipëri. Roli që Hoxha kërkonte t'u linte atyre ishte vetëm e vetëm si furnizues nën drejtimin e LNC për armë dhe pajisjen e forcave partizane. Meqë ata përfaqësonin një fuqi imperialiste, pra një fuqi të paracaktuar si armiqësore ndaj komunizmit, ai më

tepër e toleronte se sa e lehtësonte praninë e tyre. Për fat të mirë, ai ende nuk ishte i tërëfuqishëm, madje as në PKSH. Shumë nga vartësit e tij tashmë kishin arsye që të ishin të kundërshtues me të, por rrethanat në Shqipëri ishin shumë të vështjelluara, komunikimi ishte shumë i vështirë dhe lëvizja e partizane ishte tepër heterogjene me njerëzit që futi në radhët e saj gjatë fazave të para, prandaj ai nuk ishte në gjendje që ta bënte plotësisht të efektshëm kontrollin e tij mbigjithëkrah. Megjithatë ky kontroll ndihej fort dhe përfftonte një atmosferë të pakëndshme.

Sapo nisi hedhja e furnizimeve, u përhap me ngulmim fjala se ato ishin të papërshtatshme. Hoxha dhe bashkëpunëtorët e tij më të afërt nuk e patën vështirë ta frynin këtë. Ishte e lehtë t'i bindje partizanët shqiptarë se ata ishin në vijën e frontit të luftës dhe se britanikët e pasur e kishin për detyrë t'i furnizonin me armë e municione sipas kërkesave, ndërsa çdo mosplotësim i asaj që prisnin shqiptarët trajtohej si dëshmi e prirjeve të rrënjosura antipartizane. Frederik Nosin, që e kishin caktuar si oficer ndërlidhës për misionin britanik, e kishin zgjedhur sepse ishte i aftë të mbante një drejtpeshim në përzierjen e mbikëqyrjes, të rregullimit të përditshëm të punëve dhe të propagandës partizane. Udhëheqësit e LNC -PKSH nuk e fshihnin se ata e shihnin Bashkimin Sovjetik si modelin e tyre dhe Britaninë e SHBA si aleatë ushtarakë, por jo politikë. Përveç atmosferës konspirative që e rrethonte veprimtarinë e partizanëve dhe ngathtësisë që përfitohej nga tëpëria e përpjekjeve për përqendrim në një vend ku korrierët ishin mjeti më i shpejtë i komunikimit. Maklini dhe Smajli kishin ndeshur edhe telashet e pengesat që do të bëheshin të zakonshme për gjithë personelin britanik që do të shërbente në Shqipëri: përvetësimi dhe vjedhja e plaçkave dhe e ushqimeve, pa përjashtuar në ndonjë rast edhe tradhtinë e madje vrasjen për të fituar diçka; fshehja e detyruar që ndonjëherë kthehej gati në burgosje për arsye që kishin pak ose aspak të bënin me armikun, por që kishin të bënin shumë me politikën lokale; muhabetet e pafund, shumë të rënda për heronjat e lavdërimet dhe të lehta për anët praktike; shpirti i partizanëve për të jetuar në vështirësi të rënda, që mund të identifikoheshin si shpirt spartanësh në shfaqjet e veta më trimërore por ishte në kundërshtim me instinktin e oficerëve britanikë për të mos jetuar kurrë më keq se sa e bëjnë të pashmangshme kushtet dhe për të mbajtur parasysh gjithmonë kërkesat e ushtarëve për kushte të mira; ndjenja se po përdorëshin

mëshirë nga ata që e quanin veten mikpritës dhe se duhej të jetonin duke ruajtur nervat e duke rrotulluar trutë.

Të gjitha këto mund të pranoheshin më lehtë, nëse partizanët do të kishin lënë një përshtypje më të mirë për aftësitë e tyre ushtarake. Fatkeqësisht veprimet praktike ishin zhgënjyese. Oficerëve britanikë u ishte dhënë udhëzimi që të ndihmonin cilindo në Shqipëri që do të luftonte kundër armikut të përbashkët — në ditët e para kundër italianëve dhe kur erdhi koha, kundër gjermanëve. Mbi gjithçka tjetër oficerët britanikë kërkonin aksionin. Për ta nuk kishte kuptim të qëndronin në Shqipëri, nëse kjo nuk sillte ndërmarrjen e aksioneve. Ndoshta pritej shumë më tepër nga pala britanike. Forcat partizane nuk mund të krahasoheshin me trupat e stërvitura, ato asnjëherë nuk mund të duronin një bombardim të vazhdueshëm, ato nuk mund të mbanin pozicione të përhapura, sepse nuk kishte ndonjë mënyrë për t'u dërguar ushqime ose furnizime postave të përparuara; taktika e tyre e parapëlqyer ishte të qëllonin nga larg dhe të shpresonin që dalëngadalë ta raskapitnin kundërshtarin; sukseset e tyre vinin më tepër nga hesapet e gabuara të armikut. Këto tipare bënë që partizanët të arrinin disa suksese pa rëndësi në aksionet që patën mundësi t'i shihnin si dëshmitarë deri në fund të gushtit Maklini e Smajli dhe më pas kur u bashkua me ta, edhe Kempji. Udhëheqja e partizanëve të LNÇ pretendonte se kishte arritur shumë fitore, por nuk ia arriti të jepte dëshmi të forta për to, duke treguar se çfarë kishte kapur ose çfarë informacioni të dobishëm kishte marrë. Ata nuk i mirëprisnin sugjerimet që oficerët britanikë të shoqëronin njësitet partizane në operacionet. Maklini, Smajli dhe nënoficerët e tyre e mbajtën frymën lart dhe i gjetën vetes punë duke ngritur pusi e duke bërë shkatërrime të ndryshme në rrugën nga Greqia për Korçë, që kalonte fare pranë bazave të tyre. Partizanët i shihnin me dyshim veprime të tilla private. Edhe kur jepnin ndonjë ndihmë, e bënin me gjysmë zemër. Partizanët u zemëruan dyfish, kur grupi britanik rregulloi një aksion të vogël të përbashkët me një grup të Ballit Kombëtar: ata e penguan deri në atë shkallë, sa u përpoqën ta sabotonin përpjekjen e britanikëve.

Kulmi i zhgënjimit me partizanët erdhi kur Maklini dhe Smajli sugjeruan që Brigada I, pasi u armatos dhe u stërvit për një periudhë prej një muajsh, duhej të provohej në aksion. Sic duket, Mehmet Shehu e pranoi këtë dhe u planifikua një pritë kundër një kolone gjermane në rrugën afër Barmashit. Para se të niste aksioni, Shehu e tërhoqi atë me një justifikim të pabazuar, se një postë e vogël gjermane në

rrugë e bënte të pamundur përparimin e Brigadës prej 800 vetash. «Në atë kohë, — shkruan Smajli, — ne këtë dështim e quajtëm se vinte thjesht nga frika».4) Pak kohë më pas italianët ndërmorën një sulm ndëshkues mbi Vithkuqin e Shtyllën dhe Brigada e Parë u tërhoq pa bërë shumë qëndresë. Smajli shkruan me përçmim për partizanët. Disa ditë më vonë, pasi Misioni Concensus u mbledh së bashku përsëri dhe bënë inventarin e shkatërrimeve të shkaktuara nga italianët, grabitësit vendës dhe partizanët në tërheqje, Smajli u zhvendos drejt veriut duke u përpjekur të ngrinte një bazë të re në afërsi të liqenit të Ohrit. Rrugës ai hasi në disa partizanë të Brigadës së Parë në Voskopojë: ai dhe grupi i tij kaluan për mes tyre me shpejtësi. «sepse ne nuk kishim asnjë dëshirë të englediseshim me njerëz, nga të cilët me zor e fshihnim për-buzien tonë»5). Smajli nuk e takoi më Mehmet Shehun. Ata u ndanë keq meqë marrëdhëniet e tyre ishin prishur me shpejtësi.

Peter Kempf nuk i dënon kurrë prerazi veprimet e partizanëve në këto ngjarje, por ai jep një përshtypje të gjallë për zhgënjimin e Makliniut e të Smajlit me partizanët, për hidhërimin e tyre ndaj vështirësive zemëruese gjatë përpjekjeve për të punuar me ta dhe për mërzinë e tyre përballë paraqitjes së dobët të Brigadës I gjatë pagëzimit me zjarr. Kempf shton këto fjali:

«Kishte natyrisht, edhe një pikë që nuk ishte ende e dukshme për mua: Enver Hoxha dhe Mehmet Shehu nuk i ngrinin formacionet e tyre ushtarake me qëllim që të luftonin kundër gjermanëve e italianëve, po për të fituar kontrollin mbi Shqipërinë për veten e tyre; ata nuk kishin ndërmend të rrezikonin me humbje serioze në operacione që për ta kishin vetëm rëndësi të dorës së dytë»6).

Smajli thotë afërsisht po të njëjtën gjë: atë që e mendonte ai atëherë se ishte punë frike, më vonë mund të shihej se kishte qenë një llogari politike.

Në fillim të gushtit, pa e marrë vesh oficerët britanikë, ishte mbajtur një mbledhje shumë me rëndësi në fshatin Mukje në veri të Tiranës. Përfaqësuesit e LNC, duke përfshirë edhe Ymer Dishnicën, Mustafa Gjinishin dhe Abaz Kupin, ishin takuar me përfaqësuesit e Ballit Kombëtar, duke u përpjekur të gjenin një rrugë për bashkëpunim. Ata ranë në marrëveshje që të formohej një Komitet për shpëtimin e Shqipërisë, në të cilin LNC dhe BK do të përfaqësoheshin së bashku. Përfaqësuesit e LNC nuk e hodhën poshtë pikëpamjen e BK

se Shqipëria që duhej shpëtuar ishte Shqipëria etnike, pra Shqipëria e Madhe, që ishte krijuar gjatë luftës. E vetmja verejtje që bënë përfaqësuesit e LNÇ për këtë ishte se eventualisht duhej bërë një plebishit në Kosovë e Metohi për të përcaktuar të ardhmen e këtyre territoreve. Është e vështirë të besohet se të dy komunistët, Dishnica dhe Gjinishi, nuk e dinin se çfarë ishin duke bërë ose se i kishin injoruar udhëzimet, aq më tepër kur Dishnica ishte anëtar i Byrosë Politike të PKSH dhe i Komitetit Qendror. Megjithatë, marrëveshja e arritur në Mukje më 1 dhe 2 gusht u hodh poshtë dhe u dënua nga Komiteti Qendror i PKSH. Më 8 gusht u lëshua një qarkore me porosinë e përgjithshme që çfarëdo bashkëpunimi me BK duhej ndërprerë. Kjo ishte pika në të cilën lufta civile ndërmjet LNÇ dhe BK u bë e sigurtë dhe e pakthyeshme.

Në Historinë e PKSH për këtë episod jepet shpjegimi se Dishnica dhe Gjinishi kishin harruar parimin themelor se, ndërsa përkrahësit e BK mund të lejoheshin të bashkoheshin me LNÇ si individë, BK nuk mund të njihej si një organizatë që kishte status të barabartë me LNÇ. Arsyeya prapa këtij qëndrimi mund të mendohet që ka qenë se pushteti i PKSH do të përgjysmohej, nëse organizata që ajo faktikisht e kontrollonte plotësisht (LNÇ), do të lejonte barazinë me një organizatë, që ishte haptazi antikomuniste. Nikolla Pano jep një shpjegim tjetër, duke u nisur nga materiale burimore jugosllave dhe shqiptare⁷). Ai pretendon se Enver Hoxha dhe Komiteti Qendror ishin gati ta miratonin marrëveshjen e Mukjes, por Vukmanoviç-Tempoja, që në atë kohë po bënte një nga vizitat e tij në Shqipëri dhe te PKSH, e denoncoi atë dhe këmbënguli që duhej hedhur poshtë. Përfundimi që del është se PKJ nuk kishte ndërmend ta lejonte këtë parti komuniste të re, të cilën e shihte sikur e kishte krijuar vetë, që të binte në pazarllëk me nacionalizmin shqiptar të llojit irredentist. Ky përfundim del fare i qartë në parashtrimin që i bën Dedijeri marrëveshjes së Mukjes⁸) dhe Dedijeri ia vesh Enver Hoxhës dhe udhëheqjes së PKSH përgjithësisht përgjegjësinë për «deviacionin» shqiptar, vetëm Koci Xoxeja përkrahërit se ishte gjithë kohën në krahun e Tempos. Siç duket, përsëri edhe një herë ishte bishti i Kosovës që e tundte qenin shqiptar. Vukmanoviç-Tempoja nuk e mohon këtë drejtpërdrejt, por e errëson çështjen, duke e përshkruar pak gjatë se si ai ishte i angazhuar për ta shtyrë PKSH që të përqendrohej në intensifikimin e luftës së armatosur kundër pushtuesit si një nga rrugët për të shkaktuar copëtimin e BK⁹).

Hoxha në paraqitjen që u bën ngjarjeve të viteve 1941 e 1944 ankohet se jugosllavët disa here e kanë akuzuar për «sektarizëm» dhe disa herë për fajin e kundërt, për «oportunizëm». Në kohën e Konferencës së Pezës, që krijoi LNC më 1942, pohohet se ai ka qenë tepër sektar, duke mos e afruar shumicën e nacionalistëve. Më 1943 pohohet se ai ka qenë tepër oportunist, i gatshëm për t'i bërë shumë lëshime BK për hir të afrimit të tyre me lëvizjen e rezistencës nacionale. Hoxha dhe shokët e tij kryesorë të PKSH po loznin për gjëra të mëdha dhe disa prej tyre, ndoshta edhe vetë Hoxha, mund të kenë ndier veten pak të pasigurtë nga fundi i vitit 1943, nëse do të ishte e mençur të vijonin të këmbëngulnin se nuk duhej bërë rezistencë deri sa ta kontrollonin vetë ata. Ndërsa PKSH kishte bërë përparime të shënuara në dy vjetët e ekzistencës së saj, sukcesi i saj i ardhshëm do të varej nga zotësia me të cilën ajo do të realizonte trukun e besimit apo të mashtrimit nacionalçlirimtar. Formimi i Ushtrisë Nacionalçlirimtare po ecte mirë, por ajo përfshinte shumë njerëz që nuk ishin komunistë në të gjitha nivelet, me përjashtim të majës së piramidës. Në shumë pjesë të Shqipërisë dhe kudo në Veri kishte një ndjenjë të fortë antikomuniste, e cila prirej të kthehej në një ndjenjë kundër partizanëve, sepse gjithnjë e më shumë partizanët po shiheshin si trupa të Partisë Komuniste. Besohej se udhëheqësit e Ballit Kombëtar i kishin siguruar italianët që nuk do të krijonin turbullira ose nuk do t'i pengonin përpjekjet e italianëve për ta shtypur ushtarakisht LNC. Kështu mendohej se ishte përmbajtja e një protokollit të fshehtë, të protokollit Dalmaco-Këlcyra të nënshkruar në mars 1943 ndërmjet Komandantit të forcave italiane në Shqipëri dhe Ali Këlcyrës, që përfaqësonte BK¹⁰). Nga gushti nuk dukej asnjë largët dita e një zbarkimi të Aleatëve në Italinë kontinentale. Ishte e vështirë të kishte siguri që partizanët do të ishin në pozitë më të mirë se BK për të shtënë në dorë qytetet e Shqipërisë, në çastin kur do të tronditej sundimi italian. Duhet të ketë pasur disa njerëz në radhët e drejtuesve partizanë dhe në vetë PKSH, të cilët mendonin se kishte ardhur koha për kompromis, në rast se LNC nuk donte ta shihte veten të papërgatitur për rënien e Italisë ose për të luajtur një rol udhëheqës në kryengritjen finale të gjithë vendit kundër italianëve. Ndonëse forcat gjermane ishin dukur në vend, përsëri rënia e Italisë pritej të ishte momenti vendimtar për Shqipërinë. Nuk e parashikonte njeri shpejtësinë dhe forcën e lëvizjeve të Gjermanisë kur ra vërtet Italia në shtator.

Duke qenë ky sfond, duket e mundshme që Dishnica dhe

Gjinishi me të vërtetë kishin qëllim që të arrinin një farë kompromisi me BK në Mukje dhe që udhëheqja e PKSH do ta pranonte kompromisin e arritur, nëse kujdestarët jugosllavë nuk do të ngriheshin kundër tij, për shkak se ai do të nënkuptonte që pranohej të ngrihej pretendimi i Shqipërisë për Kosovën. «Sektarizmi» dhe «oportunizmi» janë terma të vulltshëm për polemikën: në praktikë udhëheqësit komunistë ishin të detyruar të lëkundeshin midis tyre në mënyrë pragmatike. Në këtë rast, Hoxha mund ta ketë pranuar heshturazi me gatishmëri një vijë oportuniste të parapëlqyer, nën presionin e ngjarjeve, nga kolegët e tij të Komitetit Qendror dhe pastaj do ta ketë ndier të detyruar, për shkak të qëndrimit të përfaqësuesve jugosllavë, që ta hedhë poshtë atë vijë si nacionaliste dhe shoviniste. Në këtë rast ai mund të ishte sektar pa u kritikuar për këtë nga partia eprore, PKJ.

Prova e dobët e Brigadës I në veprimet e pjesës së dytë të gushtit mund të ketë pasur një farë lidhjeje me hedhjen poshtë të marrëveshjes së Mukjes dhe me parashikimin e përplasjeve në shkallë vendi me BK. Por është një thjeshtëzim i tepruar të thuhet se forcat e LNÇ, ishin krijuar vetëm për të marrë pushtetin dhe jo për të luftuar kundër italianëve e gjermanëve. Për PKSH dhe për partizanët e LNÇ përgjithësisht këto dy anë ishin të pandara. Strategjia politike e PKSH, që punonte nëpërmjet LNÇ, ishte që nacionalistët të dilnin njësoj si bashkëpunëtorë të italianëve e të gjermanëve dhe kjo nuk mund të bëhej pa një nivel të përshtatshëm të veprimtarisë ushtarake kundër pushtuesve të huaj.

Për deri sa partizanët lejonin që hesapet politike të dilnin si faktor pengues në rrugën e veprimeve ushtarake kundër italianëve, ata po vepronin në një mënyrë jo të ndryshme nga BK. Këta të fundit e kishin bërë të qartë se ata ishin kundër luftës guerilje dhe pasojave të saj çrregulluese, dhe i kursenin burimet deri sa të mund të ndërmerrej një kryengritje masive në shkallë vendi gjatë fazës së fundit të disfatës së forcave të Boshtit. Nëse forcat partizane po ruheshin që të përdroreshin në një ndeshje eventuale për pushtetin, forcat dhe burimet e BK kishin për qëllim të përdroreshin që t'i shkatërronin ato dhe të siguronin që Shqipëria të mbetej nën kontrollin e udhëheqësve të saj tradicionalë. Por ndërsa refuzimi i BK për të bërë luftë guerilje ishte një vendim strategjik dhe asnjëherë nuk u ndryshua, kursimi i burimeve të partizanëve ishte diçka taktike dhe e përkohshme. Italianët dhe pas tyre gjermanët nuk kishin asnjë dyshim rreth kërcënimit që u vinte nga partizanët. Nëse këta të fundit nuk luf-

tuan mirë deri në gusht 1943, ata do ta bënin këtë në betejat e ashpra e të zgjatura në dimër dhe më 1944. Mehmet Shehu dhe Brigada I do të bëheshin legjendarë midis partizanëve gjatë dimrit që po vinte, për shkak të bëmave të tyre, të rrymarrjes së forcave dhe të luftimeve serioze kundër mësymjeve të rënda të gjermanëve. Por tashmë nga shtatori 1943 të parët oficerë britanikë në Shqipëri kishin fituar paragjykimet e thella kundër tyre dhe kundër udhëheqjes komuniste të LNC përgjithësisht.

LNC e mbajti konferencën e saj të dytë në Labinot, në veri të Elbasanit, nga 4 deri më 9 shtator (e para kishte qenë Konferenca e Pezës në shtator 1942). Abaz Kupi qëndroi me njanë Ai po bëhej gjithnjë e më këmbëngulës në të vetën me zgjerimin e sundimit komunist. Hedhja poshtë e marrëveshjes së Mukjes nga udhëheqja komuniste shënoi një ndarje të rrugëve. Kur Maklini i pati takuar për herë të parë anëtarët e Këshillit LNC në ditët e fillimit të korrikut, Kupi kishte sugjeruar që një mision ndërlidhës britanik mund të dërgohej në zonën e tij në veri të Tiranës për të punuar me të dhe për këtë ishin marrë vesh. Tashmë Maklini kishte caktonuar Toni Nilin për këtë qëllim dhe ai ishte nisur për në veri në shtator. Një nga ankesat e Kupit kundër LNC ishte se ai nuk kishte marrë as armë, as furnizime, meqë deri atëherë gjithçka ishte kanalizuar për njësitet partizane në jug. Ai duhet të ketë shpresuar se do të vepronte më mirë po të kishte një mision në zonën e vet. Më 18 shtator u shpërnda një trakt që shpallte formimin e një partie zogiste nacionaliste nga Kupi. Së shpejti ajo u bë e njohur me emrin Legaliteti, një emër që u kujtonte shqiptarëve kthimin e Ahmet Zogut në pushtet me forcë në dhjetor 1924, kur ai përmbysi qeverinë liberale të majtë të Fan Nolit dhe e quajti atë ngjarje Triumf të Legalitetit. Kongresin e parë të Legalitetit e mbajti në Zall Herr, afër Tiranës nga veriu, më 21 nëntor 1943, ndërsa në Shëngjergj, në javën e parë të dhjetorit, u bë një takim i fundit ku u hapën kartat ndërmjet Hoxhës dhe Kupit. Më tejherë pas kësaj u mbledh Kryesia e LNC për ta përjashtuar Kupin nga lëvizja.

Largimi i Abaz Kupit e bëri LNC shumë më hapur «sektare». Të vetmet figura të shquara jo komunistësh që mbetën në krye të saj, ishin Myslim Peza dhe Baba Faja, një dervish bektashi që binte në sy, i cili udhëhiqte një grup rezistence në malësitë e Martaneshit. Asnjëri prej tyre nuk paraqiste ndonjë sfidë politike kundër PKSH. Por LNC nuk u turbullua nga ngushtimi i bazës së saj politike. Përkundrazi,

logjika e hedhjes poshtë të marrëveshjes së Mukjes e çoi atë te një nivel edhe më ambicioz aspiratash dhe në Konferencën e Labinotit, në fillim të shtatorit, ajo shpalli se Këshillat Nacionalçlirimtarë të caktuar nën drejtimin e saj do të ishin i vetmi mjet i pushtetit popullor (pra qeveria) në Shqipëri. Ajo miratoi statutin dhe rregullat për ngritjen dhe funksionimin e këtyre këshillave nacionalçlirimtarë. Këshilli i Përgjithshëm i lëvizjes u shtua në numër nga shtatë (siç ishte vendosur një vit më parë në Pezë) në 62. Ai po niste të evoluonte si një lloj kuvendi popullor, i përshtatshëm për të miratuar me ngritje të dorës masat që ndërmerrete PKSH, kurse udhëheqësit e PKSH tashmë po merrnin pozat e qeveritarëve.

Konferenca e LNÇ e kreu dhe formalitetin për të miratuar hedhjen poshtë të marrëveshjes së Mukjes. Ajo gjithashtu vendosi që të ngriheshin organizata për të shërbyer si vende grumbullimi për rininë, studentët dhe gratë, pra për organizatat e masave në të ardhmen. Së fundi, Enver Hoxha, bëri një deklaratë për Kosovën, e cila nuk mund të ishte plotësisht e kënaqshme për PKJ. Ai tha këtë:

«Lëvizja nacionalçlirimtare ka për detyrë ta bëjë popullin e Kosovës koshient për aspiratat e tij dhe ai do të arrijë ta çlirojë veten vetëm nëpërmjet luftës kundër okupatorëve fashistë ose okupatorit eventual jugosllav, Drazha Mihajloviçit. Ne duhet të kujdesemi që populli i Kosovës të vendosë vetë se me cilën palë do të bashkohet... dhe të kundërshtojë regjimin jugosllav, që do të përpiqet ta shtypë»¹¹).

Ndonëse e thënë me fjalë ekuivoqe, kjo nuk ishte larg nga kërkesa që popullit të Kosovës t'i jepej e drejta për të vendosur nëse do të aderonte në Jugosllavi apo në Shqipëri, siç ishin marrë vesh Dishnica dhe Gjinishi me BK në Mukje dhe siç ishte njoftuar që e kishte quajtur të papranueshme Vukmanoviç Tempoja.

Ndërsa LNÇ kishte qenë e angazhuar me veprimtaritë politike kërcënuese në rastin e Mukjes dhe në Labinot, BLO ishin shpërndarë si një freskore mbi Shqipëri dhe po fitonin njohuri të përmasave shumë më të gjera për diversitetin e qëndrimeve dhe të aftësive të shqiptarëve për rezistencë. Nga mesi i shtatorit ata po merrnin furnizime nga ajri për vete në vendndodhjet e reja¹²). Hendzi e mori hedhjen e parë afër Dibrës natën e 22-23 shtatorit dhe atje ai priti një mision të ri me emrin e koduar Stables, që përbëhej nga majori Riçard Ridëll (Richard Riddell) dhe kapiteni Antoni Simkoks (Anthony Simcox) që të dy të RHA (Artilerisë Mbretërore

Kalorëse); Seimuri e mori hedhjen e parë në Greqë, në zonën e Myslim Pezës më 15-16 shtator; Nili, duke lëvizur drejt veriut në krahinën e Kupit, mori dy hedhje afër Shëngjergjit më 10-11 dhe 16-17 shtator dhe Fildi në jug mori disa hedhje në Tragjas, jo larg bregdetit, në juglindje të Vlorës, në shtator. Tilmani ishte vendosur në Sheper thellë në jug. Ai mori dy furnizime në shtator, duke nisur kështu një proces të vazhdueshëm furnizimi për forcat partizane në një nga zonat e pakta të Shqipërisë, ku LNC kishte arritur përfundimisht mbizotërimin që prej kohësh. Smajli kishte zhvendosur bazën në zonën e liqenit të Ohrit dhe nga mesi i shtatorit po merrte një seri hedhjesh në Llëngë (ai flet për shtatë, por regjisttrat e RAF shënojnë gjashtë). Çdo hedhje sillte pak më shumë se 1.5 ton furnizime.

Misionet në qendër e në veri tashti ishin në kontakt me BK, me udhëheqësit zogistë, si edhe me grupet e partizanëve. Ata i gostisnin me historira për tradhti e dhunë që praktikonin njëra palë kundër tjetrës dhe ata u përpoqën me një farë shkalle suksesi, të parandalonin shpërthime të veprimeve armiqësore ndërmjet tyre. Ata patën më pak sukses në përpjekjet për të siguruar një bashkëpunim pozitiv.

Balli Kombëtar ishte një shoqatë e çlirët individësh dhe përfshinte një rreth të gjerë pikëpamjesh «nacionaliste», anti-komuniste. Nga kjo anë, ai ishte krejt i ndryshëm prej LNC që duhej të ishte monolite. Shumë nacionalistë të rëndësishëm mbetën të pavarur nga BK, ndonëse ishin në kontakt me të përmes lidhjeve, miqve e kolegëve të vjetër. Kjo ishte aq më tepër e vërtetë për shumë krerë më të mëdhenj e më të vegjël në krahinat veriore. Në kundërshtim me strukturën e vet të çlirët, qëndrimi i BK ishte i njëjlojtë kudo. Ata do të bashkoheshin me një kryengritje të përgjithshme kundër pushtesit, kur fundi i luftës të ishte i afërt dhe do të ishin të kënaqur që të bisedonin për planet e këtij rasti eventual, duke pasur pak furnizime tani dhe më shumë në të ardhmen; por ata nuk do të shkaktonin shkatërrimin e vendit të tyre dhe të shoqërisë, duke organizuar sulme gueriljesh, që do të sillnin me vete raprezalje. Ndërkaq ata do të merrnin çfarëdo mase të nevojshme për të penguar përparimin e komunistëve. Deri më tani ata e kishin përdorur etiketën «komunist» për LNC në tërësi. Për këtë ata e kishin në rregull lidhur me udhëheqësit dhe përcaktuesit e politikës së LNC, por nuk ishin në rregull lidhur me anëtarët e zakonshëm dhe me disa nga komandantët e rangut të mesëm.

Për oficerët britanikë dy kategoritë e njerëzve me të cilë

kishin të bënin në Shqipëri, ishin partizanët (LNÇ, PKSH, komunistët) nga njëra anë, dhe nacionalistët (Balli Kombëtar, zogistët dhe krerët me qëndrime e pavarësi të ndryshueshme) nga ana tjetër. Po të flasim përgjithësisht dhe duke pranuar përjashtimet individuale, ishte më e lehtë të vendoseshin marrëdhënie personale të arsyeshme me nacionalistët se sa me partizanët. Nacionalistët silleshin si individë, miqësia ose armiqësia e tyre, ngrohtësia ose ftohtësia, bujaria ose kurnacëria e tyre kishin rrënjë pak a shumë më të rrokshme në rrethanat e tyre personale dhe në personalitetin e tyre. Brenda caqeve të vështirësive që i impononte jeta në Shqipëri, ishte e mundshme që të kënaqeshe me shoqërinë e nacionalistëve. Kënaqësia nuk është një fjalë që të vjen lehtë në mendje kur mendon për partizanët. Megjithatë, ndonëse shoqëria me nacionalistët prirej të ishte tunduese në krabasim me ekzistencën e rëndë, të përkushtuar dhe të ashpër që ofronin partizanët, BLO nuk mund ta pranonin këmbënguljen kryeneçe të nacionalistëve për të mos vepruar. Si pasojë, ndonëse BLO u përpoqën të inkurajonin nacionalistët duke u dhënë atyre sasi të vogla armësh, municionesh e pajisjesh herë pas here, zakonisht të lidhura me zotimin për të kryer prita ose akte sabotimi sipas marrëveshjes, grupet partizane në zonat e ndryshme merrnin pjesë më të mëdha nga ngarkesat relativisht të pakta që hidheshin nga ajri. Partizanët ankoreshin vazhdimisht se furnizimet ishin të pamjaftueshme dhe protestonin me forcë kundër furnizimit me materialë luftarake për «bashkëpunëtorët», një term elastik ky, i cili u zhvlerësua për shkak se përdorej për këdo që nuk ishte në LNÇ ose që nuk ishte me të. Nga ana e tyre, nacionalistët ankoreshin në shkallë të ndryshme zemërimi, sepse britanikët po armatosnin komunistët për të kapur Shqipërinë.

Në këtë pikë të ndërlikuar, kur LNÇ ishte e zënë me politikën në Labinot dhe BLO kishin nisur të stabilizoheshin në zonat e tyre operative, Shqipëria përjetoi një agim të shkurtër, të rremë të çlirimit që e zuri në befasi gjithkënd në këtë vend, me përjashtim të gjermanëve. Forcat e Aleatëve kapërcyen ngushticën e Mesinës dhe zbarkuan në thembrën e Italisë më 3 shtator. Më 8 shtator u shpall nga gjenerali Ajzenhauer (Eisenhower) armëpushimi ndërmjet Italisë dhe Forcave Aleate. Bisedimet ndërmjet Shtabit të Forcave Aleate dhe qeverisë italiane kishin qenë të ndërlikuara dhe të lidhura ngushtë me planet e zbarkimit, duke qenë zbarkimi në Salerno i caktuar për më 9 shtator. Kishte qenë e pamundur të paralajmërohej kushdo qoftë në Ballkan, që vepronte nën

Komandën e Lindjes së Mesme për çfarë do të ndodhte. Forcat italiane në Shqipëri ishin pa udhëzime, kurse partizanët nacionalistët e të gjitha ngjyrave dhe BLO duhej të improvizonin një veprim, kur lajmi i kapitullimit të Italisë depërta përmes buletineve të lajmeve në radio. Partizanët ishin të shqetësuar para së gjithash që të vinin dorë mbi armatime dhe pajisjet e italianëve. Italianët nuk po e prisnin me padurim që t'i çarmatosnin dhe kështu të binin në mëshirën e partizanëve. Oficerët britanikë, duke vepruar secili me iniciativën e vet, ndërhyjnë me aq sa mundën duke u përpjekur të sigurohej dorëzimi i italianëve sipas rregullit të duhur dhe që të dorëzonin armët. Por gjermanët bënë një veprim të shpejtë për të marrë nën kontroll qytetet kryesore me garnizone; partizanët e pastërvitur nuk mund të ngriheshin për t'u dhënë goditje të shpejta gjermanëve përpara se ata të konsolidonin pozicionet e tyre, ndërsa italianët nuk bënë asnjë rezistencë. Disa nga oficerët eprorë italianë dolën se ishin interesuar vetëm për të shpëtuar kokën e tyre dhe i lëshuan repartet e tyre të shpërndahen në rrëmujë. Kempin në Berat, Smajlin në Pogradec dhe Sejmurin në Tiranë, secili për vetë, turbulluan nga shpejtësia e reagimeve gjermane dhe nga qëndrimi pasiv i italianëve.

Oficerët eprorë italianë, me të cilët u përpoq Maklini të hynte në kontakt në Korçë, iu dorëzuan gjermanëve. Nili u përpoq t'i bënte partizanët e zogistët që të bashkëpunonin për të kapur e për të mbajtur Krujën, por gjermanët ndërhyrën vendosmërisht dhe vetëm Abaz Kupi personalisht tregoi një shpirt luftarak të mirë. Shumë italianë u morën rob nga gjermanët, shumë të tjerë hynë në një lloj shërbimi prej robesh jash në fshatrat shqiptare, mjaft vdiqën dhe të gjithë u demoralizuan. Vetëm një numër i vogël, jo më shumë se 150 veta, u bashkuan me partizanët dhe formuan batalionin nr. 1 emrin e komunistit italian Antonio Gramshi.

Në këtë kohë kushdo në Shqipëri mendonte se forcat Aleatëve do të zbarkonin së shpejti në Ballkan për të shfrytëzuar kapitullimin e Italisë. Në të vërtetë do të kishte qenë shumë në interes të Shqipërisë, nëse lufta do të kishte mbërritur atëhere dhe një prani e Aleatëve do të ishte në gjendje të mbante hallkën në dorë, ndërkohë që grupet e shqiptarëve do të gjenin një kompromis. Papërkulshmëria e gjermanëve dhe një vit i mëpastajmë shkatërrimesh që ata i sollën vendit e bënë të sigurtë se nuk kishte për t'u bërë asnjë kompromis. Disa fjalë në një letër, që Çurçilli e ka shkruar rrugës për Konferencën e Kajros të fundit të nëntorit, jep një verditë

përgjithësues për rezultatet e atyre ditëve të shtatorit në Ballkan:

«...ne kemi dështuar në përpjekjet për t'u dhënë mbështetje në përmasa reale partizanëve dhe patriotëve në Jugosllavi e në Shqipëri... gjermanët i fshinë vështirësitë që u krijuan nga kapitullimi dhe dezertimi i italianëve, madje me ashpërsi të madhe po i zhbijnë shumë nga forcat e patriotëve... Ne tani ndodhemi përballë perspektivës që një ditë e përcaktuar për operacionin «Overlord» do të vazhdojë ta vësh-tirësojë dhe ta dobësojë fushatën e Mesdheut, punët tona në Ballkan do të shkojnë duke rënë dhe Egjeu do të mbetet pa u lëkundur në duart e gjermanëve.»¹³).

Në Konferencën e Teheranit, që u mbajt menjëherë pas Konferencës së Kajros, të tre Aleatët u morën vesh që partizanët në Jugosllavi duhej të mbështeteshin me furnizime e pajisje në masën më të madhe të mundshme, e gjithashtu me operacione të grupeve të hedhura. Aty nuk u përmend Shqipëria, por ky vendim në favor të partizanëve të Titos nuk mund të mos ndikonte mbi skenën shqiptare, pjesërisht sepse përpjekjet më të mëdha për furnizime të drejtuara për Jugosllavinë do të kishin një rrezatim për vendin fqinjë, dhe pjesërisht sepse asnjansoheshin barrierat ideologjike për të punuar me një lëvizje partizane të kontrolluar nga komunistët.

Ndërkaq dukej që përpjekjet britanike në Shqipëri po lulëzonin. Kempin u bashkua me misionin e Sejmurit në Greqë më 16 shtator dhe arriti të vendoste lidhje me Enver Hoxhën e me udhëheqjen e LNC, që ishin në kodrat afër Arbanës, në jug të Tiranës. Veçan nga politika, ata ishin të zënë me formimin e Brigadës III partizane në zonën e Myslim Pezës. Një javë më vonë Kempin ia doli të depërtonte në Tiranë, i maskuar, me ndihmën e partizanëve dhe arriti të hynte në kontakte me përfaqësues të tendencave të ndryshme. Përvoja e kontakteve mjaft intensive me njerëzit e LNC pati po atë efekt për ta zvjerdhur Kempin, po ashtu si Smajlin. Në ditët e para të tetorit erdhi Nili nga zona e Kupit në veri të Tiranës dhe dha ndihmesën e vet për ta shtuar bindjen se detyrimet britanike ndaj partizanëve duhej të mbaheshin brenda kufijve, meqë partizanët nuk ishin aspak forcë mbizotëruese në veri. Smajli lëvizti nga zona e Ohrit drejt Elbasanit në ditët e fundit të shtatorit, sepse shumica e veprimeve që rrodhën pas kapitullimit të Italisë dukej që po ndodhnin në zonën midis Elbasanit e Tiranës. Hoxha dhe kolegët e tij në këtë kohë ishin të zënë me përgatitjen për formimin e Brigadës II dhe të III

partizane. Brigada II po formohej në krahinën në juglindje të Tiranës, atje ku Baba Faja kishte territorin dhe pasuesit e vet, ndonëse binte edhe në krahinën më të gjerë, ku parësinë e kishte Myslim Peza.

Rrugës së Smajlit për Elbasan ndodhi një ngjarje që do të kishte jehonë në gjithë muajt pasues dhe në kujtimet e Hoxhës e të Smajlit. Kur ai kapërceu urën kryesore ndërmjet Veriut e Jugut mbi lumin Shkumbin (Shkumbini kur vërshonte ishte një pengesë shumë serioze në dimër), Smajli e hodhi atë në erë për të mos e përdorur gjermanët në qarkullimin e tyre gjatë rrugës nga Korça në Elbasan e Tiranë. Kjo e zemëroi Enver Hoxhën dhe kolegun e tij ushtarak që po bëhej gjithnjë e më i rëndësishëm, Mehmet Shehun. Smajli thotë se ura ishte e rëndësishme për ta që të mos prishej për ta përdorur eventualisht që t'i hidhnin forcat e tyre toske mbizotëruese në drejtim të veriut kundër nacionalistëve gegë, por natyrisht ura shërbente për lidhjen ndërmjet jugut dhe rrethinave të Tiranës, ku LNÇ kishte shumë arsye që të ishte aktive. Për ironi, vështirësia për të lëvizur ndërmjet veriut e jugut në fillim u bë një problem i zorshëm e pothuaj fatal për udhëheqjen e LNÇ nga mesi i dimrit që po vinte, kur ata kishin nevojë të madhe jo për të shkuar drejt veriut, por për të shpëtuar nga gjermanët duke kaluar në jug. Shkatërrimi i urës e shtroi në mënyrë të mprehtë pyetjen: e cilës Shqipëri ishte ajo? Partizanët ishin plotësisht të sigurtë se ishte e Shqipërisë së tyre dhe ishin të vendosur që me çdo rrugë ajo të bëhej e tyrja, kështu që e shihnin urën si një nyje vitale. BK pretendonte se e kishte të veten dhe nuk ia mbante barku që ta dëmtonte trashëgiminë kombëtare, duke hedhur në erë urat e rëndësishme e duke ndjellë raprezalje të egra të gjermanëve. Oficerët britanikë nuk përkrahnin asnjërin pikëpamje. Ata donin veprime luftarake kundër gjermanëve dhe prireshin ta shihnin Shqipërinë si një lloj toke të askujt. Shkatërrimi që bëri Smajli ia përforcoi Enver Hoxhës mosbesimin te britanikët «imperialistë» dhe vendosmërinë e tij për t'i trajtuar ata pa asnjë lëshim. Smajli i prishi punët me Këshillin LNÇ në Labinot dhe midis tyre u shkëmbyen fjalë të nxehtura.

Pikërisht në atë kohë iu njoftua Maklini në një mesazh nga Kajroja, se një mision i ri për kuartierin e përgjithshëm do të vinte në Shqipëri për të marrë komandën e misioneve britanike dhe për të bashkërenduar punën e tyre. Komandanti i ri do të ishte gjenerali i brigadës E. F. Dejvis i Pushkatarëve Mbretërorë të Olsterit, i njohur përgjithësisht me emrin «Troc-

ki» Dejvis, emër që nuk përputhej fare me të. Smajli u zhvendos nga Labinoti në pllajën e Bizës, lart në malësinë e Çermenikës në veri të Labinotit, që LNÇ e kishte rekomanduar si shesh për hedhje me parashutë ose, siç e quanin në atë kohë, shesh zbritjeje. Me kalimin e kohës doli se kjo zgjedhje nuk ishte e përshtatshme. Biza ishte një shesh zbritjeje i shkëlqyer, por nuk ishte një vend i përshtatshëm dhe i rehatshëm me ardhjen e dimrit. Smajli e përgatiti atë si një fushim për kuartierin e ri.

Maklini u bëri një vizitë misioneve afër Tiranës dhe i gjeti pak të prapambetura për shkak të sëmundjeve. Shqipëria e kishte zakon t'u merrte ujemin atyre që ishin qoftë edhe pak të dobët nga shtati. Ishte vjeshtë, një stinë shumë e lagësht. Kjo goditje nga sëmundjet ishte i pari nga telashet që do t'u binin mbi kokë misioneve në dimër. Më 9 tetor gjermanët dhanë një paralajmërim të vogël për atë që do të ndodhte më pas, duke bërë një sulm drejt Arbanës. Partizanët u kapën në befasi, por e përballuan këtë radhë më mirë se sa në ndeshjet e mëparshme, ku kishin qenë dëshmitarë oficerët britanikë, dhe Brigada III nën Komandën e Hulusi Spahiut i zbrapsi gjermanët. Enver Hoxha dhe kolegët e tij kryesorë u përfshinë në vijën e zjarrit, por me sa duket Hulusi Spahiu dhe Mustafa Gjinishi qenë ata ndër udhëheqësit që u shquan gjatë luftimit. Që të dy këta fituan nota mjaft të mira nga oficerët britanikë që i njihnin; që të dy morën nota mjaft të këqija nga Enver Hoxha si të pabesuar politikisht.

Gjatë tetorit, ndërsa të gjithë prisnin të shihnin se çfarë do të sillte gjenerali i ri, puna e hedhjes së furnizimeve vijoi në përmasa modeste¹⁴⁾. Sejmuri dhe Kempri u ushqyen më mirë me gjashtë hedhje në Greçë, duke arritur shumë e përgjithshme rreth 10 tonë. Një pjesë e mirë e tyre duhet t'u ketë shkuar partizanëve dhe do të jetë përdorur për të pajisur Brigadën II dhe III. Nili mori një hedhje të vetme afër Bastarit në krahinën e Kupit (më pak se 2 tonë). Hendzi në zonën e Dibrës mori edhe dy hedhje të tjera. Tilmani në jug mori një hedhje dhe Fildi në zorën e Vlorës mori dy. Një dokument i përgatitur për Komitetin e Operacioneve të Posaçme në Kajro nga fundi i vitit, e përmbledhte shumë e përgjithshme të përfunduar për armët e hedhura në Shqipëri deri më 24 dhjetor 1943 kështu:¹⁵⁾

Pushkë antitank	150
Mortaja	40

Automatikë	300
Pushkë gjysmautomatike	400
Pushkë	350
Granata	4500
Mina antitank	1000
Eksplozivë	6000 paund (rreth 3 tonë)

Këto shifra përfshinin furnizimet me të cilat Maklini dhe Smajli kishin armatosur Brigadën 1 partizane. si dhe furnizimet e hedhura për misionet e tjera nga fundi i shtatorit e më pas, pjesa më e madhe e të cilave gjithashtu do të ketë shkuar për partizanët. Sasitë ishin të pamjaftueshme për t'u dhënë marrësve një epërsi ushtarake vendimtare. Komitetit të Operacioneve të Posaçme (SOC) iu tha gjithashtu se grupeve të gueriljeve u ishte dhënë një shumë e përgjithshme prej 4.820 florinjsh si dhuratë e regjistruar deri në fund të vitit 1943. Shpërndarja e florinjve nuk ishte e lidhur aq rreptësisht me veprimet ushtarake kundër gjermanëve siç ishte shpërndarja e armëve, por pjesa më e madhe e këtyre florinjve duhet të ketë shkuar te partizanët. Shumat e përfshira ishin tepër të vogla për të krijuar një arkë financiare për luftën.

Enver Hoxha ishte i zënë me shpejtimin e hapave në anën politike. Komiteti Qendror i PKS H më 1 tetor nxori një letër qarkore, me të cilën i njoftonte kuadrot e partisë në të gjithë vendin se: «Bashkimi me Ballin Kombëtar tani është një punë e vdekur dhe s'bisodhet më për atë punë. Tani bisodhet shpartallimi i Ballit Kombëtar»¹⁶). Letra jepte direktivën që të shkatërroheshin me armë të gjitha organizatat dhe forcat e armatosura reaksionare jashtë Frontit Nacionalçlirimtar. Shtabi i Përgjithshëm u dha urdhër reparteve e njësiteve partizane që të spastronin nga reaksionarët të gjitha krahinat e çliruara. Komitetet qarkore të Beratit e të Gjirokastrës u kritikuan ashpër, sepse nuk morën masa të menjëhershme për të shkatërruar aparatit e pushtetit të vjetër dhe lejuan që ky aparat të vihej nën kontrollin e Ballit Kombëtar dhe të përdorej prej tij. Sigurimi i PKS H ishte i rreptë dhe lajmet për udhëzime shumë të qarta nuk rrodhën jashtë, por nacionalistët nuk kishin dyshime për qëllimet e udhëheqësve komunistë të LNC dhe, tani që shpresat për një zbarkim të Aleatëve në Ballkan ishin shuar shpejt, nisën të shpresonin se gjermanët do t'ua prisnin shkurt synimet partizanëve. Misionet britanike ishin plotësisht të vetëdijshme për rrezikun e shpërthimit të përgjithshëm të luftimeve ndërmjet forcave të partizanëve dhe

nacionalistëve, ndërsa i kishin përqendruar përpjekjet e veta për t'i bërë që të dyja palët të luftonin kundër pushtuesit gjerman. Që nga kjo kohë e më pas për britanikët u bë një shqetësim parësor të parandalonin luftën civile. As atje në vend, as në Kajro dhe as në Londër ende nuk ishte vlerësuar se zaret tashmë ishin hedhur.

Nga ana e tyre, pushtuesit gjermanë luajtën një kartë të zgjuar, por shkatërrimtare për Shqipërinë. Ata lejuan një grup burrash shteti të vjetër që të ndërmerrnin ringjalljen e institucioneve të Shqipërisë para vitit 1939 dhe të gërryenin institucionet, ligjet etj. që ishin imponuar gjatë pushtimit italian. U formua një Këshill i Regjencës me një ish kryeministër para lufte si kryetar i Regjencës, Mehdi Frashërin, i cili kishte qenë në mërgim në Itali, por që tani u soll në Shqipëri nga gjermanët, Ai përkrahej nga dy figura të tjera me meritë nga e kaluara e pavarur e Shqipërisë, Lef Nosi dhe Pater Anton Arapi, ndërsa qeveria u formua me njerëz që nuk ishin përlyer nga bashkëpunimi i ngushtë me italianët. Regjimi i ri pretendonte se ishte asnjans në luftë, duke injoruar faktin që territori mbi të cilin ushtronin pushtetin ishte Shqipëria e Madhe, domethënë një vend i zgjeruar nëpërmjet rezultateve të shkatërrimit të Jugosllavisë fqinjë nga gjermanët. Kjo maskaradë u krye nën emrin e ruajtjes së Shqipërisë për shqiptarët dhe në radhë të parë duke e mbrojtur atë nga komunizmi. Propaganda gjermane rreth rrezikut komunist ishte e dendur dhe kudo që ndeshnin partizanët, gjermanët ishin të pranishëm në përdorimin e terrorit ndëshkues. Dora e tyre binte mjaft e lehtë mbi ata që rrinin urtë. «Nacionalistët» ua shpërblyen siç duhej dhe qëndruan të urtë. Asnjë figurë e vetme ndërmjet «nacionalistëve» të Shqipërisë nuk e ngriti zërin e protestës kundër gjermanëve dhe qeverisë së shtirë në Tiranë. Ata ishin shumë të zënë me protestat kundër LNÇ, partizanëve, PKSH dhe Enver Hoxhës. U bë një garë ndërmjet LNÇ e gjermanëve për të parë se kush do ta ndante më efektivisht Shqipërinë dhe t'i jepte fund gjysmës mbizotëruese. Siç do të shihet, gjermanët për pak sa nuk fituan në dimër, por LNÇ u mbajt në fije të perit, i qëndroi garës dhe eci përpara për të marrë gjithçka. Nacionalistët miopë në çështjet botërore, mbrojtës dhe ruajtës të një rendi shoqëror të cilin dhuna e italianëve dhe e gjermanëve tashmë e kishin rrënuar, të paaftë për vetësakrificat që kërkonte rezistenca kundër gjermanëve, qëndruan kryeneçësisht pasivë deri në fund dhe rrëshqitën nga vetëkënaqësia në dëshpërim e shfarosje.

Në një nga vështrimet përmbledhëse informative me datën 15 dhjetor 1943, Margaret Hezllaku ne Kajro ka shkruar një apologji elokumente për qeverinë e regjencës. Ajo shkruan:

«Vijat e politikës së qeverisë do të kishin gjetur miratimin tonë të ngrohtë, nëse ne nuk do të kishim qenë në luftë me një vend, forcat e armatosura të të cilit tani kishin pushtuar Shqipërinë... Për më tepër ata i kanë bërë thirrje rinisë që t'i shmanget luftës civile dhe ta ruajë të paprekur Shqipërinë, të cilën ata, burrat më të vjetër në qeveri, e kishin bërë, por të cilën ata, të rinjtë, do ta trashëgonin nesër. Në të vërtetë, këta burra të vjetër duhet të kenë një dhimbje të madhe duke vështruar kaosin, në të cilin e ka zhytur vendin lëvizja guerilje. Ata lindën për të hequr qafe sundimin e degraduar turk. Ata u rritën për të luftuar për pavarësinë, shumë njerëz si vëllezërit Butka dhe i ndjeri Idromen Kosturi e bënë me luftë çetash, disa të paktë si Lef Nosi dhe i ndjeri Preng Pasha i Mirditës e bënë me vitet e burgimit, të internimit e të mërgimit. Kur u arrit pavarësia, ata, si myslimanët dhe të krishterët, i kthyen fytyrat nga Perëndimi dhe ata bënë për vete e ndihmuan brezin më të ri për të fituar një farë shkalle të qytetërimit perëndimor. Ata u gëzuan duke parë qeveritë e mëpastajme, që ia hoqën popullsisë armët, të cilat shërbenin vetëm për të ruajtur barbarinë mesjetare. Tani ata shohin se si akrepat e orës janë kthyer prapa në vitin 1920 ose më parë, armët janë në duart e çdo njeriu, jeta e njeriut nuk vihet në hesap dhe anarkia është harbuar.

Ata nuk do të ishin aspak njerëzorë nëse nuk do të bënin pyetjen, a do ta vliente dëmin ekonomik e politik që do të pësonte vendi, atë përfitim që kishte impenjimi ushtarak i Aleatëve, i cili arrihej nga taktika guerilje duke goditur e duke ikur»¹⁷).

Ky fragment parashtron në mënyrë të admirueshme çështjen e kundërshtarëve të LNC më mirë dhe në mënyrë më bindëse se sa e kemi dëgjuar të shtrohet në Shqipëri. Por, natyrisht, ishin gjermanët ata që e kishin vënë në rrugë procesin e dëmtimit ekonomik e politik, dhe jo gueriljet e partizanët, dhe i vetmi qëllim për të cilin u dërguan oficerët britanikë në Shqipëri ishte të ngrihej lufta kundër Gjermanisë. Ky ishte shkëmbi në të cilin çështja e nacionalistëve në Shqipëri do të përplasej për t'u fundosur.

Shënime

1. Smiley (1984) në disa pjesë të librit për hollësitë rreth misionit të parë Concensus. Për kureshtje, fjala «consensus» gjithnjë është shkruar gabim «concensus».
2. PRO, Air 27/995.
3. Kemp (1958; 86-126) dhe Smiley (1984; 27-80).
4. Smiley (1984; 67).
5. Smiley (1984; 71).
6. Kemp (1958; 120).
7. Pano (1968; 51-53).
8. Dedijer (1949; 93-94).
9. Vukmanoviç-Tempo (1990; 127-132).
10. Marmullaku (1975; 48).
11. Marmullaku (1975; 142-143).
12. PRO, Air 27/995.
13. Churchill (1952; V, 292-93).
14. PRO, Air 27/995.
15. PRO, FO 371/43555.
16. Historia e Partisë së Punës të Shqipërisë (1982; 133).
17. PRO, FO. 371/43549.

Kreu 5

Misioni i gjeneralit të brigadës Dejvis dhe katastrofa në mes të dimrit

Misioni i gjeneralit të brigadës «Trocki» Dejvis ishte mbështetur në disa konceptime të gabuara. I pari, ishte ideja se Britania, ndonëse nuk kishte ndër mend të caktonte ndonjë nga forcat e saj për një fushatë në Ballkan dhe në këtë fazë kishte dislokuar vetëm një skuadër aeroplanësh Halifax për furnizime ajrore gjithë vendeve të Ballkanit, përsëri mund të luante një rol kryesor, të ndryshëm nga roli ndihmës, për organizimin e rezistencës. Në vendin fqinjë, në Jugosllavi, gjenerali i brigadës Ficroj Maklin kishte pasur fatin të vihej në një rol ndihmës që në fillim. Fatkeqësisht për «Trocki» Dejvisin, Shqipëria ende nuk kishte nxjerrë një udhëheqës të shquar. I dyti, ishte përmasa dhe trajta e misionit. Duke qenë një ushtarak i rregullt me shumë përvojë, që kishte mbajtur përsipër komandën e një brigade, ai solli me vete personelin e një kuartieri shtabi brigade. Përbërja e kuartierit të tij përfshinte postat e zakonshme G, A dhe Q, që merren me operacionet, administrimin e furnizimet, kapitenin e shtabit, një oficer sinjalizmi, një kryesekretar e kështu me radhë. Për standardet e luftës në Shqipëri ky ishte një grup tepër i madh. Aty nuk kishte asgjë për të komanduar në kuptimin konvencional ushtarak, asnjë vijë fronti prapavije që duhej të mbrohej, as «forcat tona» dhe as mjete të besueshme për të siguruar informacionin për armikun. Pati vështirësi për ta rregulluar një shtab kaq të gjerë sapo arriti në vend dhe ishte kjo arsyeja që shkaktoi vendosjen e tyre për fushim

në Bizë. Prej këtej lindi koncepti i tretë i gabuar, sipas të cilit livadhet në majë të maleve në Bizë, të ftohta, të rrahura nga era e shiu, mund të shërbenin si bazë për një shtab qendror në prag të dimrit. Keqkuptimi i katërt lidhej me moshën dhe përvojën. Gjenerali Dejvis ishte dyzet e tre vjeç dhe e kishte kaluar gjithë karrierën e tij në ushtri. Oficeri kryesor i shtabit të tij ishte nënkoloneli Artur Nikols i Gardës Koldstrim (Coldstream), gjithashtu një ushtarak profesionist dhe fizikisht jo nga njerëzit më të fortë. Duhet thënë se kushtet në Shqipëri vinin në provë gjithë duresën fizike të burrave shumë më të rinj dhe shumë gjëra që ndodhën gjatë Luftës në Shqipëri ishin një fyerje për parimet e larta dhe procedurat e shëndosha të oficerëve profesionistë eprorë. Gjatë rezistencës në Shqipëri një burrë në moshën e të tridhjetave quhej një nga më të moshuarit. Ata që e planifikuan misionin e Dejvisit dhe lejuan që të mernte trajtën që mori, nuk i njihnin kushtet në vend.

Tashmë e kemi përshkruar qëndrimin e pavendosur të Londrës ndaj Shqipërisë (shih kreun 2). MO4 në Kajro kishte në dispozicion më shumë informacion për Shqipërinë se kushdo në Londër, por ky ishte një informacion mjaft i gabuar. Në verë dhe vjeshtë 1943 zonj. Hezllak ishte ende në qendër të rrjetës së SOE për Shqipërinë, duke u përpjekur të pajtonte mesazhet që po vinin nga misioni Concensus me njohuritë e saj të mëparshme për Shqipërinë. Mesazhet detyrimisht ishin pak lakonike dhe me zbrazëti të ndërmjetme, për shkak të vështirësive të transmetimit me radio. Ato sollën disa lajme të habitshme. Në një përmbledhje informative me datën 16 korrik (data është e letrës në të cilën e ka marrë FO nga SOE), ajo shkruante:

«Kemi disa lajme të kënaqshme për të dhënë. Shërbimi informativ SOE për Shqipërinë është shëndoshë e mirë dhe çetat shqiptare janë po aq aktive dhe antiitaliane, sa ç'ka qenë njoftuar... Habia më e madhe që del nga burimet e reja të informacionit që kemi gjetur (ajo kishte folur më parë për një oficer britanik, i cili kishte depërtuar në Shqipëri disa javë më parë dhe për një tufë gazetash e broshurash klandestine, duke përfshirë edhe gazetën e PKSH «Zëri i popullit» të nxjerra fshehurazi nga Shqipëria) janë simpatitë proruse të gueriljeve. Në ditët para luftës ndikimi komunist në Shqipëri ishte i papërfillshëm dhe nuk është aspak i qartë shkaku i këtij ndryshimi. Është e sigurtë vetëm që ai ka ndodhur. Gazetat klandestine përmendin Partinë Komuniste Shqiptare, komisarët politikë, ushtrinë popullore, gru-

shtet e shtrënguar, partizanët dhe stolirat e tjera të të kuqve Partizanet mbajnë një yll të kuq me pesë cepa përveç flamurit shqiptar. Në gazetatat klandestine ata përmenden si të veçantë nga çetat vullnetare, të cilat mbajnë si simbol vetëm flamurin shqiptar. Megjithatë, partizanët dhe vullnetarët luftojnë në të njëjtën çetë dhe kur një çetë partizane është e zënë ngushtë, një çetë vullnetare nxiton që ta shpëtojë dhe anasjelltas. Gazetat klandestine e përmendin mbretin Zog vetëm një herë dhe atëhere tërthorazi e me armiqësi».)

Kjo pjesë tregon për cilësinë e informacionit që disponohej rreth situatës në Shqipëri, kur iu kërkuar gjeneralit Dejvis në gusht 1943 të kryesonte një mision ushtarak dhe të organizonte rezistencën në një vend ballkanik. Në krye ai e kujtonte se do të shkonte në Jugosllavi, por kjo u zëvendësua me Shqipërinë, kur ai arriti pas pak ditësh në Kajro.

Organizata e SOE në Kajro, MO4 vuante në atë kohë nga një zgjerim shumë i shpejtë, para se të shndërrohej në dhjetor në Forcën 133 të Komandës së Lindjes së Mesme. Gjeneral-majori Gubbins, i cili para pak kohësh ishte zëvendësuar si drejtor i SOE në Londër, kaloi në Kajro pikërisht kur Dejvisi po nisej për Shqipëri dhe i tha atij se improvizimi i shkëlqyer, që e kishte karakterizuar punën e MO4, do të zëvendësohej me një punë më të rregullt me personel.²⁾ Disa nga oficerët që kishin qenë në Shqipëri në vjeshtën e 1943, kishin dëgjuar për vonesat e gjata në dëshifrimin e radiogrameve të marra nga misionet, vonesa që disa herë arrinin deri tri javë. Vetë mesazhet ishin shumë të shkurtra dhe nuk mund të ishin aspak informative për imtësitë e holla të skenës shqiptare. Rrjedha e informacionit ishte e kursyer për shkak të vështirësive të komunikimit me anë të një radioje futur në një valixhe, që endej nga një fshat në tjetrin mbi kurrizin e një mushke ose të një njeriu dhe që ushqehet me bateri makinash në një zonë fshatare pa elektricitet, si dhe nga puna e lodhshme për të kryer një transkriptim të dyfishtë me shifrim shkronjë për shkronjë në rrethana të një jete krejt fshatarake. Kur kësaj i shtoheshin edhe vonesat në përpunimin e informacionit në Kajro, atëhere duhet pranuar se personeli drejtues ishte i detyruar të vepronte të paktën përgjysmë verbërisht dhe se misioneve atje në vend u duhej besuar të vazhdonin si ta shihnin vetë më mirë, duke pasur vetëm udhëzimet më të përgjithshme, madje edhe kur këto udhëzime ishin zakonisht pak të vjetruara. Personeli në Kajro u përpoq me ç'të mundte që të ishte i dobishëm dhe Marga-

ret Hezllaku, si i vetmi burim për informacionin autentik rreth Shqipërisë, bëri ç'është e mundur që ta kthente atë vend të dukej i kuptimshëm. Megjithatë, në tërësi BLO i vlerësonin anëtarët e grupit të Kajros më tepër për shoqërimin e tyre si njerëz, se sa për dobinë e tyre zyrtare: shërbimet e SOE dukej se ishin plotësuar nga një ushtri e vogël e FANY (Shoqata e Motrave të Ndihmës së Shpejtë), që plotësonte me kujdesje e me lezet atë që u mungonte në përmbajtje raporteve informative.

Dejvisi dhe Nikolsi u hodhën në Bizë natën e 15-16 tetorit nga dy Halifax, ndërsa dy të tjerë erdhën me personel tjetër netët e mëpastajme. Grupi i kuartierit të shtabit u prit nga Maklini e Smajli dhe u vendos në barakat që kishte përgatitur Smajli me punën e italianëve e të shqiptarëve. Kuartieri shpejt mori pamjen e një stabilimenti me peshë dhe përmasat e tij u bënë të tilla, sa doli e nevojshme të drejtohej mbi baza të rregullta disiplinore, gjë që dukej tepër e papërshtatshme në rrethanat e zhvillimit të parregullt të luftës në Shqipëri dhe u ra si një lloj shoku një grushti oficerësh e njerëzish, që tashmë i kishin mësuar kompromiset me zakonet e vendit, të cilat ishin të domosdoshme për të mbijetuar në misione të vogla e të shpërndara. U blenë me florinj kuaj e mushka nga fshatarët që vinin prej fshatrave malësore për të parë se çfarë mund të fitonin. U morën edhe mushkarë. U arrit një herë që të kishte deri 100 kafshë në radhët e tyre. U zunë me punë shërbëtorë e punëtorë, disa italianë e disa shqiptarë. U ngrit shpejt një mensë për oficerët dhe mensa të veçanta për rangjet e tjera, si dhe një kuzhinë e madhe, të gjitha me personel të përshtatshëm nga italianë e shqiptarë. U dërguan ekspedita për të bërë pazar në Elbasan. Materialet ushtarake që kishin ardhur me katër aeroplanët u shërndanë me rregull për njësitë partizane. Kadri Hoxha, i cili komandonte krahinën e Elbasanit, u caktua nga Enver Hoxha që të kujdesej për gjeneralin britanik dhe Frederik Nosi u vu si përkthyesi kryesor, si oficer ndërlihdës dhe si administratori shqiptar. Nosi ishte i kujdesshëm dhe i pranueshëm për britanikët, duke qenë njëkohësisht plotësisht i besueshëm nga pikëpamja e Enver Hoxhës (në fakt, Nosi kishte një të kaluar «deviacioniste», gjë që e bënte atë shumë të ndjeshëm ndaj kërkesave të Enver Hoxhës). Përveç Kadri Hoxhës, kishte edhe një personalitet tjetër të LNC, në atë zonë, Baba Faja, dervishi bektashi që kishte qenë një udhëheqës i hershëm i spikatur çete, por roli udhëheqës i të cilit tani

po zbehej, ndonëse ngjyrimi i spikatur i mbetej i pandryshueshëm. Ai e kishte bazën në Martanesh, në verilindje të Bizës, dhe ai me grupin e tij duhej të merrte pjesën e vet nga materialet ushtarake.

Ndonëse misioni i kuartierit ishte i gjerë, ai nuk ishte i plotë dhe asnjëherë nuk u bë i plotë. Kishte një vend të zbrazët në nivelin epror për anën administrative dhe drejtimin e kuartierit. Nënkoloneli Norman Uiler (Wheeler) nga regjimenti i vetë «Trookit», i pushkatarëve Mbretërorë të Olsterit, pritej të hidhej në Bizë shpejt pas personelit kryesor të misionit. Në fakt ai asnjëherë nuk erdhi atje. Skuadrilja 148 nisi të ndeshej me një mot shumë të keq mbi Shqipëri nga fundi i tetorit. Ata bënë disa përpjekje për të hedhur nënkoloneli Uiler dhe disa oficerë të tjerë por pa sukses, ndërsa hedhja u bë më në fund në jug të vendit, duke shpresuar që grupi do të ishte në gjendje të marshonte drejt veriut në kuartier. Ndërkaq ofensiva e dimrit e gjermanëve kishte shpërthyer e plotë dhe ata u detyruan të qëndronin në jug.

Mungesa e hedhjeve nga ajri në nëntor do të kishte një efekt tjetër të dëmshëm mbi misionin e kuartierit. Pasi i harxhuan rezervat që kishin sjellë me vete, ata u detyruan të varehin nga furnizimet e vendit dhe kjo nuk do të ishte e lehtë për një personel kaq të madh, madje edhe në kohët më të mira. Problemi i furnizimeve në Bizë u bë i mprehtë nga fundi i nëntorit. Ndërmjet 7 dhe 29 nëntorit nuk pati asnjë hedhje në Shqipëri, pjesërisht sepse një pjesë e madhe e Skuadriljes 148 në mes të nëntorit u shkëput për Kajron në perëndim që t'i shërbente një operacioni të drejtuar për në Leros. Menjëherë para dhe pas kësaj periudhe të vdekur, të vetmit ata që patën fat të merrnin furnizime ajrore ndërmjet klientëve të vjetër në Shqipëri ishin Nili (Thatimi), i cili mori pesë ngarkesa ajrore afër Bastarit në zonën e Kupit, Tilmani (Skulptori), që mori dy në Sheper në jug dhe Hendzi (Vejusha) që mori një në Degë, përtej lumit Drin thellë në veri.³⁾ Gjenerali Dejvis ishte fare pa fat.

Menjëherë sapo u vendos në Bizë, Dejvisi u përpoq të nxiste veprimet kundër gjermanëve. Ai nisi një grup për të kryer një shkatërrim në rrugën e Elbasanit dhe një grup në afërsi të Tiranës. Që të dy grupet i gjetën partizanët, në rastin më të mirë, jo të besuar për të mbështetur iniciativat e britanikëve dhe në rastin më të keq, i penguan. Ai organizoi udhëtime rikonjicioni, duke u përpjekur të gjente një rezidencë më të mirë për kuartierin, por fshatrat poshtë Bizës

në të gjitha drejtimet dukeshin të papërshtatshme. Një mision kaq i madh do të ishte shumë i zbuluar për sulme në befasi nga ana e gjermanëve, sapo të lëvizte e të dilte në pjesën më të lartë të masivit malor. Kuartieri qëndroi në Bizë në barakat e tendat e veta, të bëra nga parashutat dhe iu desh të duronte fillimin e shirave të rëndë, dëborën e herë-pashershme dhe të ftohtët që shtoheshin. Grupi i britanikëve nisi gjithashtu të provojë mënyrën me të cilën shërbëtorët besnikë ose rojat në dukje të disiplinuar, befasisht shndërroheshin në grabitës, plaçkaxhinj ose dezertorë sapo mungonte ose shthurej mbikëqyrja, kur çdo lloj krize e çregullonte jetën e zakonshme të fushimit.

Pas dy a tri ditësh konsultimi të kujdesshëm me Maklinin dhe Smajlin, Dejvisi vendosi që këta dy oficerë duhej të çanin rrugën drejt bregdetit në jug të Vlorës, ku Fieldi (Fidani) mendohej se po ngrinte një bazë për furnizime nga deti dhe do të kalonin me det në Itali e në Kajro për të raportuar. Më 23 tetor, një javë pasi kishte ardhur misioni i kuartierit, Maklini e Smajli u nisën për rrugë dhe ndalesën e parë e bënë në Labinot për t'u ndarë me Enver Hoxhën e udhëheqësit e tjerë të LNC, që ishin mbledhur atje. Kjo vizitë nuk i dha ndonjë kënaqësi Smajlit, i cili shënon që kishte një pakënaqësi të madhe për shumicën e atyre njerëzve, një pakënaqësi e cila duket se ishte reciproke; por Maklini duket qartë se kishte interes të gjallë për punët e tyre dhe, siç thotë Smajli. «madje edhe një farë respekti e simpatie për shumicën e tyre». Më pas, gjatë rrugës për në jug, Maklini dhe Smajli kaluan nga zonat e partizanëve në territoret e ballistëve dhe e kundërta, kështu që dëgjuan nga ballistët diçka për vendimet e fundit të LNC që të përforcohej presioni politik e ushtarak kundër BK, vendime që nuk i kishin përmendur vetë udhëheqësit e LNC gjatë takimit të lamtumirës në Labinot.

Maklini dhe Smajli i bënë gjithashtu një vizitë Bill Tilmanit në Sheper dhe është interesante se Smajli e shënon që Tilmani në këtë kohë ishte i zhgënjyer me partizanët, me të cilët nuk gjente bashkëpunim për aksionet kundër gjermanëve. Siç do ta shohim, disa muaj më vonë Tilmani u kthye në një përkrahës të zjarrtë të partizanëve, pasi ata mbijetuan operacionin gjerman të dimrit kundër tyre; ndërsa misioni i Tilmanit, Skulptori, u bë një pikë e rregullt dhe shumë e sigurtë e furnizimeve për partizanët në pranverën e vitit 1944. Megjithatë, në nëntorin 1943 zëri i Tilmanit ishte një

ndër të shumtët që Maklini dhe Smajli mund ta përmendnin, kur ata arritën në Kajro, si dëshmi kundër qëndrimit të hapur pa rezerva në përkrahje të partizanëve.

Kur arritën zonën bregdetare në jug të Vlorës, Maklini dhe Smajli takuan oficerin britanik më të zhgënjyer nga të gjithë, majorin Gerri Fild (Fidani). Ai po jetonte në rrethana tepër të rënda e të dëshpëruara në një shpellë, vuante nga të ftohtët dhe nga uria në një zonë të shkretuar nga sulmet e gjermanëve kundër partizanëve dhe nga luftimet reciproke ndërmjet partizanëve e ballistëve. Fildi ishte bërë aq alergjik kundër partizanëve e ballistëve bashkë, sa nuk lejonte shqiptar pranë vetes dhe jetonte në varfërinë e vet, i rrethuar nga ushtarë italianë që shpresonin të shpëtonin e të iknin në Itali. Arritja e një anijeje motorpediniere për të marrë Maklinin dhe Smajlin nga «Riviera» ishte një lehtësim i madh me gjithë kuptimin e fjalës. Pak kohë pas nisjes së tyre, fildi u lëndua keqas nga shpërthimi para kohe i njëjës nga lloqumet e tij me eksploziv të fuqishëm. Vendin e tij e zuri majori Antoni Kuejl (Anthony Quayle)⁴). Baza detare nuk e stabilizua asnjëherë në mënyrë të kënaqshme; grindjet e shqiptarëve, shkatërruese për të dyja palët, e lehtësonin kontrollin e zonës bregdetare nga gjermanët; partizanët ishin tepër të mbyllur dhe tepër të ngulur në objektivat e tyre politikë dhe nuk u kushtonin kujdes më të madh përpjekjeve për të siguruar furnizime të bollshme nëpërmjet detit. Në cilëndo fazë Shqipëria nuk ia doli mbanë që nga lidhja tepër e hollë nëpërmjet furnizimeve ajrore me Regjimentin 334 të bënte përpara drejt një diçkaje më të mirë e më të madhe.

Shpejt, pasi Maklini dhe Smajli e kishin lënë fushimin e kuartierit në Bizë, gjenerali Dejvis pati takimin e parë me Enver Hoxhën dhe figurat e tjera udhëheqëse të PKSH, të LNC dhe të Shtabit të Përgjithshëm.⁵) Për këtë qëllim, ai nis në Labinot më 31 tetor, i shoqëruar nga Nikolsi. Sipas paraqitjes së bërë nga gjenerali, tipari më i rëndësishëm i kësaj tij takimi ishte se udhëheqësit partizanë filluan të kuptonin për herë të parë, nga fjalët që u tha ai, se nuk duhej të pritej një zbarkim i britanikëve në Ballkan. Atyre do t'u duhej t'i përballonin gjermanët vetëm, nuk duhej t'i rrëmbentë vala e një fitoreje të lehtë nëpërmjet furnizimeve e mbështetjes së gjerë britanike, ata kishin përpara një dimër të ashpër e më vonë mund të shihej perspektiva për mbarim të luftës. Ata nuk ishin të përgatitur për këtë, sepse që nga koha e rënies së Italisë ishin kapur shumë pas mendimit për

rrugët me të cilat do të shtinin në dorë kontrollin e vendit dhe të mposhtnin nacionalistët kur të binte ora e çirimit. Megjithatë diskutimet vazhduan t'i sundonin mënyra mosbesuese e Enver Hoxhës dhe motivet e mëtejshme. Ai e kundërshtoi sugjerimin e gjeneralit që një oficer britanik të atashohej pranë çdo brigade partizane për qëllimet e ndërlydhjes e të furnizimit. Ai nguli këmbë që Balli Kombëtar duhej luftuar e çarmatosur në të gjithë vendin dhe i përfshiu mbretin Zog e zogistët (Abaz Kupin) në mallkimet për «bashkëpunëtorët». Ai nguli këmbë për parësinë e politikës dhe i priti me skepticizëm të shprehur haptas pohimet e Dejvisit se misioni i tij ishte thjesht ushtarak, me të vetmin objektiv për të siguruar rezistencën kundër gjermanëve, duke mbledhur sa më shumë shqiptarë të ishte e mundur. Deklaratat e Enver Hoxhës kundër Ballit Kombëtar e Legalitetit, e bënë Dejvisin të ngulmonte që LNÇ duhej të luftonte vetëm kundër gjermanëve dhe ai mori përsipër të kërkonte nga BK dhe zogistët që të zotoheshin se do të vepronin po ashtu. Më në fund, Enver Hoxha premtoi se do të bashkëpunonte me BK kundër gjermanëve, nëse BK gjithashtu do të luftonte kundër gjermanëve në bashkëpunim me LNÇ. Njëkohësisht ai shpalli bindjen e tij të patundur, se BK kurrë nuk do të pranonte.

I armatosur me këtë premtim, «Trocki» Dejvis u kthye në kampin e tij në Bizë dhe, pak ditë më pas, zbriti poshtë në Shëngjergj për një takim me Abaz Kupin, që u ndoq pak më vonë nga një takim tjetër po në Shëngjergj me Midhat Frashërin, kryetarin e Ballit Kombëtar. Edhe Abaz Kupi mori pjesë në takimin me BK, duke e përcaktuar pozicionin e vet se tani ishte «jo i Ballit, por më tepër një degë e tij». Abaz Kupi ishte i kënaqur me premtimin për tri ngarkesa ajrore me armë. BK ishte më i vështirë për t'u kënaqur. Në fillim, ata u tërbuan kur dëgjuan premtimin e Enver Hoxhës, të cilin nuk e besonin dhe refuzuan që të jepnin zotimin reciprok. Por ata e ndryshuan qëndrimin brenda natës dhe, së fundi, dhanë një zotim të shkruar, të cilin Dejvisi e mori me vete në Bizë. Ai e ftoi Enver Hoxhën në Bizë (Hoxha jep si datë 11 nëntorin) dhe këtë herë ishte radha e Hoxhës për t'u tërbuar. Blofi i tij kishte gjetur përgjigje. Ai e hodhi poshtë zotimin e Ballit Kombëtar si të pavlefshëm dhe u betua se partizanët do të luftonin kundër gjermanëve e do ta shkatërronin BK në të njëjtën kohë. Dejvisi e vuri në dyshim aftësinë e tyre për t'i bërë të dyja këto gjëra se bashku dhe

tha që, nëse vërtet do të bëhej luftë civile, LNÇ nuk do të merrte më furnizime nga britanikët.

Kur rezultatet e diskutimeve të ndryshme iu njoftuan Forcës 133 në Kuartierin e Përgjithshëm të Lindjes së Mesme, u dërgua një përgjigje, që konfirmonte se nuk do të kishte mbështetje për asnjërën palë në një luftë civile, porse misioni duhej të bënte çmos për të përkrahur përpjekjet e secilës palë kundër gjermanëve. Dosjet e Ministrisë së Jashtme përmbajnë tekstin e një telegrami nga Dejvisi, që është marrë në Londër më 19 Nëntor. Ai përmbledh fare qartë qëndrimin e tij në mes të nëntorit. Ai thoshte se në atë fazë nuk mund të rekomandonte përkrahjen vetëm të LNÇ. Kishte marrë një marrëveshje të shkruar nga BK për të luftuar kundër gjermanëve dhe ai propozonte që të vazhdonte të ishte në kontakt me Këshillin e Ballit Kombëtar, deri sa të merrte prova se ky ishte një premtim i rremë. Ai mendonte se LNÇ ishte i vetmi këshill me të cilin mund të bashkëpunonte Britania, por ai kishte dyshime për efektshmërinë e tij. LNÇ ishte pa dyshim komuniste, por më tepër nën ndikimin e Titos se sa të rusëve. Përshtypja e tij për BK ishte se, në kundërshtim me zhurme mosaprovuese që bënin për qeverinë kolaboracioniste në Tiranë, ata ishin të lidhur me të: opinioni i përgjithshëm në Tiranë dhe në vend ishte që këto dy palë ishin të lidhura ngushtë. Ai nuk e rekomandonte përkrahjen për Zogun. Dhe përfundonte:

«Lufta civile tashmë ka nisur ndërmjet LNÇ dhe Ballit Kombëtar e do të shtohet. Unë e quaj se ka të ngjarë të fitojë LNÇ, sepse është e re, është më agresive dhe ka një ngjyrim terrorist. Balli Kombëtar ka ndër mend ta kundërshtojë LNÇ në shkallë të gjerë dhe ka mundësi që të ndihmohet nga zogistët e Abaz Kupit. Vlerësimi im është se lufta do të zërë pjesën më të madhe të dimrit për t'u zgjidhur. Unë personalisht kam bërë çmos me të gjitha palët për ta shmangur luftën civile, por pa sukses».⁶⁾

Një letër e datës 26 nëntor nga SOE për Filip Nikolsin drejtorin e Departamentit të jugut në Ministrinë e Jashtme i përmbledh udhëzimet që Dejvisi po u jepte misionëve varës në Shqipëri në dritën e kësaj situatë. Ata duhej t'i shmangejshin ndërhyrjes në luftën civile, të ndihmonin rezistencën e organizuar kundër gjermanëve, nëse kjo ishte e vërtetë dhe jo e shtirë, të grumbullonin fakte të forta për sulmet e BK kundër gjermanëve ose për bashkëpunimin me gjermanët.

dhe të përqendroheshin në organizimin e sulmeve në shkallë të vogël, duke u dhënë përparësi shkatërrimeve dhe pritave në rrugët kryesore, ndërsa rezervat të mbaheshin nëpër fshatra për të mos lejuar djegien nga armiku.

Gjatë një muaji në Shqipëri gjenerali Dejvis e kishte kapur mirë situatën. Për fat të keq, vështirësitë e dimrit nisën tani të bënin presion mbi të. Kur u kthye në Bizë nga takimi me BK, ra dëbora e parë e trashë. U bë çështje urgjente që të lihej fushimi i hapur në Bizë dhe të gjendej kuartier për dimërim në fshat. Shorti i ra Orenjës në jug të Bizës dhe Kadri Hoxha ndërmori veprime të forta për të zbrazur e për t'i bërë gati tri shtëpi. Përpara se kuartieri të vendosej atje, nisi të shtjellohej fushata gjemane e dimrit për të shkatërruar partizanët dhe gjenerali me personelin e tij u përfshi në një varg lëvizjesh të pështjelluara për në malësinë e Çermenikës e që andej prapa, gjatë një moti që bëhej gjithnjë e më i keq.

Misioni Sconce (Qypi) i Sejmurit kishte mbetur pa lidhje që më 30 tetor. Ata ishin shpërndarë nga një sulm gjerman kundër forcave të Myslim Pezës. Radisti i Sejmurit ishte vrarë dhe radisti i Kempit ishte kapur rob, ishte arratisur, por pastaj kishte vdekur rrugëve. Anëtarët e misionit Sconce çanë rrugën deri në Bizë, duke përfshirë edhe vetë Sejmurin, i cili në atë kohë ishte i sëmurë. Dejvisi vendosi ta nxirrte jashtë vendit Sejmurin nëpërmjet Rivierës, por pllakosën ngjarje të tjera dhe Sejmuri u detyrua të qëndronte.

Kundër Dibrës ishte përgatitur një mësymje e gjermanëve, meqë ajo ishte pushtuar nga partizanët e LNC nën komandën e Haxhi Lleshit (shih më sipër) që me rënien e Italisë. Dibra ishte në territorin që gjermanët dhe italianët ia kishin marrë Maqedonisë jugosllave dhe ia kishin bashkuar Shqipërisë. Togerit i aviacionit Andi Hendz kishte qenë në zonën e Dibrës deri në mes të tetorit, por pastaj kishte kaluar drejt veriut. Vendin e tij e kishte zënë majori Riçard Ridell (Stables), që kishte si ndihmës kapitenin Toni Simkoks. Një oficer polak, togeri Majkëll Lis (Michael Lis), i cili kishte ardhur në Shqipëri me grupin e kuartierit të Dejvisit, u dërgua që të bashkohej me grupin Stables. Majkëll Lisi kishte detyrën e vet si polak për të hetuar mundësinë e organizimit të një rruge shpëtimi për polakët përmes Ballkanit, por ai mund të bënte pak ose aspak për këtë qëllim në ato rrethana që mbizotëronin në Shqipëri, dhe në praktikë ai u bë një anëtar i tepërt në numër i misionit Stables.

Shpejt pasi erdhi në Shqipëri Dejvisi, e thirri Peter Kempin nga Greça, ku ai kishte qenë me Smajlin, dhe i ngarkoi detyrën për të kryer një rikonjicion në Kosovë, që ishte detyra të cilën Kempin e kishte dëshiruar prej fillimit. Ndërsa Kempin po përgatitej për këtë, erdhi lajmi se Xhem Gostivari, një bashkëpunëtor shqiptar i mirënjohur i gjermanëve (dhe më i parë i italianëve) në Maqedoni, po përparonte mbi Dibër me mbështetjen e gjermanëve për të sulmuar partizanët. Hendzi dhe pas tij Ridelli ia kishin dalë mbanë të ruanin një ekuilibër të vështirë ndërmjet partizanëve të LNÇ në qytetin e Dibrës dhe krerëve nacionalistë në fshatrat përreth. Ky ekuilibër tani kërcënohej, meqë krerët tani prireshin të përkrahnin Xhem Gostivarin kundër partizanëve. Dejvisi e nisi Kempin në Dibër që të bisedonte me Ridellin dhe ta ndihmonte. Kempin e la Bizën më 1 nëntor, duke marrë kapitenin Alan Hejr me vete (Hejri kishte ardhur si kapiteni i shtabit në kuartier, por ishte zënë kryesisht me detyrat A dhe Q, që duhej t'i mbante nënkoloneli Uiler). Ata e panë se luftimet në Dibër tashmë kishin nisur, por partizanët ende po e mbanin qytetin. Ridelli dhe Kempin bënë bisedime me Haxhi Lleshin nga njëra anë, duke u përpjekur që ta bindnin t'i shite krerët si aleatë të mundshëm e jo si armiq, dhe nga ana tjetër me Fiqri Dinon, udhëheqësin e krerëve të Dibrës, duke u përpjekur ta bindin atë që ta hidhte peshën e tij kundër Xhem Gostivarit dhe ta detyronte atë të tërhiqej. Që të dyja palët dhanë përgjigje të lëkundshme e jobindëse dhe me këtë Kempin e Hejri u kthyen në Bizë, duke mbërritur më 6 nëntor për t'i raportuar gjeneralit. Moti vazhdonte të keqësohej dhe u vendos që Kempin duhej të nisej menjëherë për në Kosovë ndonëse radioja e tij Stepmother kishte mbetur te Sejmurit në Greçë. Më 13 nëntor, kur ai po bëhej gati të nisej, erdhi në Bizë të ikurit e parë nga misioni i Sejmurit në kushte dëshpëruara dhe sollën lajmin se gjermanët kishin fituar zonën e Pezës.

Kempin marshoi nëpër Dibër dhe arriti pikërisht përpar sulmit kryesor të gjermanëve mbi qytet, që nisi më 16 nëntor. Pasi e lanë Lisin në Dibër me Haxhi Lleshin, Ridelli dhe Kempin u nisën të mblidhnin krerët e t'i bindnin të bashkoheshin për të mbështetur krahët në lëvizjet kundër gjermanëve pasi më parë e kishin bindur Haxhi Lleshin që nuk kishte dëshirë të pajtohej, që të pranonte ndihmë nga kjo palë, nëse mund të sigurohej. Fiqiri Dineja, figura kryesore ndërmjet krerëve, kishte zënë bazë në Peshkopi, një qytet në veri

Dibrës, brenda kufirit të Shqipërisë para lufte. Atje ishte me të Toni Simkoksi. Ndërsa Ridelli dhe Kempit po bënë rrugën për atje, u dëgjuan zëra se gjermanët tashmë e kishin kapur Peshkopinë, por përpara se kjo të konfirmohej, ata i zuri rrugës një trupë e madhe burrash të udhëhequr nga Halil Alia, një bashkëpunëtor i njohur i italianëve dhe tani i gjermanëve. Ai nguli këmbë që t'i dërgonte për t'i ruajtur në një fshat të familjes Kaloshi, duke ia dorëzuar për t'i mbrojtur shokut të tij bashkëpunëtor, Selim Kaloshit. Kushëriri i Selimit, Ramadan Kaloshi që banonte aty pranë, por që ishte në gjak me Selimin (kjo ishte Shqipëria e veriut, vendi i gëqeve dhe i gjakmarrjes), ishte një udhëheqës i mundshëm i rezistencës dhe Ridelli e njihte mirë, kështu që Selimi e lejoj grupin e britanikëve të merrte rrugën për në shtëpinë e Ramadanit të nesërmen. Ai e siguroi, me një mirëbesim të sjellshëm, se ishte në gjendje të luante me të dyja palët, ashtu siç e tregonin veten shumë kolaboracionistë, që ata mund të gjenin kurdoherë strehim të shtëpia e tij, e Selimit, kur të kishin nevojë. Ata mësuan nga Ramadani se vërtet Peshkopia ishte në duart e gjermanëve dhe se Toni Simkoksi, pasi kishte shpëtuar për fill në Peshkopi, ishte tërhequr në male drejt veriut, duke gjetur strehë në familjen Ndreu në Sllovë. Atje ai kishte shkuar me Faik Shehun, një nga krerët e Peshkopisë, që ishte i lidhur me FNÇ. Familja Ndreu kishte pak a shumë anëtarë në të gjitha kampet. Cen Elezi, kryetari i familjes, kishte ambicje për t'u bërë udhëheqës i gjithë krahinës, siç ndodhte shpesh me krerët nacionalistë në veri. Vëllai i tij, Esat Ndreu, ishte komisar politik me forcat e Haxhi Lleshit në Dibër. Një nga nipërit e tij, Dali Ndreu, ishte koleg i afërt i Enver Hoxhës, kur erdhi koha u bë komandant i Divizionit I partizan dhe pastaj i Korpusit I partizan, dhe ishte në ekipin më të lartë të PKSH pas luftës, deri sa u likuidua si njeri shumë i afërt me jugosllavët. Djemtë e tjerë prireshin t'i ngjanin më shumë vetë Cen Elezit, duke qëndruar në mes të rrugës, nacionalistë, duke ruajtur një rrjetë të ndërlikuar marrëdhëniesh dhe duke u përpjekur fort që të gjykonin nga po frynte era dhe të shqetësuar para së gjithash për të qëndruar në majë të krahinës e të zonës së tyre.

Ramadan Kaloshi i shoqëroi Ridellin dhe Kempin për Sllovë, ku u bashkuan me Simkoksën, por nuk merrnin dot frymë nga gjermanët. Nënoficeri i Kempit, rreshter Gregson Ollkot (Allcott) erdhi me lajmin se të gjitha pajisjet dhe plaçkat e misionit Stepmother, të përtërirë, kishin humbur (gjithçka që ki-

ishte pasur në Greçë kishte humbur, kur misioni i Sejmurit (Sconce ishte prishur). Vetë gjermanët erdhën në Sllave pas pak kohe dhe sulmuan shtëpitë e familjes Ndreu, duke i zënë në befasi familjen dhe miqtë. Kempin, Simkoksi e gjithë të tjerët shpëtuan për fije, kurse shtëpitë u grabitën e u dogjën. Disa nga banorët e fshatit, burra, gra e fëmijë i lidhën e i masakruan gjermanët. Kempin gjeti strehim në familjen Lita, jo larg në veri dhe ata e udhëhoqën që të shkonte drejt veriut në Ujmisht, ku ai u takua me Muharrem Bajraktarin, më 26 nëntor. Në ditët e para të dhjetorit, duke ecur përsëri drejt veriut, ai takoi Hasan Kryeziun dhe, më në fund, hyri në kontakt me Kosovën. U bashkua me Andi Hendzin në Degë, në veri të Drinit, duke rifituar ndërlidhjen me radio me Kajron dhe një burim furnizimi.

Ridellin dhe Simkoxin i ndihmoi Ramadan Kaloshi dhe nisën një punë të mërzitshme, duke u zhvendosur e duke lëvizur nëpër kodrat e malet në veri të Dibrës e të Peshkopisë, gjë që do të vazhdonte edhe gjatë dimrit. Radioja e tij u dëmtua aq sa nuk mund të rregullohej dhe dërguan rreshterin e Kempin, Gregson Ollkotin dhe radistin e tij, tetarin Dejvis, që të përpiqeshin të gjenin një zëvendësim nga misioni i kuartierit në Bizë, por ata ishin në një gjendje diçka më të mirë se Skulptori, i cili ishte nxjerrë jashtë loje për atë kohë, dhe Njerka, që tani përbëhej vetëm nga Kempin dhe nga çfarë kishte veshur e çfarë mbante me vete ai në çantën e shpinës. Partizanët u dëbuan nga Dibra dhe shpejt përfunduan në një çetë endacake që, nën komandën e Esat Ndreut, bëri një jetesë të rëndë në kodrat veriore për gjithë pjesën tjetër të dimrit. Asnjë nga nacionalistët nuk do të ngrinte as gishtin kundër gjermanëve, ndërsa popullsia e zakonshme ishte e kënaqur që shpëtoi nga vështirësitë dhe rreziqet e jetës me partizanët. Në Dibër ata ishin të kënaqur që të binin përsëri në Shqipërinë e Madhe nën sundimin e shqiptarëve nacionalistë dhe jo nën sundimin sllavo-komunist.

Lajmi për rënien e Dibrës i erdhi gjeneralit Dejvis në formën e thashethemeve, që u përforcuan nga rrëfimet e dëshmitarëve dhe madje nga fotografitë e kufomave, se Kempin dhe Simkoksi ishin vrarë. Kjo shpejt u ndreq dhe në kohën e duhur erdhën Majkëll Lisi e më pas tre nënoficerë britanikë si refugjatë nga beteja e Dibrës dhe treguan në mënyrë të përpiktë se çfarë kishte ndodhur. Gjenerali, nuk kishte fare se çfarë të bënte për misionet e shpërndara. Tani gjermanët e kaluan vëmendjen te malësia e Çermenikës dhe ishte radha

e misionit të kuartierit që të niste kalimin e dhimbshëm në statusin e të arratisurve.

Shenja e parë kërcënuese e vëmendjes së alert gjermane që një aeroplan, i cili e vizitonte Bizën në mëngjes e pasdite, duke u përputhur me kohën e komunikimit me radio me Kajron. Komunikimi me radio u bë gjithnjë e më i vështirë me afrimin e furtunave të dimrit dhe telashet e radistëve tani u shtuan për shkak të punës natën, me qëllim që të shmangej zbulimi i pozicioneve të stacioneve. Linja e furnizimit të misionit nga Elbasani u ndërpre për shkak të veprimtarisë kërcënuese dhe represive të gjermanëve në qytet. Kjo u bë edhe më serioze, pasi misioni nuk kishte qenë në gjendje të merrte furnizime nga ajri në nëntor. Këshilli LNÇ njoftoi një informatë që kishin marrë për një sulm gjerman të përgatitur nga tre drejtime. Shpejt pas kësaj erdhi lajmi për një kolonë që po afrohej nga një drejtim i katërt. Kuartieri lëvizi për në Martanesh, duke bërë një marshim natën në një mot gjithë shi. Duhet të ketë qenë një kolonë e gjatë, e baltosur dhe e raskapitur që zbriti te Baba Faja. Oficerët britanikë dhe burrat u rrasën në një shtëpi të vetme, disa prej tyre ishin sëmurë dhe nja dy shumë rëndë. Nikolsi ishte një nga ata që vuanin nga dizenteria. Si ngjarje, kërcënimi gjerman nuk u realizua këtë herë. Gjenerali vendosi t'i rekomandonte Enver Hoxhës që të çanin drejt jugut për t'i shpëtuar rrethimit nga gjermanët, të kalonin dimrin në një zonë partizane më të sigurtë në mes të toskëve dhe të konsolidoheshin forcat partizane duke u përgatitur për pranverën. Ai u kthye në Bizë, ku e gjeti kampin e kuartierit të bastisur, kryesisht nga italianët, sapo britanikët ishin larguar për Martanesh, pastaj italianët ishin rrethuar dhe ishin ekzekutuar nga partizanët.

Dejvisi e gjeti Enver Hoxhën në Shëngjergj duke ndjekur paradën e Brigadës II. Në fakt kjo ishte ceremonia e përrimit të Brigadës II, ndonëse nga rrëfimi i tij duket se «Irockit» nuk iu tha se kjo ishte ngjarja në të cilën po vinte dëshmitar. Enver Hoxha jep si datë 28 nëntorin. Partizanët ishin të veshur keq, të mbathur keq dhe të ushqyer keq, por armët e tyre, ndonëse të markave të ndryshme, ishin të mbajtura mirë dhe ata kishin me vete një njësi italiane me katër topa malorë. Enver Hoxha deshi të zgjatej për nevojat urgjente të furnizimeve, por ra në heshtje kur gjenerali i shtroi çështjen për të ikur drejt jugut e për t'u përqendruar me furnizimet e me konsolidimin atje, duke e braktisur Shqipërinë e Mesme (dhe Tiranën) hë për hë dhe duke i lënë grupet

partizane lokale që të vepronin si të mundeshin më mirë. Hoxha tha se ai dhe kolegët e tij do të mendoheshin për këtë propozim. Gjenerali u kthye në Martanesh, ku shtabi i tij dhe të tjerët që i ishin ngjitur nga misionet e shpërndara, po jetonin në rrethana të vështira me racione të shkurtuara, pa dru zjarri, pa llampa, vetëm me disa qirinj, ndërsa shiu si lumë dhe i zgjatur rridhte teposhtë maleve përreth. Ardhja e Majkëll Lisit në këtë çast me lajmin se ishin shpërndarë partizanët e Haxhi Lleshit nga Dibra, sillte një dëshmi të qartë se edhe ky krah ishte gjithashtu i hapur gjerësisht për përparimin e një kolone gjermane.

Enver Hoxha dhe anëtarët e tjerë të Këshillit të LNÇ tani i bënë thirrje misionit britanik dhe e paraqitën si idenë e vet sugjerimin e gjeneralit për të çarë drejt jugut. Ata e ftuan atë që të zhvendosej në Orenjë (domethënë në jug të Bizës, ndërsa Martaneshi ishte në anën veriore) dhe thanë se ata do të kryenin kalimin e lumit Shkumbin dhe të rrugës kryesore Elbasan-Tiranë si një operacion të Brigadës III, ndërsa Kadri Hoxha do të bënte një operacion diversioni kundër fshatrave balliste për t'i tërhequr tutje gjermanët. Pastaj Brigada III do t'i shoqëronte ata drejt jugut në zonën e Korçes, ku LNÇ ishte relativisht e fortë, me qëllim që ta kalonin dimrin atje. U hodh mënjanë këshilla e Dejvisit, se do të ishte më e mençur dhe më e sigurtë që udhëtimi të bëhej i lehtë, me një grup të vogël.

Është e pamundur të përcaktohet data e përpiktë e largimit nga Orenja, por duhet të ketë qenë pas 7 dhjetorit, sepse në atë ditë Enver Hoxha pati takimin e fundit me karta të hapura me Abaz Kupin në Shëngjergj; pas të cilit Këshilli i LNÇ mbajti një mbledhje për ta përjashtuar Kupin. Ende politika ishte përparësia kryesore, me gjithë situatën ushtarake që po bëhej sa vinte e më e rëndë. Kur i gjithë grumbulli. Këshilli i LNÇ, Shtabi i Përgjithshëm dhe misioni britanik më në fund u nisën për të zbritur në Labinot dhe përmes Labinotit në lumë, ata e panë se i kishin hyrë një pune të dështuar. Nuk ishte bërë rikonjicion për lumin, që kishte ardhur i plotë, dhe nuk mund të gjendej një vah kalimi. Në kujtimet e veta Enver Hoxha për këtë bën fajtor Hulusi Spahiun, komandantin e Brigadës III, forcat e së cilës u nisën me vonesë, i alarmuan gjermanët me pakujdesinë e tyre dhe arritën te rruga e te lumi të çrregulluar; bën fajtor Kadri Hoxhën që humbi kohë në Orenjë dhe nuk ia doli që t'i zinte në befasi ballistët e gjermanët me një operacion diversioni;

bën fajtor edhe David Smajlin i cili e kishte hedhur në erë urën kryesore mbi lumë. Enver Hoxha u rikujton lexuesve, si për të provuar fajësinë e tyre, që Hulusi Spahiu dhe Kadri Hoxha u shkarkuan nga detyra dhe u burgosën në vitet e pas luftës: me siguri i ka ardhur inat që nuk i arrinte dora dot deri te Smajli. Dejvisi në kujtimet e tij, në mënyrë më bindëse, bën fajtores udhëheqjen e LNC dhe e kritikon veten se nuk nguli këmbë që Nikolsi t'i kontrollonte planet e LNC dhe punën e personelit. Forcat lokale të Kadri Hoxhës u gjymtuan keq.

I gjithë grupi u kthye mbrapsht në Labinot dhe gjenerali me shtabin e tij u futën në një nga dhomat e shtëpisë ku u vendos Këshilli LNC. Dejvisi e komenton që kjo afëri e detyruar me anëtarët e Këshillit u dha që të dyja palëve rastin të njiheshin nga pikëpamja njerëzore: deri atëhere oficerët britanikë kishin pasur njohje të afërt vetëm me Frederik Nossin. Ky avantazh që po aq jetëshkurtër, sa edhe i vonuar. Ngushtica nga numri i madh i njerëzve u bë edhe më e rëndë, kur skalioni i parë (kështu e quan Dejvisi) i misionit të kuartierit erdhi në skenë me karvanin e mushkave. Sipas planit, karvani me plaçkat e misionit do të ndiqte grupin e Komandës gjatë rrugës e përtej lumit pas një intervali të shkurtër, dhe ata tani kishin ardhur drejt lumit pa e ditur se kalimi kishte dështuar. Dejvisi ishte gjithnjë e më tepër i shqetësuar për t'u nisur drejt jugut, jo vetëm për të shmangur rrethimin, por edhe për të gjetur një rrugë që të dilte nga Shqipëria dhe të kthehej në Kajro që të raportonte. Për të ishte tërheqës plani që të lëvizte drejt Korçës përmes zonës së Ohrit, sepse ai po mendonte që të përpiqej të gjente një hidroplan, i cili të vinte e ta merrte nga liqeni i Ohrit. Megjithatë, për atë moment ai u detyrua të pranonte që të ecnin përsëri prapa në Orenjë, sepse Labinoti ishte si shumë afër me gjermanët, ashtu edhe shumë i mbushur me njerëz.

Kur arritën në Orenjë, ata panë se ishte bërë një hedhje ajrore natën e kaluar aty. Kjo ishte Spillway 1 natën e 25-26 dhjetorit. Spillway (Kapërderdhësi) ishte emri i koduar që iu dha një serie avionësh, të cilët më kot u munduan të hidhnin nënkolonelin Uiler, anëtarët e tjerë që mungonin në shtabin e kuartierit dhe ngarkesat e ndryshme e pajisjet për misionin e kuartierit në nëntor e në dhjetor. Spillway 1 ishte i vetmi fluturim që u bë me sukses. Ai përmbante postën personale për anëtarët e misionit, disa rroba dimri shumë të nevojshme, sasi të konsiderueshme eksplozivash e granatash, por nuk

kishte as ushqime, as armë, me përjashtim të disa armëve të tipit Sten, dhe as municione. Nuk ishte ky lloji i ngarkesës që pritej në atë gjendje krize. Kadri Hoxha u tërbua, sepse nuk kishte asgjë për të plotësuar nevojat urgjente të partizanëve të tij të lekosur e të raskapitur dhe i refuzoi ato pak gjëra që erdhën.

Më 17 dhjetor gjenerali Dejvis i dërgoi një telegram Kajros, i cili tregon se në të menduarit e tij gjatë tri ose katër javëve të mëparshme, kishte ndodhur një evoluim i shpejtë dhe radikal. Telegrami thotë:

1. Tani rekomandoj një ndryshim. Situata ka evoluar kaq shumë kohët e fundit, është imperative tani të denoncohet Këshilli i Regjencës kolektivisht dhe emër për emër. Po ashtu BALKOM dhe ZOGISTËT.
2. Të gjithë po bashkëpunojnë me gjermanët, të cilët po i shfrytëzojnë ata duke u dhënë armë në sasi të mëdha, duke i vënë të ruajnë rrugët kryesore, të bëjnë punën e policëve në qytete e të drejtojnë patrolat, duke i çliruar kështu trupat gjermane nga këto barrë.
3. Në të gjitha aksionet e kryera, kohët e fundit, nga LNC janë ndeshur me trupa të përziera gjermane e balliste, të armatosura mirë, të stërvitura nga gjermanët. Betejat në zonat e PEZËS e DIBRËS, veçanërisht në këtë të fundit, kanë dhënë prova të shumta për bashkëpunimin e ngushtë.
4. BALKOM dhe ABAZ KUPI si njëri dhe tjetri më kanë premtuar se do t'i luftonin aktivisht gjermanët, por nuk kanë bërë asnjë aksion këtë muaj të fundit, ndonëse kanë pasur shumë raste për t'u bërë rezistencë gjermanëve. ABAZ KUPI ka hequr dorë nga vendi i tij në Këshillin LNC dhe i ka prerë marrëdhëniet me ta.
5. Si BALKOM dhe ZOGISTËT tani botojnë gazeta të kushtueshme dhe ambicioze, që duket hapur se janë ndihmuar nga gjermanët. Në të të numra nuk ka pasur asnjë referim antigjerman. Të dyja palët lëvdohen se ALEATËT do të bashkëpunojnë me ta pasi të kenë ikur gjermanët, duke cituar si dëshmi që Britania nuk ka përmendur me emër as Këshillin e Regjencës dhe asnjë parti politike. Shëmbull: Fjala e drejtorit të BBC drejtuar SHQIPËRISË më 28 nëntor.
6. Do të parapëlqejja që të jepja shpjegime personalisht kur të largohesha prej këtej, por edhe mund të vonohem; e nuk ka të ngjarë që të vij te ju para mesit të janarit në rastin më të mirë.
7. Mendoj se qëndrimi i ALEATËVE duhet të bëhet publik menjëherë, duke e treguar se kuislingët, tradhtarët dhe ata që nuk luftojnë kundër gjermanëve do të marrin ndëshkimin që u takon dhe në

kohën e duhur nga aleatët. Shqiptarët e kanë luajtur këtë lojë kuislingësh në vazhdimësi me TURQIT, ITALIANËT dhe tani me GJERMANËT. Ata besojnë se do të bëjnë të njëjtën gjë me ALEATËT. Prandaj rekomandoj të bëhet një deklaratë e hapur në favor të LNÇ.»⁸⁾

Në këtë telegram Dejvisi kishte vënë gishtin mbi thelbin e situatës: lufta civile tashmë kishte nisur seriozisht dhe nga pikëpamja e «nacionalistëve» shqiptarë, gjermanët po vepronin në të si vegël e nacionalistëve për shkatërrimin e LNÇ. Për fatin e keq të LNÇ, të marrëdhënieve të Britanisë me Shqipërinë dhe ndoshta për vetë Shqipërinë gjithashtu, misioni i gjeneralit në Shqipëri faktikisht përfundoi me këtë telegram. Brenda dy ditëve nga dërgimi i tij, ai ishte në lëvizje dhe pa komunikim me radio. Mbi bazën e një telegrami të vetëm përgjithësues, ndoshta nuk mund të pranohej në Kajro e, aq më pak, në Londër, një ndryshim i rekomanduar në politikë me ndërlikime që shkonin larg; ndërsa Dejvisi dhe zëvendësi i tij Nikols do të zhdukeshin nga skena pa qenë asnjëherë në gjendje që ta shpjegonin atë ose ta ndiqnin më larg. Do të vijonte një periudhë e zbrazët prej disa javësh dhe më 1944 do të rishfaqej në skenë Billi Maklini, si i vetmi oficer epror me përvojë nga Shqipëria, i aftë për të diskutuar politikën në Londër e në Kajro, e më pas në Bari. Misioni i tij i dytë në Shqipëri do të hidhej me premisën, ndoshta me vlerë të mjaftë në nëntor 1943 por të kapërcyer nga ngjarjet e dhjetorit, se lufta civile nuk kishte nisur ende në mënyrë të pakthyeshme, se LNÇ ishte pala që ishte në rrezik për ta nisur atë dhe se ajo duhej parandaluar. Në fakt, pjesa e parë e luftës civile u zhvillua në ofensivën gjermane të dimrit dhe, pasi kjo u bë dhe partizanët e LNÇ e përballuan atë, nuk kishte më mënyrë me të cilën të parandalohej më 1944. Zhdukja në kohë të papërshtatshme e «Trocki» Dejvisit dhe misionit të tij, e pengoi që kjo pikë e qenësishme të shpjegohej ose të kuptohej nga SOE dhe nga FO.

Ndërsa Dejvisi po dërgonte këtë mesazh thelbësor por, siç doli, të kotë, Këshilli i LNÇ në Labinot po përgatiste një përpjekje të dytë për të kaluar Shkumbinin dhe grupi britanik po priste që të thirrej për këtë. Në vend të kësaj, më 19 dhjetor, nisi ofensiva gjermane në malësinë e Çermenikës dhe Enver Hoxha e Këshilli i LNÇ arritën në Orenjë nga Labinoti. Ndërsa ata po diskutonin në një mënyrë të pacaktuar me gjeneralin dhe shtabin e tij, erdhi lajmi se pararoja gjer-

mane ishte vetëm një orë larg. I gjithë grupi menjëherë u nis për në male e pyje, duke e lënë karvanin e mushkave që t'i ndiqte pas. Gjatë nates, ndërsa po ngjiteshin përpjetë, ata dëgjuan katër Halifax të veçuar që po vinin për të bërë hedhje në Orenjë dhe ranë nën zjarrin e gjermanëve. Kërkesat e tyre ngulmuese për furnizime nga ajri, më në fund, kishin marrë përgjigje, por me disa orë vonesë të madhe. Gjatë natës dhe ditës së nesërme, ata u ngrohën me aq sa mundën rreth zjarreve në një lugajë pylli, duke u përpjekur të merrnin lajme për ngjarjet jashtë dhe për karvanet me plaçkat e britanikëve. U bë e qartë se ky i fundit kishte humbur rrugen. Edhe pa të madhësia e grupit në pyll arrinte rreth 160 veta me shumë kafshë. Ushqimi ishte i pakët, vetëm pak miell misri dhe fasule, ndërsa ushqim për kafshët pothuaj nuk kishte fare. Dejvisi i bëri presion Enver Hoxhës që ta zvogëlonte në mënyrë drastike madhësinë e grupit që do të përpiquej të çante, duke e kufizuar në rreth 12 veta pa asnjë kafshë dhe të drejtohej nga lindja për të arritur zonën e liqenit të Ohrit, pastaj të kthehej nga jugu drejt zonave të sigurta partizane në drejtim të Korçës. Gjithë të tjerët duhej të mbeteshin prapa me Kadri Hoxhën dhe forcat e tij lokale, të mbijetonin si të mundnin deri sa ofensiva gjermane të binte vetë dhe pastaj të çanin rrugën drejt jugut. Enver Hoxha ra dakord, po nisja u vonua deri më 22 dhjetor dhe në këtë ndërkohë punët u bënë edhe më keq nga shiu i rëndë. Grupi doli prej 35 vetash, sepse Enver Hoxha këmbënguli që të shoqërohej nga një togë mbrojtëse. Kundërshtimet e Dejvisit nuk patën dobi. Grupi i tij i britanikëve u zvogëlua në pesë veta, duke përfshirë atë vetë dhe Nikolsin. Në këtë kohë, nuk bëhej fjalë për mbrojtje nga ana e Brigadës II dhe III. Ato po pësonin humbje të rënda nga ofensiva gjermane dhe për një kohë pushuan së qeni formacione efektive.

Grupi marshoi mes pyjeve e maleve të larta nën shiun e rëndë dhe e kaloi natën e 22-23 dhjetorit jashtë, duke u ngrohur si mundeshin rreth zjarreve dhe pa ushqim. Më 23 dhjetor u gjetën një dele dhe pak bukë misri, që u hëngrën para se të rifillonte marshimi pasdite, këtë radhë përmes dëborës mjaft të thellë në shpatet shkëmbore e të rrëpirta. Përsëri natën e kaluan jashtë rreth zjarreve, të cilët shqiptarët ishin të zotët t'i ndiznin me shkathtësi të veçantë edhe në erë, në shi e në dëborë. Ditën tjetër, grupi gjeti rrugën për në Okshatun, u ngjeshën në disa shtëpi të fshatit dhe e kaluan natën e krishtilindjeve atje, duke ngrënë e duke fjetur sipas mënyrës

shqiptare (me të cilën anëtarët e misionit të kuartierit nuk ishin mësuar). Herët, më datën 25, ata e vijuan marshimin drejt rrugës që të çon në jug nga Dibra, kapercimi i se cilës do të ishte pika e shkëputjes përpara se të ktheheshin nga jugu drejt Korçës. Kur e arritën atë, Dejvisi dhe Nikolsi u tmerruan nga shkujdesi me të cilin partizanët nisën të kapërcenin truallin e zbuluar, ku mund të shiheshin plotësisht nga një grup i vogël gjermanësh që po punonin. Ndërsa po kalonin rrafshin, gjenerali pësoi një fatkeqësi serioze duke humbur shollën e njërës nga çizmet e tij: mikpritësi i tij në Okshatun, duke menduar t'i bënte një mirësi, i kishte vënë çizmet e tij pranë zjarrit dhe i kishte djegur. Sapo ata e kapërcyen rrugën, grupi i gjermanëve që po punonin, hapi zjarr. Enver Hoxha dhe partizanët e hodhën poshtë këshillën e britanikëve që ta shkatërronin grupin e punës përpara se të ngrinin alarmin dhe iu qepën lart faqes së malit. Edhe një herë tjetër natën e kaluan jashtë rreth zjarreve. Një grup rikonzhicioni solli lajmin se gjermanët dhe shqiptarët që i ndihmonin, ishin ngritur në alarm në të gjithë zonën dhe rruga drejt jugut ishte zënë keq.

Në këtë pikë Dejvisi sugjeroi që ai dhe Frederik Nosi të rreshqisnin vetëm në drejtim të jugut, kështu që ai mund të gjente rrugën për të shkuar në Kajro dhe të raportonte. Enver Hoxha e kundërshtoi vendosmërisht këtë dhe refuzoi që t'i jepte në dispozicion Nosit. Ai madje u përpoq që ta akuzonte gjeneralin për disfatizëm dhe dezertim, këtë akuzë të pavlefshme ai e stërhollon në kujtimet e tij.⁹⁾ Në një situatë plot me ironi, është veçanërisht ironike që Enver Hoxha do ta ndalonte prerazi dhe të ishte krenar që e kishte ndaluar këtë iniciativë të kreut të misionit britanik, që mund të kishte çuar në vendime politike të favorshme për partizanët në Kajro e në Londër. Ndodhi si ndodhi, i gjithë grupi mori kthesën dhe nisi rrugën e kthimit përmes rrugës së Dibrës drejt Okshatunit e Çermenikës. Kushtet ishin të këqija sa s'bëhet, me një shi të acartë, që e kthente çdo sipërfaqe në një cipë akulli. Natën e 26-27 dhjetorit e kaluan përsëri pa ngrënë dhe jashtë, ndërsa disa shqiptarë ia arritën të ndiznin një zjarr edhe në ato kushte. Pasditën e 27 dhjetorit, ata më në fund e gjetën rrugën për t'u kthyer në Okshatun. Ashtu siç ndodhte zakonisht në Shqipëri kur bëhej një mësymje e gjermanëve kundër partizanëve, kudo u mbylleshin dyert oficerëve britanikë e veçanërisht oficerëve britanikë me partizanët. Kështu ndodhi tani në shumicën e rasteve në Okshatun, por partizanët ki-

shin lidhjet e tyre atje dhe u gjendën ushqim dhe vend fjetjeje për të gjithë. Në kujtimet e Hoxhës qëndrimi në Okshtun paraqitet i rehatshëm dhe i zgjatur, por rrëfimi i Dejvisit thotë se partizanët u detyruan të ngjiteshin lart në Kostenjë, ndërsa grupi i britanikëve mbeti i fshehur në Okshtun, duke e marrë veten nga mundimet e marshimit. Gjendja e Nikolsit ngjallte shqetësime. Ai kishte plagë të qelbëzuara në duar e në këmbë dhe kishte nevojë për pushim, për trajtim mjekësor e për përkujdesje.

Pas një jave (ndoshta më 3 janar), britanikët u zunë në befasi në vendin e fshehur nga katër shqiptarë të panjohur, për të cilët duhej menduar se punonin për gjermanët dhe për bashkëpunëtorët e tyre nacionalistë. Ishte e domosdoshme që të niseshin menjëherë. Dejvisi dhe grupi i tij u bashkuan përsëri me Enver Hoxhën dhe Këshillin e LNÇ në Kostenjë dhe gjetën atje gjithashtu kapitenin Hejr dhe majorin Çeshajr (Cheshire, oficer xhenjoje i kuartierit). Gjenerali pati mundësinë t'i zëvendësonte çizmet e prishura, duke blerë një palë çizme ushtarake angleze nga një mushkar, por për anët e tjera jeta ishte me privacione. Britanikët u mblodhën së bashku, një grup prej 15 vetash gjithsej, në një kasolle delesh, që i mbronte fare pak nga era e fortë dhe nga stuhitë e dëborës. Në fillim nuk pati ndonjë vështirësi për ushqimin, por «Trocki» vetë dhe të tjerët e grupit të tij nuk ishin të veshur në mënyrë të përshtatshme për një jetë duke qëndruar në vend dhe në kushte të zbuluara, për shembull, rrobat e tij vetë ishin gjithsej një uniformë luftarake dhe një mushama. Vështirësia në malet shqiptare ishte se kërkohesh të ishe i veshur mjaft lehtë për të rrugëtuar dhe i veshur mjaft trashë për të ndenjur në vend. Kostenja ishte në zonën e Baba Fajës dhe Gjenerali Dejvis ia arriti ta bindte për t'u bërë vend anglezëve në shtëpinë që kishte zënë ai, por ushqimi u pakësua shumë.

Ditën që, me sa duket, ka qenë 6 janar, u shfaq Enver Hoxha me kolegët e tij të Këshillit dhe i njoftoi se ata do të niseshin nga ana jugore e malësisë së Çermenikës, në drejtim të Labinotit, duke synuar që të përsërisnin përpjekjen për të çarë drejt jugut përmes Shkumbinit dhe rrugës së Elbasanit. Në kujtimet e tij Enver Hoxha pretendon se në atë kohë i kishte dërguar urdhër Mehmet Shehut në Shqipërinë e Jugut për ta sjellë Brigadën I drejt veriut nga zona e Korçës për të çarë në zonën e Çermenikës nga lindja, pak a shumë në atë rrugë ku kishte dështuar përpjekja për të çarë para pak kohe. Ndonëse Hoxha përpiqet ta bëjë këtë që të duket sikur ai po

planifikonte një operacion mjeshëtoror spastrimi nga armiku, e vërteta është se ai dhe kolegët e tij ishin në një ngushticë tepër të vështirë, pa forca efektive, të izoluar në malësinë e Çermenikës dhe të detyruar madje atje të bënin një jetë endacake. Komanda e lartë e LNÇ ishte fare afër rrezikut të shuhej.

Sipas Ramadan Marmullakut, një autor jugosllav që shfrytëzon si burimet jugosllave, edhe ato shqiptare, Enver Hoxha dhe Shtabi i Përgjithshëm në atë kohë ishin në rrezik të binin në duart e gjermanëve dhe u shpëtuan nga Mehmet Shehu dhe Brigada I e tij, të cilët bënë një lloj «marshimi të gjatë» nga jugu¹⁰). Nga ana e tij, Enver Hoxha e pranon se Brigada I bëri një inkursion në drejtim të veriut, por ai e akuzon Mehmet Shehun se e ka ngritur në legjendë këtë inkursion të dy batalioneve të Brigadës I, dhe pretendon se nuk ishte kjo që e shpëtoi Shtabin e Përgjithshëm nga rrethimi gjerman-balist, por ishin përpjekjet e forcave të vetë Shtabit të Përgjithshëm që çanë rrethimin vetë. Hoxha shkon madje aq larg, sa të ankohet që Mehmet Shehu humbi dy javë për ta kryer operacionin e tij, duke i futur forcat e Brigadës në një varg shtigjesh të rrezikshme, e duke shkaktuar kështu që shumë luftëtarë trima të Brigadës të jepnin jetën heroikisht. Nga ana tjetër, Vladimir Dedijeri, duke u mbështetur në raportet e bëra nga Miladin Popoviçi dhe Dushan Mugosha, deklaroi prerazi se¹¹), pasi u shpartalluan Brigada II dhe III, Enver Hoxha dhe Shtabi i Përgjithshëm mbetën të pambrojtur, se Brigada I u thirr që t'i shpëtonte, se 3 batalione të Brigadës I ia dolën të arrinin në zonën e Labinotit dhe ta kryenin shpëtimin, se Shtabi i Përgjithshëm për një farë kohe humbi lidhjet me pjesën tjetër të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, se në mungesë të tyre, Miladin Popoviçi ngriti një kurs pranë Korçës për të stërvitur kuadrot drejtues për oficerë të brigadave të reja dhe ku personelin e instruktimit e përbënin Dushan Mugosha, Ramadan Çitaku, Koçi Xoxe e Liri Gega; dhe se Enver Hoxha e Shtabi i Përgjithshëm arritën në jug dhe e rimorën detyrën vetëm pas një intervali kohe. Na duket e drejtë që nga e gjithë kjo të nxjerrim përfundimin se Enver Hoxha e ditë më 6 janar që pozita e tij, e Këshillit dhe e Shtabit të Përgjithshëm ishte e dëshpëruar, por pasi kishte hedhur poshtë paralajmërimet dhe këshillat e mëparshme të gjeneralit Dejvis, ai nuk mund ta bënte veten që ta pranonte se ashtu ishte puna dhe u përpoq ta paraqiste me pëtkun e një

plani pozitiv për të çarë rrethimin atë, që nuk ishte më tepër se një lëvizje shmangëse, ndërsa priste që ta shpëtonin.

Që nga 6 janari pati një zbrazëti në kontaktet e anglezëve me Enver Hoxhën deri në fillim të shkurtit, kur nënkoloneli Uiler hyri në lidhje me të në jug pranë Staraveckës dhe Backës. Enver Hoxha duhet të ketë bërë një jetë arratiaku në Çermenikë gjatë pjesës më të madhe të janarit, deri sa nga fundi i muajit e shpëtoi Mehmet Shehu me mësymjen drejt veriut dhe kjo mësymje ose ky marshim prej të paktën dy batalioneve të Brigadës I, ka qenë me të vërtetë një akt i paharrueshëm i njësisë bërthamë të Ushtrisë Partizane. Është e sigurtë se që nga ajo kohë e më pas, Mehmet Shehun e kanë nderuar dhe admiruar gjithë forcat partizane dhe ia kanë pasur frikën të gjithë ata jashtë tyre.

Dejvisi shënon se më 6 janar Enver Hoxha propozoi t'i linte britanikët nën kujdesin e Baba Fajës, ndërsa Këshilli dhe Shtabi i Përgjithshëm do të ecnin drejt anës jugore të malësisë, me argumentin se do të ishte më e lehtë që të sigurohej ushqimi, nëse do të ndaheshin grupet dhe duke premtuar se do t'i tërhiqte britanikët kur do të bëhej e mundur të çahet rrethimi. Gjenerali këmbënguli edhe një herë se duhej bërë një grup i vogël prej jo më shumë se dhjetë vetash, duke përfshirë edhe atë, për të dalë nga rrethimi, por Enveri refuzoi që t'i ndryshonte planet e veta. Enver Hoxha jep një histori tjetër të ndryshme. Ai lë të nënkuptohet se po planifikonte që ta merrte me vete misionin britanik dhe pretendon se vetëm atëherë e mori vesh që Nikolsi ishte i sëmurë dhe, aq më keq, se këmba po i gangrenizohej. Ai mori përsipër të rregullonte punën për një operim. Dejvisi sugjeroi që familja e mirënjohur dhe shumë e respektuar Toptani, afër Tiranës, mund të ishte në gjendje të ndihmonte dhe Hoxha pretendon se nuk ka kundërshtuar. Sipas Hoxhës, Dejvisi qëndroi në zonën e Baba Fajës, që të kujdesej për Nikolsin.

Pasi iku Hoxha, Baba Faja premtoi që t'i vinte britanikët në një shtëpi të përshtatshme. Të nesërmen në mëngjes, më 7 ose 8 janar u kthye në Kostenjë me furnizime një grup që kishte shkuar për të bërë pazar. Jeta dukej se po përmirësohej. Pas drekës u bë një alarm se gjermanët kishin arritur në fshatin poshtë. Pas pak nisi një sulm, kryesisht nga shqiptarët (bashkëpunëtorët, nacionalistët, ballistët) me mbështetjen e gjermanëve. Britanikët u larguan duke iu qepur faqes së malit dhe ende nuk kishin arritur të hynin nën

mbrojtjen e pyllit, kur Dejvisi u godit në bark e në thembër dhe Çeshajri në vithe. Gjenerali urdhëroi që ta merrte detyrën Nikolsi dhe Hejri të shkonte me të. Një nga nënoficerët, rreshteri Smith i Forcave Ajrore Mbretërore qëndroi besnikërisht me gjeneralin dhe Çeshajrin. Ata ranë rob duke kaluar disa etapa të dhimbshme, në fillim në duart e shqiptarëve e pastaj të gjermanëve. Shqiptari që kishte përgjegjësinë e drejtpërdrejtë për shkatërrimin e misionit britanik, ishte Azis Biçaku, një ballist bashkëpunëtor me gjermanët. Nuk është e sigurtë nëse ai e dinte cilin do të gjente në Kostenjë. Pikësnyimi real do të ketë qenë ndoshta Këshilli i LNÇ dhe Shtabi i Përgjithshëm. Ata shpëtuan dhe shpëtimi i tyre, në fund të fundit, përcaktoi fatin që i priste gjithë ata që i shërbenin çështjes së Ballit e të nacionalistëve, disa prej të cilëve ndoshta u tmerruan kur dëgjuan çfarë kishte bërë Azis Biçaku, porse asnjë prej tyre nuk kishte bërë asgjë për ta ndaluar këtë, si dhe gjithë ata që duartrokitën për atë që e mendonin se kishte qenë shkatërrimi i partizanëve të LNÇ prej gjermanëve.

Nikolsi dhe Hejri çanë rrugën përmes malësisë së Martaneshit, por nuk mundën të gjenin vend strehimi. Gjermanët e kishin shkatërruar gjithë zonën dhe frika nga gjermanët bënte që çdo portë e mbetur t'u mbyllej. Ata vuanin nga të ftohtët, Nikolsi akoma më keq. Pas disa ditësh e netësh me privacione shumë të rënda dhe pas shumë vuajtjesh të Nikolsit, Hejri ia doli mbanë ta rregullonte që atë ta merrnin për ta çuar në drejtim të Tiranës, ku lidhjet me nacionalistët ishin në gjendje t'i siguronin kujdesin mjekësor. Ai vdiq në fund të janarit. Një dekorim me Kryqin e Gjergjit pas vdekjes vinte në dukje vendosmërinë dhe kurajën e jashtëzakonshme që ai pati treguar. Me Kryqin Ushtarak u dekorua Hejri, i cili e kapërceu këtë gjendje të tmerrshme dhe ia doli mbanë të bashkohej me majorin Sejmur, që duke u kthyer nga Biza e kishte gjetur rrugën për të ardhur në zonën e tij të mëparshme jo larg nga Tirana. Ata e kaluan pjesën që mbetej të dimrit me vështirësi, duke mbledhur informata dhe duke e marrë veten nga shëndeti pak nga pak. Sejmuri arriti të mbante një radist dhe të shpëtonte një radio nga shpartallimi i misionit, kështu që kjo i dha mundësinë të rivendoste lidhjen me radio me Forcën 133.

Partizanët mbijetuan më tej në grupe ose «çeta» të vogla, që endeshin andej-këtej dhe, ndërsa i vështronin me mosbesim, kundrejt tyre u tregua një tolerancë e mjaftueshme

për ta mbajtur veten gjallë në malet e veriut. Por në fillim të vitit 1944, LNÇ ishte shkatërruar e shpërndarë si forcë ushtarake dhe politike në veri të lumit Shkumbin. Veprimi u zhvendos në jug. Dy oficerë që kishin ardhur me personelin e gjeneralit në mes të tetorit, majori (më pas, nënkoloneli) Alan Palmer dhe kapiteni (më pas majori) Viktor Smith, u dërguan prej tij në jug për detyrat e ndërlidhjes me partizanët atje. Emri i koduar i misionit të tyre ishte Swifter (I shpejti), por ata kishin gjithashtu një radio shpine me emrin e koduar Primus, të cilën sipas rastit herë njëri e herë tjetri e përdornin kur ishin larg nga baza e misionit të tyre Swifter. Nënkoloneli Uiler më disa oficerë të tjerë u hodh në zonën e Voskopojës, jo larg nga Korça, në mes të dhjetorit (me emrin e koduar Spillway, Kapërderdhësi). Këto misione dhe misioni i stabilizuar mirë i Bill Tilmanit me emrin Skulptori në Sheper rregulluan një aparat për ndërlidhje të vazhdueshme me lëvizjen partizane të LNÇ në Shqipërinë e jugut dhe për ta furnizuar atë.

Misioni Swifter nisi të merrte hedhje nga ajri më nëntor¹²). Swifter 4 dhe 5 u hodhën në Krushovë, afër Voskopojës, më 4-5 dhe 6-7 dhjetor. Pesë a gjashtë ngarkesa të Spillway u hodhën në sheshin e zbritjes të Swifter në dhjetor me një peshë të përgjithshme prej 11 tonësh ose aty rrotull. Pati katër hedhje për Swifter, për Skulptorin 5 dhe një për Primus në janar, me shumën e përgjithshme rreth 18,5 tonë, që të gjitha (ose të paktën kështu del nga dokumentet e RAF) në Sheper, sheshi i zbritjeve për Tilmanin. Të vetmet hedhje të tjera për misionet në Shqipëri gjatë janarit ishin një për Nilin (Slender) në Macukull, në verilindje të Burrelit, në qendër të Shqipërisë së Veriut, dhe dy për Ridellin në kodrat në veri të Dibrës. Këto qenë kryesisht hedhje «mbështetëse» dhe në rrethanat e pështjellimit që ekzistonte në veri, nuk kishin rëndësi ushtarake. Prandaj kanali i furnizimeve britanike për partizanët e LNÇ efektivisht vazhdoi të mbetej në vend, duke punuar normalisht dhe nuk u ndërpre nga katastrofa e dimrit, ndonëse misioni i kuartierit kishte humbur dhe bashkë me të, për atë periudhë, edhe kontakti me udhëheqjen e LNÇ partizane. Nga rrënjët që mbetën në jug më 1944, do të rritej një pemë e fuqishme e paparashikueshme.

Lajmet e para për kapjen e Dejvisit nga gjermanët erdhën në Ministrinë e Jashtme në Londër me një letër të datës 27 janar nga nënkoloneli Talbot Rajs (Rice) në SOE për

Daglas Hauardin (Douglas Howard¹³),¹⁴), i cili ishte bërë drejtori i Departamentit të Jugut), duke mos pasur asnjë njohim nga misioni i kuartierit që nga 18 dhjetori. Radio Tirana kishte njoftuar në 4 janar se një gjeneral britanik dhe shtabi i tij ishin kapur nga trupat gjermane më 5 janar (data 5 mund të mendohet se ka qenë nga një gabim i leximit të numrit 8). Përmbledhja informative e Forcës 133 që përfshinte dyjavorin deri më 23 janar (shkruar përsëri nga zonja Hezllak), e përmbledhite situatën me këtë fjali: «Kështu situata na paraqitet që, me përjashtim të krahinave shqiptare të jugperëndimit dhe të zonës që vjen duke u zvogëluar vazhdimisht në qendër, Shqipëria është në duart e Ballkanit.»¹⁵) Ndërkaq, në ditët e para të janarit kishte arritur në FO raporti i Maklinit, i shkruar në Kajro në dhjetor, dhe si rezultat i eklipsit të gjeneralit Dejvis dhe gjithë misionit të kuartierit, ky u bë fokusi për të menduarit e FO dhe të SOE rreth Shqipërisë. Kjo gjë dhe pasojat e saj do të trajtohen në kreun 8.

Eshtë e nevojshme që t'i shtohet një passhkrim këtij kreu, që lidhet me trajtimin nga Enver Hoxha në kujtimet e tij për fundin e misionit të Dejvisit.¹⁶) Ky është një ushtrim për shpifje. Ai pretendon se gjenerali iu dorëzua gjermanëve dhe se e kishte kërkuar dorëzimin disa herë, dhe rrëfimi i tij rreth marshimit të ankthshëm e kundërmarsimit që u bë përpara shpartallimit, e paraqet gjeneralin që të duket grindavec, egoist dhe i pazoti për të duruar vështirësitë. Në një a dy raste ka pasur shkëmbim fjalësh të rënda ndërmjet gjeneralit dhe Enver Hoxhës: kur i pari u përpoq që ta sillte në vete të dytin për rreziqet e situatës së vështirë, në të cilën ai i kishte futur partizanët e LNÇ, dhe kur «Trocki» pati parashtruar nevojën që t'i ndërpriste humbjet në qendër të vendit dhe të organizonte çarjen e rrethimit nga një grup i vogël, në mënyrë që Shtabi i Përgjithshëm të rimerrete drejtimin e luftës nga jugu, zona në të cilën partizanët ishin më të fortë. Por Hoxha e ndërtoi karrierën e tij mbi një kult personal dhe i ka shkruar e rishkruar kujtimet e ngjarjeve për ta treguar veten sikur ka pasur gjithmonë të drejtë, ndërsa të tjerët paskan qenë gjithmonë të gabuar ose të pazotë. Hedhja poshtë e këshillës së gjeneralit nga ana e tij detyrimisht do të merrej vesh në lëvizjen partizane dhe nuk do të ishte e vështirë për disa që të shpreheshin vetë, se ishte kjo hedhje poshtë që ishte shkaktare në një shkallë të madhe për situatën e tmerrshme në të cilën ranë partizanët në janar 1944 dhe për humbjen e misionit të gjeneralit. Si-

pas pikëpamjes së Hoxhës, ilaçi gjendej duke denigruar Dejvisin, me qëllim që të dukej sikur gjenerali shqetësohej vetëm për veten dhe jo për partizanët e LNC. Atëhere Hoxha mund ta paraqiste veten në rolin e një «supermeni», i cili gati sa nuk u përta nga vala gjermane-balliste, por që ia doli mbanë të shpëtonte me anë të pushtetit të vet dhe mbijetoi që të udhëhiqte Shqipërinë drejt fatit të saj.¹⁷⁾

Shënime

1. PRO, FO. 371/37144.
2. Davies (1952; 47).
3. PRO, Air 27/995.
4. Glen (1971; 151). Historia e mëtejshme e shpellës në Rivierë, e gjirit të Gramës dhe misionit Stables tregohet në një formë gjysmë letrare te Quayle (1945).
5. Davies (1952; 77 vij.) dhe Hoxha (1982 a; 85 vij.). Historia e treguar në këtë krye është thurur nga rrëfimet shumë të ndryshme që kanë dhënë gjenerali Dejvis dhe Enver Hoxha për ngjarjet, në të cilat u përfshinë së bashku në nëntor e dhjetor 1943.
6. PRO, FO. 371/37145.
7. Po aty.
8. Po aty.
9. Hoxha (1982 a; 152-57, 171-72).
10. Marmullaku (1971; 71).
11. Dedijer (1949; 72).
12. PRO, Air 27/995.
13. PRO, FO. 371/43549.
14. Më pas Sir Douglas Howard, KCMG, ambasador në Montevideo, ministër i Kryepeshkopatës së Shenjtë.
15. PRO, FO. 371/43549.
16. Hoxha (1982 a; 152-57, 171-72).
17. Në kujtimet e Dejvisit Hoxha trajtohet mjaft mirë. Ai nuk e meriton këtë. Trajtimi që i bëri Hoxha nënkolonelit Nikols është më pak denigruar se trajtimi për Dejvisin, por Nikolsi nuk ishte kryesori dhe prandaj ishte më pak i rrezikshëm për Hoxhën.

Kreu 6

Misioni Stables: dimri dhe amullia në Veri

Unë u hodha në Shqipëri për t'u bashkuar me misionin Stables (Stallat) natën e 19-20 dhjetorit 1943, pikërisht atë natë, kur ofensiva gjermane në malësinë e Çermenikës e shkëputi nga lidhjet misionin e kuartierit dhe nisi spiralja teposhtë për eliminimin e atij misioni. Ky fluturim në një Halifax të Skuadriljes 148, RAF, me emrin e koduar Stables 2, ishte prova e tretë. Ne kishim shpenzuar tetë orë në ajër gjatë dy netëve të mëparshme për secilën, por na kishte penguar mjegulla mbi zonën e hedhjes. Në ato ditë zakonisht nevojiteshin rreth katër orë për një bombardues me katër motorë që të fluturonte përmes Mesdheut nga aerodromi i Tokrës në Libi deri në Shqipërinë veriore. Nata 19-20 dhjetor ishte një natë e mirë për Regjimentin 334, RAF¹). Ata bënë 18 fluturime misioni mbi Ballkanin dhe 11 dolën me sukses, ky ishte një sukses jashtëzakonisht i lartë për mesin e dimrit. Katër nga dështimet ishin të Halifax të drejtuar për në Orenjë, që të sillnin ndihmën aq të nevojshme për misionin. Në vend që të mirëpriteshin nga zjarret e she-shit të zbritjes, ata ndeshën zjarrin e topave gjermanë nga toka.

Hedhja e Stables 2 u bë në sheshin e zbritjes të togërit të aviacionit Hendz (Spinster) në Degë, përtej Drinit në Shqipërinë veriore. Në atë kohë ishin atje gjithashtu edhe Peter Kempit e Toni Nili; Kempit sapo ishte kthyer nga ekspedita e tij e parë në Kosovë dhe Nili kishte ardhur nga një rikonjicion në zonën e Shkodrës dhe të krahinës fqinjë

katolike. Dy oficerë të tjerë u hodhën në Degë po atë natë si dhe unë, togeri Jan Merret, i cili do të bashkohej me Nilin dhe togeri Xhon Hiberdin (John Hibberdine), që do të bashkohej me Kempin. Unë kisha një radist, sinjalizuesin Elvixh (Elvidge) dhe ne kishim një radio të re për ta çuar drejt jugut, duke iu ngjitur luginës së Drinit të Zi, për misionin Stables diku në malet në drejtim të Peshkopisë. Merreti dhe Hiberdini gjithashtu kishin sjellë radistë e radio, kështu që Kemi dhe Nili do të kishin përsëri ndërlidhje si edhe Riddelli, do të ndreqej pak a shumë për një pjesë anësore dëmi që u ishte bërë misioneve në Veri nga ofensiva gjermane e dimrit.

Siç ndodhte me shumicën e BLO në Shqipëri, vajtja ime atje ishte e rastit. Unë isha 21 vjeç, sapo isha përgatitur si oficer tankist nga Sandhurst, që ishte Reparti i Stërviçjes së Oficerëve Kadetë të Korpusit të Korracuuar Mbretëror. Më parë unë kisha bërë dy vjet në Oksford. Atje kisha studiuar për histori dhe e kisha kaluar kohën duke bërë ato gjëra që bëjnë studentët e vitit të fundit, me përjashtim të faktit që shumë orë duheshin kaluar në Korpusin Stërviçor të Eprorëve, i cili për fat të mirë kërkonte sa më shumë udhëtime me motocikletë, me kamion e me makinë zbulimi nëpër fushat e fshatrat e Oksfordshirit dhe të krahinës përreth. Ballkani më kishte dalë vetëm në mënyrë anësore në studimet për historinë dhe politika nuk bënte pjesë në interesat e mia, që ishin përgjithësisht akademike. Komandimi im prej Sandhurstit u vonua, sepse unë kisha thyer nofullën në një aksident me tank dhe si pasojë kisha mbetur prapa nga disa shokë të mi, që po shkonin nëpër regjimente në Lindjen e Mesme, duke përfshirë edhe regjimentin që më kishte pranuar mua, Regjimenti IV i Husarëve të Mbretëreshës. Më duhej ta kaloja kohën në një batalion mbështetës të Pushkatarëve të Lankashirit në Abacinë e Uelbekut (Welbeck), rezidenca e Dukës së Portlandit në Notingemshir. Atje më ngarkuan me trupën e rikonjicionit të skuadrës së kuartierit. Ajo përbëhej tërësisht nga oficerë të rinj të rangut të ulët dhe ne kënaqeshim, duke ia shkelur deri në dërrasë me transportuesit tanë Bren nëpër kodrat e Derbishirit dhe Jorkshirit dhe duke u mbledhur në grupe për shëtitje në një rrethinë të gjerë. Kur erdhi një qarkore, e cila kërkonte vullnetarë për detyra të posaçme, e shkruar me një gjuhë të fshehtë tunduese, unë kërcëva menjëherë për t'iu përgjigjur. Më pranuan pas një bashkëbisedimi të sipërfaqshëm në një shtëpi të bukur jashtë Ok-

sfordit dhe pa e bërë të gjatë e pashë veten se po lundroja nga Liverpuli në Aleksandri me një karvan anijesh, që ishte një nga të parët i cili kaloi përmes Mesdheut pas zbarkimit në Sicili.

Në Kajro u paraqita te MO4 (që së shpejti do të bëhej Forca 133) në Ndërtesat Rustum, ku gjithçka ishte sekrete, por ku mund t'i shihje hartat e vendeve të Ballkanit po të qëndroje jashtë e të hidhje sytë kur ndizeshin dritat në mbrëmje. Në shkollën e SOE në Malin Karmel të Haifas na bënë një kurs për veprimtaritë paraushtarake, sabotimet, shkatërrimet dhe armët e llojeve të ndryshme, pas kësaj kalova në shkollën e parashutimit në Ramoth David pranë Nazaretit. Kur u ktheva në Kajro, mora vesh se më kishte rënë në short Shqipëria dhe për të më dhanë një informacion të shkurtër zonj. Hezllak dhe të tjerë, por nuk ishte ndonjë gjë që të më ndriçonte mirë. Ndoshta habia më e madhe për periudhën stërvitore ishte se askush nuk dukej të shqetësohej shumë për punën e gjuhës, ndonëse jepeshin pak mësimet parregullta për gjuhën shqipe. Duke njohur jo keq frëngjishten dhe mjaftueshëm gjermanishten, unë isha i pajisur mirë me gjuhë në krahasim me shumë shokë të tjerë oficerë, por ndoshta jo për Shqipërinë.

Majori Filip Lik (Philip Leake) ishte i ngarkuar me seksionin e Shqipërisë në Ndërtesat Rustum dhe në varësi të tij ishin dy a tre oficerë të personelit. Ata ishin pjesë e strukturës së re ushtarake, që po zëvendësonte organizatën më pak formale MO4. Në ditët e para të dhjetorit 1943, ajo u emërua zyrtarisht si Forca 133 nën GHQ të Lindjes së Mesme. Me përjashtim të Margaret Hezllakut, askush në Seksionin e Shqipërisë nuk kishte ndonjë përvojë shqiptare. Ajo dhe kolegët e saj u përpoqën që të montonin një tablo koherente të ngjarjeve nga copat e letrave që kalonin nëpër tryezat e tyre dhe që përbënin të vetmin informacion në dispozicion. Ata nxirrnin lista shushatëse emrash, duke i cilësuar si të LNC, zogistë, ballistë ose thjesht «nacionalistë», ashtu si ua diktonte informacioni që kishin në dispozicion; ata mund të citonin me duzina ngjarjesh e lëvizjesh të palidhura, si dhe ndeshje ushtarake që ishin njoftuar nga të gjitha pjesët e vendit, por nga e gjitha kjo ishte e pamundur të nxirrje ndonjë përshtypje të qartë për forcat që vepronin në Shqipëri. Shumë më interesante ishin forcat emocionale që vepronin në Kajro ndërmjet disa prej oficerëve dhe ndërmjet oficerëve e FANY, porse në të BLO që i kishim buzët me qumësht

ende, nuk qëndronim aq gjatë sa të ushtroheshim mirë me këtë apo atë studim. Shumë pak fakte nga ato që u parastruan në pesë krerët e parë të këtij libri, na kishin rënë neve në vesh, edhe ato në një mënyrë të palidhur e anekdotike. Ne mbetëm miturakë përsa u përket çështjeve të Shqipërisë.

Kur ika nga Kajroja, kisha me vete dy copa të vogla letre. Njëren e kishte nënshkruar majori Lik dhe aty shkruhej:

«Siç është përcaktuar, ju do të shkoni në SNOOD²) mëngjesin e 3 nëntorit. Nga SNOOD ju do të vazhdoni nëse e lejon moti, me ajër (Operacioni CRUCIBLE: fluturimi STABLES²) më 11 nëntor ose rreth kësaj date, për te Zona e Hedhjes së Grupit STABLES pranë PESHKOPISË, ku do të zbrisni me parashutë. Pritjen do ta rregullojë majori RIDDELL, oficer ndërlidhës i zonës, DIBËR, dhe oficeri i ngarkuar si përgjegjës i grupit STABLES. Kur të arrini në vend, do të hyni nën urdhrat e majorit RIDDELL».

Tjetra ishte shqip e anglisht dhe e kishte nënshkruar zonj. Hezllak. Aty thuhej:

«Miqte e mi në Shqipëri, togëri Hibert që ju paraqet këtë letër është anglez dhe miku im. Ashtu siç më keni mirëpritur mua, kur ju pyesja për ndonjë histori të bukur popullore ose ju bëja pyetje për bektashinjtë e për Kanunin e Lekës së madh, ju lutem po ashtu ta prisni edhe këtë anglez, me mikpritjen tuaj të njohur. Ju dërgoj urimet e mia më të mira, o miq që kurrë nuk ju kam harruar».

Mirëpo në fakt unë nuk u nisa për në SNOOD deri në dhjetor, sepse u shtrova në spital me një krizë dizanterie. Asgjë nuk u zhvillua me atë mënyrë të thjeshtë e të organizuar, siç e sugjeronin të dy copat e letrave. Megjithatë unë i mbajta të dyja në xhepin e gjoksit si hajmali gjatë gjithë qëndrimit tim në Shqipëri. I pajisur me këto dhurata për kujtim, unë u hodha në Shqipëri, ashtu siç mund të besonim të ndonjë, dhe vërtet besonte në ato ditë, se ishte mjaft e parrezikshme të bëje pothuaj gjithçka, mjafton të ishe anglez dhe i bindur se, edhe nëse Shqipëria nuk kishte asnjë domethënie për mua, dikush diku prapa meje ose mbi mua e dinte se çfarë po bënim ne dhe do të na siguronte çfarëdo mbështetje të nevojshme për të arritur sukses. Për punët e kësaj toke, Shqipëria do të bëhej universiteti im.

Unë kam mbajtur një ditar në Shqipëri në tre blloqe të

vogla, të mbushura ngjeshur, të cilat i kam pasur gjithnjë me vete, si ato letrat hajmali. Ky veprim ishte kundër rregullave, por për një djalosh që sapo vinte nga universiteti, kjo ishte një mënyrë për të përthithur përvojën nga një botë shumë e çuditshme. Që nga kjo pikë e më tej, unë do ta ndërthur materialin e ditarit në këtë tekst. Ditari ka meritën që tregon se çfarë ndihej në atë kohë në Shqipëri nën ndikimin e vrazhdë të ndodhive tekanjoze të përditshme. Duke e vënë përballë sfondit të rrëfimit më të gjerë që jepet në këtë libër, ai tregon gjithashtu se çfarë hendeuku kishte ndërmjet përvojës sonë aty në vend dhe mendimeve për Shqipërinë në nivelet më të larta ushtarake e politike. Kjo na jep një dëshmi autentike për vështirësitë dhe hutimin e shpeshtë, me të cilat ndesheshim ne dhe vetë shqiptarët, duke marrë pjesë në ato ngjarje, nga të cilat lindi Shqipëria bashkëkohore.

Kur zbritëm në Degë ishte ftohtë dhe acar, diçka që na erdhi si shok pas nxehtësisë në Libi. Na pritën me ngrohtësi Hendzi, Kempji, Nili dhe nënoficerët që kishin me vete. Në ditarin tim shkruhet: «Pak rum, pak ushqim dhe shumë gjumë në një kasolle të vogël shqiptare». Kujtesa më thotë se ajo ishte një shtëpi e zakonshme shqiptare, me dy dhoma lart për miqtë dhe për burrat, ndërsa poshtë kishte vend për gratë, fëmijët dhe kafshët. Aty ishin gjashtë oficerë britanikë, po aq nënoficerë e sinjalizues dhe disa shërbëtorë italianë, kështu që shtëpia ishte e mbingarkuar. Hendzi, Kempji dhe Nili nuk kishin asgjë të gëzueshme ose shpresdhënëse për të thënë mbi Shqipërinë. Gjithë teshat tona personale na i vodhën në sheshin e zbritjes, kështu që secili prej nesh e niste pa asgjë tjetër, veç rrobave me të cilat ishte hedhur me parashutë. Nuk kishte një motor me naftë për të mbushur bateritë, kështu që edhe neve menjëherë na futën në punën torturuese për të rrotulluar katër orë rresht një makinë ngarkimi që punonte me dorezë, për t'i mbajtur gjallë bateritë e radios. Të gjitha iluzionet tona për një luftë gueriljesh të gjallë e gjithë ngjyra plasën si filluska, kur po dëgjonim Kempin dhe të tjerët që bënë diskutime pa fund me udhëheqësit lokalë. Askush nuk kishte një informacion të sigurt për vendndodhjen e misionit Stables. Nuk kishte lajme për gjeneralin Dejvis. Megjithatë ishim të gëzuar për Krishtlindjet, hanim, pinim, flinim dhe u hipnim kuajve. U dërguan shqiptarët që i kishim pranë, për të bërë pazar në Prizren, në Kosovë dhe na sollën verë kianti, konjak, raki.

dhe cinzano. Italianët e Hendzit bënin mrekullira gatimi me prodhimet lokale. Kishim me bollëk duhan për çibuk dhe cigare të dredhura.

Morali i misionit në Degë ishte i ulët. Hendzi ishte angazhuar për të punuar me partizanët, por ata ishin shpartalluar në pjesën më të madhe të Shqipërisë së Veriut, dhe vetëm dy a tri çeta (grupe gueriljesh) të papërcaktuara dhe me frymë të dobët kishin mbetur të gjalla. Kempin shpresonte t'i prekte ndjenjat kombëtare shqiptare në Kosovë me ndihmën e familjes Kryeziu, por ai po gjente pengesa nga qëndrimi si qeni që ruan kashtën të mbajtur nga partizanët, të cilët nuk mund të çanin për vete për shkak të lidhjeve me sllavët, por gjithashtu nuk donin të lejonin asnjë tjetër të çante vetë. Nili po zhvillonte kontakte me udhëheqësit e fiseve katolike në zonën e Shkodrës, por edhe ato pengoheshin ose ndërpriteshin nga partizanët sa herë që u jepë mundësia. Nuk dukej e hapur asnjë vijë premtuese për aksion në asnjërin drejtim dhe përpjekjet e oficerëve të ndryshëm dilnin në kontradiktë.

Gjendja në veri kishte arritur një çast pezullie. Partizanët nuk gëzonin aspak popullaritet, shiheshin me armiqësi nga krerët dhe me frikë nga katundarët. Prania e tyre sillte me vete sulme ndëshkuese të udhëhequra nga gjermanët dhe të kompletuara me forca kolaboracionistësh shqiptarë, me xhandarë e mercenarë. Lëvizjet dhe çfarëdo aktiviteti që mund të bënin partizanët, ishte e sigurtë që do të sillte si pasojë raprezalje të pamëshirshme kundër fshatrave dhe shtëpive që i kishin strehuar, goftë edhe kur strehimi u ishte dhënë pa dashje dhe nga frika e dënimit prej partizanëve. Krerët nuk bënin asgjë për ta qetësuar popullin nga frika, por i nxinin pasuesit e tyre dhe gjithë popullsinë që t'i shihnin partizanët sikur nuk ishin asgjë tjetër veç komunistë, që u shërbënin qëllimeve të shteteve fqinje sllave dhe Bashkimit Sovjetik, të huaj për mënyrën shqiptare të jetesës dhe armiq të saj, që meritonin vetëm të shuheshin dhe të shfaroseshin kur dimri dhe gjermanët do ta shtrëngonin darën e tyre. Megjithatë binte në sy që ata krerë, të cilët në vija të trasha mund të cilësoheshin si «nacionalistë», domethënë ata që nuk bashkëpunonin hapur me gjermanët duke i furnizuar me forca ndihmëse, ata nuk merrnin masa aktive për shfarosjen e çetave partizane që kishin mbetur gjallë.

Kishte disa arsye për këtë. Ata nuk e besonin se gjermanët do ta fitonin luftën: ata i bënin llogaritë për një fi-

tore eventuale të Aleatëve. Ata mendonin se Britania dhe Amerika e jo Bashkimi Sovjetik do ta siguronin praninë e Aleatëve në Ballkanin Jugor në fund të luftës, dhe e quanin të padiskutueshme që Britania dhe Amerika atëherë do t'ua prisnin shkurt forcave partizane. Duke qenë se ata vetë nuk do t'i kishin lyer drejtpërdrejt duart me gjakun e partizanëve, ata mendonin se nuk do të kishin për të paguar ndonjë dënim vetëm pse kishin ndihmuar për t'ua vështirësuar jetën. Këtu hynte gjithashtu edhe konsiderata që partizanët, në fund të fundit, ishin shqiptarë që ishin ngritur kundër të huajve dhe luftonin sundimin e huaj, dhe kishte individë që i simpatizonin ata në një shkallë më të madhe a më të vogël në gjithë Veriun. Bijtë e bijat e fshatarëve gegë ndodheshin në radhët e çetave. Edhe në çastet e tyre më të këqija, partizanët përsëri kishin fije të rrënjëve në mes të popullit, nga të cilat mbaheshin. Puna ishte gjithashtu se kurrë ishin për një jetë të qetë dhe për të ruajtur statukuonë. Nuk ishte në interesin e tyre asnjë lloj përmbysjeje. Ata e gëzonin autoritetin e tyre midis njerëzve për shkak të preshtigjit të tyre si mbrojtës — mbrojtës kundër fqinjëve, kundër të huajve nga ana tjetër e malit të vendit, kundër pushtuesve të huaj, kundër shkatërruesve të mënyrës shqiptare të jetës dhe, në veçanti, kundër serbëve, grekëve, italianëve e bullgarëve. Por mbrojtja e tyre duhej të ishte efektive që të vijonte të pranohej. Një mbrojtje që çonte në fatkeqësi e shkatërrime, nuk ishte fare mbrojtje.

Në këtë mënyrë gjermanët e udhëhequr nga nazistët (dhe më pak vëndosmërisht, italianët e udhëhequr nga fashistët përpara tyre) dhe partizanët e udhëhequr nga komunistët i vunë krerët nacionalistë shqiptarë përpara një dileme të pazgjidhshme. Si gjermanët, edhe partizanët ishin të gatshëm të shkonin deri në ekstrem me përdorimin e forcës. Një nga krerët që do t'u hidhte çik secilës palë, mund të fitonte emër si burrë, madje dhe si hero, por ka të ngjarë që ai do t'i shihte pasuesit e tij nga populli të shkriheshin nga pasojat e dhunshme të raprezaljeve që pritej se do të bëheshin pas aksionit të tij. Kështu ndodhi që krerët e veriut u përmbajtën për të mos bërë asnjë aksion pozitiv në asnjërin drejtim, qoftë kundër gjermanëve, qoftë kundër «komunistëve». Ata bënë ç'është e mundur për të manovruar, në mënyrë që gjermanët gjatë luftës dhe anglezët e amerikanët më pas, të mund të shtypnin «komunizmin» për llogari të tyre. Gjendja e rëndë që u vendos mbi oficerët britanikë të mbledhur në

Degë në krishtlindjet e vitit 1943 i detyrohej kryesisht asaj situatë amullie. Ajo u rëndua nga vështirësitë e jetës në malësi: rrasja ngucur në një shtëpi, papastërtia, parazitët, furnizimi i parregullt me ushqime, vjedhjet, shtrëngesat dhe fjetja e keqe, por të gjitha këto gjëra mund të duroheshin më lehtë në qoftë se nuk do të ishte situata në rrugë të verbër, që mundonte praninë angleze në Shqipëri për këtë arsye.

Gjendja në Degë bëhej edhe më e keqe për shkak se Kosova ishte afër. Në këtë kohë, pa e ditur oficerët britanikë, Kosova po bëhej një burim politik mosmarrëveshesh ndërmjet partive komuniste të Shqipërisë e të Jugosllavisë. Deklarata pak ekuivoke e Enver Hoxhës për Kosovën në Konferencën II të Komitetit Nacionalçlirimtar në Labinot, në fillim të shtatorit 1943, tashmë është përmendur (shih kreun 4). Nga fundi i nëntorit, në kohën e mbledhjes së dytë të Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar të Jugosllavisë (AVNOJ) në Jajcë, Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Jugosllavisë i dërgoi një letër Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Shqipërisë, e cila pjesërisht ishte paralajmëruese dhe pjesërisht qortuese. Ajo thoshte kështu:

«Të ngresh çështjen e bashkimit (të Kosovës me Shqipërinë) do të thotë t'u japësh dorën e ndihmës reaksionarëve të ndryshëm, duke përfshirë edhe vetë armikun... dhe nuk është e nevojshme të theksohet se kjo nuk mund të përbëjë një çështje ndërmjet nesh dhe një Shqipërie demokratike e antiimperialiste... Jugosllavia e re që po ndërtohet, do të jetë një vend i kombeve të lira dhe, si rrjedhim, nuk do të ketë vend për shtypje kombëtare të pakicave shqiptare...»³

Në fund të dhjetorit, kur Kempfi po vendoste kontaktet e tij në Kosovë, partizanët shqiptarë e jugosllavë ishin të zënë me krijimin e një Komiteti Nacionalçlirimtar për Kosovën e Metohinë. Mbledhja e parë e tij u mbajt më 31 dhjetor 1943 dhe 1 e 2 janar në veri të Shqipërisë, në një fshat shumë afër Degës, gjë që e shpjegon përqendrimin e përzier të grupeve partizane në zonën e Valbonës, Degës e Tropojës, me të cilën ishte në kontakt Hendzi. Historia e PKSH thotë se kjo mbledhje u mbështet nga organizata e PKSH në Tropojë dhe nga Batalioni partizan «Perlat Rexhepi» i Shkodrës, që vepronte në malësitë e Gjakovës. Ishin të pranishëm dyzet e nëntë delegatë. Rolet udhëheqëse i luajtën Fadil Hoxha⁴) dhe Mehmet Hoxha, komisar i tij, i cili ishte një nga vizitorët partizanë që

erdhi te ne në Degë për krishtlindjet dhe të cilin Kempri e kishte takuar më parë me Shtabin e Përgjithshëm të LNÇ afër Tiranës dhe, një herë tjetër, në Dibër përpara sulmit të gjer-manëve. Që të dy, Fadil Hoxha dhe Mehmet Hoxha do të luanin role udhëheqëse në Kosovë dhe në Jugosllavi pas lufte. Komiteti Nacionalçlirimtar i ri i Kosmetit miratoi një rezolutë shumë të favorshme për Shqipërinë, që thoshte:

«Kosova e Metohia asht një krahinë e banueme në shumicë nga populli shqiptar, i cili si gjithmonë ashtu edhe sot dëshiron me u bashkue me Shqipërinë... E vetmja rrugë për shqiptarët e Kosovës e të Metohisë për t'u bashkue me Shqipërinë asht përmes luftës së përbashkët me kombet e tjera të Jugosllavisë kundër pushtuesve dhe forcave të tyre, mbasi kjo asht e vetmja rrugë për me fitue lirinë, kur të gjitha kombet duke përfshi edhe shqiptarët, do të jenë në gjendje me zgjedhë fatin e tyre, me të drejtën për vetëvendosje, duke përfshi edhe shkëputjen».5)

Ky tekst nuk u mirëprit nga PKJ. Duke e vënë theksin më tepër mbi mundësinë për shkëputje, se sa mbi një premtime për t'u përfshirë mbi bazën e barazisë me «kombet» e tjera në Jugosllavi, ai vinte në kundërshtim me rezolutat e miratuara nga Këshilli Nacionalçlirimtar Jugosllav i Jajcës. Më 28 mars 1944 Milovan Gjilasi do t'u shkruante, në emër të Komitetit Qendror të PKJ, udhëheqësve të rezistencës në Kosovë e Metohi duke kritikuar atë pjesë të tekstit, që u referohej aspiratave për t'u bashkuar me Shqipërinë⁶). Udhëheqja në Kosovë e Metohi mori përsipër ta ndryshonte pjesën në fjalë. Por Komiteti Nacionalçlirimtar për Kosovën e Metohinë nuk qe në gjendje ta mbante mbledhjen e tij të dytë për tetëmbëdhjetë muaj rresht, Kur, më në fund arriti ta bënte në Prizren në Jugosllavinë e çliruar, më 8-10 korrik 1945, ai e ndryshoi rezolutën e 1-2 janarit 1944 siç i ishte kërkuar dhe miratoi një rezolutë tjetër në favor të bashkimit të Kosovës e të Metohisë me Republikën Federative të Serbisë brenda një Jugosllavie Federative demokratike dhe me statusin e krahinës autonome⁷). Kjo mund të përshkruhej si një akt vetëvendosjeje në formë, por ishte në thelb një hedhje poshtë e shkëputjes. Është për t'u shënuar që PKJ nuk iu drejtua vetë PKSH për të arritur kthimin e tekstit të padëshiruar, por drejtpërdrejt udhëheqësve partizanë në Kosovë e Metohi, dhe që arritja e këtij kthimi kërkoi një kohë shumë të gjatë e nuk mundi

të kryhej për sa kohë vazhdonte lufta. Këto gjëra janë tregues të vështirësive të mëdha që kishin dy lëvizjet partizane dhe dy partitë komuniste, të Jugosllavisë e të Shqipërisë, për të zgjidhur çështjen në shkallë të lartë nacionaliste të Kosovës, si dhe të mungesës së suksesit në përpjekjet për të ngritur atje një lëvizje partizane. Në rast se partizanët nuk kishin dot sukses, ata nuk i lejonin askujt tjetër që të arrinte sukses në vend të tyre: që këtej vinin sabotimi i pafytyrë i kontakteve të Kempit me vëllezërit Kryeziu në dhjetor 1943 e janar 1944, likuidimi i veprimtarive të Toni Simkoksit me Kryezinjte në verën 1944 dhe vetë shtypja e Kryezinjve. Nuk është e pakuptueshme që PKS-H-LNÇ do ta kenë parë familjen Kryeziu si të dobishme për një farë kohe, nëse PKJ do të ishte e gatshme për të toleruar idenë e shkëputjes. Kryezinjte atëherë do të mund të ndihmonin për t'ia kaluar Shqipërisë një Kosovë nacionaliste dhe (po ta themi me gjak të ftohtë) elimini mi i tyre mund të lihej për më vonë. Por ashtu siç ndodhi, Kosova për atë kohë u bë diçka si një farë zone e ndaluar për këdo, me përjashtim të gjermanëve. Tensionet e nivelit të lartë ndërmjet PKJ dhe PKS-H, që ishin shkaku i kësaj, mbetën të panjohura për oficerët britanikë⁸⁾.

Për fat të mirë, qëndrimi im në Degë ishte i shkurtër. Më 28 dhjetor erdhi një mesazh nga majori Ridell. Atë e solla Mehmet Aliu, bajraktari i Hasit, të cilit ia kishte besuar Muharrem Bajraktari, zoti i Lumës dhe kreu udhëheqës i Shqipërisë Verilindore. Riçard Ridelli e kishte fshehur mesazhin në një kuti shkrepsesh, por Muharremi e kishte fshehur kutinë në një zarf për ta bërë më të rëndësishme. I shoqëruar nga bajraktari i Hasit unë u nisa drejt jugut më 29 dhjetor, i shoqëruar nga dy radistë dhe një radio. Ishim gjithsej dy mushka, tre anglezë, dhe nëntë shqiptarë. Pas shtatë ditësh meshi, po binte dëborë dhe ecja ishte e vështirë. Bajraktari ishte një plak shtatlartë, i fuqishëm, i qeshur, i njohur dhe i respektuar në të gjithë krahinën e Hasit, nëpër të cilën ne po marshonim. Ai bëri çmos që udhëtimi të ishte i kënaqshëm. Ditari im thotë se në qëndresën e parë, në Lenish, (?) ne përherë të parë nisëm të bënim sipas zakoneve të vendit.

«Sipas zakoneve të vendit» ka nevojë për shpjegim. Në shtëpitë e shqiptarëve kishte zakone të caktuara për të pritur mysafirët e huaj. Ata i çonin sipër, zakonisht nëpër një shkallë të jashtme, në dhomën e miqve. Ajo duhej të kishte një oxhak me vatër, në mes të murit përballë derës dhe një shteg nga

dera deri te vatra, që e ndante dhomën në dy pjesë. Dyshe-
meja në disa shtëpi ishte e zhveshur, në disa e shtruar në të
dy anët e shtegut të mesit me rrogoza, në disa me qilima, të
paktën pranë vatrës. Miqtë hiqnin këpucët dhe i vinin mënjanë
armët. Të gjithë uleshin këmbëkryq, ata më të vjetrit ose
më të nderuarit pranë vatrës dhe pastaj sipas një radhe të
përcaktuar për përparësinë deri tutje drejt derës. I zoti i shtë-
pisë ulej përballë zjarrit, që duhej të ndizej menjëherë ose që
mbushej mirë me dru me ardhjen e miqve dhe, pasi shkë-
mbeheshin formulat rituale të përshëndetjes me secilin mysafir,
ai niste të ziente kafe ala turke në vatër dhe të dridhte
cigare. Cigaret i hidheshin një nga një secilit nga miqtë dhe
secilit me radhë i jepen me kujdes filxhani i vogël i kafesë që
kishte mjaft llum në fund, zakonisht duke bërë një gjest me
dorë në zemër i zoti i shtëpisë. Kafeja duhej pirë me zhurmë,
që të tregohej vlerësimi i saj. Biseda duhej bërë me zë të
lartë, por gjëra intime shkëmbeheshin ndërmjet shqiptarëve të
pranishëm, pa treguar shumë respekt për ata që bënin muha-
betin kryesor. Përkthimi ishte një proces i mundimshëm, ve-
çanërisht kur nuk kishte asnjë që të mund ta përballonte për-
kthimin e drejtpërdrejtë ndërmjet shqipes dhe anglishtes dhe
nevojitej të përdorej një gjuhë e tretë, italishtja ose frëngji-
shtja. Kur të pranishmit bëheshin më të njohur me njëri-tje-
trin, edhe formalitetet bëheshin më pak të theksuara e vendos-
ej një atmosferë më e çliruar, dhe atëhere shkëmbimi i ci-
gareve të dredhura mbetej shenja kryesore e mirësjelljes në-
përmjet së cilës vendoseshin marrëdhëniet. Biseda dhe çuçu-
ritjet e vogla do të reshtnin dhe do të dukej shfaqur mërzia,
ndërsa të gjithë prisnin të bëhej gati për të ngrënë. Ky mund
të ishte një proces shumë i ngadaltë, veçanërisht nëse ishte
fjala për të therur një dele a një dhi, për ta rjepur e për ta
zier, ose për të mbytur një pulë, e aq më keq po të ishte ne-
voja për të pjekur bukën. Ndonjëherë kjo ndërkohë e gjatë
mund të lehtësohej duke ia nisur me raki, secili mysafir
merrte një faqore të vogël, me të cilën mbushte gotën e vet
të vogël. Rakia ndryshonte shumë nga cilësia sipas shtëpive,
por ne ishim të gatshëm të pinim pothuaj çdo gjë. Vështirësia
më e madhe, pas një marshimi të gjatë, ishte të qëndroje pa
fjetur deri sa të bëhej darka gati.

Shumë dhoma miqsh i gjenim të mbushura plot kur shko-
nim ne dhe atmosfera mbytej me tym, ndriçimi në rastin më
të mirë bëhej me një a dy llampa vajguri ose me një a dy qirinj
a pishtarë, dhe natyrisht nga zjarri në vatër. Pas disa orësh

pritjeje, futej brenda, duke e rrotulluar brinjazi, një sofër rreth një pëllëmbë e lartë dhe miqtë, ose në qoftë se kishte shumë veta, miqtë kryesorë uleshin këmbëkryq rrotull saj, njëri pas tjetrit me anën e djathtë nga sofa, pasi në fillim kryenin ceremoninë sa për të kaluar radhën, duke i njomur gishtat me ujë që ua hidhnin me ibrik mbi një legen, që e sillte rrotull i zoti i shtëpisë, ose ndonjëri prej djemve a vëllezërve të tij. I zoti i shtëpisë thyente në copa dhe e ndante rrotull sofrës një bukë të madhe të rrumbullakët, zakonisht prej misri, por në shtëpitë e pasura edhe prej thekre ose gruri. Në qendër vihej një sahan ose një tepsi, që në rastin më të mirë ishte e mbushur me një dele a dhi të zier, të vënë mbi një kapule orizi, ose kishte pilaf me copa mishi dashi, dhije ose pule, dhe më shpesh fasule ose lëng me fasule e me ca thërrmija mishi. Në shtëpitë e varfra do të nxirrnin vetëm ca djathë nga djathi i bërë me qumësht deleje, dhije ose lope, e nganjëherë asgjë tjetër veçse hirrë me thërrmija djathi që notonin në të. Të ngrënët ishte një punë gare, në të cilën shqiptarët kishin një përparësi të madhe, sepse kishin gjithë jetën që stërviteshin për ta zgjatur dorën e për të kapur boll, dhe e kishin mjaft të shkathët dorën e djathtë (dora e majtë nuk përdorej për të ngrënë). Pabarazia bëhej më e vogël kur kishte pirunj, por buka e misrit e ngjeshur gjithmonë i bënte anglezët të hanin ngadalë. Kush të donte mund të kërkonte ujë, pastërtia e burimit të fshatit ishte krenari e familjeve shqiptare. Po të kishte shumë miq, ata të sofrës së dytë do të detyroheshin të kënaqeshin me atë që mbetej nga sofa e parë.

Pas darke secili shtrihej menjëherë për të fjetur, zakonisht mbi qilimat me një cergë sipër si mbulesë, por ndonjëherë edhe mbi një farë shtroje mbi dysheme e ndonjëherë drejt e në dyshemenë e zhveshur. Kur dhoma ishte e rrasur plot, secili gjente vend në dy radhët që nga vatra e deri te dera në të dy anët e dhomës. Një zot shtëpie i kujdesshëm do të rrinte këmbëkryq para zjarrit, duke u kujdesur për të parë që miqtë t'i zinte gjumi dhe zakonisht ai do të ishte i pari përsëri me të rënë drita sapo ata zgjoheshin, e mbushte zjarrin përsëri, bënte kafet ose u ngrohte qumësht. Pleshtat, çimkat dhe morrat të hanin të gjallë në të gjitha shtëpitë, me ndonjë përjashtim krejt të veçantë të ndonjë shtëpie luksi, dhe aq më tepër ishte e vështirë t'i hiqje qafe në rrethanat kur çdokush rrinte i veshur e i ngjeshur për disa ditë e net me radhë. Në mëngjes mund të gjeje ujë të ftohtë në një enë të përdorur prej kohësh për të larë shpejt e shpejt duart e faqet.

Nevojtorja do të ishte një kthinë prej dërrasash e ndërtuar në murin e prasëm ose anësor të katit të sipërm të shtëpisë, me një vrimë në dyshtemenë e ndotur, ndërsa në katin përdhes të shtëpisë pranë murit ngrihej kapica e plehut. Kur ne qëndronim për dy a tri ditë ose më shumë në një shtëpi, krijohej mundësia që të bëheshin disa ndryshime në rregullat e geverisjes së shtëpisë, me qëllim që t'u përshtateshin kërkesave dhe shijeve tona, si dhe për të arritur një farë larmie të ushqimit, por ne nuk nisëm të bëheshim të zotët e jetës sonë të përditshme dhe të ushqimit, deri sa erdhi koha të jetonim jashtë në pranverë me një personel mbështetës italianësh (një furrar, një gjellëbërës, një berber, një kryekamerier nga një mensë) dhe disa shqiptarë si mushkarë, korrierë, pazarakë dhe për shërbime të tjera. Faqet e ditarit tim përmbajnë diçka për ushqimin pothuaj çdo ditë. Asnjëherë nuk na hiqeshin nga koka mendimet për ushqimin: asnjëherë nuk mund ta quanim të garantuar. Një pjesë të madhe të vëmendjes sonë e zinte gjetja, aty-këtu, e gjërave të thjeshta për të ngrënë dhe e llojeve nga më të ndryshme të dietës shqiptare me bukë misri. Ishte një ekzistencë në nivelin më të ulët.

Nja dy faqe nga ditari e tregojnë se si nisën udhëtimet e mia nëpër Shqipëri:

«30 dhjetor. Ne shkojmë në Helshan dhe flemë në shtëpinë e bajraktarit. Na trajtojnë mirë dhe duket qartë se po rrugëtojmë nën një mbrojtje nga më të mirat. Ne kemi nevojë për këtë, sepse fshati nationalist ka dyshime për veprimet e anglezëve dhe për djegien e shtëpive nga gjermanët. Mushkat nuk janë aq të mira, njëra ka plagë të rënda nga pajimet, tjetrës i kanë humbur tre patkonj. Kurse shqiptarët tanë janë tepër dembelë që të na ndihmojnë për t'i rregulluar.

31 Dhjetor 1943. Ne marsojmë drejt rrugës së Kukësit dhe e kapërcejmë natën, pasi kalojmë Drinin me trap në Vaun e Spasit. Luajmë një komedi të madhe heshtjeje dhe fshehtësie ndërsa kapërcejmë rrugën, por dy kamionë me trupa gjermane marrin kthesën prapa nesh kur po kalonim dyzet-pesëdhjetë metrat jetike të urës dhe të rrugës ndërmjet dy shtigjeve tona malore. Ne kërcejmë mbi buzën e urës, e cila për fat të mirë është vetëm afër dy metër e gjysmë nga ana ime. Kur hedh sytë lart, shoh cigaret e armikut që xixëllojnë në kamionat, të cilët na kalojnë pak metra më tutje. Të gjitha shanset janë në favorin tonë, por shqiptarët tmerrohen. Po të ndalonin kamionët, të tre anglezët do të ndodheshin fare vetëm. Mehmet Ali Bajraktari më përqafton shumë bujarisht, duke shprehur lehtësimin e tij të madh dhe ne ecim nëpër natë, nëpër shtigje të këqija drejt një kasolleje mali, ku

hamë e çlodhemi, të shqetësuar vetëm nga një zjarr sipër në çati për njëzet minuta. Kështu e presim të vijë viti i ri».

Ditën e vitit të ri ne u nisëm për marshim para agimit dhe pas pak arritëm në territorin e Muharrem Bajraktarit. Më 2 janar erdhëm në shtëpinë e tij pranë Ujmishtit. Ai na priti me nderime dhe nisi bisedën për politikën në një frëngjishte me shumë fjalë por me veçanti individuale, ndërsa djemtë e tij dhe i vëllai e merrnin fjalën për rastet e mirësjelljes. Përfituam luksin që të flinim në dyshek dhe jorgan në një dhomë veçan nga shumë shqiptarë që ishin aty. Këtë përvojë të rrallë do të më takonte ta gëzoja edhe dy a tri herë deri sa doli dimri. Komenti fillestar i ditarit tim për Muharremin thotë se ai kishte një mendje të mirë për punë, por nuk ishte njeri i këndshëm, dhe se kishte ambicje shumë të larta për veten në Shqipëri.

Nga kjo shtëpi unë dhe dy sinjalizuesit e vazhduam marshimin më 3 janar, me një grup shoqëruesish nga njerëzit e Muharremit. Të nesërmen na çuan në një shtëpi ku rrinin majori Ridell, kapiteni Toni Simkoks dhe kapiteni Majkëll Lis; aty unë u bëra anëtar i ri i Misionit Stables, që dukej se ishte një shoqëri e mirë. Ishim në fshatin e Kalisit, «një luginë e bukur, me një sfond plepash në livadhet e pjerrëta ngjyrë bari të errët, dhe ne e soditnim atë nën dëborë kur shkëlqen dielli, plot me veshje fshatare të shkëlqyera dhe me muzikën e fyejve shqiptarë si të ngjirur, një bashkim i Pol Nashit dhe Brojgëlit (Paul Nash dhe Breughel») Na zieu shpejt një ponç rakië dhe, siç ndodhte gjithmonë kur takoheshin oficerët britanikë në Shqipëri, nisëm të shkëmbenim lajmet për disa orë pa mbarim.

Misioni Stables nuk kishte një bazë të ngulur dhe ende varej shumë nga mbështetja dhe mbrojtja e familjes Ndreu, pasi djegia e shtëpive të tyre në nëntor i kishte shpërndarë oficerët britanikë dhe i kishte dhënë fund rezistencës në zonën e Peshkopisë. Xhelal Ndreu, një nga djemtë e Cen Elezit, vepronte si përkthyes dhe organizues i një bishti të pakëndshëm pasuesish parazitë. Dukej se ai po luante një farë loje të dyshimtë. Me ardhjen e një radioje të re dhe të dy radistëve, Ridelli dhe Simkoksi po mendonin për ta përtërirë veprimtarinë, porse radistët arrinin ta kapnin Kajron vetëm rastësisht dhe ne kishim vetëm një ngarkues me dorë për bateritë. Synimi i parë ishte që të merrnim një hedhje ajrore me furnizime. Kjo na doli një përvojë zhgënjyese. Nga 5 janari ra një dëborë

e rëndë. Neve na u desh të zhvendoseshim shpesh nga një shtëpi në tjetrën dhe kërkesat financiare të zotërve të shtëpive u bënë rrjepëse. Sheshi i zgjedhur për hedhjen ishte afër fshatit Dardhë, por katundarët ose ishin ose pretendonin se ishin të frikësuar nga gjermanët dhe frika e tyre duhej të zbutej përkohësisht nga pagesat me para në dorë për gjithçka kishim nevojë. Radistët punonin në kushte shumë të vështira, të rrasur në një kasolle me njerëz të padëshirueshëm që u qepeshin pas. Na erdhi një përkthyes i ri ose i dytë, Ali Dika, gjithashtu një anëtar i familjes Ndreu, por armik me Cen Elezin, i afërt me një familje tjetër «nacionaliste» me influencë, Litat, dhe, në mënyrë paradoksale, ai u pëlqente partizanëve. Tipari i tij karakteristik ishte mungesa e trimërisë, gjë që e vinte në pikëpyetje dobinë e tij kur ta kishim pisk punën.

Natën e 14-15 janarit dy aeroplanë na hodhën furnizime, njëri për mrekulli nga lartësia 270 metra dhe tjetri për fat të keq nga lartësia 1800 metra dhe rreth një kilometër larg zjarreve tona. Menjëherë njerëzit e fshatrave rrotull nisën grabitjen e tyre, të nxitur nga krerët më të vegjël, të cilët mendohej se ishin të gjithë besnikë të Cen Elezit. Unë për vete qëllova kundër njërit prej grabitësve dhe ai ua mbathi. Ne ia dolëm të mblihdhnim afërsisht ngarkesën e njërit aeroplan dhe e vendosëm në kasollen tonë, por banorët e Dardhës nuk na lejuan ta merrnim me vete. Riçard Ridelli kishte ikur për një rikonjicion në drejtim të Macukullit, duke u përpjekur por pa sukses që të merrte lajme për misionin e kuartierit, dhe tani po kthehej duke sjellë me vete Majkëll Lisin, rreshterin Gregson Ollkotin dhe tetarin Dejvis. Ai shoqërohej nga Dan Kaloshi me një tufë të njerëzve të tij. Ata nuk kishin qejf të zreshin me njerëzit e Dardhës. Pasi u grindëm mjaft, ne nuk e zgjatëm më kot dhe u përvodhëm nëpër një shteg nga prapa me ato pak gjëra që mund të mbanim mbi kurriz. Pas dy a tri ditësh, pësjtjellimi u qetësua dhe ne rifilluam mënyrën e zakonshme, duke u zhvendosur nga një fshat në tjetrin dhe nga një shtëpi në tjetrën, sipas qëndrimit të ngrohtë ose të ftohtë nga grupet e njerëzit e ndryshëm. Rrallë kishim sukses që radion dhe radistët t'i rregullonim në një vend pa u shpërngulur për më shumë se tri ose katër ditë radhazi.

Riçard Ridelli kishte hyrë në kontakt me një tjetër BLO, kapitenin Bulman, gjatë rrugës që bëri deri në Macukull, dhe kishte marrë prej tij lajme për majorin Sejmur dhe togerin Smith, për të cilët na ishte thënë se që të dy ishin keq me shëndet. Bulmani dhe Smithi kishin qenë ndër oficerët e shu-

mtë, të cilët erdhën me gjeneralin Dejvis dhe me misionin e kuartierit në tetor 1943. Bulmani ishte dërguar për të studiuar mundësitë e fushës bregdetare në përfundim të Tiranës dhe Smithi ishte dërguar të punonte me Nilin (Slender). Pas shkatërrimit të misioneve Sconce dhe Stepmother në nëntor radioja e Nilit kishte qenë e vetmja që shpëtoi në qendër të vendit. Nili u shpërngul drejt veriut dhe mori togerin Merret si ndihmës, bashkë me një radio të re, nga furnizimet tona në Degë. Bulmani dhe Smithi u ngarkuan me misionin Slender dhe vëpruan në zonat zogiste të Krujës e të Matit.

Në atë kohë askush prej nesh të misionit Stables, as ata të misionit Slender, as Hendzi, Kempji ose Nili nuk dinin për katastrofën që kishin pësuar gjenerali Dejvis, Koloneli Nikols dhe misioni i kuartierit më 8 janar. Porse ne po i mësonim nga përvoja e rëndë efektet copëzuese mbi shoqërinë shqiptare të ofensivës gjermane të dimrit. Ajo gati sa nuk i kishte shkatërruar partizanët dhe asnjëri prej nesh në Veri nuk mund të shihte asnjë shpresë për të arritur diçka kundër gjermanëve, duke u vënë përkrah çetave të vogla partizane që ende ekzistonin. Në vend të kësaj, ne iu kthyem mendimit për t'u përpjekur që të arrinin ndonjë lloj mirëkuptimi me krerët nacionalistë, sipas të cilit ata do të ndërmerren aksione kundër gjermanëve dhe do ta rregullonin që furnizimet nga ajri të mbështesnin forcat e tyre. Pështjellimi që kishin shkaktuar gjermanët ishte pothuaj total: dora e çdo njeriu dukej sikur ishte gati të kthehej kundër fqinjit të tij, dhe me siguri kthehej kundër tij sapo ai t'i kthente shpinën për një çast. Ne të BLO shpesh vinim në përfundimin e dëshpëruar se kjo situatë ishte endemike për Shqipërinë. Shumë gjëra nga rrethanat tona na e bënë të vështirë që ta mendonim ndryshe. Megjithatë për atë kohë ne ishim të mbërthyer aty ku u ndodhëm dhe etja e natyrshme për aksion na shtynte që të përpiqeshim me optimizëm të ngrinim një farë ndërtese rezistence, që mund të sillte rezultate praktike në pranverë dhe në verë.

Brenda disa javësh ne e mësuam copa-copa shkatërrimin e misionit të kuartierit, e rrokëm ngadalë gjerësinë e traumës që i kishte shkaktuar përcaktimit të politikës britanike dhe u hymë përpjekjeve për të përmirësuar iniciativat tona lokale për të rifilluar procesin e rezistencës. Në zonën e Stables kishte katër emra kryesorë, që ne u përpoqëm t'i tërhiqnim. Aty ishte familja Ndreu, me Cen Elezin në krye, ku njeriun kryesor për lidhjet kishim Xhelalin, tek i cili nuk mund të kishe besim.

Aty ishte familja Lita, me Osman Litën në krye, zona e së cilës ishte pak më larg në veri dhe më shumë në malësi se sa ajo Ndreu. Edhe më tej drejt veriut, ishte Muharrem Bajraktari. Duke gjykuar nga të dhënat e tij të ngatërruara, ai përbënte materialin më premtues nga të gjithë për rezistencën. Në jug të zonës, më afër Peshkopisë, ishte Dan Kaloshi, i cili kishte influencë ndërmjet një numri krerësh më të vegjël dhe e kishte derën të hapur te Fiqri Dineja, udhëheqësi i krerëve të Dibrës. Faqet e ditarit tim për periudhën deri në prill tregojnë se si ne e kaluam dimrin duke u zhvendosur ndërmjet këtyre forcave të ndryshme, nganjëherë me shpresë të pamëshetur se mund të merreshim vesh me ta, nganjëherë pesimistë fare të pashpresë, dhe se si në fund ne nuk patëm sukses në asgjë, me përjashtim të marrëdhënieve personale. Ricard Ridell, drejtuesi i misionit, i shtriu një pjesë të mirë të përpjekjeve në pjesën jugore të zonës. Toni Simkoksi, duke pasur ndihmën time, u përqendrua më shumë te Muharrem Bajraktari. Majkëll Lisi u specializua për familjen Lita.

Të parin, nga shumë takime me Muharrem Bajraktarin, e patëm më 19 janar. Ai tha se po shkruante një raport, të cilin dëshironte t'ia dërgonte z. Çurçill dhe z. Iden. Idetë e tij për pozitën që mund të aspironte dukej qartë se ishin shumë të mëdha. Në atë radhë ai deshi që të na përulte ne. Ditën tjetër u rishfaq Xhelal Ndreu, i shoqëruar nga Sherif Lita, ndërli-dhësi ynë kryesor me familjen Lita. Edhe ata deshën të na vinin poshtë. Sherifi kishte sjellë një gazetë të Tiranës të 16 janarit, që njoftonte plagosjen dhe kapjen e «Trocki» Dejvisit më 8 janar, dhe ai na tha për fletushkat që hidhnin gjermanët në luginën e Drinit për ta paralajmëruar popullsinë kundër nesh. Më 22 janar bëmë një marshim të rëndë për të takuar Esat Ndreun dhe disa nga partizanët e tij në shtëpinë e Ali Dikës. Përkthimin na e bëri mirë Qazim Prishtina, i cili rastisi të bëhej interpretuesi i misionit tonë kur do të punonim me partizanët disa muaj më vonë. Rezultati kryesor i këtij takimi ishte që mua më dërguan të shoqëruar nga katër partizanë për të parë nëse mund të gjeja njerëz të shpëtuar prej misionit të kuartierit në zonën e Martaneshit, ku mendohej se Baba Faja duhej të kujdesej për ta.

Ishte një marshim raskapitës dhe zgjati pesë ditë. Pjesën më të madhe të rrugës e bëmë në errësirë, disa herë në shi e në dëborë, por nganjëherë edhe natën me yje, kurse çdo natë ecnim nga tetë deri në dymbëdhjetë orë. Partizanët ishin nervozë dhe ngulmonin që gjatë ditës të binim për të

pushuar në shtëpi miqsh. Ata kërkuan që unë të rrugëtoja me rroba fshatare, por unë këmbëngula se do t'u bindesha rregullave dhe do ta mbaja uniformën. Në një fshat më akuzuan se isha jugosllav, meqë isha me partizanët, por ia dola në krye që t'i bindja banorët e vendit se isha një oficer britanik i padëmshëm. Partizanët lexonin materiale propagandistike dhe flisnin me zë të lartë rreth propagandës me njëri-tjetrin gjatë orëve pa gjumë, gjë që na u bë shumë e bezdisshme. Ushqimin dhe pijet i kishim me pakicë si spartanët, por unë qeshë në gjendje të paguaja me para për të siguruar një sasi rakisë, duhani dhe, për çudi, bonbonesh. Ne i kaluam anës Peshkopisë e Dibrës, por përdorëm rrugën gjithë gurë ndërmyjet tyre dhe pastaj rrugën Dibër-Klos në orët e qeta të natës. Mora me qira një kalë për të kapërcyer Drinin. Kishte shumë zëra për patrullat gjermane, por nuk pamë gjë. Në këtë kohë unë punoja për të marrë vesh italishten dhe e përdorja për të komunikuar me shoqëruesit. Më në fund, më 27 janar, ndeshëm një grup partizanësh në Gurin e Bardhë, të cilët na drejtuan në Xibër, ku ata mendonin se ishte një oficer britanik. Komisari i tyre politik na tha se Shtabi i Përgjithshëm i LNC kishte ikur drejt jugut të Shqipërisë dhe ai i urdhëroi edhe katër partizanët e mi që të marshonin drejt jugut. Ai vetë më çoi në Xibër dhe atje gjetëm Smithin të ngarkuar me misionin Slender, të rrethuar prej zogistëve. Përsëndetja me zë tingëllues e shoqëruesit tonë «Vdekje fashizmit» (përgjigja e rregullt sipas partizanëve duhej të ishte «Liri popullit!») u prit me heshtje. Mund të kishte ndodhur edhe më keq. Me sa duket, komisari më kishte shfrytëzuar mua si pretekst për të hedhur një sy në *entente* anglo-zogiste në Xibër, pastaj menjëherë u largua.

Të nesërmen erdhi kapiteni Bulman; ai edhe Smithi më treguan se çfarë dinin për shpërndarjen e misionit të kuartierit dhe për shpëtimin e kolonelit Nikols (por koloneli Nikols në fakt, ndoshta, kishte vdekur deri atëhere). Radioja e tyre nuk punonte dhe ata më dhanë mesazhe për t'i transmetuar nëpërmjet radios së Stables, në rast se unë do të kthehesha para se sa radioja e tyre të vendoste ndërlidhjen. Ata dhe katër nënoficerët e sinjalizuesit e tyre po bënë një jetë mjaft të rhatshme, por e ndienin veten se gjenin shumë pengesa. Bulmani që ishte më pak i shoqërueshëm se Smithi, u shpreh me shumë zemërimin për vendin dhe për njerëzit. Në ato ditë ne mund të dëgjonim gjëmime të rastit nga bombardimet e

rënda në drejtim të Tiranës e të Durrësit, me sa duket të bëra nga RAF.

Pas një dite me Thatimin, unë iu vura rrugës për t'u kthyer nën mbrojtjen e zogistëve, duke marrë një drejtim më nga veriu dhe nëpër vise më malore. Marshimi ishte më i ngeshëm, nuk kishte nevojë të fshihesha, ushqimi e pijet ishin të mira e me shumicë, por fjetja ishte gjithnjë me shumë veta, sepse çdo zot shtëpie e kthente atë në një darkë me të ftuar. Ditët tona ishin pak a shumë një ngjitje afër një kilometër përpjetë dhe zhytja afër një kilometër poshtë e pastaj përsëri po kjo punë e kjo përsëritej përmes dëborës vezulluese nën diellin e ndritshëm. Pejzazhi ishte i mrekullueshëm, siç e kam shënuar në ditar: «Prapa nesh është një pamje e bukur me male blu e lugina ngjyrë kafeje, me vezullime aty-këtu të përrenjve e të kulmeve të shtëpive. Në pyjet e larta qetësia dhe shkëlqimi janë të përkryera». Ne marshuam në drejtimin Lis-Macukull-Lurë dhe e arritëm Drinin në Reç brenda katër ditësh. Toni Simkoxsin e gjeta më 2 shkurt në Kalis me radion. Ai nuk ishte mirë dhe kishte pasur fërkime ndërmjet radistëve tanë dhe banorëve vendës. Lëvizjet shumë të shpeshta nga një shtëpi ose nga një fshat në tjetrin, ishin të pashmangshme për të mbajtur sjelljen dhe qëndrimet e të dyja palëve brenda caqeve të tolerueshme.

Mëngjesin e 3 shkurtit ne pamë se burrat e Kalisit po bënë një kuvend për «besë», që do të thotë armëpushim ose paqe, e cila i imponohet ose pranohet nga një bashkësi për t'i dhënë fund ose për ta parandaluar një veprim të dhunshëm. Doli se qëllimi i tij ishte për ta shtrënguar mikpritësin tonë, Mersin Matjen, që të hiqte qafe miqtë e tij britanikë të rrezikshëm. Mersini na largoi në një kasolle pa ngrohje, ndërsa vetë e kundërshtoi në atë stilin e malësorëve shqiptarë sfidën e armiqve të tij, me disa prej të cilëve ai ishte prej kohësh në gjak. Ai doli jashtë dhe e vrau njërin. Shumë shpejt ne na rrethuan katundarët dhe me dritën e parë të mëngjesit të datës 4, shtëpia ra nën një zjarr të dendur pushkësh, ndërsa më vonë në mëngjes nën zjarrin e automatikëve. Në një farë mënyre kjo nuk ishte shumë e rrezikshme, për shkak se frika (apo fjala më e drejtë do të ishte për shkak të kujdesit?) i përmbante rrethuesit që të mos e sulmonin shtëpinë, pikërisht meqë Mersini kishte sulmuar duke e qëlluar tjetrin nga prapa. Gjithë plumbat goditën katin e sipërm, muret ishin të trasha dhe dritaret ishin si frëngji. Unë i pata shkruar një thirrje Muharrem Bajraktarit mbrëmjen e kaluar me stilin tim më të

mirë frëngjisht dhe darkën e datës 4 ai erdhi me një shpurë të fortë burrash, i detyroi të bënin armëpushim, i bëri edhe një gjyq të shpejtë Mersinit, duke e dënuar që t'i digjeshin shtëpia e stallat, dhe na mori me vete pasi ra errësira në një fshat lart në kodra. Kur ne po largoheshim, flakët e përfshinë shtëpinë e Mersinit në acarin e mesit të dimrit. Muharremi u grind që ne nuk kishim qëndruar mënjanë.

Ditari im për 3 shkurtin shënon një diskutim për gjendjen në Shqipëri, të cilin ne e bëmë me Toni Simkoxsin në kasollen e ftohtë e të uritur:

«Ne po diskutojmë për Shqipërinë dhe jemi të një mendimi se gjendja duket e keqe. Kuartieri i përgjithshëm është shkatërruar. Koloneli Nikols është fshehur me këmbët të ngrira keq e të gangrenizuara pas nëntë netësh të tmerrshme nëpër male. Hejri do të shkojë në Kajro për të shpjeguar se politika e «Troçkit» që të shpallemi në favor të LNÇ, është pa shpresë, ndërsa misionet Slender dhe Stables nuk kanë ndërlikime me radio, kështu që nuk mund ta shpjegojnë politikën e re të Nikolsit për të ndihmuar zogistët dhe gjithë elementët e rezistencës. Sejmurit është premtuar që të bëhet G1 (shef shtabi për të zëvendësuar Nikolsin) i ri për ne, ndërsa është e qartë se Kempit është më i përshatshëm për këtë detyrë. Dhe nuk ka ndërlikime ndërmjet misioneve në veri dhe në jug. Do të jetë një mrekulli nëse do të ketë ndonjëherë një rezistencë efektive kundër gjermanëve në Shqipëri.

Në zonën tonë të Peshkopisë forcat partizane janë të papërfillshme dhe të bllokuara ngaqë nuk kanë popullaritet. Toni dhe unë besojmë se njerëzit këtu kurrë nuk do të ngrihen dhe udhëheqës si Cen Elezi dhe Dan Kaloshi kurrë nuk do të lëvizin. Shpresat tona të vetme që na mbeten janë të Muharrem Bajraktari dhe Fiqri Dineja, dhe të komiteti i tij progjerman. Asnjëri prej tyre nuk paraqet perspektiva të shkëlqyera, por megjithatë ne ende po bëjmë bisedime me ta. Njerëzit këtu kanë frikë nga gjermanët, por ata e dinë se nuk do ta pësojnë nga duart e gjermanëve, nëse do të rrijnë urtë. Dhe nëse ata dëshirojnë që t'i shohin gjermanët të qërohen nga vendi i tyre, ata janë njësoj të bindur se Anglia dhe Amerika mund ta arrijnë këtë pa ndihmën e tyre. I vetmi shqetësim i tyre është ta përdorin ndihmën britanike për të zgjidhur me anë të forcës grindjet e tyre politike dhe të përgatiten për të kërkuar pjesë nga Greqia dhe Jugosllavia pas lufte. Ky ishte qëndrimi i udhëheqësve kundrejt nesh: njerëzit e zakonshëm na shohin vetëm si një burim për fitime financiare dhe si viktima të përshatshme, duke e këmbyer mikpritjen me grabitjen. Është e qenësishme të kuptohet, se nuk ekziston vullneti për të luftuar kundër gjermanëve në këtë vend: vetëm zbarkimi i një forcë aleate do

t'i bindë këta njerëz që të na pasojnë, tepër vonë. Ky vend është i përshtatshëm vetëm për një numër oficerësh shtegtues, që të mbledhin informata dhe të përhapin propagandën: një mision më i madh ushtarak si yni është një farsë. Kjo keqësohet edhe më nga dështimi i Kajros për të siguruar përkthyes pa ndonjë ndërlikim politik në vend. Kjo luftë, që mendohet se po e zhvillojmë ne, është plotësisht fiktive, dhe ekzekutohet me kaq solemnitet nga të gjitha palët, sa e bën fare komedi».

Riçard Ridelli ishte larguar në këtë kohë me Dan Kaloshin, më afër Peshkopisë. Kjo nuk i pëlqente Muharremit, sepse ai kishte panifikuar një kuvend të krerëve të zonës dhe fliste se do të paraqiste Fiqri Dinen, kreun më të rëndësishëm të zonës së Dibrës. Ai dëshironte ta tregonte sheshit se ai, Muharremi, gëzonte favoret e britanikëve. Ne e bindëm që Toni Simkoksi i kishte të gjitha lajmet e fundit për veprimtaritë e anglezëve (lajmet që unë kisha sjellë nga Slender) dhe mund t'i siguronte praninë angleze që ai e dëshironte. Më 6 shkurt ne marshuam për dy orë pas errësimit nëpër një erë therëse e të akullt deri në një shtëpi lart në kodra, afër zonës së familjes Lita. Aty gjetëm Muharremin me Cen Elezin dhe tre nga djemtë e tij, por nuk ishte Fiqri Dineja. Mledhja u kufizua me Muharremin dhe pasuesit e tij kryesorë, si dhe me familjen Ndreu me pasuesit e saj. Ne u ankuam prerazi te Ceni për mënyrën se si na kishin trajtuar në zonën e tij dhe pastaj dëgjuam Muharremin që paraqiti një plan të zburuar për një kryengritje të kombinuar të fiseve, të mbështetur në furnizime të rëndësishme angleze, të hedhura me parashutë. Ne i dhamë zemër që ai të shkruante një letër, të cilën ai na e premtoi, në mënyrë që idetë e tij të mund të çmoheshin si duhet.

Muharremi u nis herët në mëngjes. Ai u përkujdes që të mos e shihnin pranë nesh në dritën e ditës. Ai na porositi që ta mbanim fshehur radion tonë, por Xhelal Ndreu hyri te radistët tanë duke u dhënë fund mendimeve për fshehtësinë. Në këtë moment u bë e gjallë familja Lita. Majkëll Lisi u kthye me një letër nga Sherif Lita, «balli» i dukshëm i familjes, që sillte një protestë gjithë zemërim nga Osmani, kreu i familjes, kundër reshperimit tonë me Muharremin (armikun e tij) dhe Cenin (që zor se e kishte mik) në territorin e tij. Ai bënte këcënim për të na dëbuar. Xhelali, të cilit nuk mund t'i besohej, vijoi të tregonte një interesim të sëmurë për radion dhe radistët tanë dhe ne e dinim se ai mbante lidhje

me Sherifin. Ndërkaq për ne u tregua një kujdes i madh (qumësht, bukë gruri, mollë, arra, dyshekë e jorganë) në një shtëpi të mirë në Ceren me urdhër të Muharremit. Jashtë bënte të ftohtë i madh dhe kishte rënë dëborë e rëndë. Erdhi Riçard Ridelli dhe kaloi dy ditë me ne, para se të kthehej te Dan Kaloshi. Ai kishte shumë shpresë se Dani mund të përgatitej për të vepruar kundër gjermanëve kur të përmirësohej moti, ndërsa kishte dyshime për Muharremin. Toni Simkoksi dhe unë ishim skeptikë për Danin.

Pjesën që mbeti të shkurtit, ne vazhduam të endeshim tutje e tëhu nga një shtëpi në tjetrën, herë të rehatshme e herë jo, por gjithmonë me vështirësitë për të sistemuar radion dhe radistët. Morali dhe disiplina e tyre shkonin drejt rënies, kur oraret e caktuara për radion dilnin disa herë radhazi pa sukses, megjithëse ishin shpenzuar aq orë të gjata për të ngarkuar bateritë me forcën e krahut, ndërsa jeta e tyre e rrallitur në shtëpitë shqiptare mund të krahasohej me banimin e përhershëm në shpella. E vetmja çlodhje e tyre ishin të ngrënët, të pirët dhe loja me letra, ndërsa të gjitha këto nuk ishin as me cilësi dhe as të larmishme. Toni Simkoksi, Majkëll Lisi dhe unë ishim në gjendje ta thyenim pak këtë gjendje, nëpërmjet kontakteve dhe duke bërë udhëtime të rasit për t'i mbajtur ato të freskëta. Që të gjithë kishim zënë morra dhe në të gjitha shtëpitë na sulmonin herë më shumë e herë më pak çimkat e pleshtat. Moti ishte shumë i keq dhe, ngaqë mikpritësit tanë ngulmonin që ne të lëviznim vetëm natën, ishim të detyruar të bënim disa marshime shumë të mundimshme në dëborë e në akull dhe në errësirë të plotë nëpër shtigje malore. Ne në fakt nuk kishim asnjë teshë tjetër veç rrobave që i mbanim vazhdimisht veshur, por kur lëvizte radioja na duhej ta mbanim në kurriz, bashkë me bateritë, makinën e ngarkimit dhe regjistrat e radiogrameve. Toni Simkoksi dhe unë erdhëm te një shtëpi të bërë qull deri në palcë dhe një herë të vetme i hoqëm pantallonat për natën, duke i vënë si jastëk nën kokë. Duhet të kemi bërë një gjumë shumë të rëndë. Gjatë natës gjashtëmbëdhjetë monedha floriri nga një stërlinë dhe dymbëdhjetë napolona flori na i kishin përlarë nga xhepat e vegjël. Kur u zbulua kjo, u prishën keq marrëdhëniet tona me familjen mikpritëse dhe me gjithë fafësin e tyre. Humbja e rezervave të hedhura në Dardhë në janar vazhdon të shkaktonte tensione, meqë Xhelal Ndreu ia hidhte fajin Ali Dikës dhe ky, me më shumë të drejtë, fajësonte Xhelalin. Shqiptarë të ndryshëm na sillnin gjëra nga rezervat e vje-

dhura dhe kërkonin të na i shisin. Ne dërguam nja dy nga pasuesit tanë për të bërë pazar në qytet dhe ata na sollën disa gjëra që ishin luks për ne, si sheqer, rrush të thatë, duhan e madje një herë edhe portokaj. Pati edhe një ngjarje të jashtme për t'u shënuar. Një farë dallge e përshkoi krahinën përreth, kur një prej familjes Lita përhapsi lajmin se gjermanët do t'i armatosnin shqiptarët në Kosovë për të luftuar kundër serbëve dhe Titos. Kjo ishte një luftë që ngjalli entuziazëm të vërtetë. Paralajmërimet tona kundër kësaj u pritën me heshtje.

Ditën kur unë mbushja 22 vjeç, më 21 shkurt, fati ynë nga të ftohtët e ashpër, telashet e jetesës dhe dieta vetëm me bukë misri në shtëpi të varfra, ktheu te një luks në krahë me to në shtëpinë e Muharrem Bajraktarit, ku kishte darkë të rregullt, raki të mirë e madje kafe të vërtetë. Muharremi na kishte njoftuar se letra ose raporti i tij ishte gati dhe ne na kishte thirrur për ta marrë. Ai na takoi me lajmin se Andi Hendzin dhe partizanët i kishin dëbuar nga Dega dhe se hoxha i fshatit ishte djegur brenda në xhami. Po mendohesha se sa nga teshat e mia personale, të vjedhura në sheshin e hedhjes, do t'i kenë përçarë flakët bashkë me të. Thuhej se Hendzi dhe Merreti ishin shëndoshë afër Berishës, por pa radio. Kur në kohën e duhur Hendzi raportoi në Seksionin shqiptar të Barit, ka thënë se misioni i tij ra nën sulmet e gjermanëve më 13 janar dhe partizanët, nga mbrojtja e të cilëve varej ai, ishin zhdukur.⁹⁾ Sipas Muharremit, Nili ishte i sëmurë por kishte shpëtuar diku, ndërsa Kempri po çante rrugën drejt veriut në Mal të Zi për ta evakuar. Mbetej vetëm Hiberdini në kufirin me Kosovën. Një lajm tjetër interesant ishte se një grup me krerë shqiptarë kishte ardhur nga Prizreni për të kërkuar ndihmë kundër Mihajloviçit dhe çetnikëve të tij, për të cilët thuhej se po pushtonin Kosovën. Toni Simkoxi bëri me këta krerë një bisedë për t'u dhënë zemër, duke u kërkuar që të shihnin si armikun e tyre gjermanët e jo serbët.

Në bisedat e gjata me Muharremin, ne bëmë një farë përparimi për t'i zdruguar pak ambicjet e tij dhe për ta bërë që të mendonte se çfarë mund të ndërmernte për t'u nxjerrë telashe gjermanëve në Kukës, si qyteti më i afërt, por ai u bënte bisht gjërave të tilla praktike sa herë e kishte në dorë fillin e bisedës. Më 23 shkurt Simkoxi dhe Lisi u nisën për t'i raportuar Ridellit dhe për t'u lidhur me radio. Mua më lanë që të përktheja letrën e Muharremit, të shkruar shqip. Unë e

bëra nëpërmjet frëngjishtes e italishtes, duke më dhënë Muharremi versionin e tij në një frëngjishte laramane, ndërsa i biri më jepte ndreqjet e hollësishme italisht. Unë pata kënaqësinë e rrallë që të mbetesh plotësisht vetëm për disa orë, duke bërë punën time më tej. Kur përkthimi po e merrte trajtën e vet, e mendova me keqardhje se si do të qeshte Ridelli, kur ta shihte se çfarë fantazie kishte dalë prej punës së kujdeshme nga ana ime dhe e Tonit me Muharremin.

«Raporti» i Muharremit botohet këtu në fund si Shtojca 1. Ai e meriton të vihet në arkiv si një monument i mungesës së realizmit në qëndrimet dhe të menduarit e «nacionalistëve» gjatë kohës së luftës. Duke e vështruar veten si zëdhënës të gjithë kombit shqiptar, Muharrem Bajraktari nuk kishte dëshirë t'i drejtohej një komandanti aleat, madje as komandantit të Forcës 133 apo një oficeri të thjeshtë britanik të ndërlidhjes. Ai ngulmonte që të paraqiste një disertacion historik e politik, përpara se të hynte në diskutimin e planeve të hollësishme për veprime, kështu pra e vinte qerren para qeve. Ai e ofronte Shqipërinë dhe popullin shqiptar si pikënisjen për politikën e ardhshme në Ballkan, pavarësisht nga fakti kokëfortë se gjendja si satet e Shqipërisë në atë kohë ishte e pasigurtë dhe më pak e njohur në Ballkan dhe në gjithë Europën. Politika që ai mendonte se do ta vlente, ishte një politikë e drejtpërdrejtë antisllave, antiserbe, antikomuniste, që harronte detyrimet e shprehura të Britanisë së Madhe më 1944 kundrejt Bashkimit Sovjetik si aleat bashkëluftues, ndaj Jugosllavisë si viktimë e shkretuar në mënyrën më të egër nga Gjermania në Ballkan, dhe kundrejt çdo force tjetër që kishte marrë armët kundër Gjermanisë, duke iu përgjigjur thirrjes së aleatëve, pavarësisht nga përkatësitë politike. Ai po fliste në shkurt për të bërë një kryengritje kundër pushtuesit gjerman në prill ose maj, vetëm pas dy-tre muajsh më vonë, në një vend ku mungonte infrastruktura logjistike dhe që kishte komunikacionet më të këqija që mund të përfytyrohen. Kryengritja do të kushtëzohej me një përgjigje të plotë nga ana e Aleatëve për një listë nga më ambiciozet me mallra, ndër të cilat ndoshta gjëja më e lehtë për ta plotësuar do të ishte kërkesa për rreth 500.000 ose 1.000.000 lira stërlina të dhëna si para në dorë. Për të gjitha këto Muharremi nuk largohej nga normat e zakonshme «nacionaliste». I vetmi dallim ndërmjet tij dhe udhëheqësve të tjerë «nacionalistë», ishte se ai i hodhi në letër në mënyrë koherente dhe të ngjeshur ato gjëra, të cilat të tjerët i shpallnin

gojarisht, në mënyrë jokohërente dhe me zgjatje pa mbarim. Nëse do të kishte qenë në gjendje të shkruante, edhe Abaz Kupi do të kishte bërë diçka të ngjashme me këtë, vetëm duke shtuar mjaft gjëra për mbretin Zog.

Mund të shprehet habia përse ne, oficerët britanikë të misionit Stables, ia bëmë qejfin kaq gjatë Muharrem Bajraktarit dhe lodhëm kokën me një dokument kaq kimerik. Ne kishim shpresë se, pasi Bajraktari të merrte lejen që ta shpaloste pozën e vet si udhëheqës i kombit, duke iu drejtuar lordëve britanikë, ndoshta do të bëhej e mundur që të bisedoheshin me të anët praktike, të rrudhej lista e tij e mallrave në përmasa më të arsyeshme, të bindej ai që të ndërtonte plane më tepër për zonën e vet se sa për gjithë kombin dhe të mendonte për një koalicion me forcat e tjera, në vend të një lëvizjeje kombëtare të drejtuar nga një qendër e, mbi të gjitha, ta bënim që të shihte se rezistenca kundër gjermanëve ishte gjëja që duhej bërë e para dhe vetëm lufta do të përcaktonte cilët do të ishin ndërtesat e kombit e të shtetit shqiptar pas lufte. Në katër muajt e parë të vitit 1944, nuk pati njeri tjetër në gjithë zonën e Shqipërisë verilindore, në veri të Peshkopisë e të Dibërës, që t'i mbante premtimet më mirë se Muharrem Bajraktari, ndonëse edhe dy-tre veta të tjerë ishin të gatshëm të jepnin po ato premtime. Partizanët e LNÇ kishin pushuar së qeni një forcë, e cila mund të llogaritej seriozisht. Ne nuk kishim vërtet besim se krerët e ndryshëm nacionalistë, duke përfshirë edhe Bajraktarin, po ashtu mund të llogariteshin seriozisht. Por ne ishim të detyruar që të bënim çmos për të siguruar një lëvizje kundër gjermanëve. Ne dështuam me të gjithë krerët nacionalistë. Ashtu siç ishte raporti i Muharrem Bajraktarit tipik për qëndrimet dhe të menduarit e «nacionalistëve» në përgjithësi, po ashtu ishte tipik dështimi ynë me të për dështimin më të gjerë të oficerëve ndërliqñës britanikë, që të siguronin një rezistencë efektive «nacionaliste» kundër gjermanëve.

Lidhur me shtrirjen e Shqipërisë etnike, që e kishin në mendje Muharrem Bajraktari dhe shqiptarët gegë të tjerë më të shquar, jep një ide të thjeshtë harta e botuar në kreun e dytë, që është harta e përgatitur për Pirson Diksonin dhe Departamentin e Jugut të Ministrisë së Jashtme më 1942. Ministria e Jashtme mund ta ketë nënvleftësuar forcën dhe domethënien e nacionalizmit shqiptar, por ajo nuk ishte e informuar keq rreth aspiratave të tij. Gjatë kohës kur qëndrova me Muharremin, e ftova një mbrëmje për të më treguar variantin e tij të Shqipërisë etnike në një hartë. Ajo dilte kolo-

sale, shtrihej nga Arta në vijën Volo nëpër Greqi dhe merrte gjithë Greqinë veriore deri në kufirin turk, gjithë Maqedoninë dhe pjesë të rëndësishme të Serbisë e të Bullgarisë. U bë mirë që letrës së Muharremit nuk iu bashkangjiti ndonjë hartë.

Pasi e lashë shtëpinë e Muharremit, vijoi një periudhë e ngatërruar dhe me telashe. U bashkova përsëri me Riçard Ridellin dhe Toni Simkoxsin më 28 shkurt dhe i gjeta me radio. Riçardi na solli lajmin nga zona e Dibrës, se po formohej aktivisht një koalicion i udhëheqësve nacionalistë, duke pasur si drejtues Mehdi Frashërin, i cili bashkëpunonte me gjermanët në qeveri, Abaz Kupin si udhëheqës të zogistëve, Fiqri Dinen që përfaqësonte zonën e Dibrës dhe Gjon Markagjonin, që sillte fiset e Mirditës. Po të kishte sukses kjo, Muharremi do të detyrohej të pranonte një rol ndihmës. Mbetej një çështje e hapur, se premtimet e kujt ishin më të mjegullta dhe kush do të pranonte udhëheqjen e cilitdo tjetër. U vendos që ta vinim në provë Muharremin, duke bërë një hedhje nga ajri në zonën e tij. Riçard Ridelli u kthye drejt jugut për në zonën Peshkopi-Dibër, ndërsa Toni dhe unë mbetëm pranë Muharremit me radion dhe Majkëll Lisi vijoi ta kalonte pjesën më të madhe të kohës me Litat. Moti u bë shumë i keq, të ftohtët e rëndë këmbehej me shkriren e dëborës dhe me erë të fortë, shi e dëborë. Gjithnjë e më tepër po bëheshim viktimat të shtrëngesave që na vinin nëpër fshatra, ndërsa patrullat nëpër kodrat e luginës së Drinit, të përbëra nga xhandarë e rastësisht edhe gjermanë, u jepnin mikpritësve tanë përligjje të pranueshme, që të na rrasnin nëpër kasolle të acarta e që rridhnin edhe nëpër ahure gjatë ditës, ndërsa natën na detyronin të bënim marshime shumë të vështira e duke u zhvendosur shpesh. Ditari im ka të regjistruara ditë me pesë ose gjashtë orë nëpër shi e nëpër dëborë që shkrin afër një metër të thellë, përpjetë shtigjeve të thikëta, me radion, bateritë dhe pajimet e tjera mbi kurriz e duke u rrëzuar shpesh midis shkëmbinjve dhe pirgjeve të dëborës. Në fakt xhandarët bënin kujdes që të mos na gjenin dhe, kur ndodhte që të dyja palët rastisnin në po atë fshat e madje në po atë shtëpi, siç rastiste disa herë, asnjëra nuk e bënte tjetrën që ta merrte vesh praninë e saj.

Muharremi lëkundej për të marrë një hedhje ajrore, por një nga togerët e tij të rinj, Selim Noka, e pranoi këtë mendim. Ai kishte namën si cub herë pas here gjatë kufirit të vjetër malor ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë, e ndoshta ai e shihte hedhjen si një aventurë me rrezik për ta ndihmuar që

të rritej në pozitë. Muharremi qëndroi mënjanë, por ndërhyri aq sa për të na kujtuar ne që ai ishte autoriteti më i lartë. Nga ana e tyre, familjet Lita dhe Ndreu që u paralajmëruan për planin tonë të hedhjes (siç dyshonim ne) nga përkthyesi ynë, Ali Dika, na kërcënuan se do të na ndalonin me forcë, por Selim Noka ishte i përgatitur që t'i përballonte. Ai madje ishte i përgatitur që t'u kërcëllonte dhëmbët nja dy fqinjëve për të na siguruar kushte më të pranueshme jetese për ekipin tonë të radistëve. Muharremi tani po e përmbyste raportin për një koalicion nacionalist, që e kishte sjellë me vete Riçardi nga Dibra. Siç tha Muharremi, ai ishte një koalicion për të bashkëpunuar me gjermanët me qëllim që të shkatërroheshin komunistët, domethënë partizanët. Ai na u përbetua neve, anglezëve, që të mbanim një qëndrim të qartë kundër bashkëpunëtorëve të mundshëm, duke preferuar që t'i jepnim mbështetje të plotë atij, Muharremit. Një vizitë e Ridellit me një shpurë të fortë prej burrash dibranë shkaktoi një lloj pështjellimi, sepse burrat e Lumës, njerëz të Muharremit, i shihnin ata si të ishin kontrabandistë të padëshiruar. Bashkë me Majkëll Lisin kalova pak ditë në krahinën e Litajve dhe m'u desh të dëgjoja leksione këmbëngulëse nga Sherif Lita dhe djemtë e Cen Elezit se sa gabim e kishim ne të misionit, që merreshim nga njëra anë me Muharremin dhe, nga ana tjetër, me krerët e Dibrës e të Peshkopisë. Xhaferr Lita pohonte se Litajt duhej të vështroheshin si organizatorët më të mirë të mundshëm për rezistencën nacionale, por natyrisht ata do të kishin nevojë për sasi të konsiderueshme florinjsh, që të fitonin dhe të mbanin një numër pasuesish të armatosur.

Gjatë gjysmës së parë të marsit, ndërsa ne endeshim poshtë e përpjetë me telashet e motit, me mlkpritësit tanë shqiptarë të ndryshëm dhe me vështirësitë për të gjetur një vend të përshtatshëm ku mund të punonte me efektivitetet radioja, ne i dërguam një varg mesazhesh Seksionit Shqiptar në Kajro, duke u përpjekur nganjëherë të shpreheshim për perspektivat e dobëta që të bëhej çfarëdo lloj rezistence kundër gjermanëve, dhe nganjëherë me shpresën se, në fund të fundit, diçka mund të sajohej me njërin apo tjetrin nga udhëheqësit, me të cilët kishim lidhje. Mesazhet nga Kajroja na e bënë të qartë se veprimet e partizanëve në jug të Shqipërisë vlerësoheshin dhe se nuk do t'u tregohej shumë simpati luftëtarëve të çastit të fundit kundër gjermanëve dhe bashkëpunëtorëve të gjermanëve deri në çastin e fundit. Në mes të shkurtit na paralajmëruan se duhej të ishim gati për të dhënë ndihmesë për një ope-

racion në shkallë të gjerë, që po përgatitej me emrin e koduar Operacioni Underdone.¹⁰⁾ Nuk duhej të kishte ndonjë perspektivë që ne të ishim në gjendje të jepnim ndonjë ndihmesë dhe neve na dukej se kjo çonte në përfundimin e trishtuar, që lufta po na kalonte anash.

Natyra që mendohej të kishte Operacioni Underdone mund të rroket nga një mesazh i 16 shkurtit 1944 prej Kuartierit të Përgjithshëm të Lindjes së Mesme dërguar në drejtime të ndryshme, duke përfshirë edhe Forcën 133¹¹⁾. Ai u thoshte atyre se «Underdone» ishte emri i dhënë një plani për të përgatitur dhe ekzekutuar disa operacione në Shqipëri, me qëllim që të raskapitej armiku në shkallën më të lartë të mundshme, kur më në fund do të tërhiqej nga vendi. Ai parashikonte veprime të bashkërenduara gueriljesh në rrugët brenda vendit, që të çojnë në veri nga Greqia, në mënyrë që gjermanët të detyroheshin të kalonin në rrugën bregdetare, ku Forcat Ajrore të Aleatëve në Itali mund t'i sulmonin. Ai duhet të ketë qenë i lidhur me shpresat tepër optimiste në janar e në shkurt për një përparim të shpejtë në Itali, që do të çonte në kapjen e hershme të Romës, duke pasur si qëllim që të shfrytëzohej një sukses i tillë në një mënyrë të kufizuar në Ballkan, ndërsa mësymja kryesore e aleatëve do të kapërcehej në Mesdhe për një sulm në Francën jugore, që të ndihmohej zbarkimi Overlord në veri. Për fat të keq, ushtritë aleate në Itali u ndalën në pikën bregdetare Ancio në janar e shkurt dhe në Monte Kasino në mars. Deri më 11 maj gjenerali Aleksandër nuk ishte në gjendje të shpërthente ofensivën e tij të përgjithshme për të kapur Romën dhe në Romë hynë vetëm më 4 qershor. Ndërkohë, partizanët e LNÇ e kishin marrë veten nga pika e ulët e mesit të dimrit, kishin nisur të merrnin iniciativën në fushën e betejës dhe po e rrisnin fuqinë e tyre me shpejtësi të jashtëzakonshme. Kishte kaluar koha për urdhrat operative angleze, që mund të kishin ndonjë efekt në Shqipëri.

Më 15 mars Xhon Hiberdini, tashti i rritur me gradën kapiten, zbriti te ne me radistin e tij dhe me disa italianë e shqiptarë. Ai kishte marrë rrugën për të gjetur Abaz Kupin me shpresë se do të siguronte ndihmë për Nilin, që ishte i sëmurë dhe fshihej diku në veri. Ai na tha se Andi Hendzi po përpiqej të largohej nëpërmjet Malit të Zi. Na përshkroi vështirësitë që kishin ndeshur ai dhe Kempin me partizanët e Kosmetit dhe se si Kajroja e Bari i kishin prerë shkurt veprimtaritë e Kempit në Kosovë, për shkak të rëndësisë më të madhe të marrëdhënieve me partizanët e Titos në Jugosllavi

dhe sepse ishte e padëshirueshme që të ndëlikobeshin në një diskutim të mundshëm për kufijtë. Dukej se nuk kishte mbetur gjë më për të shpresuar në veriun e epërm dhe se ne, të misionit Stables, ishim posta e fundit e përparuar e interesave britanike në gjithë zonën e lumit Drin.

Të nesërmen, më 16 mars, pasi Xhon Hiberdini u nis për rrugën e tij, ne më në fund morëm një hedhje ajrore. Ishte një natë shumë e ftohtë, me një qiell plot yje dhe me erë të fortë. Megjithëse aeroplani bëri disa fluturime ultas të rrezikshme, ngarkesën e hodhi keq dhe, me sa duket, gjysma e ngarkesës i mbeti në depon e bombave pa u lëshuar. Selim Noka mbajti një rregull shembullor në sheshin e hedhjes, i mblodhi të gjitha arkat e shpërndara dhe e ndaloi grabitjen me rreptësi të madhe. Të nesërmen, kur fshati fqinjë erdhi *en masse* për të protestuar dhe për të kërkuar pjesën e vet, ai u doli përballë dhe i përcolli tutje. Ai ishte një nga të paktët udhëheqës vërtet të aftë që kemi takuar në Shqipëri, por duket se nuk kishte ambicije tjetër, veçse të ishte një nga krerët lokalë të shënuar.

Sapo u shpërndanë fshatarët, u duk Andi Hendzi, i shoqëruar nga Jan Merreti dhe nga një grup i vogël anglezësh, italianësh e shqiptarësh, që kishin qenë me misionin Spinster në Degë. Rruga për në Malin e Zi nuk mund të kalohej për shkak të dëborës dhe ata tani donin të dilnin në bregdetin në jug të Vlorës për t'i marrë me det. Andi Hendzi nuk i miratoi kushtet e këqija në të cilat ishte i detyruar të jetonte misioni Stables dhe neve nuk na pëlqeu që morëm qortime për mjerrimin, të cilin na e kishin imponuar rrethanat. Hedhja e fundit e furnizimeve na bëri të mundur që t'i gostitnim me biftek viçi, çorbë, konserva perimesh dhe kafe të vërtetë dhe si ata, edhe ne, u lehtësuam njësoj kur ata ikën.

Gjithë kjo lëvizje në zonë tërhoqi vëmendjen e gjermanëve. Një grup milicësh u nis drejt jugut të Kukësit në krahinën e Muharremit dhe një grup prej rreth 50 gjermanësh u nis drejt veriut nga Peshkopia në krahinën e familjes Ndreu. Dëgjua se Osman Lita e kishte denoncuar Muharremin për strehimin e anglezëve dhe për organizimin e hedhjes. Muharremi, pa e bërë të gjatë, e denoncoi Osman Litën për strehimin e Majkëll Lisit. Ndër ata të Ndreut u dogj shtëpia e Ali Dikës, ndërsa Selim Noka mori malet me të gjitha materialet tona nga hedhja, pasi xhandarët e kishin pyetur Muharremin e gjindshëm nëse kishte ndonjë rrezik po të gjenin ato lloj materiale ose vetë ne te shtëpia e Selimit. Radioja dhe radistët tanë u përvodhën me Ali Dikën, ndërsa Riçard Ridelli,

Toni Simkoksi dhe unë u endëm natën ndërmjet shtëpive e fshatrave, duke iu shmangur vendeve ku ishin shtruar gjermanët dhe xhandarët. Ne ishim si peshqit e Mao Ce Dunit që notojnë në detin e popullit, vetëm se temperatura e detit u ul thekshëm dhe një strehë e akullt e një ushqim i varfër na jepet vetëm duke shprehur pakënaqësi. Për fat të mirë, hedhja ajrore na i kishte plotësuar furnizimet me stërlina e napolona flori dhe kjo na ndihmonte për të na i hapur dyert. Ca dhurata të mira për Muharremin dhe Selimin patën një efekt përmirësues. Riçard Ridelli e kishte në thua që ta quante me rëndësi për të mos i lënë telashet e misionit asnjëherë të zgjasnin goftë edhe një minutë më tepër, nëse kjo kishte mundësi të shmangej.

Nga 27 marsi gjermanët e xhandarët po tërhiqeshin. Selim Noka i mblodhi përsëri materialet tona me besnikëri të shquar dhe ishte e qartë se ai kishte marrë urdhra nga Muharremi për ta ruajtur mirë radion tonë. Të zotët e shtëpive në gjithë krahinën ende kishin shumë frikë që të na pranonin brenda, por qëndrimi i popullsisë ishte më shumë antigjerman e antikolaboracionist se sa më parë. U njoftua se Cen Elezi kishte kaluar me gjermanët dhe me qeverinë kolaboracioniste në Tiranë. Kjo gjë dënohej gjerësisht, madje edhe nga ata që thuhej se ishin pasuesit e tij. Thashethemet merrnin nëpër gojë edhe Muharremin, se a do të bënte edhe ai po ashtu. Litajt organizuan një «besë» kundër nesh në nëntë nga fshatrat e tyre, por privatisht na dhanë sigurime se kjo kishte për qëllim vetëm t'ua hidhte gjermanëve, ndërsa shumë kryefamiljarë pranonin që ta shkelnin atë besë dhe na fusnin brenda, natyrisht duke marrë pagesën përkatëse. Pasi e morëm furnizimin ajror me gjithë përpjekjet e Litajve për të na penguar, ne tani ishim në pozita më të forta për të biseduar me Litajt. Na u bë shumë më e lehtë të blinin ushqime dhe ta përmirësonim nivelin e jetesës. Kjo ishte me shumë rëndësi për t'i pasur në gjendje të mirë radistët tanë.

Më 29 dhe 30 mars morëm disa informata interesante nëpërmjet radiogrameve. Na u tha se Operacioni Underdone ishte anuluar dhe se nuk pritej ndonjë zbarkim në Shqipëri në muajt e ardhshëm. Deri në atë çast ne, të Misionit Stables, e kishim përfytyruar se forcat e Aleatëve do të zbarkonin në Ballkan më 1944 dhe po kështu shpresonin edhe shqiptarët, me të cilët merrnim e jepnim. Ne nuk kishim dijeni për njoftimin që i kishte dhënë gjenerali Dejvis Enver Hoxhës përpara krishtlindjeve, se Shqipërisë do t'i duhej ta bënte e vetme luf-

tën e saj për çlirim. Po në të njëjtën kohë na u tha se Billi Maklini do të vinte përsëri në Shqipëri me gradën e nënkolonelit për të bashkërenduar aksionet në veri, ndërsa do të vazhonte mbështetja për LNÇ në jug. Bari na tha gjithashtu se Komanda e Lartë Sovjetike kishte nisur të interesohej për lëvizjet e trupave gjermane në Ballkan. Përfundimi që nxorëm ne nga të gjitha këto ishte se do të kishim edhe disa muaj përpara, gjatë të cilëve mund të pritej që ne të arrinim disa rezultate. Mesazhet që dërguam ne përpiqeshin të përçonin vështirësitë e situatës, por duke mos e humbur shpresën se me pak përpjekje më shumë, ende kishte mundësi që të shtyhejshin Muharremi dhe «nacionalistët» e tjerë të ndërmerrnin luftime kundër armikut në pranverë.

Kur hyri prilli, moti u përmirësua dhe u bë e mundur që të kalonim më shumë kohë jashtë shtëpive. Madje mundëm të lanim këmishat tona, të qëronim morrat mjaft mirë dhe të bënim një banjë jashtë. Blemë gjithashtu disa kuaj e mushka dhe nisëm të mblidhnim një personel të vogël me italianë si shërbëtorë, të cilët na bënë më pak të varur nga dieta e ashpër shqiptare. Filluam më tepër të zinim dhoma me qira nëpër shtëpi, se sa të varehim duke qenë si mysafirë. Në fakt nisëm të afroheshim me standardin e jetesës që kisha parë në Degë, kur erdha për herë të parë në Shqipëri në dhjetor. Nga mesi i prillit po çelnin lulet dhe ne mund të bënim banja dielli bashkë me hardhucat, ndonëse kishte ndërrime të motit me ditë e net të akullta, ndërsa dëbora që po shkrinte ende ishte pengesë në shtigjet e malësisë së lartë. Kishim pasur ditë e net gjatë dimrit, që gjatë marshimeve na dilnin pamje me peyzazhe shumë të bukura e të ashpra, veçanërisht kur kapërcënim majat e maleve dhe sodisnim Shqipërinë e mbuluar nga dëbora, me luginat e thella të errëta, që shkëlqenin përballë diellit në një qetësi të pacenuar. Tani që po përparonte pranvera, ne ishim në gjendje të ngjiteshim më lart në male, më afër masivit të madh të malit Korab, duke pasur pamje të gjera teposhtë e përpjetë luginës së Drinit drejt Kukësit në veri dhe Dibrës në jug. Toni Simkoksi dhe unë bëmë kërkime nëpër malet e larta për të parë mundësinë e shesheve të hedhjes dhe zbritëm poshtë afër Peshkopisë, nëse mund të rregullohej një brez uljeje në Kastriot. Në mendjet tona ne kishim njësoj si furnizimin e mundshëm, ashtu edhe evakuimin e mundshëm.

Gjatë gjithë gjysmës së parë të prillit Ridelli me Lisin punuan me familjen Lita, ndërsa Simkoksi dhe unë vazhdu-

am të mbanim kontakte me Muharrem Bajraktarin e Selim Nokën dhe shokët e tyre. Grupi i Hendzit ende ishte andej pari nga fillimi i muajit, por u largua nga perëndimi drejt luginës së Matit dhe, nga 6 prilli, iu shtua në ngushticën e vet misionit Slender. Për fatin tonë të mirë, ai na kishte lënë kuzhinierin e tij italian të klasit të parë. Një mesazh nga Seksioni i Shqipërisë na e bëri të qartë se gjëja më e madhe që mund të priste Muharremi, do të ishte një furnizim në shkallë të vogël dhe vetëm nëse së pari ai do të lëvizte për t'u bashkuar me rezistencën. Gjithë përpjekjet tona po shkonin kot, meqë të gjithë krerët prisnin që së pari të vinin furnizimet dhe luftimet të vinin të dytat.

Më 16 prill, befaz u rishfaqën partizanët lokalë. Ne nuk i kishim parë fare që nga janari. Ata ishin shpërndarë dhe kishin qenë inaktivë gjatë muajve më të këqij të dimrit. Tani ata dukeshin të rrekosur e të drobitur, por me shpirt të lartë. Ishin nja njëzet veta. Ata folën për mundësinë e bashkëpunimit me Muharrem Bajraktarin. Njëkohësisht ne morëm një letër me premtime të bukura nga Muharremi, por ai nuk na donte pranë vetes, sepse gjermanët i kishin djegur shtëpitë afër Bicajt. Më 18 prill ne dëgjuam nga Bari se Maklini kishte ardhur përsëri në Shqipëri me Smajlin dhe me një anëtar të ri të ekipit Concensus, Xhulian Emerin, dhe se ai tani duhej të bashkërendonte punën e gjithë BLO në veri. Kur Ridelli, Simkoksi dhe unë takuam Muharrem Bajraktarin më 19, ky u birte rrotull të gjithave si kurdoherë dhe po me aq ambicje, saqë e quante veten jo më pak se sa partnerin më të madh kundrejt Britanisë në Shqipëri. Ne na u desh ta pranonim që diskutimi me të të pezullohej deri sa të vinte Maklini e të vizitonte zonën tonë.

Disa ditë më pas, na u pengua puna nga një sëmundje shumë e rëndë që zuri Toni Simkoksin. I hipi një ethe shumë e lartë dhe ai u mblodh në një pikë të largët thellë brenda vetes dhe ne nuk kishim asgjë me çfarë ta ndihmonim. Na u deshën dy ditë, deri sa e rregulluam që të rrinte në një dhomë vetëm, pa radion dhe sinjalizuesit (që të tre në atë kohë ishin ngritur në gradën e tetarit). Litajt pretendonin se kishin një «doktor», por në fillim nuk donin ta dërgonin, sepse Osman Lita ishte fyer nga veprimtaria jonë me të tjerët. Më në fund erdhi doktori. Asnjëherë nuk e morëm vesh se çfarë zarati kishte, po nga përvoja dukej se merrte vesh nga ilaçet dhe na doli se ishte jugosllav e jo shqiptar. Ai e ngjeshi Tonin me hapje të ndryshme dhe i

sëmuri e mori veten. «Doktori» na doli se ishte homoseksual dhe tepër i interesuar për të futur hundët në punët tona. Na u bë bela për disa ditë. Nga një maji Toni po e merrte veten dhe tani më erdhi radha mua që të bija i sëmure për disa ditë, ndonëse jo aq rëndë sa Toni.

Major Ridelli ishte marrë vesh me çetën e partizanëve që të vinte një hedhje ajrore për ta në malet e larta. Mendohej që ta rregulloja unë këtë me Qazim Prishtinën, oficeri ndërlidhës i çetës që fliste anglisht. Na u desh ta shtynim hedhjen gjatë sëmurdjes së Tonit dhe kur rashë unë i sëmure, Riçard Ridelli i mori vetë përsipër punët për t'i rregulluar. Më 9 maj ai ngriti një fushim të hapur në Gramë, në majë të vijës së drurëve në mal, pak më poshtë se një shesh hedhjeje tjetër, i zgjedhur në një pllajë edhe më të lartë me kodrina. Më në fund hedhja u bë natën e 16-17 majit.

Ndërkaq, më 2 maj Majkëll Lisi kishte ikur nga ne për t'u bashkuar me grupin (që po rritej) të oficerëve nga misionet e veriut, të cilët prisnin rastin për t'u evakuar me misionin Slender në luginën e Matit. Edhe Riçard Ridelli e kishte kapërcyer luginën e Matit për t'u takuar me Bill Maklinin në Xibër. Kur u kthye më 4 maj, ai solli disa lajme të ndryshme interesante: zbarkimi në Europë do të bëhej nga Anglia, formacione të rëndësishme të Aleatëve ishin larguar nga Italia për të marrë pjesë në zbarkim dhe se «Fani» Hezllaku nuk ishte më me Seksionin e Shqipërisë, që tani ishte vendosur në Bari. Lidhur me Shqipërinë, udhëzimet e Maklinin ishin që të kërkoheshin më përpara aksione, e pastaj furnizime. Faqja në ditarin tim për këtë pikë ishte cinike: «A do të thotë kjo se ky është fundi i besueshmërisë për BLO? Unë mendoj se jo. Maklini kërkon sukses, ashtu si edhe ne të tjerët». Pasi u kthye nga Xibri, Riçard Ridelli e nisi Toni Simkoxin për të bërë një rikonjicion për situatën në veriun më të largët, nga i cili ishte larguar misioni britanik në dimër. Për gjithë kohën tjetër që qëndroi në Shqipëri, Simkoxi drejtoi një mision të vetin në kufijtë e Kosovës dhe Ridellit i mbeta vetëm unë për ta ndihmuar.

Më 18 maj, nëpërmjet shërbimeve të mira të Muharrem Bajraktarit, unë pata një takim me kapitenin Abdurrahman Guri, komandantin e postës së xhandarmërisë të Bicajt. Ne biseduam gjatë pjesës më të madhe të natës dhe unë sodita një perëndim të bukur dielli dhe agimin duke qenë hipur në

kalë. Ai ishte gati të mbështeste gjithë veprimtaritë tora, me përjashtim të marrëdhënieve me partizanët. Asgjë nuk mund ta lëvizte nga kjo. Sapo u ktheva në bazën tonë më 19 maj, u përhap një panik, sepse erdhi një njoftim që një patrullë gjermane ishte vetëm dhjetë minuta larg. Të gjithë ua mbathën, duke u kujdesur që të rrëmbenin rdonjë gjë të vlefshme në ikje e sipër. Unë ia arrita ta mblidhja radion me bateritë në një pako dhe gjeta një vend që m'u duk i sigurtë për të dhe për tetarin Dejvis në pyllin aty afër. Me mua qëndruan një shqiptar besnik dhe italianët tanë, por nuk patëm asnjë tjetër, nga i cili të merrnim informata. Pas disa kohe, njerëzit nisën një nga një të ktheheshin dhe ne morëm vesh se patrulla «gjermane» na kishte qenë një tufë kosovarësh, që kishin dezertuar nga shërbimi i gjermanëve dhe që po çanin rrugën për në shtëpitë e tyre. Kur u kthyem ne, e gjetëm dhomën tonë në shtëpinë e «sigurtë» të plaçkitur e të shkatërruar nga miqtë dhe jo nga armiqtë. Ndërkohë Riçardi mori edhe një hedhje tjetër në Gramë, kështu që shumica e teshave që humbëm mund të zëvendësohej. Meqë ishim mësuar në dimër për të mos pasur plaçka të tjera veç atyre pak gjërave që mund të mbaheshin në një çantë të vetme e të vogël shpine, këto lloj ndodhish na shkaktonin pak vështirësi materiale, por na rëndonin shumë në shpirt. Më 21 maj unë u bashkova me Riçardin në fushimin e Gramës në një rrethinë alpine, ndërsa partizanët nuk ishin larg. Nuk më erdhi keq që e lashë prapa varësinë nga shtëpitë shqiptare.

Zhvendosja në Gramë dhe fushimi në ajër të hapur nga fundi i majit i dha fund fazës dimërore, me përpjekjet për t'i rrxitur nacionalistët që të luftonin. Ajo hapi një fazë të re, në të cilën misioni Stables gjithnjë e më tepër u bë një mision që punonte me partizanët e LNÇ. Në një kapitull më poshtë do të tregohet se si forca e rrethanave na çoi në këtë drejtim. Përvoja jonë gjatë dimrit ishte e veçantë për zonën në veri të Dibrës e të Peshkopisë përgjatë luginës së Drinit, por ajo ishte gjithashtu mjaft tipike për përvojën që BLO patën me «nacionalistët» nëpër gjithë Shqipërinë. Kërret secili nga ana e vet bënin premtime afatgjata për bashkëpunim me aleatët, duke pasur para sysh anglezët dhe amerikanët, por gjithnjë duke futur një kërkesë shumë të konsiderueshme për armë, municione dhe flori bashkangjitur. Ata donin që më parë të vinin furnizimet pastaj të bëheshin luftime, ose sidoqoftë të ishin të garantuar se do të

vërshonin me shumicë që nga çasti që do të niste rezistenca me luftë. Ata dukej se ishin të paafhtë për t'u lidhur së bashku. Çdo kryetar udhëheqës bënte propozimin e vet për t'u njohur nga aleatët si udhëheqësi kryesor dhe dukej se ishte i përgatitur për të pranuar udhëheqjen e një tjetri vetëm nëse do ta shihte se favoret e aleatëve i jepeshin atij individit, duke e kthyer atë në një burim ndihmës favoresh dhe, natyrisht, furnizimesh. Vetëm në raste të rralla një nga krerët e guximshëm mund të organizonte ndonjë aksion të shpejtë e në përmasa të vogla kundër gjermanëve, por asgjë që mund të quhej luftim serioz. Në parim ata i mirëprisnin misionet britanike, por mikpritja e tyre kishte një element të fortë mercenar dhe kishte prirje të ndryshonte nga shkalla e ngrohtësisë në varësi prej afërsisë dhe agresivitetit të gjermanëve, si dhe nga vlerësimi që i bënin ata vetë shkallës se sa ishte fituar lufta kundër «komunistëve». Ata ishin kokëngjeshur ndaj çdo përpjekjeje për t'ua shpjeguar lojën e forcave më të mëdha botërore, nga e cila do të vendosej fati i Shqipërisë. Në një masë të madhe ata ishin të verbuar nga nacionalizmi i tyre i lënduar dhe nga besimi se çështja e tyre kundër gjithë fqinjëve ishte e drejtë e do të shpërblehej, mjaftonte që të mbahej larg «komunizmi». Ndër ta nuk doli asnjë udhëheqës, me vizionin për të parë se, për shkak të dhunës së egër që kishte shpërthyer në gjithë Europën, nga Italia e Gjermania, shqiptarëve dhe Shqipërisë do t'u duhej të kalonin përmes gjakut e zjarrit, që të fitonin të drejtën për një pozitë të mirë kur të vinte paqja. Vëllëzërit Kryeziu ishin një përjashtim i mundshëm, por ata ishin ngatërruar në kurthin e problemit të Kosovës dhe nuk mund të merrnin pozitën udhëheqëse në Shqipërinë e mirëfilltë.

Mosdëshira e krerëve nacionalistë për të luftuar ishte e kuptueshme. Në luftime do të shkatërroheshin bota e tyre, shoqëria e tyre, mënyra e jetesës së tyre dhe e pasuesve të tyre. Ata nuk mund ta honepsnin faktin kokëfortë që më 1944 Britania nuk ishte aq e pasur ose aq e fortë, sa ta projektonte pushtetin e saj në zemër të Ballkanit dhe të siguronte mbijetesën e tyre pa përpjekje të forta nga ana e tyre, dhe që nëse këtë nuk mund ta bënte Anglia, askush tjetër në botë nuk mund ta bënte. Meqë edhe shumë anglezë nuk e vlerësonin dot këtë më 1944, është e vështirë ta quash të habitshme përse edhe shumë shqiptarë kishin pikëpamje të gabuara. Megjithatë, e thënë me terma historikë, mosdëshira e nacionalistëve shqiptarë për të luftuar ishte e pafal-

shme dhe ndërsa lufta po shkonte drejt fundit, atyre nuk ua fali kush dhe ata korrën një shpagim të tmerrshëm. Shpresat e oficerëve britanikë ngriheshin e uleshin në mënyrë marmamendëse, ndërkohë që përpiqeshin të nxirrnin marrëveshjet praktike për luftime efektive, qoftë edhe luftime të çastit të fundit, nga krerët njëri pas tjetrit. Por dimri humbi më kot dhe kur erdhi pranvera e vitit 1944, racionalistët e panë veten që ua kapërcyen dhe shumë shpejt ua morën tërësisht epërsinë partizanët e ringjallur.

Oficerëve britanikë, që e kaluan dimrin 1943-1944 në veri të Shqipërisë, iu desh të bënin një jetë të trazuar, që varej shumë nga tekat dhe hesapet e krerëve dhe që u nënshtrohej shtysave të paqëndrueshme të malësorëve, tek të cilët ishin përzier ngjeshurazi respekti për zakonet tradicionale të mikpritjes, frika nga ndërluftuesit e të dyja palëve, pasiguria për rezultatin e luftës, dyshimi ndaj të huajve (veçanërisht ndaj atyre që ishin të pranishëm aty) dhe lakmia elementare. Vetë shpresat dhe ambicjet tona prireshin për t'u bërë po aq të paqëndrueshme sa edhe shtysat e malësorëve, kur e shihnim veten se po kapeshim radhazi pas një fije kashte, duke përfunduar gjithnjë pa asnjë rezultat në kuptimin e përpjekjeve luftarake. Duke jetuar aq ngushtë pranë e pranë, ne disa herë ia ngrinim nervat njëri-tjetrit, por duke e vështruar në retrospektivë është e habitshme se kjo ka ndodhur relativisht pak dhe se morali u mbajt i lartë, me gjithë zhgënjimin se nuk u arrit asnjë «aksion». Ne ishim të bindur për fitoren përfundimtare, ishim të sigurtë se përfaqësonim një fuqi botërore dhe nuk e kishim të vështirë t'i vështronim shqiptarët si humbës, kur ata nuk ngriheshin në nivelin e shpresave tona. Ne mbetëm tamam anglezë edhe kur u bëmë si vendas dhe kjo na bëri që ta kalonim provën në mënyrë të kënaqshme.

Shënimet

1. PRO, Air 26/441.
2. Emri i koduar për aerodromin e Tokrës, bazën e Regjimentit 334 dhe të Skuadriljes 148 të RAF.
3. Marmullaku (1975; 143).
4. Shih komentin për Fadil Hoxhën në fund të kreut të parë.

5. Marmullaku (1975; 143) dhe Hoxha (1982 b; 117-119).
6. Po aty.
7. Po aty.
8. Peter Kemp jep një rrëfim të vështirësive dhe të zhgënjimeve në përpjekjet për të punuar në Kosovë, në Kemp (1958; 182-220).
9. PRO, WO, 204/9530.
10. Quayle (1945; 112) shkruan për Operacionin Victoria. Duket se kjo do të ketë qenë mënyra e tij letrare për të fshehur Operacionin Underdone.
11. PRO, WO, 204/10235.

Kreu 7

Shqipëria e Jugut: partizanët mbijetojnë dhe e marrin veten

Rrjedha e ngjarjeve në Shqipërinë e Jugut, në viset e toskëve, ishte mjaft e ndryshme nga rrjedha në Shqipërinë e Veriut, në viset e gegëve. Shqipëria ndahet përmes nga lumi Shkumbin. Ai nuk është një lumë i gjerë, sipas të dhënave statistikore shqiptare ai ka një prurje mesatare prej 60 metrash kub në sekondë, kundrejt 320 metrave kub për sekondë të Drinit. Por Shkumbini është një lumë i rrëmbyer në rrjedhën e sipërme e të mesme, deri sa arrin në fushat në perëndim të Elbasanit. Ai mund të kapërcehet me vështirësi në dimër; me përjashtim të vendeve ku janë urat e përhershme të rrugës lindje-perëndim, që lidh Korçën e Pogradecin me Elbasanin e Tiranën. Gjermanët dhe italianët përpara tyre kontrollonin rrugën dhe urat. Në teori mund të kishte qenë i mundshëm një kalim i urave me betejë, por kjo u bë e diskutueshme kur Shqipërinë e pushtuan gjermanët. Dështimi i Shtabit të Përgjithshëm të LNÇ për të kaluar drejt jugut në dhjetor 1943 me gjeneralin Dejvis dhe misionin e tij të kuartierit, tregoi se partizanëve u mungonte aftësia për të përballuar pengesën e Shkumbinit në mes të dimrit. Në praktikë Shqipëria e Jugut gjatë muajve të parë të vitit 1944 ishte shumë e shkëputur nga Shqipëria e Mesme dhe e Veriut.

Lëvizja partizane e LNÇ e kishte forcën e saj kryesore në qendër e në jug dhe ishte e dobët në malësitë e veriut. Pas mësymjeve gjermane, që i shkatërruan formacionet partizane në qendër në dhjetor 1943-fillimi i janarit 1944, lëvizja parti-

zane LNC u tërhoq te burimet e saj në jug. Ndonëse jugu ishte zona që jepte mbështetjen më të madhe për partizanët e LNC, dhe kjo doli se ishte e vetmja lëvizje e rezistencës që bëri veprime ushtarake të efektshme kundër gjermanëve në Shqipëri, përsëri në jug kishte shumë më pak oficerë britanikë se sa në veri, pasi Maklini dhe Smajli e përfunduan periudhën e tyre fillestare të veprimtarisë me partizanët e LNC në verë të vitit 1943. Tilmani (Skulptori) u dërgua në gusht 1943 dhe, siç e kemi parë tashmë, ngriti një bazë për furnizime nga ajri në Sheper që nga shtatori e më pas. Fildi (Sapling) u dërgua gjithashtu në gusht në jug dhe u zëvendësua nga majori Antoni Kuejl nga fundi i dhjetorit, por siç e kemi parë, misioni Sapling kishte si qëllim kryesor të kapte një bazë për furnizime nga deti në bregun në jug të Vlorës dhe nuk pati përparim të suksesshëm. Kur gjenerali Dejvis u hodh në Bizë dhe ngriti aty kuartierin e tij në tetor, ai caktoi dy nga oficerët e tij për të punuar në jug. Këta ishin majori (më vonë nënkol.) Alan Palmer, i Artilerisë Mbretërore dhe kapiteni (më vonë major) Viktor Smith, i Pushkatarëve të Lankashirit. Këta dy oficerë u nisën menjëherë për në jug dhe ngritën misionin Swifter atje që nga nëntori e më pas. Nga mesi i dhjetorit nënkol. Uiler dhe disa oficerë të tjerë, që kishin si qëllim të bashkoheshin me kuartierin e Dejvisit, u hodhën gjithashtu në jug, meqë kishin gjetur pengesa disa përpjekje për t'i hedhur ata në veri. Ata prisnin që Dejvisi të shkonte drejt jugut dhe kishin marrë udhëzime që ta prisnin, por ai nuk erdhi dhe ata nuk kishin ndonjë lajm tjetër për të, veçse që radiot e tij nuk dilnin më në valët e komunikimit. Prandaj ata u vendosën në jug dhe punuan me misionet Swifter dhe Sculptor.

Që të dyja këto misione ishin në kontakt ose ishin atashuar kryesisht me forcat partizane të LNC, të cilat asnjëherë nuk u shpërndanë ose nuk u shkatërruan totalisht, ndonëse pësuan sulme të ashpra nga gjermanët. Nga shkurti udhëheqja partizane e LNC dhe Shtabi i Përgjithshëm u rishfaqën në jug, pasi kishin shpëtuar nga rrethimi gjerman në malësinë e Çermenikës dhe kishin çarë rrugën përmes Shkumbinit. Si rrjedhim, lëvizja partizane e LNC në jug nuk e humbi drejtimin qendror ose sidoqoftë jo për më shumë se dy-tri javë në janar, ndërsa misionet angleze e panë se kishin të bënë me një organizim të bashkërenduar e koherent me autoritet në të gjithë zonën, që kishte një kontroll të mjaftueshëm mbi zona të gjera territoriale për hedhje nga ajri të furnizimeve, të cilat mund të rregulloheshin në mënyrë të arsyeshme sistematikisht. Kjo e

bëri të panevojshme që të shpërndaheshin shumë misione individuale si në veri dhe u dha mundësi oficerëve britanikë që të punonin së bashku si grup rreth bazave të furnizuara nga misionet Swifter e Sculptor. Në fakt ato kryen në një shkallë shumë më modeste dhe në një mënyrë shumë më elastike detyrën e ndërlihdjes qendrore, që duhej të ishte detyra e gjeneralit Dejvis.

Grupi i oficerëve britanikë në jug, përveç Tilmanit, Uil-erit, Palmerit e Smithit, përfshinte kapitenin (më pas major) Markus Llajënin (i Dragonëve të Jorkshirit të Mbretëreshës), kapitenin E.Northrop (Pushkatarët Irlandezë të Londrës), kapitenin Xhek Dymulën (Korpusi Mjekësor i Ushtrisë Mbretërore) dhe majorin Gordon Lejzell (i cili u vra nga një aksident me armën e vet në fillim të shkurtit). Në shkurt e në mars ata u përforcuan me kapitenin Brajën Ensor (Pushkatarët Mbretërorë të Olsterit), majorin P.M.Rous (Heshtarët 16-5), kapitenin C.L.D. Njuell (Korpusi i Korracuar Mbretëror) dhe togerin J.A. Jang (Infermierët e Stafordshirit të Veriut). Numri i përgjithshëm i oficerëve që punonin me partizanët e LNÇ në jug më 1944 asnjëherë nuk i kapërceu njëmbëdhjetë, në krahasim me numrin e përgjithshëm në veri, që asnjëherë nuk ra nën 13 dhe u rrit në 16 në prill. Kur në maj e në qershor u evakuan nga jugu katër oficerë (Uileri, Tilmani, Rousi dhe Jangu) erdhën tre të tjerë (majori Shou dhe kapiteni Rajt, që të dy të Pushkatarëve Mbretërorë të Olsterit dhe togeri Merri i Xhenjerëve Mbretërorë).

Enver Hoxha e kishte hedhur poshtë një propozim të bërë nga gjenerali Dejvis në fund të vitit 1943 që në çdo brigadë partizane të atashohej një oficer britanik. Ai ishte i vendosur që të mos lejonte asnjë ndërhyrje jokomuniste në drejtimin e ushtrisë së tij. Megjithatë oficerë të ndryshëm britanikë në jug synonin që të kishin zonat e kontaktet e tyre të veçanta, siç do të dalë më poshtë gjatë shtjellimit.

Nga pikëpamja ushtarake, veçoritë më të rëndësishme gjeografike në jug ishin rrugët. Ka tri rrugë të rëndësishme, që e përshkojnë Shqipërinë jugore nga Janina në Greqinë Veriore për në Tiranë, nga ku rruga vazhdon drejt veriut pëmes Shkodrës në Jugosllavi. E para është rruga veriperëndimore nga Janina në Gjirokastër, që ecën gjatë luginës së Drinos (të mos ngatërrohet me Drinin në veri) dhe vazhdon drejt veriut në Tepelenë, ku Drinosi derdhet në Vjosë dhe pastaj ndjek luginën e Vjosës përpara se të kthejë drejt veriut për Fier, Lushnje, Durrës e Tiranë. E dyta është gjithashtu një rrugë

drejt veriperëndimit, që kalon nëpër luginën e sipërme të Vjosës përmes Përmetit deri në Këlcyrë, e atëherë e lë luginën e lumit, ngjitet nëpër male deri në Berat e pastaj vete në Lushnjë, Durrës e Tiranë. Kjo rrugë lidhet me të parën nga një copë e shkurtër tërthore ndërmjet Këlcyrës e Tepelenës, që kalon poshtë shkëmbinjve të lartë të grykës së Këlcyrës, aty ku i çan malet Vjosa. E treta është rruga që kalon drejt verilindjes përmes Leskovikut nëpër kodra e në Korçë dhe që andej ose drejt lindjes në Maqedoni, ose drejt veriut në Pogradec, në liqenin e Ohrit dhe pastaj gjatë shtratit të Shkumbinit në Librazhd, duke u degëzuar në Librazhd drejt perëndimit në Elbasan e Tiranë dhe drejt veriut në Dibër e Peshkopi. Një rrugë e katërt ecën gjatë bregut nëpër vijën Konispol, Sarandë, Borsh, bigëzohet në Borsh për të ecur në të dy anët e vargut malor për Vlorë dhe pastaj në Fier, Lushnje e kështu më tej.

Ndërmjet këtyre dy rrugëve të para shtrihet kurri i gjatë i maleve të Zagorisë, ku Bill Tilmani (Skulptori) pati bazën e tij në Sheper për pjesën më të madhe të kohës deri në maj. Më në perëndim ndërmjet rrugës së parë dhe të katërt, ose bregdetares, shtrihet një vargmal tjetër më i gjerë, malësia e Kurveleshit. Seaview (Riviera), baza detare e furnizimit dhe pika e daljes që u shfrytëzua vetëm ndonjëherë, shtrihet (nga pikëpamja e atyre që ishin brenda në Shqipëri) përtej maleve të Kurveleshit. Në lindje dhe në veri të dy rrugëve të para dhe në perëndim të rrugës së tretë ose rrugës së Korçës, shtrihet një masiv i madh territoresh malore, që përbëjnë në pellgun ujëmbledhës të lumenjve Devolli e Osumi, të cilët bashkohen në veri të Beratit e formojnë Semanin, një lumë me rëndësi por që përmendet pak, i cili krijon meandra nëpër tokat kënetore të Myzeqesë deri në Adriatik. Ndërmjet pellgut të sipërm të Devollit dhe pellgut të sipërm të Osumit shtrihet mali i Ostrovicës me një pikë të lartë 2383 metra dhe me drejtimin verilindje-jugperëndim. Udhëheqja e LNÇ partizane dhe grupi i kuartierit të misionit britanik në jug e kaluan shumicën e kohës deri në maj në afërsitë e malit Ostrovicë nga ana e tij jugore.

Rrugët e Shqipërisë jugore ishin me rëndësi për gjermanët si rrugë dytësore nga Greqia, duke plotësuar rrugën ushtarake parësore nga Selaniku përpjetë luginës së Vardarit e në Maqedoninë jugosllave, dhe si një mjet për të mbrojtur garnizonet në Sarandë, Vlorë, Durrës, Shkodër e Tiranë që mbrojnë krahuin e Adriatikut të Ballkanit të pushtuar. Zonat ma-

lore ndërmjet rrugëve për gjermanët kishin interes vetëm për sa u bënë trualli ushqyes i forcave guerilje, të cilat në praktikë do të thoshin forca partizane, të afta për të kërcënuar zotërimin gjerman mbi sistemin e rrugëve. Edhe për partizanët e LNÇ jugu ishte më tepër mjet për një qëllim, se sa një qëllim në vetvete. Zonat malore ndërmjet rrugëve jugore ishin trualli për grumbullimin e ushtrisë partizane, por pasi kjo ushtri u bë mjaft e fortë, qëllimi ishte që të hidhej ajo drejt veriut në Tiranë, në kryeqytet, dhe në qytetet e tjera kyç të fushës perëndimore dhe jo të përdorej kryesisht për luftën lokale në jug. Kështu që jugu as nga gjermanët dhe as nga LNÇ, pra nga asnjëra palë, nuk vështrohej si fushëbeteja kryesore. Këto konsiderata shpjegojnë shumë anë të asaj që ndodhi atje; nga njëra anë, faktin që gjermanëve u dolën huq deri në një farë mase goditjet e tyre dhe nuk i ndoqën sulmet e veta deri në atë pikë sa të mund t'i shfarosnin partizanët; dhe, nga ana tjetër, faktin që partizanët nuk u përqendruan në bllokimin dhe shkatërrimin e rrugëve në atë shkallë, sa do të kishin dashur komanda e lartë e Aleatëve ose komanda eprorë e Ushtrisë Nacionalçlirimtare Jugosllave, kështu i shpëtuan fatit që do t'i kishte përparë në fund të dimrit, në rast se provokimi kundër gjermanëve do ta kishte kapërcyer kufirin. Si pasojë, ndonëse forcat partizane të LNÇ disa herë pësuan presione të rënda në jug dhe disa nga udhëheqësit e tyre u shprehën frikën e rrezikut të madh oficerëve britanikë kur mësymja e dimrit e gjermanëve u mori ujemin e vet, ata i kapërcyen ditët më të këqija të dimrit dhe nisën të lulëzonin e të zgjeroheshin kur dimri ia la vendin pranverës, deri sa më në fund, në verë, ata mundën të lëshonin një forcë më të madhe ushtarake drejt veriut përmes maleve e Shkumbinit, kështu që betejat vendimtare u bënë në qendër e në veri dhe jo në jug.

Zhvillimi i ngjarjeve në jug në fillim të vitit 1944 ka nevojë të shihet jo vetëm në lidhje me gjeografinë e jugut, por edhe në lidhje me modelet e reja që nisën të përvijoheshin në procesin e furnizimeve ajrore gjatë muajve të parë të vitit. Kuartieri i Regjimentit 334 të RAF u zhvendos nga Tokra në Cirenajkë për në Brindizi në Italinë e jugut ndërmjet 22 e 27 dhjetorit 1943¹). Ndërkohë dy skuadriljet me Halifax nën komandën e tij, Skuadrilja 148 dhe skuadrilja 624 qëndruan në Afrikën e Veriut, Skuadrilja 148 furnizonte operacionet në Ballkan dhe Skuadrilja 624 furnizonte operacionet në Italinë e veriut dhe në Francën Jugore, por rastësisht i plotësonte veprimet e Skuadriljes 148 me ndonjë dalje ose dy mbi vendet e Ballkanit.

Më 15 janar 1944 gjenerali amerikan Iker (Eaker) mori komandën e Forcave Ajrore Aleate të Mesdheut²⁾, duke përfshirë Regjimentin 334. Pak kohë më pas, aeroplanët amerikanë nisën të merrnin pjesë së bashku për hedhjet ajrore mbi Ballkan. Skuadrilja 148 u zhvendos në Brindizi nga 22 deri në 31 janar dhe atje u bashkua me të, në shkurt, Grupi Transportues i Trupave 62 i Forcave Ajrore të SHBA, që përbëhej nga tri skuadrilje me 47 (Dakota). Edhe Regjimenti 334 mund të përdorte shërbimet e dy C47 për çdo natë nga Skuadrilja 267 e RAF, që kishte bazën në Bari dhe kryente detyra transporti në Itali.³⁾ Për operacionet në largësi të mëdha, Regjimenti 334 u përforcua me një skuadrilje Bombarduesish të Rëndë të Forcave Ajrore të SHBA (aeroplanë Liberator dhe Fortesa Fluturuese) dhe për operacionet mbi Poloni, me Flight (Polak) 1586, të pajisur me Halifax. Në mars, Grupi i Transportit të Trupave 62, USAAF, nisi të zëvendësohej nga Grupi i Transportit të Trupave 60, USAAF, me katër skuadrilje C47⁴⁾. Që nga marsi e më tej operacionet e furnizimit ajror mbi Shqipërinë nisën t'u besoheshin pothuaj tërësisht aeroplanëve C47. Në atë muaj Skuadrilja 148 kreu vetëm katër hedhje në Shqipëri dhe pastaj u tërhoq nga skena shqiptare, pasi kishte mbështetur me guxim misionet në malet e Shqipërisë në kushtet shumë të këqija të dimrit. Duke pasur mjaft aeroplanë C47 në dispozicion për të bërë një hop të shkurtër përmes Adriatikut nga Brindizi, aeroplanët më të rëndë britanikë dhe amerikanë mund të përdroreshin për operacione më në thellësi të Ballkanit. Për operacione në largësi të vogla, u vunë në dispozicion të Regjimentit 334 edhe disa aeroplanë italianë, që e kishin bazën në Leçe.

Ky hop cilësor në aftësinë e furnizimit ajror nga fillimi i vitit 1944 pati si efektin e vet më të madh rritjen e shpejtë të furnizimeve ajrore për partizanët në Jugosllavi. Gjenerali i brigadës Ficroj Maklini kishte qenë me Titon që në shtator 1943 dhe qeveria britanike vendosi t'i jepte mbështetje të plotë ushtrisë nacionalçlirimtare partizane të Jugosllavisë në kapërcyellin e vitit. Numri i fluturimeve të furnizimeve për Jugosllavinë nisi të rritej me shpejtësi që nga muaji mars e më vonë: 81 në mars, 196 në prill dhe 600 në maj. Figurat e krahasuara për Shqipërinë ishin 23 në mars, 21 në prill dhe 34 në maj. Greqia, Italia dhe Polonia secila veçan morën mbi tri herë më shumë fluturime me ngarkesa se sa Shqipëria. Rritja e aftësive të furnizimit ajror për Regjimentin 334, me sa duket, siguroi që përpjekjet për furnizime në drejtim të Shqi-

përisë mbetën të qëndrueshme, në kundërshtim me kërkesat e rritura për gjetkë, por vetëm kur erdhi vera pati një kthesë domethënëse për rritjen e numrit të fluturimeve në drejtim të Shqipërisë dhe për dërgesat e furnizimeve.

Prirja e rëndësishme lidhur me Shqipërinë në muajt e parë të vitit 1944 ishte që, ndërsa numri i fluturimeve dhe i tonazhit që hidhnin mbeti i pandryshueshëm, më shumë furnizime filluan të shkonin për partizanët në jug. Nuk kishte pasur ndonjë vendim zyrtar për të favorizuar çështjen e partizanëve e të LNC në Shqipëri, por rrethanat diktonin që do të përfitonin partizanët dhe LNC. Në veri të vendit nuk kishte rezistencë kundër gjermanëve dhe oficerët britanikë atje nuk ishin në gjendje që të merrnin hedhje furnizimesh të rëndësishme e të vazhdueshme. Në jug forcat partizane ishin në veprim, ishin të afta që të mbanin sheshe hedhjeje për periudha të përshtatshme kohe dhe kishin pranë tyre misionin Skulptori (Tilmanin) dhe misionin Swifter (Palmerin e Smithin). Kur u ndanë Palmeri me Smithin, njëri prej tyre përdori emrin e koduar plotësues Primus dhe u bë një pikë e tretë destinimi për hedhje furnizimesh. Në mars hyri në përdorim një emër i katërt i koduar Pickwick (Pikuiku). Nga prilli të gjitha furnizimet që hidheshin në Shqipëri po shkonin te Skulptor, Swifter, Primus dhe Pickwick në jug.

Shifrat e tonazhit për katër muajt e parë të vitit 1944, tregojnë se si peshorja e furnizimeve nisi të anonte në favor të jugut. Në janar pati 14 fluturime me sukses për Shqipërinë dhe u hodhën 25.8 tonë furnizime. Nga këto 9.6 tonë vajtën për Sculptor, 7 tonë për Swifter dhe 1.7 tonë për Primus. Dhe e kundërta, Stables, Slender dhe Spinster në veri morën 6,5 tonë ndërmjet tyre dhe ndër to 3,8 tonë vajtën për Stables dhe u grabitën në pjesën më të madhe nga banorët e Dardhës (shih kreun 6). Në shkurt tonazhi i përgjithshëm i dërguar për Shqipërinë ishte një çikë më pak se në janar, duke arritur deri 20,6 tonë. Prej tyre 8,2 tonë u morën nga Sculptor, dhe 5.1 tonë nga Swifter. Spinster (Hendzi) në veri mori 7,3 tonë (duke përfshirë edhe një ngarkesë të vënë së bashku për Stables), por vështirësitë e misionit Spinster në atë kohë ishin aq të theksuara, sa që shumica e tyre duhet të kenë shkuar kot. Në mars tonazhi total ishte 29 tonë, prej të cilëve 18.7 tonë vajtën për Sculptor, Swifter, Primus e Pickwick në jug dhe 10,3 tonë për Stables dhe Slender në veri. Historia e hedhjeve për Stables është treguar në kreun 6. Tri

a katër ngarkesa për Slender (6,5 tonë) ishin hedhja e fundit me rëndësi për forcat zogiste gjatë një farë periudhe. Në prill gjithë tonazhi vajti për jugun, një shumë totale prej 27.8 tonësh, duke qenë marrësit kryesorë Sculptor dhe Pickwick. Slender në veri nuk mori asnjë furnizim gjatë prillit, por mori tre parashutistë. Ata ishin Bill Maklini dhe David Smajli që po ktheheshin në Shqipëri, këtë radhë te Abaz Kupi e zogistët, të shoqëruar nga Xhulian Emeri.

Ndonëse në jug (pra për partizanët) u hodhën më shumë furnizime ushtarake me ajër se sa në veri gjatë katër muajve të parë të vitit 1944, dhe ky përpjesëtim një me tre në favor të LNC nuk mund të mos merrte domethënie politike për shqiptarët, përsëri sasitë reale që u hodhën ishin të vogla. Rreth 79 tonë furnizime në katër muaj për një ushtri partizane të rreckosur e në procesin e formimit, që u nënshtrohej sulmeve të përsëritura nga gjermanët, nuk mund të përshkruhen si të bollshme. Nga disa prej oficerëve që ishin në veri të Shqipërisë me «nacionalistët» dhe që mendojnë se Shqipëria duhej të kishte mbetur «nacionaliste», është pohuar se kolegët e tyre me partizanët e armatosën dhe e pajisën LNC për luftë civile dhe kështu ia dorëzuan Shqipërinë komunizmit. Statistikat e furnizimeve ushtarake për partizanët në dimrin 1943-1944 nuk e mbështesin këtë. Rrjedha e ngjarjeve në Shqipëri gjatë pranverës dhe verës së vitit 1944 nuk u përcaktua dhe nuk mund të përcaktohej nga diçka më pak se 100 tonë armë, municione dhe pajisje të hedhura partizanëve nga aerodromet e Tokrës e të Brindizit deri në fund të prillit. Ankesat e Enver Hoxhës, për pamjaftueshmërinë e sasive të furnizuara në përpjesëtim me presionin që ushtronin gjermanët mbi partizanët, pothuaj qëllojnë në shenjë. Forca 133 ndiqte një politikë oportuniste. Ata që mund të mbanin sheshe hedhjeje dhe ishin të përgatitur për t'u mbrojtur nga gjermanët, merrnin furnizime. Të tjerët merrnin zemër për të luftuar, por pak gjë tjetër. Në muajt e dimrit të fillimit të vitit 1944, rezistenca shqiptare nuk e kishte arritur kulmin e intensitetit që tashmë kishte arritur në Jugosllavi. Niveli i furnizimeve ishte në përpjesëtim me nivelin e veprimtarisë, por gjithmonë zvarritej pas tij. Nëse partizanët morën furnizime, kjo ndodhi sepse ata ishin aktivë: është i pabazuar argumenti se ata u bënë aktivë, qoftë kundër gjermanëve ose Ballit Kombëtar, për shkakun se morën furnizime. Sasitë e përfshira ishin tepër të vogla që të ishte e vërtetë kjo.

Një paraqitje e ngjarjeve në jug duhet të nisë me Bill

Tilmanin, sepse nga pikëpamja e furnizimeve ai ishte njeriu i spirancës në jug. Ai ka lënë shënimet e veta në një kapitull të librit «Kur njerëzit dhe malet takohen».5) Siç e kemi thënë tashmë, ai u vendos në Shepër, në malet e Zagorisë ndërmjet rrugës Gjirokastër-Tepelenë dhe rrugës Përmet-Këlcyrë nga shtatori 1943, dhe kishte marrë dy furnizime ajrore në shtator, një në tetor, dy në nëntor dhe dy në dhjetor. Atje ai ishte në kontakt me komandën partizane të Zonës I me kuartier në Kuç, nga ana perëndimore e maleve të Kurveleshit. Si komandant ishte një oficer i dikurshëm i xhandarmërisë, Islam Radovicka, kurse komisar politik ishte Bedri Spahiu, njeriu i parë i LNC me të cilin kishin pasur kontakt në maj 1943 Maklini dhe Smajli. Zona kishte rreth 3000 veta të armatosur, të cilët u shtuan në 5000 gjatë dimrit dhe ishin të ndarë në pesë batalione nga kufiri grek e deri në zonat e Vlorës e të Beratit. Kur lindte nevoja, mund të mobilizoheshin forca të tjera në njësitë lokale. Pothuaj gjithë partizanët e batalioneve kishin pushkë, por kishin shumë pak automatikë të lehtë. Kishin një nevojë të madhe për këpucë. Zona I partizane eci mirë nga kapitullimi i Italisë në shtator 1943, duke fituar një sasi armësh e pajisjesh italiane, por pësoi një rënie të madhe kur gjermanët ndërhyjnë nga Greqia më 29 shtator dhe i flakën tutje partizanët gjatë një jave luftimesh. Në raportin informativ në maj 1944, Tilmani i ka përmbledhur si më poshtë pasojat e kësaj ndërhyrjeje të gjermanëve:

«Kështu, në të parin aksion të madh me gjermanët, partizanët humbën pjesën më të madhe të pajisjeve që kishin marrë nga italianët, të dyja bazat në Kuç e Cepo,6) dhe pësuan rreth tridhjetë të vrarë e të plagosur. Dhe nuk mjaftonte vetëm kjo, sepse morali i popullsisë u vu në një provë të rëndë nga djegia rrafsh me tokën e të paktën dhjetë fshatrave në fillim të dimrit».7)

Mësymja e gjermanëve u shua vetë, gjermanët u tërhoqën për një kohë dhe partizanët u kthyen në qytetet e në malet. Kuartieri i Zonës I u rivendos në Kuç. Në këtë fazë, nga fundi i vitit 1943, disa nga qendrat ishin nën kontrollin e LNC dhe disa nën Ballin Kombëtar. Për shembull, Gjirokastra ishte nën LNC, ndërsa Këlcyra, e rëndësishme për tregun e saj të grurit, ishte nën BK. Tensioni ndërmjet LNC dhe BK u rrit menjëherë në tetor. Qarkorja e dërguar nga Këshilli Qendror i LNC në gusht (pas hedhjes poshtë të marrëveshjes së Mukjes), që urdhëronte të ndërpri-

tej bashkëpunimi me BK, po jepte pasojat e saj mbi qëndrimet e partizanëve; gjithashtu po rritej nga ana e BK për të gëlltitur propagandën antikomuniste gjermane dhe për të lehtësuar lëvizjet e gjermanëve kundër LNÇ me qëllim që të eliminohej kërcënimi komunist. Gjatë një udhëtimi për në kufirin grek në atë kohë Tilmani, i shoqëruar nga një partizan, kaloi nëpër fshatrat e BK si oficer gjerman. Me fillimin në nëntor të shirave e të dëborës me shumicë, veprimtaria ushtarake ra në një nivel të ulët, por gjermanët e pushtuan Gjirokastrën më 9 nëntor dhe partizanët nisën ta shihnin se Balli Kombëtar me gjermanët prapa tyre ishin më të rrezikshëm se sa e kishin menduar.

Një përshtypje e gjallë dhe autentike për qëndrimet reciproke ndërmjet partizanëve të LNÇ dhe Ballit Kombëtar jepet në librin e sër Antoni Kuejlit «Tetë orë larg nga Anglia». 8) Majori Kuejl ishte i ngarkuar me misionin Sapling, që po përpiqej të hapte një bazë për furnizime nga deti në bregun në jug të Vlorës, që nga fillimi i janarit e deri në fund të marsit 1944. Nga njëra anë, ai provoi etiketimin e ashpër, të pamëshirshëm si «kolaboracionist» që i bënin partizanët kujtdo, i cili nuk ishte me ta dhe që meritonte të ndreqej me forcë; nga ana tjetër, ishte këmbëngulja kokëfortë e BK se në radhë të parë (bashkë me gjermanët në vijën e frontit) duhej bërë eliminimi i partizanëve komunistë dhe pastaj mund të vazhdohej me eliminimin e gjermanëve (bashkë me anglezët dhe amerikanët në vijën e frontit). Bashkëbiseduesit kryesorë të Toni Kuejlit ishin Skënder Muçoja, udhëheqësi i Ballit në zonën e Vlorës, dhe komandanti e Komisari të Brigadës V partizane, Shefqet Peçi dhe Hysni Kapoja, por qëndrimet dhe ndjenjat e tyre, ashtu siç i përshkruan ai, mund të shpërnguleshin në çdo pjesë të Shqipërisë ku partizanët ishin si forcë, gjë që në dimrin e 1943-1944 do të thoshte në çdo pjesë të jugut.

Nga ana e partizanëve kishte një teh terrorist. Ai nuk ishte në asnjë mënyrë një terrorizëm pa dallim, siç e zbatonin forcat gjermane, po ata nuk hezitonin të zbatonin një terror përzgjedhës, që kishte si synim t'i ndante fshatarët e zakonshëm nga ata prej udhëheqësve lokalë që mund të klasifikoheshin si ballistë, nacionalistë ose thjesht si «reaksionarë». Partizanët nuk e pranonin asnjësinë ose pasivitetin e individëve apo të fshatrave, ata kërkonin pjesëmarrje aktive në luftën e tyre dhe ishin shumë të gatshëm ta bënin me forcë atë kudo ku kishin aq forcë fizike, sa u duhej për ta

bërë. Lufta e tyre ishte me dy presa, drejtohej kundër pushtuesit gjerman dhe drejt revolucionit shoqëror. Shtypja e kundërshtarëve zakonisht motivohej me këtë të dytën, por ajo zbatohet në emër të së parës. BK nuk qe në gjendje që ta kuptonte rëndësinë e luftës kundër gjermanëve ose madje, siç dukej, që të vlerësonte rreziqet, po ta shihnin se ishte në anën e gjermanëve në Europën e vitit 1944. Partizanët e LNÇ u ndeshën me një luftë më të rëndë nga ana e gjermanëve se sa ndoshta e kishin pritur, por ata iu përgjigjën me luftë dhe ishte kjo që u dha atyre pushtetin për ta kaluar në vend presën e dytë, revolucionin shoqëror, kur tashmë kishin dalë fitimtarë.

Në nëntor 1943, siç e kemi treguar tashmë, Palmeri dhe Smithi kishin arritur në jug të Shkumbinit dhe kishin ngritur një bazë në Krushovë, në malësitë nga perëndimi i Korçës dhe pak më në veri të Voskopojës, dhe në atë zonë ku Maklini e Smajli kishin armatosur Brigadën I partizane në verën e 1943. Atje ata morën një hedhje ajrore nga fundi i nëntorit dhe dy të tjera në ditët e para të dhjetorit. Ata ishin në kontakt me partizanët e zonës së Korçës, të komanduar nga Nexhip Vinçani. Aeroplanët «Spillway» që mbarnin oficerët dhe furnizimet për misionin e kuartierit të Dejvisit, të cilët nuk qe e mundur të hidheshin në Bizë, u drejtuan në dhjetor për në Krushovë. Markus Lllajeni dhe Toni Northropi u hodhën atje më 7 dhjetor e Norman Uileri, Xhek Dymulëni dhe kapiteni Lejzell u hodhën atje më 15 dhjetor. Pati edhe tri hedhje të tjera për Spillway në Krushovë dhe dy të tjera për Swifter në fillim të janarit. Ndërkohë, pa e ditur vetë, Uileri ishte bërë oficeri epror britanik në Shqipëri, meqë Dejvisi dhe Nikolsi kishin humbur në pllajën e Çermenikës. Ai dhe gjashtë oficerë të tjerë me të, ishin një grup më i vogël se ai që kishte pasur Dejvisi në Bizë por, për fat të mirë, ata përbënin një qelizë me përmasa të përshatshme, nga e cila mund të ndërtohej misioni i kuartierit i ri, zëvendësues, për ndërlidhjen me partizanët e LNÇ. Kjo nuk ndodhi aty për aty, por nga ditët e para të shkurtit, kur Enver Hoxha dhe kolegët e tij të Këshillit Qendror të LNÇ, të Shtabit të Përgjithshëm dhe të Byrosë Politike të Partisë Komuniste të Shqipërisë erdhën në afërsi të tyre, ai nisi të merrte trajtë.

Ndërkaq në jug po rritej veprimtaria e gjermanëve. Me shpërndarjen e forcave partizane në qendër e në veri, me eliminimin e Brigadës II dhe III afër Tiranës dhe me dë-

bimin drejt jugut të komandës së lartë partizane të LNC, aty nga janari gjermanët, qeveria shqiptare kukull, bashkëpunëtorët e hapur, ballistët e nacionalistët të gjithë bashkë mund ta ndienin se në veri e kishin nën kontroll gjendjen dhe një masë e moderuar përpjekjesh të gjermanëve në jug do ta shtynte lëvizjen partizane në skajet e jetës shqiptare. Në përmbledhjen e saj informative për Forcën 133 në mes të dhjetorit, Hezillaku në Kajro shënonte se gjermanët kishin pasur mjaft sukses me politikën e tyre përça e sundo, aq sa qenë në gjendje që të tërhiqnin nga Shqipëria elementët e dy divizioneve plotësuese që kishin futur në vend pas ikjes së Italisë.⁹⁾ Por ideja se partizanët kishin marrë fund ishte po aq e gabuar, sa kishte qenë ideja e vetë partizanëve në vjeshtë, se ata do ta kishin vënë përpara Ballin Kombëtar brenda pak javëve, dhe njëkohësisht do t'u bënë ballë forcave gjermane e do të ngrinin një prani ushtarake vendimtare në afërsi të Tiranës, të gatshme për zgjidhjen përfundimtare të luftës.

Në janar njësitë partizane në jug ndërmorën një varg aksionesh për të shqetësuar gjermanët. Ata minuan rrugën në jugun e skajshëm ndërmjet Delvinës e Sarandës, gjë që çoi në një betejë me gjermanët. Ata minuan rrugën Këlcyrë-Berat dhe morën nën kontroll Këlcyrën, por ajo që ndoshta kishte më shumë rëndësi, morën furnizimet e saj me grurë të Ballit Kombëtar. Brigada I partizane nën Mehmet Shehun ose pjesë të saj u shfaqën me luftime në lokalitete të ndryshme. Forcat partizane, ndonëse pësuan privacione të rënda nga dimri në një zonë fshatare të shkatërruar, e ruajtën qëndrimin e tyre sulmues. Gjermanët u shtrënguan të lëshonin kolona gjatë rrugëve nga Greqia për t'i mbajtur partizanët nën kontroll dhe vijat e komunikimit të lira.

Uileri dhe grupi i vogël i personelit të tij në Krushovë nisi të lëvizte pak më nga jugu, në radhë të parë në Propotapë, duke i lënë Palmerin e Smithin për ndërlidhje me Nexhip Vinçanin e Brigadën IV të tij të sapoformuar. Një ditar «skeletik» që ka mbajtur Markus Llajeni e tregon se ata ishin në Lavdar, në jugperëndim të Voskopojës, më 11 janar, dhe ata bashkë me partizanët atje ranë në zjarrin e një sulmi. Palmeri dhe Smithi u dëbuan nga Krushova dhe u bashkuan me ta përsëri. Gjithë grupit iu desh t'i shmangej hyrjes në aksion dhe të largoheshin në vise më të larta, me një marshim prej 38 orësh përmes dëborës. Nga 14 janari ata arritën në Koprenckë dhe Lapan, që do të thotë se ata

kishin kaluar nga lugina e Devollit në luginën e Osunit, duke lëvizur nga verilindja e vargut të Ostrovicës, drejt jug-perëndimit. Në këtë kohë, udhëheqësit partizanë, me të cilët ata qenë në kontakt, ishin të shqetësuar për situatën në të cilën kishin rënë dhe për presionet që po rriteshin. Ka mundësi që ata të dinin diçka për katastrofën që kishin pësuar shokët e tyre në Shqipërinë e mesme e të veriut dhe kishin frikë se mos ashpërsia e dimrit, shkatërrimi i fshatrave, denoncimet e ballistëve dhe epërsia e pamëshirshme e forcave gjermane mund të ndërthureshin të gjitha bashkë për t'i dhënë fund aftësisë së tyre që të mbijetonin deri në pranverë.

Nga Koprencka Nexhip Vinçani u kthye drejt veriut për ta riformuar Brigadën e vet të shpërndarë, duke marrë me vete një subvencionim prej 1500 lirash flori, që të ndihmohej për të zgjidhur problemet e rënda të furnizimit. Nga Llapani Markus Llajëni vajti në jug të Përmetit, ndërsa Uileri, Palmeri dhe Smithi shkuan në drejtim të bazës së Tilmanit në Sheper, pasi kishin humbur gjithë teshat gjatë ndjekjes nga gjermanët dhe kishin nevojë të pajiseshin nga e para. Një hedhje ajrore Primus u bë në Sheper më 19-20 janar dhe dy hedhje Swifter po atje më 21-22 janar. Në këtë kohë Ramadan Çitaku i Këshillit Qendror të LNÇ, u kthye prej një vizite në Greqi dhe solli lajmet për përqendrimet gjermane në kufirin grek. Veprimtari gjermane kishte gjithashtu në Gjirokastrë e në Korçë. Përgatitjet e gjermanëve shkaktoan anulimin e paradës së përuimit të Brigadës VI partizane në Përmet më 25 janar. Ofensiva gjermane e përgatitur shpërtheu më 27 e 28. Tilmani dhe grupi i tij rrëshqitën nga Zagoria dhe kapërcyen bashkë Vjosën nëpër Përmet përpara se gjermanët të arrinin atje, kurse i gjithë grupi i oficerëve britanikë u ribashkua në Frashër më 29 janar e pastaj në Miçan. Edhe oficerët eprorë të Zonës I partizane ishin gjithashtu në Frashër, duke përfshirë Bedri Spahiun, Islam Radovickën dhe Tahirin, komandantin e Brigadës VI të re. Gjermanët kryen edhe djegie të tjera të fshatrave në krahinat që tashmë ishin shkatërruar në të dy anët e rrugës dhe u tërhoqën. Tilmani pohonte në maj, në raportimin e tij për Barin, se forcat gjermane ishin shoqëruar nga forcat e Ballit Kombëtar dhe se këta të fundit kishin plaçkitur e grabitur në gjithë zonën përpara se të tërhiqeshin.¹⁰) Në ditët e para të shkurtit partizanët, Tilmani dhe misioni i tij depërtuan përsëri në Zagori e në Kurvelesh. Tilmani edhe një herë e

ngriti bazën në Sheper më 4 shkurt dhe kuartieri i Zonës I partizane u kthye në Kuç.

Grupi kryesor i anglezëve tani u bë ai i vendosur në Staraveckë dhe Backë, në jug të vargut të Ostrovicës, në krahinën e quajtur Skrapar, sepse Staravecka ishte e përshtashme si shesh hedhjeje. Udhëheqësit partizanë ishin vendosur aty afër në Panarit dhe eventualisht në Helmës. Aksidenti në të cilin u vra Lejzelli ndodhi mbrëmjen e parë në Staraveckë. Për pjesën më të madhe që mbetet të dimrit këto fshatra dhe të tjerët aty rrotull u bënë qendra kryesore e lëvizjes partizane LNC dhe të misioneve britanike në jug. Në këtë kohë u rishfaqën Enver Hoxha dhe kolegët e tij udhëheqës të Këshillit Qendror të LNC dhe të Shtabit të Përgjithshëm, pasi kishin shmangur unazën e ngritur nga gjermanët me nxitjen dhe përkrahjen e ballistëve rrotull Çermenikës, ndërsa Uileri dhe Palmeri morën detyrën e ndërlidhjes me ta. Nevoja e parë ishte të siguroheshin furnizime nga ajri. Regjistrat e hedhjeve ajrore tregojnë se u bënë tri hedhje Swifter në Potom (jo larg nga Staravecka) natën e 8-9 shkurtit, ndërsa sipas kujtimeve të Uilerit pas dy a tri javësh pati hedhje të mjaftueshme për të ripajisur grupin e britanikëve për t'u dhënë inkurajim partizanëve. Kjo e bëri të mundur për oficerë të ndryshëm nga grupi britanik, që të dilnin për detyra në gjithë jugun, nganjëherë për të hyrë në kontakt me një brigadë partizane, për të ndihmuar që të hidhej në erë një rrugë, ose për të bërë rikonjicionin e një zone. Pastaj ata ktheheshin në bazën poshtë vargut të Ostrovicës, që siguronte lidhjen kryesore me radio me Forcën 133 në Kajro dhe në Bari. Disa nga oficerët, për shembull Northropi, Ensori, Njuelli, Rousi dhe Jangu vepronin si degë të misioneve, duke bërë ndërlidhjen me njësi të ndryshme partizane dhe kuartieret e zonës. Oficerët në jug u ndeshën pothuaj po me ato vështirësi si dhe oficerët në veri, ditë e net marshimesh të lodhshme të përziera me ditë pritjeje, telashe të mëdha me ngarkimin e baterive dhe shifrimin, ushqimi i parregullt dhe i pasigurtë, të gjitha dizavantazhet që lindin kur mendohet se je i pasur në mes të një fshataresie të varfëruar, çimka, pleshta e morra, muhabete pa fund (por duke iu shtuar pengesa e dallimeve ideologjike) dhe një jetë vazhdimisht e ashpër. Atyre iu desh që të ndanin një pjesë të madhe të shtërngesave të partizanëve, por për të përballuar këtë ata patën një varg të rregullt e në rritje hedhjesh ajrore, që u sollën ato sende, të cilat përgjithë-

sisht klasifikohen si «gjëra komforti». Ata kishin nevojë shumë të madhe për to, sepse jetonin në vise që kishin pësuar shumë shkatërrime dhe nuk mund të siguronin asnjë kënaqësi. Përparësia e tyre më e madhe kundrejt kolegëve në veri, ishte se ata jetonin në kontakt të përditshëm me një organizatë shumë të disiplinuar, që rritej vazhdimisht dhe që i jepte kuptim vetë misionit të tyre në Shqipëri, qëllimi i të cilit ishte, natyrisht, të inkurajonte dhe të mbështeste rezistencën kundër gjermanëve. Veprimtaria e partizanëve nuk ndalte te lufta me gjermanët, ajo përfshinte edhe gjëra që nuk mund të mirëpriteshin nga Britania, por gjermanët luftuan kundër partizanëve dhe partizanët ua kthyen me luftë në çdo pjesë të jugut, duke treguar një përmirësim të vazhdueshëm të aftësisë luftarake e të burrërisë.

Ditari i Markus Llajënit shënon një udhëtim me Viktor Smithin ndërmjet 7 e 16 shkurtit për të përtërirë kontaktin me partizanët e Brigadës IV. Në ditët e para të marsit, Smithi u largua për disa ditë për një operacion shkatërrimi të një rruge. Xhek Dymulëni ishte i zënë me spitalin partizan në Panarit, i ndihmonte ata që të ngriheshin disa njësi spitalore me një farë mënyre të decentralizuara (që të ishin më pak të goditshme), bënte operacione, jepte këshilla për çfarëdo lloj problemi mjekësor dhe jepte porosi për materiale mjekësore që të hidheshin nga ajri. Uileri dhe Palmeri herë pas here përfshiheshin në mbledhje me Shtabin e Përgjithshëm të partizanëve dhe zhvillonin një shkëmbim të dendur mesazhesh me Barin rreth situatës në Shqipëri dhe meritave relative për t'i mbështetur partizanët në jug dhe elementët nacionalistë e zogistë në veri. U morën vesh me Forcën 133 që Norman Uileri duhej të shkonte në Itali për raportim mbi situatën, duke e lënë Alan Palmerin si oficerin epror britanik me LNÇ. Markus Llajëni ka regjistruar një mbrëmje lamtumire për Uilerin më 13 mars, ndonëse Uileri nuk ia doli mbanë të arrinte në Itali bashkë me Bill Tilmanin deri më 22 maj. Vetë Norman Uileri ka mbajtur shënim anëtarët udhëheqës të LNÇ, me të cilët u nda me një drekë të dhënë nga misioni britanik. Ai kishte në listë: Enver Hoxhën, Spiro Moisiun, Dr. Dishnicën, Dr. Shtyllën, Koçi Xoxen, Ali Alimin (pseudonimi që përdorte Miladin Popoviçi, jugosllavi krahu i djathtë i Enver Hoxhës), Ramadan Çitakun, Islam Radovickën dhe Haxhi Lleshin, një mbledhje mjaft e plotë e njerëzve të shquar të LNÇ, dhe të Partisë Komuniste të Shqipërisë. Menjëherë pas kësaj, më

16 mars, Llaçeni ka shënuar se ka marrë lajmë, ose ka dëgjuar fjalë për vdekjen e Nikolsit dhe kjo u konfirmua nga Shtabi i Përgjithshëm i Partizanëve më 19 mars. Ngadalësia me të cilën kishte udhëtuar ky lajm tregon se sa efektivisht e kishin shkëputur gjermanët jugun nga veriu. Ky incident tregon gjithashtu se sa e dendur ishte mjegulla e luftës, nëpër të cilën misionet britanike në Shqipëri duhej të gjenin rrugën e tyre gjatë dimrit. Llaçeni kujton një udhëtim që bëri me Toni Northropin nga fundi i marsit e fillimi i prillit për të bërë rikonjicion të kufirit grek, dhe një udhëtim tjetër në mes të prillit në zonën e Korçës, gjatë të cilit ai takoi disa figura udhëheqëse partizanësh: Spiro Mojsiun (shefin e shtabit), Nexhip Vinçanin dhe komisarët e Brigadës I e IV. Nga fundi i prillit ai u nis përsëri, këtë radhë me Viktor Smithin për një vizitë tjetër në Brigadën IV.

Uileri dhe Tilmani kaluan një periudhë të mundimshme në bregdet, duke pritur që t'i merrnin për Itali.¹¹) Nuk u duk asnjë anije dhe ata me partizanët pritën më kot për një javë. Atëhere gjermanët vunë dorë, ndërmoren një spastrim gjatë rrugës bregdetare dhe në luginat që zbritnin drejt saj. Uileri dhe Tilmani u detyruan të tërhiqeshin në brendësi deri në Kuç. Që atje Uileri hyri në kontakt me Brigadën V partizane dhe majorin Rous. Edhe një herë i ndoqi spastrimi gjerman, por Uileri dhe Rousi ia dolën mbanë të ngrinin një shesh hedhjeje në Golem, ku ishin bashkuar disa grupe partizane të shpërndara dhe u riformuan me ndihmën e disa ngarkesave ajrore me armë e municione. Kur presioni i gjermanëve u pakësua dhe u bë e mundur të ktheheshin përsëri drejt bregdetit, Uileri ndeshi rastësisht togerin Stefan, oficerin amerikan të OSS (Zyra e Shërbimeve Speciale), i cili kishte zbarkuar bashkë me dy të tjerë në Bazën Seaview në territorin e Ballit Kombëtar në bregdet, më afër Vlorës, dhe po përpiquej të çante rrugën për te partizanët. Uileri e ka përshkruar takimin si atë të të varfrit Stanlej me Livingstonin. Po në atë kohë, baza Seaview u kap nga gjermanët dhe misioni Sapling, i nisur nga Fildi dhe i vazhduar nga Kuejli mori fund, i penguar deri në mbarim nga pamundësia për ta bërë Ballin Kombëtar dhe LNÇ të bashkëpunonin njëri me tjetrin, me qëllim që të shfrytëzoheshin mundësitë më të gjera të furnizimit nga ana e detit. Duke qenë i shkëputur nga deti dhe duke rënë në kushtet e urisë që sundonte në atë zonë, si pasojë e sulmeve shkretuese të gjermanëve dhe të ashpërsisë së dimrit, Uileri u përpoq ta

bindte Forcën 133 në Bari që të dërgonte një aeroplan për ta marrë atë në një brez uljeje të improvizuar, por edhe kjo nuk doli e frytshme. Nga fundi i prillit dhe në ditët e para të majit rigjallërimi i veprimtarisë së partizanëve u bë i ndjeshëm. Ishin formuar Brigada VI dhe VII partizane dhe ishin bërë aktive, e para në drejtim të jugut dhe e dyta të veriut të Brigadës V, ndërsa në gjysmën e dytë të majit ato ishin në gjendje të mbanin një brez të bregdetit në afërsi të Borshit. Uileri, Tilmani dhe nënoficerët e tyre qenë në gjendje të përdornin me efekt të mirë eksplozivat e tyre për të penguar rrugët. Më në fund, më 22 maj, një anije zbarkimi ktheu rrugën në një plazh të paracaktuar dhe i mori Uilerin e Tilmanin, ndërsa partizanët që ia kishin arritur të grumbullonin disa qindra mushka në një krahnë të shkretuar, u larguan duke marrë me vete një ngarkesë anijeje me furnizime. Ndërsa oficerët britanikë, siç e tregon ky katalog i lëvizjeje, kishin mjaft punë për t'u marrë me to, veprimtaria ushtarake nga të dyja palët ishte pakësuar, sepse si gjermanët edhe partizanët, ashtu si kushdo tjetër, po prisnin pranverën. Në mars ra dëborë e rëndë dhe dimri ishte i ashpër. Pikërisht në këtë kohë, Mehmet Shehu me rreth 200 veta bëri një aksion në Shqipërinë e mesme, që në historinë e PKSH përshkruhet si një marshim heroik thellë në territorin e armikut. Me sa duket, ai i kaloi forcat nga zona e Korçës drejt veriut e pastaj drejt perëndimit në malësinë e Martaneshit, duke depërtuar në veri deri në Klos të Matit (vendlindja e Abaz Kupit) dhe pastaj u kthye drejt jugut në Shëngjergj e Çermenikë, marshoi përmes zonës së Myslym Pezës në jug të Tiranës dhe u kthye drejt jugut përmes lumit Shkumbin, në drejtim të Beratit. Shfaqjen e tyre në Shëngjergj, rreth 6 marsit, dhe shkëmbimin e zjarrit me banorë të vendit e ka njoftuar Sejmurin dhe e ka vënë në dukje zonj. Hezllak në vështrimin e saj informativ të 14 marsit.¹²⁾ Natyrisht, kuptimi i këtij marshimi ishte që udhëheqja partizane e LNÇ në asnjë mënyrë nuk e kishte pranuar si përfundimtar dëbimin e saj nga Shqipëria e mesme dhe veriore, e kështu po jepte shenjën se kishte ndër mend të rikthehej me forcë, sapo të dilte mundësia e parë. Ajo do t'i jepte përparësinë më të madhe këtij objektivi dhe jo operacioneve në jug. Ky aspekt i ngjarjeve, me sa duket, është vënë re në Forcën 133, për të cilët ishte vetëm një nga shumë *faits divers* me interes. Në atë kohë, këtë ngjarje nuk e dinin oficerët e tjerë që ishin

në vend, me përjashtim të Sejmurit. Enver Hoxha nuk do ta ketë parë këtë si diçka që u interesonte atyre. Kështu që nuk u kuptua vlera e saj si tregues i asaj, që do të ndodhte më vonë gjatë vitit.

Është e vështirë të gjykohet se çfarë marrëdhënieje ka pasur ndërmjet këtij marshimi dhe ndërhyrjes së Brigadës I, të cilën e kishte kërkuar Enver Hoxha në fillim të janarit, kur ai dhe Këshilli Qendror e Shtabi i Përgjithshëm ishin në shtërngesë të dëshpëruar në Çermenikë dhe në nevojë urgjente për ndihmë. Në kujtimet e veta Hoxha e zvogëlon fare ndihmën e janarit, e mohon se ajo i shpëtoi dhe e akuzon Mehmet Shehun se e ka fryrë atë deri sa e ka bërë legjendë.¹³) Nga ana tjetër, ai e lejon që marshimi në fund të shkurtit e në fillim të marsit të përshkruhet si heroik në Historinë e Partisë. Duket e mundshme që kishte qenë një operacion urgjence në janar ai, i cili bëri të lindte ideja për të kryer një operacion më sistematik dhe demonstrativ në mars. Atëhere, si përfundim, do të kemi që madje edhe në motin e keq të marsit, kur operacionet ushtarake në jug ishin në fakt të pezulluara dhe partizanët ende nuk e kishin marrë veten nga goditjet ndëshkuese, që u kishin dhënë gjermanët me ndihmën e ballistëve, sytë e Enver Hoxhës dhe të kolegëve të tij eprorë ishin të drejtuar para së gjithash dhe në mënyrë të vendosur ndaj Tiranës e qeverisë. Në Forcën 133 në Bari partizanët i kishin fshirë gjerësisht nga regjistri si forcë e shuar ose, e shumta, si forcë lokale me rëndësi vetëm në jugun toskë. Atë që udhëheqësit e LNÇ e shihnin si fatin e tyre, vëzhguesve të huaj ajo u dukej si një pretendim mendjemadh.

Në këtë kohë, Enver Hoxha kishte problem që të ngrihte moralin e partizanëve pas humbjeve të dimrit, dhe humbjet më serioze i kishin Brigada II dhe III. Ai i shkroi një letër Nako Spiros në zonën e Tiranës në mars, në të cilën ai e pranonte që « me të vërtetë situata është e vështirë, shumë e vështirë... por bash në këto situata të vështira të përpiqemi të mos humbasim moralin». ¹⁴) Mirëpo pikërisht në kohën kur është shkruar kjo, pasqyra javore informative e Forcës 133 me datën 8 mars (e shkruar përsëri nga Margaret Hezllak) vinte në dukje, me një ton habie, dëshminë e ringjalljes së partizanëve:

«Rigjallërimi i partizanëve i detyrohet elasticitetit dhe manovrueshmërisë së brigadave të LNÇ, për shumicën e të cilave një muaj më

parë njoftohej se ose ishin shpërndarë nga mësymjet gjermane, ose gjendeshin përballë vdekjes së shpejtë». ¹⁵⁾

Pasqyra me të drejtë e përmbledh forcën e partizanëve në këto gjëra: «disiplina, energjia dhe qartësia e qëllimit». Një javë më parë pasqyra njoftonte se Brigada I kishte qenë në aksion kundër forcave gjermane e balliste në Berat, pasi kishte qëndruar inaktive për një farë kohe për shkak të humbjeve që kishte pësuar nga mësymja gjermane. Ka të ngjarë që kjo do të ketë qenë pjesë e veprimtarisë së Brigadës I rreth Beratit, në kohën që priste të vinin elementët që kishin shoqëruar Mehmet Shehun në sulmin e tij drejt veriut. Forca 133 e kishte shumë të vështirë nga ana politike të futej thellë në atë çka po ndodhte në Shqipëri. Nga fundi i janarit, vlerësimi i tyre kishte qenë që «me përjashtim të krahinave shqiptare në JP dhe të një zone vazhdimisht në zvogëlim në qendër, Shqipëria është në duart e Ballkanit». ¹⁶⁾ Dy muaj më vonë ata po e shihnin se Balli Kombëtar ishte në rënie të shpejtë, ndërsa Grupi i Tiranës, koalicioni nacionalist në të cilin Abaz Kupi po luante një rol udhëheqës, po bëhej forca politike sunduese, me përjashtim të jugut të thellë. Largimi i nacionalistëve nga LNC vazhdonte dhe pati hamendje se mund ta kishte Myslim Peza tani radhën për ta braktisur.

Në fakt, atë zhvillim në muajt e parë të vitit 1944, që në fund të fundit do të provohej se ishte vendimtari, e për-bënte ngritja e pandërprerë e Ushtrisë Nacionalçlirimtare të LNC, në kundërshtim me pengesat nga ana e gjermanëve dhe e Ballit Kombëtar. Nuk janë të dokumentuar mirë hapat e hollësishëm, nëpërmjet të cilëve u arrit ky proces. Ai ishte një proces organizativ e administrativ, të cilit i mungonte interesi politik i lajmeve që kishin ngjarjet në veri. Brigadat IV, V, VI e VII u formuan në jug gjatë muajve të dimrit. Përmbledhja informative e zonjës Hezllak për Forcën 133, më datën 9 janar, flet për Brigadën IV, që ishte formuar kohët e fundit në Shqipërinë juglindore. ¹⁷⁾ Ky informacion duhet të jetë nxjerrë nga radiogramet e Swifter, i cili ishte në kontakt me Brigadën IV afër Korçës. Dëdijeri e konfirmon se Korça ka qenë zona e krijimit të Brigadës IV dhe thotë se ajo u formua në fund të nëntorit 1943. ¹⁸⁾ Ai tregon se Brigada V nuk ishte formuar deri në fillim të vitit 1944. Ajo ishte e vendosur në krahinën në jug

të Vlorës. Viktor Smithi thotë se kaloi një farë kohe me Brigadën V pas periudhës fillestare në jug me Alan Palmerin. Para e përrurimit të Brigadës VI duhej të ishte bërë më 25 janar në Përmet, por u shty për shkak të ofensivës gjermane në Zagori. Brigada VII mori formë në krahinën e Mallakastrës (Skraparit?) ndërmjet Vlorës e Beratit në mars-prill. Tilmani pati një rast tjetër për të marrë pjesë në një përrurim më 25 prill, kur Brigada VIII bëri paradën në Sheper, me dy batalione më pak, që ishin zënë në luftim në Çamëri afër bregdetit. Sipas dëshmisë së Ramiz Alisë, i cili u bë pasardhës i Enver Hoxhës si udhëheqës i Shqipërisë më 1985 (Ramiz Alia i ri po e niste karrierën e tij më 1944 si anëtar i aparatit politik të Brigadës VII), Brigada XII u formua në zonën e Këlcyrës në maj.¹⁹) Brigada I nën Mehmet Shehun mbeti *corps d'élite* e partizanëve, e kalitur nga vështirësitë e dimrit deri në nivelin e një qëndrueshmërie të madhe dhe nga komandanti i saj i ashpër e i patundur deri në një shkallë disiplinore e manovrueshmërie që do ta habiste David Smajlin, i cili u zhgënjye aq shumë në përpjekjet e tij të para më 1943. Brigadat e tjera e kishin si një model të shquar për të konkurruar me të: së bashku ata përbënin bërthamën e një ushtrie të aftë për t'u përdorur lirisht nëpër gjithë Shqipërinë, kur të vinin pranvera dhe vera.

Përmbledhja informative e Forcës 133 me datën 29 mars²⁰) njoftonte se gjermanët e kishin tërhequr Divizionin 100 Jaeger nga Shqipëria në Hungari dhe pak më vonë, në maj, njoftonte se Divizioni 279 i këmbësorisë ishte tërhequr madje edhe më parë. Vendin e tyre e kishin zënë trupa garnizonesh të stabilizuara, të sjella nga Greqia, që përmbanin elemente me peshë jo të vogël ushtarësh jo gjermanë, armenë, bullgarë, turq etj. Rreth 4 000 deri 6 000 trupa ose xhandarë kosovarë kishin zënë vend në qytetet kryesore dhe mbanin rendin me forcë. Në teori shqiptarët e Kosovës duhej të kishin qenë luftëtarët më të flaktë për çlirimin kombëtar, porse në rrethanat e vitit 1944, duke e identifikuar kauzën e nacional-çlirimtares me serbët dhe komunizmin sllav, ata u bënë agjentë e shërbëtorë të pushtimit gjerman. Dobësimi i garnizoneve gjermane në Shqipëri ndihmoi që të lehtësohej mbijetesa e partizanëve të LNC dhe e bëri më të lehtë për ta që të përqendroheshin në ngritjen e fuqisë së tyre. Kjo ngritje ua ngatërroi mendjen shumë vëzhguesve, të cilët i kishin fshirë ata nga defteri.

Nga prilli, Ushtria Nacionalçlirimtare po merrte inicia-

tivën në zonat e ndryshme të jugut.²¹⁾ Historia e PKSH pohon se kjo po ndodhte tashmë që në mars, por në atë muaj kjo mund të ishte e vërtetë vetëm për Brigadën I. Më 5 prill Shtabi i Përgjithshëm e urdhëroi Ushtrinë Nacionalçlirimtare Shqiptare (UNÇSH) që të hidhej në ofensivë gjithandej. Kjo duket se ka qenë një shembull tipik i praktikës së Enver Hoxhës për ta shtrirë dorën më tepër se ç'arrin dhe pastaj për të kërkuar përpjekje mbinjerëzore nga gjithë të tjerët, që të sigurohej se do të arrinte sukses kjo shtrirje. Në prill forcat gjermane organizuan disa sulme kundër partizanëve, por Tilmani në raportimin e tij i përshkruan ato se ishin me gjysmë zemre. Ata nuk patën sukses për ta ndërprerë ngritjen e UNÇSH. Të gjitha brigadat partizane ishin aktive:²²⁾ e para në malet në perëndim e në veri të Korçës, duke bërë operacione në veri deri në Librazhd; e katërta duke bashkëpunuar me të parën në zonën e Pogradecit e të liqenit të Ohrit; e pesta në zonën e Vlorës me të gjashtën, duke vepruar në jug të Gjirokastrës dhe, nga fundi i muajit, kapi Borshin në bregdet; e shtata duke punuar në afërsi të Beratit. Në veri Brigada II po priste të mblidhej përsëri në Pezë, batalionet e Çermenikës e të Dumresë po riformohehin në të dy anët e rrugës së Elbasanit dhe çeta e Esat Ndreut kishte dalë përsëri në sipërfaqe në zonën e Dibrës.²³⁾ Gjatë prillit oficerët e misionit britanik të kuartierit në Staraveckës, siç duket, i kanë bërë veprimet e tyre kryesisht në drejtim të Korçës, ndërsa për Brigadën I dhe IV emri i Nexhip Vinçanit del dendur në ditarin e Markus Lllajënit në këtë kohë. Alan Palmeri në bazën e Staraveckës ishte në kontakt të shpeshtë me Enver Hoxhën dhe Shtabin e Përgjithshëm, që u zhvendosën në Helmës, fare pranë Staraveckës, në mes të prillit. Siç e kemi treguar tashmë, në prill peshorja e furnizimeve të hedhura nga ajri anoi plotësisht në favor të partizanëve të LNÇ, por sasia totale e hedhur për ta gjatë muajit, 27.8 tonë, ishte ende modeste në krahasim me luftimet që ata po bënin dhe me nevojat urgjente që kishin për armë, municione, veshje, këpucë dhe ilaçe.

Gjatë prillit, Alan Palmeri i dërgoi Barit një rekomandim që Enver Hoxha të ftohej në Itali për bisedime rreth çështjeve ushtarake, ndoshta me komandantin Suprem të Aleatëve, gjeneralin Uillon, ose me përfaqësuesit e tij. Enver Hoxha dhe kolegët e tij e kishin ushqyer idenë që të vizitonin kuartierin e aleatëve në Mesdhe që kur ata u ri-

shfaqën në jug, pasi shpëtuan nga Shqipëria e mesme. Raporti i situatës së përditshme i Forcës 133, me datën 14 mars,²⁴) shënonte se Uileri kishte qenë në mbledhje me Enver Hoxhën e Spiro Mojsiun, që të dy (siç ishte vënë në dukje pa shumë mjeshteri) kishin qenë kohët e fundit në zonën e Tiranës dhe ata kishin përsëritur një kërkesë të mëparshme, që përfaqësuesit e tyre të bënin një vizitë në Kajro për të parashtruar çështjen e tyre. Uileri e rekomandonte me forcë një vizitë të tillë. Në prill Palmeri njoftoi se atij po i bëhej presion për këtë problem dhe se LNÇ e vështronte një ftesë si një shfaqje besimi.

Në një telegram të 5 majit, z. Filip Broud (Philip Broad) nga Bari i raportonte z. Harold Makmilan në Algjer, se propozimi ishte hedhur poshtë nga frika se të tjerët do të shihnin ndërlikime politike në një vizitë të tillë.²⁵) Kjo frikë, pa dyshim, kishte arsye të forta. Duket si e sigurtë që të pranohet, se Hoxha e kishte bërë propozimin pikërisht për shkak të ndërlikimeve të tij politike. Makmilani u përgjigj nga Algjeri, më 9 maj, se ai e miratonte hedhjen poshtë të propozimit, por mendonte se do të ishte e dobishme, nëse dikush nga Bari do të mund t'i bënte një vizitë Hoxhës në Shqipëri. Ndodhi që tashmë ishte bërë gati një plan që nënkoloneli Filip Lik, shefi i Seksionit të Shqipërisë në Forcën 133, të bënte një vizitë në Shqipërinë e jugut. Më 30 prill i ishte dërguar një mesazh me radio Alan Palmerit, që njoftonte arritjen e tij. Fatet e partizanëve kishin pësuar lëkundje aq të forta, sa që kërkohej një argumentim tepër i fortë që t'i vlerësonte ata dikush me autoritet nga Bari, i cili të njihte edhe panoramën më të gjerë të luftës. Nevoja e Barit për një vështrim më nga afër rreth situatës brenda në Shqipëri, dëshira e Enver Hoxhës për një formë njohjeje nga aleatët dhe ndjenja e Harold Makmilanit se duhej bërë një lloj gjesti inkurajimi për Hoxhën — që të gjitha u përputhën më së miri për ta bërë të përshtatshme vizitën e Filip Likut. Për Hoxhën një vizitë e Likut kishte shumë më pak vlerë se sa do të kishte pasur një vizitë e Hoxhës në Itali. Megjithatë, ajo mund të ishte e dobishme.

Për fat të keq, ajo e humbi këtë vlerë siç duhej ta kishte në sytë e Hoxhës, për shkak se ndodhi njëkohësisht me ardhjen e Bill Maklinit, që do të bashkohej me Abaz Kupin dhe forcat zogiste. Billi Maklini, David Smajli dhe Xhulian Emeri, që përbënin misionin Concensus II, ishin hedhur në Bizë, vendi i kuartierit të vjetër të gjeneralit «Trocki» Dej-

vis, më 19 prill dhe tashmë ishin vendosur në një fushim afër Xibrit dhe Bastarit, në verilindje të Tiranës, në krahnën e Abaz Kupit. Misioni Slender e thithi Concensus II. Hejri. Merreti dhe Bulloku u bënë pjesë e ekipit të Maklini. Oficerët e tjerë dhe ushtarakët e gradave të tjera, që kishin qenë rrotull zonës Slender gjatë dimrit nga misionet e copëzuara dhe të prishura në veri, u nisën në pikat e evakuimit, disa drejt jugut në krahinat e partizanëve shqiptarë për t'u evakuuar me anije nga Seaview, ose nga ndonjë pikë tjetër në bregun në jug të Vlorës, dhe disa drejt veriut te një brez fluturimi, që e mbanin partizanët jugosllavë në Malin e Zi.

Në këtë mënyrë u ngrit skena dhe dolën aty aktorët për dramën e «luftës civile», që do të zinte fundin e pranverës dhe verës. Alan Palmeri, që u gradua nënkolonel, drejtonte ekipin britanik si ndërlihdës me partizanët e LNC, ndërsa Billi Maklini, që gjithashtu u ngrit në gradën e nënkolonelit, drejtonte ekipin britanik të ndërlihdjes me zogistët-nacionalistët.

Misioni Stables, i drejtuar nga Riçard Ridelli, ku bëja pjesë unë, e nisi në ekipin e Maklini dhe përfundoi tek i Palmerit. Përndryshe të dy grupet, ose dy palët siç mund të quhen fare mirë lidhur me ndjenjat e forta të përfutuara nga puna e tyre, mbetën të ndara deri në fund të fushatës dhe, siç do ta shohim, edhe kur u bë paqja e madje deri në moshë të thyer.

Një fjalë e fundit i duhet shtuar këtij kreu për jugun dhe ringjalljen e partizanëve, lidhur me përgatitjet e Enver Hoxhës për verën. Nga fundi i prillit dhe në ditët e para të majit, po bëheshin të qarta dy gjëra. Nga ana ushtarake, Ushtria Nacionalçlirimtare Shqiptare që tani pohonte se arrinte numrin 35.000 burra e gra, po përgatitej për t'u shtrirë drejt veriut. Nga ana politike, LNC po përgatitej të thërriste një Kongres Nacionalçlirimtar për të zgjedhur një qeveri shqiptare të përkohshme. Në prill Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Shqipërisë i paraqiti një propozim lidhur me këtë Kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm të LNC dhe ishin marrë vesh që Kongresi I Antifashist Nacionalçlirimtar do të mbahej në Përmet nga fundi i majit. Përpara këtij u mbajt Plenumi I i Komitetit Qendror të PKSH në Helmës të Skraparit më 15 maj. Plenumi miratoi planet për ngritjen e një qeverie të përkohshme dhe për ta kthyer Ushtrinë Nacionalçlirimtare në një ushtri të rregullt, gjithashtu miratoi që armët do të mbeteshin në duart e njerëzve pas dis-

fatës së Gjermanisë, me qëllim që të sigurohej e të garantohet liria e popullit. U miratua edhe një rezolutë me qëllim që aleatët të mos lejoheshin që të ndërhyjnë në çështjet e brendshme politike dhe ushtarake të popullit shqiptar.

Kursi që po përgatitej për Shqipërinë ishte i qartë. PKSH, duke punuar nëpërmjet LNC, kishte vendosur të krijonte një asamblë kombëtare (Kongresin) dhe një qeveri, duke e llogaritur që kishte forcë ushtarake të mjaftueshme për të marrë pushtetin. Aleatëve (duke nënkuptuar në radhë të parë Britaninë) nuk do t'u vihej veshi nëse do të kundërshtonin. Kishte vetëm një lëshim domethënës nga vija e PKSH, që përndryshe ishte e ashpër. Ky lëshim ishte që të gjitha parullat duhet të vazhdonin të ishin parulla nacionalçlirimtare dhe jo parulla të Partisë Komuniste. Nuk ishte ende koha për të shpallur luftën e klasave, më së pari duhej fituar lufta që po zhvillohej. Me këto masa Enver Hoxha dhe PKSH po e shpallnin veten fitimtarë dhe po përgatishnin dhënien e çmimeve vetvetes, pikërisht po ashtu si britanikët po lëviznin për të nisur ndërmjetësimin, duke shfrytëzuar ato që mund të quheshin rregullat e Konferencës së Pezës të shtatorit 1942, pa e vlerësuar se sa të vjetruara ishin bërë ato gjatë dimrit. Konfrontimi nuk mund të mos ishte dramatik.

Shënimet

1. PRO, Air 23/1666.
2. PRO, Air 41/51.
3. Fluturimet e ndryshme mujore dhe tonazhi total në këtë krye dhe në krerët e mëtejshëm janë nxjerrë nga dosjet e ndryshme të PRO-Air 23/1665, 1666 dhe 1667, që përmbajnë raportet për Ministrinë e Aviacionit në Londër, në të cilat përmbliidhen operacionet ajrore në teatrin e Mesdheut në mbështetje të Operacioneve të Posaçme; Air 27/995 dhe 999 përmbajnë regjistrat e operacioneve të Skuadriljes 148 të RAF dhe Air 26/441 e 442 përmbajnë regjistrat e Regjimentit 334 të RAF.
4. PRO, Air 23/1666.
5. Tilman (1946, krerët 9-12).
6. Cepo nuk del në asnjë hartë që kemi pasur të Shqipërisë. Tilmani e vendos në afërsi të Lekdushit.

7. PRO, WO, 204/9530.
8. Quayle (1945, vijim).
9. PRO, WO, 204/10235 dhe FO. 371/43550, pasqyrat informative të Forcës 133 janë futur në dosje në mënyrë pak të rastit si në Arkivin e Ministrisë së Jashtme, edhe në atë të Ministrisë së Luftës.
10. PRO, WO. 204/9530.
11. Gjeneral majori Norman Wheeler pati mirësinë të më jepte një artikull të pabotuar, që ai e kishte shkruar pas lufte rreth përvojës së tij në Shqipëri dhe unë pata mundësi të mbështetësja te ai për pika të ndryshme të këtij kreu.
12. PRO, WO, 204/10235 dhe FO. 371/43550.
13. Hoxha (1982; 599).
14. Historia e Partisë së Punës të Shqipërisë (1982; 150).
15. PRO, WO, 204/10235.
16. PRO, FO, 371/43549.
17. Po aty.
18. Dedijer (1949; 70).
19. Alia (1988; 61). Ramiz Alia i ri ka qenë sekretar i Organizatës së Rinisë Komuniste të Beratit dhe në mars 1944, në moshën nëntëmbëdhjetë vjeç, ndiqte kursin, e parë të përgatitjes teorike të ngritur për kuadrot e partisë në Panarit. Ai e ka takuar Enver Hoxhën për herë të parë me këtë rast. Pas Panaritit atë e vunë në aparat politik të Brigadës VII të re, ku shërbeu deri në gusht. Në gusht ai mori pjesë në Kongresin e Parë të Bashkimit të Rinisë Antifashiste Shqiptare dhe në një mbledhje të Komitetit Qendror të Lëvizjes së Rinisë Komuniste në Helmës, ku ai u takua përsëri me Enver Hoxhën. Pas kësaj ai u ngrit në aparat politik të Divizionit II të ri në Shqipërinë qendrore-veriore. Kjo e solli atë në kontakt me Nexhmije Xhuglinin, e cila më vonë u bë gruaja e Enver Hoxhës. Ajo punonte në zonën e Divizionit II si e dërguar e Komitetit Qendror të Rinisë Komuniste. Në dhjetor Alia u takua edhe një herë me Enver Hoxhën, këtë radhë në Tiranë dhe përsëri u ngrit në post, duke u bërë komisar politik i një divizioni të ri, Divizionit V, i cili kishte detyrën delikate për të vepruar në Kosovë dhe përbëhej nga Brigada V (e marrë nga Divizioni II) dhe një brigadë e re, XXV. Kjo ngritje e shpejtë në dhjetë muaj nga një komunist shumë i ri pasqyron shpejtësinë e jashtëzakonshme të zgjerimit të UNÇSH më 1944, mungesën e komunistëve të besueshëm e me përvojë për të plotësuar postet kyç dhe vëmendjen e afërt personale që u kushtonte Enver Hoxha rekrutimit dhe vendosjes në poste të njerëzve të besuar.
20. PRO, WO, 204/10235.
21. PRO, WO, 204/10236.

22. Po aty.
23. Po aty.
24. PRO, WO, 204/10235.
25. PRO, FO, 371/43550, telegram i Barit për Algjerin nr. 7 dhe telegram i Algjerit për Barin nr. 3. 2. Makmilani ishte ministër britanik i përhershëm në AFHQ dhe Z. Broad ishte përfaqësues i tij dhe këshilltar politik i Ministrisë së Jashtme në Bari. Philip Broad më pas u bë këshilltar politik në Trieste dhe konsull i përgjithshëm në Stamboll.

Kreu 8

Raporti i Maklinit: përcaktimi i politikës në Londër — dërgimi i misionit Concensus II te Kupi

Majori Billi Maklin dhe kapiteni David Smajli erdhën në Bari nga fundi i nëntorit 1943, pasi i bënë dorëzimet gjeneralit Dejvis dhe misionit të tij të kuartierit. Aty ata u raportuan gojarisht oficerëve të ndryshëm, duke përfshirë edhe gjeneralin Aleksandër, kurse pas tri ditësh ata u nisën me aeroplan në Kajro, ku mund të merrnin udhëzime nga Seksioni MO4 për Shqipërinë. Në këtë kohë Seksioni i Shqipërisë nën majorin Filip Lik ishte organizuar si një seksion me personel të rregullt. Data zyrtare e shndërrimit të MO4 në Forcën 133 nën Kuartierin e Përgjithshëm të Lindjes së Mesme ishte 10 dhjetori. Po bëhej një ristrukturim i komandave të larta të Aleatëve në Mesdhe dhe në kapërcyellin e vitit gjenerali Meitlend Uillson (Maitland Wilson, më vonë feldmarshal, Lordi Uillson), u bë Komandanti Aleat Suprem në Kuartierin e Forcave Aleate (AFHQ) në Algjer dhe më vonë në Kazertë të Italisë, duke zënë vendin e gjeneralit Ajzenhauer, ndërsa Pexhet (Paget) u bë kryekomandant i Lindjes së Mesme në Kajro, duke zënë vendin e gjeneralit Uillson. Komandanti suprem i Aleatëve (SAC) tani u bë përgjegjës për operacionet në Ballkan (deri atëhere AFHQ kishte drejtuar në pjesën nga perëndimi i Adriatikut, ndërsa kuartieri i Lindjes së Mesme në pjesën nga lindja e Adriatikut). Këtej e tutje varësia e Forcës 133 ndaj SAC kalonte nëpërmjet Kuartierit të Përgjithshëm të Lindjes së Mesme.⁴) Gjeneral-majori Stouell

(Stawell) u bë përgjegjës për mbikëqyrjen e veprimtarive të Forcës 133 në Kajro e në Bari dhe kjo do të vazhdonte deri në prill, kur ai u ngarkua me Kuartierin e ri të sapoformuar për Operacione të Posaçme në Mesdhe drejtpërdrejt në varësi të AFHQ. Që atëhere u përfundua kalimi i gjithçkaje kishte të bënte me Shqipërinë nga Kajroja në Bari.

Maklini dhe Smajli e kaluan muajin dhjetor në Kajro dhe shkruan një raport mbi përvojën e tyre. Për këtë detyrë ata morën ndihmë nga Xhulian Emeri, i cili nuk kishte përvojën e tyre, por kishte një interes të gjallë për Shqipërinë që nga koha kur kishte qenë në Beograd më 1940 e 1941 dhe tani rastisi të ishte në Kajro. Sipas Smajlit, pjesën politike të raportit e bënë Maklini dhe Emeri, pjesën ushtarake e bëri Maklini me të dhe pjesën teknike e bëri vetë Smajli. Nga fillimi i janarit Maklini dhe Smajli vajtën me aeroplan në Londër, ndërsa Emeri u largua për një udhëtim në Arabinë Saudite.

Raporti²⁾ përmbante një histori të ngjeshur për rritjen e lëvizjes së rezistencës në Shqipëri. Lista e mëposhtme e ngjarjeve dhe e mendimeve më të rëndësishme, për të cilat ai tërhiqte vëmendjen, përbën një përmbledhje mjaft të goditur për evoluimin e situatës në Shqipëri nga fundi i vitit 1943:

- formimi i LNC në Konferencën e Pezës në shtator 1942;
- formimi i Ballit Kombëtar me parullën: «Shqipëria e shqiptarëve»;
- veprimtaria e gjallë e partizanëve të LNC, nëpërmjet së cilës ata gozhduan pesë divizione italiane dhe më pas dy divizione e gjysmë gjermane;
- formimi në verën e vitit 1943 i lidhjeve të bajraktarëve, kryesisht i Lidhjes së Dibrës;
- hyrja me forcë e gjermanëve në Shqipëri në shtator 1943 me kapitullimin e Italisë;
- ngritja e një qeverie kolaboracioniste në një Shqipëri që nënkuptohej si e pavarur;
- mungesa e nacionalistëve në Këshillin e LNC, me përjashtim të Abaz Kupit, Myslim Pezës dhe Baba Fajës;
- mbizotërimi i komunistëve në LNC dhe roli i rëndësishëm që luanin në forcat partizane komisarët politikë;
- tërheqja e Abaz Kupit nga LNC dhe formimi i Partisë Zo-giste në vjeshtën e vitit 1943;
- vendimi i LNC, pas grindjeve të ndryshme me BK, për t'u përqëndruar në eliminimin e BK pas tetorit 1943 e më vonë;
- zbatimi nga ana e gjermanëve, që nga tetori e më pas, i një politike terrori për të eliminuar LNC.

Përmbledhja dhe përfundimet e raportit meritojnë të botohen të plota. Ato ishin si më poshtë:

PËRMBLEDHJE DHE PËRFUNDIME

«LNÇ është e vetmja forcë ushtarake me ndonjë vlerë luftarake në këtë vend. Zona e saj përfshin pjesën më të madhe të Shqipërisë së Jugut e të Mesme, por me përjashtim të një grupi në zonën e Shkodrës dhe një tjetri në Kosovë, ajo nuk shtrihet në Shqipërinë e Veriut. Asnjë nga Nacionalistët që përbëjnë shumicën në Shqipërinë e Veriut, nuk duket i prirur për të luftuar kundër gjermanëve. Në të vërtetë, ata bashkëpunojnë me ta.

Lufta civile, që ka shpërthyer në zonat partizane, ka pasur prirje t'i shtyjë nacionalistët në gjithë Shqipërinë edhe më tepër për të bashkëpunuar me gjermanët, ndërsa njëkohësisht u rrëmben shumicën e energjive partizanëve. Me qëllim që të arrihet efektshmëria më e madhe kundër armikut, po bëjmë sugjerimet e mëposhtme:

- I. Lufta civile mund të ndalohej, në rast se partizanët pranojnë që më mirë të neutralizohen se sa të sulmohen ata elementë të nacionalistëve, të cilët janë kundër partizanëve. Në një bisedë jozyrtare kol. Velebit, i dërguari i Titos në Kajro, ka shprehur gatishmërinë për t'i kërkuar Titos që t'i dërgojë një direktivë të Këshillit LNÇ të Shqipërisë, duke udhëzuar partizanët të heqin dorë nga lufta civile. E vetmja gjë që kërkonte kol. Velebiti si shkëmbim ishte që BEC në asnjë mënyrë të mos mbështeste ose të përligjite qeverinë e regjencës apo të kolaboracionistëve, ose anëtarët e Ballit Kombëtar që po bashkëpunojnë me gjermanët.
- II. Lëvizja NÇ duhet të zgjerohet për të përfshirë sa më shumë nacionalistë që të jetë e mundur. Meqë herët-a vonë ne do të detyrohemi të bashkëpunojmë vetëm me partizanët, na duket në interesin tonë të sigurojmë që LNÇ të ketë sa më shumë jokomunistë që të jetë e mundur. Duke e pranuar që lufta civile mbaron, Abaz Kupi, i cili deri pak kohë më parë ka qenë anëtar i Këshillit Qendror të LNÇ, ndoshta do të mund të bindej që të kthehej në LNÇ dhe kështu do ta bënte veten një pikë grumbullimi për të gjithë ata nacionalistë, që janë të përgatitur të luftojnë kundër gjermanëve.
- III. Në Shqipërinë e Veriut shumë nga lidhjet e bajraktarëve dhe të fiseve mund të inkurajohen për të qenë më pak progjermane, duke u bërë një deklaratë nga ana e Titos se e ardhmja e Kosovës do

t'u lihet vetë kosovarëve për ta vendosur pas lufte dhe se do të bëhen zgjedhje, në të cilat kosovarët do të zgjedhin formën e vet të qeverisjes dhe shtetin në të cilin ata do të duan të jetojnë. Kol. Velebit gjithashtu ka thënë se kjo deklaratë tashmë ishte bërë dhe se ai mund ta rregullonte që asaj t'i jepej një publicitet sa më i gjerë i mundshëm nga ana e palës jugosllave. Po të ishte bërë kjo, do të kishte vepruar në mënyrën më të efektshme se çdo gjë tjetër që të shkëputeshin kosovarët nga gjermanët. Kjo gjithashtu do të hiqte një nga shtyllat kryesore të propagandës gjermane, e cila thotë se armiqtë e vërtetë të Shqipërisë janë grekët dhe jugosllavët.

- IV. Politika jonë duhet të jetë që t'i mbështesim partizanët me gjithë ndihmën e mundshme materiale, meqë ata janë e vetmja forcë ushtarake që e vlen të mbështetet në këtë vend. Njëkohësisht ne duhet të mbajmë kontakt me grupet nacionaliste dhe, po të jetë e mundur, të përpiqemi të ndalojmë luftën civile. Ne duhet të përpiqemi dhe të sigurojmë që nacionalistët më antigjermanë ose të bashkëpunojnë me lëvizjen LNÇ, ose të hyjnë në të. Ne duhet t'u japim partizanëve mbështetjen më të plotë nëpërmjet publicitetit për veprimet e tyre ushtarake, me qëllim që të tregojmë se përpjekjet e tyre luftarake njihen dhe çmohen. Njëkohësisht, ne duhet t'u ngulitim gjithë shqiptarëve se, kur të vijmë në Shqipëri aleatët, në asnjë mënyrë nuk do të bashkëpunojnë me ata elementë, që më parë kanë bashkëpunuar me gjermanët».

Harta në faqen tjetër është riprodhuar nga një hartë që i bashkangjitej raportit. Ajo tregon se si e shihnin Maklini dhe Smajli shpërndarjen e influencës së LNÇ, të Ballit Kombëtar, të nacionalistëve e të zogistëve në Shqipëri në tetor 1943. Ajo tregon gjithashtu se sa jorealiste dhe e thjeshtëzuar ishte pikëpamja se gjithë jugu ishte propartizan dhe gjithë veriu nacionalist.

Miratimi në raport për gjithë ndihmën e mundshme materiale për partizanët ishte pa mëdyshje, meqë ata ishin e vetmja forcë ushtarake që e vlen të mbështetet. Shprehej qartë zhgënjimi për nacionalistët. Nuk tregohet ndonjë besim i madh për Kupin: «ai ndoshta do të mund të bindej» për ta bërë veten një pikë grumbullimi për rezistencën, por për arsye vetëm ushtarake dhe jo ideologjike. Kolonelit Velebit i atribuohet më shumë se sa ai kishte mundësi të bënte, por dihej kaq pak nga britanikët për marrëdhëniet e PKSH me PKJ si në përgjithësi, ashtu edhe në veçanti, lidhur me Kosovën, saqë nuk është për t'u habitur nga kjo kapje pas një

fijeje bari. Pika në të cilën raporti përputhej me realitetin shqiptar ishte qëndrimi ndaj çështjes së luftës civile. Nga janari ishte përfunduar një lajë e plotë e parë e luftës civile me shpartallimin e partizanëve të LNC në qendër e në veri, që u snkaktua (siç e vështronin partizanët) nga bashkëpunimi i ballistëve e nacionalistëve me gjermanët. Nuk kishte asnjë shans që partizanët e LNC do ta harronin ose do ta falnin këtë, në rast se do të mbijetonin dhe do ta merrnin veten. Nuk kishte ndonjë ndryshim nga që partizanët e LNC, të mbështetur nga jugosllavët, e kishin shkaktuar vetë në një shkallë të madhe që kjo t'u binte mbi kokë, duke hedhur poshtë marrëveshjen e Mukjes dhe për arsye se me qëllim kishin ndërmarrë një ofensivë kundër BK në tetor. Forcat ishin vënë në lëvizje në një mënyrë që asnjë lloj ndërmjetësimi nga jashtë nuk mund ta ndalonte. Gjenerali Dejvis e kishte kapur këtë, kur dërgoi mesazhin e tij të 17 dhjetorit, që kërkonte denoncimin e hapur të Këshillit të Regjencës, të Ballit Kombëtar e të zogistëve dhe një deklaratë të hapur në favor të LNC. Dejvisi u largua nga skena menjëherë pas kësaj dhe nuk qe në gjendje ta shpjegonte pikëpamjen e vet më tej. Disfata që pësuan partizanët ishte e tillë, sa që vëzhguesit britanikë të cilët mbetën në vend, nuk mund ta përfytyronin se LNC do ta rimerre veten dhe kjo do të ishte aq e shpejtë dhe e plotë, sa ta bënte të sigurtë pjesën e dytë të luftës civile, aq më pak sa t'u jepte atyre një fitore totale e të shpejtë në këtë luftë.

Telegramet e dërguara nga Kajroja, në fillim të janarit, tregojnë se sa shpejt forcat e inercisë nisën të shuajnë rekomandimet e mprehta radikale që kishte dhënë Dejvisi, madje përpara se të qarkullonte raporti i Maklinit e Smajlit. Në një telegram të 1 janarit³, Kristofer Stili⁴ (Christopher Steel), konsull në ambasadën e Kajros, përgjegjës për dhënien e këshillave politike lidhur me çështjet e SOE dhe me operacionet e posaçme në Ballkan, njoftonte se Komiteti i Operacioneve të Posaçme (SOC) në Kajro kishte marrë në diskutim një letër nga Forca 133 që shqyrtonte anët pro dhe anët kundër për rekomandimet. Nga ana pro, ata kishin vënë dëshirën për të siguruar bashkëpunim të vazhdueshëm nga ana e LNC dhe për të siguruar se mbështetja britanike kundër gjermanëve ishte e vërtetë, si dhe faktin që Balli Kombëtar në mënyrë të padiskutueshme po bashkëpunonte me gjermanët. Nga ana negative, ata vinin nevojën për të shmangur ndërhyrjen në punët e brendshme të Shqipërisë, heqjen e shpresave për një kryengritje të përgjithshme shqiptare (d.m.th. më të gjerë se LNC) në kulmin e luftës, gjasën që BLO do ta kishin të pamundur

të vepronin kudo qoftë në veri të Tiranës dhe goditjen e shpresave për të hapur një pikë furnizimi në jug të Vlorës (pika e Seaview ishte e rrethuar nga një territor me Ballin Kombëtar). Përfundimi i SOC ishte që të deklarohej se do t'i jepej ndihmë kujtdo që luftonte vërtet kundër gjermanëve dhe popullarizim do t'u bëhej atyre që kishin luftuar vërtet. Në një telegram të dytë, Stili fliste më gjerë, për mendimet që ishin prapa kësaj pikëpamjeje për të mos ndërhyrë.⁵). Përpara se të mbante anën e një pale në luftën e brendshme, qeveria britanike duhej të ishte e sigurtë se e kishte gjetur palën e drejtë dhe të ishte gjithashtu e sigurtë se kërkesat ushtarake e kishin bërë me të vërtetë të domosdoshme që të zgjidhej njëra ndërmytet palëve. Vlerësohej se palët ishin të barabarta në krahasim. Pa dyshim LNÇ kishte bërë gjithçka kishte mundur të bënte kundër gjermanëve, por informacioni i mbledhur nga BLO me BK ishte i dobishëm dhe pranimi i ndihmës gjermane nga BK kundër LNÇ duhej të shihej më tepër si një veprim oportunist, se sa pro Boshtit. Për çështjen më të përgjithshme lidhur me nevojën që të mbahej qëndrim në favor të njëres palë, shkalla e luftimeve në Shqipëri ishte e parëndësishme, LNÇ në mënyrë të dukshme nuk ishte në po atë nivel si Titoja, përpjekjet e LNÇ kundër gjermanëve kishin qenë të dobëta dhe ata ishin realisht më të interesuar për të luftuar kundër BK, ndërsa Shqipëria nuk ishte në lidhjet vitale të komunikacionit të gjermanëve, kurse garnizonet gjermane kundër zbarkimit atje nuk do të tërhiqeshin për t'i kaluar në fronte të tjera, madje edhe po të pushonte krejt veprimtaria e gueriljeve.

Askush në Londër nuk e shihte të nevojshme të diskutonte këto argumente përjashtimore ose të vinte në dukje se, duke dërguar BLO në Shqipëri, Britania tashmë e kishte angazhuar veten për të nxitur rezistencën në Shqipëri dhe duhej të pritej që do ta linin prapa ngjarjet, nëse do të përpiqej të bëhej e paangazhuar. Meqë zakonet e të menduarit në Londër ishin për ta më tepër si një objekt, dhe një objekt tepër i lodhshëm për këtë, se sa si një subjekt, askush nuk u vu aspak në lëvizje për ta vlerësuar situatën atje fuqimisht. Po të mos ishte larguar nga skena «Trocki» Dejvisi, ai pa dyshim do ta kishte sfiduar të menduarit e turbullt në mënyrën e të arsyeuarit të Stilit dhe të SOC. Meqë kjo ndodhi, nuk kishte asnjë tjetër që të mund ta bënte ashtu.

FO e mori kopjen e vet të raportit të Maklinit e të Smajlit nën mbulesën e një letre nga nënkol. Talbot Rajs (Rice) të SOE, me datën 12 janar. Me sa duket, nuk u ndie që ishin të

domosdoshme vendime urgjente si rezultat i këtij raporti. Të dy oficerët patën takim me zyrtarë të ndryshëm, me Sekretarin për punët e jashtme Antoni Idenin, me Ministrin për çështjet ekonomike të luftës, Lord Selbornin, i cili ishte përgjegjës për SOE, dhe me Leo Emerin, Sekretarin për dominionet. Ata gjithashtu i bënë dy herë vizitë mbretit Zog dhe takuan mbretëreshën, Geraldinën me mbretin Zog në një drekë të shtruar nga Leo Emeri. Qarkullonte në ajër një ide dhe Maklinin ia përmendi Ideni se ndoshta ai duhej të kthehej në Shqipëri, që të përpiqej ta bënte Kupin të rrokte armët, por nuk u bënë plane të përcaktuara. Gjatë janarit ata dhe kushdo tjetër që takuan, kujtonin se ende kishte një mision të kuartierit në Shqipëri, të kryesuar nga Dejvisi. Ai nuk kishte qenë në lidhje me të tjerë që nga 18 dhjetori, por asgjë nuk mund të bëhej deri sa ai të dilte prapë në ndërlidhjen me radio dhe të raportonte se çfarë po u ndodhte. Në Londër kapja e tij u bë e njohur vetëm më 27 janar. Lajmi iu njoftua përgjegjësit të Departamentit të Jugut të FO, Daglas Hauard, në një letër nga Talbot Rajsi.⁶⁾ Po atë ditë, Hauardi nënshkroi një protokoll, për ta paraqitur raportin e Maklinin e të Smajlit për konsiderata në një nivel më të lartë, pasi kishte bërë një bisedë me autorët e tij javën e mëparshme. Ai shënonte në protokollin e tij se «Majori Maklin dhe majori Smajli ishin të një mendjeje me pikëpamjen tonë se sugjerimi i gjeneralit Dejvis, që ne këtej e tutje duhet të mbështesim LNC dhe ta lëmë të eci sipas rrjedhës punën me organizatat e tjera, ishte një sugjerim jo i mençur»⁷⁾. Kështu, rekomandimi i fundit dhe radikal i «Troçki» Dejvisit u la mënjanë pikërisht atë ditë, kur u mor vesh se ai vetë kishte humbur. Vëmendja e FO u përqendrua në mundësinë për ta vënë në jetë idenë e Maklinin që të bëhen përpjekje për t'i afruar bashkë përsëri LNC dhe Kupin. Maklini e kishte përpunuar pak atë, duke sugjeruar veçan se i duhej drejtuar mbretit Zog për t'i dërguar një mesazh personal Abaz Kupit që t'i kërkohej të bashkëpunonte me LNC, ndërsa Titos i duhej drejtuar që të përdorte ndikimin e tij mbi LNC për t'i bindur ata që ta ndreqnin grindjen që kishin me Kupin. FO i bëri telegram Kajros lidhur me këtë, duke kërkuar pikëpamjen e Kristofer Stilit.⁸⁾

Më 10 shkurt, Talbot Rajsi i shkroi Daglas Hauardit në FO, duke thënë se kishin marrë një telegram nga Kajroja, që kërkonte të dërgoheshin përsëri në Shqipëri Maklini e Smajli për të marrë komandën e misioneve të shpërndara në veri.⁹⁾ U morën vesh që ata të ktheheshin atje sa më shpejt të ishte

e mundur për t'u marrë me krizën që kishte lindur. Kjo i bëri urgjente konsultimet ndërmjet FO dhe SOE. Më 13 shkurt erdhi një telegram nga Stili, që u hidhte ujë të ftohtë përsipër propozimeve të Makliniut me këto shprehje:

«...sado të ishte i përshtatshëm dikur ky plan për të zgjeruar LNC, informatat e fundit, dmth. që kur u rivendos kontakti me Abaz Kupin, tregojnë se tani ai është vetëm një të menduar sipas dëshirës. Abaz Kupi... ka bërë... propozime të një natyre me të vërtetë shumë inkurajuese për krijimin e një lëvizjeje kombëtare gueriljesh. Megjithatë, ndonëse ai tani duket se po shqyrton seriozisht veprimet aktive kundër gjermanëve (pa dyshim, meqë e sheh se po afrohet fundi), nuk ka absolutisht asnjë dëshmi se Kupi do të bashkëpunonte me LNC, e cila me disa përjashtime të shquara, është praktikisht një grumbullim komunist. Ai është një antikomunist i vendosur dhe më kanë njoftuar se ai do të parapëlqente shumë më tepër të tërhiqte nga LNC elementët jokomunistë që kanë mbetur për t'i futur në organizatën e vet (në rast se do të dalë kundër gjermanëve), se sa të hynte përsëri në LNC. Propozimi për të renditur shërbimet e mira të mbretit Zog me siguri do të ishte i barabartë me daljen hapur në mbështetje të tij si kandidat për mbretërinë. Kjo do ta tërbonte LNC dhe nuk do të kishte të ngjarë të arrihej gjë e madhe me popullsinë e përgjithshme në rrethanat e tanishme. Së fundi, Kupi është i lidhur ngushtë me elementët më të mirë në Ballkom dhe për asnjë arsye nuk do ta komprometonte mbështetjen e tyre, duke e rregulluar grindjen me komunistët.

Fakti është se LNC e precipitoi luftën e klasave në Shqipëri dhe kjo u kap me zell nga gjermanët. Qendra e gravitetit në Shqipëri është diku në të djathtë (pjesa më e madhe e popullsisë është natyrisht anti-komuniste) dhe gjatë pak javëve të fundit, me ndihmën e gjermanëve, e majta e ka humbur shumë forcën. Lidhur me mbështetjen e dobët që dislokimi i tanishëm i aeroplanëve dhe (nuk dëshifrohet dot grupi i shifrave) për organizatën tonë në Shqipëri do të na bëjë të mundur neve ta japim, unë nuk mendoj se ne mund të arrijmë ndonjë rezultat me një manovër politike ambicioze si ajo që e propozon Maklini, që do të jetë në përpjesëtim të drejtë me vështirësitë politike në të cilat ne do të binim».10)

Ky vlerësim realist dhe, siç doli, profetik për shanset që të arrihej pajtimi ndërmjet Kupit dhe LNC, u shqyrtua në një mbledhje të Ministrisë së Jashtme me SOE, të kryesuar nga Sër Orme Sarxhenti, më datë 18 shkurt, duke qenë i pranishëm Maklini. Një procesverbal i asaj date¹¹⁾ nga Majkëll Rouz (Michael Rose)¹²⁾, Sekretari i dytë i Departamentit të Jugut, shë-

non se Maklini e pranoi që kishin një farë force vërejtjet e Stilit, por argumentoi se kishte një shans pesëdhjetë për qind që plani i tij të kornte sukses dhe madje edhe po të dështonte, gjërat nuk mund të bëheshin shumë më keq se sa ishin tashmë. Më 21 shkurt, Sër Orme Sarxhenti ia paraqiti rekomandimet Sekretarit të Shtetit¹³), duke u mbështetur në sigurimet e Makliniit si një farë zgjidhjeje o merre, o lëre. E vetmja mëdyshje e Sër Ormes ishte lidhur me futjen në valle të mbretit Zog, duke shprehur qëndrimin e kujdesshëm prej kohësh të FO lidhur me mbretin Zog; por kujdesit të tij ia hodhën Maklini dhe SOE, të cilët kishin sugjeruar që FO nuk duhej të ndërlikohej dhe mbretit Zog mund t'i drejtoheshin mbi baza thjesht ushtarake për t'i marrë një letër që t'i dërgohej Kupit. Prandaj Sër Orme rekomandoi që Maklini të autorizojë t'i kërkonte një letër mbretit Zog, në të cilën të porositej Kupi për t'u bashkuar me LNC kundër gjermanëve; kjo letër duhej të përdorej nga Maklini pas kthimit të tij në Shqipëri vetëm nëse ai do të bindej që nuk kishte rrezik serioz prej kësaj të intensifikojë lufta civile dhe, sido që të ndodhte, jo pa raportuar më parë për situatën. Komiteti i Operacioneve të Posaçme i Kajros duhej ta shqyrtonte kërkesën për Titon që të ndërhynte pranë LNC. Nëse Maklini më në fund do ta përdorte mesazhin e mbretit Zog pranë Kupit. Sër Aleksandër Kadogan ka shënuar në procesverbal që «kjo duket fare në rregull» dhe Sekretari i Punëve të Jashtme nuk kundërshtoi, duke u kufizuar vetëm të shkruante «po» pas pikës që thoshte se Maklini duhej të raportonte përpara se të vepronte me Kupin.

Ndërkaq SOE dhe Maklini i kishin dalë përpara punës: Maklini i bëri vizitën mbretit Zog dhe e mori letrën e dëshiruar, ndërsa Sekretari për Punët e Jashtme ende po shqyrtonte rekomandimin e Sër Ormes. Ky i fundit e pranoi që kjo ishte rezultat i një keqkuptimi *bona fide* nga ana e SOE dhe nuk ishte bërë asnjë dëm. Por, siç i tha ai Sekretarit për Punët e Jashtme, teksti i mbretit Zog nuk ishte plotësisht i kënaqshëm dhe do të duhej të ndryshohej. Ai paraqiti për miratim një riformulim të FO. që Maklini t'ia çonte prapë mbretit Zog dhe ai përsëriti edhe një herë sigurimet e tij, se nuk kishte ndonjë rrezik real duke ndjekur kursin e propozuar dhe se në tërësi e vlente barra qiranë. Sekretari i Punëve të Jashtme e dha miratimin e vet dhe shënoi se do të dëshironte ta takonte Maklinin për pesë minuta përpara se të kthehej në Shqipëri.

Në fakt mbreti Zog e kishte tërhequr shatin nga ana e

vet më shumë se sa e kërkonte urtësia. Përveç hartimit të një letre për Abaz Kupin, ai kishte bërë gjithashtu një letër për një farë Salih Vuçiterni Hoxha, një ish ministër i Punëve Botore, të cilin dukej se e kishte vlerësuar më lart se vetë Kupin¹⁴). Në letrën e hartuar për Kupin mbreti Zog fliste për padobinë që fshatrat shqiptare të rrezikoheshin nga shkatërrimet e djegiet dhe e kishte formuluar këtë në një mënyrë që të dukej se ishte bërë dhe, pa dyshim, që të kuptohej si një dënim i veprimtarisë luftarake të LNC, si dhe si një miratim i vijës së Ballit e të nacionalistëve, që rezistenca duhej të kufizohej me një kryengritje kombëtare në prag të fitores eventuale të Aleatëve në Europë. FO dëshironte që ta rumbullakoste thepin, duke e bërë të qartë se shkatërrimet e panevojshme ishin shkatërrimet e luftës civile, jo të luftës kundër gjermanëve. Mbreti Zog bënte thirrje gjithashtu për veprime të vendosura «kur unë t'ju jap shenjen e nevojshme.» FO donte ta ndryshonte këtë, duke e bërë «në lidhje me planët e komandës së Aleatëve». Letra e hartuar për Salih Vuçiternin përfshinte një element edhe më të kundërshtueshëm. Mbreti Zog donte të thoshte: «Atdheu ndodhet përballë një rreziku të madh: Korça dhe veçanërisht Kosova e Gjirokastra lakmohen nga fqinjët tanë, të cilët nuk kursejnë asgjë për të na i grabitur», e pak më tej: «Hoxha, si mik besnik që je, unë dëshiroj që ju ta merrni përsipër realizimin e këtij bashkimi të shenjtë dhe organizimin e përgjithshëm për shpëtimin e Kosovës, Korçës dhe Gjirokastrës». Ministria e Jashtme natyrisht ishte e shqetësuar, që të mos ngrihej çështja e pretendimeve të mundshme territoriale të Greqisë dhe aq më tepër në atë mënyrë, që mund të nënkuptonte mbështetjen britanike kundër Greqisë. Ishte e qartë se Kosova përbënte një çështje tepër përvëluese dhe nuk mund të prekej. Mbretit Zog i bëhej ftesë që të pranonte një tekst të ndryshuar, të propozuar nga Ministria e Jashtme, por më 8 mars ai përgatiti një version që përsëri përmbante ndjenja të papranueshme. Ai deshi të thoshte: «Fuqitë e Mëdha i kanë garantuar pavarësinë Shqipërisë, por kjo pavarësi dhe kufijtë kombëtarë do të realizohen me përpjekjet dhe me fuqinë tonë. Ne duhet të bashkohemi me ata që e vënë këtë qëllim mbi gjithçka tjetër», dhe: «Unë ju kërkoj që të bëni gjithçka të mundshme, që të bashkohen pa asnjë përjashtim të gjithë shqiptarët, të cilët janë gati të luftojnë kundër okupatorit të vendit, cilido qoftë ai». Ai kërkonte që fjala «djegia e panevojshme e fshatrave në luftën civile» të bëhej «djegia e panevojshme e fshatrave dhe lufta civile». Ndërmjet drejtorit të Departamentit

të Jugut në FO dhe Maklinin, më 11 mars, u arrit marrëveshja që ky i fundit do të kthehej për t'u takuar me mbretin Zog dhe që t'i thoshte se teksti i rihartuar prej tij nuk mund të pranohet. Siç ndodhi, Maklini u nis nga Londra për Itali më 14 mars dhe ideja për të marrë një letër nga mbreti Zog për Abaz Kupin u la mënjanë.

Ndonëse ai nuk mori me vete ndonjë letër për Abaz Kupin, Maklini u largua nga Londra me një mesazh gojor për Kupin, i cili vinte nga një tjetër keqkuptim. SOE pretendonte në mars¹⁵) se ishte arritur një marrëveshje midis atyre dhe Departamentit të Jugut të FO, që ndonëse ai nuk kishte asgjë me shkrim, Maklini duhej t'ia thoshte me gojë Abaz Kupit domethënien e atyre pjesëve të letrës së redaktuar nga Ministria e Jashtme, duke u nisur nga teksti i mbretit Zog, që kishin qenë të pranueshme për mbretin Zog. SOE e përmbulidhte pozitën kështu: Maklini do t'i transmetonte Kupit një mesazh gojor, që do të ishte si një thirrje nga mbreti Zog, e cila do të mbulonte tri pika. Duhej t'u jepej strehim gjithë BLO; Kupi duhej të bënte çmos për të arritur bashkimin kundër gjermanëve, pavarësisht nga bindjet politike; ai duhej të siguronte dënimin e gjithë atyre që bashkëpunonin me okupatorin. Hauardi në FO kishte shënuar se, kur Sir Orme dhe ai ishin takuar me Maklinin, ata nuk ishin marrë vesh për këtë. meqë vetë Maklini kishte thënë se kjo do të ishte e kotë, por ai shtonte: «Megjithatë nuk ka ndonjë të keqe, nëse do ta provojë, po qe se e mendon që e vlen barra qiranë». Brenda një muaji dhe nën trysinë e krizës së shkaktuar nga kapja e Dejvisit, Ministria e Jashtme, së cilës i mungonte çfarëdo bindje ose politikë kundrejt Shqipërisë, duke mos pasur as besim të mbreti Zog, e kishte ndryshuar rrënjësisht pozitën e vet, siç dukej qartë pa qenë e vetëdijshme për ndërlikimet e asaj që po bënte. Pikënisja në fund të janarit kishte qenë vlerësimi i raportit të Maklinin, se LNC ishte e vetmja forcë ushtarake me ndonjë vlerë luftarake dhe duhej të mbështetej me gjithë ndihmën materiale të mundshme. Në shkurt ata ndërruan dhe kaluan të ideja e Maklinin për një thirrje Kupit që të bashkohej përsëri me LNC, ndonëse madje edhe vetë Maklini nuk i jepte më shumë se pesëdhjetë për qind shanse për sukses. Së fundi, nga mbarimi i shkurtit, ata u angazhuan që të dërgonin ndërlidhësit britanikë eprorë të SOE me një mision të Kupi në emër të mbretit, duke e ftuar atë që të bënte një lojë si gjoja rezistencë kundër gjermanëve në Shqipëri.

Maklini dhe Smajli u larguan nga Londra ditët e fundit

të shkurtit, ndërsa tashmë Maklini ishte bërë nënkolonel dhe Smajli major. Smajli thotë se kur ata u kthyen në Kajro, u zgjerua plani që me misionin të bashkohej edhe Xhulian Emeri. Vetë Emeri thotë se Filip Liku, përgjegjës i Seksionit të Shqipërisë në Forcën 133, e thirri atë në ditët e para të shkurtit që ta ftonte të bashkohej me Maklinin në Concensus II, sepse Maklini i kishte kërkuar «një farë oficeri politik». Pjesën më të madhe të marsit Maklini, Smajli dhe Emeri e kaluan në Kajro. Pastaj u zhvendosën në Bari dhe u hodhën në Bizë më 19 prill.

Gjatë gjithë kësaj kohe informacioni për Shqipërinë që mund të gjendej në Ministrinë e Jashtme mbeti i varfër. Vetëm nga fundi i dhjetorit Kristofer Stili në Kajro nisi t'i dërgonte Departamentit të Jugut kopje të përmbledhjeve të informacionit dhe vlerësime të përdyjavshme të Forcës 133 (të Margaret Hezllakut). Informacioni që përmbanin ato ishte detyrimisht mjaft i rastit dhe i gabuar, sepse varej nga mesazhet e ndërmjetme me radio të BLO, vështirësitë e të cilëve për komunikim tashmë i kemi shpjeguar. Një shembull interesant i informatave të errëta ndeshet në një përmbledhje me datën 9 janar. Ajo thotë:

«Është gjetur ai që e ka ndezur luftën civile në Shqipëri. Siç është shprehur supozimi në të fundit «vlerësim dyjavor», ai është një i huaj, komunist dhe serb. Quhet Ali Dushanoviç nga Peja në Kosovën e Jugosllavisë, dhe njihet përgjithësisht nga partizanët në Shqipërinë e Jugut me emrin «Ali Peja», meqë Peja është trajta shqipe e emrit serb Peç. Ai oficeri i ri i shkëlqyer, i cili drejtoi grupin e parë që depërtoi në Shqipëri, mësoi për ekzistencën e tij dhe dyshonte se ishte i rëndësishëm, mirëpo nuk po e gjente dot as emrin e tij, kaq i madh ishte sekreti që e rrethonte. Zbulimin e bëri Mestar Ujaniku (një udhëheqës çete në Shqipërinë e Jugut). Në një letër me datën 14 nëntor, ai na njofton se ai dhe Xhelal Staravecka (një udhëheqës tjetër çete në jug) janë revoltuar aq shumë nga «lufta vëllavrasëse» që u është imponuar shqiptarëve nga «komunizmi serb i Dushanoviçit», sa që të dy e braktisën LNÇ.»¹⁶⁾

Identitetet dhe rolet e përpikta të jugosllavëve me PKS H dhe LNÇ mbetën diçka e fshehtë për oficerët britanikë, që u ndeshën me ta deri më 1944. Siç u shpjegua në kreun e parë, ata ishin dy, Miladin Popoviçi dhe Dushan Mugosha, i pari ishte më tepër *persona grata* për Enver Hoxhën se sa i dyti. Enver Hoxha thotë se Popoviçi shpesh njihej me emrin shqiptar Ali Gostivari. Ai del gjithashtu i njohur disa herë me

emrin Ali Alim. Ndërsa për Miladin Popoviçin Enver Hoxha flet me ngrohtësi, Mugoshën përpiqet ta ulë duke e përshkruar si sektar, megalloman dhe karrierist, që kishte shumë merit sipas mendimit të Titos e të kompanisë së tij. Hoxha nxjerr në dukje faktin që, nga pranvera e vitit 1943 e më tej, Mugosha punoi në lidhje të ngushta me Mehmet Shehun, në fillim në zonën e Vlorës dhe pastaj, pas formimit të Brigadës I, në zonat ku vepronte Brigada I. Duhet të kujtojmë se më 1982, kur po shkruante këto, Enver Hoxha ishte i interesuar për ta nxirë reputacionin e Mehmet Shehut, duke e lidhur atë me një jugosllav «të rrezikshëm» që në fazën e hershme të karrierës së tij në kohën e luftës. Jugosllavi që oficerët britanikë me partizanët do ta takonin më shpesh nënkuptohet që duhet të ketë qënë ai, që ishte më pranë Enver Hoxhës, pra Miladin Popoviçi, për ndryshe Ali Gostivari, alias Ali Alim.

Është tërheqës mendimi që ta quash Ali Dushanoviçin një personazh fantazie, të dyfishtë, të përbërë pjesërisht nga Miladin Popoviçi dhe pjesërisht nga Dushan Mugosha. Raporti i Maklinit e Smajlit i quan *éminences grises* jugosllavë si Ali alias Dushanoviçin dhe Veledinin. Peter Kempit thotë se pseudonimi Ali Gostivari i përkiste Dushan Mugoshës dhe se ky i fundit përdorte gjithashtu emrin Ali Dushanoviç. Emeri pohon se Partia Komuniste e Shqipërisë i pati zanafillat e saj në udhëzimet e Titos, të sjella nga dy të dërguar, që erdhën me pseudonimet Ali dhe Miladin, ndërsa pak më poshtë ai e emërton delegatin e Titos pranë LNC si Ali Dushanoviç. Është e qartë se Enver Hoxha dhe kolegët e tij janë kujdesur që të hedhin një vello mistifikimi rreth shokëve të tyre jugosllavë, dhe se britanikët nuk kanë qënë në gjendje që t'i ngrenë palat e saj, por edhe duke qënë kështu, është çorientuese që në një përmbledhje informative britanike të janarit 1944 të gjesh se na serviret «Ali Dushanoviçi» sikur paska qënë *fons et origo* i turbullirave të Shqipërisë. Përmbledhja me datën (dy javë më vonë) 23 janar¹⁷), citon një revistë të re të botuar në Shqipëri me titullin «Mbrojtja kombëtare», që i përmendte emrat e agjentëve të huaj, të cilët punonin në Shqipëri si: Shuli, një bullgar, Dushanoviçi, një serb që thuhej se ishte sekretari i Partisë Komuniste Shqiptare, dhe Millajdonoviçi, sekretari malazias. Të tilla qënë ato fije kashte, që përbënin gjithçka kishte qënë e mundur të qëmtohej si ndihmesë për përpjekjet e Londrës, që të bënte një a dy tulla për politikën ndaj Shqipërisë.

Vështirësitë që i dilnin SOE në përpjekjet për të kuptuar

peripecitë e Shqipërisë mund të ilustrohen nga disa telegrame që Kristofer Stili në Kajro i ka dërguar Daglas Hauardit, shefit të Departamentit të Jugut në FO, ditët e fundit të shkurtit.¹⁸⁾ Stili njoftonte se nuk kishte dyshim që një numër i madh përkrahësish të BK po bashkëpunonin ngushtë me gjermanët kundër LNC në Shqipërinë e Jugut; gjithashtu u provua si autentike informata që e ndërlikonte BK në kapjen e gjeneralit Dejvis. Drejtorja e Luftës Politike si pasojë përgatiti një vijë më të ashpër kundër bashkëpunësorëve të pushtesve, për ta transmetuar nëpërmjet Radio Londrës. BK po kishte sukses të dukshëm dhe LNC ishte në një ngushticë mjaft serioze. Megjithatë Komiteti i Operacioneve të Posaçme në Kajro ende lëkundej që ta dënonte Ballin Kombëtar, sepse BK ishte një organizatë e çlirët dhe jo koherente, që përfshinte disa njerëz që ishin vetëm në mbrojtje kundër komunizmit, po ashtu si të tjerë që ishin agresivë. Më tej Stili përmendte si shembull rastin e Seaview, pikën që mendohej për furnizim nga deti në jug të Vlorës. Pjesa e territorit aty rrotull ishte nën kontrollin e BK, por BK në këtë rast ishte mbrojtës, jo agresiv dhe ata kishin qëndrim miqësor ndaj oficerëve ndër-lidhës britanikë. LNC bënte kërcënime se do ta sulmonte atë zonë kryesisht me qëllim për të siguruar ushqime. Askujt nuk i vinte ndonjë e mirë nëse do të vepronte dikush ndryshe, ose nëse do të ngriheshin gjermanët për ta shkatërruar zonën. Udhëheqësi lokal i BK, Skënder Muçoja, kishte parashtruar një plan ambicioz për të bashkëpunuar në organizimin e një kryengritjeje kundër gjermanëve në çastin e duhur, me kusht që të jepeshin sigurime për të ardhmen e Shqipërisë. Ai për vete kërkonte që të pranohej si bashkëbisedues ndërmjetës në Kajro. Ndërsa SOC nuk mund ta trajtonte këtë oficer shumë seriozisht, përsëri e pranoi që ishte menduar sinqerisht dhe duke mbajtur parasysh vlerën e mundshme të bashkëpunimit të BK gjatë tërheqjes së gjermanëve, vendosi në favor të justifikimit me vepra. Veprimet sulmuese të BK kundër LNC duhej të ndërpriteshin dhe atëhere mund të zhvilloheshin bisedime për një bashkëpunim në shkallë modeste ndërmjet britanikëve dhe BK.

Në fakt, partizanët (Mehmet Shehu dhe Brigada I) i dhënë goditje BK në zonën e Seaview para se të arrihej ndonjë gjë, por nuk ka arsye të mendohet se BK do të mundte ndonjëherë ta përballonte provën e justifikimit me vepra. Ky ishte një version nga Shqipëria e Jugut i historisë së Muharrem Bajraktarit ose në të vërtetë, i historisë së Abaz Kupit. Gabimi nga ana britanike ishte se mendohej që rezistenca

mund të arrihej me bashkëbisedime ose të bëhej realitet me të lutura. Në të vërtete, rezistenca është një shkëndijë që shkrep vetvetiu në mendjet dhe në zemrat e njerëzve dhe e cila mund të ndihmohet kur del jashtë, por nuk mund ta bësh nga jashtë që të shkrepë. Burimi i saj më i sigurtë janë bindjet politike dhe ato duhet të vijnë nga brenda dhe jo nga jashtë. Në Shqipëri u provua që bindjet politike të LNC ishin burim i flakës së rezistencës, kurse përkundrazi bindjet politike të nacionalistëve të BK prireshin ta shuanin atë. Në kundërshtim me të gjitha qëllimet e mira, Seaview asnjëherë nuk bëri mbarë dhe materialet e rezervuara aty ranë në duart e gjermanëve. Një pikë furnizimi nga deti u ngrit në një plazh më në jug, afër Borshit, në maj dhe pati sukses, sepse e mbanin partizanët atë rrip bregdeti dhe morën një furnizim prej 30 tonësh materiale atje. (Kjo ndodhi kur u evakuan Tilmani dhe Uileri, shih kreun e mëparshëm).

Deri në prill 1944 i vetmi raport nga një burim i dorës së parë për gjendjen në Shqipëri, që erdhi në Bari, në Kajro dhe në Londër ishte ai i Makliniit dhe i Smajlit. Që nga maji e më pas erdhën raporte të tjera, meqë nisën të evakohen oficerët nga Shqipëria e Jugut. Ato duhet të kenë pasur një farë efekti mbi oficerët e personelit në Bari dhe eventualisht, pas vonesave në transmetim, edhe mbi zyrtarët në Londër. I pari nga këto raporte ishte ai i majorit Antoni Kuejlit. Ai kishte qenë përgjegjës i misionit Sapling dhe i bazës së furnizimit e të evakuimit në shpellën e Seaview dhe në Gjirin e Gramës që nga fillimi i janarit, por kishte vuajtur nga një varg sëmundjesh dhe kishte ikur nga Shqipëria më 3 prill. Raporti i tij për gjendjen mbante datën 30 prill. Fragmentet e mëposhtme japin pikëpamjet e tij për Ballin Kombëtar, për marrëdhëniet BK-LNC dhe për shanset e pajtimit ndërmjet tyre:

«Partia e Ballit Kombëtar

Nuk duhet menduar se kjo është një parti e organizuar në po atë mënyrë si edhe LNC. Ai është një grumbullim i padisiplinuar i njerëzve të veçantë, që i bashkon vetëm urrejtja e tyre kundër komunizmit, anarkizmit e terrorizmit, dhe frika se çfarë do të ndodhë me Shqipërinë, nëse partizanët do t'ia dalin mbanë të imponojnë doktrinën e tyre mbi këtë vend.

Udhëheqësit e tij përfshijnë njerëz që pa dyshim kanë patriotizëm dhe parime të larta, njerëz me pikëpamje politike të moderuara. Duke i mbajtur sytë hapur, këta njerëz janë rreshtuar me gjermanët kundër

LNÇ. Ndoshta ata kanë menduar se rreziku i komunizmit është më kërcënues se sa pushtimi (mjaft dashamirës) nga gjermanët. Ndoshta ata kanë menduar se çlirimi i Ballkanit mund t'u lihet fare mirë Aleatëve, ndërsa ata — Ballkomi — do të përqendroheshin në armiqtë e trashëguar e të ardhshëm, siç janë grekët e jugosllavët, për çështjen e kufijve të të cilëve Aleatët nuk do të bënin deklarata të hapura. Ndoshta ata e besonin propagandën gjermane — gjë e kuptueshme, po të shihet se sa shumë gjermanë e kanë besuar atë dhe ende e besojnë — që Aleatët, domethënë demokracitë, do ta përfundojnë luftën duke u bashkuar me Gjermaninë për të thyer Rusinë.

Me këta njerëz pastaj janë bashkuar udhëheqës të tjerë, disa gjermanofitë të tërbuar, si Risilia, udhëheqësi i bandës balliste. Për të luftuar për ta kanë ardhur fshatarë e barinj, të cilëve u janë vrarë njerëz të afërt ose u janë djegur shtëpitë nga partizanët.

(Politika e terrorizmit, e zbatuar nga partizanët, ka qenë e efektshme në shumë raste, por ajo krijon njësoj edhe armiq të rreptë në këtë vend të hakmarrjes personale). Kështu të dyja palët krijuan bandat e tyre të hakmarrjes dhe Ballkomi vendosi që të vërë të gjitha forcat për të shkatërruar partizanët.

Ata pothuajse ia dolën qëllimit. Mirëpo ata në të vërtetë «e nxorën gjarpurin, por nuk e vranë» dhe pas një kohe të shkurtër, në sajë të ndihmës britanike, LNÇ «do ta mbyllte e do të ishte prapë vetë».

Pra Ballkomi dështoi në qëllimet e veta dhe tani është më larg se kurdoherë nga mundësia për ta shkëputur veten prej bashkëpunimit me gjermanët.

Duke e kuptuar se tani është e sigurtë që gjermanët do të munden dhe se ne i shohim ata pothuaj si kuizlingë. ballistët po e shohin me shqetësim të ardhmen. Ata përbëjnë një pakicë në Shqipërinë e Jugut dhe prandaj kush do t'i shpëtojë ata tani nga hakmarrja e partizanëve ditën kur gjermanët të ikin nga Shqipëria?

Aq e madhe është nevoja që kanë për miq të fuqishëm, sa tani po përpiqen të bëhen aleatë me zogistët.

Mundësitë e pajtimit

Ata janë shumë të largëta, meqë partizanët, kur janë në pozitë të mirë, flakin çdo kompromis.

T'i lësh ata që të shkatërrohen — siç do të ndodhte me siguri pa ndihmën e Aleatëve — është krejtësisht në kundërshtim me politikën e Aleatëve dhe prandaj, duke rënë në një rreth me cen dhe ironik, ne vetë jemi duke krijuar kushtet në të cilat pajtimi është i pamundur.

Të shpresosh për pajtim brenda vendit, ose madje qoftë edhe për një takim të dobishëm ndërmjet protagonistëve,

është e kotë. Në rast se duhet bërë ndonjë përpjekje për të ndaluar luftën civile, ajo mund të bëhet vetëm duke i thirrur përfaqësuesit me autoritet në një takim, nën kujdestarinë tonë, që të mbahet në tokën italiane.

Asgjë tjetër nuk mund të arrijë sukses dhe nëse palët nuk do të pajtohen tani, asgjë nuk do të mund ta parandalojë që të shpërthejë një luftë civile në shkallë të gjerë ditën e tërheqjes së gjermanëve, e ka mundësi të shoqëruar me një invazion të partizanëve grekë në Shqipërinë e jugut, të cilët do të vijnë për të ndihmuar shokët e tyre shqiptarë.

Prania e trupave të Aleatëve do të mundte — pothuajse me siguri do ta bënte këtë — ta parandalonte.¹⁹⁾

Nga fundi i majit, Norman Uileri dhe Bill Tilmani u evakuan. Raporti informativ i Tilmanit mbante datën 10 maj dhe duhet të ketë qenë i njohur për oficerët e personelit në Bari që nga ajo datë, por ai nuk qarkulloi në Londër deri më 12 korrik. Përfundimet e Tilmanit ishin këto:

«Kur u largova unë isha po aq i bindur, sa kisha qenë për disa muaj më parë, se politika jonë për të mbështetur LNÇ ishte e ndershme dhe e përshtatshme, meqë ata ishin e vetmja palë në Shqipëri që kishte po ato qëllime luftarake si edhe tonat, të gatshëm për të bërë sakrifica për to. Për më tepër, ata nuk janë një grumbull krerësh fisnorë ose feudalë me pasues personalë, por një palë e organizuar, që përfaqëson të dy besimet fetare, të dy ndarjet krahinore dhe të paktën 75% të popullsisë në Shqipërinë e Jugut e të Mesme. Dhe ndonëse Partia Komuniste e Shqipërisë është e përfshirë në LNÇ, ata mirëpresin këdo që do të luftonte kundër nazizmit ose fashizmit dhe e kanë deklaruar herë pas here se ata po luftojnë për një Shqipëri të pavarur, të lirë e demokratike.

Ata i mbanin shumë të fshehta planet e tyre, por nuk duhen fajësuar për këtë. Ata e kuptonin që ne po bënim çmos për t'i ndihmuar nga ana materiale, por efekti i mirë i kësaj ane është kundërbalancuar për keq nga ndihma që u japim njësoj palëve të tjera, edhe nëse jo me materiale e me para, qoftë edhe me inkurajimin tonë. Mungesa e popullarizimit në radio dhe në shtyp të përpjekjeve dhe sakrificave që po bënte LNÇ; mungesa e denoncimit të Ballit Kombëtar që po bënte aleancë të hapur me armikun; mungesa e denoncimit të qeverisë së Tiranës; numri i oficerëve ndërlihdës me palët e tjera; mosdëshira e dukshme për të besuar gjithçka që njoftohej nga ana e LNÇ; paraqitja e gabuar nga padija ose me qëllim e gjendjes në Shqipëri nga udhëheqësit tanë të luftës, p.sh. deklarata e z. Atli (Attlee) në Dhomën

e Parlamentit në 23 maj, — të gjitha këto i kanë bërë ata që të kenë dyshim dhe të jenë zemëruar me qeverinë britanike, ndërsa në mendjen e tyre kjo mund të shpjegohet vetëm me ndikimin e asaj që ata e quajnë «klike reaksionare në Londër». Për këto arsye, kjo flet shumë për elasticitetin, vullnetin për të fituar dhe besimin në vetvete e në çështjen e tyre, që LNC i ka përballuar shtërngesën dhe tensionet e dymbëdhjetë muajve të kaluar dhe tani është e gatshme dhe e aftë të marrë përsipër kontrollin e Shqipërisë kur të vijë koha».20)

Me sa duket, raporti i Uilerit i është paraqitur SOE në Londër pas kthimit të tij atje dhe jo në Bari. Përveç përgatitjes së raportit të shkruar për SOE, ai u bëri vizita z. Antoni Iden, Lord Selbornit (ministrit përgjegjës për SOE) dhe gjeneral-majorit Gubins (Drejtori i SOE). Ai u bëri vizita edhe z. Harold Makmilan dhe gjeneralit Mejtland Uillson në Itali. Në të gjitha këto raste, ai foli sipas vijave të raportit të shkruar. Një përmbledhje që përmbante pjesët thelbësore të tij, erdhi në FO e shoqëruar me një letër nga majori Boksshall i SOE me datën 30 qershor. Pasazhi i mëposhtëm përmban argumentet e tij qendrore:

«Marrëdhëniet me LNC kanë qenë tërësisht të përzemërta. Në muqesë të Komitetit Qendror dhe të gjeneralit të brigadës gjatë pjesës së parë të vitit 1944, unë kam qenë në kontakt të ngushtë me përfaqësues të Komitetit Qendror, e konkretisht me dr. Shyllën, Koçi Xoxen, Haxhi Lleshin dhe Ali Alimin (të njohur për BO si Aliu nga Peja ose Ali Gostivari dhe që paraqitej prej tyre si oficer ndërlidhës i Titos). Asnjë herë nuk e kanë ngritur çështjen e kufijve të ardhshëm të Shqipërisë, por kanë përsëritur dëndur që synimet e tyre ishin një Shqipëri e bashkuar si një demokraci e sunduar nga populli.

Qëllimi kryesor i LNC është të dëbohen gjermanët nga vendi. Është shprehur mendimi se kjo është një dredhi nga ana e tyre për të siguruar ndihma të tjera prej Aleatëve. Një komb që ecën zbathur në dëborë, të cilit ia djegin dhe ia plaçkisin shtëpitë, që vdes urie nëpër male si mjet mashtrimi, e meriton të fitojë. Sukseset ushtarake të partizanëve në Shqipëri nuk kanë qenë, dhe për shkak të natyrës së vendit, nuk kanë mundësi të jenë aq spektakolare sa gjetkë, por nuk ka asnjë dyshim se partizanët po bëjnë një luftë aktive kundër gjermanëve.

Është provuar përtej çdo hijeje dyshimi, se qeveria e Tiranës dhe Ballkomi janë duke bashkëpunuar aktivisht me gjermanin, ndërsa pjesa tjetër e vendit, duke ndenjur si soditës, bashkëpunon pasivisht. Prandaj mund të çmohet se është jashtëzakonisht e vështirë që t'u shpje-

gosh partizanëve arsyen përse Aleatët jo vetëm nuk i denoncojnë këta bashkëpunëtorë, por u japin furnizime (p.sh. Seaview, ku kishte rëndësi parimi dhe jo sasia) dhe vazhdojnë të mbajnë misione ushtarake pranë tyre. Më kanë thënë se misionet duhet të mbahen për qëllime informative, por është e sigurtë se kjo është një detyrë që i përket më tepër një agjenti se sa një ushtaraku.

Gjatë gjashtë muajve të kaluar, së bashku me majorin Tilman dhe Palmerin, unë kam kërkuar që të bëhej një ndryshim i politikës dhe kam paraqitur rekomandimet përkatëse. Pozita ka mbetur e pandryshuar. Majori Lik kaloi katër javë në atë vend dhe ka parashtruar pikëpamje pothuaj identike, duke shprehur mendimin se fatkeqësisht LNC e ka gjithçka në dorë... e përse «fatkeqësisht»? Unë jam një ushtarak profesionist e nuk jam politikan, por nga ajo që kam parë për LNC, ajo është plotësisht e aftë ta drejtojë Shqipërinë dhe duke e kënaqur popullsinë. Partia e LNC është jashtëzakonisht mirë e organizuar dhe, duke mbajtur para sysh mungesën e komunikimit në vend, është e kontrolluar mirë. Me sa duket, edhe majori Lik e quan se duhen marrë disa masa dënimi për bashkëpunëtorët.

Asnjëherë LNC nuk më ka bërë ato që do t'i quaja kërkesa të tepëra. Ata më kanë paraqitur katër pika, të cilat i përsëriti Komiteti Qendror kur erdhi në mars dhe që unë i kam rekomanduar dhe ia kam parashtruar Kajros.

Ndonëse përdoren komisarët sipas modelit rus, duhet thënë në të mirë të LNC, se nuk është bërë asnjë përpjekje për të dëmtuar personelin britanik dhe në fakt LNC kurdoherë ka treguar se është e vetëdijshme për përgjegjësinë që ka për mbarëvajtjen tonë, ndoshta sepse ata donin të na krijonin përshtypjen, ose sepse e ndiejnë me të vërtetë, që ne jemi Aleatë.

Pjesa më e madhe e Jugut është me të vërtetë pro partizanëve dhe në shumë raste kemi ndeshur persona në zona të tjera, që kanë simpati për partizanët (p.sh. ata që shpëtuan nga territoret e Ballkomit, Karteri dhe Kaningami të W.O., pjesa tjetër e grupit të tyre iu dorëzua gjermanëve).

LNC tashmë po zbaton një program ndihme për popullsinë civile me aq burime sa kanë.

Unë nuk kam pasur të bëj me asnjë palë tjetër dhe, në fakt, kam qenë i detyruar ta zhvendos kuartierin tim në dy raste, për shkak të presioneve të Ballkomit e të gjermanëve. Unë erdha në këtë vend si oficer shtabi i gjeneralit të brigadës me pikëpamje të paangazhuara përsa i përket politikës; radhët e mësipërme paraqesin përfundimet e mia pas pothuaj gjashtë muajsh në kontakt të afërt me LNC, në shumicën e viseve të Shqipërisë së Jugut».21)

Këto citime nga raportet informuese tregojnë se ndërmjet BLO po ngjallehin ndjenja të forta për shkak të ekuivoqeve në politikën britanike. Këto ndjenja vazhduan të shtoheshin gjatë pranverës dhe verës. BLO me partizanët e LNÇ e shihnin se vetëm klientët e tyre po luftonin kundër gjermanëve në çfarëdo rruge domethënëse, ata e shihnin me sytë e tyre se këto ishin luftime gjithnjë e më serioze dhe jo të shtira. Ata e dinin se partizanët e LNÇ e kishin sulmuar Ballin Kombëtar, por ata e kishin parë BK se si ndihmonte gjermanët për të sulmuar partizanët e LNÇ. Për ta ishte e vështirë që të pranonin se ballistët, nacionalistët dhe zogistët duhej të gëzonin në mënyrë të përsëritur favorin se mbeteshin dyshime, kur ata nuk luftonin kundër gjermanëve. Dukej se në një afat të shpejtë të arsyeshëm Britania do t'u kthente krahet nacionalistëve që nuk luftonin dhe do t'u jepte partizanëve mbështetjen e saj pa mëdyshje, siç kishte ndodhur tashmë në rastin e Jugosllavisë. Udhëheqësit e partizanëve të LNÇ vazhdimisht i qortonin BLO përse Britania nuk e bënte këtë dhe Enver Hoxha e kishte gjithnjë e më të lehtë të impononte vijën e tij «ta bëjmë vetë», «të mos i përfillim aleatët», e cila pati përfundimisht sukses me një çmim të lartë për Shqipërinë dhe me pasoja të dëmshme shumë serioze për marrëdhëniet ndërmjet aleatëve perëndimorë dhe Shqipërisë në fund të luftës. Siç u pa tashmë në pjesën e parë të këtij kreu, ishin krejt të rastësishme arsyet përse Britania vazhdoi të mbante qëndrim ekuivok. Këto arsye veç kësaj, ishin të shumta. Kjo erdhi sepse humbi para kohe gjenerali Dejvis; sepse Maklini dhe Smajli ishin në vend në çastin e krizës dhe u zhgënjyen me partizanët dhe (me ndihmën e Emerit) e mbivlerësuan fuqinë dhe influencën e Abaz Kupit; sepse vendimi për të dërguar Maklinin me një mision të ri pranë Kupit ishte mbështetur në një tablo të ngjarjeve që ishte e azhurnuar në tetor, por ishte e prapambetur në janar; sepse misionet në veri dhe personeli në Kajro mendonin në janar se partizanët kishin marrë fund; sepse misionet në veri ishin më të shumta se në jug dhe krijuan një opinion të gabuar të shumicës, dhe së fundi, sepse vetë partizanët e LNÇ, me Enver Hoxhën si udhëheqësin e tyre, jo vetëm që nuk mbajtën qëndrim të plotë bashkëpunimi ose frymëzues për mirëbesim, por bënë shumë më pak se gjysma e kësaj në marrëdhëniet me misionet britanike më 1943. Nëse ata dukeshin më të prirur për bashkëpunim në jug gjatë pak muajve të parë të vitit 1944, ishte e vështirë të mos besojë se kjo vinte për shkak se ata kishin marrë disa ndëshkime

të ashpra nga gjermanët. Nuk ka arsye të besohet që ndërhynte ideologjia në vendimet ushtarake që merreshin nga ana britanike deri në pranverë 1944. Megjithatë, vendimi për të dërguar prapë Maklinin në një mision pranë Kupit, i cili nuk kishte bërë asgjë më shumë se krerët e tjerë të veriut për të fituar këtë favor, shkaktoi që të fillonte të dukej sikur interesi kryesor i Britanisë ishte për ta penguar e për ta ngatërruar LNC. Nuk ka qenë ky qëllimi i Londrës. Do të ishte e vështirë që të tregohej se Londra në atë kohë kishte çfarëdo synimesh të posaçme përgjithësisht në marrëdhëniet me Shqipërinë, të tjera veç inkurajimit të rezistencës kundër gjermanëve në çfarëdo rruge që mund të ishte e efektshme. Por dyshimet e thella ndaj synimeve të Britanisë nisën t'i ndërlikonin marrëdhëniet me LNC që nga ajo kohë e më pas.

Shënimet

1. PRO, WO, 204/10392.
2. PRO, FO 371/43549 dhe WO. 204/9461. Raporti përbëhej nga këta kre-rë: (I) hyrja; (II) një përmbledhje e kontakteve politike të bëra; (III) një analizë e strukturës sociale të Shqipërisë; (IV) historia e rritjes së lëvizjeve të rezistencës shqiptare; (V) një paraqitje e Lëvizjes Nacionalçlirimtare, LNC; (VI) një paraqitje e Ballit Kombëtar, BK; (VII) një paraqitje e Partisë Zogiste; (VIII) një paraqitje e lidhjeve të bajraktarëve, kryesisht për Lidhjen e Dibrës; (IX) formimi, pas rënies së Italisë, i një qeverie shqiptare që bashkëpunonte me gjermanët; (X) përçarja e lëvizjeve të rezistencës në lëvizje të së djathtës e të së majtës dhe kërcënimi i një lufte civile ndërmjet LNC dhe të tjerave; (XI) një përmbledhje e qëndrimeve të shqiptarëve ndaj aleatëve dhe të tjerëve (Anglisë, SHBA, Ruisë, Greqisë, Jugosllavisë, Gjermanisë, Turqisë, Italisë, Maqedonisë e Bullgarisë; (XII) përmbledhje dhe përfundime.
3. PRO, FO 371/43555, telegram i Kajros për FO, nr. 2.
4. Më vonë Sir Christopher Steel, GCMG, ambasador në Bon.
5. PRO, FO. 371/43549, telegram i Kajros për FO, nr. 3.
6. PRO, FO. 371/43549.
7. Po aty.
8. Po aty.
9. Po aty.
10. PRO, FO. 371/43549, telegram i Kajros për FO, nr. 277.

11. PRO, FO, 371/43549.
12. Më vonë ministër në Bon, kur Sir Christopher Steel ishte ambasador atje dhe më pas ambasador në Leopoldvil.
13. PRO, FO. 371/43549.
14. PRO, FO. 371/43550.
15. Po aty.
16. PRO, FO. 371/43549.
17. Po aty.
18. PRO, FO, 371/43555. telegram i Kajros për FO. nr. 327 dhe 365.
19. PRO, WO. 204/9530.
20. Po aty.
21. PRO, FO. 371/43551.

Kreu 9

Maj dhe qershor 1944 — pika e kthesës: Enver Hoxha e kapërcen Rubikonin

Maji dhe qershori ishin muajt, në të cilët u përcaktua trajta e së ardhmes së Shqipërisë pas luftime. Fundi i luftës në Shqipëri, erdhi vetëm në nëntor, por pika e kthesës, në të cilën u bë e sigurtë se partizanët do t'i përllanin të gjitha dhe se Shqipëria do të binte nën sundimin komunist, erdhi katër muaj më parë. Britania, dhe me Britaninë Shtetet e Bashkuara, nuk arritën ta pranonin zgjidhjen kur ajo ndodhi dhe vazhduan të ishin të preokupuar me përpjekjet për të parandaluar një luftë civile, e cila tashmë ishte në fazën e saj përfundimtare. Në kohën kur erdhi fitorja, pati më shumë ngritje akuzash se sa festim të përbashkët ndërmjet Shqipërisë dhe Fuqive Aleate, të cilat kishin dhënë më shumë ndihmesë, goftë edhe më shumë në mënyrë modeste, për përpjekjet luftarake në Shqipëri. Divergjencat nisën në maj e qershor.

Ngritja e qeverisë nga LNC dhe fushata për të kapur pushtetin në veri

Nga ana e ushtarakëve, tipari më i rëndësishëm i punëve në jug në maj ishte vazhdimi i formimit të shpejtë të brigadave partizane. Pasqyra informative e Forcës 133 dhe vle-

rësimi i datës 26 maj¹) (përgjegjësinë për operacionet në Shqipëri tashmë prej Forcës 133 e kishte marrë Forca 266, nën kuartierin e Operacioneve të Posaçme për Mesdheun me gjen.-maj. Stouell (Stawell), që përgjigjej drejtpërdrejt para Kuartierit të Forcave Aleate), e llogarisnin që tani kishte 20.000 partizanë nën armë, nga të cilët 13.000 ishin të rreshtuar në 12 brigada. Historia e Partisë Komuniste të Shqipërisë pohon se Ushtria Nacionalçlirimtare numëronte 35.000 veta në maj. Kjo shifër mund të përfshijë forcat territoriale, të cilat qëndronin prapa «forcave të rregullta». Zgjerimi i forcave partizane ose të UNÇSH në pranverë ishte një dukuri e jashtëzakonshme, që i habiti oficerët britanikë, të cilët kishin qenë dëshmitarë të gjendjes së rrezikshme për bërthamën e fortë të partizanëve vetëm dy a tre muaj më parë.

Në një kuptim, ishin gjermanët dhe Balli kombëtar arkitektët e ngritjes së partizanëve, domethënë grabitjet dhe shkatërrimet që ata kishin bërë në gjithë Shqipërinë e jugut kishin krijuar një proletariat në kuptimin e fjalës siç kishte në Romën e lashtë, një klasë njerëzish që nuk kishin as pronë e asgjë tjetër për të kontribuar për vendin e tyre, përveç fëmijëve të tyre. Të rinjtë e të rejtat, djemtë e vajzat vërshuan nën flamujt partizanë kur erdhi pranvera dhe njerëzit më të moshuar, fshatrat, shtëpitë dhe kasollet e të cilëve ishin plaçkitur e djegur pa mëshirë, u grumbulluan në skamjen dhe në varfërimin e tyre të skajshëm për të mbushur radhët e një organizimi në shkallë vendi për mbështetje e furnizime, që drejtohej nga LNÇ. Në një kuptim tjetër edhe më të egër, LNÇ e fitoi ngritjen e saj nëpërmjet intransigjencës së vet të pamëshirshme, e cila e solli terrorin gjerman mbi kokën e saj dhe mbi të gjithë ata, që guxonin ta ndihmonin ose, në shumë raste, pranonin të ndihmonin vetëm duke u lëkundur. Kjo ishte gjendja e punëve, që ishte krijuar në Shqipërinë e jugut nga Gjermania naziste nëpërmjet përpjekjeve të saj për të shfarosur një bërthamë të vogël luftëtarësh guximtarë, që i bashkonte disiplina e centralizuar dhe propaganda e agjitacioni i pandërprerë i Partisë Komuniste të Shqipërisë. Kur Ushtria Nacionalçlirimtare grumbulloi forcë në pranverë, ajo fitoi një valë mbështetjeje popullore, për shkak se dukej që po korrite sukses, se ishte shqiptare, se mbronte çështjen e varfanjakëve (domethënë të shumicës së gjerë të fshatarëve shqiptarë) dhe se ngrihej për ndryshime, për liri, për pavarësi dhe për vlera të tjera

që pak njiheshin në Shqipëri. Shumë nga ata që u futën në UNÇSH duhet të jenë zhgënjyer pasi mbaroi lufta, por nuk mund të kishte dyshime për modën e të qenit partizan, që u përhap në gjithë Shqipërinë gjatë muajve të mesit të vitit 1944.

Kjo nuk ishte vetëm çështje numrash, por edhe e moralit. Brigadat partizane që përbënin UNÇSH, kishin një moral të lartë që binte në sy. Një shtojcë për raportin e misionit Stables, të cilin Ricard Ridelli dhe unë e shkruam në Bari në tetor 1944, përmbante këtë pjesë për disiplinën dhe mbajtjen e moralit nga partizanët:

«Së fundi, komandën (në një brigadë) e ushtron një komitet prej katër vetash, dmth. komandanti, komisari, zëvendëskomandanti dhe zëvendëskomisari, të përforcuar nga komandantët e batalioneve etj. siç e do nevojja... Vendimet e këtij komiteti dhe veprimet e mëpasme të komandantëve në të gjitha nivelet janë të hapura për kritikë ose vlerësim publik në mbledhjet e përgjithshme të brigadave, batalioneve e kompanive... Seksioni «teknik» (dmth. politik) punon për komisararin... Kur misioni bëri një udhëtim për dy muaj me Brigadën I, ishte në gjendje të shihte se çfarë rëndësie të madhe i jepnin partizanët edukimit politik e social. Kur një brigadë ndalon në një fushim, komisarët me anëtarët e seksionit «teknik» mund t'i shohësh gjithnjë duke iu drejtuar një mbledhjeje të skuadrës, kompanisë, batalionit ose madje të brigadës. Të gjitha mendimet i nënshtrohen parashtrimit dhe diskutimit publik, ndonëse anëtarët më të përgatitur të seksionit «teknik» janë të detyruar të fitojnë çfarëdo diskutimi. Partizanët janë të parët që duhet të fusin mendimin në kokat e zbrazëta të shqiptarëve. Ata janë të vetmit që u ofrojnë shqiptarëve diçka konstruktive. Veprimtaria e tyre edukuese, e ndërthurur me propagandën e sektorit të botimeve dhe të korit, janë baza e një morali të shkëlqyer dhe e shpirtit të repartit për partizanët, duke i bërë rekrutët e ardhur me gjysmë zemre që të bëhen partizanë entuziastë brenda natës... Propagandën partizane e ndihmon shumë disiplina partizane. Komisarët shpjegojnë që disiplina e tyre është pjesë e sistemit të tyre edukativ. Brenda brigadës krimet ndëshkohen nga gjyqi i kompanisë, i batalionit ose i brigadës (të përbërë nga komandanti, komisari, zëvendësit etj.), që gjithmonë i nënshtrohen më pas kritikës në mbledhjet e njësisë. Shkalla e dënimeve të tyre është afërsisht kjo:

- I. Shqyrtim publik dhe dënim i krimit, që bëhen nga komisarari në një mbledhje të njësisë.
- II. Ndajimi për të kënduar këngët partizane.
- III. Heqja e distinktivit të partizanit dhe ndajimi për të bërë propagandë partizane, si dhe për të marrë pjesë në mbledhjet e partizanëve.
- IV. Dënim me vdekje.

Për faje më të vogla mund të jepen si ndëshkim shërbime jashtë radhe, por kjo bëhet vetëm nëse mund të rregullohet që të mos bëhet demaskimi publik. Disiplina partizane është me të vërtetë e rreptë, ndërsa marrëdhëniet morale ndërmjet burrave dhe grave janë nga më të rreptat që oficerët tanë kanë pasur mundësinë të shohin. Nuk ndodhin raste imoraliteti, nëse do të ndodhnin, do të dënoheshin me vdekje. Vetëm ngulmimi i partizanëve për vlerat morale është përgjegjës për shndërrimin e vullnetarëve fshatarë në njësi luftarake me moral të klasit të parë²⁾.

Ky sistem disiplinor krijoi pothuaj nga hiçi një ushtri të rrekosur, por të bashkuar, në pranverën e vitit 1944. Kur ajo u hodh në sulm në qershor, ajo e ndryshoi balancën e pushtetit në Shqipëri brenda pak javësh.

Ngjarja më e rëndësishme gjatë majit në jug ishte politike. Kjo qe mbajtja e Kongresit I Antifashist Nacionalçlirimtar në Përmet ndërmjet 24 e 28 majit. Historia e Partisë Komuniste Shqiptare pohon se delegatët e Kongresit u zgjedhën me votim të hapur në zonat e çliruara. Në rrethanat e kohës fjala «i hapur» duhet të ketë pasur si kuptim diçka më tepër se sa popullsia u thirr në mbledhje e mitingje përgatitore. Kongresi iu dha roli i një asambleje kushtetuese. Ajo u thirr për të zgjedhur një Këshill Antifashist Nacionalçlirimtar, i cili u caktua si trupi më i lartë legjislativ dhe ekzekutiv i Shqipërisë, ndërsa Këshillit iu dha e drejta për të zgjedhur një Komitet Antifashist Nacionalçlirimtar, i cili do të kishte atributet e një qeverie të përkohshme. Enver Hoxha u bë kryetar i Komitetit, pra kryetar i qeverisë së përkohshme. Që nga kjo kohë LNC (Lëvizja Nacionalçlirimtare) u bë FNÇ. Fronti Nacionalçlirimtar. Arsyeja prapa këtij ndryshimi ishte se Shqipëria tani kishte një asamble kombëtare dhe një qeveri, së kështu që Lëvizja Nacionalçlirimtare pushoi së pasuri një funksion ekzekutiv. Me termat komunistë, ai u bë një organizatë masash, një vegël politike për të siguruar mobilizimin e popullit, një lloj fronti popullor, praktikisht një front për Partinë Komuniste Shqiptare. Në të gjitha këto është e mun-

dur të shihet se u ndoq modeli jugosllav, por aktet e Kongresit të Përmetit ishin akte autentike shqiptare, të parapërgatitura nga PKSHP për të realizuar vendimet e Komitetit Qendror të mesit të majit në Helmës dhe jo të parapërgatitura nga PKJ.

Një nga aktet e para të Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar ishte ndalimi i kthimit të mbretit Zog në Shqipëri, duke e bërë kështu plotësisht të qartë se ai po i zinte vendin monarkisë së përmbysur nga pushtimi italian më 1939. Këshilli, gjithashtu, hodhi poshtë të gjitha marrëveshjet e jashtme që kishte lidhur mbreti Zog, duke i këputur kështu të gjitha lidhjet kontraktuale të Shqipërisë me vendet perëndimore, jo komuniste. Nga ana ushtarake, Këshilli nxori dekretin që UNÇSH, një ushtri partizane, kthehej në ushtri të rregullt dhe u vendosën gradat ushtarake. Enver Hoxha u bë kryekomandant. Ushtria do të përbëhej nga divizione dhe, sipas rastit, nga korpuse, duke nisur me Divizionin I, për të cilin bërthama e fortë do të ishte Brigada I e famshme. Ditën e fundit të Kongresit, më 28 maj, Enver Hoxha, si komandant i përgjithshëm dhe kryetar i Komitetit Antifashist Nacionalçlirimtar ose i qeverisë së përkohshme, nxori një urdhër për të filluar ofensivën e përgjithshme për çlirimin e Shqipërisë dhe asgjësimin e Ballit Kombëtar. Ofensiva e përgjithshme do të kishte në krye si majë të shtatës Divizionin I të ri, i cili do të sulmonte drejt veriut përmes lumit Shkumbin.

Ndërsa po ndodhnin në Përmet këto ngjarje, të cilat vëzhguesve të jashtëm u dukeshin në atë kohë si vetëbesim i tepruar, por që në fakt dolën për Shqipërinë me rëndësi të madhe për çastin, oficerët e misionit britanik qëndruan mënjanë në një pozitë abstenimi. Nënkolonel Filip Lik nga Bari kishte qenë me nënkolonel Palmer që nga 10 maji³). Intensifikimi i hapave politikë nga ana e Enver Hoxhës krijonte një klimë të vështirë për vizitën e Likut. Ditari i Markus Lajënit shënon se të dy kolonelët «çohen e përpiqen ta hanë mëngjesin me Shtabin» më 18 maj (shtabi këtu do të thotë Shtabi i Përgjithshëm). Më 21 maj «Shtabi kalon rrugës për në Kongres (në Përmet). Ne u dërgojmë letra që duhet t'i kenë tundur».

Në kujtimet e tij për «Rrezikun anglo-amerikan për Shqipërinë», Enver Hoxha lëshon dy ankesa kundër Filip Likut. E para thotë se Liku e shpalli qëllimin për të hyrë në kontakt me një udhëheqës ballist, me synimin që të dëgjonte pikëpamjen e ballistëve. Hoxha pretendon se e ka hedhur po-

shtë këtë, duke thënë se po të dilte Liku për të takuar ballistët, nuk do të hynte më kurrë në territoret e partizanëve. E dyta thotë se Liku vendosi një marrëdhënie personale me Mustafa Gjinishin, i cili e kishte informuar për planet rreth Kongresit të Përmetit, dhe i dha zemër që t'i kundërshtonte masat më intransigjente që do të miratoheshin. Për britanikët Mustafa Gjinishi ishte njeriu më i afrueshëm nga udhëheqësit e lartë të LNC, për Hoxhën ai ishte një agjent i anglezëve, ndoshta tashmë i rekrutuar, por me siguri në mundësi për t'u bërë. Përveç këtyre fyerjeve, Likut iu desh ta refuzonte ftesën e Enver Hoxhës për në Përmet, ndërsa togeri Stefan i Ushtrisë Amerikane, i cili kishte ardhur pak kohë më parë si oficer ndërlidhës amerikan me partizanët, vajti në Kongresi si vëzhgues.

Britanikët ishin në pozitë të vështirë, sepse e dinin çfarë kishin ndër mend të bënin Enver Hoxha dhe kolegët e tij në Kongres. Ata nuk mund ta bënin veten që t'i falnin këto, duke lejuar që të merrte pjesë një oficer britanik. Problemi i shtruar nga Britania ishte që lufta civile duhej të parandalohet, por ja ku ishte Enver Hoxha që luante trukun e tij të zakonshëm, duke shpallur se loja ishte fituar dhe kishte mbaruar, pikërisht kur gjithë të tjerët mendonin se ishte mbyllur vetëm pjesa e parë. Oficeri ndërlidhës britanik më me përvojë, më i vjetri në kuptimin e shërbimit në Shqipëri, Billi Maklini, ishte hedhur tek Abaz Kupi në një përpjekje për të bindur atë dhe nacionalistët e tjerë, që më në fund të bënin diçka kundër gjermanëve, me parakusht që partizanët të mos e precipitonin luftën civile, por ja ku ishte Enver Hoxha, i cili jo vetëm luante me luftën civile ose bënte gjëra që bartin rrezikun e luftës civile, por edhe e kishte angazhuar në mënyrë të pakthyeshme gjithë lëvizjen e tij dhe ushtrinë partizane për të marrë pushtetin dhe për të ngritur një qeveri «popullore», e cila nuk do t'u jepte zogistëve e të tjerëve asnjë mundësi tjetër, veçse: ose të nënshtroheshin, ose të eliminoheshin. Duke e ditur rrugën në të cilën kishte evoluuar politika britanike, ishte e logjikshme që misioni britanik do ta bojkotonte Kongresin e Përmetit, por ishte fatkeqësia e Likut që atij do t'i duhej ta përcillte mesazhin e padëshirueshëm gjatë qëndrimit të vet të shkurtër. Politika amerikane ishte e paformuar dhe asnjë mision i SHBA nuk e kishte zbuluar Abaz Kupin a ndonjë kandidat tjetër nga udhëheqë-

sit nacionalistë. Si rrjedhim, togeri Stefan ishte në gjendje të shkante në Përmet dhe t'u jepte kënaqësi partizanëve, ndërsa pas ngjarjes që e mundur të shihej se prania e tij nuk i kishte angazhuar SHBA për asgjë.

Nuk është nevoja të thuhet se Enver Hoxha dhe kolegët e tij u fyen nga mungesa e britanikëve. Sipas mendjes së tyre, kjo ishte një tregues tjetër që anglezët kishin për qëllim ta pengonin LNÇ, nëse mund ta bënin këtë. Enver Hoxha deri në atë kohë duhet të ketë qenë i informuar mirë për misionin e ri të Maklinit pranë Kupit (Smajli kujton që Frederik Nosi, përkthyesi dhe shoqëruesi i tyre i mëparshëm nga partizanët, i kishte takuar ata në Shën Gjergj menjëherë pasi u hodhën në Bizë më 19 prill). Atë që britanikët e mendonin si drejtpeshim si nga e djathta, edhe nga e majta, Hoxhës i dukej si anim me qëllim nga e djathta. Rreth kësaj kohe i shtoi dyshimet e LNÇ partizane një përgjigje e z. Atli për një pyetje në Dhomën e Komuneve⁴). Më 23 maj, Atli paraqiti një trajtim të shkurtër mbi Shqipërinë, të shkruar për të nga Departamenti i Jugut i FO. Aty pohohej se veprimtaria e gueriljeve ishte e përhapur gjerësisht nëpër Shqipëri, por ishte e organizuar më mirë në qendër dhe në jug. Ajo ngrinte njësoj barabar si krahun e majtë të LNÇ në jug, Lëvizjen e Legalitetit të Abaz Kupit në qendër dhe BK si një trupë nacionalistësh me lidhje të çlirëta. Aty thuhej se të gjitha këto grupe u përmbaheshin pikëpamjeve politike të forta, gjë që disa herë kishte çuar në ndeshje midis të tyre. «Qeveria e Madhërisë së tij megjithatë, nëpërmjet oficerëve ndërlidhës në vend, po përpiqet t'i bashkojë ato dhe të ngrëjë një front të bashkuar rezistence kundër armikut». Kjo ishte e pacënueshme si një përmbledhje e skenës shqiptare, ashtu siç e përfytyronin në Londër ose siç do t'i kishte pëlqyer Londrës që të ishte. Por kur ajo u transmetua në drejtim të Shqipërisë, do të ngjallte detyrimisht zemërimin e partizanëve të LNÇ me përciptërinë dhe pasaktësinë e saj.

Në një kuptim, të gjitha këto ndodhi ishin drithë për mullirin e Hoxhës. Ato mund të citoheshin për të treguar se sa të drejtë kishte pasur Plenumi I i Komitetit Qendror të PKSH në Helmës në mes të majit, për të adoptuar rezolutën, sipas së cilës aleatët nuk do të lejoheshin të ndërhynin në punët e brendshme politike dhe ushtarake të popullit shqiptar, dhe për t'i bindur kolegët e tij që të mos shman-

geshin nga kursi i tyre për shkak të paralajmërimeve britanike rreth luftës civile dhe kërcënimit të nënkuptuar se ndihma britanike do të ndërpritej, nëse këto paralajmërime nuk do të merreshin para sysh. Në një kuptim tjetër, ato megjithatë nuk mund të mirëpriteshin nga Enver Hoxha. Çështja e partizanëve të LNC ishte pjekur me shpejtësi dhe kishte fituar aftësinë për të ndërmarrë një lojë vendimtare të fundit për luftën civile, që po zhvillohej që nga fundi i vitit 1943. Kjo lojë e fundit do të kishte qenë edhe më e shkëlqyer, nëse do të ishte zhvilluar me mbështetjen aleate, të po atij lloji siç po e gëzonte tani në mënyrë të dukshme Titoja. Por kjo nuk qe e thënë të bëhej dhe asnjëherë nuk u ndërtuan marrëdhënie «të mira» të britanikëve me Hoxhën. Natyrisht, si Enver Hoxha dhe PKSH, nga njëra anë, edhe anglezët nga ana tjetër, po luanin me shuma të mëdha, por anglezët kishin dizavantazhin që nuk kishin asnjë objektiv politik të qartë, asnjë vlerësim të azhurnuar dhe të papështjelluar për balancën e forcave politike dhe ushtarake në Shqipëri në maj 1944. Të dhënat e Enver Hoxhës lidhur me vlerësimet ushtarake nuk ishin të mira, por instinktet e tij politike ishin nga më të mprehtat dhe ai tashmë ishte një mjeshtër i përsosur i politikës në prag të katastrofës.

Kur hyri Filip Liku në Shqipëri më 10 maj, ai ishte i armatosur me pikëpamjen e pranuar përgjithësisht në qarqet britanike, se partizanët ishin një lëvizje jugore, pa ndonjë pretendim të përligjur për të folur në emër të gegëve ose për të ndërhyrë në veri, se partizanët ishin dëmtuar rëndë nga fushata e dimrit dhe se e ardhmja i përkiste një kryengritjeje nacionaliste ose zogiste në veri, nëse kjo do të mund të rregullohej. Që kjo të bëhej e mundshme, partizanët duhej të bindeshin për të pranuar kufizimet e veta dhe të mendonin me idenë e një koalicioni dhe jo me idenë e mbisundimit. Në librin «Misioni në Shqipëri», Smajli e bën të qartë se misioni Concensus II e miratoi Likun: «ne kishim besim te gjykimi i tij, por nuk u besonim anëtarëve të tjerë të personelit të tij»⁹). Gjatë qëndrimit të tij të shkurtër në Shqipëri, përshtypjet e Filip Likut për situatën pësuan një ndryshim të shpejtë. Siç e kemi parë tashmë (në kreun 9), Uileri e quajti atë si fëndërrues pas dy javësh në Shqipëri. Në një letër për Majkëll Rousin të Departamentit të Jugut në Ministrinë e Jashtme, me datën 26 maj, Bokshalli i SOE njoftonte disa nga përshtypjet që kishte transmetuar Liku për Barin. Ato përfshinin sa më poshtë:

- I. Cilësitë dhe aftësitë luftarake të partizanëve janë rritur shumë dhe ata tani janë në gjendje t'u bëjnë ballë sulmeve gjermane dhe të ndërmarrin veprime ofensive të bashkërenduara.
- II. Për shkak të dështimit të Ballit Kombëtar, luftimet tani janë përqendruar kundër gjermanëve dhe trupave kosovare të drejtuara nga oficerët gjermanë, ndonëse këto të fundit shpejt mund të eliminohen për arsye të moralit të ulët.
- III. Për shkak se zona nën kontrollin e partizanëve është zgjeruar, ata i kërcënojnë tani efektivisht komunikacionet e gjermanëve.
- IV. Po rriten me shpejtësi numri dhe forca e partizanëve.
- V. Këshilli Qendror është «i prirur të jetë i ngadaltë dhe oriental» dhe ka pak mbështetje në veri të Tiranës, me përjashtim të qyteteve.
- VI. Shkalla e stërvitjes së brigadave partizane nuk është e barabartë, ndonëse kanë një nivel të lartë (Brigadat I, IV dhe V*6).

Është për t'u shënuar se ai ka përdorur shprehjen «në veri të Tiranës» dhe jo «në veri të Shkumbinit». Zonat e partizanëve dhe të zogistëve kryqëzoheshin përreth Tiranës.

Ndërsa Liku ishte në Shqipëri, tashmë kishin nisur të shpreheshin dyshime nga personeli i tij në Bari për vlefshmërinë e alternativës zogiste. Në një notë më datën 11 maj⁷⁾ për Harold Makmilanin, ministrin rezident pranë Kuartierit të Forcës Ajrore Aleate, Filip Broudi, Këshilltari Politik i Ministrisë së Jashtme në Bari, bënte këtë koment: «Lëvizja prozogiste, e organizuar nga major Abaz Kupi, është më pak e avancuar se sa besohej fillimisht». Më 6 qershor, Seksioni i Shqipërisë i Forcës 266 dërgoi një telegram për Londrën, që përmbante një rivlerësim të situatës në Shqipëri, të bazuar në raportet e fundit të marra nga Maklini, Liku, Palmeri dhe të tjerët. Ai përfshinte dhe këtë pjesë:

«Lëvizja e Legalitetit është e papjekur dhe nuk ka mbështetje në vend. Forcat e armatosura të partisë zogiste nuk janë ende një faktor ushtarak. Kontaktet me Kupin po mbahen nëpërmjet nacionalistëve të njohur, për rastin nëse Aleatët do të vendosin të mbështesin Zogun... Partizanët tani po gëzojnë një farë ndjenje pushteti dhe kanë zgjedhur udhëheqësit qeveritarë. Ata ndoshta e dinë vetë se janë të dënuar, në qoftë se nuk do të mund ta mbajnë vendin me anë të forcës ushtarake»⁸⁾.

Ditën tjetër, më 7 qershor, Seksioni i Shqipërisë vazhdoi me një rekomandim: «Ne e konsiderojmë se tani nuk e vlen të mbështetet Kupi për arsyet e mëposhtme»⁹⁾. Ai ishte më

i dobët se sa ishte menduar, duke pasur vetëm rreth 5.000 veta, kryesisht italianë; ai kërkonte shuma të mëdha parash e furnizimesh; ai nuk kishte pasur asnjë sukses gjatë pesë muajve për ngritjen e një force ushtarake e politike; pasuesit e tij ishin vetëm lokalë dhe nuk përfshinin shumë nga krerët nacionalistë të Dibrës e të Lumës; ai kishte bashkëpunuar të paktën tërthorazi me gjermanët; marrëdhëniet me LNC ishin rënduar për shkak të lidhjeve të Britanisë me Kupin; LNC tani ishte e fuqishme. Përfundimi i telegramit ishte se nuk duhej të bëhej asgjë, që mund të interpretohej nga LNC si mbështetje për Kupin dhe kjo vetëm mund të nxiste luftën civile. Kjo ishte e kundërta e argumentimit të zakonshëm, që paraqitej nga nacionalistët dhe simpatizantët e tyre, se ndihma britanike për LNC i kishte dhënë mundësinë LNC të zhvillonte luftë civile.

Ndërsa Liku ishte në Shqipëri, Seksioni i Shqipërisë drejtohej nga majori Eliot Uotrous. Emri i Eliot Uotrousit del në dokumentet e Seksionit të Shqipërisë për herë të parë në prill¹⁰), kur ai nisi të nënshkruante përmbledhjet informative dhe vlerësimet, që më parë ishin fusha e Margaret Hezllakut. Ajo kishte ndenjtur në Kajro dhe u largua nga Forca 133, kur kjo u zhvendos në Bari, por ende ishte në kontakt me të herë pas here. Në Kajro po grumbullohej një personel për të formuar një bërthamë të një Kuartieri Ushtarak Ndërlidhës të Aleatëve në Shqipëri, që përfytyrohej se do të vihej në lëvizje nga fundi i veprimeve ushtarake. Seksioni i Shqipërisë e vazhdoi dërgimin e informacionit për këtë Kuartier Ushtarak Ndërlidhës. Majori Çarlz Broklëhërst (Charles Brocklehurst) i këtij kuartieri, i shkruante më 3 qershor kapitenit Xhon Ajr në Seksionin e Shqipërisë, duke i thënë: «Listën e përkrahësve të Kupit, të bërë nga Billi Maklini, ia kam dhënë Fanit për ta komentuar»¹¹). Lista arriti në Bari pas dy ditësh. Hezllaku e ka vlerësuar listën e Kupit si një ekip të mirë B dhe jo aq si ekip A. Kapiteni Xhon Ejri, i cili ishte korrespondenti kryesor i Broklëhërstit, ishte anëtar i Partisë Komuniste të Britanisë dhe ishte prania e tij në Seksionin e Shqipërisë në Bari, që më vonë u citua (dhe ende vijon të citohet) nga teoricienët e konspiracionit, si dëshmia kryesore që Shqipëria iu dorëzua komunistëve nga të majtët britanikë në Forcën 133/266/399. Eliot Uotrousin vetë nuk e akuzojnë për majtizëm, vetëm se ka qenë me mendime shumë liberale, i dobët dhe i pazoti t'u qëndronte paragjyqimeve, dredhive dhe pasioneve të të majtëve. Në këtë pikë na

duket e nevojshme të bëjmë vetëm një koment, që telegramet e Seksionit të Shqipërisë të datave 6 e 7 qershor, me sa duket, kanë qenë të lidhura fare ngushtë me faktet e gjendjes në vend dhe nuk mbajnë asnjë vulë «majtiste». SOE në Londër i bënë këtë interpretim Ministrisë së Jashtme, se ata mendonin që Norman Uileri, i cili kishte ardhur në Bari nga fundi i majit, mund të ketë ndikuar për hartimin e tyre dhe, siç thanë ata, ai ishte shumë pro partizanëve.

Në ditët e para të qershorit, zhvillimi i pandërprerë i punëve të partizanëve dhe i të menduarit të britanikëve rreth tyre u ndërpre nga ofensiva gjermane. Skema e ngjarjeve nuk ishte e ndryshme nga ato në dhjetor 1943. Partizanët ranë nën sulmet e rënda të gjermanëve dhe oficeri britanik më i rëndësishëm humbi. Filip Liku u vra nga copa e një predhe, kur aeroplanët gjermanë sulmuan fushimin e britanikëve në Sheper, ku ai kishte qëndruar rrugës për në bregdet, që të kthehej në Bari. Ai u largua nga skena po ashtu siç ndodhi me gjeneralin Dejvis, pikërisht kur ishte në gjendje të sillte disa mendime të reja lidhur me vlerësimet e Barit e të Londrës për gjendjen dhe, më në veçanti, për aftësitë dhe qëllimet e partizanëve. Drejtimi i Seksionit të Shqipërisë në Bari i kaloi si pasardhës Eliot Uotrousit dhe i mbeti atij për gjithë periudhën tjetër të fushatës.

Ofensiva gjermane nisi ta prekte misionin britanik të kuartierit më 4 qershor. Një ditë më parë, siç e ka shënuar Markus Llajëni në ditar, Alan Palmeri, Filip Liku dhe Viktor Smithi kishin shkuar për t'u takuar me «qeverinë», domethënë me Enver Hoxhën e kolegët e tij me cilësitë e tyre të reja pas Përmetit, që pretendonin se ushtronin autoritetin më të lartë qeveritar në gjithë Shqipërinë. Bombardimi dhe rrahja me artileri e kuartiereve të partizanëve e të anglezëve ndodhi më 5 dhe më 6. Nga mbërmbja e datës gjashtë të gjithë ishin vënë në ecje dhe «qeveria» e re e pa veten pa seli. Gjermanët kishin hedhur në lojë disa trupa të klasit të parë, duke përfshirë edhe elementë të Divizioneve Malore I dhe XXV, të Divizionit të Këmbësorisë 297 dhe të Divizionit 104 Jaeger. Situata paraqitet e përmbledhur në një telegram nga Bari për Algjerin (i Broudit për Makmilanin) më 22 qershor¹²). Një forcë prej rreth 15.000 trupash gjermane i dëboi partizanët nga rrugët veri-jug në Shqipërinë e veriut dhe i mbërtheu me shpatulla nga deti. Luftimet kundërmësymëse të partizanëve u bënë të ashpra për tri javë. Aeroplanët Spitfire të RAF nga bazat në Itali u

thirrën nëpërmjet misioneve të BLO në jug për të sulmuar kolonat gjermane, duke u dhënë kështu një mbështetje të rëndësishme forcave partizane. Më 28 qershor Bari njoftoi se gjermanët, më në fund, e shkatërruan kryeurën e partizanëve në bregdet dhe u tërhoqën brenda vendit nëpër rrugët, duke i dhënë fund ofensivës¹³). Forcat partizane menjëherë u morën me rigrupimin në zonat ku kishin zënë vend që në fillim.

Misionet britanike ishin tërhequr drejt perëndimit me partizanët dhe erdhën e u bashkuan me Palmerin e Smithin, në kohën që ata kalonin pranë zonave të veprimit në jug larg misionit të Kuartierit, disa nga BLO, duke përfshirë edhe Northropin, Njuellin dhe Rousin. Ata arritën në bregdet më 11 qershor dhe njoftuan me radio Barin, që t'u dërgonte një anije të vogël për t'i marrë disa prej tyre. Natën e datave 12-13 erdhi një anije dhe, ndërsa Palmeri e Njuelli ndenjën prapa me një radio dhe një nënoficer radist për të mbajtur ndërlidhjen me partizanët, pjesa tjetër e grupit u evakuua në Bari për t'u «rifutur» më vonë. Misionet britanike po bëheshin po aq të shkathëta sa edhe partizanët, për t'u shkruirë e për t'u riformuar kur grushti gjerman shuhej. Ardhja e Viktor Smithit, Markus Llajënit dhe e kolegëve të tyre në Bari, i dha mundësinë personelit të Seksionit të Shqipërisë që të azhurnohej shumë mirë me punët e partizanëve.

Historia e Partisë Komuniste të Shqipërisë jep si datë të fillimit për ofensivën gjermane ditët e fundit të majit. Ajo përcakton dy faza për të, të parën nga 28 maji deri më 10 qershor, që u drejtua nga Berati, Elbasani, Pogradeci e Korça në brendësi drejt fortesave malore në pellgjet e lumenjve Devoll e Osum, të dytën që zgjati nga 10 deri më 30 qershor, në krahinat e Vlorës e të Gjirokastrës. Divizioni I i sapoformuar, i përbërë nga Brigadat I, IV dhe V, mori goditjen kryesore në fazën e parë të sulmit gjerman dhe, për disa kohë, u shkëput në Tomoricë, në zonën ndërmjet Devollit e Osumit, në veri të vargmalit të Ostrovicës. Divizioni arriti që të çante dhe ofensiva gjermane vërshoi drejt jugut e perëndimit, duke kapur Helmësin e Staraveckën, ku ishin vendosur kuartieret e partizanëve e të anglezëve. Brigadat që u mbërthyen me shpinë nga deti në zonën midis Vlorës e Gjirokastrës ishin VI, VII dhe VIII. Ndërsa ofensiva gjermane atje u shua vetë, Divizioni I, duke iu bindur urdhrave të Enver Hoxhës, u hodh në veri drejt Dibrës dhe kaloi lumin Shkumbin më 26 qershor,

që ishte «Rubikoni» i kësaj lufte të veçantë. Ndërsa skema e ngjarjeve kishte ngjashmëri me atë të dhjetorit 1943 (një ofensivë ushtarake e politike e shpallur nga partizanët, një ofensivë gjermane e llogaritur për ta mbytur atë që në djep, partizanët duke u mbathur dhe vëzhguesi kryesor i britanikëve i vrrarë), rezultati ishte shumë i ndryshëm. Ushtria partizane tani ishte e aftë për të luftuar kundër gjermanëve, duke u tërhequr e duke u rigrupuar, ndërsa e ruante veten si një forcë ushtarake koherente. Dhe ajo ishte në gjendje të shpërthente një ofensivë të vetën drejt veriut, në të njëjtën kohë që përballonte ofensivën gjermane në jug.

Në maj kishte pasur një rritje të dukshme të tonazhit për furnizimet e hedhura në Shqipëri. Ishin caktuar tridhjetë tonë, por u bartën 64 tonë me 34 fluturime të aeroplanëve Dakota. Për herë të parë u shfrytëzua me sukses për hedhjet periudha pa hënë. Dokumentet e RAF që nga kjo kohë e më pas nuk tregojnë më cilat ishin misionet që i merrnin veç e veç hedhjet, por shumica e tonazhit pa dyshim vajti te partizanët. Në dy fluturime u hodhën 20 pjesëtarë të një grupi komandosësh me pajimet e tyre. Këto ishin pjesa e parë e një vargu operacionesh në Shqipërinë e jugut nga ana e forcave të rikonjicionit dhe të inkursioneve, që ishin në dispozicion të Komandantit të Forcës 266 (Komandoset 2, 9, 40 e 43 dhe kuartieri i Brigadës II të Shërbimeve të Posaçme). Një direktivë e 21 marsit nga Komandanti Suprem Aleat, gjenerali Uillon, drejtuar Komandantit të Forcës 266, pohonte se objektivi ishte të mbërtheheshin sa më shumë forca gjermane që të ishte e mundur në Ballkan dhe e udhëzonte atë që operacionet duhej të ishin të natyrës së inkursioneve sa më të shpeshta dhe me atë fuqi që e lejonin burimet e tij¹⁴). Inkursionet amfibe në bregdetin e Jugosllavisë e të Shqipërisë plotësoheshin me inkursionet për hedhje ajrore më në thellësi, kryesisht me synimin për të ndërprerë komunikimet verijug. BLO në jug të Shqipërisë siguronin ndërlidhjen ndërmjet forcave të sulmit dhe partizanëve. Natyrisht, veprimtaria e shtrirë gjerësisht e partizanëve ishte faktori që lehtësonte veprimtarinë me inkursione dhe ndihmonte për ta bërë atë të efektshme.

Në qershor numri i fluturimeve me sukses në Shqipëri u zvogëlua, sepse ofensiva gjermane i pengonte partizanët dhe BLO që të mbanin sheshet e hedhjeve. Nga 41 1/2 prova për hedhje, vetëm 24 1/2 dolën me sukses. Tonazhi i hedhur që 34.7 tonë, (për shembull, Jugosllavia mori 1.617 tonë në qer-

shor, Italia 221,8 tonë dhe Greqia 81.1 tonë). Kjo sasi nuk ishte shumë për nëntë brigada, të angazhuara në luftime aktive me gjermanët, dhe për tri të tjera që sapo ishin formuar ose po formoheshin, por aeroplanët gjuajtës të RAF merolin e tyre për sulme nga ajri në tokë nuk u lanë partizanëve asnjë dyshim lidhur me mbështetjen e Aleatëve, ndërsa ata mund të prisnin hedhje të tjera nga ajri, sapo të kishin mundësi t'i rihapnin sheshet e tyre për hedhje.

Mosveprimtaria e vazhduar në Veri deri kur u bë mësymja e UNÇSH

Zhvendosja e misionit Stables në fushimin e tij malor nga mesi i majit e bëri jetën e përditshme më të kënaqshme, por për atë kohë nuk i lehtësoi pengesat për punën e tij. Misioni ishte aktiv, por nuk kishte asnjë shenjë nga kushdo në Shqipërinë e veriut se po bënte ndonjë përpjekje serioze për të sulmuar gjermanët. Gjatë qershorit unë veprova shumicën e kohës si komandant i fushimit, ndërsa Riçard Ridelli lëvizte nëpër zonë, duke u përpjekur t'i nxiste krerët që të arrinin në çastin e vendimit. Në fushim kishim një radio, që e përdornin tetari Elvixh dhe Gudieri, si dhe një radio në një shtëpi në rrëzë të maleve, që e përdorte tetari Dejvis. Materialet nga hedhjet ajrore mund të barteshin poshtë te Dejvisi dhe Ridelli mund të merrte që atje gjithçka i nevojitej.

Fushimi malor në Gramë u bë një vend plot punë e nganjëherë i mbingarkuar me njerëz. Çeta e Esat Ndreut kishte ngritur fushimin fare pranë dhe çeta po shtohet në numër. Meqë partizanët na e siguronin sheshin e hedhjeve, Qazim Prishtina, njohësi më i mirë i tyre i anglishtes, u bë pak a shumë oficer ndërlidhës i përhershëm dhe zuri vend shumicën e kohës në fushimin tonë. Një rrymë vizitorësh nisën ta gjenin rrugën për te ne, disa sepse përkrahnin partizanët, disa sepse ishin kundër partizanëve dhe donin të shihnin çfarë po bënim ne me ta, ndërsa shumica vinin sepse ishtë përhapur fjala se ne po merrnim hedhje ajrore dhe ata shpresonin të përfitonin diçka për vete. Çeta partizane nuk ndërmoi ndonjë aksion, ajo po organizohej, po pajisej dhe po stërvitej për vete. Esat Ndreu nuk na dha ndonjë informatë për qëllimet e ardhshme, vetëm na dha sigurimet e turbulita

konvencionale, se ata do të luftonin kur të ishin të gatshëm. Enver Hoxha e bën të qartë në shkrimet e tij, se ishte dhënë një urdhër i përgjithshëm, që e ndalonte komunikimin për anglezët të informacionit rreth operacioneve. Partizanët i kishin mësuar që funksioni i oficerëve anglezë ishte të kërkonin furnizime me armë, municione e pajime dhe asgjë tjetër.

Moti nganjëherë e bënte të mundimshme jetën tonë në ajër të hapur. Deri në mes të qershorit kishte dëborë vetëm pesëmbëdhjetë metra mbi ne, por njëkohësisht pylli i madh poshtë nesh ishte plot me qyqe. Kishte ditë të ftohta, me dëborë, me llohë, me shi e me mjegull dhe ne nuk kishim asgjë tjetër përveç strehët dhe tendat e stisura me degë, me parashuta dhe me ambalazhet. Megjithatë ishte më e parapëlqyeshme të qëndronim në vend të hapur dhe të kishim një liri relative për lëvizje. Kishim shpëtuar nga çimkat e plesh-tat e madje nga morrat, por në ditët e ngrohta na grinin mushkonjat dhe detyroheshim të bënim tym për t'i larguar. Personeli u bë i madh, pesë italianë që përbënin një personel të shkëlqyer për mensën dhe rreth një dyzinë shqiptarësh, që shërbenin si mushkarë e hamaj, shkonin si korrierë, kërkonin furnizime lokale për ne, niseshin për të bërë pazar në qytete të afërta ose të largëta dhe shërbenin si ndërlidhës ndërmjet meje e Ridellit, ose ndërmjet nesh dhe krerëve fqinjë. Ne gjetëm një qen dhe një këlysh ujku. Në një largësi të vogël mbi fushimin tonë, ishte një pellg i përroit, që na siguronte ujin dhe atje, për herë të parë gjatë gjastë muajve, ne mund të zhvisheshim lirisht e të laheshim, ndonëse temperatura ishte e akullt. Si rrjedhim i hedhjeve ajrore, ne më në fund morëm pajisje të përshtatshme për radiot dhe motorë me naftë për ngarkimin e baterive. E megjithatë kishim plot gjëra që nuk ecnin dhe pothuaj na duhej të improvizonim gjithçka që na nevojitej. Ishte një stërvitje për t'u mësuar me «bëje vetë çdo gjë», që unë nuk e kam harruar gjatë gjithë jetës. Duke pasur të gatshme bateri të ngarkuara plotësisht, na u bë e mundur që ta përdornim radion për të kapur emisionet e lajmeve, pa e ndier se po e harxhonim kot «lëngun». Nga mesi i qershorit, një dërgatë për pazar na solli një radiomarrëse të zakonshme shtëpiake dhe nja dy a tre aparate fotografike, si dhe gjëra që na zëvendësuan sendet e humbura, si orë dhe stilografë. Kur na vinin grupe të tëra vizitorësh, na lindnin probleme për t'i kënaqur, por ne siguruam një komplet pajisjesh për kuzhinë e për të shtruar tryezën dhe shpejt italianët tanë u mësuan të përgatisnin dreka, darka ose mëngjese

për një dyzinë miqsh ose aty rrotull. Një nga detyrat më të ndërlikuara për të ecur sipas parimit «bëje vetë çdo gjë», ishte të përgatisnim furrat, që të ishin aq të mira sa i kërkonte një kuzhinier italian i klasit, të parë dhe një furrtar italian me shumë huqe. Zjarri i mbrëmjes në kampin tonë ishte zakonisht ngjarje shoqërore e çdo dite; kushdo që ishte rreth e rrotull vinte i tërhequr nga atmosfera jonë e gëzuar.

Për disa ditë nga fundi i majit na bëri një vizitë të shkurtër komandanti i skuadronit Toni Nil, i cili kishte ardhur në zonën tonë ngaqë e kishin ndjekur gjermanët drejt jugut. Ai kishte me vete tre dezertorë gjermanë. Veprimtaria subversive ndërmjet trupave gjermane për t'i bërë ata që të dezertinin, ishte e planifikuar për BLO, por rrallë paraqiteshin raste për ta bërë praktikisht. Njësitë gjermane të dorës së dytë, që ishin vendosur si garnizone në veri të Shqipërisë, duke përfshirë edhe disa që ishin rekrutuar ndërmjet pakicave kombëtare në Azinë Qendrore dhe në Kaukazin e Bashkimit Sovjetik, jepnin mundësi për veprimtarinë subversive. Teorikisht shkërmoqja e forcave gjermane me çfarëdo mjeti të mundshëm ishte në interes të partizanëve, të cilët ishin të vetmit që luftonin kundër tyre. Mirëpo në fakt këtë, ashtu si çfarëdo veprimtari tjetër të anglezëve në veri, partizanët e shikonin me dyshim të madh. Në shkrimet e tij Enver Hoxha e thotë hapur se ai besonte që veprimtaria e Toni Nilit kishte si synim që të arrihej një plan i përbashkët gjerman-anglez për të bllokuar përparimin e partizanëve të LNÇ. Është krejt e natyrshme që vetëm një mision, i cili kishte kontakte të mira me kolaboracionistët ose pothuaj kolaboracionistët, do të kishte edhe rastin për të vendosur kontakte indirekte me trupat gjermane në Shqipëri. Si shumë herë të tjera, Enver Hoxha shihte një konspiracion atje ku kishte vetëm një koincidençë.

Morëm hedhje ajrore më 2 dhe 4 qershor (me aeroplanë C47) dhe një herë të tretë më 24 qershor. Ato na sollën materiale e pajisje luftarake të mjaftueshme për qëllimet tona të atypëratyshme, domethënë të mjaftueshme për t'u bërë premtime inkurajuese krerëve që flisnin për rezistencë dhe të mjaftueshme për të pajisur çetën partizane. Çeta u soll plotësisht korrekte gjatë grumbullimit të ngarkesave të shpërndara në zonë dhe rreth sheshit të hedhjes dhe i sollë në kampin tonë pa plaçkitur asgjë, ata gjithashtu nuk bënë asnjë përpjekje për të penguar karvanet e mushkave që ne

nisëm për t'i dërguar Ridellit një pjesë të materialeve që t'ua shpërndante në pjesë të vogla njerëzve nga «nacionalistët» me të cilët kishte kontakte. Kishim shumë punë për të bërë në kamp: zgjedhjen, ruajtjen dhe përgatitjen e armëve, të municioneve, të veshmbathjeve, të eksplozivëve, ndërsa kishim rëndësi që të mos mbanim tepër materiale në vende të hapura, që mund të ndillnin vizitorët kur bëheshin turmë e madhe.

Mesazhet që merrnim nga Bari nisën të përmendnin rrezikun e luftës civile, në rast se nacionalistët nuk do të bindeshin për të rrokur armët. Kjo na bënte të mendonim se Abaz Kupi e zogistët e tij, me të cilët ishte në lidhje Bill Maklini në luginën e Matit, po ashtu nuk premtinin gjë si edhe krerët tanë në luginën e Drinit, kur vinte puna për gatishmërinë e vërtetë që të rrëmbenin armët për të luftuar kundër gjermanëve. Të gjithë prisnin të hapëj fronti i dytë në Francë sa më shpejt dhe ushtria sovjetike kishte arritur në kufirin verior të Rumanisë, porse në Shqipërinë qendrore e veriore nuk po lëvizte asgjë. Në fillim të qershorit Esat Ndreu nisi të na bënte një farë presioni nga ana e partizanëve. Më 2 qershor ai kërkoi më tepër furnizime për çetën e vet. Në atë kohë, politika e misionit ishte që çetës t'i jepeshin me dorë të lirë veshmbathje, por vetëm pak armë të marra. Ne iu përmbajtëm kësaj politike pas hedhjeve ajrore më 2 e 4 qershor, ndërsa partizanët u dukën se, hë për hë i pranonin shpjegimet tona (që më kërkuan mua shumë orë për t'i bërë), por shfaqën disa dyshime lidhur me çfarë kishim ndër mend të bënim me armët dhe municionet që i kishim tani në depo. Ridelli vazhdonte të endej për t'u takuar me krerët lokalë, veçanërisht me familjen Lita, me qëllim që të përgatitej mbledhja e përgjithshme e krerëve të Veriut, siç e kishte planifikuar Maklini. Po ashtu po vepronte Toni Simkoxi në Has, në kufi me Kosovën. Ai na bëri një vizitë fluturimthi më 11 qershor për të marrë disa furnizime. Me hidhërimin tim të madh, ai mori edhe një kalë shumë të mirë, të cilin ma kishte dhënë Muharrem Bajraktari. Edhe Billi Maklini me personelin e tij kaloi nëpër zonën tonë nga mesi i qershorit, për t'u takuar me krerët, siç do të shihet në pjesën tjetër të këtij kreu. Në këtë rast unë nuk u pashë me ta, sepse i shoqëroi Riçard Ridelli.

Hyrja e trupave të Aleatëve në Romë më 4 qershor dhe hapja e Frontit të Dytë më 6 qershor, u pritën në Shqipëri me *feux de joie* duke i harxhuar me shumicë e kot. Edhe partizanët, edhe nacionalistët shtinë në ajër e harxhuan municione po njësoj si sasi. Në kampin tonë ne morëm pjesë në këtë

zhurmë vetëm me një kallëp eksplozivi 808. Më 7 qershor, Esat Ndreu i përtëriu përfaqësuesit e tij te ne. Ai na solli lajmin për mbajtjen e Kongresit të Përmetit në jug nga fundi i majit dhe për formimin e qeverisë së përkohshme nga LNC. Ai na tha se kishte ardhur koha që ne, britanikët, të përcaktonim pozitën tonë midis partizanëve dhe gjithë të tjerëve. Unë iu përgjigja se partizanët po merrnin ndihmë të rëndësishme nga Britania në jug, se iniciativën e kishin partizanët dhe se ardhja e ndihmës britanike do të përcaktohej rreptësisht nga shtrirja e luftës kundër gjermanëve si nga ana e partizanëve, ashtu edhe nga të tjerët. Esati nuk nguli këmbë sa nuk duhej për këtë çështje dhe ne kaluam te një drekë e mirë, me diskutimin e zakonshëm pa fund për Shqipërinë dhe politikën botërore. Deri në këtë kohë, unë e kisha mësuar aq shqipen, sa të isha në gjendje të bisedoja si më partizanët e thjeshtë, ashtu edhe me udhëheqësit e tyre. Vijën e Partisë ua kishin ngulur të gjithëve në kokë dhe ata e përsërisnin me besnikëri dhe në mënyrë të mërzitshme, porse udhëheqësit ishin gjithnjë të hapur për diskutim, ndonëse nuk bindeshin për të kundërtën.

Unë bëra në këtë kohë nja dy shëtitje, njërën më 10-11 qershor për t'u takuar me Dan Kaloshin në Limjan, në drejtim të Peshkopisë, dhe tjetrën nga 21 deri më 26 qershor për të takuar Faik Shehun në Grevë, që sheh Peshkopinë. Dan Kaloshi ishte si gjithmonë plot e përplot me premtime për t'u ngritur kundër gjermanëve, por ai dhe pasuesit e tij vazhdonin t'i lidhnin premtimet e tyre me kërkesat për garanci të forta se do të kishin mbështetjen dhe furnizimet britanike. Dani na paralajmëroi se gjermanët, dhe me ndihmën e Halil Alisë e të njerëzve të tij, po bëheshin gati të ndërmerrnin një sulm kundër nesh e çetës së Esat Ndreut. Mua m'u duk se kjo ishte pikërisht ajo që na duhej për të provuar vullnetin e partizanëve për të luftuar dhe qëndrimet ndaj partizanëve të «nacionalistëve» të ndryshëm, me të cilët ishim në kontakt.

Për vizitën, te Faik Shehu më nxitën lajmet që na kishin ardhur nëpërmjet partizanëve, se dy aviatorë të SHBA ishin rrëzuar diku afër Peshkopisë. Faik Shehu ishte një nga krerët e paktë që mbështesnin LNC dhe zona e tij e influencës ishte në afërsitë e Peshkopisë. Gjatë javëve të fundit ne ishim mësuar të shihnim formacione të mëdha të Forcave Ajrore të SHBA me bombardues Liberator, që fluturonin në

qiell gjatë ditës për të bombarduar, siç e mendonim ne, objektiva në Jugosllavi dhe në Bullgari. Në fakt, shumica e tyre drejtoheshin mbi fushat e naftës të Rumanisë në Ploesht, Ata dy pilotë vinin prej atyre fluturimeve. Unë u takova me Faikun dhe me një numër të madh pasuesish të tij në Grevë dhe në Tren, pak më në jug të Peshkopisë. Haxhi Lleshi erdhi më 23 qershor nga jugu. Ai dukej qartë se ishte njeri me rëndësi në hierarkinë e LNÇ. Më vonë mora vesh se ai kishte ardhur si përfaqësues i Shtabit të Përgjithshëm të Enver Hoxhës. Ai duhet të ketë qenë duke u përgatitur për mësymjen e pritshme drejt veriut të Divizionit I të UNÇSH; por, natyrisht, mua nuk më thanë asgjë për këtë. Ndonëse Peshkopia me garnizonin gjerman ishte fare afër, të gjithë lëviznin lirisht, duke qenë të sigurtë se zonën aty rrotull e kontrollonin partizanët, por, është mjaft kureshtare, i gjithë grupi i kaloi netët në ajër të hapur duke folur, duke ngrënë e pirë rrotull zjarreve të mëdha dhe shkonin për të fjetur nëpër fshatra pas agimit. Me sa duket, ata kishin frikë nga një sulm natën kundër fshatrave. Ishte një punë e lodhshme dhe netët për mua u kthyen në një agoni, meqë unë kisha vetëm rroba të lehta për tropikët. Pilotët amerikanë i sollën në Grevë më 25 korrik dhe unë u nisa që atë natë për në Gramë, i shoqëruar nga 50 veta, ndërsa amerikanët i hipën mbi kuaj meqë ishin shumë të lodhur, shumë të lodhur për t'u kënaqur me ëndjen e një marshimi natën në një pranverë shqiptare, me zërat e gjinkallave e të bretkosave, me shenjat rrugore që dukeshin të mjegulluara dhe me bukurinë e agimit.

Kur kaluam fushimin e partizanëve më 26 qershor, e gjetëm të mbushur me vizitorë: partizanët po mbanin një konferencë me krerët që nuk ishin kolaboracionistë. Me sa dukej kishte shumë prej tyre, por të gjithë ishin të shkallës së ulët. Ne u kthyem në fushimin tonë dhe pamë se Elvixhi kishte marrë një hedhje ajrore me ndihmën e Qazim Prishtinës e të partizanëve, ndërsa të gjitha sendet i kishin mbledhur plotësisht në rregull. Ridelli erdhi më 27 qershor dhe shpejt pas tij ia behu Faik Shehu me një grup prej nja pesëmbëdhjetë vetash. Faiku na mbajti me muhabet gjithë natën. Ai na njoftoi se tani kryesonte një Këshill të Dibrës të LNÇ, që njihte autoritetin e qeverisë së përkohshme të dalë nga Kongresi i Përmetit. Është interesante se edhe në këtë datë të mesit të vitit 1944, Enver Hoxha dhe kolegët e tij nuk kishin mëdyshje për ta trajtuar Dibrën sikur ajo t'i përkiste Shqipërisë. Jugosllavia e Titos nuk ishte ende në gjendje ta

vendoste vetë përfundimisht këtë çështje. Faik Shehu donte që furnizimet tona të kanalizoheshin kryesisht për partizanët, ne i dhamë pak materiale luftarake më 28 qershor, por iu përmbajtëm vijës sonë si të paanshëm.

Dy ditët e tjera, Riçard Ridelli vajti të takonte Muharrem Bajraktarin, i cili tani po përgatitej të punonte me familjen Lita, por u kthye pa sqaruar asgjë. Gjatë po atyre dy ditëve, unë u bëra i vetëdijshëm se po ziente një turbullirë me partizanët. Qazim Prishtina na njoftoi se ai po ikte, meqë nuk ishte bërë asnjë përparim në marrëdhëniet tona me të. Njëkohësisht partizanët kërkuan një furnizim me eksplozivë. Meqë ata nuk donin të na jepnin asnjë shpjegim për të, morën vetëm gjysmën. Më 1 korrik u zgjova shumë herët nga një korrier partizan, i cili më dha një letër nga Esati, që thoshte se ne duhej t'ia dorëzonim menjëherë gjithë materialin tonë luftarak çetës partizane, përndryshe ata nuk do të pranonin për të na ndihmuar që të merrnim më shpejt me aeroplanë. Ndërsa Ridelli u nis të bënte edhe një përpjekje për të siguruar diçka e jo vetëm fjalë nga Muharremi, unë harxhova një ditë me diskutime me partizanët, por sikur i flisja murit. Një kthesë të vështirë mori situata me ardhjen në afërsitë tona të një trupe milicësh nën komandën e një pjesëtari të familjes Lita (Zyber Litës). Qëllimi i tyre dukej se ishte që të na trembnin dhe të na bënin të ishim të kujdesshëm në lidhjet me partizanët, por nuk ndërmorën ndonjë veprim të drejtpërdrejtë kundër nesh.

Më 2 korrik, Ridelli dhe unë u nisëm për takimin e shumëpritur me Maklinin, që do të mbahej me krerët e Veriut. Xhandarët e Zyber Litës na pikasën dhe, pas disa dërdëllisjesh, na thanë se do të na lejonin të kalojmë «këtë herë». Ne kapërcyem Drinin dhe arritëm në Fushë Lurë, ku gjetëm Muharremin, e disa miq të tjerë të vjetër, por Maklini nuk ishte. Disa prej tyre e humbën durimin nga fundi i 4 korrikut dhe ikën nëpër shtëpitë e veta. Më në fund, më 5 korrik, na sollën një letër nga Maklini, që e kishte vonuar një ditë korrieri, dhe ne morëm rrugën për në takimin që na kishte caktuar. Pas një dite të gjatë e të këndshme mbi kuaj, ne arritëm në vendqëndrimin e njerëzve të Abaz Kupit. Ishte një pamje përshtypjëlënëse në një luginë të bukur, të dy shpatet e pyllëzuara në të dy anët ishin të laracuara nga zjarret, mbi të cilat piqeshin në hell dele të tëra sipër flakëve të mëdha. Dukej që vendi gëlonte nga njerëzit dhe kishte ushqime të bollshme. Billi Maklini, David Smajli, Xhulian Emeri

dhe Jan Merreti ishin aty me shpurën personale. Ishte një atmosferë e plotë e Kupit. Madje edhe Muharrem Bajraktari u rregjua prej saj.

Lajmi që na priti ishte se një divizion partizanësh kishte kapërcyer lumin Shkumbin, i kishte dëbuar forcat zogiste nga Shëngjergji dhe po synonte drejt veriut. Kapërcimi i lumit kishte ndodhur më 26 qershor. Maklini dhe grupi i tij e kishin marrë vesh këtë dhe betejën që ishte bërë ndërmjet divizionit dhe një force zogistësh më 30 qershor. Faik Shehu, Haxhi Lleshi dhe Esat Ndreu duhej ta kishin ditur se cili ishte qëllimi, kur Riçard Ridelli dhe unë u kishim folur në dhjetë ditët e fundit të qershorit. Por ata as nuk e hodhën fjalën se çfarë po ndodhte, duke u kufizuar vetëm me predikimet se kishte ardhur koha që ne duhej ta ndanim mendjen se me cilën palë ishim.

Vargu i ngjarjeve të lidhura me konferencën e krerëve të mbledhur nga Maklini dhe me dështimin e saj si pasojë e përparimit të partizanëve shtjellohet në pjesën tjetër të këtij kreu. Ridelli dhe unë u kthyem që andej për t'u bërë më pas një mision që ishte me partizanët. Këtë gjë e diskutuam me Maklinin përpara se të largoheshim dhe duket se ai u pajtua, që ky do të ishte kursi i drejtë për ne në zonën tonë. Ne erdhëm përsëri në Gramë më 8 korrik dhe e gjetëm gjithë zonën të mbushur me thashetheme të çuditshme e me njoftime të pabesueshme, siç ishte njëri për një sulm që na kërcënonte nga Halil Alia. Më 9 korrik morëm një njoftim për një luftim që kishte ndodhur në Peshkopi (kjo shtjellohet në kreun 11 si fillimi i betejës së Dibrës). Nga 10 korriku u bë e qartë se çeta e Esat Ndreut dhe batalioni i Brigadës I partizane, që kishte arritur në Peshkopi dhe pastaj kishte bërë një përpjekje për të sulmuar kështjellën e Halil Alisë, kishte pësuar një gjymtim të rëndë me rreth 50 të vrarë e të plagosur. Të plagosurit nisën të vinin në kampin tonë më 10 korrik dhe ne i strehuam aq mirë, sa kishim mundësi. Furnizimet tona mjekësore i kishim fare të pakëta dhe na u desh të punonim nën shiun me rrebesh.

Fatet e misionit tonë Stables u kthyen me kokë teposhtë brenda pak ditësh. Kur ishim nisur për konferencën e Maklinit, Riçard Ridelli dhe unë ishim pesimistë për mundësitë e çfarëdo rezistence në Shqipërinë e Veriut. Kur u kthyem, ishte e qartë se kishte ardhur një forcë luftarake dhe se ditët e kthimit të fletës kishin marrë fund për këdo. Aty ishin pesë batalione të Brigadës I (Hakmarrja) të Mehmet Shehut në

zonën Dibër-Peshkopi dhe dy brigada të partizanëve maqedonë në afërsi. Dukej sikur ato do të ishin mjaft të forta të kapnin garnizonet gjermane në Dibër e Peshkopi, me kusht që të vepronin sistematikisht dhe me kusht që ne do t'i ndihmonim me furnizime. Por ne ishim të pasigurtë nëse ata do të ishin të gatshëm për të punuar me ne, apo nëse do të na lejonin të punonim me ta. Nevojat e tyre për furnizime ishin shumë të mëdha. Shumë nga partizanët që kishin ardhur prej jugut, ishin të rreckosur e disa ishin të zbathur. Ata kishin mungesa serioze të ushqimeve, por fryma e tyre luftarake dukej e shkëlqyer.

Problemi imediat që duhej të përballonin britanikët ishte lufta civile. A mund të përshkruhej situata thjesht si luftë civile? Nëse po, kujt i binte përgjegjësia për këtë? Dhe a mund të bënte Britania për këtë diçka që të kishte efekt real? Autoritetet britanike ishin në ankth për një farë periudhe rreth këtyre çështjeve dhe pastaj e panë se ata i fshiu tej rryma e ngjarjeve. Gjermanët i përcaktuan partizanët si armikun e tyre; partizanët i angazhuan në luftime gjermanët dhe krerët nacionalistë njëkohësisht; ndërsa njerëzit e zakonshëm, për një periudhë të shkurtër por më kulmore, i braktisën udhëheqësit e tyre tradicionalë dhe u bashkuan me partizanët fitimtarë. Britaninë e tërhoqi me vete vala partizane.

Misioni Concensus II: Angazhimi britanik pranë Abaz Kupit

Kur Billi Maklini, David Smajli dhe Xhulian Emeri u hodhën me parashutë më 19 prill, ata menjëherë u nisën në krahinën e Abaz Kupit në veri të Tiranës dhe u vendosën në Xibër e në shpatin e Malit të Bastarit, duke thithur edhe anëtarët aktivë të mbetur nga misioni i vjetër Slender (shih kreun 7)¹⁵. Emeri mori rolin e oficerit politik të misionit, ndërsa Smajli u bë oficeri operativ.

Ndërsa Maklini kishte qenë duke parashtruar në Londër çështjen për ta bërë Kupin që t'i përqendronte përpjekjet për t'i ngritur nacionalistët kundër gjermanëve dhe Ministria e Jashtme po e pranonte këtë si një politikë *faute de mieux*, Kupi vetë kishte propozuar kandidaturën e vet nga ana

e tij. Një radiogram nga majori Sejmur (Slender) iu dërgua Londrës nga Kajroja më 8 shkurt dhe përmbante një mesazh me datën 13 janar, të cilin Sejmuri e kishte marrë nga Kupi⁴⁶). Ai tërhoqte vëmendjen për Kongresin e lëvizjes së Legalitetit, që ishte mbajtur më 21 nëntor 1943 (shih kreun 4). Ai vazhdonte duke thënë se, meqë mund të priteshin së shpejti operacione të Aleatëve në Ballkan, bashkimi i forcave nacionale nën një komandë ishte thelbësor, me qëllim që të bëhej Shqipëria e aftë për të luajtur një rol të plotë, dhe këtë komandë duhej ta merrte përsipër mbreti Zog. Mbreti Zog duhej të ndërmerre hapa për të formuar një qeveri që të njihej në Londër ose në Kajro për të bashkërenduar punën e forcave luftuese shqiptare me Komandën Aleate. Një mesazh, që të mishëronte këto pika, duhej t'i drejtohej popullit shqiptar nga ana e mbretit Zog.

Radiogrami i Sejmurit përmbante gjithashtu të dhëna për Nikolsin. Ai njoftonte se ky po vuante nga një ngrirje akute dhe nga gangrena dhe kishte nevojë për një operacion të këmbëve. E mbanin të fshehur në shtëpinë e Abaz Kupit, i cili kishte siguruar për të shërbimet e Osmanit, të njohur si kirurgu më i mirë i Shqipërisë. Nënkuptimi ishte se Nikolsi ishte ende i gjallë më 5 shkurt, por mund të ketë ndodhur që, në ato vështirësi për komunikim, Sejmuri të mos e kishte marrë vesh ende vdekjen e tij, e cila ka ngjarë rreth asaj kohe. Sejmuri njoftonte komentet që kishte bërë Nikolsi për mesazhin e Kupit, me sa duket në gjysmën e dytë të janarit. Nikolsi e konsideronte se rekomandimet për denoncimin e partive të ndryshme politike, të paraqitura nga gjenerali Dejvis në dhjetor, tani ishin të prapambetura për shkak të ndryshimeve në situatën politike (sic). Ai mendonte se do të kishte vlerë një thirrje për bashkim nga ana e mbretit Zog kundër armikut të përbashkët. Duke ia përcjellë FO radiogramin e Sejmurit, z. Talbot Rajs i SOE, e komentonte që një mesazh nga ana e mbretit Zog ashtu siç e rekomandonte Kupi, mund ta largonte LNÇ dhe se do të ishte shumë më e përshtatshme të sigurohej një mesazh i shkruar nga mbreti Zog për t'ia përcjellur Kupit nëpërmjet ndonjë BLO, që t'i thoshte se konsiderata më e rëndësishme për ditët e tanishme, që të konsolidohej pozita e Shqipërisë me Aleatët, do të ishte të bashkëpunohej me të gjithë ata që dëshironin të luftonin kundër gjermanëve, duke përfshirë LNÇ, dhe jo të theksoheshin dallimet ideologjike ndërmjet së majtës e së djathtës.

Ideja për një mesazh të shkruar nga ana e mbretit Zog për Kupin tashmë ishte sugjeruar në Londër nga Maklini dhe Ministria e Jashtme e kishte hedhur poshtë rekomandimin e Dejvisit për të kaluar në mbështetjen e plotë të LNÇ (shih kreun 8). Propozimet e paraqitura Sejmurit nga Kupi ishin marrë para sysh në Kajro prej Kristofer Stilit, kur ai kishte dërguar telegramin që hidhte ujë të ftohtë mbi «manovrën politike ambicioze» të sugjeruar prej Maklini. Radiogrami i Sejmurit që përcillte mesazhin e Kupit për këtë arsye nuk ngriti ndonjë dallgë në Londër. Më 28 shkurt, FO miratoi rekomandimet e bëra nga Komiteti i Operacioneve të Posaçme në Kajro për t'i bërë një përgjigje Kupit¹⁷). Atij iu tha se Maklini do të vinte në Shqipëri për t'i diskutuar gjërat me të dhe do t'i jepeshin Kupit disa fonde për t'i dhënë zemër gjatë kohës që do të ishte në pritje.

Me sa duket, Kupi e ka bluajtur në mend për disa javë këtë përgjigje të dhënë për të fituar kohë dhe pastaj e ashpërsoi pozitën e vet. Një telegram nga Kajroja për SOE në Londër, më datën 7 prill, njoftonte se në një takim me Sejmurin, pas gjashtë javësh heshtjeje, Abaz Kupi kishte thënë që nuk do të ndërmernte asnjë aksion deri sa Aleatët të njihnin mbretin Zog dhe të lejonin që të formohej jashtë Shqipërisë një qeveri nën mbretin¹⁸). Nëse Aleatët nuk do ta pranonin këtë, Kupi do të kufizohej vetëm duke u dhënë strehim të sigurtë anëtarëve të misioneve ushtarake aleate në Shqipëri. Kupi pretendonte se ishte në gjendje të ngrinte menjëherë 6.000 deri 8.000 veta, dhe do t'i shtonte në 25.000 në kohën e përshtatshme. Ai e përshkruante Ballin Kombëtar si një forcë që kishte dështuar dhe e nënçmonte rëndësinë e Muharrem Bajraktarit në veri dhe në Kosovë. Komenti i Sejmurit për të gjitha këto ishte se politika e Kupit synonte të gjente një justifikim përse nuk po luftonte fare, ndërsa qëllimi i tij i vërtetë ishte të qëndronte pasiv nga ana luftarake dhe të mblidhte fuqinë e plotë për një *coup d'état* kur të iknin gjermanët.

Kjo që gjendja jo premtuese, në të cilën Xhulian Emeri e gjeti Kupin nga fundi i prillit. Emeri u përpoq ta bindte atë që ta shihte nevojën e aksioneve kundër gjermanëve edhe si qëllim të dëshirueshëm në vetvete, edhe gjithashtu si një parakusht të domosdoshëm për ndërhyrjen angleze që të parandalohet lufta civile, ndërsa një ndërhyrje e tillë vështirë se mund të përlligjej në rast se të dyja palët nuk do të ishin angazhuar kundër gjermanëve. Në këtë fazë Kupi nuk lëvizti

nga pozita e tij. Përveç kërkesës për të njohur mbretin Zog dhe një qeveri zogiste, ai po kërkonte gjithashtu që Shqipëria të përfshihet në Kombet e Bashkuara dhe të sigurohej vetëvendosja për Kosovën e për territoret në jug, që mund t'i pretendonte Greqia.

Maklini dhe Emeri e kaluan gjysmën e parë të majit duke u endur në Mat e në Krujë me Abaz Kupin, me qëllim që të shihnin vetë disa nga pasuesit e tij. Nga fundi i kësaj kohe, Kupi e ndryshoi qëndrimin deri në atë shkallë, sa të thoshte se do të luftonte, në qoftë se do ta urdhëronte mbreti Zog ta bënte këtë. Ai dëshironte një mesazh nga mbreti Zog. Maklini dhe Emeri e morën përsipër që ta paraqisnin këtë kërkesë në Londër. Mesazhet e Maklinit për këtë çështje arritën në Londër më 26 dhe 27 maj nga Bari.¹⁹⁾ Rekomandimin, sipas të cilit mbretit Zog duhej t'i kërkohej që t'i dërgonte Kupit një mesazh personal duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit me aleatët dhe nevojën e bashkëpunimit të plotë me oficerët ndërlidhës britanikë, e kaloi Filip Broudi me një miratim të vakët se ndoshta do ta detyronte Kupin të dilte hapur dhe të bënte një farë lufte kundër armikut, pas gjashtë muajsh pasiviteti, por do të ishte me rëndësi që ky mesazh të mos botohej, sepse do të kishte efekt të keq mbi LNC, e cila ishte e vetmja palë që po luftonte aktivisht kundër gjermanëve. Njëpërmjet kanaleve normale, raporti u shfaqërua me një mesazh personal nga Maklini për Sekretarin e Shtetit, Antoni Idenin. Aty thuhej:

«Kupi, udhëheqësi i Partisë Zogiste Shqiptare, ka rënë dakord që të bashkëpunojë me ne dhe të luftojë kundër gjermanëve. Ai e kupton se nuk mund të shtrohet çështja për të njohur Zogun, por kërkon që mbreti t'i dërgojë një telegram personal, të ndjekur nga një letër, që të konfirmojë vendimin e tij. Ka një rrezik të madh që pa këtë masë inkurajimi, Kupi mund të ecë në rrugën e Mihajloviçit dhe për këtë arsye unë shfrytëzoja ofertën tuaj për t'ju dërguar një telegram personal në rast të diçkaie urgjente».²⁰⁾

Mesazhet e Maklinit nuk ishin aq të mirëpritura në Ministrinë e Jashtme. Kishin kaluar vetëm tre muaj nga zënka shterpë me mbretin Zog për përpjekjen e mëparshme të Maklinit që të siguronte një letër për Kupin. Ajo që kërkohej nga Maklini ishte një raport i plotë për gjendjen e punëve në veri dhe ndonjë shenjë aksioni nga Kupi kundër gjermanëve, dhe jo një ngatërrim i padëshiruar me mbretin Zog. Reagimi

në nivelet e larta të FO ishte që t'u kthehej kurrizi vështirësive në trajtimin e Shipërisë dhe të nxirrej topi jashtë loje. Në një protokoll të 31 majit, Sër Orme Sarxhenti ka vënë në pikëpyetje vlerën e çfarëdo gjëje që mund të bëhej përgjithësisht në Shqipëri²¹). Atje kishte një amulli të plotë dhe madje edhe po të ishte në flakë i gjithë vendi, kjo do t'u shkaktonte fare pak telashe gjermanëve. Përpara se t'i futeshin një plani të përpunuar për të mobilizuar forcat e brendshme të rezistencës, Kuartieret e Forcave Aleate duhet të bënin pyetjen nëse vërtet dëshironin që të intensifikoheshin veprimet, apo do të mendonin që njerëzit, paratë dhe materialet mund të përdroreshin më mirë gjatë. Sër Aleksandër Kadogani shënoi më 1 korrik se ai pajtohej plotësisht me këtë: «Unë do të dëshiroja të dija më shumë, përpara se të këshilloja që këto përpjekje të ndërpriten»²²). I ra barra Idenit që t'u kujtonte zyrtarëve të tij se tashmë ishte pak vonë për të shprehur dyshime të tilla. Ai ka shënuar më 2 korrik:

«Por unë mendoja se të gjitha këto ishin diskutuar dhe vendosur kur kol. Maklini ishte këtu. Duket si shumë e vështirë që ai të dërgohet prapë dhe kur ai kërkon një letër nga Zogu të fillojmë ta shqyrtojmë nëse ne duam të bëjmë përgjithësisht ndonjë gjë në Shqipëri apo jo»²³).

Me sa duket, pasuan disa diskutime ndërmjet Sekretarit të Shtetit dhe këshilltarëve të tij. Është e qartë se këshilltarët ia arritën të bënin të tyren, sepse më 3 qershor Sarxhenti i ka shkruar Sekretarit të Shefave të Shtabit²⁴). Kjo bëri që SOE të paraqiste një memorandum për ta shqyrtuar Shefat e Shtabit²⁵). Ndërsa pajtohej që duhej kërkuar mendimi i AFHQ, SOE përmendte gjithçka lidhur me vlerën e rezistencës së partizanëve të LNC dhe dëshirën që të mos bëhej asgjë, e cila mund ta pengonte atë. Por jo po aq me korrektësi, SOE e përshkruante LNC si të ishte një lëvizje e jugut, ndërsa veriun si të ishte nën ndikimin e Abaz Kupit dhe, më lart në veri, sikur ishin krerët fisnorë të pavarur, ndërsa sikur mungesa e rezistencës kundër gjermanëve në veri i detyrohej faktit që grupet e veriut nuk ishin armatosur nga SOE. Natyrisht, ishte e vërtetë e kundërta: ata nuk ishin armatosur, sepse ata nuk do të luftonin kundër gjermanëve. SOE argumentonte me kujdes që ishte kundër mbështetjes për Kupin. Mareshali Tito do ta vështronte këtë si një veprim jo miqësor, do të duhej një kohë shumë e gjatë për të ngritur një forcë zogiste të

efektshme; Shipëria zinte një vend nga fundi në listën e përparësive për furnizimet ajrore dhe kjo fliste kundër ndërmarrjes së një angazhimi të ri; partizanët e LNÇ po i shqetësonin aktivisht komunikacionet e gjermanëve nga Greqia drejt veriut në bregdetin e Adriatikut dhe po arrinin «një numër rezultatesh të kënaqshme në një shkallë të vogël», ndërsa nuk prishte shumë punë nëse veprimtaria e tyre nuk dyfishohej në veri: energjitë e LNÇ do të tërhiqeshin mënjatë, nëse do të krijoheshin forcat e Kupit dhe kjo do të çonte në përleshje të brendshme. Rekomandimi përfundimtar ishte se armatimi i lëvizjes së Legalitetit të Kupit nuk duhej ndërmarrë. Kur Shefat e Shtabit u takuan më 8 qershor, ata miratuan një përgjigje për FO të paraqitur nga gjeneral-koloneli Naj (Nye):

«Është... pjesë përbërëse e strategjisë sonë në Ballkan që të gozhdohen sa më shumë forca armike në Shqipëri, për më tepër, planet tona të mashtrimit përfshijnë një sulm të trilluar kundër bregdetit shqiptar. Megjithatë në të kaluarën rezistenca shqiptare ka qenë në një shkallë mjaft të parëndësishme, e krahasuar me operacionet e Mareshalit Tito në Jugosllavi, ose madje edhe me veprimet e ELAS në Greqi.

Në këto rrethana Shefat e Shtabit janë të prirur që ta vënë në dyshim, nëse çfarëdo operacioni që mund të ndërmerrej nga pala zogiste si rezultat i këtyre propozimeve, do t'i sillte në këtë rast një mbështetje të madhe kërcënimit nga ana e aleatëve ose e asaj pale vetë kundër gjermanëve, duke ndihmuar në një shkallë të ndjeshme gozhdimin e forcave të armikut në Shqipëri. Kështu që inkurajimi i propozuar për palën zogiste vështirë se mund t'i përligjë e t'u vlejë për përpjekjet që do të kërkoheshin». (26)

Shefat e Shtabit i dërguan një radiogram AFHQ, duke kërkuar pikëpamjet e gjeneralit Uillon.

Gjenerali Uillon u përgjigj me një radiogram të datës 16 qershor. Ai, ashtu si edhe memorandumi i SOE, tërhiqte vëmendjen te vlera e veprimtarisë së partizanëve.

«Partizanët po rriten me shpejtësi nga forca dhe organizimi e tashmë janë një mjet i efektshëm për veprime kundër armikut në jug. ku janë edhe angazhimet e tij kryesore (mbrojtja e rrugëve jetike të komunikimit nga Greqia)... Duke pritur një pajtim ndërmjet zogistëve dhe partizanëve, mbështetja ushtarake për të parët do të ishte thjesht një inkurajim për zhvillimin e luftës civile... pajtimi... është një kërkesë paraprake thelbësore përpara se t'u jepet zogistëve çfarëdo ndihme ushtarake.»(27).

Por radiogrami përfundonte se nuk kishte të ngjarë për një pajtim.

Ministria e Jashtme pikërisht këtë nuk kishte dëshirë të dëgjonte. Ata ishin zhytur në një politikë të inkurajimit të Kupit (ndërsa, në mënyrë kontradiktore, nuk dëshironin ta inkurajonin Zogun) dhe vazhdonin të kishin një përshtypje shumë të zmadhuar për rëndësinë dhe aftësitë vepruese të Kupit. Ata vrisnin mendjen për ta mbajtur të hapur alternativën e supozuar të Kupit. Ndërkohë problemi ishte ndërlikuar nga vlerësimi i ri i situatës shqiptare që po përfitohej në Bari. Shenjat e para të tij ishin shfaqur në dyshimin për vlerën e Kupit, që shprehej në njoftimet nga Filip Broudi dhe nga Forca 266 në fund të majit e në fillim të qershorit, ndërsa Liku ishte në Shqipërinë e Jugut (shih pjesën e parë të këtij kreu). Më 11 qershor, Seksioni i Shqipërisë në Bari i dërgoi një telegram SOE në Londër, duke përsëritur argumentet e telegrameve të tyre të 6 e 7 qershorit dhe duke bërë një rekomandim të prerë të pafavorshëm për Kupin: «Ne e quajmë se tani ka ardhur koha për një ndryshim të politikës kundrejt lëvizjes së Kupit dhe gjithashtu kundrejt palëve të tjera në Shqipërinë e veriut»²⁸). Ata sugjerorin që t'i jepej një ultimatum Kupit në formën e një afati kohe për të ndërmarrë veprime kundër gjermanëve. Në një letër të 12 qershorit, Talbot Rajsi i SOE i tha FO se rekomandimet e Seksionit të Shqipërisë kishin miratimin e gjen. — maj. Stouell (shefi i Operacioneve të Posaçme për Mesdheun) dhe të Filip Broudit²⁹). Në disa telegrame ndërmjet Filip Broudit në Bari dhe Harold Makmilanit në Algjer u diskutuan avantazhet dhe dizavantazhet e mundshme të një afati kohe për Kupin. Broudi futi në këtë diskutim një pikë rreth qëndrimit të partizanëve të LNC, e cila po e bënte veten që të ndihej me një forcë në rritje: «Sipas njoftimeve që marrim nga oficerët britanikë të ndërlidhjes në zonën e LNC, partizanët gjithnjë e më tepër po e shtojnë mosbesimin ndaj politikës sonë të tanishme ndaj Kupit dhe ka një rrezik që të paragjykohej veprimet e tyre për interesin e përgjithshëm të Aleatëve, në rast se ata nuk binden që ndihma jonë në Shqipëri kufizohet dhe u jepet vetëm atyre që janë të përgatitur për të luftuar. Ata kanë mosbesim për lidhjet tona me Kupin dhe dyshojnë se në kemi plane për ta kthyer me forcë përsëri mbretin Zog»³⁰).

Broudi e përfundonte me një rekomandim të vendosur që Kupit i duhej kërkuar të kryente një operacion të veçantë kundër gjermanëve brenda një afati kohe, siç i ishte kërkuar gjeneralit Mihajlloviç në Jugosllavi.

Ideja e një ultimatumit për Kupin nuk u mirëprit në Londër. SOE dhe Shërbimet e armatosura kishin frikë se Kupi mund ta dridhte dhe atëhere nuk do të kishte një zgjidhje të prerë qartë. Ministria e Jashtme nuk dëshironte ta humbiste alternativën e Kupit. Askush nuk dëshironte një episod tjetër si ai që ishte provuar me Mihajloviçin. Në një mbledhje të 13 qershorit në Londër, të përcaktuar si mbledhja e 30-të e Komitetit të Ministrisë së Jashtme e të SOE, u pranua përgjithësisht vija e SOE që një kufi kohe me afat si shansi i fundit për Kupin mund të nxirrte vështirësi, në rast se Kupi do ta kryente me sukses detyrën që i ishte ngarkuar³¹). Sër Aleksandër Kadogani vazhdoi të përpiqej që Shqipërinë ta nxirrte në periferi të politikës, duke tërhequr vëmendjen te «sasia relativisht e madhe e materialeve që po i dërgohen Shqipërisë» dhe duke sugjeruar që «burimet tona të kufizuara të aeroplanëve dhe të anijeve ndoshta do të përdroreshin më mirë në drejtime të tjera». Ky argument u la mënjanë nëpërmjet një marrëveshjeje, që FO do ta mbikëqyrte situatën. Politika lidhur me Kupin u la në një farë gjendjeje të pa-përcaktuar. Nuk pati ndonjë marrëveshje që t'i jepej mbështetje, por gjithashtu as për t'ia hequr mbështetjen, dhe as për ta vënë në provë atë.

Departamenti i Jugut i FO vazhdoi ta përtypte këtë problem. Denis Laskej³²), Sekretar i Tretë, oficeri i zyrës së Shqipërisë, ka shënuar më 15 qershor:

«Ka disa avantazhe ushtarake afatshkurtër po të vazhdojmë të veprimet me Kupin dhe mund të kemi disa avantazhe politike afatgjatë shumë më të fuqishme. Për shembull, nuk është aspak e sigurtë se ne do të fitojmë politikisht duke i vënë gjithë paratë tona në kartën e LNC që anon nga komunistët»³³).

Zëvendësshefi i departamentit, Armin Dju³⁴), e pasoi këtë me një shënim protokoll, që e zbulonte acarimin ndaj rrymës kundër Kupit, që po vinte nga Bari dhe SOE:

«SOE po na shtyn nga një ekstrem në tjetrin brenda një kohe prej 3 javësh. Unë nuk e besoj se ndonjë nga këta njerëz e merr vesh se për çfarë flasin dhe se këshillat që marrim janë nga ekspertë të paragykuar (të ashtuquajtur), të cilët i ngrenë shumicën e kopicave të tyre të vogla të plehut ndoshta për arsye personale, me qëllim që të zmadhojnë rëndësinë e vet»³⁵).

Zyrtarët e Ministrisë së Jashtme shpresonin se gjenerali Uillon mund të ftohej që të bënte komente të tjera dhe ata mendonin se kishin zbuluar një kontradiktë në radiogramin e tij të 16 qershorit,³⁶) që mund të hapte rrugë për shkëmbime të tjera. Më 20 qershor, Sër Orme Sarxhenti i shkroi Sekretarit të Komitetit të Shefave të Shtabit, duke vënë në dukje se mesazhet e fundit nga Bari përmbanin propozime krejt të ndryshme nga ato, për të cilat ishte kërkuar që të raportonte gjenerali Uillon: «na duket se atij i duhet kërkuar që t'i marrë ato në konsideratë përpara se të dërgojë pikëpamjet e tij»³⁷). Megjithatë, Shefat e Shtabit e shqyrtuan radiogramin e gjeneralit Uillon të 16 qershorit në një mbledhje të 22 qershorit dhe vendosën ta quajnë atë si konfirmim të drejtësisë së përfundimeve të tyre të mëparshme të përkohshme: «që nuk i duhet dhënë asnjë inkurajim partisë zogiste»³⁸). Që nga kjo kohë e më pas, FO nuk do të merrte dot asnjë mbështetje nga ana e ushtarakëve për një politikë pro Kupit.

Megjithatë, përfundimi i arritur nga Shefat e Shtabit nuk mund të ishte fjala e fundit për këtë çështje, sepse në fakt po i jepej inkurajim partisë zogiste me dërgimin të Kupit të misionit Concensus II. FO vazhdonte të kërkonte një rrugë të mesme. Në protokollet e 27 dhe 28 qershorit³⁹), Laskej dhe Dju kanë vënë në dukje se është e padëshirueshme që të jemi të detyruar të vihemi në një pozitë të tillë, sa t'i japim gjithë mbështetjen LNC, ndërsa nuk e dinin fare se një ditë më parë, më 26 qershor, Divizioni i I partizan kishte kapërcyer Shkumbinin me qëllimin e përpiktë që të shtrëngonte këdo, brenda dhe jashtë Shqipërisë, që të ndiqte vijën e LNC. Protokollit i Djusë përfshinte këtë koment:

«Kemi të bëjmë me historinë e vjetër të Zervasit dhe të ELAS, të Mihajlloviçit dhe të Titos, ndërsa për asnjërin prej këtyre rasteve ne nuk kemi gjetur ende një zgjidhje. Çështja shqiptare është shumë më e komplikuar, sepse nuk ka madje as një qeveri në mërgim, rreth së cilës të dyja palët mund të shtyheshin për t'u bashkuar. Personalisht mua do të më pëlqente të mbaja një qëndrim krejt të paanshëm ndaj Shqipërisë».

Ai vazhdonte duke sugjeruar se kursi më i mirë do të ishte të liheshin BLO të luanin rolin e arbitrit, ata mund ta përcaktonin se kush po luftonte e kush nuk po luftonte kundër gjermanëve dhe në përputhje me këtë mund të jepej ndihma materiale. Sër Orme e ka shënuar më 28 qershor miratimin e tij

për këtë vijë. Kështu, rrota e bëri rrotullimin e saj të plotë dhe Ministria e Jashtme u kthye prapë te pika, ku nuk kishte asnjë politikë që t'ia vlente të shprehej lidhur me Shqipërinë, pikërisht kur ishte arritur pika kulmore në çështjet shqiptare, kapërcimi i Shkumbinit nga Divizioni I partizan.

Madje edhe tani, pasi zbatoi një qëndrim dorëheqjeje, FO vazhdoi të përpiqej ta mbante të hapur alternativën e Kupit. Më 6 korrik, Sër Orme i shkroi Sekretarit të Komitetit të Shefave të Shtabit, duke e kundërshtuar edhe një herë idenë për t'i dhënë Kupit një afat kohe për veprim dhe duke këmbëngulur që qëllimi i parë duhej të ishte nxitja e një lloj marrëveshjeje pune ndërmjet Kupit dhe LNC⁽⁴⁰⁾. Ai bënte këtë koment: «nga pikëpamja politike ka shumë gjëra për të thënë që ne ta mbajmë lidhjen me Kupin». Me sa duket, ai shpresonte se ende mund të ishte e arritshme të nxirrej një farë ndihme ushtarake për këtë qëndrim dhe e ngacmonte një kontradiktë të mundshme në tekstin e radiogramit të gjeneralit Uillon me datën 16 qershor, duke shpresuar se gjeneralit mund t'i kërkohej të bënte shpjegime të tjera. Ndërkohë, Smajli e kishte kryer shkatërrimin e një ure në zonën e Kupit dhe Sër Orme e citoi këtë si një dëshmi të mundshme për ndryshimin e qëndrimit të Kupit.

Ishin bërë tashmë gjashtë javë që kur Maklini i kishte dërguar mesazhin Sekretarit të Jashtëm dhe ngjarjet e kishin përmbytur atë situatë, që kishte qenë kur e dërgoi, e tashmë ishte larguar nga ajo që në FO mendohej se vijonte të ishte. Pasi kishte dërguar mesazhin në ditët e fundit të majit, Maklini kishte nisur një udhëtim me Emerin për t'u njohur me gjendjen e punëve në veri, jashtë territorit të vendlindjes së Kupit. Ata vizituan zonën e Dibrës, ku morën informata nga majori Ridell, dhe ecën drejt veriut përmes gjithë zonës së misionit Stables, duke takuar personalitetet e ndryshme udhëheqëse, me të cilët ne të misionit Stables kishim pasur të bënim gjatë dimrit, familjen Kaloshi, familjen Ndreu, Litajt dhe, në Lumë, Muharrem Bajraktarin. Ata kërkonin me zell ndonjë shkëndijë rezistence ndërmjet hirit nacionalist, të cilit ne i kishim bërë tashmë një gërmim të plotë e zhgënjyes. Është krejt e natyrshme, që u nxorën në dritë disa shkëndija. Krerët e veriut nxorën në shesh gjithë premtimet e tyre të vjetra dhe u përpoqën t'i ekspozonin sa më mirë përpara këtij misioni të ri dhe më me autoritet. Muharrem Bajraktari paraqiti memorandumimin e tij që iu prit

me seriozitet dhe, ashtu siç ia kishim kërkuar ne, iu tha që të mendonte me më shumë modesti për të kryesuar rezistencën në zonën e tij lokale rreth Kukësit e në luginën e Drinit, se sa të përpiqej për të marrë udhëheqjen e gjithë kombit. Nga Luma Maklini dhe Emeri u shtynë më në veri gjatë Drinit në krahinat e Hasit e të Bytycit, duke i shoqëruar Muharrem Bajraktari. Këtu, më 5 qershor, në kufijtë e Kosovës, në kordrat pranë Gjakovës, ata takuan Gani e Seid Kryeziun. Për herë të parë ata dëgjuan nga një nacionalist shqiptar atë, që çdo BLO në veri kishte kohë që po priste ta dëgjonte, një deklaratë të pacilësuar për gatishmërinë që të luftonin menjëherë kundër gjermanëve në cilindo drejtim që do ta kërkonte Kryekomandanti Aleat. Gani Kryeziu nuk kishte mëdyshje dhe kërkoj që pranë tij të atashohej një oficer britanik. Aty në verd ishte Toni Simkoksi, i cili tashmë ishte shkëputur nga misioni Stables në mes të majit, për të kryer një rikonjicion në veri, pra ishte kandidati i gatshëm për këtë post dhe u dërgua që të merrte një pjesë nga materialet dhe pajisjet e Stables, me qëllim që të ngrihej vetë si një mision i pavarur me Gariun. Ndodhi që në këtë vizitë të shkurtër që na bëri në misionin Stables më 11 qershor, ai më mori kalin tim.

Në paraqitjen e tij të plotë për udhëtimin në veri me Maklinin. Xhulian Emeri në veprën «Bijtë e Shqipëse» përmend se Gani Kryeziu ishte në kontakt me partizanët e Kosmetit, të cilët në këtë kohë nuk ishin në gjendje të arrinin asgjë në atmosferën antisllave, antiserbe dhe nacionaliste që mbisundonte ndërmjet shumicës së shqiptarëve në Kosovë; ai përshkruan gjithashtu praninë e Ganiut me Llazar Fundon, komunistin shqiptar që ishte kthyer kundër Stalinit dhe kishte braktisur Moskën e Kominternin⁽⁴⁾. Ganiu i zhvilloi bisedimet me britanikët pak a shumë hapur përpara partizanëve. Në atë kohë ata ishin të pafuqishëm për të bërë çfarëdo gjëje lidhur me këtë. Por nuk ka asnjë dyshim se një informacion i plotë i është dërguar Enver Hoxhës në njërin drejtim dhe Titos në drejtimin tjetër, e që të dy këta udhëheqës duhej tashmë ta kishin vendosur se, nga pikëpamja e tyre, do të ishte më mirë që të mos kishte fare rezistencë në Kosovë, se sa të kishte një lëvizje të suksesshme, të udhëhequr nga Gani Kryeziu me mbështetjen angleze. Kështu që fati i projektit Kryeziu-Simkoks ishte i paracaktuar dhe prania e Fundos shtonte një element të shëmtuar të pjesëmarrjes së ko-

muniste në këtë situatë. Por mundësinë për të vështruar përpara, që na jepet sot për ta parë këtë, nuk e kishin oficerët britanikë që ishin të interesuar më 1944.

Maklini dhe Emeri e plotësuan punën e tyre me Gani Kryeziun në veri të Drinit më 6 qershor dhe bënë një marshim të shpejtë e të mundimshëm për t'u kthyer në kampin e tyre të fushimit në Malin Bastar nëpërmjet zonës së prapambetur e të pasigurtë të Mirditës, «kapedan» i së cilës ishte Gjon Markagjoni, një bashkëpunëtor i njohur i gjermanëve. Ata arritën në kampin e tyre më 11 qershor, të shoqëruar nga Seid Kryeziu. Ndërmjet mesazheve që kishte marrë Smajli gjatë mungesës së tyre, ishin disa që e paraqisnin kërcënimin e mësymjes partizane në veri të Shqipërisë, por asnjëri nuk jepte një përgjigje të qenësishme për kërkesën e një mesazhi nga mbreti Zog për Kupin, që ishte paraqitur dhe dërguar afër tri javë më parë. Prandaj atyre iu desh t'i dilnin përballë Kupit me duart të zbrazëta. Pas shumë bisedave të vështira me të, në të cilat ata vunë në dukje seriozitetin e gjendjes së vështirë në të cilën ai do të binte, nëse partizanët do të virin në veri dhe do ta godisnin përpara se ai të kishte bërë ndonjë lëvizje për të luftuar kundër gjermanëve, ai u këshillua me pasuesit e tij kryesorë dhe u kthye me përgjigjen se ai ende nuk mundej të ndërmerre ndonjë hap për të lëvizur. Ai do t'i mbante forcat e tij të mobilizuara për t'i bërë qëndresë mësymjes partizane të pritshme. Megjithatë, ai ishte tronditur nga një mesazh prej një njësie zogiste në jugperëndim të Tiranës, që njoftonte se partizanët i kishin sulmuar. Prandaj ai e ndryshoi qëndrimin dhe tha se do të pranonte të bëhej shkatërrimi i një ure në zonën e tij. Kjo i hapi rrugën Smajlit për të hedhur në erë urën e rëndësishme të Gjoles në rrugën kryesore nga Tirana që të çonte në Durrës e në Shkodër, i mbështetur nga një tufë zogistësh. Ky operacion u krye me sukses natën e 20-21 qershorit. Pas kësaj, Kupi e quante se ai e kishte treguar besën e tij dhe kërkoi që të përpunohej një plan furnizimesh, që do t'i jepte atij mundësinë për ta zënë fushën e betejës. Kjo kërkonte një shmangie thelbësore nga parimi «nuk ka armë përpara se të bëhen aksione», por Maklini e pranoi shkatërrimin e urës së Gjoles si një shenjë të mjaftueshme për vullnetin e Kupit që të luftonte dhe, nga 23 qershori, hartoi me të një plan për furnizimin e mortajave, të mitralozëve të lehtë, të mitralozëve të rëndë, të pushkëve

antitank dhe të municioneve të mjaftueshme për të pajisur një forcë prej 2.000 vetash, të organizuar në 8 grupe me nga 250 veta secili. Ky plan iu dërgua me telegram Barit për miratim e zbatim, ndërsa Merreti u dërgua që të hapte një shesh të ri e të sigurtë hedhësh afër Macukullit, për të pritur furnizimet eventuale. Në këtë kohë Sejmurit u largua nga misioni për t'u evakuuar nga aerodromi që e mbanin partizanët jugosllavë në Beranë të Malit të Zi. Shoqëruesit e tij, që rrok ishin partizanë, u vranë nga partizanët e Kosmetit, kur ranë në duart e tyre *en route*.

Maklini tani i ftoi gjithë krerët udhëheqës të veriut për t'u takuar me të në Lurë, në malësinë në gjysmë të rrugës ndërmjet zonës së Kupit dhe luginës së Drinit, më 4 korrik. Pasi ia kishte dalë ta bënte Gani Kryeziu në kufirin e Kosovës dhe Kupin në Mat e në Krujë që ta shpallnin veten se ishin të gatshëm për të luftuar, edhe nëse do të kishin mundësi ose në rastin e Kupit do të kishte mundësi, të ndërmerrenin hë për hë vetëm një veprimtari të rreme në krahasim me rezistencën serioze që tani zhvillohej nga partizanët, Maklini shpresonte t'i tërhiqte të gjithë krerët veriorë në një lëvizje të përgjithshme të rezistencës bashkë me ta. Ndërsa po prisnin për këtë mbledhje vendimtare, Maklini, Emeri dhe Hejri vajtën në rrethinat e Tiranës në një përpjekje për t'i bindur personalitetet e ndryshme të njohura atje që të mos merrnin pjesë në një qeveri të re, të cilën po përpiqeshin ta formonin gjermanët, sipas një orientimi për rezistencë kundër komunizmit. Ata morën përgjigjen e zakonshme se u binte barra anglezëve që ta shtrëngonin Enver Hoxhën, të cilin e kishin armatosur. Kësaj tani iu shtua argumenti se Gjermania tashmë, në fakt, kishte marrë fund: kishte ardhur koha për të kundërshtuar përparimin e komunizmit.

Kur ata u kthyen në bazën e tyre në Malin e Bastarit më 29 qershor, i priti Smajli me lajmin se Bari e kishte miratuar marrëveshjen e furnizimeve me Kupin dhe se gjashtë ngarkesa aeroplani me material tashmë ishin grumbulluar. Të nesërmen erdhi lajmi se Divizioni I partizan kishte kapërcyer malet e Çermenikës dhe i kishte dëbuar zogistët nga Shëngjergji. Pasi një takim i zyrtë me Kupin i Maklini, të mbështetur nga Seid Kryeziu, që i kërkoi Kupit ose ta vinte gjithçka për një sulm të plotë kundër gjermanëve ose, po të mos e bënte këtë, t'i lejonte pa kundërshtime partizan-

nët që të hynin në Krujë e në Mat. Kupi nuk mund ta pranonte. Zymtësia në kampin Concensus II u lehtësua pak, kur erdhi një mesazh nga Bari, që thoshte se të gjitha furrimet për partizanët do të ndërpriteshin, për shkak të sulmeve të Divizionit I kundër zogistëve. Kjo do të thoshte se Kuartieret britanike kishin ndërmend të pranonin këshillën e nacionalistëve dhe të ndalonin Enver Hoxhën. Në misionin Concensus II nuk u vlerësua, ose ndoshta (nga goditja e parë prej lajmit) në Bari, se Enver Hoxha tani në fakt ishte i pandalshëm, se gjermanët, të cilët nacionalistët me gëzim i përshërdesnin në rrugën e tyre sa herë që ata sulmonin partizanët, mund t'i mbanin shpresat në luftën e pandërprerë kundër partizanëve kudo në Shqipëri për të shpëtuar vetveten, dhe se britanikët do ta kishin të pamundur t'i mononin furnizimet forcës më të madhe që ishte angazhuar në luftime të gjera serioze kundër gjermanëve, duke pasur si qëllim që me këtë mohim të shpëtonin ata që nuk kishin luftuar fare.

Maklini dhe oficerët e tij u nisën për konferencën e krerëve në Lurë dhe e bindën Kupin që të mos qëndronte mënjane, në kundërshtim me shqetësimin e tij për të mbrojtur territorin e vet kundër Divizionit I. Mbledhja u bë një ditë më vonë më 5 korrik. Në ato rrethana ajo nuk mund të arrinte asgjë. Krerët po peshonin shanset e tyre për të arritur ndonjë lloj marrëveshjeje me partizanët kundër shanseve se Britania mund të vendoste për një vijë të ashpër me partizanët dhe t'i detyronte ata të ndaleshin, ndërsa për këtë rastin e fundit nëse ata do të bënin më mirë t'i lëpisheshin Kupit e Zogut, apo të ngulmonin për pretendimet e tyre të pavarura për udhëheqje. Enver Hoxha nuk mund ta ketë ditur në atë kohë se sa me mprehtësi e kishte dhënë goditjen e tij. Alternativa e Kupit, alternativa e Muharrem Bajraktarit, alternativa e Litajve (nëse kishte ekzistuar ndonjëherë), alternativa e Kaloshëve, të gjitha mbetën në vend të zbrazëta. Kjo u pranua menjëherë lidhur me këdo, me përjashtim të Kupit. Angazhimi anglez me Kupin në trajtën e misionit Concensus II e mbajti alternativën e Kupit të vazhdonte edhe për katër muaj të tjerë. Ajo duhej të kishte marrë fund në korrik.

Mbledhja e Lurës përfundoi me lajmin se majori Viktor Smith, i cili ishte numri dy pas nënkolonelit Alan Palmer në jug, ishte hedhur për misionin Concensus II me manda-

tin që të përpiqej ta parandalonte luftën civile. Smithi ndodhi që ishte në Bari për shkak të evakuimit të disa oficerëve britanikë nga jugu gjatë ofensivës së qershorit, të ndërmarrë nga gjermanët kundër partizanëve. Ai zbriti në sheshin e hedhjeve të Merretit në Macukull, më 6 korrik. Në kreun tjetër do të trajtohen misioni i tij, synimet dhe vazhdimësia e tij. Maklini, Smajli dhe Emeri ikën nga Lura më 7 korrik dhe vetëm kur u afruan në Mal Bastar, panë se kampi i tyre i fushimit tashmë ishte përparë nga Divizioni I partizan, kapiteni Alan Hejr dhe radisti i tij ishin nisur për në Kuartierin e Divizionit I dhe partizanët po digjnin shtëpitë e për-krahësve kryesorë të Abaz Kupit në luginën e Matit. Që nga kjo kohë e më pas, misioni Concensus II u kthye në një mision të arratisur pa një bazë. Për fat të mirë, ata e kishin një radio dhe rreshterin Dejvis që të punonte me të, pasi ia kishin marrë hua Ridellit dhe misionit Stables.

Në çdo fazë të gjysmës së parë të vitit 1944, pas humbjes së gjeneralit Dejvis, përpjekjet e njëpasnjëshme të Britanisë për të zhvilluar një politikë efektive kundrejt Shqipërisë u kapërcyen nga ngjarjet. Ato veprime të britanikëve, që do të kishin qenë praktike e ndoshta të ndjeshme dy a tre muaj më parë, ishin të prapambetura dhe me efekt të kundërt në kohën që viheshin në zbatim. Kjo ndodhte veçanërisht në rastin e Misionit Concensus II. Kur po ikte nga Londra, Maklini iu kërkua të bënte një raport të shpejtë e të plotë për situatën në veri. Mendohej se kjo duhej të vinte përpara marrjes së çdo vendimi dhe do të jepte bazat e nevojshme për vendimet. Raporti i plotë, ashtu si shumë gjëra të tjera, humbi në rrymën e ngjarjeve. Maklini dhe Emeri nuk ia dolën që ta shkruarin atë deri nga mesi i qershorit dhe ai nuk arriti në Londër deri më 26 qershor⁴²). (Ai jepet në fund të këtij libri si Shtojca 2). Ish oficerëve ndërlidhës britanikë u shkaktonte habi se si një tekst kaq i gjatë e me shumë fjalë, do të mund të dërgohej telegrafikisht në Bari me anë të shifrimit të thjeshtëzuar dhe të programeve e të procedurave të pasigurta të radiove, nga të cilat ne ishim të detyruar të vareshim. Ai e meriton të paraqitet si dokument i një analize shumë të mirë të pozitës së krerëve nacionalistë në veri. Por që në çastin që u shkrua, ai ishte i dënuar të ishte dhe të mbetej një studim akademik. Çështjet e Shqipërisë nuk kishin ngecur në dhjetor 1943 e janar 1944, kur partizanët e LNÇ u shpartalluan në pjesën e parë të luftës civile, çështjet e Shqipërisë kishin vazhduar të rridhnin dhe nga qer-

shori 1944 partizanët kishin fituar forcë të madhe. Kishte mbetur shumë prapa ajo kohë, kur mund të ngrihej një kryengritje e përgjithshme nacionaliste. Megjithatë, ai raport është një përmendore e vlefshme se çfarë mund të kishte qenë Shqipëria.

Shënimet

1. PRO, WO. 204/10236.
2. Nga dokumentet e mbajtura privatisht që nga koha e luftës dhe dhe që tani i ruaj unë.
3. PRO, FO, 371/43555, telegram i Barit për Algjerin, nr. 27 i 12 majit
4. Hansard, vëll. 400 HC Deb, 5, kol. 572.
5. Smiley (1982; 120).
6. PRO, FO. 371/43551.
7. Po aty.
8. Po aty.
9. Po aty.
10. PRO, WO. 204/9531.
11. Po aty.
12. PRO, FO. 371/43551, telegram i Barit për Algjerin, nr. 185 dhe 200.
13. Po aty.
14. PRO, WO. 204/10235.
15. Një raport i plotë për kontaktet e misionit Concensus me Abaz Kupin gjendet në librin e Amery (1948) dhe një paraqitje më e përgjithshme për lëvizjet e misionit gjendet te Smiley (1984).
16. PRO, FO. 371/43563.
17. PRO, FO. 371/43569, telegram i FO. për Kajron, nr. 290 i 28 shkurtit.
18. PRO, FO, 371/43555.
19. PRO, FO, 371/43555, shtojca te COS. (44) 490 (0) i 3 qershorit.
20. Po aty.
21. PRO, FO. 371/43550.
22. Po aty.
23. Po aty.
24. PRO, FO. 371/43555, COS. (44) 490 (0) i 3 qershorit.
25. PRO, FO. 371/43555, COS. (44) 502 (0) i 7 qershorit.
26. PRO, FO. 371/43555, COS (44) mbledhja e 187 (0) e 8 qershorit, çështja 4.
27. PRO, FO. 371/43563, radiogrami MEDCOS 130.
28. PRO, FO. 371/43563.
29. Po aty.

30. PRO, FO. 371/43563, telegram i Barit për Algjerin, nr. 133 i 16 qershorit.
31. PRO, FO. 371/43563, pjesë nga protokollet e përkohshme të mbledhjes së 30-të të Komitetit të Ministrisë së Jashtme — SOE.
32. Më vonë Sir Denis Laskey, KCMG, ambasador në Bukuresht e në Vjenë.
33. PRO, FO. 371/43563.
34. Armine Dew nuk rrojti deri në mbarim të luftës: ai vdiq në një aksident ajror mbi Mesdheun rrugës për në Konferencën e Jaltës në janar 1945.
35. PRO, FO. 371/43563.
36. MEDCOS 130. — shih shënimin 27.
37. PRO, FO. 371/43563.
38. Po aty.
39. Po aty.
40. PRO, FO. 371/43566.
41. Amery (1948: 131-33).
42. PRO, FO. 371/43551.

Kreu 10

Kriza e korrikut

Pak kohë përpara se mësymja drejt veriut e partizanëve ta shpejtonte krizën e marrëdhënieve ndërmjet FNÇ, zogistëve dhe britanikëve, në Bari ngjau i fundit nga disa riorganizime për përgatitjet e kuartierit që të merrej me rezistencën në Ballkan. Nga njëra anë, strukturat e komandave kishin nevojë të bëheshin më të specializuara dhe të larmishme në nivelet e ulëta, me qëllim që t'u përshtateshin ndërlikimeve në rritje të angazhimit aleat në çështjet e Ballkanit; nga ana tjetër, nevojitej një kontroll i gjithanshëm për t'i mbajtur të lidhura së bashku komandat e ulëta që po shumëzoheshin. Regjimentet dhe grupet e forcave ajrore britanike e amerikane, që përdoreshin për mbështetjen e rezistencës në Ballkan po formonin një organizëm të ri, që mori emrin Forca Ajrore e Ballkanit brenda komandës së gjeneralit Iker të Forcave Ajrore Aleate për Mesdheun⁴). Komandanti Suprem Aleat për Mesdheun, gjenerali Uillon, lëshoi në qershor një direktivë, që i jepte pushtet nënmareshalit të ajrit Eliot²), të sapoemëruar si oficer ajror për të komanduar Forcën Ajrore të Ballkanit (BAF), që të ushtronte kontrollin operativ mbi operacionet e posaçme në Hungari, Jugosllavi e Shqipëri dhe të siguronte bashkëpunimin e plotë ndërmjet shërbimeve për operacionet përtej Adriatikut. Nënmareshali i ajrit mbajti një mbledhje në kuartierin e tij në Bari, më 17 qershor, për të përcaktuar pikat e referimit që të kishte një Komitet Politik të ri për BAF dhe, nën mbikëqyrjen e tij, një Komitet të Operacioneve të Posaçme, që të mbikëqyrte operacionet e përditshme³).

Pati edhe një ndryshim tjetër në numrin e koduar të Kuartierit të Forcës që merrej me Shqipërinë. Kuartieri i Operacioneve të Posaçme për Mesdheun, nën gjen.-maj. Stouell, funksiononte që nga prilli. Ndërkaq Forca 266 ishte zhvilluar si një kuartier i forcave për inkursione dhe së fundi, në maj, ishte shndërruar në Kuartierin e Forcave Zbarkuese të Adriatikut⁴). U ngrit një Forcë e re 399, përgjegjëse përpara gjen.-maj. Stouell, nën drejtimin e nënkolonelit Lord Harcourt dhe prej Forcës 266 ajo thithi Seksionin e Shqipërisë, të cilin Forca 266 dhe e mëparshmja e kishin trashëguar nga Forca 133, së bashku me Seksionet që merreshin me Jugosllavinë dhe Hungarinë. Forca 133 vijonte të ekzistonte, por merrej me Greqinë dhe me vendet e tjera të Ballkanit.

Komiteti i ri Politik i BAF⁵) kishte si përgjegjës Nënmarshalin e Ajrit dhe si anëtarë një përfaqësues të gjeneralit të brigadës Ficroj Maklin, komandantët e Kuartierit të Operacioneve të Posaçme për Mesdheun dhe Kuartierin e Forcave të Zbarkimit për Adriatikon, Oficerin e Flamurit Detar të Tarantos dhe të Ndërlidhjes për Italinë (FOTALI), përfaqësuesin në Bari (Filip Broudin) të Ministrit rezident pranë AFHQ (Harold Makmilanin), një përfaqësues të Këshilltarit Politik Amerikan pranë AFHQ (Robert Mërfi), një përfaqësues të Degës së Luftës Psikologjike (PWB) të AFHQ dhe kooptoi, pas mbledhjes së parë, komandantin e Forcës 399. Sekretariati i Komitetit Politik kishte në shërbim zyrën e Broudit dhe në shumicën e rasteve kryesohej nga nënkoloneli Uiliam Dikin⁶). Komiteti Politik ishte i ngarkuar me funksionet e AOC si përfaqësues lokal i Komandantit Suprem të Aleatëve lidhur me çështjet politike në zonën e përgjegjësisë së AOC, domethënë në Jugosllavi, Shqipëri e Hungari. Komiteti i Operacioneve të Posaçme i varur nga Komiteti Politik kishte një anëtarësi pak më të gjerë dhe përfshinte Forcën 133, Zyrën Amerikane të Shërbimeve Strategjike dhe dy a tri trupa të specializuara ushtarake dhe/ose informative. Këto komitete kryesore ndërshërbimore mbështeteshin nga një Komitet Informativ i Bashkuar, një Komitet Planifikimi i Bashkuar, një Komitet Sinjalizimi i Bashkuar dhe një komitet që merrej me përgjegjësitë për propagandën të PWB. Kur lindi kriza e korrikut në Shqipëri, në sajë të këtij organizimi kishte një kuartier të integruar në Bari, që ishte i aftë të merrej me të, madje edhe pse ky kuartier kishte vetëm dy javë që ishte krijuar.

Edhe tri episode të tjera meritojnë të përmenden përpara

se të shqyrtohet kriza e korrikut. Ministria e Jashtme në Londër vazhdonte përpjekjet për të parandaluar autoritetet ushtarake që t'ia mbyllnin plotësisht derën e ndihmës Kupit. Përpjekjet e tyre më në fund i shkëputën një lëshim Komitetit të Shefave të Shtabit. Në një mbledhje të 11 korrikut zëvendëshefat shqyrjuan një material për Shqipërinë, që ishte frymëzuar nga këmbëngulja kokëfortë e Sër. Orme Sarxhentit, se qëllimi duhej të ishte që të arrihej një pajtim ndërmjet FNÇ e Kupit dhe se politikisht do të ishte e dëshirueshme të mbaheshin lidhjet me Kupin. Gjeneral-majori Gubins, shefi i SOE, nuk pati mundësi të merrte pjesë në mbledhje, por ai dërgoi një letër, që shprehte pikëpamjet e SOE. Ai vinte në dukje se mundësitë për të realizuar një pajtim ndërmjet FNÇ dhe Kupit ishin shumë të vogla. Ndërsa pajtohej se duhej të vazhdonin përpjekjet për të arritur një marrëveshje, ai këmbërgulte që «e vetmja vijë e dobishme për veprim në atë çast në Shqipëri ishte të vazhdohej t'i jepet mbështetje e plotë LNÇ, që po luftonte kundër gjermanëve me një shkallë të konsiderueshme suksesi»⁷). Zëvendëshefat u morën vesh që t'i dërgonin një radiogram gjeneralit Uillson, i cili pa e kundërshtuar gjeneral-majorin Gubins, i dha një farë sadsifaksioni FO, duke bërë një pyetje hipotetike:

«Ministria e Jashtme dhe SOE në Londër pajtohen me ne, se në këtë rast (pajtimi ndërmjet zogistëve dhe FNÇ) kundërshtimet për të mbështetur zogistët, të paraqitura në telegramet përkatëse (COSMED 126 dhe MEDCOS 130 të 16 qershorit) nuk do të vlejné dhe ne duhet të jemi të përgatitur për t'u dhënë atyre ndihmë, me kusht që ne të sigurohemi se ajo do të përdoret kundër gjermanëve»⁸).

Gjenerali Uillson u pyet nëse pajtohej. Ai zor se mund të bënte ndryshe, ndonëse hipoteza e pajtimit tashmë ishte e paralizueshme nga 11 korriku. Por përsëritja në këtë kohë dhe në këtë nivel të lartë e objektivit hipotetik, shërbeu që t'i pengonte për disa javë gjithë të interesuarit që të mos arrinin në përfundimin e vështirë se duhej bërë, më së fundi, një zgjedhje ndërmjet FNÇ dhe lëvizjes zogiste.

Ndërkaq, kryesisht në sajë të ofensivës së madhe gjermane të qershorit kundër forcave partizane dhe të përgjigjes së fuqishme të partizanëve kundër saj, opirioni ushtarak në Bari po piquej në favor të FNÇ. Kuartieri i Operacioneve të Posaçme për Mesdheun qarkulloi një vlerësim informativ më 22 qershor, i cili arrinte në këto përfundime:

- a. Rëndësia relative e lëvizjes së rezistencës partizane shqiptare është më mirë të merret në konsideratë nga pikëpamja thjesht ushtarake.
- b. Trupat e armikut të angazhuara ose të paralizuar nga këta partizanë përndryshe mund të hidheshin kundër TITOS, i cili kështu përfiton tërthorazi nga operacionet e tyre.
- c. Kur u janë furnizuar armë e materiale, lëvizja partizane ka siguruar rekrutë dhe llogaritet se numri i saj është rritur nga 6.000 në 25.000 veta që nga marsi 1944. Këto forca i kanë shkaktuar armikut një numër të konsiderueshëm të vlarësh e të plagosurish, ata kanë pasur sukses në ndërprerjen e dy vijave të rëndësishme komunikacioni, në zvogëlimin e nxjerrjes së kromit dhe në hapjen e një kryeure në bregdet, në një kohë kur armiku është veçanërisht i ndjeshëm ndaj kërcënimit të zbarkimit. Këto operacione kanë shkaktuar kundërmasa të armikut në një shkallë të madhe.
- d. Në rast se nuk ka konsiderata politike të forta, që do ta bënë në të dëshirueshme shtimin e mbështetjes për vendet e tjera në kurriz të Shqipërisë, është rrjedhimisht e rekomandueshme që të vazhdohet mbështetja në një shkallë të mjaftueshme për ta mbajtur lëvizjen e rezistencës në nivelin e saj të tanishëm, ndërsa nga pikëpamja ushtarake ajo e shpërblen veten mirë»⁹⁾.

Ky vlerësim iu transmetua Londrës nga Broudi më 28 qershor dhe u mor në Ministrinë e Jashtme më 7 korrik. Armin Dju në Departamentin e Jugut, shkroi një protokoll, që vinte në dukje rëndësinë e tij.¹⁰⁾

Nga fundi i qershorit, ideja që një delegacion i LNC¹¹⁾ të bënte një vizitë në Kuartierin britanik në Itali doli edhe një herë në shesh (shih kreun 7). Broudi i raportoi Makmilanit dhe FO më 28 qershor, se LNC përsëri po bënte presion për të dërguar një delegacion të vogël dhe se kjo ishte diskutuar nga Komiteti Politik i ri i Forcës Ajrore të Ballkanit¹²⁾. Ata e kishin ndier se, lidhur me përpjekjet që forcat e LNC po bënin tani kundër armikut, do të ishte e dobishme që t'u jepej atyre zemër duke e pranuar kërkesën e tyre. duke ua nënshtruar kushteve. Këto kushte ishin që do të diskutoheshin vetëm çështje ushtarake e operative, që misioni duhej të përbëhej vetëm prej tre delegatësh, të cilët do të qëndronin vetëm për tri ose katër ditë, që oficeri ndërlihdës kryesor britanik me partizanët duhej të thoshte fjalën e fundit lidhur me përbërjen e misionit dhe duhej ta shoqëronte atë, dhe që bisedimet duhej të bëheshin në Bari dhe jo në AFHQ. Përpara se të merreshin vendimet për këtë rekomandim, ndodhi kriza e korrikut. Do ta shohim se ideja për të ftuar një

mision të LNÇ në Itali, u bë një nga instrumentet në trajtimin e kësaj krize.

Lajmi se Divizioni I partizan i kishte sulmuar dhe i kishte dëbuar zogistët nga Shëngjergji, u erdhi Maklini dhe misionit Concensus II në fushimin e tyre në Malin e Bastarit më 30 qershor, një ditë pasi ai kishte marrë vesh se ishte miratuar plani i tij për të siguruar furnizime për një forcë prej 2.000 vetash të zogistëve të Kupit. Nga 2 korriku lajmet për «luftën civile» nisën të vinin në Londër nga Bari. Bari njoftonte se iu dërgua një paralajmërim LNÇ, duke i thënë se mund të ndërpriteshin furnizimet¹³). Një telegram i mëvonshëm nga Bari, më 2 korrik, njoftonte se kishin ndërmend të hidhnin Viktor Smithin te Concensus II me qëllim që të bëheshin përpjekje për të ndaluar luftimet vëllavrasëse¹⁴). Nga 4 korriku, kjo mori formën e një plani, sipas të cilit Smithi në fillim do të hynte në kontakt me Kupin nëpërmjet Billi Maklini, ta paralajmëronte atë që t'i shmangej ndeshjes me LNÇ dhe t'i thoshte se, në qoftë se do të pranonin të dyja palët, do të ftoheshin në Bari përfaqësues të Kupit dhe të LNÇ për të diskutuar veprimet e përbashkëta në të ardhmen dhe sasinë e furnizimeve për rezistencën: pas kësaj, ai do të çante rrugën për në kuartieret e perparuara të partizanëve, do t'u thoshte atyre se do t'u ndërpriteshin të gjitha furnizimet, nëse do të sulmonin zogistët, dhe t'u thoshte se autoritetet ushtarake britanike ishin të gatshme për të pranuar një mision prej tre delegatësh për të diskutuar në Bari me Kupin ose me përfaqësuesit e tij. Smithi do të merrte me vete letra nga Komandanti i Forcës Ajrore të Ballkanit për Kupin dhe LNÇ. Antoni Ideni ka shkënuar mbi telegramin që e njoftonte këtë: «Mirë. Me sa duket, Broudi po vepron mirë»¹⁵).

Ndërkaq, Alan Palmeri ishte në bregdetin shqiptar duke pritur që ta merrnin e ta çonin në Itali, ndërsa Bari kërkonte që ta udhëzonte dhe ta kthente sa më shpejt prapa, te Enver Hoxha. Ndërlidhja me Hoxhën për atë kohë mbahet nga majori Shou. Hoxha i tha Shou se nuk kishte ndërmend të bënte bisedime dhe se do t'i sulmonte kur të kishte qejf me ndihmën ose pa ndihmën e mëtejshme të Aleatëve. Shou kishte marrë udhëzime që të mbante qëndrim të fortë dhe t'i thoshte se «Komanda Eprorë nuk do ta lejonte luftën civile që të ndërhynte në strategjinë e madhe dhe se partizanët duhej ta dinin që nuk ishin në gjendje ta kontrollonin Shqipërinë kundër gjermanëve pa ndihmën e Aleatëve». Që

të dyja palët po e ngrinin pazarin ca si lart, por britanikët diçka më lart se Hoxha.

Telegramet e 4 dhe 5 korrikut nga Bari për SOE në Londër që njoftonin për këtë ngjarje, përmbledhnin këshillat kontradiktore të marra nga Maklini në veri dhe nga Palmeri në jug¹⁶). Maklini njoftonte se Kupi nuk gjente ndonjë rrugë për të shmangur përleshjen me partizanët, veç në rast se Aleatët ishin të përgatitur t'i përmbanin ata dhe pastaj të përdornin shërbimet e tyre të mira për të vendosur bashkëpunimin ndërmjet dy palëve. Maklini e përshkruante qëndrimin e Kupit si të arsyeshëm dhe realist: ai ishte i gatshëm të bënte lëshime të rëndësishme për të shmangur një konflikt, ndërsa Maklini besonte se ai do të luftonte kundër gjermanëve, kur të merrte furnizimet e premtuara. Atëhere do të kishte një shans të mirë për të siguruar bashkëpunimin me partizanët. Maklini mendonte se partizanët kishin vendosur ta sulmonin Kupin pikërisht sepse e kuptonin që ai po bisedonte për një marrëveshje me misionin Concensus II dhe ata donin që t'i dilnin përpara kësaj. Maklini kërkoi të bëhej presion nga britanikët mbi kuartierin e partizanëve, për t'i bërë ata që ta pezullonin agresionin. Sipas komenteve të Alan Palmerit, Divizioni I partizan ishte formuar pikërisht për të sulmuar Kupin dhe do t'ia dilte mbanë shpejt kundër tij, mjafton që të mos ndërhyjnë gjermanët. Një marrëveshje ndërmjet partizanëve dhe Kupit as nuk mund të shtrohej në një fazë kaq të vonuar, edhe sikur Kupi të luftonte kundër gjermanëve. Politika që propozohej tani nga ana e britanikëve, duhej të ishte zbatuar një muaj më parë (kur Palmeri dhe Liku kishin shfaqur idenë për t'i dhënë Kupit një afat kohe që të bënte aksione kundër gjermanëve). Tani ishte shumë vonë. Kupit nuk duhej t'i dërgoheshin armë, sepse ato do të përdoreshin kundër partizanëve. Nuk kishte kohë më që ai të luftonte kundër gjermanëve, përpara se ta sulmonin partizanët. Mosdëshira e Kupit për të luftuar gjermanët, tashti ishte me siguri e qartë. Palmeri rekomandonte që të tërhiqeshin menjëherë misionet me Kupin. Mbajtja e tyre vetëm mund ta rëndonte luftën civile dhe do të ishte një rrezik i vërtetë për BLO në fjalë.

Viktor Smithi u hodh te Maklini në Macukull, më 6 korrik, dhe po atë ditë Alan Palmeri arriti në Bari. Gjithashtu, po atë ditë, mbledhja e Maklinit me krerët e veriut u shpërnda në çrregullim dhe Divizioni I partizan depërtoi në «territorin» e Kupit, në luginën e Matit, nisi të digjte shtëpitë e kre-

rëve dhe kapi bazën e fushimit të Maklinit. Që më 6 korrik, menjëherë pas arritjes, Smithi mori një përgjigje pozitive nga Kupi dhe Seid Kryeziu për propozimin rreth mbledhjes në Itali. Kjo nuk ishte për t'u çuditur: Kupi ishte vënë me shpatulla për muri.

Në Bari Komiteti Politik i Forcës Ajrore të Ballkarit nuk kishte pritur për përfundimet e misionit të Smithit. Mëngjesin e datës 6, ai nxori përfundimin përkatës negativ se shanset për pajtim ishin të papërfillshme dhe se duhej pritur një ndeshje ndërmjet partizanëve e zogistëve. Ai vendosi që t'i udhëzonte BLO me të dyja palët për t'i vazhduar përpjekjet që të arrihej një marrëveshje, të qëndronin në pozitat e tyre në rast të një ndeshjeje dhe të përpiqeshin ta ndalonin përhapjen e luftës civile.¹⁷ Ata morën gjithashtu udhëzime që ta përqendronin vëmendjen në veprimet kundër gjermanëve, madje edhe nëse partizanët nuk do t'i fshinin zogistët, si dhe të përpiqeshin të shmangnin çdo shfaqje se po e braktisnin Kupin në mes të bisedimeve me të. Embargoja e vënë tashmë mbi furrizimet për partizanët do të vazhdonte dhe do të përdorej si një levë «për ta bindur LNC që të sillej mirë». Këto vendime të Komitetit Politik ngriheshin deri te pranimi i disa realiteteve të situatës, meqë ato pranonin heshturazi se gjuha e përdorur dy ditë më parë («Komanda Eprore nuk do ta tolerojë luftën civile...») nuk mund të mbahej më. E vërteta ishte se partizanët, të cilët kishin qenë viktimat e konfliktit civil gjatë dimrit, tani po ua kthenin me të njëjtën monedhë atyre që kishin bashkëpunuar drejtpërdrejt ose tërthorazi me gjermanët për t'i shkatërruar. Bari ende mendonte gabimisht se ndërprerja e furrizimeve do t'i detyronte partizanët të tërhiqeshin. Se sa e gabuar ishte kjo, do të provohej nga eksperiencia brenda dy javëve.

Vëmendja e britanikëve në Bari dhe në Londër ishte përqendruar te sulmi mbi Kupin. Në fakt, mësymja e Divizionit I drejt veriut nuk kishte për qëllim vetëm e vetëm sulmin kundër Kupit. Ajo synonte edhe kapjen e Dibrës. Beteja për Dibrën do të zgjaste dy muaj dhe ajo ishte pa asnjë mëdyshje një betejë kundër gjermanëve. Ishin luftimet serioze kundër gjermanëve rreth Dibrës dhe Peshkopisë, që i shtrënguan autoritetet britanike për të pranuar më në fund që, nëse ata donin rezistencë kundër gjermanëve në Shqipëri, ishin partizanët ata që mund dhe do ta bënin atë, ndërsa Kupi dhe zogistët tashmë ishin bërë diçka e dorës së dytë.

Më 7 korrik Maklini, Smajli dhe Emeri, të shoqëruar nga

Viktor Smithi, e gjetën luginën e Matit dhe gjithë zonën e Malit Bastar në duart e partizanëve. Smithi i kishte paralajmëruar Maklinin e kolegët e tij se, po t'i gjenin partizarët, duhej ta prisnin që do t'i kapnin për t'i mbajtur në mbrojtje. Frikës së tyre iu shtua kështu edhe indinjata. Në «Bijtë e Shqiponjës», Emeri pretendon se Smithi u kishte thënë që kuartieri rre Bari e kishte pranuar një propozim lidhur me këtë nga Enver Hoxha¹⁸). Kjo nuk është e besueshme. Nuk ka ndonjë dëshmi që Bari të ketë rënë dakord ndonjëherë për diçka të tillë, por puna është se shumë BLO në Shqipëri e mendonin që partizanët do ta shqyrtonin mbajtjen në mbrojtje të oficerëve britanikë me palën tjetër dhe nuk do të pengoheshin nga paralajmërimet ose protestat. Në një telegram për Algerin të 6 korrikut, Filip Broudi njoftonte për qërdrimin intransigjent të Komandantit të Divizionit I dhe bënte këtë koment: «duket se ai nuk kishte ndër mend t'u bënte keq, por t'i vinte oficerët tanë të ndërlihdjes me Kupin nën një ruajtje për mbrojtje»¹⁹). Kështu pranohej ajo që mund të bënte *force majeure*, jo përkrahja e saj. Maklini dhe shokët e tij po merrnin një mësim të parë për rënien e fuqisë britanike.

Duke qenë përballë perspektivës për t'u kapur nga partizanët, Maklini dhe kolegët e tij u fshehën për disa ditë dhe provuan hidhësinë që ndien, kur panë se shumë nga ata që më parë ishin të zellshëm për t'i ndihmuar dhe gëzonin fávoret e tyre, tani po u kthenin kurrizin. U bë e vështirë për të gjetur çfarëdo ushqimi ose furnizimi. Viktor Smithi u largua prej tyre më 7 korrik dhe çau rrugën të një kuartieri i partizanëve rre Klos, në luginën e Matit. Doli se ky kishte qenë Shtabi i Brigadës V, të cilin po e vizitonte Mehmet Shehu, komandanti i Brigadës I partizane. Atje ishte edhe Mustafa Gjinishi, si i deleguar i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare. Ata e shihnin me simpati qëndrimin e Smithit, por nuk kishin kompetencë t'i përgjigjeshin dhe ia kaluan Dali Ndreut, komandantit të Divizionit, kuartieri i të cilit ishte në zonën e Dibrës. Pas një dy ditësh vonesë, Dali Ndreu e dërgoi atë në jug tek Enver Hoxha në Helmës. Ai duhet të ketë arritur atje rreth po asaj kohe, kur Alan Palmeri u kthye nga Bari për të marrë përsipër misionin e kuartierit britanik.

Palmerit i ishte dhënë një direktivë me shkrim për të hyrë në kontakt me gjeneral Enver Hoxhën dhe për ta bindur atë që të parandalonte sulmet kundër forcave të Kupit

dhe zonave përreth, ku ishin vendosur përkrahësit e Kupit²⁰). Palmeri duhej të merrej me përcaktimin e tre përfaqësuesve të përshtatshëm të LNC (duke përfshirë mundësisht vetë Hoxhën) për të bërë vizitën në Itali, që të zhvilloheshin, nga njëra anë diskutime me Kupin, me kusht që ai të kishte pranuar paraprakisht që të luftonte kundër gjermanëve, dhe nga ana tjetër, me kuartierin e Forcës Ajrore të Ballkanit, diskutime për operacionet e ardhshme të LNC në përputhje me strategjinë e Aleatëve. Në rast se Hoxha nuk do t'i pranonte bisedimet me Kupin, ai megjithatë duhej të bindej që të pranonte bisedimet me kuartierin e Forcës Ajrore të Ballkanit. Palmeri ishte i autorizuar që ta hidhte fjalën se BLO me Kupin do të tërhiqeshin, në rast se Kupi nuk do të pranonte që të luftonte kundër gjermanëve. Në rast se Hoxha nuk do të pranonte bisedime të menjëhershme, atëhere atij i duhej bërë e qartë se kuartieri i Forcave Ajrore të Ballkanit dëshironte të mbante kontakte të ngushta me të dhe se do të ishte e pranueshme një datë e mëvonshme për diskutime ushtarake. Hoxhës duhej t'i kërkohej një garanci me shkrim, se ai do të trajtonte si personel ushtarak të Aleatëve cilindo pjesëtar të Misioneve Aleate në Shqipërinë e Veriut që mund të binte në duart e tij, ndërsa këto misione do të kishin udhëzime që të mos merrnin asnjë pjesë në përlëshjet civile. Alan Palmerit iu dha një letër nga nënmareshali i Ajrit Eliot, për t'ia çuar Enver Hoxhës, e cila përmbante një mesazh nga gjenerali Uillson, Komandanti Suprem Aleat. Mesazhi i Uillsonit fillonte duke pranuar një mesazh që Hoxha ia kishte dërguar disa ditë më parë me shprehjen e mirënjohjes për përkrahjen e dhënë nga forcat ajrore të Aleatëve për partizanët gjatë ofensivës gjermane të qershorit. Mesazhi vazhdonte:

«Megjithatë më duhet të kërkoj që ju të ndërmerrni çdo hap brenda kompetencave tuaja për të parandaluar që forcat tuaja të zhvillojnë veprime ushtarake kundër forcave të Abaz Kupit. Më duhet t'ju vë në dukje se armët dhe furnizimet që ju dërgojmë, janë të destinuara vetëm për një qëllim, e pikërisht për të ndihmuar forcat tuaja që të luftojnë armikun. Unë nuk mund ta toleroj që ju t'i përdorni këto armë për të vrarë ose për të eliminuar bashkatdhetarët tuaj për qëllime politike, dhe në rast se ju do t'i përdorni këto armë për një qëllim të tillë, unë do të detyrohem ta ndërpres furnizimin për ju. Shërbimi më i madh që mund t'i bëjë armikut kushdo në vendin tuaj, është të nisë një luftë civile. Është brenda fuqisë suaj që ta parandani atë. Prandaj më duhet t'ju quaj personalisht përgjegjës për të

garantuar që të ndërmerren hapa për të arritur një marrëveshje me Kupin, dhe kështu të bini në një mendje për aksione të përbashkëta kundër armikut. Ju ftojme që të dërgoni në Bari tre përfaqësues, me qëllim që të diskutohet gjendja aktuale në Shqipëri me Komandantin e Forcës Ajrore të Ballkanit, i cili do të veprojë me autorizimin tim të plotë për këtë çështje.

Lidhur me këtë, unë do t'ju isha mirënjohës nëse ju do t'u jepnit përfaqësuesve të mi, nënkolonelit Palmer dhe majorit Smith, gjithë lehtësitë për të plotësuar gjithë udhëzimet që u kam dhënë»²¹⁾

Ky mesazh dhe qëndrimi për të cilin kishte marrë udhëzime Palmeri që t'ia paraqiste Hoxhës, tregonin se mënyra e të menduarit të britanikëve rreth situatës në Shqipëri kishte evoluar mjaft brenda një jave. Hoxha mund të lexonte midis rreshtave, se britanikët e pranonin që ai po fitonte. Në shkrimet e veta Hoxha e ka përshkruar mesazhin si një tërheqje taktike nga anglezët. Palmeri u hodh përsëri në Shqipëri më 14 korrik, i shoqëruar nga kapiteni Markus Lllajën, i cili kishte qenë në Itali që nga mesi i qershorit. Direktiva për Palmerin thoshte se Lllajëni duhej të qëndronte me Këshillin Qendror të LNÇ si përfaqësues i Kuartierit të Forcës Ajrore të Ballkanit, kur Palmeri do të ikte nga Shqipëria me delegatët e Hoxhës për diskutime në Itali²²⁾. Brenda pak ditësh Enver Hoxha dhe kolegët e tij e pranuan ftesën për të dërguar një mision të vogël në Bari. Më 21 korrik Bari (z. Broud) i raportoi Kazertës se Palmeri pritej që të sillte një grup prej tre vetash në Bari rreth 26 korrikut²³⁾. Grupi do të udhëhiqej nga koloneli Bedri Spahiu dhe si anëtarë të tjerë do të ishin koloneli Ramadan Çitaku dhe Frederik Nosi.

Përpara se delegacioni të risej nga Shqipëria, autoritetet britanike tashmë u kishin bërë një koncesion shumë të rëndësishëm partizanëve. Ata kishin lejuar që të rifillonte furnizimi ajror për partizanët. Kjo u bë sepse Divizioni I kishte rënë në rëndshje me forcat gjermane në zonën e Dibrës dhe u bë e qartë se ishte i afërt një sulm i gjermanëve kundër Divizionit I. Një telegram i 18 korrikut nga Bari për Algjerin, njoftonte se pritej së shpejti një kundërsulm i gjermanëve. Aty shpjegohej se forcat partizane ishin ngushtë me municione, se ishte bërë e qartë që gjendja në Shqipërinë e Veriut nuk ishte më një çështje e drejtpërdrejtë e luftës civile dhe se partizanët tani ishin përballë një kërcënimi të vërtetë nga gjermanët. Së fundi, aty informohej Zyra e Ministrat rezident se kishin rënë dakord që të rifillonte dër-

gimi i furnizimeve për forcat e LNC, sapo Enver Hoxha të niste përfaqësuesit e kuartierit të tij për diskutime në Bari²⁴).

Kur kryeministri Uinston Çurçill pa një kopje të këtij telegrami më 19 korrik, ka shënuar mbi të: «Më paraqni një shënim për këtë, që të tregojë se me cilën anë jemi në. Ideni u përgjigj më 23 korrik. Tabloja që kishte bërë FO për gjendjen në Shqipëri e zvogëlonte pozitën e partizanëve dhe e zmadhonte tepër pozitën e Abaz Kupit, ndërsa ishte shumë optimiste në sugjerimet e saj se ende ishte i konceptueshëm pajtimi ndërmjet tyre. Por qëllimi i përgjithshëm ishte që të birdej kryeministri për të pasur besim në trajtimin e çështjeve nga Bari dhe, siç duket, për këtë patën sukses Ideni dhe FO. Parashpresa për kryeministrin ishte e shkurtër, por pak e pasaktë dhe në të shkruhej:

«Gjendja (në Shqipëri) nga shumë anë është e ngjashme me Jugosllavinë. LNC, Lëvizja Nacionalçlirimtare, është një organizatë e majtë me një element të fortë komunist, ndonëse shkalla e kontrollit komunist është më e vogël se në rastin e partizanëve jugosllavë ose të EAM në Greqi. Kjo është e vetmja organizatë në Shqipëri, e cila po bën ndonjë luftim serioz kundër gjermanëve, por ndikimi i saj deri më tani ka qenë i kufizuar në jug, ku duket se ka popullaritet të vërtetë. Është e dyshimtë nëse do të gëzojë të njëjtën masë të mbështetjes në qendrën dhe veriun, që janë më konservatorë.

2. Lëvizja tjetër e vetme e rezistencës është ajo nën Abaz Kupin, ish oficer xhandarmërie, i cili ende i qëndron besnik mbretit Zog. Kupi nuk e ka komprometuar veten seriozisht me armikun, por deri më sot nuk ka ndërmarrë ndonjë operacion aktiv kundër tij. Ne kemi oficerë ndërlidhës si me Kupin, edhe me LNC, por pothuaj gjithë furnizimet tona shkojnë për LNC.

3. Gjendja aktuale është që LNC sapo ia ka dalë të përballojë një ofensivë të fortë gjermane dhe tani po përpiqet ta zgjerojë kontrollin e saj në qendër e në veri të Shqipërisë. Ata kanë vepruar kundër disave prej forcave të Kupit dhe ka pasur një numër luftimesh ndërmjet fraksioneve rivale, ndonëse në një shkallë shumë të vogël. Ne po i themi LNC se ata duhet ta shmangin luftën civile dhe se ne do t'i ndërpresim furnizimet, në rast se do t'i përdorin armët tona për këtë qëllim. Atyre u është bërë ftesë që të dërgojnë përfaqësues në Bari për të diskutuar një rregullim me Kupin, që të ndërmerren veprime të përbashkëta kundër armikut. Ne po i themi Kupit se ai duhet të përpiqet të arrijë një marrëveshje me LNC, por nëse nuk do të ketë asnjë shpresë për këtë dhe nëse ne do të duhet ta furnizojmë me armë, ai duhet të heqë dorë nga qëndrimi i tij negativ dhe të dalë hapur kundër gjermanëve. Unë men-

doj se situata po trajtohet mirë në Bari dhe unë ende kam një farë shprese që ne mund të jemi në gjendje t'i pajtojmë të dy fraksionet»²⁵).

Ndërsa Ministria e Jashtme ende shpresonte se do të ndodhte një mrekulli në Shqipëri që do ta shpëtonte vendin nga sundimi komunist, dhe ndërsa forca e ngjarjeve po i tërhiqte autoritetet britanike në Bari (në praktikë, nënmareshali i Ajrit Eliot dhe Komiteti Politik i Forcës Ajrore të Ballkanit) drejt partizanëve, po ajo forcë e ngjarjeve po e tërhiqte Abaz Kupin drejt njerëzve në Tiranë, që bashkëpunonin me gjermanët. Maklini, Smajli dhe Emeri dolën nga privacionet e strehimit të tyre në shpatin e malit të Skënderbeut më 13 korrik. Ata e panë se ishte krijuar një vijë mbrojtëse kundër divizionit partizan në drejtim të perëndimit e të veriut të luginës së Matit, që i mbronte rrugët e afrimit të kështjella e Kupit në Krujë nga perëndimi dhe rrugët e afrimit drejt Mirditës nga veriu. Sipas Emerit, Fiqri Dineja, Mustafa Kruja dhe Mark Gjon Markaj (i biri i kapedanit të Mirditës), tre nga bashkëpunëtorët kryesorë «nacionalistë» me gjermanët, kishin dalë nga Tirana më 11 korrik për të vendosur kontakt me Abaz Kupin²⁶). Ishte e qartë se ata u frikësuan nga forca dhe aftësia agresive e partizanëve, të cilët sipas asaj që prisnin «nacionalistët», duhej të ishin shpartalluar nga gjermanët, ndërsa ata vetë gjithnjë e më tepër ishin të shqetësuar, sepse po e shihnin që ishin mbërthyer me palën që po e humbiste luftën.

Shqetësimi i tyre i parë ishte për të rregulluar ndonjë lloj aksioni të bashkënduar për ta ndaluar e për ta zmbrapsur Divizionin I partizan. Abaz Kupi bashkëpunonte me ta për këtë qëllim, ndërsa vazhdonte t'u nderte një dorë britanikëve. Ata bashkëpunonin me gjermanët dhe sollën në vijën e zjarrit të gjitha forcat që kishin mundësi të grumbullojnë. Fiqri Dineja e pranoi postin e kryeministrit në qeverinë kolaboracioniste, duke shpresuar se do të ishte në gjendje ta shpëtonte nga partizanët «territorin» e vet në zonën e Dibrës. Në luginën e Matit u shfaqën forcat gjermane dhe partizanët u shtrënguan të tërhiqeshin nga presioni në disa drejtime njëkohësisht. Nga 19 korriku, Abaz Kupi, Billi Maklini dhe pjesa tjetër e misionit Concensus II u kthyen edhe një herë në zonën e Malit të Bastarit, të cilën e kishin zënë partizanët më 6 korrik. Më 22 korrik partizanët ndërmorën një kundërsulm nga drejtimi i Shëngjergjit, por ai nuk pati sukses. Më pas zogistët e pastruan luginën e Matit në jug deri në Klos. Në këto operacione nuk pati ndonjë bashkëpunim të

drejtpërdrejtë ndërmjet Abaz Kupit dhe gjermanëve, por ka pasur pa dyshim bashkëpunim të tërthortë përmes bashkëpunëtorëve «nacionalistë». Kupi u premtoi oficerëve anglezë se nuk do t'i ndiqte partizanët përtej zonës së vet, një premim që ishte i lehtë për ta dhënë, sepse ai nuk e kishte afësinë për ta bërë ndjekjen. Ai vazhdoi të ngulmonte se nuk mund të mendonte për një veprim kundër gjermanëve, nëse britanikët nuk e pengonin përparimin e partizanëve drejt veriut dhe nuk i dërgonin atij furnizime për 2.000 veta, gjë për të cilën ata me Maklinin kishin rënë në marrëveshje.

Me tërheqjen e partizanëve, Maklini dhe shokët e tij u zhvendosën në Priskën e Vogël, një fshat në shpatin perëndimor të malit që shihte nga fusha në veri të Tiranës dhe, pas një nisjeje të çrregullt, ia arritën të rivendosnin jetën e misionit. Një hedhje ajrore më 29 korrik u solli atyre një motor të ri për ngarkimin e baterive, kështu që ata mund të punonin efektivisht përsëri me radion e tyre. Ata ende shpresonin se mund të ishin në gjendje ta merrnin Kupin në Bari për bisedime, por një rikonzhion nga Smajli në bregdetin e mbrojtur mirë, nuk gjeti një vend të përshtatshëm për evakuimin me anë të detit. Në ditët e para të gushtit, Jan Merriti, dy nga reshterët e misionit dhe disa nga shërbëtorët italianë të fushimit u rishfaqën nga malet e pyjet ku kishin gjetur strehim, kur ishin kapur fushimi i misionit dhe sheshi i caktuar për hedhje pranë Macukullit. Misioni mbante kontakte me njerëzit në Tiranë dhe në zonën e zogistëve, ku kishin ngritur fushimin, por vetë fakti që ata ishin në gjendje të vepronin atje me një liri relative, ishte në vetvete një shenjë se fati i luftës po vendosej gjatë. Është koha që të kthehemi te beteja e Dibrës.

Shënimet

1. PRO, WO. 204/10392.
2. Më pas mareshal shef i Ajrit Sir William Elliot, GCVO, KCB, KBE, DFC.
3. PRO, WO. 204/8463.
4. PRO, WO. 204/10236.
5. PRO, WO. 204/8463.
6. Më pas Sir William Deakin, DSO, Mbikëqyrës i Kolegjit St. Antony në Oksford.
7. PRO, FO. 371/43566.
8. Po aty.
9. PRO, FO. 371/43563.

10. Po aty.

11. Po të flasim me përpikëri, LNÇ nuk ekzistonte më, pasi autoritetin e kishte marrë Këshilli Antifashist Nacionalçlirimtar dhe Komiteti i tij drejtues AFNÇ, por meqë Britania nuk i njihte këto organizma dhe as pretendimet e tyre se përbënin një qeveri, ishte e volitshme që të vazhdohej praktika për t'iu referuar lëvizjes partizane në përgjithësi si LNC.
12. PRO, FO. 371/43563, telegrami i Barit (Mr. Broad) për Algjerin (Ministrit rezident) nr. 207.
13. PRO, FO. 371/43566, telegram i Barit për Algjerin, nr. 225.
14. PRO, FO. 371/43566, telegram i Barit për Algjerin, nr. 230.
15. PRO, FO. 371/43566, telegram i Barit për Algjerin, nr. 236.
16. PRO, FO. 371/43566.
17. PRO, FO. 371/43566, telegram i Barit për Algjerin, nr. 242.
18. Amery (1948; 208).
19. PRO, FO. 371/43566, telegram i Barit për Algjerin, nr. 242.
20. PRO, FO. 371/43551, telegram i Barit për Kazertën (Ministrit rezident) nr. 7 e 9 të 13 korrikut.
21. PRO, FO. 371/43555, telegram i Barit për Algjerin, nr. 290 i 15 korrikut.
22. Këshilli Qendror i LNÇ natyrisht që ishte zëvendësuar nga Këshilli Antifashist Nacionalçlirimtar dhe nga KANÇ.
23. PRO, FO. 371/43551, telegram i Barit për Kazertën, nr. 17.
24. PRO, FO. 371/43551, telegram i Barit për Algjerin nr. 300.
25. PRO, FO. 371/43551.
26. Amery (1948; 219).

Kleu 11

Beteja e Dibrës

Mësymja drejt veriut e Divizionit I partizan përveç se e shpejtoi konfliktin e hapur ndërmjet Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare (UNÇSH), të udhëhequr nga komunistët, dhe forcave nacionaliste të përbëra nga zogistët ose Legaliteti i Abaz Kupit, pati edhe një efekt tjetër. Ajo krijoi një kërcënim të drejtpërdrejtë për garnizonin gjerman në Dibër. Ishte kjo arsyeja që shpejt e bëri të pamundur për autoritetet britanike t'i përmbaheshin vijës se partizanët e kishin zhlytur Shqipërinë në luftë civile dhe se, prandaj, kështu e kishin humbur të drejtën për të kërkuar ndihmë britanike. Divizioni I i angazhoi forcat gjermane në krahun e vet të djathtë në Dibër, po në atë kohë kur angazhoi edhe zogistët në krahun e majtë në luginën e Matit.

Politika e përcaktuar nga Partia Komuniste e Shqipërisë që nga Konferenca e saj e Parë kombëtare, në mars 1943, ishte që të shfrytëzohej irtensifikimi i luftës nacionalçlirimtare si mjeti kryesor për t'i dhënë zgjidhje luftës së brendshme politike kundër nacionalistëve. Krerët nacionalistë do të kishin mundësinë për të zgjedhur ndërmjet rrugës së bashkimit me UNÇSH në luftë kundër pushtuesit ose rrugës për të mbetur mënjarrë e, madje, të eliminoheshin. Natyrisht, në praktikë, nga korriku i vitit 1944, zgjedhja u kishte mbetur ndërmjet njëres ose tjetrës formë për t'u mënjanuar. Ishte beteja e Dibrës ajo që vendosi mënyrën se si Kupi u hoq mënjana.

Faik Shehu i pati thënë Riçard Ridellit dhe mua për formimin e një këshilli nacionalçlirimtar për Dibrën vetëm më 27 qershor dhe ne, më vonë, mësuam se Divizioni I partizan kishte kapërcyer lumin Shkumbin një ditë më parë. Këto dy ngjarje pa dyshim ishin të lidhura dhe Faiku duhet ta ketë ditur se Divizioni po vinte, por nuk e përmendi këtë. Haxhi Lleshi, përfaqësues i Shtabit të Përgjithshëm të Erver Hoxhës për krahinën e Dibrës, kishte ardhur nga jugu më 23 korrik. Kur unë e takova atë ditë me Faik Shehun, ai nuk e hodhi fjalën se po ndodhte një lëvizje e madhe. Esat Ndreu dhe çeta partizane lokale e tij nisi të bëhej më kërkues ndaj nesh më 1 qershor, një ditë përpara se re të niseshim për shkak të atij takimi fatkeq me krerët veriorë, por Esati nuk na dha asnjë shpjegim për qëllimet e partizanëve. Prandaj beteja e Dibrës na zuri të papërgatitur dhe vetëm më pas, duke vështruar prapa, vendosëm lidhjet ndërmjet rrjedhës së ngjarjeve.

Beteja nisi me aksione të forcave lokale, pa dyshim të orkestruara nga Faik Shehu, Haxhi Lleshi dhe Esat Ndreu. Një arëtar i këshillit nacionalçlirimtar të sapoformuar të Dibrës, Aqif Lleshi, sulmoi kullat e Hysni Demës në drejtimin jugor të Dibrës dhe i dogji. Hysniu kishte qenë një kryetar i njohur i xhandarmërisë, me një histori të gjatë bashkëpunimi me italianët dhe gjermanët. Ai ishte gjithashtu një armik familjar i Aqifit. Nga veriu i Dibrës vetë Faik Shehu, me Esat Ndreun dhe çetër partizane lokale, kapën qytetin e Peshkopisë më 6 korrik. Myftar Kaloshi, i njohur mirë si bashkëpunëtor i italianëve dhe i gjermanëve, marshoi mbi Peshkopi për të dëbuar Faikun dhe partizanët, por u zbraps, ndërsa vetë u plagos për vdekje. Më 8 korrik Divizioni I partizan, duke pasur si rrugëçarës Brigadën I të Mehmet Shehut, u shfaq në teatrin e luftës nga perëndimi i Dibrës, pasi kishte zbritur nga malësia e Çermenikës dhe e Martaneshit. Nga krahu lindor ai tani u lidh me Brigadën II maqedone nga Jugosllavia. Forca të mëdha gjermane i pritën ata nga drejtimi i Dibrës, por u zbrapsën. Batalioni I i Brigadës I marshoi drejt Peshkopisë me Haxhi Lleshin. Haxhi Lleshi, Faik Shehu dhe Esat Ndreu vendosën të bëjnë një sulm në Fushë Alijë, një fshat i fortifikuar i kreut lokal të fuqishëm Halil Alija, kolaboracionist kryesor i krahinës. Hesapi ishte bërë gabim. Mbrojtja ishte shumë e fortë për ta dhe në mëngjesin e datës 9, ata pësuan 50 të vrarë e të plagosur nga gjithë forca

e tyre prej 300 vetash. Fshatarët e katundeve përreth, kur panë se partizanët u mundën, u kthyen me forcë kundër tyre dhe i ndoqën pas gjatë tërheqjes së tyre nëpër male deri te pllaja e sheshit tonë të hedhjeve nga ajri, në Gramë. Peshkopia kaloi nën kontrollin e kolaboracionistëve, por më datën 11 batalioni I partizan dhe çeta e Esat Ndreut hynë edhe një herë në veprim dhe ia arritën ta kapnin përsëri Peshkopinë dhe ta mbanin deri më datën 13, kur, për mungesë të municioneve, u detyruan të bënin një tërheqje të dytë në Gramë. Mehmet Shehu tani arriti në zonën e Peshkopisë me shumicën e Brigadës I, që deri atëherë ishte e angazhuar në veprime në perëndim të Dibrës, ndërsa Brigada IV bashkë me forcat partizane maqedone kishte sulmuar Dibrën nga jugu dhe nga lindja. Gjermanët në Dibër u përforcuan nga Struga dhe në këto përforcime u përfshinë edhe tanke. Hysni Dema kishte ngritur edhe forca të tjera të xhandarmërisë. Brigada I arriti në Peshkopi më datën 13, por gjermanët dhe bashkëpunëtorët e tyre i ndoqën nga pas. Batalioni I i brigadës u detyrua, për shkak të mungesës së municioneve, që të tërhiqej në male drejt Gramës.

Forcat partizane në Gramë tani ishin në një pozitë shumë të vështirë e po kështu qemë ne, të misionit Stables, kur ata na u drejtuan për ndihmë. Partizanët nuk ia dolën mbanë që të fitonin kontrollin mbi krahinën me një goditje të shpejtë dhe nuk kishin ndonjë furnizim rezervë. Ata mbetën shumë ngushtë për ushqime, ndërsa veshjet dhe këpucët e shumë prej tyre nuk ishin të përshtatshme për malësitë e larta as në stinën e verës. Brigada I mbeti e shkëputur nga pjesa tjetër e Divizionit; Brigada IV dhe V ishin të angazhuara nga gjermanët në perëndim dhe në jug të Dibrës, ndërsa Grama shtrihet në verilindje. Embargoja e vendosur në Bari mbi furnizimet për partizanët e bënte të pamundur për ne që t'i furnizonim ata sërish. Tërheqja e tyre kishte shkaktuar që e gjithë zona fshatare të kthehej kundër tyre. Ata nuk mund ta përballonin që të qëndronin në Gramë me shpresën se embargoja do të hiqej së shpejti, dhe ne, të misionit Stables, nuk mund të ishim të sigurtë se embargoja do të hiqej, madje edhe mbasi luftimet rreth Dibrës e Peshkopisë nuk kishin qenë luftë civile, por luftë kundër gjermanëve dhe kundër bashkëpunëtorëve të njohur me gjermanët.

Mehmet Shehu vendosi shpejt të tërhiqej në Maqedoni dhe majori Ridëll vendosi që misioni Stables do të shkonte me të duke shpresuar që të siguronte miratimin e Barit për

të rifilluar furnizimin e brigadës, në mënyrë që të niste së-
rish sulmi mbi Dibrën. Marshimi për në Maqedoni filloi më
16 korrik. Më 17 gjermanët ndërmorën ndjekjen e Divizio-
nit I, por dështuan në përpjekjen për ta angazhuar në be-
tejë, ndërsa forcat e Dali Ndreut, në perëndim të Dibrës,
gjithashtu po vuanin për shkak të furnizimeve dhe ishin
tërhequr në male. Tërheqjen e forcave partizane nga lugina e
Matit në gjysmën e dytë të korrikut, e shkaktuan më tepër
pengesat nga ana e gjermanëve dhe e bashkëpunëtorëve të
tyre në Dibër, se sa kundërndjekja nga forcat e Kupit dhe
të «nacionalistëve» në krahinën e Matit.

Gjatë këtyre ditëve ne, të misionit Stables, u tërhoqëm
fort nga rrjedha e ngjarjeve. Riçard Ridëlli shoqëroi Haxhi
Lleshin dhe forcat e tij partizane në Peshkopi më 11 korrik
dhe i bënë përshtypje të madhe aftësitë luftarake të Ba-
talionit të parë të Brigadës I. Unë qëndrova në fushimin
tonë në Gramë dhe u kujdesa, me aq sa mundja, për të pla-
gosurit, numri i të cilëve po rritej. Të plagosurit që mund
të ecnin i sillnin te ne, ndërsa të plagosurit rëndë ishin gru-
mbulluar së bashku në dhomat mbushur me çimka në Slla-
tinë, nja dy orë rrugë më larg. E marr me mend se kushtet
e tyre do të kenë qenë të ngjashme me ato që kanë zotëruar
në fushat e betejës përpara kohës së Florens Najtingelit
(Florence Nightingale). Partizanët e plagosur e përballonin
fatkeqësinë e tyre me burrëri. E vetmja gjë që mund të bënim
ne ishte t'u pastronim plagët e t'ua lidhnim, me shpresën se
vetë natyra do t'i shëronte. E, në disa raste, ndoshta kështu
ka ndodhur.

Nga Bari na erdhën mesazhe që ripohuan se furnizimet
nga ajri për Shqipërinë ishin ndërprerë për shkak të luftës
civile që mendohej që po fillonte. Kur më 13 korrik Ridëlli
u kthye me partizanët që tërhoqeshin nga Peshkopia, ne bëmë
një mbledhje mes shiut të rëndë me Haxhi Lleshin, Esat
Ndreun dhe të tjerët, për t'u shpjeguar përse ishin ndaluar
furnizimet. Me gjithë dështimin që kishin pasur, morali i tyre
dukej i lartë. Meqë nuk mund t'i mbanin me ushqime forcat
e tyre në malësinë e lartë, ata u nisën, duke u përpjekur që
të lidheshin me pjesën kryesore të Divizionit I pranë Dibrës,
Ne shifruam dhe dërguam një numër mesazhesh për Barin,
duke njoftuar për luftimet dhe kërkuam që të bëhej gjith-
çka e mundshme për t'u ndërruar mendjen krerëve naciona-
listë të lëkundur që të mos mbanin anën e kolaboracionistëve
dhe për ta shkëputur popullsinë nga ata, që po përpiqeshin

ta mobilizonin atë kundër partizanëve. Më datën 14 ne zbritëm poshtë për të takuar familjen Lita. Ata nuk treguan thashethemet për krerët e tjerë nacionalistë, veçanërisht për Cen Elezin dhe Dan Kaloshin, që mbanin anën e Halil Ali-së, kryebashkëpunëtorit të gjermanëve. Ata na thanë se për vete kishin ndërmend të qëndronin asnjanes, por do të luftonin për ta mbrojtur asnjësinë e tyre. Sherif Lita bëri një pohim kuptimplotë, se njerëzit nuk po u shkonin më pas krerëve të tyre. Pikërisht kur po largoheshin nga Litat, na erdhi lajmi se Mehmet Shehu dhe Brigada I e tij partizane kishte kapur Peshkopinë më 13 dhe se krerët e Dibrës po ua mbathnin; Litat u squllën fare.

Ridelli dhe unë u kthyem në fushimin tonë në Gramë dhe te kujdesi me orë të tëra për të plagosurit aty dhe në Sllatinë. Një alarm, i cili si shumë të tjerë doli pastaj i rremë, na bëri që t'i çonim të gjithë të plagosurit në pyll, duke ua shtuar shumë vuajtjet. Malet dukeshin të zbrazëta e të frikshme atë natë, kur rojet partizane dhe infermierët sikur u zhdukën gjatë kohës që zgjati alarmi. Më 16 korrik, me ardhjen në Gramë të Mehmet Shehut dhe të gjithë Brigadës I, të zbrapsur nga Peshkopia prej gjermanëve dhe ndihmësit e tyre shqiptarë, mesa duket fati ndërroi. Ne nuk patëm kohë të mendoheshim mirë për këtë. Ky qe takimi ynë i parë me Mehmet Shehun. Ai dukej që ishte njeri i vendimit dhe i vendosur dhe ne menjëherë u përfshimë në tërheqjen e tij në Maqedoni. Shpejtësia me të cilën vepronte ai na habiti pas aq muajsh mosveprimi nga çdo shqiptar, me të cilin kishim pasur të bënim. Ne e ngritëm fushimin menjëherë në mbrëmjen e datës 16, por Brigada ishte zhdukur në shpatet e malit Korab, ndërkohë që ne po ngarkonim mushkat. Nuk patëm mundësi që t'i gjenim deri të nesërmen. Rruga jonë të çonte drejt lindjes, në drejtimin e përgjithshëm të Kërçovës, lu qepëm të përpjetave të terrenit, duke u ngjitur me vështirësi 1000 metra lart deri në majë të kreshtave dhe duke u lëshuar 1000 metra teposhtë në lugjet e thella të luginës dhe pastaj ngjiteshim përpjetë përsëri menjëherë. Kapërcyem rrugën Dibër-Gostivar dhe pastaj u ngjitëm në pllajën e Bistrës, para se të kthenim drejt jugut dhe të zbrisnim në rrugën Dibër-Kiçevo, më tej u ngjitëm në shpatin tjetër në drejtimin e përgjithshëm të Strugës dhe liqenit të Ohrit.

Dy ditët dhe netët e para qenë të rënda. Shumicën e kohës binte shi me shtëmba. Mehmet Shehu pati vështirësi për t'i bindur fshatrat gjatë rrugës për të mos e kundërshtuar

marshimin. Në një rast, kur kolona jonë erdhi në largësinë e të shtënës me pushkë nga një grup xhandarësh, bindja mori formën e disa të shtënave nga një mortajë e një baterie italiane, që ishte bashkuar me partizanët e plotë, me gjithë oficerët, pas kapitullimit të Italisë dhe që mbeti pjesë e Brigadës I deri në fund të luftës. Kur ndalonim, askujt nuk i lejohej të ndizte zjarre, nga frika se mos tërhiqim vëmendjen. Partizanët nuk kishin asgjë për të ngrënë. Nuk kishte mjete transporti për të sëmuret e të plagosurit: kuajt tanë përdroreshin për t'i lehtësuar nga pak me radhë disa nga ata që dukeshin të sëmurë më rëndë. Personeli ynë italian qëndroi me ne, kurse mushkarët i mbajtëm me detyrim. Kishim marrë me vete pak oriz e nja dy pula dhe na u lejua të ndiznim një zjarr pas një ndalese në mëngjes për të fjetur ditën e dytë. Kjo na dha mundësinë që t'u jepnim një drekë Mehmet Shehut dhe zëvendëskomisaresh së Brigadës, Fiqretes¹), një femër e këndshme, si dhe pak partizanëve të tjerë, disa burra e gra, që ishin afër nesh gjatë marshimit. Një tendë me pëlhura parashutash, që e ngritën italianët tanë të shka-thët, na mundësoi që të mos qulleshim deri në kockë, ndonëse ishim të detyruar të pajtoheshim me ujin që depërtonte vazhdimisht në rrobat dhe në plaçkat tona. Pjesa tjetër e Brigadës mbeti pa vënë gjë në gojë dhe u bë qull me ato rroba të grisura dhe me brashnje të improvizuara. Qëndrueshmëria e tyre ishte e jashtëzakonshme dhe për t'u admiruar.

Më 19 korrik arritëm në një fshat maqedon, që dukej i lulëzuar dhe që na priti me ngrohtësi dhe bujari të habitshme. Më në fund, Brigada pati mundësi të hante diçka. Doli dielli. Riçard Ridellin, mua dhe kapterët tanë na gostitën në cdo shtëpi ku ndaluam, ndërsa vajzat e vogla dilnin në rrugë me vrap për të na puthur duart. Të nesërmen na pritën po aq mirë në një fshat më të varfër, në jug të rrugës Dibër-Kiçevo. Ndërmjet këtyre dy pikave kaluam përmes disa fshatrave të shkatërruara. Na thanë se këtë punë e kishte bërë Xhem Gostivari, një bashkëpunëtor i njohur i gjermanëve. Po ndoshta çështja nuk ishte kaq e thjeshtë. Kishte më shumë mundësi që çka po shihnim kishte ndodhur pjesërisht nga grabitjet dhe pjesërisht nga tensionet kombëtare që kishin lindur në zonën kufitare ndërmjet shqiptarëve dhe sllavëve, pas krijimit të Shqipërisë së Madhe prej italianëve dhe gjermanëve. Simboli i partizanëve, ylli i kuq me pesë cepa, me sa duket ishte shtegu që siguroi mikpritjen e fshatrave maqedone, ndoshta sepse partizanët këtu shiheshin si çlirimtarë

nga sundimi shqiptar. Do të kishte ndodhur ndryshe në fshatrat shqiptare të krahinës, ku partizanët do të vështrobeshin si aleatë të sillavëve.

Më 20 korrik Mehmet Shehu dhe ne i hymë seriozisht çështjes për të siguruar një hedhje furnizimesh nga ajri për Brigadën. Moti u bë shumë i mirë dhe na treguan një shesh hedhjeje të mrekullueshëm në një pllajë të lartë, sipër kullotave të bukura malore, ku fshatarët po kositnin barin. Atje hapej një pamje e gjerë mbi Maqedoninë në çdo drejtim dhe prapa drejt maleve tona të Shqipërisë në perëndim. Vendosi çadrat në rrëzë të një pylli pak më poshtë dhe bëmë përpjekje për të treguar pozicionin tonë me mesazhe nëpërmjet radios për Barin. Personeli në seksionin e Shqipërisë atje kishte vështirësi për të kuptuar se çfarë po bënim ne në Maqedoni dhe përse ata duhej të dërgonin furnizime «për Shqipërinë» në territorin e Titos e të Tempos. Mehmet Shehu dhe disa nga oficerët e tij u bënë vizitorët tanë të shpeshtë që mezi prisnin rezultatet. Për një farë kohe, e vetmja gjë që mund t'u jepnim ishin lajmet e mira për sukseset e partizanëve në jug të Shqipërisë, në Delvinë e Gjirokastrë, dhe për zbrapsjen e sulmeve gjermane në pjesën kryesore të Divizionit I partizan afër Martaneshit. Mehmeti, i cili kishte lidhje me Shtabin e Përgjithshëm të forcave nacionalçlirimtare jugosllave për Maqedoninë, na tha se një oficer ndërlihdës britanik ishte vetëm katër orë marshim larg nesh, dhe kishte sjellë furnizime ajrore për partizanët maqedonë. Ai kishte siguruar shtatë furnizime ajrore për dy ditë. Përse ne nuk e bënim dot këtë gjë? Ne po binim brenda në një diskutim të vazhdueshëm me partizanët e të gjitha niveleve rreth luftës, politikës, botërore, komunizmit dhe të ardhmes së Shqipërisë, ndërsa çështja urgjente e furnizimeve na dilte përpara me ngulmim dhe partizanët me të drejtë pretendonin se po luftonin kundër gjermanëve, kurse aleatët i kishin braktisur, në veçanti Britania. Pozitën tonë e bënte më të papëlqyeshme fakti që ne po jetonim jo aq keq në fushimin tonë, me personelin tonë italian dhe me furnizimet ushqimore që kishim mundësi t'i gjenim, ndërsa pesë batalionet e Brigadës duhej ende të duronin shtrëngesën. Më 23 korrik një aeroplan i vetëm hodhi furnizime për ne. Edhe kjo na mërziti, sepse ishte një ngarkesë mbështetëse, domethënë ushqime, veshje dhe sende «komforti» për misionin Stables dhe veshje për partizanët, por nuk kishte asgjë me vlerë në kuptimin e armëve dhe të municionit. Ngarkesa u shpërnda shumë gjatë

rënies dhe partizanët mezi e mbloodhën. Bashkë me të mbloodhën edhe zhgënjimin e tyre. Unë përfitova diçka me rëndësi, një palë syze (të tipit ushtarak, me skelet metalik) për të zëvendësuar ato që i kisha thyer në fund të qershorit, pikërisht para se të merrte jetë lufta. Më 26 korrik ne, më në fund, dëgjuam se do të merrnim katër ngarkesa ajrore në tre ditët pasuese. Të nesërmen na erdhi një letër nga Mehmet Shehu, që na qortonte sepse nuk kishim forcë bindëse për Barin.

Natën e 27 korrikut tre aeroplanë dhe natën tjetër një aeroplan hodhën një sasi të madhe materialesh për Brigadën, duke përfshirë edhe shumë municione italiane për armët e tyre të tipit italian. U rivendos kredia jonë te Mehmet Shehu dhe oficerët e tij. Pasi mori këtë sasi të kufizuar furnizimesh. Mehmeti na dërgoi një mesazh më 30 korrik, ku thoshte se po e kthente brigadën në Dibër për të marrë pjesë në një sulm kundër garnizonit gjerman, të planifikuar së bashku me partizanët maqedonë për datën një gusht.

Ndërkaq ne ishim njohur mirë me personelin dhe me komandantët e komisarët e Brigadës I. Gjithashtu na rastisi të njiheshim me kapitenin Menegaci (Menegazzi) dhe kapitenin Bruno të baterisë malore italiane dhe me nja dy oficerë italianë më të rinj, që shërbenin në radhët e partizanëve. Jeta e tyre ishte e vështirë e plot mundime. Dy oficerët e artillerisë fituan adhurimin tonë për mënyrën se si e mbanin të bashkuar baterinë e tyre si njësi italiane, duke bërë rrugën e tyre me partizanët në rrethana shumë të rënda. Në shtojcën 3 në fund të librit, një raport i shkurtër i kapitenit Menegaci për veprimet e baterisë me UNÇSH botohet si shenjë e vogël mirënjohjeje për ta.

Menjëherë pas katër hedhjeve me furnizime, Ridelli, unë dhe grupi ynë (radisti, italianët, nja dy shqiptarë dhe mushkat tona, gjithashtu dy aviatorë amerikanë të hedhur me parashutë në Maqedoni dhe që na kishin sjellë partizanët), u nisëm të hynim në kontakt me oficerin ndërlidhës britanik, që punonte me partizanët maqedonë. Na doli që ishte një oficer nga Afrika e Jugut, kapiteni Donald McDonald (McDonald), të cilin e kisha njohur në Kajro para se të vija në Shqipëri. Kaluam përmes një vendi me pyje të bukur dhe nga hapej një pamje tërheqëse e Strugës dhe e Liqenit të Ohrit, më në fund e gjetëm atë në kushte të këqija, të vetmuar, në një farë mase të mërziur e të rënë ngaqë i mungonin aksionet dhe larmia e jetës. Ai ishte nga ata oficerë ndërlidhës britanikë, siç do të kërkonte Enver Hoxha

të ishim të gjithë ne, pra oficerë furnizimi dhe asgjë më tepër. Duke qenë me forcat e Titos, ai mund të kërkonte hecnje me furnizime sa të dëshironte dhe nuk kishte asnjë problem politik. Ai nuk rrinte gjithë kohën me partizanët, por ishte larg frontit, për aq sa mund të ketë front në një luftë partizane. Ai ishte kanali për furnizime të bollshme, por partizanët maqedonë, siç na u duk ne, e trajtonin pa bujari, me shtrëngesa dhe pa ia shpërblyer. Ai kishte kaluar një dimër të ashpër. Ne e quajtëm se përvoja jonë me gjithë përipecitë e saj ishte shumë më e pëlqyeshme. Italianët tanë i shërbyen me një drekë të shkëlqyer. I krahasuam me të shënimet për orë të tëra dhe ai na ndihmoi për t'i theksuar Barit, se ishte një anomali që t'u dërgoheshin furnizime të bollshme partizanëve maqedonë, që i kishin njësitet të drejtuar nga Dibra, dhe t'u dërgoheshin furnizime shumë të pakta partizanëve shqiptarë, të cilët ishin drejtuar po nga ai objektiv. Gatuam një mesazh për Barin, të cilin në ditarin tim e kam përshkruar si radiogramin tonë më të fortë nga të gjithë pro partizanëve.

Natën e 30 korrikut ne i lamë dy pilotët amerikanë me Makdonaldin dhe morëm rrugën për t'u bashkuar sërish me Mehmet Shehun në frontin e Dibrës. Pas një marshimi shumë të gjatë, përmes pluhurit e vapës, më 31 korrik arritëm në Gorenë, në anën lindore të Dibrës, ku disa njerëz të Brigadës I po na prisnin për orën zero. Sulmi nisi në orën 03.50 të një gushtit, por ne ende po flinim orët e para, pastaj u bashkuam me Mehmet Shehun dhe komandën e tij në një pozicion lart mbi sistemin e rrugës së Dibrës nga mesi i paradites. Dy batalione të Brigadës I dhe një batalion maqedon kishin shpërthyer një sulm mbi pozicionet e përparuara të gjermanëve dhe i shtynë ata prapa në perimetrin mbrojtës të zonës së kazermave të Dibrës. Partizanët qëndruan të patundur gjithë ditën nën predhat e granatat e gjermanëve dhe treguan një disiplinë të mirë nën zjarr. Kur ra nata, ata u përpoqën të sulmonin kazermat, por mbrojtja ishte shumë e fortë për ta. Ata kishin mundur të sillnin vetëm një mortajë të rëndë, ndërsa mortajat e tyre italiane ishin ngushtë për predha. Ata pësuan disa të vrarë e të plagosur në luftim trup me trup dhe u tërhoqën në mëngjesin e 2 gushtit. Ndërkaq një batalion tjetër i Brigadës I kishte sulmuar dhe shkatërruar postërojat gjermane dhe urën e Spiles, që lidhte Dibrën me Strugën.

Pa e ditur Mehmet Shehu, Brigada V partizane, e cila ishte gjithashtu në Divizionin I, kishte lëvizur nga zona e

Matit për të kapur Peshkopinë më 29 korrik, pasi kishte djegur rrugës Fushë Alijën, kështjellën e Halil Alisë. Gjermanët kishin kundërsulmuar dhe një trupë e madhe e «nacionalistëve» kuislingë u përpoq t'i kapte partizanët prapa kraheve. Brigada V ia arriti t'u zinte pusi gjermanëve dhe t'i vinte në ikje, ndërsa trupat «nacionaliste» u shpartalluan ose u dorëzuan. Tashmë Peshkopia ishte një qytet «i çliruar» dhe u bë baza e Dali Ndreut për zhvillimin e operacioneve të tjera për të goditur Dibrën. Nga 2 gushti, Brigada IV dhe V po e mbyllnin qarkun rreth Dibrës nga veriu dhe perëndimi, ndërsa Brigada V depërtoi në qytet dhe ia doli mbanë të shpëtonte disa nga të plagosurit e Brigadës I. Ishte mëkat që nuk u bë e mundur të bashkërendohej veprimi i Brigadës I kundër Dibrës me lëvizjet e pjesës tjetër të Divizionit. Tani Dali Ndreu urdhëroi Brigadën I që të lëvizte drejt perëndimit, drejt krahinës së Burrelit në luginën e Matit, për të kaluar krahun e Divizionit kundër lëvizjeve të mundshme të gjermanëve nga zona bregdetare dhe nga garnizonet në Tiranë e në Shkodër, ndërsa Brigada IV dhe V ndërmorën bllokimin e Dibrës. Duke lëvizur Brigadën I drejt perëndimit, Dali Ndreu gjithashtu po siguronte që formacionet e zgjedhura të UNÇSH të zinin pozita kyçe për të dhënë çfarëdo goditjeje përfundimtare që do të nevojitej për të eliminuar Abaz Kupin dhe zogistët. Tashti që Divizioni kishte siguruar furnizime mund të vepronte në mënyrë më sistematike dhe sipas qëllimeve të caktuara.

Rreth po kësaj kohe Viktor Smithi, i cili kishte qenë postë në jug të Enver Hoxha dhe të Shtabi i Përgjithshëm i partizanëve për qëllimet e misionit të tij ndërmjetës, por që tashmë e kishin kapërcyer ngjarjet, madje që gjatë kohës kur ai ishte në udhëtim, u kthye drejt veriut dhe u bë oficer ndërlidhës britanik për Divizionin I partizan. Kështu që u bënë dy misione me Divizionin I. Smithi të Shtabi i Divizionit në Peshkopi me Dali Ndreun, dhe Ridelli (i misionit Stables) me Mehmet Shehun dhe Brigadën I. Kur rifilluan furnizimet ajrore nga fundi i korrikut, të dy misionet qenë në gjendje t'i siguronin Divizionit një ardhje të ndjeshme rifurnizimesh për operacionet e tij të ardhshme.

Rifillimi i furnizimeve ajrore për partizanët ishte një ngjarje me rëndësi. Kur lajmet për këtë depërtuan të Billi Maklini dhe misioni i tij Concensus përmes kontakteve që kishim me zogistët, u shkaktuan panik. Bari nuk i kishte njoftuar për këtë ndryshim, ndoshta sepse ishte i preokupuar me kërkesat e vetë operacionit, duke mos e parë domethënien

e tij të madhe politike. Lajmi u përhap shpejt nëpër malësi. Emeri në librin *Sons of the Eagle* ndryshimin e politikës ia vesh ecjes sipas rrymës në Bari: «shtabet tona nuk kishin zbatuar një politikë të re, por thjesht po ecnin sipas rrymës së ngjarjeve që i merrte përpara, që në këtë kontekst do të thoshte presioni i partizanëve».²⁾ Ai thotë se njerëzve në Bari u bëri përshtypje fakti që partizanët vijuan të luftonin kundër gjermanëve, «ndonëse jo aq dendur». «Kjo pikëpamje u përforcua nga kërkesat e vazhdueshme për armë prej oficerëve ndërlihdës me partizanët, çdonjëri prej të cilëve ishte i shqetësuar, dhe kjo ishte e natyrshme, në radhë të parë për ta paraqitur me sukses misionin e vet»³⁾. Për fat të keq, ndodhi që fushëpamja e misionit Concensus II ishte e mbushur me luftë civile. Për ata luftimet kundër gjermanëve ishin diçka që do të mund të ndodhte vetëm kur lufta civile të kishte përfunduar me ndërmjetësinë britanike (domethënë me presionin britanik mbi partizanët). Nga ana tjetër, fushëpamja e misioneve me partizanët ishte e mbushur me mundësitë e reja për aksione kundër gjermanëve dhe bashkëpunëtorëve të tyre të ngushtë, në vijim të betejave të bëra dhe të luftimeve që po zhvilloheshin nga partizanët gjithnjë në rritje dhe më të fuqishme. Lufta civile zinte vetëm një cep të skenës për BLO që ishin me partizanët dhe atyre u dukej se e meritonte gjithnjë e më pak që të mbante këtë etiketë, sepse «nacionalistët» që nuk po zbrisnin në fushën e betejës kundër gjermanëve gjithnjë e më tepër po bëheshin të padallueshëm nga ata që dilnin në fushën e betejës aktivisht me ta dhe për ta. Maklini dhe kolegët e tij i kërkuan Barit që t'u përmbahej propozimeve për ndërmjetim, të cilat ua kishte sjellë Smithi më 6 korrik, t'u ndërpriteshin gjithë furnizimet partizanëve dhe çdo propagandë në favor të tyre, dhe të paktën të ruhej kërcënim i për një pushtim të mundshëm britanik. Në rast se nuk mund të zbatohej kjo politikë, nuk do të mbetej mundësi tjetër veçse të mbyllej kjo punë dhe të kalohej gjithë përkrahja te partizanët. Në këtë rast Abaz Kupit do t'i ofrohej strehimi në Itali, ndërsa krerëve të tjerë nacionalistë do të duhej t'u kërkohej që të merreshin vesh vetë me partizanët si të mundnin. Shtabi i Përgjithshëm në Bari e pranoi me gatishmëri (« për habinë tonë», shkruan Emeri) se në të vërtetë kjo do të ishte zgjidhja politike që duhej zbatuar dhe ia referuan këtë Londrës. Kjo i trembi ata të Concensus II, sepse e kuptuan që vetëm një aksion i shpejtë mund t'i nda-

lonte partizanët, por një aksion i shpejtë ishte i pamundur derisa referimi i ishte bërë Londrës.

Megjithatë nuk kishte asnjë mundësi për një kërcënim britanik se do të ndodhte një pushtim eventual i Shqipërisë. Vendimet e marra në takimet e nivelit të lartë më 1943 kishin si pasojë të pashmangshme që nuk do të kishte forca në dispozicion për të pushtuar Shqipërinë. Kishte shumë pak shanse që Britania t'i ndërpriste gjithë furnizimet për partizanët. Bari kishte bërë titur një herë për «luftën civile» dhe i kishte ndërprerë furnizimet, porse vetëm kishte parë brenda pak ditësh se situata ishte shumë e komplikuar, sa nuk mund t'i vihej thjesht etiketa «luftë civile» dhe se ndërprerja e furnizimeve për partizanët do të thoshte të ndërprerë aksionet kundër gjermanëve. Në të vërtetë kishte ardhur koha, e ndoshta tashmë kishte kaluar, për t'i kanalizuar gjithë ndihmat për partizanët. Por misioni të Kupi kishte ardhur prej Londre dhe vetëm Londra mund të merre vendimin për ta braktisur, natyrisht, në rast se partizanët do të dilnin para vendimeve të Londrës, duke korrur fitore në veri dhe duke i shtyrë zogistët në zgrip. E, në fakt, pikërisht kjo ndodhi.

Ndonëse furnizimet ajrore britanike për UNÇSH ishin me rëndësi, sasi të materialeve luftarake të përfshira ishin modeste, në raport me përmasat numerike të forcave partizane që rriteshin me shpejtësi. Përvoja jonë në Brigadën I na bëri mjaft të vetëdijshëm për këtë raport. Riçard Ridelli ka ruajtur që nga koha e luftës regjistrin e shënimeve të misionit Stables që nga 28 korriku 1944 e më pas dhe ma ka dhënë për ta shfrytëzuar. Pjesa e parë e tij është shkruar me laps në një fletore ushtrimesh për nxënësit italianë dhe përmban vetëm radiogramet tona, pjesa e dytë (për shtatorin) ka të regjistruara si mesazhet e marra, ashtu edhe të dërguara, është shkruar me bojë në një fletore ushtarake model 193, që ishte e caktuar për të shërbyer si regjistër korrespondence në zyrat e ordinancave. Kalimi nga lapsi dhe fletorja e ushtrimeve të boja dhe fletorja ushtarake është një dëshmi se jeta e një-sive guerrile po ndryshonte shpejt drejt diçkaje më të rregullt në gusht e shtator 1944, ndërsa Ushtria Nacionalçlirimtare çlironte pjesë gjithnjë e më të mëdha të territorit të Shqipërisë dhe vetë gjendja jonë e furnizimeve përmirësohej. «Radiogrami më i fortë propartizan nga të gjithë», që ne dërguam kur ishim me Makdonaldin në Maqedoni më 30 korrik, nuk duket dhe aq i fortë sot. Ai u dërgua në tri pjesë të shkurtra për shkak se ngatërresat e lodhshme për ta shi-

fruar dhe për të vendosur kontakt të vazhdueshëm me radio na pengonin të dërgonim më shumë se tri ose katër fjali njëherësh. Në të shkruhej:

«BLO Shqip si duket nuk kanë qenë në gjendje të furnizojnë më shumë se një pjesë të vogël të kërkesave të partizanëve për shkak të mungesës së avionëve. Brigada I tani sheh furnizime të pakufizuara e të shkëlqyera për partizanët maqedonas, pra dyzet aeroplanë në një muaj. Kjo e lidhur dhe me ndihmën për Kupin shkaktonte që partizanët ta krahasojnë punën e BLO Shqip në mënyrë të pafavorshme me të tjerëve dhe e bën bashkëpunimin e ngushtë me partizanët për ne të vështirë. Të gjitha këto i cungojnë përpjekjet e tyre luftarake dhe tonat, për shembull sulmi i partizanëve shqiptarë kundër Dibrës, Peshkopisë nuk mund të bëhet me besim pa pasur mbështetje të plotë. Hundërpjuri (Donald Macdonald) pranon se partizanët shqiptarë kanë bërë më shumë se maqedonasit kundër hunëve dhe, po të furnizohen po në atë masë, do të kenë rezultate luftarake të papritura. Partizanët shqiptarë janë gjithashtu të pakënaqur nga mungesa e popullarizimit botëror që e meritojnë së tepërmi. Pas tetë muajsh me të ashtuquajturit elementë nacionalistë, ky mision i bindur ata nuk do të luftojnë hunët dhe vetëm partizanët me mbështetje aleate mund dhe do të luftojnë hunët në zonat veriore. Lut njoftoni nëse furnizimet në shkallën maqedone mund të priten, domethënë dy zero aeroplanë kërkojnë gusht për pajisjen e Brigadës I»4).

Ky mesazh u pasua pas dy ditësh nga një radiogram në pesë pjesë, që paraqiste kërkesën për furnizimet, për të cilat ishim marrë vesh ne me Mehmet Shehun, se ishin të nevojshme për të sjellë Brigadën I dhe çetën e Dibrës të Esat Ndreut në një nivel luftarak të kënaqshëm. Kjo ka qenë kërkesa jonë për gushtin. Të gjitha misionet kishin me vete një broshurë të quajtur «Lista e pakove standard», që ishte një lloj katalogu porosish postare me fjalë të koduara për ngarkesat e paketuara të të gjitha pajisjeve dhe furnizimeve ushtarake që mund të kërkoreshin. Duke përdorur një kopje të kësaj liste, të cilën unë e kam edhe sot, mundet që fjalët e koduara të përdorura në telegramet tona të kthehen në fjalë të kuptueshme për llojet dhe sasinë e materialeve. Kërkesa jonë për një dërgesë të menjëhershme dhe urgjente ishte:

7 mortaja Piat dhe 200 granata
20 mitralozë të lehtë Bren
50 automatikë

100 granata Mills
 30.000 predha të municioneve 303
 20.000 predha të municioneve 9 mm
 20 dylbi
 20 pistoleta sinjalizimi me municionet
 100 predha për artilerinë italiane 75/13
 1.240 komplete veshjesh luftarake
 1000 palë këpucë
 1050 palë të brendshme
 1000 palë çorape
 500 palë pece
 200 kapele ushtarake fushore
 si dhe 1000 monedha ari ose 30.000 napolona letër.

Pas këtij katalogu me kërkesa urgjente, u dërgua një listë plotësuese me materiale që nuk kishin përparësi, por që do të nevojiteshin për ta pajisur plotësisht Brigadën I dhe çetën e Dibrës. Ajo përfshinte sasi të llojeve të ndryshme të municioneve italiane dhe gjermane për t'i përdorur me armët që kishin kapur partizanët, për mortajat 50 mm, eksplozivë të fuqishëm plastikë, pallto dhe disa granata dore. Nuk kishte ndonjë mundësi që të merreshin të gjitha këto furnizime, por në fakt ne morëm një pjesë të mirë të tyre në gusht. Lista tregon se kërkesat më të rëndësishme për partizanët ishin armët automatike, mortajat, municionet dhe veshjet. Kërkesa jonë mbulonte nevojat e një formacioni të zgjedhur të UNÇSH, të Brigadës I. Nevojat për njësitë e tjera partizane, më pak të shquara, në veçanti për brigadat e reja që ishin formuar me shpejtësi me ardhjen në shumicë të njerëzve gjatë verës, ishin shumë më të mëdha.

Oficerët ndërlidhës britanikë të tjerë që punonin me partizanët, po paraqisnin kërkesa për sasi të ngjashme dhe për furnizime të ngjashme me to dhe, ashtu si edhe ne, po merrnin një pjesë të asaj që kërkonin. Ndryshimi ndërmjet kërkesave dhe dërgesave gjithmonë mbetej i madh. Ishte e pamundur të pajisej ushtria partizane deri në një nivel të kënaqshëm luftarak brenda sasive mujore në ton, që ishin caktuar për hedhjet nga ajri në Shqipëri, kështu që Enver Hoxha dhe udhëheqësit e tjerë partizanë asnjëherë nuk pushuan së ankuari se furnizimet nuk ishin të bollshme, duke e ditur, ashtu siç e dinin, se sa shumë më të bollshme, ishin në Jugosllavinë fqinjë. Por, ndërsa Titoja e pati staturën dhe shkathhtësinë për ta bërë veten të njohur si një aleat bashkëluftues, Enver

Hoxha e kishte flakur tej shansin e tij për t'u njohur po njësoj, kur ai me aq pakujdesi e humbi gjeneralin Dejvis në mes të dimrit.

Ne të misionit Stables u nisëm për marshim drejt perëndimit nga Dibra mbrëmjen e 2 gushtit për të shoqëruar Brigadën I. Ndarja e kohës për ne diktohej kryesisht nga orët e fiksuara për radiotransmetimet, por ne ia arritëm të fushonim pranë njësiteve të Brigadës në mbrëmjet dhe kënaqeshim me këngët e forta të partizanëve rreth zjarreve të fushimit të tyre, në netët e ngrohta të verës. Lëvizjet e Brigadës ishin të përpikta dhe kryheshin mirë. E vetmja vonesë që ndodhi ishte më 5 gusht, kur Mehmet Shehut iu desh të përcillte zëvendëskomisaren e vet, Fiqreten, e cila po nisej për në jug. Ridelli e pranoi që unë duhej të bëja një rrugë deri në Peshkopi për t'u lidhur me Viktor Smithin, ndërsa ai vijoi rrugën drejt Matit me Mehmet Shehun. Unë udhëtova me Haxhi Lleshin dhe qeshë në gjendje të shihja mirëseardhjen e jashtëzakonshme me të cilën e prisnin, ndërsa ne kalonim përmes fshatrave që ishin të krahinës së vendlindjes së tij. Kaluam gjithashtu edhe pranë kullave të Hysni Demës, që ishin djegur që në fillim të betejës së Dibrës. Aty pasuesit e mëparshëm të Hysniut nxitonin që të na përshëndetnin me «Vdekje fashizmit» (përshëndetje e partizanëve), duke u përpjekur të na tregonin se kishin qenë fshehurazi gjithmonë me ne. Në Peshkopi, i pari qytet «i çliruar», të cilin kam pasur mundësi të vizitoja, kishte parulla partizane të saposhkruara mbi shumicën e murave dhe shumë nga ndërtesat ishin dëmtuar. Sheshi ishte plot me partizanë dhe njerëz të ngeshëm të qytetit e dukej sikur askush nuk po bënte asgjë. Mua më priti me bujari Faik Shehu dhe takova Mustafa Gjinishin, që shoqëronte Divizionin I si i dërguar i Shtabit të Përgjithshëm të Enver Hoxhës. Mustafai më bëri përshtypje si një njeri me pikëpamje shumë të hapura për një udhëheqës partizan dhe i gatshëm për t'u marrë vesh. Ai u ka lënë po këtë përshtypje oficerëve të tjerë anglezë, që kishin të bënë me të. Dhe kjo i solli që Enver Hoxha t'i vinte një njollë të zezë.

Më 7 gusht e gjeta Viktor Smithin që ishte vendosur në Sllatinë, ku vetëm një muaj më parë Riçard Ridelli dhe unë ishim përkujdesur për të plagosurit partizanë. Siç dukej, misioni i Viktorit jetonte në ngushticë dhe ishte shumë i zënë me radiogramet për Barin, duke i deshifruar, merrte furnizime nga ajri herë pas here dhe mbante lidhje me Brigadën

IV e V e, natyrisht, me shtabin e Divizionit. Unë qëndrova me Viktorin për katër ditë dhe munda të dëgjoja prej tij për herë të parë çfarë kishte ndodhur gjatë dimrit dhe pranverës në jug të Shqipërisë. Kjo ma bëri më të lehtë për të kuptuar lojën e forcave që i kishte dhënë mundësinë UNÇSH të përmbyste situatën në Shqipërinë e jugut e të mesme në një kohë të shkurtër për katër a pesë javë. Dy djemtë e Cen Elezit erdhën të më shihnin dhe deshën të rregullonim marrëdhënie paqësore ndërmjet babait të tyre e familjes dhe partizanëve. Viktor Smithi hyri në kontakt me Muharrem Bajraktarin me qëllim që ta shtynin të vepronte në po atë drejtim. Njëkohësisht partizanët po e peshonin që të përdornin forcën kundër kujtdo që mëdyshte për të punuar me ta, kështu që duke sikur familja Lita ishte në krye të listës së atyre që do të shkatërroheshin nga Brigada IV.

Në këtë kohë ndodhi një ndryshim i rëndësishëm në strukturën e komandës së UNÇSH në qendër e në jug të Shqipërisë. Do të formohej një divizion i dytë, i përbërë nga brigadat partizane III, VI dhe XVIII. Brigada III ishte një nga dy brigadat (tjetra ishte e dyta) prej krahinave të Pezës, Çermenikës dhe Martaneshit, që ishin goditur dhe shpërndarë gjatë ofensivës gjermane të dimrit në dhjetor 1943, kur misioni i Shtabit të Dejvisit u shkatërrua. Ajo ishte rimëkëmbur në pranverë dhe duhej të bashkohej me Brigadën VI nga Shqipëria e Jugut, që ishte formuar në janar në Përmet. Brigada XVIII ishte formuar e re në krahinën e Dibrës nga çeta e Esat Ndreut, duke iu shtuar luftëtarë të rinj, që po mblidheshin nën flamurin partizan në zonat e sapoçliruara. Divizioni I dhe II së bashku duhej të formonin Korpusin I të UNÇSH dhe Dali Ndreu, nga komandant i Divizionit I, do të ngrihej në postin e komandantit të ri të Korpusit, me Hysni Kapon, anëtar i PKSH dhe i shtabit të përgjithshëm të Enver Hoxhës, si komisar politik. Mehmet Shehu u ngrit nga komandant i Brigadës I të famshme për të zëvendësuar Dali Ndreun në komandën e Divizionit I. Tuk Jakova, komisar politik i Divizionit I, mbeti aty ku ishte. Ndonëse Mehmet Shehu tashmë kishte fituar prestigj të madh si komandant ushtarak, ai zinte vetëm një pozitë të dorës së dytë në hierarkinë e PKSH dhe FNÇ. Ai nuk ishte anëtar i Shtabit të Përgjithshëm, as i qeverisë së përkohshme (Komiteti Antifashist Nacionalçlirimtar), as i Byrosë Politike të Partisë Komuniste të Shqipërisë. Tuk Jakova që tani u bë komisar politik i tij, ishte nga ana politike më epror se ai. Në

nivelin më të lartë, Hysni Kapoja ishte më epror politikisht se Dali Ndreu. Dali Ndreu (ose Dali Sufa, siç e thërrisnin disa herë) kishte një karakteristikë krahinore në veri, sepse ishte nip i Cen Elezit. Në këtë kohë ishte Dali Ndreu me Hysni Kapon përkrah që merrej gjithnjë e më tepër me politikën kundrejt krerëve nacionalistë, ndërsa Mehmet Shehu, si ushtarak, merrej me gjermanët në Dibër. Ndryshimi në strukturën komuniste dukej i sipërfaqshëm, si një përshtatje e drejtpërdrejtë për t'u përputhur me zgjerimin e ushtrisë, por kjo, dhe ndoshta në mendjen e Enver Hoxhës, që ishte më me rëndësi, shënonte një hapje të freskët të burimeve politike për fitoren komuniste në Shqipëri.

Mehmet Shehu arriti në zonën e Peshkopisë nga Mati më 9 gusht për të marrë komandën e Divizionit I. Dy ditë më parë, Brigada V kishte ndërmarrë një sulm mbi Dibrën nga veriu, por ishte zbrapsur me humbje. Edhe një herë forcat partizane e panë se nuk mund të mateshin me pozicionet e fortifikuara dhe kjo kërkesë u mbështet me forcën ajrore të Ballkanit nga Italia për të bombarduar pozicionet e fortifikuara dhe kjo kërkesë u mbështet me forcë nga Mehmet Shehu sapo arriti. Më 10 dhe 11 gusht avionët Beaufighter të Forcave Ajrore Mbretërore të BAF i shkatërruan kazermat në Dibër me zjarrin e raketave. Gjermanët ia kishin dalë mbanë të përforconin garnizonin e Dibrës, por sulmet me raketa ua prishën planet për një goditje më të shpejtë kundër Brigadës V dhe ndihmën e Xhem Gostivarit dhe të forcave kuislinge të tij. Gjermanët nuk qenë në gjendje ta përgatitnin sulmin e tyre deri më 19 gusht. Brigada V i mbajti pozicionet e veta rreth Maqellarës, në gjysmë të rrugës ndërmjet Dibrës e Peshkopisë, dhe luftimet vazhduan aty deri më 26 gusht, kur gjermanët u zbrapsën në qytetin e Dibrës. Forca Ajrore e Ballkanit i sulmoi ata përsëri atje dhe gjermanët u tërhoqën nga qyteti e zunë pozicione në drejtim të veriut. Më në fund ata u tërhoqën nga e gjithë zona më 30 gusht, duke humbur 400 të vdekur dhe sasi të mëdha materialesh luftarake. Beteja prej dy muajsh e brigadave të partizanëve shqiptarë dhe maqedonë jepte shembuj antologjikë për të dyja anët, të drejta e të gabuara, se si bëhet lufta partizane. Mehmet Shehu dhe Divizioni I ishin bërë një forcë e shkëlqyer dhe me shumë përvojë për vazhdimin e mëtejshëm të luftës në Shqipëri.

Kur e lashë Viktor Smithin në Sllatinë më 11 gusht, më shoqëronte një grup përfocimesh për Brigadën I në zonën e

Matit. U vonuam pak në Peshkopi, ku flitej vetëm për sulmin me raketa mbi Dibër dhe Faik Shehu e pasuesit e tij mbanin një qëndrim të çlirët e jashtëzakonisht mirëbesues. Ndoqëm mbi kodra një rrugë në drejtim të kundërt me akrepat e orës, derisa dolëm në rrugën e Klosit dhe që atje patëm mundësi të ecrim me shpejtësi. Partizanët i prisnin mirë nëpër fshatra dhe ishin të kënaqur që mund të flinin brenda nëpër shtëpi çdo natë. Ata nuk mund ta kuptonin kundërshtimin tim për ta pranuar këtë luks dhe këmbënguljen për të fjetur jashtë. Moti ishte shumë i nxehtë dhe çimkat e pleshtat gëlonin në çdo kasolle, duke iu shtuar edhe mizat e, ndonjëherë, edhe mushkonjat. Shoqëruesit e mi jo vetëm po flinin mirë sipas standardeve të tyre, por edhe po hanin mirë. Një herë, kur patën rastin të gjenin katër dele të mëdha, ra u desh të ndaleshim menjëherë që t'i therrnim, t'i ripnim, t'i piqnim në hell dhe t'i hanim deri në thelën e fundit. Unë arrita në shtabin e Brigadës I afër Lisit natën e 14 gushtit dhe u bashkova përsëri me Ridellin në fushimin e tij pak para se të gdhinte. Ridelli kishte një shesh lëshimi shumë të mirë dhe po merrte një varg hedhesh ajrore për Brigadën I. Në fakt Bari po dërgonte shumicën e armëve, municioneve dhe të pajisjeve, të cilat i kishim kërkuar në fund të korrikut. Gjithsej ne morëm 17 ngarkesa ajrore gjatë gushtit, rreth 30 tonë furnizime. Na u desh së shpejti të lirim Brigadën I, me qëllim që të vendoseshim pranë Divizionit II të ri. Ndërkohë që e lamë Brigadën I, më 25 gusht, ne i kishim pajisur sërish ata në një shkallë mjaft të kënaqshme.

E pashë se Ridellit, ashtu si edhe Smithit, i kishte bërë përshtypje të madhe zgjerimi i shpejtë i forcave partizane që po ndodhte në pjesën e Shqipërisë ku ishim ne. Kjo u bë një nga çështjet kryesore në radiogramet tona për Barin. Regjistri i radiogramëve të misionit tonë Stables tregon se Ridelli dërgoi një mesazh më 10 gusht (ai atëherë ishte tashmë në Mat), ku sugjeronte se do të kërkohehin më shumë misione për të punuar me partizanët në Shqipërinë e Veriut dhe se i duheshin dërguar direktiva nënkolonelit të aviacionit Nil dhe kapitenit Simkoks për të forcuar marrëdhëniet e tyre me partizanët. Ai shtonte: «Pozita mund të thjeshtohet po të kishte një mision të oficerëve ndërlidhës britanikë për partizanët në Veri»⁵). Më 15 gusht ai dërgoi një radiogram për të kërkuar një radiomarrëse

tjetër dhe një radist, në mënyrë që ai dhe unë të mund të punonim veçan po të ishte nevoja, për të furnizuar Divizionin II afër Tiranës, Brigadën e tij të re XVIII në zonën e Dibrës dhe një brigadë tjetër që duhej të formohej në Mat. Ai shtonte: «zgjerimi i lëvizjes partizane në veri të Shqipërisë po ecën me shpejtësi të madhe, zgjerimi kryesor i furnizimeve të përballojë shtimin e radhëve»⁶). Më 18 gusht ai iu përgjigj një kërkesë nga Bari për furnizimet e caktuara për shtatorin, duke vënë në dukje se Brigada XVIII dhe batalioni i Matit, që pritej të kthehej në brigadë, ishin në fakt pa pajime. Për t'i pajisur ato do të duheshin deri tri-dhjetë ngarkesa ajrore me armë, municione, veshje ushtarake dhe këpucë. Brigada III dhe VI, përbërëset kryesore të Divizionit II, pritej se do të kishin nevojë për pajime pak a shumë në po atë shkallë që po i përfitonte Brigada I, domethënë rreth dhjetë ngarkesa ajrore për brigadë. Më 19 gusht një radiogram nga misioni Stables kërkonte dy ngarkesa të tjera ajrore me rroba ushtarake dhe granata për Brigadën I, duke thënë se kjo do ta plotësonte procesin e pajisjes së përshtatshme të brigadës për herë të parë. Personeli në Bari u përgjigj mirë për kërkesat që të furnizoheshin brigadat e konsoliduara mirë, por ata nuk ishin në gjendje të pranoin mendimin për një ushtri partizane që po rritej me shpejtësi. Kishte një pikëpyetje për dëshirën që të ndihmohej UNÇSH për t'u rritur me kaq shpejtësi. Çështja e Kupit mbetej ende e pazgjidhur dhe misioni Concensus II ishte ende me të. Ato misione që tashmë ishin me partizanët në Veri (të Viktor Smithit dhe të Riçard Ridellit) mund të mbështeteshin, por ideja për të shtuar numrin e misioneve me partizanët në Veri, me qëllim që të mbështetej zgjerimi i UNÇSH, nuk mund të përkrahej.

Në gjysmën e dytë të korrikut, pasi Divizioni I partizan ishte angazhuar në kontakt të afërt me gjermanët në zonën e Dibrës e të Peshkopisë, u lehtësua presioni mbi zogistët në luginën e Matit. Misioni Concensus II pati mundësi ta rimerrte veten, duke rrgitur fushimin në anën perëndimore ose të Tiranës të kodrave që ndajnë luginën e Matit nga fusha në veri të Tiranës. Te libri «Sons of the Eagle» Xhulian Emeri jep 20 gushtin si datën në të cilën partizanët ndërmorën ofensivën e tyre të dytë në luginën e Matit, duke përparuar drejt veriut përmes Klosit dhe duke pushuar Burrelin⁵).

Operacioni u krye nga Brigada I, që ishte tërhequr nga

Dibra më 2 gusht. Ajo duhet të jetë përgatitur nga Mehmet Shehu në ditët e tij të fundit me brigadën, kur po e linte për të marrë komandën e Divizionit më 7 ose 8 gusht. Brigada pati një ngecje të përkohshme në Burrel, kur forcat «nacionaliste» nga fshatrat malore e ripushtuan qytetin për dy ditë, por më në fund partizanët morën epërsinë dhe «nacionalistët» u shpërbënë. Kapja e luginës së Matit nga partizanët pati si efekt shkatërrimin e një pjese të madhe të bazës së pushtetit të Abaz Kupit. Për atë moment partizanët nuk përparuan më tej drejt perëndimit kundër fortësës që i kishte mbetur Kupit në Krujë, nga hapej pamja e fushës së Tiranës. Misioni Corcensus II ishte vendosur në Mukje, aty nga jugu i Krujës. Ata ishin të detyruar të vëzhgonin procesin e dëshpëruar të copëzimit dhe të shpërbërjes që po e gërryente lëvizjen e Abaz Kupit. Ata në krye po gjenin rrugët se si të shpëtorin veten nga dallga partizane që po vinte; ata poshtë u përvodhën në fshatrat e veta me shpresë që të shpëtonin, kurse vetë Kupin shumica e shihnin se kishte rënë midis dy karrigeve, duke mos e mbështetur më as anglezët dhe as gjermanët.

Kur u bashkova përsëri me Riçard Ridellin në luginën e Matit më 15 gusht, mundëm të dëgjonim të shtënat e largëta nga Veriu dhe nga Perëndimi. Brigada I ende po përparonte drejt kufijve të luginës së Matit, drejt Krujës në perëndim dhe Mirditës në veri. Nga 20 gushti gjermanët u bënë përsëri të gjallë, duke përparuar me disa forca nga veriu, ndërsa neve na u bë thirrje që të mblihdeshim te shtabi i brigadës në Lis. Ne e pranuan, por edhe kështu u kapëm në befasi më 24 gusht, kur u zgjuam nga të shtënat. Ne nuk u vumë rëndësi, duke menduar se ishim të mbuluar me siguri prapa brigadës, por pas pak zbuluam se vendkomanda e brigadës ishte zbratur. Zbritëm teposhtë te kullat e Zogut në Burgajet, nja një kilometër larg dhe e gjetëm shtabin, por gjithashtu ramë në mes një beteje dhe bombardimit të rëndë nga predhat gjermane. Pas pak një kundërsulm i partizanëve i zmbropsi gjermanët dhe ata, me zogistët që i shoqëronin, u tërhoqën prapa drejt Veriut nga Mirdita. Gjëmimet e betejës na vinin nga veri-lindja: Brigada IV po përparonte drejt Veriut gjatë luginës së Drinit, duke shtypur rezistencën e atyre krerëve, me të cilët ne kishim bërë bisedime gjatë dimrit. Lajme inkurajuese erdhën nga Dibra për sukseset e Brigadës V atje kundër gjermanëve.

Gjatë kësaj periudhe radioja jonë shërbeu si një ndër-

lidhëse e rëndësishme për komandantët partizanë. Bari na dërgonte informacion për situatat luftarake në të gjitha pjesët e vendit dhe përmes Barit oficerët e tjerë ndërlidhës anglezë me partizanët mbaheshin të informuar për përparimet e bëra në zorën tonë. Radisti ynë, tetari Elvixh, ishte shumë i ngarkuar me punë dhe kishte mjaft ngatërresa me ngarkimin e baterive dhe vendosjen e kontakteve me radio në afatet e caktuara. Megjithatë ndërlidhja nuk u ndërpre dhe kjo, bashkë me ardhjen e pandërprerë të furnizimeve të reja nga ajri, i bëri marrëdhëniet tona me partizanët të mbushen plot punë e gjallëri. I vetmi klient vni krejt i pakënaqur ishte komandanti i batalionit lokal të Matit, Mustafa Kaçaçi, sepse ne nuk ishim në gjendje ta detyronim Barin të dërgonte furnizime për një «njësit» të ri. Ata vazhdonin të kundërshtonin për shkak të implikimeve politike që do të kishte pranimi i rritjes së shpejtë të UNÇSH. Mustafa Kaçaçi ishte edhe më i hidhur, sepse ai e dinte që Bill Maklini dhe misioni Concensus II ishin vetëm në një largësi të vogël në anën tjetër të kodrave të afërta dhe ai gabimisht mendonte se ata po i sillnin furnizime Kupit. «Pse i inkurajoni zogistët të bëjnë luftë civile?», më pyeti ai. Kjo ishte krejt njësoj me pyetjen që zogistët i bënë Maklinit dhe grupit të tij — pse ne i ndihmonim partizanët për të bërë luftë civile?

Kushtet e jetës së përditshme për ne u përmirësuan diçka në Mat. Fruta kishte plot. Hedhjet ajrore të shpeshta na sollën ushqime të konservuara e të thata dhe disa sende të revojshme. Moti i nxehtë ndërpritej vetëm rastësisht nga stuhi me gjëmime. Kishim mundësi të laheshim në lume. Gjetëm disa karrige të thurrura me kashtë për kampin tonë. Nisëm të rruheshim përditë. Një radiomarrëse Decca na dha mundësinë të dëgjonim lajmet dhe muzikë. Italianët tanë po kënaqeshin. Nga Bari morëm një furrizim të dobishëm me pluhur kundër morrave.

Më 25 gusht, një ditë gëzimi sepse morëm lajmin për qirimin e Parisit, e lamë Brigadën I me keqardhjen e të dyja palëve dhe u nisëm për rrugë drejt masivit të Çermnikës, për t'u lidhur me Brigadën III dhe me shtabin e Divizionit II të ri. Ne ishim të vetëdijsëm gjatë korrikut e gushtit se fakti që si misioner ne e kishim kaluar dimrin me krerët nacionalistë, ngjallte dyshime në sytë e partizanëve, por marrëdhëniet tona praktike me Brigadën I kishin qenë të mira që në fillim, dhe Mehmet Shehu dukej se i çmonte

më shumë veprimet se sa fjalët. Patëm kontakte të mira me dy komisarë të lartë, Hysri Kapon dhe Tuk Jakovën. Megjithatë u bë e qartë se kishte një pikëpyetje kundër nesh në regjistrat e Enver Hoxhës dhe se ai parapëlqente të kishte si oficer ndërlidhës britanik me Divizionin I dhe me Korpusin I një oficer që të kishte punuar me partizaret qysh në fillim. Kjo që arsyeja që e shtyu Barin të vinte Viktor Smithin me Dali Ndreun, ndërsa Ridelli dhe misioni Stables do të luante një rol mbështetës, duke furnizuar njësitin kyç të Dali Ndreut. Kur e dëgjuam se do ta linim Divizionin I dhe do të punonim me Divizionin II të ri, e pamë këtë si një shenjë se po na largonin nga qendra e ngjarjeve për në periferi.

Kur ne të misionit Stables e lamë Brigadën I, beteja e Dibrës në fakt kishte mbaruar. Partizaret ishin vendosur përfundimisht në Shqipërinë qendrore dhe nisën ta kthenin vëmendjen drejt Tiranës dhe rrugës që lidh Tiranën drejt Veriut me Shkodrën. Ata gjithashtu çanë drejt Veriut gjatë luginës së Drinit, duke qeruar hesapet me krerët që u kishin kundërshtuar më parë dhe që tani nuk pranorin të dorëzoheshin. Partizanët nuk hasën vështirësi të mëdha për të hyrë në zonat malore. Pasuesit e krerëve po treteshin dhe sidoqoftë nuk përbënin ndonjë kundërshtar të barabartë për brigadat partizane, që kishin fituar përvojë luftarake. Gjermanët në Tiranë dhe në rrugët që çonin në Tiranë ose që niseshin prej ardejt, ishin një objektiv shumë i vështirë. Forcat gjermane po tërhiqeshin nga Ballkani dhe garnizonet gjermane nuk ishin me cilësi të lartë, por kjo ishte një tërheqje luftarake dhe ata po luftonin për jetë a vdekje, sepse nuk donin të binin në duart e partizanëve. Gjatë gjithë periudhës kur Divizioni I po çante rrugën në Shqipërinë Qendrore e të Veriut, njësitet partizane në Shqipërinë e Jugut i kishin sulmuar garnizonet gjermane në qytetet kryesore dhe karvanet gjermane në rrugët nga veriu në jug. Në veçanti u bënë beteja të ashpra në Gjirokastër e Delvinë dhe pati mjaft luftime në zonën e Korçës.

Në këtë pikë të luftës, kur dita e fitores së plotë ishte akoma disa muaj larg dhe kur komandantët aleatë kërkonin një sulm të përgjithshëm mbi gjermanët kudo ku mund të goditeshin, partizanët në Shqipëri ndërmorën atë veprim që kërkohet. Duke bërë këtë, ata e konsoliduan dorën e tyre mbi vendin dhe i goditën ashpër të gjithë ata që u zinin rrugën. Por akuza se ata kanë luftuar kundër gjermanëve

«ndorjëherë më të rrallë», nuk qëndron. «Nacionalistët» i humbën shanset e tyre plotësisht, sepse nuk ngritën as gjatë kundër gjermanëve, madje as në çastin e fundit, duke i ruajtur forcat vetëm e vetëm për veprime kundër partizanëve. Ky ishte një gjykim i gabuar, i trishtueshëm dhe vdekjeprurës nga ana e tyre, që mund të shpjegohet vetëm me shkallën e lartë të verbimit dhe të hipnotizimit të tyre nga aspiratat kombëtare kundër fqinjëve sllavë, dhe me pafatësinë e tyre për të kuptuar se ato aspirata ishin shumë të panjohura për botën e jashtme dhe me siguri nuk shiheshin me simpati ose me mirëkuptim. Enver Hoxha dhe kolegët e tij kishin gjithashtu një damar të fortë nacionalist por ata, ose të paktën Hoxha, asnjëherë nuk e kishin vënë në dyshim se u duhej të luftonin me armë në dorë për çdo gjë që kërkojnë. Dhe ata, ose ai, ishin të përgatitur për të qenë po aq intransigjentë me gjermanët, sa edhe më pas me këdo tjetër, siç e ka treguar historia e Shqipërisë në këta dyzet vjet të kaluar. Kjo u solli atyre fitoren dhe e ktheu Shqipërinë në një shtet komunist.

Një shënim për furnizimet i duhet shtuar këtij kapitulli për betejën e Dibrës. Në kreun 9, u vu në dukje se pati një rënie të ndjeshme të furnizimeve të hedhura nga ajri në qershor (nga 64 tonë në maj, ranë 34.7 tonë në qershor), për shkak të ofensivës gjermane të qershorit, që i largoi partizanët nga sheshet e tyre për hedhjet nga ajri. Nuk ka ndonjë dyshim për këtë zvogëlim, por është e vështirë të jesh i sigurtë rreth shifrave të përpikta, sepse ka një mospërputhje që nga qershori e më pas ndërmjet dokumentimit të Regjimentit ajror 334 të Forcave Ajrore Mbretërore dhe dokumentimit të shtabit të Forcës Ajrore të Ballkanit⁷). Regjimenti ajror 334 jep një shifër për furnizimet faktike në qershor pak më të lartë se sa jep SHFAB — 40.2 tonë në krahasim me 34.7 tonë të FAB. Në korrik, me gjithë ndalimin e plotë të furnizimeve për partizanët në gjysmën e parë të muajit, raportet e shtabit të Forcës Ajrore të Ballkanit tregojnë se tonazhi u rrit në 68.63 tonë, të dërguar në 51 fluturime me aeroplanë C47 (Dakota), shumica të Forcave Ajrore të Ushtrisë Amerikane. Dokumentet e Regjimentit ajror 334 pajtohen me numrin e fluturimeve, por japin 96 tonë si sasi totale të dërguar. Regjimenti 334 e jep kuotën mujore për Shqipërinë 70 tonë, duke u rritur në 98 tonë nga fundi i muajit, ndërsa sipas SHFAB kuota për muajin ka qenë vetëm 46 tonë. Rritja e dërgesave nga fundi i muajit

jit shpjegohet me vlerësimin në atë kohë të Shtabit të VAB për rëndësinë e betejës së Dibrës dhe për sulmet kundër qyteteve ku ishin garnizonet gjermane dhe qendrat e komunikimit në jug. Në gusht kuota e tonazhit për Shqipërinë u ngrit. Shtabi i FAB tregon për një kuotë 110 tonë dhe një sasi të përgjithshme prej 162,6 tonësh të dërguar. Shifra për fluturimet drejt Shqipërisë në gusht, me sa duket, ka qenë 86.

Statistikat për hedhjet nga ajri në korrik e gusht tregojnë se rreth një dyzinë njerëz janë hedhur çdo muaj. Ata kanë qenë në pjesën më të madhe të pararojës së LRDG⁷) dhe të grupeve të komandove që do të luanin rol në Shqipëri gjatë shtatorit dhe tetorit. Një pjesë e vogël e tonazhit të furnizimeve do të ketë qenë prej furnizimeve të misioneve, por pjesa themelore ishte me municione, armë, pajime dhe veshje për partizanët, për Ushtrinë Nacionalçlirimtare. Mund të llogaritet se nga mesi i korrikut deri në fund të gushtit, gjatë betejës së Dibrës, partizanët kanë marrë rreth 150 deri 160 tonë furnizime nga ajri. Një pjesë e rëndësishme e këtyre furnizimeve ka shkuar drejtpërdrejt për Divizionin I partizan në Shqipërinë Qendrore. Ne të misionit Stables kemi marrë 17 ngarkesa ajrore në gusht. Viktor Smithi në Shtabin e Korpusit I duhet të ketë marrë të paktën po aq. Pa këto furnizime Divizioni I do të kishte pësuar një disfatë dhe e gjithë lëvizja partizane rjë goditje serioze: gjermanët dhe ata që bashkëpunonin me ta, do të kishin konsoliduar limanin e sigurtë që u ofronte Shqipëria e Veriut.

Nga ana tjetër, nuk mund të pohohet se 150 tonë furnizime mund të vendosnin fatin e një lufte, qoftë edhe në një vend kaq të vogël si Shqipëria. Ndoshta përfundimi i drejtë është se furnizimet e hedhura për partizanët nga Forca Ajrore e Ballkanit në korrik e gusht 1944 siguruan që gjermanët të vazhdonin të ndesheshin me luftime dhe me beteja të ashpra gjithnjë në rritje në Shqipëri, e, njëkohësisht, furnizimet e prena «luftën civile», duke i bërë partizanët të aftë për ta fituar atë shpejt dhe relativisht me pak gjakderdhje. Nuk ka dyshim se ushtria partizane do ta kishte vendosur autoritetin e vet mbi gjithë Shqipërinë më në fund: partizanët e kishin fort në dorë Shqipërinë e Jugut dhe në veri e lindje të Shqipërisë po ngrihej Jugosllavia komuniste, këto dy anë do të ishin të mjafta për ta siguruar atë përfundim faktikisht, madje edhe nëse Divizioni I do të ishte dërrmuar e do të zbrapsej duke kapërcyer

Shkumbirin në korrik. Por faza e parë e komunistizimit të Shqipërisë do të kishte qenë një proces shumë më i përgjakshëm se sa ishte në fakt, dhe kontributi i Shqipërisë për luftën e përbashkët kundër Gjermanisë do të ishte shumë më i vogël. Enver Hoxha duhej të tregonte më shumë mirënjohje për ndihmën që mori ushtria e tij nga aleatët në korrik e gusht 1944 dhe aleatët duhet të kishin qenë më të shpejtë për të njohur që në mes të vitit 1944 se vetëm partizanët ishin në gjendje për të dhënë ato grushte ushtarake që kërkoheshin kundër gjermanëve, dhe se qëllimi politik i mbuluar për ta mbajtur në këmbë Kupin ishte i papajtueshëm me kërkesat e situatës ushtarake.

Shënime

1. Mendoj se ajo u martua me të pas luftës. Nuk kam qenë në gjendje ta verifikoj këtë, por është e sigurtë se emri i së shoqes ishte Figret.
2. Amery (1948: 234).
3. Idem.
4. Regjistri i radiogrameve të misionit Stables është në zotërimin tim privat. Ky është burimi i gjithë radiogrameve të Stables që citohen në këtë kapitull dhe në kapitullin 14.
5. Amery (1948: 241).
6. Statistikat e furnizimeve ajrore në këtë kapitull vijnë të nxirren nga dosjet e Arkivit Qendror Shtetëror të përmendura në shënimin 3 për Kreun 7. Nga qershori 1944 e më pas ato përmbajnë raportet mujore të operacioneve për furnizimet ajrore të kryera nga Shtabi i Forcës Ajrore të Ballkanit, si edhe nga raportet e Shtabit të Forcave Ajrore Aleate të Mesdheut dhe dokumentet operative të Regjimentit Ajror 334 të Forcave Ajrore Mbretërore. Dokumenti 24/110 Ajror përmban gjithashtu raportet e Operacioneve të Posaçme të FAB.
7. Grupi i Shkretëtirës i Distancave të Largëta.

Kreu 12

Fundi i lojës

Nënkoloneli Palmer kishte ardhur në Bari me një delegacion prej tre vetash nga Shtabi i Përgjithshëm i UNÇSII, Ushtria Nacionalçlirimtare Shqiptare, më 26 korrik¹). Nga 2 gushti u arrit një marrëveshje me ta për shumë pika të politikës ushtarake, por ata kishin paraqitur disa kërkesa që ngrinin vështirësi politike²). Ata kërkuar që Komiteti Antifashist Nacionalçlirimtar duhej të njihej si qeveria e përkohshme e Shqipërisë, dhe ata donin që të pranohej në Bari një delegacion i përhershëm. Ata gjithashtu parashtruan dokumente me qëllimin që të tregonin se Abaz Kupi dhe lëvizja e Legalitetit po bashkëpunonin me gjermanët dhe kërkuar që të dy të denoncoheshin hapur si tradhtarë të popullit shqiptar dhe të çështjes së aleatëve. Kjo pikë doli se ishte më e lehta ndër çështjet e diskutueshme që të mënjanohesh. Lord Harkorti (Harcourt), komandanti i Forcës 399, ishte në gjendje të thoshte se qëndrimi i aleatëve ndaj Kupit dhe Legalitetit do të vështrohej në listën e dëshmimeve dokumentare të parashtruara dhe të çdo informacioni tjetër që do të sigurohej³). Dy kërkesat e tjera, për njohjen dhe për një mision të përhershëm pranë komandës aleate, u diskutuan me kujdes në Bari dhe në Kazertë. Një raport i shkurtër, me datën 8 gusht, u përgatit për Komitetin Politik në Kuartierin e Forcave Aleate në Kazertë, dhe rekomandonte që të jepej një përgjigje refuzimi me mirësjellje për kërkesën e njohjes, por duke bërë lëshimin se mund të pra-

nohej në Bari një mision i përhershëm, me kusht që ai të përbëhej vetëm nga dy a tre oficerë, të ishte rreptësisht ushtarak dhe nuk do të lejohej që të shndërrohej në një bazë⁴). Megjithatë, raporti vinte në dukje se duhej të zgjidhej një çështje thelbësore politike: a do të vijohet edhe më tej përpjekja për ta ruajtur Kupin si forcë politike në Shqipëri (kjo përsëritet si «synimi i Ministrisë së Jashtme»), apo do të pranohej se kjo nuk ishte më e zbatueshme në praktikë dhe se aleatët duhej të përqendroheshin të përfitimmi prej dividendeve të mira ushtarake që vinin nga mbështetja për LNC. «dhe të pranohet fakti që kur të tërhiqej armiku, ata do të ishin e vetmja forcë ushtarake ose politike me peshë në Shqipëri dhe do të ishte e lidhur ngushtë... me Titon». Raporti vinte në dukje se shanset për ta ruajtur Kupin po binin me shpejtësi, por duke mbajtur parasysh se faktori vendimtar për të arritur një vendim duhej të ishte forca e konsideratave politike që ndërlikoheshin në këtë.

Ndërkaq, më 6 gusht, Filip Broudi i kishte dërguar një telegram Harold Makmilanit në Kazertë, duke sugjeruar se situata e re në Shqipëri mund ta bënte të nevojshme të tërhiqeshin BLO të atashuar pranë Kupit dhe ai premntonte t'u bënte telegrame edhe më pas për këtë çështje⁵). Disa ditë më vonë, Makmilani dërgoi një telegram, në të cilin pajtohej me Broudin⁶). Kur telegrami i Broudit u pa në Ministrinë e Jashtme në Londër, sekretari i tretë dhe përgjegjësi i zyrës për Shqipërinë në Departamentin e Jugut, Denis Laskej ka shëruar më 11 gusht:

«Shanset për të bërë një marrëveshje ndërmjet LNC dhe Nacionalistëve po pakësohen me shpejtësi dhe duket sikur së shpejti neve do të na duhet të heqim dorë nga këta të fundit. Nga pikëpamja ushtarake, kjo nuk do të ishte një humbje e madhe, meqë LNC është e vetmja organizatë që ka bërë ndonjëherë beteja serioze kundër gjermanëve dhe vlera e Nacionalistëve, edhe po të dilnin në krahun tonë, do të ishte problematike. Megjithatë, nga ana politike, është e dyshimtë nëse ne duam ta ndihmojmë LNC për të fituar kontrollin mbi gjithë Shqipërinë. Ata nuk duhet të jenë nën kontrollin e plotë të komunistëve, por ngjyra e përgjithshme politike e Lëvizjes është pa dyshim mjaft nga e majta dhe e ngjashme me partizanët (është fjala për në Jugosllavi) dhe me E.A.M. Unë përsëri mendoj se mund të ishte në interesin tonë e gjithashtu të vetë Shqipërisë, nëse mbreti Zog do të kthehej pas lufte dhe kjo do të ishte një zgjidhje më e mirë

se sa një qeveri e LNC. Megjithatë unë nuk po shoh ndonjë mënyrë për ta bërë këtë.»⁷⁾

Eprori i Laskejt, Armin Dju, kishte bërë edhe më pak përpjekje se Laskej për ta rrokur realitetin e gjendjes në Shqipëri. Ai ka shënuar më 13 gusht: «Në këtë fazë të luftës ne nuk duam të angazhohemi thellë me njërin palë ose me tjetrën dhe unë jam kundër tërheqjes së BLO nga Kupi». Sër Orme Sarxhent u kufizua të shënonte: «Unë pajtohem» dhe, më 16 gusht, Ministria e Jashtme udhëzoi që: «...tani për tani nuk mund të ngrihet çështja për të tërhequr BLO nga ky i fundit (Kupi)⁸⁾».

Ndërsa FO në Londër ishte kapur pas kartës së Kupit që po zhvlerësohej, ndonëse duhet rikujtuar që asnjëherë nuk ishte menduar që të ofrohej një shans suksesi jo më tepër se 50 me 50, Komandanti Suprem i Aleatëve në Kazertë e kishte diskutuar raportin e 8 gushtit me Komitetin e tij Politik dhe i kishte pranuar dy rekomandimet e tij praktike. Kështu që ai porositi që t'i jepej një përgjigje refuzimi me mirësjellje kërkesës së Hoxhës për njohjen politike, por kërkesa për një mision ushtarak të përhershëm në Bari duhej të pranohet brenda caqeve të kufizuara, të propozuara në relacion⁹⁾.

Si efekt i gjithë kësaj ishte që hapat e menjëhershëm praktikë që duhej të ndërmerreshin për ta bërë marrëdhënien ushtarake të arsyeshme nga ana politike, të mos bëheshin ose, madje, mund të thuhej se ishin kundërshtuar. Heshturazi ishte pranuar mungesa e dëshirës, në të vërtetë pamundësia e përpjekjeve për të ndaluar avancimin e partizanëve, por FO që e kishte nxjerrë jashtë loje mbretin Zog si kandidat të përshtatshëm për mbështetjen dhe favorizimin e tij nga ana e aleatëve në vitet e mëparshme, tani dëshironte të përkrahte atë dhe pasuesit e tij pikërisht në atë çast, kur çështjes së tyre dukej që i kishte ardhur fundi. Kotësia e këtij qëndrimi e tregoi veten lidhur me një çështje tjetër që lindi në atë kohë. Vetë mbreti Zog bëri një hap afrimi ndaj Ministrisë së Jashtme, duke thënë se ai dëshironte të dërgonte dy-tre emisarë në Shqipëri për t'u përpjekur që të arrihej një pajtim ndërmjet zogistëve dhe grupimeve të tjera. Pas shkëmbimit të disa telegrameve ndërmjet Londrës dhe Kazertës, ky propozim, ashtu siç pritej, u hodh poshtë¹⁰⁾. Duke e nxjerrë Kupin jashtë loje, nuk dilte mundësia për ta bërë mbretin Zog një pikënisje dhe me qëndrimin e hapur të partizanëve për ta mbajtur atë jashtë vendit, nuk kishte ndonjë shpresë që ai të mund të pranohet si ndërmjetës.

Le të kthehemi në Bari. Bisedimet me delegacionin e partizanëve shqiptarë kishin hasur përsëri në një gozhdë. Eroudi e kishte njoftuar Makmilanin, më 10 gusht, se nënshkrimi i marrëveshjes kishte ngecur, sepse partizanët e kundërshtonin kërkesën që Shtabi i Përgjithshëm duhej të këshillohej me eprorin e BLO (Palmerin) për shpërndarjen e materialeve ushtarake që u ishin furnizuar¹¹). Ky ishte një veprim tipik për Hoxhën. Në shkrimet e tij bëhet e qartë se ai prej kohësh i kishte indoktrinuar vartësit e vet me bindjen se i vetmi funksion i të dërguarve përëndimorë ishte që t'u dërgonin furnizime dhe se ata duhej të mos merrnin pjesë në vendimet që merrnin partizanët e, madje, të mos dinin asgjë për çfarë vendosej. Delegatët në Bari thanë se e kishin parashtruar çështjen e aleatëve para gjeneral-kolonelit Hoxha: oficerët e Kuartierit të Forcave Ajrore të Ballkanit qëndruan të palëkundur dhe prisnin rezultatet. Për ta ishte e qartë se Ramadan Çitaku ishte njeriu më i rëndësishëm ndërmjet të tre delegatëve (pak më vonë, ai u bë ministër i financave), por madje edhe ai i nënshtrohej një kontrolli të fortë nga Enver Hoxha. Më 21 gusht, Bari njoftonte se Hoxha kishte pranuar që eprori i BLO duhej «të informohej» për vendimet e Shtabit të Përgjithshëm për shpërndarjen e furnizimeve, por ai kërkonte gjithashtu sigurimin se sasitë e përcaktuara në marrëveshje për furnizimin mujor gjithnjë të përballoheshin të plota¹²). Atij iu dha një përgjigje e ftohtë. Enver Hoxha, më në fund, «lëshoi» rrugë dhe marrëveshja ushtarake u nënshkrua më 24 gusht¹³).

Sipas marrëveshjes, 140 tonë furnizimesh në tërësi do t'i dërgoheshin UNÇSH duke u hedhur nga ajri çdo muaj dhe 300 tonë nga deti, por sasitë e sakta do të ndryshonin nga muaji në muaj. Furnizimet do t'u shpërndaheshin njësisë të ndryshme të UNÇSH nga Shtabi i Përgjithshëm i partizanëve, në konsultim me nënkolonelin Palmer. Përcaktoheshin zonat e veprimit të misioneve të ndryshme britanike dhe ishin vendosur edhe përparësitë për zonat e ndryshme. Oficerët britanikë që drejtonin misionet përcaktoheshin sipas kësaj liste:

Zona e Gjirokastrës
 Zonat e Beratit
 Zona e Pezës
 Zona e Çermenikës
 Zona e Mokrës
 (afër Pogradecit)

Kapiteni C.L.D. Newell
 Kapiteni H. W. Wright
 Majori A.V. Hare
 nuk ka të caktuar
 Kapiteni E. Northrop

Zona e Korçës
Zona veriore
(me Divizionin I)

Majori J.K.H. Shaw

Majori W.V.G. Smith

Në këtë listë ka dy gjëra me interes të veçantë. E para, është se Alan Hejri dilte si mbijetuesi më i madh, meqë e kishte nisur me Dejvisin dhe partizanët në dimër, punoi nën morojtjen zogiste nga tunda i dimrit, u përishi në Misionin Concensus II të Makunit në pranverë, u kap nga Brigada I partizane në verë dhe kështu u kthye në atë që e quante si rrugën e punëve të mpara në vjeshtë. E dyta është se misioni ynë Stables nuk përmiej rare. Ridelli nuk përmendej me emër dhe vendi i caktuar për Çermenikën nuk ishte plotësuar, ndonëse pikërisht në Çermenikë, në Bizë u ndodhëm në runda të gushtit, duke pritur që të krijohet Divizioni II. Enver Hoxha dhe personeli i tij nuk na njihnin mua e Ridellin personalisht, siç njihnin hejrin dhe nuk ka dyshim se kishte shumë njoua të zeza të shënuara kundër nesh, për shkak të qëndrimit tonë të gjatë në dimër midis krerëve nacionalistë të luginës së Drinit. Puna jonë e afërt me Mehmet Shehun dhe marrëdhëniet e mira me të dhe me Brigadën I të tij gjatë betejës së Dibrës, nuk do të na jepnin medoemos nota në favorin tonë në defterët e Hoxhës.

Marrëveshja ushtarake shënonte që kërkesa për njohjen e Komitetit Antifashist Nacionalçlirimtar si qeveri e përkohshme ishte hedhur poshtë nga aleatët. Ajo dëshmonte se ishte pranuar formula e nënkolonelit Lord Harkourt lidhur me vendimet e aleatëve për qëndrimin e tyre ndaj Kupit, ashtu siç dukej në dritën e të dhënave që i ishin paraqitur. Shtoj një paragraf që thoshte se ishte arritur marrëveshja që «Shtabi i Përgjithshëm i UNÇSH nuk mund të ishte përgjegjës për të pranuar cilindo personel aleat, që kishte punuar më parë për majorin Abaz Kupi».

Nga mesi i gushtit, tashti kur Brigada I partizane përsëri e kishte në zotërim luginën e Matit deri në zonën e Burrelit dhe po niste të shtyhej më tej drejt veriut, kur Brigada IV dhe V si dhe njësitë maqedone po u bënë presion gjermanëve në Dibër, dhe kur dukeshin shenjat e para se partizanët po nisnin ta drejtonin vëmendjen e tyre ndaj Tiranës, Fiqri Dineja dhe qeveria e tij kolaboracioniste mund ta shihnin se ata nuk mund të shpresonin më ta përmbanin vërshimin komunist në Shqipëri duke u mbështetur te gjer-

manët. Më 18 gusht Fiqri Dineja, i shoqëruar nga gjenerali Prenk Previsi, komandant i xhandarmërisë, dolën nga Tirana për t'u këshilluar me Abaz Kupin. Ata donin të dinin nëse tani mund të bashkoheshin me të, në vend që të përpiqeshin ta manipulonin atë për t'u bashkuar me ta, dhe nëse ishte e hapur ende alternativa britanike. Abaz Kupi u kërkoi atyre ta linin Tiranën, të dilnin malit e të bashkoheshin me të për të sulmuar gjermanët.

Fiqri Dineja dhe gjenerali Previsi ishin të përgatitur për ta pranuar këtë, nëse kështu mund të hapnin rrugën për të kaluar te aleatët dhe të merrnin furnizime ushtarake. Ata u kthyen në Tiranë dhe Abaz Kupi u takua me Maklinin. Ky e paraqiti propozimin në Bari si një shans të fundit për të siguruar një kryengritje të të gjithë vendit kundër gjermanëve dhe për të penguar që Shqipëria të bëhej komuniste.

Propozimi u prit me shumë rezerva në Bari. Përfaqësuesi i Ministrisë së Jashtme, Filip Broudi, sugjeroi që përgjigja për Abaz Kupin të bëhej në këto vija:

«Duke mbajtur parasysh faktet e deritanishme për grupin e nacionalistëve që i janë afruar Kupit, ne nuk jemi në gjendje tani për tani të kemi ndonjë besim real për aftësinë e tyre që t'i rezistojnë armikut. Megjithatë, nëse ata duan të ndër marrin ndonjë veprim kundër gjermanëve dhe të japin dëshmi konkrete për këtë dëshirë, ne do të jemi të përgatitur për ta rishikuar qëndrimin tonë».14)

Ministria e Jashtme e miratoi këtë formulim në një telegram të 25 gushtit. Ai iu dërgua me telegram Maklini dhe Maklini ia komunikoi Abaz Kupit më 28 gusht, duke shtuar se misioni Concensus II do të tërhiqej, nëse Kupi nuk do t'i sulmonte gjermanët menjëherë. Kupi reagoi keq kundrejt kësaj dhe u ankua për dështimet e njëpasnjëshme britanike, sic i shihte ai, për të arritur marrëveshje me të. Ai e mori përsipër t'ia përcillte mesazhin Fiqri Dines, ndonëse dukej qartë, pa pasur asnjë besim, se me këtë mund të arrihej gjë, dhe atëhere ai befasi shpalli se kishte ndër mend të sulmonte Durrësin brenda tri ditësh.

Si u kthyen në Tiranë, Fiqri Dineja dhe kolegët e qeverisë së tij mbajtën një mbledhje me figurat drejtuese të nacionalistëve dhe vendosën që të braktisnin Tiranën e t'u shpallnin luftë gjermanëve, po të ishin të sigurtë se do të kishin mbështetjen britanike. Por nuk u ndërmor asnjë ve-

prim i menjëhershëm. Më 24 gusht një njësit partizan bëri një aksion brenda në Tiranë. Mbrëmjen e 28 gushtit Fiqri Dineja dhe kolegët e tij dolën edhe një herë të dytë nga Tirana për t'i bërë vizitë Kupit dhe për të dëgjuar prej tij kushtet e përgjigjes britanike. Kur ata u kthyen në Tiranë mëngjesin e datës 29, qeveria dha dorëheqje dhe u shpërnda. Ata kishin dështuar në shkatërrimin e partizanëve me ndihmën e gjermanëve dhe tani britanikët nuk u ofronin asgjë për t'i ndihmuar kundër partizanëve. Thirrja e britanikeve për t'u rezistuar gjermanëve nuk u interesonte: baza e tyre politike ishte shkërmoqur në atë shkallë, sa ata nuk ishin më në gjendje që t'i përgjigjeshin kësaj thirrjeje. UNÇSH ishte tashmë pothuaj te portat e Tiranës. Dora e nacionalistëve kishte mbetur jashtë loje.

Këtë rrjedhë të shpejtë të ngjarjeve ndërmjet Kupit, Fiqri Dines dhe misionit Concensus II, duhet ta kenë marrë vesh shumë shpejt Enver Hoxha dhe kolegë të tij udhëheqës në Helmës në jug. Në Tiranë dhe gjetkë kishte shumë shqiptarë që ishin të etur t'u bënin favore partizanëve, duke u dhënë vullnetarisht informacion për palën që po humbiste. Enver Hoxha kishte një dhunti të veçantë për goditje të guximshme dhe dredharake. Mund të mendohet se ai kishte shumë dyshime për rolin që mund të luante misioni Concensus II dhe ishte i shqetësuar që madje edhe tani, në këtë çast të fundit, mund të formohej një front nacionalist kundër gjermanëve dhe të pretendonte që të trajtohej njësoj me lëvizjen e tij, të cilën nacionalistët e kishin goditur aq rëndë, por që nuk ia kishin dalë ta shpartallonin. Ai kishte gjithashtu nuhatje për taktikat hutuese dhe ekuivoke si mjet ndihmës për mbijetesën dhe epërsinë politike. Ai kishte arritur një marrëveshje me komandën britanike në Bari dhe ishte i detyruar të tërhiqej për çështje të ndryshme të rëndësishme. Mbrojtja e tij më e mirë kundër çdo akuze eventuale për marrëdhënie «oportuniste» me Britaninë do të ishte një demonstrim i hershëm i «sektarizmit». Cilatdo qofshin motivet që e shtynin atë, ai ndërmoi një hap që i dëmtoi marrëdhëniet me britanikët pikërisht në kohën kur ato po arrinin një pikë tjetër më të lartë. Më 25 gusht ai thirri kapitenin Markus Llajën, i cili ishte i ngarkuar me detyrë në Kuartierin e Misionit në kohën që Alan Palmeri mungonte duke qenë në Bari, dhe i dorëzoi një ultimatum për misionin Concensus II. Në telegramin e Markus Llajënit që njoftonte Barin, lexojmë:

«E takova Hoxhën sonte. Ai deklaroi se Maklini, Smajli dhe Sej-muri po punonin me bashkëpunëtorët e armikut kundër partizanëve. Ai kerkoi që ata duhej ose të iknin nga Shqipëria, ose duhej t'u dorë-zoheshin partizanëve për t'i evakuar në Itali brenda pesë ditëve që nga ajo natë. Përndryshe, tha ai, do të dërgoheshin patrulla për t'i kapur dhe për t'i sjellë që të nxirreshin para gjyqit ushtarak partizan. Hoxha tha se për shkak të sjelljes së tyre, ai nuk i konsideronte këtej e tutje si oficerë aleatë, por i quante ata agjentë të reaksionarëve të huaj, që po organizonin luftën kundër partizanëve».15)

Kjo shkaktoi një reagim të zemëruar të menjëhershëm në Bari. Nënmareshali i ajrit Eliot i kishte dhënë lamtumirën delegacionit shqiptar më 25 gusht pas nënshkrimit të marrëveshjes ushtarake me ta më 24. Më 26 gusht, ditë e shtunë, ai i thirri prapë për një takim të posaçëm me anëtarët e Komitetit Politik të tij, pasi ky komitet e kishte diskutuar mesazhin e Llajënit¹⁶⁾. Elioti ua lexoi mesazhin të tre shqiptarëve dhe vuri në dukje se ai prekte çështjen e Kupit, së cilës i ishte rezervuar një vend i veçantë në marrëveshjen e saponëshkruar. Ai tha se ai dhe Komiteti Politik nuk kishin fare se si ta kuptonin mesazhin dhe e ndienin se duhej të kishte ndodhur ndonjë gabim i rëndë. Ai u kerkoi t'i thoshin Enver Hoxhës se as që mund të ngrihej çështja për të toleruar një kërkesë nga ana e tij, që të tërhiqeshin oficerët ndërlidhës të aleatëve dhe aq më pak të kapeshin ata me forcë e të nxirreshin përpara një gjyqi ushtarak partizan. Nënmareshali i ajrit kerkoi që Hoxha të tërhiqte si deklaratën edhe kërcënimin, dhe të jepte një garanci të pandryshueshme se nuk do të ndërmerre asnjë veprim çfarëdo qoftë kundër personelit britanik në Shqipëri. Britanikët nuk do të ishin në gjendje të plotësonin kushtet e marrëveshjes ushtarake deri sa garancitë e kërkuara të mos jepeshin. Maklini thjesht po zbatonte urdhrat që kishte marrë për të bërë gjithçka të mundshme për t'i shtyrë nacionalistët që të vepronin kundër gjermanëve. Të tre delegatëve iu kerkua që të rrinin në Bari deri sa çështja të zgjidhej në mënyrë të kënaqshme, por nuk do të kishte kufizime për lëvizjet e tyre në zonën e Barit. Meqë Enver Hoxha kishte folur për një afat prej pesë ditësh nga 25 gushi, edhe përgjigja prej tij do të pritej brenda kësaj kohe. Delegatëve iu tha se atyre u kërkohej që të vepronin si ndërmjetës. Kapiteni Llajën do të informohej për çfarë u tha në mbledhje dhe do të udhëzohej që t'ia transmetonte Hoxhës, por ai nuk duhej të hynte në diskutime për këtë çështje.

Delegatët u kufizuan për vete të pyesnin se ku ishin oficerët britanikë për të cilët bëhej fjalë. Iu vu në dukje se majori Sejmur ishte larguar nga Shqipëria më 8 korrik (kjo ishte një nga çuditë e incidentit, se Hoxha ishte kaq keq i informuar, sa kishte përfshirë emrin e Sejmurit dhe jo të kapitenit Emeri).

Shpejt u bë e qartë se koloneli Ramadan Çitaku dhe koloneli Bedri Spahiu e ndien se u ishte ngarkuar një detyrë e papërballeshme: ata kishin frikë nga Hoxha ose të palatën që t'i hidhnin në letër çfarëdo kritikash për të dhe pajtaj të zbatonin udhëzimet intransigjente që do të vinin si përgjigje. Kur Komiteti Politik bëri mbledhjen tjetër më 23 gusht, iu tha se delegatët nuk kishin dëshirë të qëndronin dhe kërkonin të ktheheshin në Shqipëri për të folur me Hoxhën¹⁷). Prandaj u vendos që Palmeri, i cili ishte i pranishëm në mbledhjen me delegatët më 26, do të hidhej përsëri në Shqipëri të nesërmen dhe me një udhëzim të shkruar prerë, për ta drejtuar në bisedimet me Hoxhën. Palmeri e takoi Hoxhën më 30 gusht dhe njoftoi se sjellja e tij kishte qenë miqësore dhe se i kishte dhënë përshtypjen se donte të zbriste nga kërcënimi i tij. Megjithatë, ishte e dukshme se këtu ndërlikohej një element personal, Hoxha kishte një pakënaqësi të madhe për Maklinin e Smjalin dhe i akuzoi ata për sjellje të papërshtatshme e për qëndrim armiqësor ndaj LNC. Telegrami nga Bari për Kazertën që njoftonte për këtë takim, përmbante një koment se do të ishte e dëshirueshme që të tërhiqeshin Maklini dhe Smajli¹⁸). Pa dyshim, Enver Hoxha e mbante mend antipatinë reciproke që kishte lindur nga fundi i vitit 1943 ndërmjet misionit Concensus I dhe udhëheqjes së LNC (shih kreun 4 dhe kreun 5). Ai nuk ishte nga ata që e harronte një fyerje ose një pakënaqësi.

Alan Palmeri e takoi Enver Hoxhën përsëri më 4 shtator, këtë herë në prani të oficerit ndërlidhës amerikan dhe të një tjetri që i ishte shtuar rrethit të kuartierit, një oficeri ndërlidhës sovjetik¹⁹). Kësaj radhe Enver Hoxha e tërhoqi komunikimin dhe kërcënimin e tij, duke thënë se ato ishin bërë në një moment emocionesh pas vdekjes para pak kohësh të Mustafa Gjinishit dhe të shokëve të tjerë në duart e kuislingëve e të gjermanëve. Ai asnjëherë nuk kishte pasur ndër mend ta zbatonte kërcënimin e tij, por ai dëshironte që BLO të cilët ishin me Kupin, që ai e shihte si kuisling, duhej të tërhiqeshin. Hoxha u shpreh se ishte mjaft i kënaqur me rezultatet e arritura në marrëveshjen ushtarake të nënshkruar në Bari. Palmeri e pranoi tërheqjen e Hoxhës dhe marrë-

veshja ushtarake e nënshkruar në Bari hyri në fuqi. Një delegacion ushtarak shqiptar prej dy oficerësh, njëri prej tyre epror, nënkoloneli Kadri Hoxha, gjeti rezidencë në Bari më 18 shtator. Kadri Hoxha kishte qenë oficeri i zonës përgjegjës për t'u kujdesur për gjeneral-brigadierin Dejvis dhe për kuarterin e misionit në Bizë nga fundi i vitit 1943 dhe më pas kishte komanduar Brigadën VII partizane.

Më 8 shtator, Broudi i njoftoi Makmilanit se Komiteti Politik i BAF kishte vendosur që do të ishte e këshillueshme të tërhiqeshin sa më parë të ishte e mundur Maklini dhe Smajli²⁰). Po atë ditë, Antoni Iden në Londër kishte shënuar në kopjen e tij të telegramit tjetër nga Bari se «Është e qartë se Kupi nuk ka ndër mend të bëjë asgjë. Me siguri do të na dalin ngatërresa po t'i lëmë oficerët tanë me të. Më mirë të hiqen që andej». Por do të pritej fundi i tetorit që ky vendim të vihej në zbatim dhe, gjatë javëve ndërmjet kësaj kohe, vëmendja dhe energjitë e personelit në Bari vituan t'u kushtoheshin më tepër matarimit të eklipsit të Kupit e të Concensus II, se sa rregullimit të marrëdhënieve me qeverinë e re që po lindte *de facto* të Shqipërisë. Britanikët ishin të pavendosur dhe Enver Hoxha nuk po tregonte shpirtmadhësi. Por përpara se të merremi me këtë histori të trishtuar, është nevoja të paraqiten dy episode të tjera.

Njëri prej tyre është vdekja e Mustafa Gjinishit. Ai u vra në një pritë nga fundi i gushtit, ndërsa po ecte me Viktor Smithin. Nuk u pa se kush i sulmoi. Gjinishi u godit me bërpkëri me dy të shtëna. Në fillim u mendua se sulmuesit ishin gjermanë, por ishte e çuditshme që ata nuk u përpoqën të kapnin Viktor Smithin, ndonëse ata ishin fshehur vetëm pak metra nga shtegu i tij. Shqyrtimi i mëvonshëm i incidentit na sugjeron se kjo ishte një vrasje. Në kujtimet e tij Hoxha kritikoi për Gjinishin i bën me sharje, duke e portretizuar atë si spiun të britanikëve. Me termat komunistë, Gjinishi ishte një «oportunist», me kontakte të gjera në shumë nivele dhe sektorë të jetës shqiptare, shprehej në favor të përpjekjeve të gjera kombëtare kundër pushtuesve, ishte popullor me forcat partizane, kishte dëshirë dhe aftësi për të punuar në mënyrë konstruktive me të huajt nga perëndimi dhe i prerë për të qenë nismëtar i pajtimit kombëtar. Ai kishte qenë një nga negociatorët e marrëveshjes së Mukjes në tetor 1943, që shpejt u hodh poshtë nga LNC (shih kreun 4). Në korrik dhe gusht 1944, ai shoqëroi Divizionin I dhe bastaj Korpusin I në Shqipërinë e veriut. Ai arriti një farë suksesi duke tërhequr disa nga udhëheqësit nacionalistë më

pak të komprometuar, për shembull, Dan Kalošhin e Cen Elezin dhe, siç ishin hapur fjalë, edhe Muharrem Bajraktarin, në bisedime me partizanët e madje, siç duket, edhe për fillimin e bashkëpunimit. Pas vdekjes së tij, nuk u dëgjua më gjë për këto dhe brigadat partizane nuk treguan durim me krerët veriorë dhe i shkatërruan njërin pas tjetrit. Është e vështirë të mos arrish në përfundimin se Gjinishi u likuidua nga një skuadër goditëse, që punonte për Hoxhën, i cili nuk kishte ndër mend që të pranonte njërin nga kolegët e tij kryesorë, që të bëhej një pikë bashkimi për një koalicion kombëtar. Nëse ky supozim është i drejtë, atëhere ka qenë po ajo ndjenjë e Hoxhës që goditi njëkohësisht Maklinin dhe Gjinishin. Sidoqoftë, pretendimi i Hoxhës, kur po fliste me Alan Palmerin më 4 shtator, se kishte marrë vesh për vdekjen e Mustafa Gjinishit kur e thirri Markus Llajënin dhe i bëri kërcënimin për Maklinin më 25 gusht, do të dukej i pranueshëm vetëm në rast se, natyrisht, ai e dinte nga brenda se kjo ngjarje ishte e planifikuar.

Një oficer ndërlihdës nga Bashkimi Sovjetik, majori Ivanov, i shoqëruar nga një toger, u shfaq në jug të Shqipërisë nga ditët e para të gushtit dhe çau rrugën për në kuartierin e përgjithshëm të Enver Hoxhës në Helmës. Kishte diçka të fshehtë për mënyrën se si ai erdhi në Shqipëri. Bari e njoftoi AV — M Eliotin se shprehte hamendjen që rusët ishin hedhur me parashutë²¹). Ka më shumë të ngjarë që ata të kenë hyrë nga Jugosllavia, përmes Maqedonisë dhe zonës së Korçës. Në këtë ndërkohë ishte një njësi e vogël ajrore sovjetike në Bari, që përdorte pajisjet e nevojshme të Forcës Ajrore të Ballkanit dhe punonte në drejtim të Jugosllavisë. Z. Iden u shqetësua kur e pa këtë lajm, duke e ndier se qeveria sovjetike duhej ta kishte paralajmëruar aleatin britanik për qëllimet e veta. Z. Çurçill ishte në atë kohë në Itali dhe nga Londra iu dërgua një telegram AFMQ më 15 gusht, që kërkonte të tërhiqej vëmendja e tij për arritjen e misionit sovjetik në Shqipëri²²). Ngjarjet e shumta që e preokuponin në atë çast mendjen e Çurçillit përfshinin: rrethimin e Varshavës dhe dështimin e sovjetikëve për të bërë ndonjë hap që të ndihmohej Ushtria Kombëtare Polake; planifikimin e zbarkimit britanik në Greqi; rregullimin deri në një farë shkalle të bashkëpunimit ndërmjet mareshalit Tito dhe udhëheqësve politikë jugosllavë në mërgim; zbarkimet e Aleatëve në jug të Francës; si dhe mundësitë për përparimin në frontin italian në kundërshtim me tërheqjen për në teatra të tjerë të shumë prej trupave më të mira të

gjeneralit Aleksandër. Pasi pa disa nga njoftimet e shkurtër plotësuese rreth rusëve në Shqipëri nga Kuartieri i Forcës Ajrore të Ballkanit, Çurçilli u kënaq që më 18 gusht të shënonte: «Nuk më duket se është i nevojshëm ndonjë veprim nga ana ime»²³). Duhej të pranohej *fait accompli*, por ardhja e rusëve shërbeu për ta rritur shqetësimin e Ministrisë së Jashtme rreth të ardhmes së Shqipërisë në një moment lëkundjesh për politikën ndaj Shqipërisë, Siç do të shihet, për ironi, Enver Hoxha kishte më tepër se britanikët arsye të atypëratyshme që të shqetësohej rreth ardhjes së majorit Ivanov. Enver Hoxhën e priste ngatërresa në një përleshje me të dërguarin e ri që i kishte nisur Titoja dhe majori Ivanov do të mbante anën e jugosllavëve. Enver Hoxha nuk ka gjetur gjë të mirë të thotë për të në shkrimet e veta.

Deklarata e Abaz Kupit se ai do të sulmonte Durrësin nuk doli gjë. David Smajli ia doli mbanë ta bindte se forcat e tij do të ishin të paafta që ta mbanin qytetin edhe po të arrinin ta kapnin, kështu që do të rrezikoheshin të shkatërroheshin. Ai e pranoi rrugën Tiranë-Shkodër si një objektiv më modest. Ndërkaq trupat nga Azia Qendrore në forcat gjermane gjatë zonës bregdetare nisën të dezertonin dhe Kupi e misioni Concensus filluan t'i rekrutonin ata. Kupi kishte ndërmend që t'i përdorte ata kundër Durrësit, por nuk është për t'u habitur që edhe kjo nuk doli gjë.

Nga 4 shtatori, Kupi ende po bënte premtime për aksione kundër gjermanëve, por në fakt nuk ishte ndërmarrë asnjë veprim. Atë ditë partizanët mësynë drejt perëndimit përmes maleve mbi Krujë. Përfundimi ishte i parashikueshëm. Qyteti dhe kështjella e Krujës ranë në duart e partizanëve më 8 shtator. Kupi me këtë e humbi kalanë e tij të fundit. Pikëpamja e Emerit për këto ngjarje nga fundi i gushtit dhe fillimi i shtatorit, është përmbledhur në këtë fjali: «edhe një herë, pikërisht kur Abaz Kupi kishte vendosur të bënte një sulm, Enver Hoxha u vu në lëvizje që t'i sabotonte planet e tij»²⁴). Por situata mund të shpjgohet edhe anasjelltas, duke qenë njësoj me të drejtë: pikërisht kur Enver Hoxha dhe partizanët ishin bërë në veri aq të fortë, sa mund t'i jepnin Kupit *coup de grace*, ky më në fund vendosi të ndërmerre një aksion kundër gjermanëve.

Gjatë gjysmës së parë të shtatorit, pozita mbeti e turbullt. Forcat e UNÇSH, kryesisht Brigada I, por gjithashtu edhe Brigada III, nisën të afroheshin në Tiranë dhe në rrugën Tiranë-Shkodër, si dhe po i fshinin mbeturinat e zogi-

stëve e të ballistëve drejt veriut në malësitë e Mirditës, që ishte kështjellë katolike dhe e fortë nacionaliste e Gjon Marka Gjonit, një bashkëpunëtor konsekuent i italianëve dhe gjermanëve. Por në të njëjtën kohë forcat që i kishin mbetur Kupit, të inkurajuar nga misioni Concensus II dhe nganjëherë me ndihmën e oficerëve britanikë, organizuan me sukses dy a tre prita, sulme dhe shkatërrime të pozicioneve e të kolonave gjermane në rrugën Tiranë-Shkodër.²⁵) Madje edhe një grup ballistësh, me nja 200 veta, sulmoi dhe shkatërroi një kolonë gjermane më 10 shtator, dhe Mithat Frashëri e Abaz Ermenji kërkuan që misioni Concensus ta regjistronte këtë aksion dhe t'i furnizonte me armë e municione të reja për njerëzit e tyre.

Komiteti Politik i Forcës Ajrore të Ballkanit, që u mbledh në Bari, u përpoq të përballonte informacionin kontradiktor që vinte nga fushëbetejat. Më 8 shtator protokoli i Komitetit tregon se u shpreh dyshim që Kupi do të kishte luftuar ndonjëherë kundër gjermanëve dhe u vu në dukje se kishte një rrezik të mundshëm që të gaboheshin nga aksionet sa për sy e faqe për t'i dhënë atij një mbështetje të qenësishme²⁶). Një ditë më parë i ishte dërguar një mesazh Maklinit, duke e paralajmëruar se UNCSH ishte gati ta sulmonte rrugën Tiranë-Shkodër dhe i kërkonte atij që të bënte gjithçka të mundshme për të parandaluar një ndeshje midis saj dhe forcave të Kupit. U ra në marrëveshje që t'i dërgoheshin udhëzime Palmarit për të rregulluar evakuimin e Maklinit e të Smajlit përmes territoreve partizane «për të raportuar». Xhulian Emeri do të mbetej në krye të misionit, por me udhëzime që të vepronte vetëm me rolin e vëzhguesit. Kupit duhej t'i thuhej se evakuimi bëhej me qëllim konsultimi. Komiteti e mbajti shënim vlerësimin për punën e shkëlqyer të bërë nga Alan Palmeri në bisedimet e tij me Hoxhën. Në mbledhjen tjetër të Komitetit, më 14 shtator, ata u njoftuan se përplasja ndërmjet partizanëve dhe zogistëve, që ata kishin dashur ta parandalonin, kishte ndodhur në Krujë më 8 shtator²⁷). Raporte pak më të ndryshme për atë që kishte ndodhur, ishin marrë nga njëra anë prej Concensus II (Kupi kishte luftuar kundër gjermanëve dhe luftimi po vazhdonte) dhe nga ana tjetër prej Stables (Kupi dhe gjermanët së bashku kishin luftuar kundër partizanëve e këta të fundit kishin fituar). Protokollet e Komitetit për këtë rast janë plot me shprehje dyshimi për Kupin. A mund të vështroheshin «veprimet e vonuara» të tij si kërcënim ushtarak

serioz për gjermanët? Forcat e tij ishin shumë më të vogla se të partizanëve dhe ishin të kufizuara në një zonë të vogël afër bregdetit. Dërgimi i furnizimeve për Kupin, nëse nuk do të kishte vlerë reale ushtarake, vetëm do të ushqente luftën civile. A ishin ato operacione vërtet operacione ushtarake, nën kujdesin e vetë Kupit, apo ishin sulme të vogla sabotimi të ndërmarra nga disa prej pasuesve të Kupit, nën drejtimin e oficerëve britanikë? Ndërrimi i frontit nga Kupi ishte i vonuar dhe me gjysmë zemre, tepër i vogël e tepër i vonuar. Kishte një sugjerim të tipit «Murtaja ka rënë në të dy shtëpitë», pra: a mos duheshin të tërhiqeshin të gjitha misionet nga të dyja palët? Për këtë u dha përgjigje se «LNC ishte në fakt duke kryer operacione luftarake të dobishme kundër gjermanëve dhe nëpërmjet tyre po ndërhynte për të penguar komunikacionet në vend për qëllimet e tërheqjes». U paraqit ideja se ndoshta kapiteni Emeri dhe anëtarët e tjerë të misionit Concensus II gjithashtu duheshin tërhequr. Në fund, Komiteti vendosi se duheshin bërë sa më shpejt të ishte e mundur përçapjet për evakuimin e Maklinin e të Smajlit dhe se i duhej dërguar një sinjalizim Maklinin, duke i thënë se nuk do të viheshin furnizime në dispozicion të Kupit (dhe kjo do të thoshte gjithashtu se nuk do të dërgohej asgjë në përgjigje të kërkesës, që Maklini kishte dërguar më 10 shtator për disa furnizime me municione për ballistët)²⁸).

Ky ishte fundi i rrugës përse i përket shansit 50:50 që Kupi mund të ishte çelësi për një kryengritje kombëtare, që Maklini e kishte shqyrtuar në Londër në janar. Por misioni Concensus II u zvarrit ende deri në fund të tetorit. Miratimi i FO për të tërhequr gjithë misionin dhe jo vetëm Maklinin e Smajlin «për konsultime», nuk depërtoi deri në mes të tetorit²⁹). Është e kuptueshme që Maklini dhe kolegët e tij nuk kishin ndërmend të kalonin përmes territorit të partizanëve, nëse do të kishin mundësi t'i shmangeshin. Ata kishin frikë, dhe padyshim me të drejtë, se partizanët do ta kthenin në spektakël disfatën e tyre. Sic e thotë Xhulian Emeri në «Bijtë e Shqipës»: «Prandaj ne i shumëfishuam iustificimet për vonesën, duke i zmadhuar vështirësitë e udhëtimit në periudhën kur lumenjtë kishin vërshuar dhe duke u gjetur kundërshtime të gjitha takimeve që na propozonte kuartieri ynë i përgjithshëm».³⁰)

Më në fund, Bari pranoi që zgjidhja më e mirë do të ishte një evakuim nëpërmjet detit nga bregu. Përfundimisht

kjo u arrit më 26 tetor. Deri atëhere misioni Concensus II ishte nën kujdesin e zogistëve, ballistëve dhe, për shumicën e kohës, nga gjenerali Prenk Previsi, deri kohët e fundit komandant i xhandarmërisë shqiptare. Pati çështje të dhimbshme për fatin e Abaz Kupit e të nëpunësve dhe punonjësve të fushimeve të misioneve të ndryshme në Shqipëri, Itali dhe Azinë qendrore, evakuimin e të cilëve e kishte kundërshtuar Bari. Qëndrimi negativ i Barit u atribuohet tensioneve të ngatërruara që kishin lindur në Shqipëri e në Bari për shkak të dështimeve në nxjerrjen jashtë vendit të misioneve me shpejtësi³¹). Kur vështirësia për Kupin iu paraqit Anton Idenit, ai udhëzoi që Kupi duhej të nxirrej jashtë pa u bërë e dukshme se Qeveria e Madhërisë së Tij ishte ngatërruar në këtë operacion³²). Në fund Kupi e zgjidhi problemin duke gjetur një barkë dhe u evakua më 6 nëntor. Ai u bë subjekt i shumë konsultimeve të nivelit të lartë, deri sa më në fund u largua nga Italia për në Egjipt dhe kështu mbeti në mërgim deri në fund të vitit.

Ndërsa po luhej akti i fundit i dramës së Kupit, një tragjedi tjetër po ndodhte në veri, në Kosovë. Vëllezërit Kryeziu, Ganiu, Seidi dhe Hasani ishin të vetmit nacionalistë në Shqipërinë e kohës së Luftës, që ishin kapur me gjithë zemër pas idesë për ta ndërtuar Shqipërinë e ardhshme duke luftuar kundër gjermanëve. Ata iu shmangën qëndrimit kundër partizanëve që mbanin nacionalistët e tjerë dhe u përpoqën të mbanin marrëdhënie bashkëpunimi me LNÇ, kryesisht nëpërmjet anëtarëve më të moderuar e më kompleksë të udhëheqjes së LNÇ, në veçanti Mustafa Gjinishit. Seid Kryeziu shoqëroi Kupin dhe misionin Concensus II gjatë korrikut e gushtit dhe u përpoq fort që të ndikonte mbi Kupin për të ndërmarrë aksione kundër gjermanëve, ashtu siç kërkohej nga britanikët. Kur Kupi e shpalli vendimin e tij të vonuar për të sulmuar gjermanët në fillim të shtatorit, Seidi pasi kishte bërë gjithçka kishte mundur me Kupin, u kthye në veri në Kosovën e tij amtare. Toni Simkoks, që ishte shkëputur nga misioni Stables në korrik, ishte vendosur ndërkohë përfundimisht si oficer ndërlidhës britanik me Gani Kryeziun. Simkoksi që në gjendje të rregullonte hedhje nga ajri për të pajisur forcat e Ganiut. Ata bënë disa sulme çetash kundër njësisve gjermane e të xhandarëve dhe nga mesi i gushtit Ganiu që në gjendje të sulmonte e të shkatërronte instalimet e minierave të kromit në Kam e në Kepenek afër Gjakovës. Nga mesi i shtatorit forcat e Kryeziut ishin bërë aq të forta sa të ndërmerrnin një sulm të gjerë kundër gjermanëve në Gjakovë.

Suksesi i vëllezërve Kryeziu shihej me xhelozin nga partizanët kosovarë, të udhëhequr nga Fadil Hoxha dhe Mehmet Hoxha. (Natyra e çështjes së Kosovës për PKJ dhe PKSHP dhe pasojat e saj për marrëdhëniet midis tyre është paraqitur në kreun 1 dhe 6). Partizanët e Kosmetit nuk gëzonin popullaritet në popullsinë kryesisht shqiptare të Kosovës, dhe nuk kishin arritur gjë të madhe ndërmjet saj. Lëvizja e Kryezinjve, po të vazhdonte, mund të çonte në një kryengritje të përgjithshme nacionaliste të kosovarëve, por kjo mund të ishte shqetësuese e ndoshta e rrezikshme, ndonëse në mënyrë të ndryshme, për udhëheqësit komunistë si në Jugosllavi edhe në Shqipëri. Pasi u hoq qafe Mustafa Gjinishi, taktika e përdorur nga PKSHP, që punonte nëpërmjet UNÇSH, kur kishte të bënte me krerët e moderuar në Shqipërinë e Veriut, të cilët nuk mund të llogariteshin si bashkëpunëtorë të gjermanëve ose që ishin pjesëmarrës realë e të mundshëm të rezistencës, ishte që të grumbullonte një forcë më eprorë dhe pastaj t'u bënte thirrje që të bashkoheshin me Lëvizjen Nacionalçlirimtare dhe t'i bënin pasuesit e tyre të rekrutoheshin në UNÇSH. Në rast se ata kundërshtonin që të eliminonin veten me këtë mënyrë, ata eliminoheshin me forcë. Disa shpëtuan, disa u vranë dhe disa u kapën rob. Kjo taktikë ishte zbatuar tashmë në luginën e Drinit me Muharrem Bajraktarin dhe të tjerët, me të cilët ne kishim pasur kontakte dimrin e kaluar. Tani ajo po zbatohet me Kryezinjët. Forcat e Kosmetit u përforcuan me Brigadën V partizane, e cila kishte kaluar drejt veriut nga Dibra. Më 19 shtator në Dobrej, Simkoxin e mbajtën me forcë partizanët e Brigadës V dhe e nisën drejt jugut për t'ia dorëzuar misionit të kuartierit britanik me partizanët. Seid Kryeziu u ftua për blsedime dhe pastaj e detyruan të shkonte në jug për t'u takuar më Enver Hoxhën. Në variantin e Emerit për këto ngjarje, Gani Kryeziu që mbeti pa furnizimet britanike, u detyrua shpejt t'i shpërndante forcat e veta. Sipas versionit të Enver Hoxhës, Ganiu u kap nga partizanët të nesërmen pasi u ndalua Simkoxi. Sipas Emerit, kur Seid Kryeziu arriti në shtabin e partizanëve në jug, Enver Hoxha dhe kolegët e tij i ofruan t'i paguanin një çmim të lartë nëpërmjet vendeve në qeveri për ta bërë Kryeziun që të bashkohej me ta (ka të ngjarë që kjo t'i jepte një kartë me vlerë PKSHP kundrejt PKJ gjatë trajtimit të problemit të Kosovës, nëse Lëvizja Nacionalçlirimtare Shqiptare do të ishte e aftë t'i fuste në ekipin e vet udhëheqës këta krerë nacionalistë shqiptarë të njohur nga Kosova). Seidi re-

fuzoi dhe kuartieri i Misionit Ndërlidhës Britanik që në gjendje ta evakuonte atë në Itali. Emeri thotë se Gani dhe Hasan Kryeziu ranë në duart e jugosllavëve. Hasani u zhduk, kurse Ganiut iu bë gjyqi dhe e burgosën.

Enver Hoxha na tregon një histori të ndryshme nga kjo. Sipas tij, udhëheqja shqiptare kishte ndër mend t'i nxirrte në gjyq Seid dhe Gani Kryeziun, por u pengua nga një ndërhyrje e prerë e jugosllavëve. Në shtabin e Enver Hoxhës, nga fundi i gushtit, kishte ardhur një i dërguar i ri i Titos. Ky ishte koloneli Velimir Stojniçi, i cili erdhi si kryetar i misionit ushtarak jugosllav në Shtabin e Përgjithshëm të UNÇSH. Ai shoqërohej nga Nijazi Dizdareviçi. Kur Stojniçi dëgjoi se partizanët shqiptarë po mbanin Seid dhe Gani Kryeziun, ai kërkoi që ata t'u dorëzoheshin autoriteteve jugosllave, meqë ata ishin kosovarë dhe Kosova ishte pjesë e Jugosllavisë. Stojniçi kërcënoi se do të mbliidhte plaçkat e do të ikte, nëse Enver Hoxha nuk i hapte rrugë. Këtë e bëri Hoxha siç duhej. Ai pohon në shkrimet e tij se Titoja donte që Seidi të shkonte në Itali, me qëllim që të fitonte mbështetjen amerikane dhe britanike për qëllimet e tij, Titos, në Kosovë: «për të siguruar armë për Kosovën nga aleatët», siç e thotë Hoxha³³). Kështu Seidi u lejua të largohej për në Itali, ndërsa Ganiu mbeti në duart e partizanëve në Kosovë.

Po në këtë kohë, ndodhi edhe episodi i vrasjes së Llazar Fundos, të akuzuar si komunist tradhtar (shih kreun 1). Fundoja i kishte takuar vëllezërit Kryeziu kur ishte i internuar nga italianët dhe ishte pranuar prej tyre si një lloj këshilltari politik i krahit të majtë. Ata e vunë atë pranë Toni Simkoksit si oficer ndërlidhës dhe përkthyes. Kështu që e kapën partizanët bashkë me Simkoksën. Sipas Enver Hoxhës, koloneli Stojniç kërkoi që Fundoja gjithashtu t'u dorëzohej autoriteteve jugosllave, por Hoxha refuzoi të hapte rrugë në këtë rast, sepse nuk kishte dyshim që ai ishte nga Shqipëria. Sipas mënyrës së të menduarit konspirative dhe me dyshime të Enver Hoxhës, prania e Fundos me Misionin ndërlidhës britanik ishte dëshmi tjetër e qëllimit të britanikëve për të ulur poshtë partizanët dhe, prapa partizanëve, Partinë Komuniste Shqiptare dhe vetë Enver Hoxhën. Për Simkoksën dhe oficerët e Concensus II, si dhe për këdo nga ana e britanikëve që ishin angazhuar për çështjen «nacionaliste», vrasja brutale e Fundos ishte dëshmi e natyrës së papranueshme të pushtetit partizan. Në fakt, episodi i Fundos ishte një rast i komunizmit që gllabëron të vetët: ky ishte një likuidim midis shokëve ose, në këtë rast, ish shokëve. Në një shënim në fund

të historisë, Enver Hoxha kërkon falje për mënyrën me të cilën u trajtua Toni Simkoks, por vetëm me vonesë, në mes të tetorit.

Me shkatërrimin e lëvizjes Kryeziu, u likuidua e vetmja rezistencën efektive jo komuniste kundër gjermanëve në veri të Shqipërisë. Mund të shihet në retrospektivë që një lëvizje e rezistencës nacionaliste shqiptare në Kosovë ka mundësi të ishte e paracaktuar që të përfundonte me katastrofë, kur Jugosllavia të rivendosej në kufijtë e paraluftës, cilidoqoftë regjimi i Beogradit. Natyra fatalisht e patrajtueshme e problemit të Kosovës, me sa duket, nuk ka qenë vlerësuar si para edhe gjatë luftës, dhe pa dyshim kjo i detýrohej faktit që Shqipëria e populli i saj dhe interesat e problemet e tyre në atë kohë nuk kishin ushtruar asnjë ndikim në vetëdijen e qeverive të fuqive kryesore. Përpyekja britanike për të nxitur rezistencën kundër gjermanëve në Kosovë u dukej oficerëve ndërlidhës britanikë të asaj kohe si një nga aventurat më premtuese që u hapej përpara. Seksioni D dhe SOE i nisën veprimtaritë atje më 1940, Peter Kemp u përpoq të fillonte diçka atje në kapërcyellin e viteve 1943-1944 dhe Toni Simkoksi arriti të niste diçka në verën e vitit 1944. Me ardhjen në pushtet të PKJ në Jugosllavi dhe të PKSH në Shqipëri, kjo përpjekje ishte me siguri e dënuar, por ndoshta ajo ishte e dënuar nga vetë natyra e problemit të Kosovës, si edhe nga ideologjia e qeverive që do të vinin në Beograd e në Tiranë.

Komiteti Politik në Kuartierin e Forcës Ajrore të Ballkanit e kishte përkrahur tërheqjen e misionit Concensus II nga Shqipëria që nga fillimi i gushtit, por kjo ishte ndaluar nga Ministria e Jashtme. Vendimi për të thirrur Maklinin e Smajlin për konsulime u lejua nga FO në ditët e para të shtatorit, por Xhulian Emeri dhe pjesa tjetër e misionit duhej të mbeteshin me cilësinë e vëzhguesit (një pozitë e pamundshme në rrethanat e Shqipërisë të asaj kohe). Mbledhja e 32-të e Komitetit FO e SOE u mbajt në Londër më 15 gusht. Në përmbledhje e procesverbaleve të tij tregon që aty u paraqit një raport, se ishte braktisur ideja për t'i sjellë së bashku në Bari FNÇ dhe Kupin, porse një oficer ndërlidhës duhej të mbahej te Kupi³⁴). Mbledhja e 33-të u mbajt një muaj më vonë, më 19 shtator, dhe këtë radhë u njoftua se Maklini dhe Smajli po vinin për diskutimet³⁵). Enver Hoxha mund të mendonte se e kishte fituar davanë me tërheqjen e tyre, por kjo ndoshta nuk kishte shumë rëndësi.

Po atë ditë, më 19 shtator, Sër Orme Sarxhenti mbajti një mbledhje në FO, në të cilën ishin të pranishëm përfaqësues të Ministrisë së Luftës, SOE dhe të MI6. Procesverbali i tij është më datën 26 shtator³⁶). *Fail accompli* e dominimit të partizanëve, e si pasojë të komunistëve në Shqipëri, më në fund u pranua, por me rezervat dhe kushtet që ishin të paracaktuara t'i bënin marrëdhëniet e britanikëve me drejtuesit e rinj të Shqipërisë në rastin më të mirë joentuziaste dhe në rastin më të keq të acaruar. Si hapa praktikë u rekomanduan që i gjithë misioni Concensus II të tërhiqej por jo shumë shpejt, me qëllim që të mos tregohet dobësi përballë kërkesave të Enver Hoxhës; gjenerali Uillon, komandanti suprem i Aleatëve, mund ta «thërriste» Enver Hoxhën për diskutime në Itali për çështjet ushtarake, duke iu shmangur politikës, meqë në këtë fazë nuk kishte asnjë nevojë që të njihet FNC si qeveri e përkohshme; gjenerali Uillon duhej t'i kërkonte FNC të formonte një front të bashkuar me të gjitha palët shqiptare dhe «t'ia bënte të qartë Hoxhës se ne nuk do ta lejojmë luftën civile në Shqipëri», duke vënë si kusht që do të ndërpritej përkrahja britanike dhe madje nuk do të njihet pavarësia e Shqipërisë në konferencën e paqes; dhe së fundi, nëse Hoxha do t'i përgjigjej këtij trajtimi, misioni i kuartierit britanik në Shqipëri mund të përforohej duke dërguar atje një oficer të rangut të lartë, ndërsa dërgimi i një agjenti politik, që do të përfaqësonte FO, u la për ta shqyrtuar më vonë. Z. Iden ka shënuar më 30 shtator: «Për ne është si të ecim në telin e pelivanit. Por nuk shoh asnjë gjë tjetër që do të mund të bënim»³⁷). Ai kërkoi që të përgatitej një protokoll i shkurtër për kryeministrin. Ai u nxor nga procesverbali i Sër Ormes duke i lënë mënjanë rekomandimet: Iu vu data 5 tetor dhe ka këtë përmbajtje:

«1. Tani kur ka mundësi që të ndodhë tërheqja e gjermanëve nga Ballkani në një datë jo shumë të largët, është bërë e nevojshme që të shqyrtohen situata në Shqipëri dhe vijat e politikës sonë të ardhshme.

2. Forca më e madhe në Shqipëri në këtë kohë është FNC. (Lëvizja Nacionalçlirimtare). Ashtu si partizanët në Jugosllavi dhe EAM në Greqi, ai është nën kontrollin mbizotërues të komunistëve, ndonëse komunistët janë ndoshta një pakicë ndërmjet anëtarëve të thjeshtë. FNC nën udhëheqësin e tij Enver Hoxha, është e vetmja organizatë që u ka

bërë rezistencë serioze si italianëve edhe gjermanëve, dhe të gjitha furnizimet që ne kemi dërguar në Shqipëri gjatë pak muajve të fundit u kanë shkuar atyre.

3. E vetmja lëvizje tjetër rezistence është lëvizja e Legalitetit nën Abaz Kupin. Kupi ka qenë oficer xhandarmërie dhe ende predikon besnikërinë ndaj mbretit Zog. Nuk ka arsye për të dyshuar për integritetin e tij personal, por për shumë muaj ai nuk ka ndërmarrë asnjë aksion pozitiv kundër gjermanëve dhe është më tepër i shqetësuar për të ndaluar që FNÇ të fitojë kontrollin mbi gjithë vendin. Ndonëse ai personalisht nuk bashkëpunon me armikun, ka qenë në kontakt me «nacionalistët», duke përfshirë shumë anëtarë të ish qeverisë kukull. Si Kupi edhe nacionalistët tani janë të preokupuar që të sigurohen sërish tek ne dhe kanë premtuar të luftojnë kundër gjermanëve. Ata kanë ndërmarrë disa aksione të vogla, por ata nuk kanë sy të na japin ndihmë të rëndësishme ushtarake dhe qëllimi i tyre që kërkojnë mbështetjen tonë, është pa dyshim të forcohen për vete, që të jenë në gjendje të diskutojnë kontrollin e ardhshëm të Shqipërisë me FNÇ, pasi të tërhiqen gjermanët.

4. Kështjella kryesore e FNÇ ka qenë gjithmonë në Shqipërinë e Jugut. Qendra dhe veriu i vendit janë shumë e shoqërore të krahut të majtë. Megjithatë, kohët e fundit, FNÇ i ka shtrirë operacionet e veta drejt veriut dhe ka gjetur çuditërisht pak rezistencë. Nëse tërheqja e gjermanëve nga Shqipëria do të ndodhë në të ardhmen e afërt, nuk ka të ngjarë që Kupi dhe nacionalistët ose çfarëdo grupi tjetër do të jetë në gjendje ta kundërshtojë efektivisht qëllimin e padyshimtë të FNÇ për të marrë kontrollin e gjithë vendit. Dhe as duket që të ketë ndonjë rrugë nëpërmjet së cilës të mund të pengohet kjo, meqë FNÇ është tashti mjaft i fortë sa të bëjë edhe pa ndihmën tonë, po të jetë nevoja.

5. Interesat tanë në Shqipëri janë të kufizuar, por ne jemi zotuar që të përkrahim rivendosjen e pavarësisë në Shqipëri pas lufte dhe për këtë qëllim ne do të kërkojmë rivendosjen e menjëhershme të ligjit e të rendit dhe vendosjen e një qeverie të qëndrueshme në shkallë të arsyeshme. Do të ishte gjithashtu kundër interesave tona që Shqipëria të kalonte tërësisht nën influencën sovjetike dhe do të kishte një farë rreziku për këtë, nëse vjen në pushtet qeveria e FNÇ.

6. Por në këto rrethana, sipas mendimit tim, nuk ka alternativë tjetër veçse të pranohet perspektiva për FNÇ

të fitojë kontrollin mbi Shqipërinë pas lufte dhe t'i përqendrojmë përpjekjet tona në përforcimin e pozitës sonë me ta, me qëllim që t'i kundërvihemi influencës ruse. Unë ia kam paraqitur këto pikëpamje Makmilanit dhe i kam sugjeruar disa veprime të menjëhershme që mund të ndërmerreshin.

7. Një nga rezultatet e marrjes së kontrollit nga FNC, është se nuk do të ketë ndonjë mundësi të menjëhershme për mbretin Zog që të rifitojë fronin e tij pas lufte, meqë udhëheqësit e FNC e kundërshtojnë ashpër. Në muajt e fundit mbështetja për mbretin Zog ndërmjet shqiptarëve jashtë shtetit ka ardhur duke u rritur, por përkrahësit e tij brenda vendit kanë ardhur duke rënë dhe përveç Kupit e pasuesve të tij të paktë, nuk ka një grup me rëndësi në Shqipëri, i cili të donte kthimin e mbretit. Megjithatë, është gjithnjë e mundshme që qeveria e FNC, në rast se do të krijohet, do ta bëjë veten jo popullore dhe shpejt a vonë do të përmbysset. Në këtë rast ndjenjat do të zhvendosen në favor të mbretit Zog. Nga pikëpamja jonë kjo mund të jetë një avantazh, meqë Zogu ka më pak të ngjarë që të bjerë nën influencën sovjetike, në krahasim me udhëheqësit e FNC. Edhe nëse ne e pranojmë një qeveri të FNC, ne atëhere duhet të shmangemi që të mos angazhohemi thellë me ta, aq sa pozita jonë në Shqipëri të mund të dobësohet, nëse ata do të përmbysen dhe do të kthehet mbreti Zog³⁸).

Rekomandimet që kishte bërë Sër Orme ishin të palidhura me gjendjen në Shqipëri për disa arsye. Asgjë nuk mund të fitohej duke ecur me ngadalësi për tërheqjen e misionit Concensus II. Enver Hoxha do ta shihte tërheqjen e tij si një shenjë realizmi dhe jo të dobësisë, por ai do ta vështronte vazhdimin e qëndrimit si një shenjë se Britania ende ushqente shpresa se do ta pengonte Lëvizjen Nacionalçlirimtare dhe se do t'i shpëtonte nacionalistët. Asnjë nga pala britanike nuk ishte në gjendje që «t'ia mblidhte Hoxhës». Lufta civile në fakt tashmë kishte mbaruar, duke përfunduar me fitoren e plotë të partizanëve dhe nuk do të kishte kuptim që të vazhdohej t'i bihej avazit të luftës civile. Nuk kishte asnjë shans që Hoxha të ndërronte mendje për një front të bashkuar ose nacional për shkak të kërcënimit britanik për të rënë në ujdi. Nga pikëpamja afatshkurtër ose madje dhe afatmesëm, ishte krejt jorealiste të mendohej se Lëvizja Nacionalçlirimtare do të përmbyste pikërisht në momentin kur ajo ia kishte dalë mbanë me sukses të përmbyste gjithë të tjerët.

Kur rekomandimet iu dërguan me telegram Kazertës, gjenerali Uillon dhe zoti Makmilan e vunë në pikëpyetje çështjen për të bërë bisedime jopolitike me Enver Hoxhën, meqë mesazhi drejtuar atij do të ishte në thelb politik³⁹). Më në fundi, ky rekomandim u la dhe Enver Hoxha nuk u ftua në Itali. U vendos që çështja e përfaqësimit britanik do të zgjidhej, duke dërguar një mision ushtarak nga fundi i dhjetorit, të kryesuar nga një gjeneral brigade, por me shtab nënkolonelin Alan Palmer dhe me majorët Viktor Smithin dhe Alan Hejrin. Kjo do të përbënte një ndryshim mjaft modest lidhur me marrëveshjet ekzistuese dhe zor se ishte llogaritur për të arritur objektivin që të përforcohej pozita jonë me FNC, që e kishte rekomanduar raporti i Sër Ormes. Por edhe vetë rekomandimi ishte me gjysmë zemre. I vetmi rekomandim që u vu menjëherë në zbatim ishte ai lidhur me misionin Concensus II. Më 15 tetor Filip Broudi njoftoi Kazertën (ministrin rezident) se «sipas udhëzimeve të komandantit Suprem Aleat, i gjithë misioni britanik me major Kupin po tërhiqej menjëherë»⁴⁰). Në fakt u deshën edhe dy javë përpara se të bëhej realisht tërheqja.

Vendimi për ta lënë Kupin e për të pranuar faktin e pushtetit të partizanëve duhej të ishte një pikë kthese në marrëdhëniet anglo-shqiptare. Për fat të keq, vendimi u mor shumë me vonesë, u megjullua dhe u bë pa qejf. Operaconet e SOE britanike në Shqipëri faktikisht përfunduan në këtë pikë dhe nisën marrëdhëniet e pasluftës të Britanisë me Shqipërinë. Si përfundimi dhe fillimi ishin të varfër. SOE u kishte dhënë një ndihmë të rëndësishme materiale partizanëve, por ata e ndienin se ata e kishin nxjerrë atë prej nesh me përpjekjet e tyre të pamohueshme dhe se, po të kishte parë punën e vet Britania, ata nuk do të kishin fituar. Britania duhej të zinte një vend të nderuar, qoftë edhe ideologjikisht të huaj, në Shqipërinë e re që po merrte tani formë, por Britania ngurroi dhe dukej qartë se nuk pajtohej me ndryshimin e pushtetit që kishte ndodhur. Në rastin e Jugosllavisë, kryeministri Uinston Çurçilli e pranoi në kohën e duhur realitetin e ardhjes në pushtet të mareshalit Tito dhe marrëdhëniet që vendosën gjenerali i brigadës Ficroj Maklin dhe oficerët e tij me Titon e me kolegët e tij i kanë hyrë në punë shumë mirë si Britanisë edhe Jugosllavisë deri më sot, përmes shumë peripecive. Asgjë e krahasueshme me këtë nuk ndodhi në rastin e Shqipërisë. *Britania për një kohë tepër të gjatë vuri bast për një humbës dhe prandaj humbi kredinë e fituesit.* Dora e djathtë e Britanisë, ushtarakët dhe SOE,

kujdesi i të cilëve më 1944 ishte të mundej Gjermania, e gjetën veten gjithnjë e më tepër të angazhuar me partizanët, të cilët luftuan me të vërtetë kundër gjermanëve, por dora e majtë e Britanisë, Ministria e Jashtme, misioni Concensus II dhe një a dy BLO të tjerë me nacionalistët, kujdesi i të cilëve më 1944 ishte tashmë që të përmbanin përparimin e komunizmit në Evropën Lindore përpara se sa vala e nazizmit të ndalej përfundimisht, gjithnjë e më tepër u angazhuan në përpjekjet për të ndaluar përparimin e partizanëve, madje edhe atëherë kur ishte bërë qartas i pandalshëm dhe ishte i destinuar të fitonte, Enver Hoxha e ndërtoi karrierën e tij mbi bazën e politikës në prag të katastrofës, duke qenë gjithnjë i gatshëm për ta provokuar ose për ta precipituar një krizë atëherë kur nuk e kishte ndonjë të gatshme, sa herë që i duhej për qëllimet e manovrimit politik; qoftë kundër kolegëve, qoftë kundër kundërshtarëve. Është e pamundur të shkruhet një histori hipotetike dhe askush nuk mund të thotë çfarë mund të kishte ndodhur, nëse marrëdhëniet e Shqipërisë pas lufte me Perëndimin do të kishin filluar mbarë. Por është e mundur të thuhet me një farë besimi se është për të ardhur keq, dhe ka qenë e panvejoshme, që Britania t'i siguronte Hoxhës ekstremizmin e tij të mbështetur në forcat e veta kundrejt djallit të parë të huaj, duke i paraprirë në kohë madje edhe Jugosllavisë në këtë rol.

Shënimet

1. PRO, FO, 371/43551.
2. PRO, FO, 371/43551, Telegram i Barit për Kazertën nr. 43 i 2 gushtit.
3. PRO, WO, 204/8462.
4. PRO, FO, 371/43563, AFHQ, dokumenti PC (44) 88.
5. PRO, FO 371/43551, Telegram i Barit për Kazertën, nr. 57.
6. PRO, FO, 371/43551, Telegram i Kazertës për FO, nr. 124 i 12 gushtit.
7. PRO, FO, 371/43551.
8. PRO, FO, 371/43551, Telegram i FO për Kazertën, nr. 346.
9. PRO, FO, 371/43551, Telegram i Kazertës për Barin, nr. 25 i 12 gushtit.
10. PRO, FO, 371/43551, Telegram i FO për Kazertën, nr. 239, i 5 gushtit.
11. PRO, FO, 371/43551, Telegram i Barit për Kazertën nr. 70.
12. PRO, FO, 371/43552, Telegram i Barit për Kazertën, nr. 108.
13. PRO, FO, 371/43553.

14. PRO, FO, 371/43552, Telegram i Barit për Kazertën, nr. 109 i 21 gushtit dhe telegram i FO për Kazertën nr. 465.
15. PRO, WO, 204/8462 dhe gjithashtu FO, 371/43552.
16. PRO, WO, 204/8462 dhe Air 23/8270, procesverbalet e mbledhjes së nëntë të Komitetit Politik të BAF dhe të mbledhjes së posaçme më pas me delegatët e UNCSH.
17. PRO, WO, 204/8462 dhe Air 23/8270, procesverbalet e mbledhjes së 10-të të Komitetit Politik të BAF.
18. PRO, FO, 371/43552, telegram i Barit për Kazertën, nr. 177 i 2 shtatorit.
19. PRO, FO, 371/43553, telegram i Barit për Kazertën nr. 192 i 6 shtatorit.
20. PRO, FO, 371/43553, telegram i Barit për Kazertën nr. 195. Shënimi i Antoni Idenit ishte mbi telegramin e Barit nr. 194.
21. PRO, FO, 371/43551, telegram i Barit për Kazertën, nr. 80 i 12 gushtit.
22. PRO, FO, 371/43551, telegram nga Londra për AFHQ i 15 gushtit.
23. PRO, FO, 371/43551.
24. Amery (148; 265).
25. PRO, FO, 371/43566, telegram i Barit për Kazertën nr. 215 i 14 shtatorit. Edhe Smiley (1984) e Amery (1948). Një përmbledhje kronologjike e raporteve të marra në Bari rreth veprimtarisë së Kupit del në PRO, Air 24/110.
26. PRO, WO, 204/8462 dhe Air 23/8270, procesverbalet e mbledhjes së 11-të të Komitetit Politik të BAF.
27. PRO, WO, 204/8462 dhe Air 24/110, procesverbalet e mbledhjes së 12-të të Komitetit Politik të BAF.
28. PRO, FO, 371/43555, parafrazimi i një telegrami nga Komandanti Ajror i BAF për AFHQ më datën 14 shtator ref. BAF/256 dhe DO, 371/43566, telegram i Barit për Kazertën nr. 216 i 14 shtatorit.
29. PRO, FO, 371/43566, telegram i Barit për Kazertën nr. 304 i 10 tetorit dhe 324 i 15 tetorit.
30. Amery (1948; 314).
31. PRO, FO, 371/42566, telegram i Barit për Kazertën nr. 377 i 28 tetorit.
32. PRO, FO, 371/425661, telegram i Romës për FO nr. 758 i 31 tetorit.
33. Hoxha (1928); 326-333).
34. PRO, FO, 371/43551.
35. PRO, FO, 371/43555.
36. Po aty.
37. Po aty.
38. Po aty.
39. PRO, FO, 371/43556, telegram i Kazertës për FO, nr. 509 i 11 tetorit.
40. PRO, FO, 371/43566, telegram i Barit për Kazertën nr. 324.

Kreu 13

Përfundimi i luftës partizane: fillimi i sundimit komunist

Ndryshe nga korriku e gushti, muaji shtator ishte pa zhvillime ushtarake të mëdha me natyrë dramatike. Kjo mund të shpjegohet pjesërisht me faktin që Enver Hoxha dhe kolegët e tij më eprorë po bëheshin shumë të preokupuar me çështjet politike, meqë nisën përgatitjet për sesionin e dytë të Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar. Ai ishte planifikuar për tetorin dhe ata kishin synim që ky të bëhej rasti për ta shpallur veten si Qeveria Demokratike e Shqipërisë. Ata po përgatiteshin gjithashtu për Plenumin II të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Shqipërisë, që do të mbahej në nëntor. Ai do të përcaktonte kush do ta drejtonte makinën e Partisë dhe kush do të drejtonte qeverinë. Kojat që viheshin në kartë ishin të larta për vetë Enver Hoxhën, që ishte *de facto supremo*, dhe për këdo që mund ta ngushtonte atë ose t'i kufizonte pushtetin. Muaji shtator ishte një kohë për manovrimin përgatitor dhe luftën e brendshme politike, të fshehur nga bota e jashtme dhe, natyrisht, nga oficerët anglezë në Shqipëri. Lufta e brendshme me aq sa e ka lejuar Hoxha informacionin për të që të botohej shumë kohë më pas ngjarjeve, do të përshkruhet më poshtë në këtë krye.

Një arsye tjetër që muaji shtator ishte relativisht pa ngjarje, ndoshta mund të gjendet në një raport nga seksioni shqiptar në Bari me datën 5 tetor¹). Aty ata kanë vënë në dukje se Korpusi I partizan ishte ndodhur pa municione në javën e tretë e të katërt të shtatorit. Kjo do të shpjegonte

ngathësinë e dukshme në ndjekjen e zogistëve nga Divizioni I, pasi i dëboi ata nga Kruja më 8 shtator, si dhe natyrën vetëm me tentativa të aksioneve të partizanëve rreth Tiranës dhe kundër rrugës Tiranë-Shkodër. Megjithatë ka dëshmi se mungesa e municioneve ishte më tepër relative se sa absolute. Brigada V nuk kishte prapambetje në lëvizjet drejt Kosovës dhe në shkatërrimin e vëllezërve Kryeziu e pasuesve të tyre. Në të vërtetë, mësymja drejt Kosovës duket se ishte detyra më e rëndësishme e Korpusit I në shtator, pasi u flak jashtë Kupi.

Njoftohej se Brigada V, bashkë me grupin partizan të Kosovës, ishte aktive kundër trafikut gjerman në rrugën Kukës-Prizren nga 3 shtatori. Kukësi ishte në Shqipërinë e paraluftës, Prizreni ishte në Kosovë. Kapja e majorit Simkoks ndodhi më 19 shtator në Dobrenjë, dhe Hoxha bën kujdes në rrëfimin e tij për ngjarjen që ta shpjegojë se kjo ndodhi në Shqipëri, në Shqipërinë e paraluftës. Siç duket, nuk ka ndonjë dyshim që Brigada V lëvizte lirisht tutje e tëhu përmes kufirit të vjetër në këtë kohë, duke i përdorur partizanët si mbulesë, në rast se do të ngriheshin kundërshtime nga pala jugosllave. Njoftohet se forcat e Korpusit I kishin kapur Prizrenin më 4 tetor, por është mjaft kureshtarë që historia e PKSH deklaronte se Brigada V dhe III kaluan në Kosovë më 5 tetor³⁾. Ndoshta 5 tetori është data, në të cilën Titoja dhe kolegët e tij arritën një lloj marrëveshjeje zyrtare me Enver Hoxhën dhe PKSH, që këto brigada duhej t'i jepeshin hua komandës jugosllave për t'u dislokuar në Kosovë, ku forcave serbe dhe forcave të tjera joshqiptare nuk mund të pritej që t'u jepej mirëseardhja si çlirimtarë.

Nuk është shpjeguar as nga pala shqiptare dhe as nga pala jugosllave përparësia e madhe që i është dhënë gësitjes për të siguruar që njësitë partizane shqiptare të luanin një rol kryesor në «çlirimin» e Kosovës. Historia zyrtare e PKSH thotë vetëm se «me kërkesën e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë», një numër kuadrosh të PKSH u dërguan për të organizuar partinë dhe luftën kundër pushtesve fashistë në Kosovë dhe në Rrafshin e Dukagjinit³⁾. Kjo me sa mund të mendohet, u referohet agentëve të PKSH, që kishin për detyrë të përpiqeshin të siguronin mbështetje për partizanët e Kosmetit gjatë luftës. Është e qartë se dy brigadat e UNÇSH që kaluan në Kosovë në tetor 1944, përbënin një ndërhyrje shumë më me peshë. Motivimi nga ana e shqiptarëve mund të ketë qenë shpresa se do të arrihej të

vetëvendosja për kosovarët (vetëvendosja në kuptimin për të zgjedhur midis komunizmit shqiptar dhe komunizmit jugosllav). Historia zyrtare e PKSH pretendon shkoqur:

«PKSH kishte shpallur botërisht se populli kosovar me fitoren e revolucionit në të dy vendet do të fitonte të drejtën të vendoste vetë mbi fatin e tij. Në rast të kundërt ai do të luftonte kundër asaj Jugosllavie që do të përpiqej ta shtypte e ta robëronte»⁴).

Fryma e kësaj fjalie të fundit nuk mund t'i deklarohet Jugosllavisë së mareshalit Tito më 1944. Ajo mund të ketë qenë shprehur në një farë kohe lidhur me Jugosllavinë «kapitaliste». Kjo fjali është shkruar në Historinë e Partisë shumë kohë pas luftës dhe përpiqet të fitojë kredi për një qëndrim më të fortë e më të shprehur, se sa ai që Enver Hoxha dhe kolegët e tij do të kishin guxuar të adoptonin në kohën kur ishin gjerësisht të varur nga Jugosllavia. Në atë kohë, mundet që ekzistonte tashmë mendimi nga pala jugosllave se zgjidhja ideale për problemin e Kosovës do të ishte që Shqipëria të bashkohej me Federatën Jugosllave. Do të kishte shumë gjëra ekuivoke në të dyja palët që të bëhej i mundur bashkëpunimi midis tyre për Kosovën, dhe aq më shumë që ai të kishte sukses.

Forca shqiptare prej dy brigadash, që hyri në Kosovë në tetor, u rrit në dy divizione në dhjetor⁵). Brigadat V dhe III, duke iu shtuar një brigadë e re, Brigada XXV, formuan Divizionin V, gjithashtu një divizion i sapoformuar, Divizioni VI, u dërguan atje nga Shqipëria e Veriut. Ndërsa natyra e marrëveshjes ndërmjet Jugosllavisë dhe Shqipërisë për dërgimin e këtyre njësive nuk është shpjeguar në mënyrë të kënaqshme, Enver Hoxha e ka komentuar tërheqjen e tyre eventuale nga Kosova në një mënyrë e cila, ndoshta, hedh pak dritë për vajtjen e tyre. Ai pretendon se ato, pasi «çliruan» Kosovën pa ndonjë vështirësi të madhe, sepse ata ishin shqiptarë që po «çlironin» shqiptarët, dhe pasi gjatë këtij procesi u ngritën këshillat nacionalçlirimtarë në të gjithë krahinën, Shtabi i Përgjithshëm jugosllav urdhëroi që ato ta ndiqnin armikun thellë në Jugosllavi⁶). Dhe në të vërtetë, shqiptarët llogaritin ndërmjet meritave të tyre luftarake ndjekjen e armikut në Malin e Zi, Sanxhak, Bosnje-Hercegovinë, Serbi dhe Maqedoni. Përballë kësaj, është për t'u çuditur se si mund të pranohet që forcat jugosllave kishin nevojë për përforcime nga UNÇSH, që ishte shumë më e vogël dhe më e dobët në këtë fazë të

luftës. Hoxha thotë se ky qe një truk për t'i larguar brigadat shqiptare nga Kosova, pasi u arrit faza e parë e «çlirimit» të kësaj zone tepër nacionaliste (nacionaliste shqiptare). Pas kësaj, forcat serbe dhe malazeze mund të hynin dhe ta rilidhnin Kosovën me Jugosllavinë, duke prishur gjatë këtij procesi këshillat nacionalçlirimtarë të ngritur nga shqiptarët, ndërsa brigadat shqiptare, pasi i shterruan mundësitë e përdorimit të dobishëm në zonat joshqiptare në Jugosllavi, mund të përcilleshin prapa në atdheun e tyre pa e prekur përsëri Kosovën.

Kjo analizë nuk është e papajtueshme me një version të ngjarjeve që e tregojnë të mërguarit shqiptarë nga Kosova.⁷⁾ Ata thonë se nga fundi i vitit 1943, u themelua në Kosovë e dyta Lidhje e Prizrenit, duke imituar Lidhjen e parë të 1878, me qëllim që të sigurohej kalimi i Kosovës në Shqipëri kur të mbaronte lufta. Nga fundi i vitit 1944, Lidhja e çoi punën në një ndeshje me forcat e Titos dhe i zbrapsi ato. Atëhere Titoja thirri njësitë e UNÇSH dhe këto e «paqësuan» Kosovën me shumë gjakderdhje. Forcat e Titos i zëvendësuan njësitë e UNÇSH dhe e rivendosën autoritetin e Jugosllavisë (të Serbisë) mbi Kosovë në mars 1945.

E vërteta për këto ngjarje pa dyshim do të bëhet më e qartë kur të vijë rasti. Nuk ka vend për dyshime, që Jugosllavia e «përdori» Shqipërinë në raundin e parë të problemit të Kosovës në periudhën pas luftës. Kjo duhet t'i ketë lënë shumë veta nga pala shqiptare, duke përfshirë edhe Enver Hoxhën, të fyer. Të tjerët, nga ana tjetër, si për shembull Koçi Xoxe, shihnin një të ardhme të shkëlqyer në bashkëpunimin me Jugosllavinë, duke e përdorur Kosovën më shumë për t'u bashkuar se sa për t'u ndarë. Enver Hoxha duhet ta ketë ndier nga vjeshta e vitit 1944, se nuk do të kishte vend për të personalisht, nëse Jugosllavia do të fitonte në këtë rrugë. Kështu, farat e grindjes së gjatë pas lufte ndërmjet Shqipërisë e Jugosllavisë tashmë po nxirrnin bisqe në kohën kur lufta në Ballkan po shkonte drejt fundit, dhe bashkë me to ndërthurrreshin farat e spastrimeve të ardhshme në PKSH.

Kalimi drejt veriut dhe në Kosovë i Brigadës III, solli që përbërja e Divizionit II të ndryshonte pothuaj para se vetë divizioni të formohej. Ne na ishte dhënë të kuptonim se ai do të përbëhej nga Brigada III prej Shqipërisë së Mesme, nga Brigada VI prej jugut dhe nga një e re, Brigada XVIII, që po formohej në zonën e Dibrës e të Peshkopisë. Nga fundi i shtatorit, Brigada VII erdhi nga jugu për të zënë vendin e Brigadës III, ndërsa një brigadë e re, Brigada XXII zuri ve-

ndin e Brigadës XVIII. UNÇSH në këtë kohë ishte si një grup qelizash që e riprodhonin veten me shpejtësi, duke u ndarë e duke u rikombinuar. Enver Hoxha dhe shtabi i tij punonin për ngritjen e formacioneve të reja çdo muaj e madje çdo javë, me qëllim që të mbushej zbrazëtia e hapur nga rënia e gjermanëve dhe shpartallimi i «nacionalistëve». Por njësitë e reja kishin pak vlerë luftarake, me përjashtim të faktit që kështu ushtria partizane filloi të dukej numerikisht mbizotëruese. Brigadat e stërvitura mirë, të cilat kishin fituar përvojë betejash gjatë dimrit, pranverës dhe verës vazhduan të shërbenin si maja e shpatës, sa herë dilte nevoja për luftime serioze. Brigada I, e cila ishte njësia themelore e Divizionit I, ishte në vijën e frontit për betejën vendimtare të fundit me gjermanët në Tiranë. Me të ishte Brigada IV dhe ishte Mehmet Sheheu, komandanti i parë i Brigadës I dhe tani komandanti i Divizionit I, që e drejtoi këtë betejë.

Brigada VI dhe VII, që përbënin Divizionin II, gjithashtu morën pjesë në sulmin për t'i dëbuar gjermanët nga Tirana dhe Shkodra. Siç e kemi parë, Brigada V dhe III përbënin bërthamën e forcës që vepronte në Kosovë. Të tjerat nga brigadat më të vjetra (më të vjetra në kuptimin që kishin ekzistuar prej më shumë se katër, pesë ose gjashtë muajsh) morën drejtimin për të pastruar gjermanët nga pikat e përforuara që u kishin mbetur në jug. Gjermanët i përqendruan përpjekjet e tyre në Shqipërinë e jugut, duke u munduar që të mbanin të hapura dy vija kryesore të tërheqjes, njëra nga perëndimi në lindje prej Durrësit, përmes Elbasanit në Strugë, në veri të liqenit të Ohrit, dhe tjetra nga jugu në veri prej Janinës në Greqi, përmes Korçës në Manastir, Maqedoni⁸). Forcat e UNÇSH në jug sulmonin kolonat gjermane në këto rrugë dhe mbanin të rrethuara për t'i raskapitur garnizonet gjermane, që po zvogëloheshin nëpër qytete. Siç u njoftua nga Bari (për Londrën), Brigada XII kishte marrë nën kontroll të plotë bregdetin në jug të Vlorës që nga 21 shtatori. Vetë Vlorë u kap nga partizanët më 15 tetor⁹). Nga gjysma e dytë e shtatorit u bënë të shpeshta aksionet gjatë natës brenda në Tiranë e në Elbasan.

Në këtë kohë, nisi një veprimtari e re e anglezëve, e cila ngjalli dyshime në kuartierin e Enver Hoxhës dhe ndërmjet disa komandantëve të UNÇSH. Kuartieri i Forcave Tokësore në Adriatik, për të plotësuar porosinë që të planifikonte dhe të ndërmernte operacione amfibe kundër bregdetit të Jugosllavisë e të Shqipërisë, nisi të organizonte operacione në Shqi-

përi. Ato përfshinin një element rikonjicioni në thellësi (Brigada e komandove dhe njësitë e lidhura me to)¹⁰). Planifikimi i operacioneve të tyre nisi në maj. Nga fundi i qershorit, një operacion i LRDG tashmë kishte likuiduar një garnizon gjerman prej 150 vetash dhe një stacion roje bregdetare në Spile, afërsisht në gjysmën e rrugës ndërmjet Vlorës e Sarandës. Kapiteni Xhon Olivej (John Olivey) i LRDG ishte i aktivizuar me partizanët në zonën e Qafës së Llogarasë në rrugën e brendshme që lidh Vlorën me Sarandën. Kjo rrugë ishte e rëndësishme për gjermanët që mbronin bregun kundër zbarkimeve të mundshme, ishte gjithashtu e rëndësishme për BLO britanikë dhe për partizanët, meqë ajo ndërpriste shtigjet që të çonin brenda vendit nga furnizimet e Rivierës dhe te pika e evakuimit, si dhe te një a dy pika të tjera në bregdet të përshtatshme për furnizime nga deti. Më 9 gusht një oficer tjetër i LRDG, Stan Istvud (Eastwood) u hodh për t'u lidhur me Alan Palmerin dhe përmes tij me Shtabin e Përgjithshëm të Partizanëve. Enver Hoxha pranoi që Istvudi mund të shkonte në zonën e Pezës në jug të Tiranës për t'u lidhur me njësitë partizane atje, ndërsa majori Alan Hejr e shoqëroi për atje. Ditët e para të shtatorit pati shenja se tërheqjes së pritur të gjermanëve nga Greqia po i vinte çasti dhe u ndërtaua një plan për të sjellë disa patrulla të LRDG që të ishin në kontakt të afërt. Nga 16 shtatori Hoxha ishte bindur të pranonte që Istvudi mund të përforcohej dhe, më 24 shtator, u lidh me grupin e tij prej 36 vetash nënkoloneli David Llojd Ouen (Lloyd Owen)¹¹). Llojd Oueni dëmtoi shtyllën kurrizore gjatë zbritjes dhe u nevojiti të hidhej një mjek oficer për ta ndihmuar deri sa të evakuohej nga fundi i tetorit. Ndërkaq Istvudi dhe një oficer tjetër i LRDG, Ron Tinkeri, drejtuan sulmet mbi rrugët Tiranë-Elbasan dhe Elbasan-Strugë, me një farë ndihme të përzier nga partizanët. Këta e kishin mblendhur mendjen që të mësynin drejt Tiranës për goditjen e fundit. Xhon Olivej pati po ato vështirësi dhe zhgënjime me partizanët në Qafën e Llogarasë dhe pranë saj.

Një operacion më i madh u përgatit thellë në jug të Shqipërisë nga forcat e sulmit me komando. Ishte vënë në lëvizje një plan për sulmin mbi Korfuz që nga muaji maj dhe, me zhvillimin e tij, ai çoi te një plan për një sulm mbi Sarandën në bregdetin shqiptar përballë Korfuzit, meqë Saranda ishte një shteg i mundshëm shpëtimi për gjermanët, të cilët mund të përpiqeshin t'ia mbathnin nga Korfuzi. Dita e caktuar për operacionin e Sarandës ishte 22 shtatori. Qëllimi i

forcës me komando nuk ishte vetëm për ta ngacmuar armikun në Sarandë, por edhe për të ndërprerë rrugën që të çonte brenda vendit nga Saranda në Delvinë¹²). Kur sulmi kishte nisur, u vendos që të përforcohej ai dhe të kapej Saranda, me qëllim që të izolohej Korfuzi. Komandoja nr. 40 dhe një sasi artilerie u sollën që të bashkoheshin me Komandon nr. 2, ndërsa gjenerali i brigadës Tom Çurçilli me Brigadën e shërbimit të Posaçëm II të Kuartierit mori komandën e «Houndforce»¹³). Nga 1 tetori gjermanët ia arritën që ta përforconin Sarandën me një sasi artilerie dhe një periudhë me mot shumë të keq shkaktoi që të kishte 50 për qind të sëmurë ndërmjet komandove. Bashkëpunimi me komandantin partizan veteran, Islam Radovickën, dhe me forcat partizane aty rrotull, me brigadat XII, XIV dhe XIX u arrit të vendosej me kujdes nëpërmjet BLO që ishin aty në vend, ndonëse partizanët kishin vështirësi për t'u furnizuar në pozicione të ngulura, ndërsa vazhdonte rrethimi. Brigadat XIV dhe XIX sulmuan Delvinën, ndërsa Brigada XII dhe elementë të XIV vepronin pranë Sarandës. Saranda u mor më 9 tetor dhe garnizoni gjerman në Korfuz nisi të dorëzohej më 12 tetor. Atëherë lindi çështja për ta shfrytëzuar suksesin dhe u dhanë konsiderata për të mësyre nga veriu drejt Vlorës gjatë bregdetit dhe drejt Tepelenës brenda vendit. Në këtë pikë Kuartieri i Enver Hoxhës u ankua se trupat britanike po plaçkisin në Sarandë dhe, në kohën që u trajtua kjo «canard», u braktis ideja që të shfrytëzohej më tej përpjekja në Shqipëri.

Stan Istvudi dhe patrullat e tij të LRDG qëndruan në Shqipëri për betejën e Tiranës dhe ai ishte në gjendje t'u jepte një ndihmë të çmueshme partizanëve të Mehmet Shehut, duke thirrur sulme ajrore të aeroplanëve të RAF; një ditë, për shembull, solli 28 aeroplanë Beaufighters të pajisur me raketa, që sulmuan kazermat e fortifikuara dhe pozicionet e topave. Pasi ra Tirana, ai luajti një rol kyç për të rivendur në punë aerodromin dhe për të bërë të përshtatshëm për qarkullimin ajror nga fundi i nëntorit. Ai dhe grupi i tij u tërhoq nga Shqipëria në ditët e para të dhjetorit. Dy patrulla të tjera të LRDG u dërguan për t'u marrë me forcat gjermane që po tërhiqeshin në rrugën drejt veriut për Shkodër. Ato i komandonte Xhek Ejtken (Jack Aitken), i cili erdhi me anijen që mori Maklinin më 26 tetor. Këto patrulla gjetën një bashkëpunim të dobët nga ana e partizanëve, vëmendja e të cilëve ishte përqendruar te Tirana dhe qeveria, dhe qëndruan vetëm tri javë. Pati edhe një grup të

vogël nga Shërbimi i Posaçëm i Anijeve me David Sadherlendin (Sutherland), i cili kishte marrë për detyrë të ndërpriste lëvizjet e armikut ndërmjet Greqisë e Jugosllavisë nga ana lindore e vendit.

Enver Hoxha pretendon në «Rreziku anglo-amerikan për Shqipërinë» se ai dhe kolegët e tij ishin vigjilentë në verën e vitit 1944 përballë përpjekjes së anglezëve për të zbarkuar trupa ushtarake në Shqipëri «me qëllim që ta fusnin Shqipërinë në kthetrat e tyre»¹⁴. Paraqitet sikur këtë e parandaloi vigjilenca e Partisë Komuniste të Shqipërisë dhe urdhri i dhënë nga Hoxha për forcat partizane, që të kundërshtonin me forcë këdo që do të vinte si pushtues ose do të përpiquej të depërtonte në vend. Hoxha e quan meritë që pranoi një operacion të kufizuar komandosh kundër stacionit bregdetar gjerman në Spile nga fundi i qershorit, pikërisht sepse ai ishte i kufizuar dhe lokal. Ai përpiqet ta zvogëlojë rolin që luajtën anglezët dhe për t'ua dhënë gjithë meritat partizanëve të Brigadës XII. Ai e paraqet veten që ka hedhur poshtë një kërkesë nga Palmeri për grupe sulmi anglezësh, që do të hidheshin në zonat afër Elbasanit e Tiranës për të bashkuar forcat me partizanët. Ai jep një rrëfim për operacionin e Sarandës nga Houndforce, në të cilin përshkruhen formacionet e partizanëve shqiptarë sikur kanë bërë të gjitha luftimet efektive kundër gjermanëve, ndërsa i kufizuan me shkathtësi anglezët, kështu që ata nuk mundën ta realizonin planin e tyre të supozuar për të përparuar në brendësi të vendit dhe kështu, më në fund, u larguan.

E vërteta ka qenë pak ndryshe. Hoxha kishte me të vërtetë shumë dyshime për propozimet e anglezëve, qoftë edhe për aksionet më të vogla brenda në Shqipëri nga forcat britanike, dhe ai kishte akoma më tepër dyshime sepse për arsye sigurimi dhe të operacioneve ishte e pamundur që t'i jepeshin shumë, në qoftë se do të kishte, njoftime paraprake për to. Ai nuk u paralajmërua për operacionin më të madh të anglezëve, për atë kundër Sarandës. Sipas një raporti nga seksioni i Shqipërisë në Bari më datën 5 tetor, mosdëshira e Hoxhës që forcat e posaçme angleze të kryenin operacione në Shqipëri, u kapërcye kur ai mori një mesazh personal nga Komandanti Suprem i Aleatëve, gjenerali Uillon¹⁵). Mesa duket, ky mesazh u dorëzua më 23 shtator dhe u hapi rrugën për operacionet e ndryshme nga grupi i nënkolonelit Llojd Ouen i LRDG dhe për bashkëpunimin e plotë që ishte arritur ndërmjet gjeneralit Çurçill dhe Islam Radovickës në Saran-

dë¹⁶). Duke u hapur rrugë dëshirave të Komandantit Suprem, Hoxha kishte kënaqësinë plotësuese që hidhte poshtë një përgjigje negative të dhënë nga shefi i shtabit, Spiro Mojsiu, pa dyshim sipas udhëzimeve të mëparshme të Hoxhës. Më 5 tetor, Seksioni i Shqipërisë raportonte se bashkëpunimi me Shtabin e Përgjithshëm të partizanëve ishte «i mirë në tërësi»¹⁷);

Në një letër të 25 nëntorit, Boksshalli i SOE i dërgoi Laskejti në Departamentin e Jugut të FO një dokument të gjatë, që shqyrtonte vështirësitë në rritje me partizanët. Duke iu referuar operacionit në Sarandë, ai bënte këtë koment:

«...FNÇ është i alarmuar nga një veprim i tillë i britanikëve si operacioni i Sarandës, të cilin ata pa dyshim e marrin si një forcë angleze për të vendosur kontrollin britanik mbi zonën e diskutueshme. Ky aksion, i lidhur me mungesën e çfarëdo kundërshtimi (anglez) ndaj pretendimeve të kohëve të fundit të grekëve për territorin e diskutueshëm, pa dyshim i ka shtyrë ata të besojnë se në fakt ne tashmë kemi vendosur që e ardhmja e Shqipërisë së jugut ose e Epirit të Veriut është në favor të Greqisë»¹⁸).

Boksshalli u përqendrua në dyshimet e shqiptarëve rreth qëndrimit anglez për çështjet territoriale ndërmjet Shqipërisë dhe Greqisë. Ka mundësi që kishin më shumë rëndësi dyshimet e PËKSH për qëllimet ideologjike të Britanisë në favor të Kupit, të nacionalistëve dhe të mbretit Zog. Nga shtatori 1944 dyshimet dhe mosbesimi ndaj të huajve, duke nisur me anglezët e duke shkuar deri te jugosllavët e eventualisht për gjithkënd në botë, u bë një nga marifetet politike të ngulitura të Enver Hoxhës, që përdorej rregullisht për të mënjeluar të gjithë ata që guxonin t'i kundërviheshin ose thjesht të mos i bënin qejfin atij. Në këto rrethana është e habitshme që bashkëpunimi i shqiptarëve me grupet angleze të rikonjicionit e të sulmit ishte aq i mirë, sa që në fund të verës dhe në vjeshtë 1944 Alan Palmeri dhe misioni i tij i kuartierit, si dhe BLO në Shqipërinë e jugut, bënë një punë të shkëlqyer për të ndërmjetësuar në këtë bashkëpunim.

Furnizimi ajror me aeroplanë C47 (Dakota) të USAAF që i përkisnin Forcës Ajrore të Ballkanit ra pak në shtator, në krahasim me gushtin. Mospërputhja ndërmjet dokumentimeve të Kuartierit të Operacioneve të Posaçme të Forcës Ajrore të Ballkanit dhe atyre të Regjimentit 334 të RAF vijon ta bëjë të vështirë që të jesh i sigurtë për shifrat. Kuartieri i Ope-

racioneve të Posaçme jep për Shqipërinë në shtator një ngarkesë prej 131 tonësh dhe hedhjen e 72 tonëve (krahasuar me 858 për Jugosllavinë, 186 për Italinë dhe 125 për Greqinë), si dhe një total prej 54 1/2 fluturimesh me sukses. Regjimenti 334 i RAF jep një ngarkesë prej 175 tonësh për shtatorin, hedhjen e 102.7 tonëve dhe një total prej 62 fluturimesh. Që të dy palët e dokumenteve pajtohen që janë hedhur 72 veta bashkë me pajisjet e tyre. Ato duhet të kenë përfshirë grupin prej 36 vetash të LRDG me Llojd Ouenin, tre oficerë të rinj të BLO dhe radistët e tyre, që u dërguan për të përforcuar ose për të zëvendësuar misionet e vjetra në Shqipërinë e Veriut, si edhe të tjerë njerëz të ndryshëm, që ishin të zënë me misione rikonjicioni ose sulmi. Ka mundësi që Kuartieri i Operacioneve të Posaçme jep për tonazhin shifrat e përpikta të hedhjeve për BLO dhe për partizanët, ndërsa shifrat e Regjimentit 334 përfshijnë pajisjet e grupeve të rikonjicionit e të sulmit, që mund të mos kenë ardhur nga burimet e Forcës 399. Në tetor furnizimet me hedhje nga ajri për Shqipërinë arritën kulmin e tyre, do të binin në fare pak në nëntor dhe do të ndërpriteshin krejt në janar 1945. Kuartieri i Operacioneve të Posaçme, BAF, ka shifrat më të mëdha për tetorin, duke dhënë si kuotë mujore për Shqipërinë 120 tonë, hedhja faktike ishte 234.5 tonë (krahasuar me 472 për Jugosllavinë dhe 398 për Greqinë) dhe numri i fluturimeve të suksesshme 120 1/2. Këtë herë Regjimenti 334 i RAF ka regjistruar shifra më të ulëta: 206 tonë të transportuara në 107 operacione me sukses. Numri i njerëzve të hedhur në tetor jepet me ndryshime 15 ose 13. Mesa duket, këta kanë qenë kryesisht oficerë të ulët si përforcime ose zëvendësime për misionet ekzistuese në vend, plus disa nënoficerë të rinj dhe radistë.

Vërshimi i furnizimeve në gusht, shtator e tetor, kontribuoi për një zgjerim shumë të shpejtë të Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Në një vlerësim që e përfundoi më 10 tetor. Eliot Uotrous, kryetari i Seksionit të Shqipërisë në Forcën 399 të Barit, ka llogaritur që deri atëherë ka pasur njëzet e tri brigada partizane dhe një numër të konsiderueshëm grupesh e batalionesh të pavarura⁴⁹). Duhej të ishin katër divizione dhe dy korpuse. Forca e përgjithshme e UNÇSH do të arrinte 40.000 veta nga fundi i tetorit. Historia e Partisë Komuniste të Shqipërisë thotë se UNÇSH numëronte 70.000 veta në tetor, nga të cilët 90 për qind ishin fshatarë, 80 për qind ishin të rinj dhe 9 për qind ishin gra. Shifra 70.000 ndoshta përfshinte një numër të madh rezervistësh lokalë ose formacionesh te-

rritoriale, që nuk janë përfshirë në vlerësimet britanike. As nuk mund të shtrohej çështja për të dërguar pajisjet e nevojshme për këtë numër të madh dhe, sidoqoftë, njësitë e reja nuk ishin të destinuara për beteja kundër gjermanëve, por më tepër për të shërbyer si mjet për ta mobilizuar popullsinë dhe për të kapur çdo cep të vendit. Furnizimet britanike vijuan të kanalizoheshin kryesisht për brigadat më të vjetra, të cilat ishin tehu i UNÇSH. Formacioni luftarak që mbeti gjithmonë në krye të gjithë të tjerëve nga stërvitja, pajisjet, përvoja në luftime dhe morali ishte Divizioni I i Mehmet Shehut dhe, brenda këtij divizioni, Brigada I e tij e vjetër. Katyre trupa-ve nën komandën e Mehmet Shehut (por nën drejtimin e Korpusit I), iu ngarkua detyra për të zhvilluar betejën e fundit serioze të luftës në Shqipëri, betejën e Tiranës, e cila nisi seriozisht nga fundi i tetorit dhe përfundoi me pushtimin e kryeqytetit më 17 nëntor.

Gjatë shtatorit e tetorit, duke e parë të qartë fundin e luftës në Shqipëri dhe fitoren në duart e tij, Enver Hoxha e përqendroi vëmendjen mbi çështjen e pushtetit për periudhën pas lufte. Në fillim të shtatorit, ai ende ishte i vendosur në kuartierin e tij të vjetër në Helmës, thellë në malësitë në jug të vargmalit të Ostrovicës. Në ditët e para të muajit ai u zhvendos në Berat, një qytet «i çliruar»²⁰. Sipas asaj që rrëfen ai vetë, në këtë kohë nisi të shqetësohej për manovrimet brenda Byrosë Politike të tij, Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PKSHP dhe për ndikimin mbi këto manovrime të përfaqësuesit jugosllav që sapo kishte ardhur, kolonelit Velimir Stojniç dhe ndihmësit të tij, Njazi Dizdareviçit.

Hoxha pretendon, në shkrimet e tij, se Stojniçi kishte qëndruar armiqësor që në fillim. Meqë Hoxha ka shkruar pas prishjes me Jugosllavinë, duhet pranuar që tensioni ndërmjet tij dhe Stojniçit më 1944 ka qenë më pak i hapur se sa e bën ai që të duket. Megjithatë, duket se nuk ka ndonjë arsye për të dyshuar se pati tension dhe se Hoxha e pa veten në mbrojtje. Stojniçi ishte kritik ndaj vijës së partisë shqiptare, që natyrisht ishte vija e Hoxhës. Gjykimi që u komunikua nga Titoja ishte se Partia Komuniste e Shqipërisë kishte ndjekur një politikë të paqëndrueshme dhe të gabuar, disa herë tepër «oportuniste» dhe disa herë tepër «sektariste». Kjo ishte një kthim prapa te kritikata që kishte bërë Vukmanoviç Tempoja gjatë vizitave të tij në kuartierin e Hoxhës më 1943. Duke folur në mënyrë të përgjithshme, PKSHP dhe Hoxha po akuzohe-

shin se kishin qenë tepër «oportunistë» për çështjet që lidheshin me Jugosllavinë (Kosovën, Dibërën, nacionalizmin shqiptar përgjithësisht) dhe disa operacione ushtarake, të cilat do t'i kishin ndihmuar partizanët jugosllavë në kurriz të shqiptarëve, dhe se kishin qenë tepër «sektarë» në trajtimin e opozitës brenda Shqipërisë. Jugosllavët po u tregonin si model lëvizjen e vet nacionalçlirimtare. Ata dukeshin se mendonin që PKSH duhej të kishte treguar më shumë elasticitet në trajtimet e grupimeve nacionaliste, me qëllim që të arrihej një front nacional mundësisht sa më i gjerë nën udhëheqjen e Partisë Komuniste. Stojniçi kritikoi veçanërisht masat e ashpra, për të mos thënë terroriste, që ishin marrë nga Mehmet Shehu në pika të ndryshme gjatë fushatës së tij, masa të cilat ishin përkrahur nga Liri Gega, gruaja komuniste udhëheqëse shqiptare, që kishte qenë e deleguar nga Komiteti Qendror për të shoqëruar Mehmet Shehun herë pas here në Shqipëri. Por, natyrisht, pikësynimi i vërtetë i kritikave të Stojniçit ishte Enver Hoxha. Duhej që Hoxha të qetëj sa t'i zvogëloheshin përmasat, kështu që Shqipëria të bëhej një pasuese e bindur e Jugosllavisë.

Stojniçi e zbuloi shpejt se Miladin Popoviçi ose me emra të tjerë Ali Gostivari, Ali Amini, Ali Dushanoviçi, i cili kishte qenë këshilltar i përhershëm jugosllav dhe koleg i Enver Hoxhës që më 1941, mbante anën e Hoxhës. Kurse Hoxha, nga ana e vet, zbuloi se oficeri ndërlihdës sovjetik që sapo kishte ardhur, majori Ivanov, mbante anën e Stojniçit. Stojniçi menjëherë ndërmoi hapa që ta hiqte qafe Miladin Popoviçin. Ky i fundit u thirr në Jugosllavi për të raportuar dhe u bë e qartë se Komiteti Qendror i Jugosllavisë dhe vetë Titoja nuk ishin të kënaqur me punën e tij në Shqipëri. Enver Hoxha korri një fitore të vogël mbi Stojniçin, duke e rregulluar me Palmerin që ta evakuonin Popoviçin në Itali si të sëmurë (vuante nga tuberkulozi). Ai arriti në Bari me Palmerin nga fundi i shtatorit dhe që atje u kthye në Jugosllavi. Hoxha thotë se ai u vra më 1945 nga sigurimi i Rankoviçit, por burimet jugosllave pretendojnë se ai u vra në Kosovë më 1945 nga shqiptarët e djathtë²¹).

Në kuartierin e Hoxhës në Odriçan, Stojniçi nisi të luante një rol me influencë në punët e Partisë Komuniste të Shqipërisë. Ai kërkoi që të merrte pjesë në mbledhjet e Byrosë Politike të PKSH, në të cilat do të përgatitej materiali për Plenumin II të Komitetit Qendror. Byroja Politike në atë kohë

përbëhej prej Enver Hoxhës si sekretar i përgjithshëm, Koçi Xoxes, Nako Spirut, Ramadan Çitakut dhe Liri Gegës. Enver Hoxha e kundërshtoi kërkesën e Stojniçit, por kur u mbledh Byroja, Koçi Xoxeja e mbrojti çështjen e Stojniçit dhe mendimi i Enver Hoxhës u hodh poshtë me votat e Xoxes, Nako Spirut dhe Liri Gegës. Koçi Xoxeja kishte pasur marrëdhënie të ngushta me Vukmanoviç-Tempon më 1943. Nako Spiroja ishte udhëheqës i organizatës së rinisë komuniste dhe, sipas Hoxhës, kishte rënë nën ndikimin e influencës së ndihmësit të Stojniçit, Njazi Dizdareviçit, i cili siç duket kishte udhëzime të veçanta për t'u interesuar në punët e rinisë. Liri Gega në fillim e mbështeti pikëpamjen e Hoxhës dhe pastaj e ktheu fletën, kur erdhi puna për votim. Lidhja e saj me jugosllavët ishte kjo, që ajo kishte punuar me Dushan Mugoshën më 1943, kur Mugosha ishte interesuar nga afër për ngritjen e veprimtarive të Brigadës I nën Mehmet Shehun.

Pasi fitoi të drejtën për të marrë pjesë në Byronë Politike, Stojniçi vazhdoi duke e ngritur lart përvojën jugosllave faktikisht në çdo fushë si model që duhej ta ndiqnin shqiptarët, ai i shtjelloi më tej kritikën për vijën e shkuar të PKSH dhe për politikën, siç i kishte shprehur që më parë. Vija që kritikonte ai, vija «sektare» e intransigjencës së rreptë kundrejt gjithë grupimeve jokomuniste në Shqipëri, ishte natyrisht vija e Enver Hoxhës. Enver Hoxhës iu desh të fitonte kohë dhe të priste çastin e përshtatshëm. Në të vërtetë, atij i duhej të përballonte keqësimin e pozitës së vet. Kur kuartieri u zhvendos nga Odriçani në Berat, në mes të tetorit, Koçi Xoxeja dhe Nako Spiroja e sajuan që të largonin nga Byroja Politike Ramadan Çitakun (i cili mbështeste Hoxhën) dhe Liri Gegën (e cila nganjëherë e mbështeste Hoxhën) dhe t'i zëvendësonin me Sejfulla Malëshovën dhe Pandi Kriston. Hoxha vetë duhet t'i ketë mbyllur sytë përpara këtij ndryshimi, ndonëse së shpejti do të pendohej për këtë; por ai nuk e shpjegon përse e bëri kështu. Malëshova ishte i vetmi anëtar udhëheqës i PKSH me një të kaluar në Moskë dhe Enver Hoxha ishte përkuqjesur që ta mbante atë në një nivel më poshtë se ai i majës: ai ishte vetëm kandidat i Komitetit Qendror. Duke pasur përparësinë e përgatitjes para lufte në Moskë, ai ishte ideologu kryesor i partisë. Hoxha e përshkruan atë si «liberal», që do të thotë se ai pajtohej me Stojniçin në kritikën për «sektarizëm». Hyrja e tij në Byronë Politike vështirë se do të jetë mirëpritur nga Hoxha, por Hoxha nuk e tregon se cilat ishin forcat, që e bënë ta pranonte këtë. Pandi Kristoja, ashtu si Koçi Xoxe.

ishite nga Korça dhe mund të besohej se do të ndiqte vijën e Xoxes. Enver Hoxha e pa veten me katër kolegë në Byronë Politike, që ishin të kënaqur t'i nënshtroheshin influencës së Stojniçit. Ai vetë qëndronte një kokë më sipër mbi të gjithë, për shkak të prestigjit si kryekomandant i UNÇSH, sekretar i përgjithshëm i partisë dhe kryetar i qeverisë së përkohshme. Ndërsa të tjerët nuk e kishin prestigjin kombëtar si arkitektë të fitores, siç e kishte Hoxha. Por liria për manovrim e Hoxhës u kufizua dhe ai duhej të bënte një luftë të vështirë, që të përpunonte një raport me peshë për Plenumin e dytë i cili t'i jepte të drejtë atij vetë dhe kursit që ishte ndjekur nën udhëheqjen e tij, ndërsa nga ana tjetër të mos e keqësonte edhe më tej diskutimin me Stojniçin e me udhëheqësit e tjerë të PKSH, që i nënshtroheshin ndikimit të Stojniçit.

Mbledhja e dytë e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar u mbajt në Berat nga 20 deri në 23 tetor. Në Kongresin ANÇ të majit, Këshilli ishte kthyer në asamble kombëtare dhe legjislativë, ajo kishte zgjedhur një komitet ekzekutiv që gëzonte kompetencat e qeverisë. Në Berat Këshilli u thirr që ta bënte të përhershme atë qeveri të përkohshme. Qeveria u shpall formalisht si Qeveria Demokratike e Shqipërisë. Natyrisht, atë e kryesonte Enver Hoxha dhe përbërja e saj u vendos nga Byroja Politike e PKSH. Këshilli iu kërkua gjithashtu që të miratonte ligjin që rregullonte funksionet dhe kompetencat e këshillave nacionalçlirimtarë në nivelet e ndryshme administrative në të gjithë vendin. Në këtë mënyrë, Shqipëria doli nga lufta me elementët, por vetëm me elementët e zhveshur të një strukture shtetërore të re. Mbledhja e Këshillit ishte rasti për shumë festime me veturime për fitoren.

Plenumi i II i Komitetit Qendror të PKSH, që u mbajt në Berat një muaj më vonë, duke nisur më 23 nëntor, ishte një ngjarje më e rëndësishme, ndonëse më pak publike. Anëtarët e Komitetit Qendror ishin ata që ishin zgjedhur në Konferencën themeluese të PKSH në Labinot në mars 1943. Ata ishin pesëmbëdhjetë anëtarë dhe pesë kandidatë. Të gjithë ishin të pranishëm në Berat, me përjashtim të një kandidati — Mehmet Shehut, i cili ishte i zënë me detyrën për të sjellë në rregull Tiranën, pasi e kishte përfunduar pushtimin e kryeqytetit disa ditë më parë. Në fund të Plenumit u zgjodhën shtatë anëtarë të rinj të Komitetit Qendror dhe njëmbëdhjetë kandidatë të rinj, që do të thotë se ai u zgjerua përgjysmë. Liri Gega u përjashtu si dënim për «sektarizmin» e saj dhe

aventurizmin e shfaqur, që u kritikua shumë nga Stojniçi dhe madje me forcë edhe nga vetë Hoxha.

Ndërmjet marsit 1943 (Konferencës së parë të Partisë) dhe nëntorit 1944 (Plenumit të dytë të KQ), partia ishte drejtuar dhe sunduar nga Enver Hoxha dhe një grup shumë i vogël rreth tij. Në Berat u sulmua drejtimi i punëve nga Hoxha gjatë kësaj periudhe. Ai pretendon se sulmi u organizua nga Stojniçi. Në fakt Xoxeja, Malëshova dhe Spiroja kishin ambiciet e tyre, të cilave shpresonin t'u shërbenin duke ndjekur vija të ndryshme nga Hoxha. Xoxeja, një nga të paktët punëtorë krahu në udhëheqje, kërkoi proletarizimin e partisë dhe një rol më të vogël të intelektualëve. Si sekretar organizativ ai kërkonte që të rriste kontrollin e tij mbi zgjedhjen dhe ngritjen e kuadrove. Si njëri nga ata që nuk ishin shquar në krijimin dhe udhëheqjen e UNÇSH, ai ankohej se drejtimi i partisë ishte monopolizuar nga një grup i ngushtë, që përbëhej nga Hoxha, Miladin Popoviçi, Ramadan Çitaku dhe, deri sa e humbi pozitën pas ngatërresës në Mukje, Ymer Dishnica, kështu që pas tij vendin e katërt e kishte zënë Liri Gega. Sejfulla Malëshova, që kishte pretendime ideologjike e intelektuale, mbajti një analizë të politikës së partisë kundër Ballit Kombëtar, Lëvizjes së Legalitetit dhe udhëheqësve të ndryshëm «nacionalistë», duke konstatuar se në çdo rast partia (domethënë, Hoxha) kishte larguar aleatët e mundshëm dhe kishte krijuar kundërshtarë me intransigjencën e tij pa kompromis. Ai madje e akuzoi partinë se praktikonte terrorizmin dhe dënoi vrasjen e Llazar Fundos. Në vend që të krijonte dhe të udhëhiqte një front nacional të gjerë, partia kishte lejuar që vendi të brehej nga fraksionet. Ndryshe nga Xoxeja dhe Malëshova, të cilët që të dy kishin përgjegjësinë për të paraqitur raporte në Plenum, siç bëri edhe Hoxha si sekretar i përgjithshëm, Nako Spiroja nuk pati ndonjë çështje të veçantë për ta trajtuar dhe Hoxha e përshkruan si njeri ambicioz për t'u ngjitur lart dhe që i shihte shanset më të mira për këtë ngjitje duke punuar me jugosllavët. Nga ana e vet, Velimir Stojniçi e shfrytëzoi plenumin për të kërkuar që PKSH të ndiqte PKJ dhe që Shqipëria të bashkëpunonte më ngushtë me Jugosllavinë në çdo fushë, ndoshta deri në nivelin e një konfederate ose edhe më tutje. Ashtu si në Jugosllavi, Fronti Nacionalçlirimtar duhej të popullarizohej dhe jo Partia Komuniste, ndërsa njerëz me influencë të borgjezisë dhe të klerit duhej të tërhiqeshin në FNÇ.

Stojniçi kishte nga prapa prestigjin e madh që kishte fi-

tuar mareshali Tito gjatë luftës. Kritikant e tij të ashpra për gabimet e bëra nga udhëheqja shqiptare, u bënë siç i drejtohet mësuesi nxënësit. Duke e krahasuar me PKJ, PKSH nuk ishte një parti komuniste e vërtetë: «... udhëheqja e partisë suaj duhet të shkundet», tha ai. «Partia juaj nuk ka qenë në gjendje ta bënte vetë këtë shkundje. Kjo gjë kërkonte një forcë nga jashtë dhe kjo forcë ka ardhur këtu me ne.»²²) Por jo të gjitha gjërat shkuan sipas qejfit të tij. Hoxha kishte për-krahës në Komitetin Qendror, në veçanti në mes të atyre që vinin nga frontet e betejave, Hysni Kapos, komisarit politik të Korpusit I, Gogo Nushit që drejtonte organizatën e partisë në Tiranë dhe Tuk Jakovës, komisarit politik të Divizionit I. Mehmet Shehu nuk ishte i pranishëm, por Enver Hoxha duhet të ketë pasur besim që mund të llogariste mbështetjen e tij nga ajo anë, nga garda pretoriane e ushtrisë. Në fund të plenumit, Bedri Spahiu dhe Tuk Jakova u caktuan në Byronë Politike, që të dy ishin nga ana e luftëtarëve të partisë dhe ka mundësi që i sillnin një farë përforcimi Enver Hoxhës, ndonëse asnjërit Hoxha nuk i vë ndonjë notë të lartë politike.

Enver Hoxha e komenton që kundërshtarët e tij në Berat nuk ia arritën që ta hiqnin atë nga posti, posti kyç si sekretar i përgjithshëm i PKSH, por do të ishte e habitshme nëse ata do të kishin qenë në gjendje të kurdisnin një grusht kundër tij në çastin kulmor të fitores. Hoxha i trajton katër vjetët e mëpastajmë si një periudhë prove nën presionet e Jugosllavisë, si devijim nga vija e drejtë e partisë, si «oportunizëm» të rrezikshëm dhe si luftë të vazhdueshme kundër armiqve të brendshëm, të cilët e izoluan atë në Berat. «Çlirimi» i tij personal u arrit vetëm më 1948, kur prishja e Stalinit me Titon i dha mundësi Shqipërisë të shkëputej nga sjetulla e Jugosllavisë dhe ai, Hoxha, që në gjendje t'i lante hesapet me Koçi Xoxen, pikërisht ashtu si ishte Xoxeja gati ta eliminonte atë. Karriera, pas lufte, e Hoxhës si Kalorës i Vetmuar i komunizmit botëror nisi në Berat, dhe ky rol iu imponua atij nga ngjitja e tij e shpjetë, e pamëshirshme dhe kokëkrisur gjatë kohës së luftës. Në rast se ai do të kishte qenë më «liberal», më i interesuar për unitetin kombëtar, më i predispozuar për t'u bërë një udhëheqës popullor, ai ndoshta nuk do të kishte arritur aty ku arriti. Por duke pasur mungesa në këto anë dhe duke mos e pasur të konsoliduar as pozitën e vet dhe as të PKSH në kohën kur po mbaronte lufta, atij iu desh të gjente rrugët për të vazhduar të luftonte me qëllim që të mbi-jetonte. Ndodhi kështu që pikërisht këtu fshihej edhe gjenia

e tij. Ai kishte një mjeshtëri për të grumbulluar pushtetin dhe për t'i ngatërruar rivalët, duke e zgjatur luftën dhe ai gëzonte atë lloj fati që shoqëron politikën në prag të katastrofës të klasit më të lartë. Këto janë cilësi, të cilat kanë shkakuar që ai të quhet stalinist. Ai nuk u formua nga Stalini dhe iu drejtua Stalinit për ndihmë vetëm kur e pa të përshtatshme. Por ai i eliminoi kundërshtarët e rivalët me një rregullsi e përpikëri, që e bënë të dukej si dishepulli më i mirë i Stalinit. Ata që u përpoqën ta ndalnin atë në Berat, po përgatitnin justifikimet për likuidimin eventual të vetë atyre dhe hapnin rrugën për vargun e spastrimeve, që vijuan ta torturonin Shqipërinë deri në fund të karrierës e të jetës së Hoxhës më 1985.

Menjëherë pas përfundimit të Plenumit të dytë, më 28 nëntor Enver Hoxha dhe kolegët e tij u nisën për në Tiranë, që të merrnin pjesë në paradën e fitores atje. Ditën tjetër, më 29 nëntor, «u çlirua» Shkodra. Lufta në Shqipëri kishte mbaruar. Në çastin e fitores oficerët që përfaqësonin fuqitë aleate, Britaninë, Shtetet e Bashkuara, Bashkimin Sovjetik dhe Jugosllavinë zunë një pozitë të nderuar krahas udhëheqësve të qeverisë së re shqiptare, Lëvizjes Nacionalçlirimtare, Ushtrisë Nacionalçlirimtare dhe forcës lëvizëse prapa të gjitha këtyre, Partisë Komuniste të Shqipërisë. Në të vërtetë, marrëdhëniet me Britaninë dhe SHBA tashmë kishin marrë të tatëpjetën. Nuk do të ndodhte njohja e shpejtë e qeverisë shqiptare dhe dyshimet e Enver Hoxhës për qëllimet e britanikëve dhe të amerikanëve patën si pasojë përforcimin e intransigjencës së tij, në vend që të sillnin që ai të bënte lëshime duke u përpjekur të fitonte përkrahjen e tyre. Për fat të keq kjo i shkonte mirë atij për shtat në llogaritë e brendshme politike për të luajtur rolin e Davidit shqiptar, që i kundërvihet Goliatit kapitalist. Marrëdhëniet me Jugosllavinë ishin të ngushta për shkak të papjekurisë dhe të mungesës së përvojës nga ana e PKSH, si dhe nga mungesa në atë kohë e çfarëdo padroni ose mbrojtësi tjetër komunist, por nacionalizmi i Shqipërisë dhe i Jugosllavisë po i brente marrëdhëniet që në fillim dhe do të vazhdonte po kështu. Marrëdhëniet me Bashkimin Sovjetik vështirë se ekzistonin dhe Bashkimi Sovjetik dukej i kënaqur për momentin që ta linte Shqipërinë nën kujdesin e Jugosllavisë së Titos. Është karakteristike që Enver Hoxha në Berat e kundërshtoi tezën e parashtruar nga Stojniçi dhe Malëshova se të gjitha fuqitë e mëdha duheshin trajtuar njësoj përsa u përket marrëdhënieve shtetërore. Ai nguli këmbë që i duhej dhënë

preferencë Bashkimit Sovjetik. Duke synuar në këtë mënyrë për zogun e lirë në pyll, ai po i jepte vetes dorë të lirë të sillej keq me zogjtë që i kishte në dorë. Se si e bëri këtë ai, është pjesë përbërëse e historisë pas luftës. Rrëfimi ynë mbaron me këtë pikë që, madje edhe në çastin e fitores, kur Shqipëria u ringjall nga hiri dhe rivendosi me sukses pavarësinë dhe sovranitetin e vet, marrëdhëniet e saj me të tjerët u prishën dhe nuk tregonin një ogur të mirë për paqen dhe lulëzimin pas lufte.

Shënimet

1. PRO, FO, 371/43556.
2. PRO, FO, 371/43554, Telegram i Barit për Kazertën nr. 14 Saving i 21 shtatorit dhe 38 Saving i 18 tetorit, si dhe «Historia e Partisë së Punës të Shqipërisë» (1982; 162).
3. «Historia e Partisë së Punës të Shqipërisë» (1982; 167).
4. Po aty (168).
5. Alia (1988; 82-85).
6. Hoxha (1982 b; 212-13).
7. Prifti (1978; 229).
8. PRO, FO 371/43554, Telegrame të Barit për Kazertën nr. 14 Saving i 21 shtatorit dhe 38 Saving i 18 tetorit.
9. Po aty. Telegram i Barit për Kazertën nr. 38 Saving i 18 tetorit.
10. Lloyd Owen (1980) në disa pjesë të tekstit për hollësitë e operacioneve të LRDG.
11. Më pas gjeneral-major David Lloyd-Owen, CB, DSO, OBE, MC. Shih Lloyd Owen (1980).
12. PRO, WO, 204/8513, mesazh nga Varshava për misionin Spillway i 18 shtatorit.
13. PRO, WO, 204/8513, 8514, dhe 8515 përmbajnë hollësi për operacionin në Sarandë.
14. Hoxha (1982 a; 335-347).
15. PRO, FO, 371/43554.
16. PRO, WO, 204/8513, një raport nga misioni Swifter me datën 23 shtator për një takim me Enver Hoxhën.
17. PRO, FO. 371/43554.
18. Po aty.
19. PRO, Air 23/7978.

20. PRO, FO, 371/43554, telegram i Barit për Kazertën nr. 38 SAVING
i 18 tetorit.
21. Shih shënimin 24 te kreu 1.
22. Hoxha (1982 b; 210),

Kreu 14

Fundi i misionit Stables

Për oficerët ndërlidhës britanikë lufta në Shqipëri më tepër mund të thuhet që u shterua, se sa mbaroi. Nga shtatori u bë e qartë se ishte vetëm një punë kohe dita kur UNÇSH do të vinte kontrollin e plotë mbi çdo pjesë të vendit. Ushtria partizane në zgjerim të shpejtë ende kishte nevojë për shumë furnizime, por frontet e luftimeve ishin larguar nga sheshet malore të hedhjeve dhe ishin në rrethinat e qyteteve, kështu që BLO po e shihnin veten larg nga akcionet dhe se kishin mbetur prapa në zona të prapavijave pa ndonjë gjë interesante. Shqetësimi kryesor i udhëheqësve kryesorë po bëheshin politika dhe qeveria. Kjo e bëri punën e misionit të kuartierit interesante, por shumica e BLO nisën të mendonin që të largoheshin nga Shqipëria për të gjetur një angazhim të dobishëm për luftën gjetkë.

Në këtë kohë, pa e shpjeguar se çfarë po bënte, Forca 399 nisi të fuste një ekip të ri oficerësh për t'u lidhur me partizanët në veri të vendit. Viktor Smithi u hoq nga posti i tij me Korpusin I për të zëvendësuar Palmerin në misionin e kuartierit me Enver Hoxhën dhe Shtabin e tij, në fillim në Odriçan, pastaj në Berat dhe së fundi në Tiranë. Një oficer i ri, majori M. J. Thornton i Regjimentit Mbretëror të Tankeve u hodh më 1 shtator dhe mori përsipër postin e ndërlidhësit në Korpusin I, kur Smithi u largua drejt jugut nga fundi i muajit. Edhe dy oficerë të tjerë u hodhën në veri, kapiteni J. F. P. Oliver i Korpusit Mbretëror të Pushtatarëve të Mbretit në 8 shtator dhe togeri, i nderuari

Rouländ Uin (Rowland Winn) i Husarëve Mbretërorë Irlandezë të Mbretit më 19 shtator. Disa oficerë të tjerë u hodhën në pjesë të tjera të vendit për të përforcuar misionet ekzistuese. Kjo me sa duket lidhej me planifikimin nga SOE për një të ardhme që nuk u realizua, siç ndodh shpesh në kohë lufte. Për oficerët e rinj kishte pak punë për të bërë dhe ata e panë veten se po iknin nga vendi shpejt, nga fundi i vitit ose në fillim të vitit 1945. Për ne, të misionit Stables, dërgimi i oficerëve të rinj në veri u duk i çuditshëm, meqë kishim marrëdhënie të mira me komandantët partizanë, ndër-sa Riçard Ridelli si oficeri epror në veri, që kishte një vit përvojë nga Shqipëria, dukej si njeriu i përshtatshëm për vendin në postin e Korpusit I, kur Viktor Smithi u largua që të merrte në ngarkim misionin e kuartierit. Për këtë çështje ne shkëmbyen nja dy radiograme të acaruar me Barin.

Shqetësimi ynë u rrit për faktin se, pasi morëm 17 ngarkesa ajrore me furnizime në gusht, me sa dukej do të kishim perspektivën e pasigurtë për 10 ngarkesa ajrore në shtator, ndonëse Divizioni II, me të cilin kishim të bënë tani, kishte një nevojë shumë më urgjente për armë, pajisje dhe veshmbathje se sa kishte pasur Divizioni I. Neve nuk na ishin thënë kushtet e marrëveshjes ushtarake me partizanët, që ishte nënshkruar në Bari më 24 gusht. Vetëm si pasojë e protestave që i bëmë ne Barit rreth shpërndarjes së papërshtatshme të aeroplanëve, mësuam në mes të shtatorit se dislokimi i furnizimeve tashti përcaktohej nga personeli i kuartierit të Enver Hoxhës në konsultim me Alan Palmerin. Doli në dritë se Hoxha nuk kishte miratuar asnjë shpërndarje për misionin Stables dhe Divizionin II, duke dhënë urdhër që Divizioni II duhej të furnizohej nga Divizioni I (një veprim krejt i pazbatueshëm, duke marrë parasysh vështirësitë për çfarëdo transporti në Shqipërinë e asaj kohe). 17 aeroplanët në gusht për ne kishin rrëshqitur përpara së Hoxha të vinte dorë mbi çështjen e furnizimeve. Ne e vijam presionin mbi Barin dhe Riçard Ridelli dërgoi një mesazh personal për Palmerin nëpërmjet Barit, duke u përpjekur që të siguronte disa aeroplanë për t'u drejtuar nga ne. Përdryshe, çfarë kuptimi kishte të qëndronim në Shqipëri dhe, siç kërkonte Bari, t'i atashoheshim Divizionit II? Më në fund, më 16 shtator, morëm sigurime se 10 aeroplanë do të dërgoheshin për ne dhe misioni i kuartierit do ta përcaktonte këtë me Enver Hoxhën.

Një problem tjetër që na doli në këtë kohë dhe përpëlitjet e të cilit mund të gjurmohen në regjistrin e radiogrameve të Stables, ishte se Bari kërkonte që Riçard Ridelli të shkonte për të kërkuar Maklinin e Smajlin dhe t'i sillte në kuartierin e Korpusit I për t'u evakuar. Ky do të kishte qenë një operacion dredharak e që do të harxhonte kot kohën, meqë sipas përvojës sonë të shkuar me krerët nacionalistë, kishte mundësi që ai të mos u bënte mirë marrëdhëniet tona me partizanët. Brigada I partizane që kishte qenë në aksione kundër zogistëve në Krujë, mori porosi që ta trajtonte misionin Concensus II me kujdes, në rast se do të binte në kontakt me të. Kështu që sugjerimi i kundërt nga ana jonë ishte që Maklini duhej të hynte në kontakt me Brigadën I. Siç doli në dritë, Maklini dhe Smalji nuk ishin të prirë që të vinin në drejtimin tonë, po ashtu siç nuk ishim ne për të shkuar drejt tyre dhe kështu çështja u shua. Situata mori një ngjyrë surrealistike kur ne morëm më 19 shtator një radiogram që thoshte se ishim të lirë të largoheshim nga Shqipëria në çdo kohë dhe se kjo ishte sqaruar me Maklinin. Rruga jonë ishte larguar kaq prerazi nga rruga e Maklinit që nga fillimi i korrikut, sa që ishte e çuditshme të sillej ndër mend që ai ende ishte emëruar si eprori i BLO i ngarkuar për misionet në veri të Shqipërisë.

Fija e fundit përse i përket misionit Stables, ishte një radiogram nga Bari më 23 shtator, i cili i fshiu ekuivoket e mërrparshme dhe njoftoi se ishte lëvizur Viktor Smithi për të marrë përsipër misionin e kuartierit, Smithi ishte zëvendësuar në Korpusin I nga majori Thornton i rishardhur dhe ishte caktuar kapiteni i rishardhur Oliver për ndërlihdje me Divizionin I. Mesazhi i radiogramit për Stables ishte: «Vlerësoni qëndrimin tuaj në Div. II. Do të merren masa për zëvendësimin». Atij iu dha përgjigje më 24 shtator me një radiogram të zemëruar nga Ridelli, që protestonte për mënyrën e pakujdesshme me të cilën ishte trajtuar dhe që njoftonte se ne do të largoheshim nga vendi së shpejti. Gjatë udhëtimit tonë drejt bregdetit, Ridelli mori një radiogram personal nga Eliot Uotrous, kryetari i Seksionit të Shqipërisë, i cili i afrohej një apologjie me aq sa mundej dhe me sa mund të pritej. Ai e pranonte se duhej të na kishte informuar më përpara për qëllimet e tij lidhur me udhëzimet e reja dhe jepte shpjegime se ato «ishin quajtur të nevojshme, meqë të dy këta oficerë (Thorntoni dhe Oliveri) kishin pasur kohët e fundit mundësinë për të përfutur politikën tonë kundrejt

partizanëve, e cila siç e dini, ka qenë jashtëzakonisht e ndërlikuar, veçanërisht lidhur me politikën e Ministrisë së Jashtme kundrejt nacionalistëve». Lidhur me çështjen e qëndrimit të Hoxhës kundrejt nesh, radiogrami i Uotrousit thoshte:

«Palmeri ishte porositur ta ngrinte këtë çështje me Hoxhën dhe të merrte miratimin e tij. Megjithatë, në një kohë kur ne po përcaktanim një vijë të vendosur ndaj Hoxhës lidhur me krizën e Maklinit, nuk do të kishte qenë e mundur që t'ju vinim ju me Korpusin I... Këtë mesazh e kemi marrë nga Palmeri., Hoxha ka qëndrim miqësor dhe i vlerëson gjithë përpjekjet e tij (të Ridellit)».

Kështu mori fund misioni ynë në Shqipëri, me peripeci deri në pikën e fundit.

Për shkak të këtyre ekuivoqeve në pozitën tonë, muaji i fundit i misionit Stables ishte diçka si një antikulm. Kur e lamë Brigadën I dhe Divizionin I në luginën e Matit, në ditët e fundit të gushtit, ne u nisëm për në Bizë, në pllajën e madhe si pjatë në majë të Malësisë së Çermenikës, që kishte qenë baza e gjeneralit Dejvis dhe që ishte përdorur si shesh hedhjeje në kohë të ndryshme nga disa misione të ndryshme. Moti ishte fare i mirë dhe pyjet e malet shkëlqenin, por vjeshta tashmë e bënte veten të ndihej, ndërsa netët po bëheshin shumë të ftohta e me mjegull, me vesë të rëndë dhe madje në ndonjë rast me ngrica. Grupi ynë i vogël po vuante gjithnjë e më tepër nga një varg sëmundjesh: ethe, dhimbje e të prera, çrregullime të tretjes e të zorrëve. Ato na u qepën aq më fort, sa më shumë qëndronim, si pasojë, pa dyshim, e jetesës sonë mjaft të parregullt, ndonëse ishim të rinj e të lidhur. Italianët dukeshin edhe më të prekshëm se ne, ata ishin aq më tepër të pasigurtë se ku do të qëndronin ose se ku do të përfundonin.

Kur arritëm në Bizë, malet ishin të zbrazëta, me përjashtim të ca barinjve me tufat e tyre, që shtinin me pushkë herë pas here për të kaluar kohën. Më 27 gusht erdhi një grup nga Brigada III, që tha se ata po hynin në përlëshjet e para në rrethinat e Tiranës. Më 28 gusht Hulusi Spahiu, komandanti i brigadës, erdhi i shoqëruar nga komisari i tij politik. Ai kishte shërbyer në Brigadën Ndërkombëtare në Spanjë dhe fliste rrjedhshëm frëngjisht. Shpejt hymë në marrëdhënie të mira me të. Natën e 29-30 për ne erdhën dy aeroplanë, që hodhën plot armë e municione, gjë që ishte një fillim i mirë për marrëdhëniet tona. Më 31 gusht koma-

ndanti i ri i emëruar për Divizionin II, Tahiri, (?) erdhi me komisarën e tij politik. Tahiri kishte komanduar Brigadën VI, që prej formimit të saj në Përmet në jug nga janari. Ai dhe komisarë i tij ishin më pak të shkolluar se oficerët epërorë partizanë që ne kishim takuar më parë dhe në fillim dukeshin pak më të rezervuar, por ata u çliruan pas një farë kohe dhe dukeshin më të mprehtë për punët praktike ushtarake se sa për politikën. Tahiri tha se do ta shqyrtonte me Shtabin e Përgjithshëm çështjen e statusit të misionit Stables. Kjo ndoshta ishte një shenjë se atij i mungonte stërhollimi politik.

Ishte e qartë se lajmi për hedhjet e furnizimeve tona ishte përhapur me shpejtësi nëpër male. Na u paraqit Baba Faja, dervishi bektashi i famshëm për rezistencën e tij të hershme kundër italianëve. Ai solli me vete jehonën e madhështisë e të karakterit të kohërave të vjetra. Ai me Myslim Pezën dhe Abaz Kupin ia kishin dhënë ngjyrimin e rezistencës «nacionale» LNÇ, kur u formua në Pezë në shtator 1942. Ai e futi në lëvizjen partizane më 1943 çetën e tij të Martaneshit dhe ai ishte pjesërisht përgjegjës për t'u kujdesur për Dejvisin dhe kuartierin e misionit gjatë ofensivës fatale gjermane nga fundi i atij viti. Ai ishte nënkryetar i LNÇ dhe dukej se e ndiente veten të shpërfillur nga bisedimet tona të tepruara me komandantët e thjeshtë të divizionit e të brigadës. Ne i dhamë disa materiale ushtarake për njerëzit e tij dhe ai e vlerësoi mikpritjen tonë e dukej i kënaqur kur u largua. Ai nuk dinte gjuhë tjetër veç shqipes dhe pata kënaqësinë të shihja se, pas nëntë muajsh në këtë vend, unë kisha mundësinë të merresha vesh siç duhej me të në gjuhën e tij.

Nga 3 deri më 8 shtator, bëra një ekskursion teposhtë maleve deri në rrethinat e Tiranës për të parë njësitë e Brigadës III në aksion. Qeveria e Fiqri Dines kishte marrë fund dhe dha dorëheqjen më 29 gusht, kurse popullsia e Tiranës ishte me mendjen e mbarimit të pushtimit. Si një rrjedhë e pandërprerë nga qyteti dilnin të rinj për t'u bashkuar me partizanët dhe ata rreshtoheshin në batalionin lokal Dajti, para se të dërgoheshin si përforcime në brigadat e ndryshme. Njerëzit që i dërgonim për të bërë pazar ishin në gjendje të lëviznin pak a shumë hapur dhe nuk kishin vështirësi për të gjetur furnizime. Brigada III vepronte nga Priska, fare pranë Tiranës. Gjatë ditës nuk ndodhi ndonjë gjë e madhe, por batalionet partizane sulmuan postat e xhandarmë-

risë ndaj të ngrysur dhe shkaktuan shkëmbime të vogla zjarri me armë me patrullat gjermane. Herë pas here gjermanët bënë ndonjë sulm të befasishëm për t'i dëbuar partizanët dhe nga mëngjesi zjarri pak nga pak shuhej. Kishte disa të plagosur, plumbat gjermanë bënë shumë më tepër dëme se ata italianë, por luftimet ishin me intensitet të ulët, ndonëse të vazhdueshme. Tirana kishte një pamje të bukur në vapën e verës, por rrethinat bëheshin një det me baltë kur na zinin shtrëngatat e verës.

Kur u ktheva në Bizë, Riçard Ridelli u largua për një mbledhje me Dali Ndreun e Viktor Smithin në Priskë. Për ne nga kjo nuk doli ndonjë gjë me interes të madh, me përjashtim të konfirmimit që marrja e vendimeve në Shqipëri gjithnjë e më tepër po binte në duart e udhëheqjes partizane dhe se misioni i kuartierit me Enver Hoxhën dhe Shtabin e Përgjithshëm ishte tani në pikën e fokusit për realizimin e politikës angleze. Ne zhvilluam një shkëmbim të dendur mesazhesh me Barin, duke u përpjekur të përfitonim një garantim të aeroplanëve e të furnizimeve për Divizionin II. Më në fund, Bari u detyrua të na thoshte më 9 shtator se Stables nuk ishte në listën e Enver Hoxhës për furnizimet për shkak të së kaluarës sonë «reaksionare», por ata prematuan se do të përpiqeshin të na dërgonin 10 ngarkesa me aeroplanë. Zhgënjimi nga kjo u zbut pak për mua nga një mesazh që më ngrinte në gradën e kapitenit nga mesi i korrikut, por nuk kishte asgjë për ta zbutur Riçard Ridellin.. Megjithatë, ne morëm zemër kur dëgjuam Radio Barin të transmentonte komunikatat që kishim përpiluar ne rreth veprimtarisë partizane të kohëve të fundit. Ndërkaq, veprimi luftarak vazhdimisht po largohej prej nesh. Brigada IV po spastronte Mirditën; Brigada V kishte depërtuar në Kukës; Brigada I kishte pushtuar Krujën, duke i dëbuar përfundimisht zogistët; Brigada VI po sulmonte Elbasanin; Brigada III vazhdimisht po synonte pjesët e jashtme të Tiranës.

Një pjesë e informacionit që na u dërgua nga Bari, dukej e ngatërruar. Për shembull, Radio Bari njoftoi një mbrëmje se Cen Elezi dhe Dan Kaloshi po bashkëpunonin me partizanët, ndërsa informacioni ynë ishte se ata ishin «neutralizuar» dhe se Litajt ishin eliminuar. Një mesazh nga Bari pretendonte se Kupi po bashkëpunonte me partizanët dhe po luftonte gjermanët, gjë që nuk dukej e besueshme. Një i dërguar i Mehmet Shehut, që erdhi tek ne më 15 shtator, na tha se Muharrem Bajraktari u kishte bërë rezistencë par-

tizanëve dhe se Brigada V kishte zbuluar një depo të fshehtë të materialeve luftarake angleze në shtëpinë e Selim Nokës. Ne arritëm në përfundimin se gjithçka ishim përpjekur të arrinim në dimër, kishte shkuar fare kot.

Më 19 shtator shkëmbimet tona të padurueshme me Barin përfytuan një mesazh, i cili na tha se ne ishim të lirë ta linim Shqipërinë kur të kishim dëshirë dhe kur të mundeshim. Po atë ditë ne morëm tre furnizime ajrore, që i hodhën ngarkesat në mënyrë shumë të parregullt, në pllajën e madhe të Bizës. Në mënyrë të papritur, ishin përfshirë edhe dy veta, togeri, i nderuari Rouland Uin dhe rreshteri Boulton. Për fat të keq, Uini theu këmbën gjatë zbritjes. Asgjë-kundi aty afër nuk kishte asnjë doktor. Ne i dhamë ndihmën e parë të shpejtë dhe ai kaloi një natë të vështirë në sheshin e hedhjes. Të nesërmen e çuam në kampin tonë. Ai e duroi mirë gjendjen e tij të vështirë dhe ne e rregulluam aq rehat, sa patëm mundësi në shtretërit tanë të sajuar. Dërguam korrierë për të parë se çfarë mund të na rregullonin partizanët për ta ndihmuar. Pritja për një përgjigje ishte shumë e mundimshme për të.

Unë dola më 20 shtator për të bërë një rikonjicion në sheshin e vjetër të hedhjes në Dibër, për rastin nëse do të ishte e mundur të bindej Bari që të dërgonte një aeroplan të lehtë për të marrë Ridellin, Roland Uinin dhe mua dhe të na evakuonte në Itali. Udhëtimi m'u kthye në një rikujtim të padëshiruar për jetën gjatë dimrit, me ushqimin e keq dhe me çimkat e pleshtat që gëlonin. Marshimi që i gjatë, kuajt ishin në gjendje të keqe dhe Dibra «e çliruar» ishte në një gjendje të mjeruar me shkatërrime, çrregullime dhe me mungesa të rënda të furnizimit me ushqime. Qyteti u mitralua nga dy aeroplanë gjuajtës gjermanë gjatë kohës që ne ishim atje, por pa ndonjë efekt të dobishëm. Brigada e re XVIII që ishte formuar me vullnetarë të ardhur me shumicë të partizanët nga zona e Dibrës, po largohej drejt veriut, së pari në Peshkopi, por ndoshta për të pushtuar luginën e Drinit të Zi, ndërsa formacionet më të konsoliduara të partizanëve u futën në Kosovë. Sheshi i zbritjes në Dibër doli se ishte në një hapësirë të zbrazët e të braktisur dhe aty dukej se nuk kishte ndonjë shans që unë mund të merrja ndonjë sigurim që Forca Ajrore e Ballkanit do ta kishte të nevojshëm, përpara se të rrezikonte që të dërgonte atje një aeroplan. I vetmi përfitim nga vizita ishte se unë ndesha një shqiptar të thinjur e të ashpër, i cili kishte kaluar shumë vjet në Shtet-

tet e Bashkuara ku kishte marrë emrin Harri, dhe që kishte punuar si përkthyes për një oficer amerikan në Maqedoni. Unë e rekrutova për misionin Stables dhe ai qëndroi me ne për kohën e shkurtër që mbetej, duke na u bërë i dobishëm për shumë gjëra. Nga 23 shtatori unë isha përsëri në Bizë, pikërisht në kohën për të parë Brigadën III duke marshuar për në Kosovë. Brigada IV po zinte vendin e saj në rrethinat e Tiranës. Kjo ishte e para nga një varg lëvizjesh, që e sollën Mehmet Shehun dhe Divizionin I (pa Brigadën V) në pozitë për të bërë rrethimin e fundit dhe kapjen e Tiranës në tetor — fillimi i nëntorit.

Nisja e Brigadës III për në Kosovë shkaktoi mosmarrëveshje të mprehta ndërmjet nesh, të misionit Stables, dhe atij që sapo kishte ardhur, Rouland Uinit. Kapiteni Oliver, një tjetër që kishte ardhur i ri në Shqipëri, ishte bashkuar me fushimin tonë në Bizë gjatë mungesës sime në Dibër dhe na doli se ishte i një mendjeje me Uinin. Koncepti i tyre ishte që detyra e parë e BLO duhej të ishte të pengohej përparimi i komunizmit. Ata shprehën pikëpamjen se duhej të dënoheshin planet e partizanëve për të mposhtur Kosovën dhe (siç e morëm ne me mend) për t'u dhënë fund përpjekjeve të vëllezërve Kryeziu që të udhëhiqnin një rezistencë «nacionaliste.» Ata përkrahën pezullimin e çdo ndihme për partizanët, unë iu mbajta pikëpamjes se ne nuk kishim mundësi për të zgjedhur, veçse të qëndronim mënjanë. Fitorja e plotë e UNÇSH, të udhëhequr nga komunistët, tashmë ishte bërë krejtësisht e sigurtë dhe ndoshta nuk mund të ndalohej nga asgjë që ishte në gjendje të ndërmerre Britania. Ridelli dhe unë i thamë Oliverit e Uinit se përvoja jonë me misionin Stables na kishte bindur që ishte e mundur të arrihej një ekuilibër pune me partizanët, dhe ne ishim të bindur se e vetmja politikë me kuptim ishte përpjekja për të realizuar një *modus vivendi* me ta. Oliveri dhe Uini u përgjigjën se ne e kishim gabim që mbështesnim partizanët dhe pretenduan se e dinin që Ministria e Jashtme kishte ato pikëpamje që po shprehnin ata.

Dukej e çuditshme që pikërisht në çastin e fitores së partizanëve dhe pas këmbënguljes së vazhdueshme që BLO ishin vetëm për të nxitur luftën kundër gjermanëve dhe për t'u dhënë furnizime ushtarake vetëm atyre që vërtet kishin rrokur armët kundër pushtuesit, Forca 399 na dërgonte në Shqipërinë e veriut dy oficerë, që pretendonin se kishin një objektiv krejtësisht të ndryshëm. Kjo na bëri mua dhe Ride-

llin që të dërgonim një radiogram për Barin, duke pyetur nëse ishte shpallur një vijë e re për Shqipërinë, e mbështetur në konsiderata të politikës së jashtme më tepër se sa në konsiderata ushtarake, të cilat kishin qenë mbizotëruese deri në tani. Ne pyetëm nëse pikëpamjet që po dëgjonim nga BLO të rinj ishin zyrtare apo personale, sepse ato do të kishin ndikim mbi punën që bëhej nga BLO. Pak ditë më vonë, kur ne po marshonim drejt jugut, morëm një përgjigje të kujdesshme nga Eliot Uotrous. Ai na këshillonte që të flisnim me Palmerin për këtë çështje kur të arrinim në Odriçan, meqë Palmeri ishte plotësisht i informuar për gjendjen e Maklinit dhe për politikën lidhur me të. Ai na tha se politika ushtarake ndaj Shqipërisë vendosej në Bari. Ministria e Jashtme në të kaluarën kishte bërë deklarata zyrtare për Shqipërinë dhe ato ishin të qarta. Nuk kishte ndonjë vijë të re zyrtare, që t'u ishte dhënë BLO. Por vetëm sa për të na informuar ne, kishte një vendim të FO që një pjesë e misionit të Maklinit duhej të mbetej me Kupin dhe FO po tregonte më shumë interes për Shqipërinë.

Kështu, ndërsa ne po e linim Shqipërinë, ambiguiteti që e kishte ndjekur këmba-këmbës veprimtarinë angleze dhe e kishte penguar Britaninë të fitonte kredi me cilëndo palë në vend, dukej se ende mbahej fort. Por kishte një gjë që nuk e dinim as ne, as Uini e Oliveri dhe as gjithashtu Eliot Uotrous: pikërisht në ato ditë, FO po i nënshtrohej fitores së partizanëve dhe po e braktiste Kupin (shih kreun 12). Pro tokolli i sër Orme Sarxhentit, mbi të cilin bazohej vendimi thelbësor i politikës së jashtme, mbante datën 16 shtator.² Tani qëllimi do të ishte «të përqendroheshin përpjekjet tona për të përforcuar pozitën tonë me ata (me FNC) me synimin që të shmanget ndikimi rus». Për fat të keq, siç u argumentua në kreun 12, ky ndryshim i politikës erdhi shumë vonë dhe kishte shumë kushte të lidhura me të, kështu që nuk mund të ushtronte një veprim me të vërtetë pozitiv mbi Enver Hoxhën e kolegët e tij. Në fund të fundit, ai doli pikërisht si një hap tjetër në tatëpjetën për të mos pasur fare marrëdhënie me Shqipërinë. Gjithë diskutimet tona me Oliverin dhe Uinin do të kenë ndodhur më 23 e 24 shtator, sepse më 24 shtator Riçardi, i zemëruar nga mesazhi i shpëlarë, i marrë nga Bari më 23 shtator, që njoftonte për dispozitat e reja të misionit në Shqipërinë e veriut pa dhënë asnjë shpjegim, vendosi që të niste marshimin drejt një pike evakuimi. Datën 24 e shpenzuam për të mbledhur plaçkat. E lamë Bi-

zën herët pas agimit. Meqë kishim autorizim të merrnim vetëm shtatë italianë me ne në Itali, na ra barra e pakëndshme për të hedhur me short cilët do të ishin ata të dy që do të mbeteshin.

Diskutimet me Oliverin dhe Unin ishin një episod shumë i shkurtër dhe i parëndësishëm, por ato patën një vazhdim kureshtar për mua në vitet e mëvonshme, siç do ta tregojë kreu i fundit i këtij libri. Madje edhe kur po diskutonim, ngjarjet na kishin kapërcyer. Gani Kryeziu dhe vëllezërit e tij tashmë ishin kapur nga Brigada V partizane dhe partizanët e Kosmetit, kurse Toni Simkoksi ishte arrestuar më 19 shtator. Dy javë më pas, ndodhi mësymja e UNÇSH në Kosovë. Lëvizja e Brigadës III nga zona e Tiranës në drejtim të Kosovës ishte vetëm një pjesë e vogël e një kombinimi shumë më të gjerë që Shtabi i Përgjithshëm i UNÇSH duhej ta kishte bashkërenduar me shtabet e mareshalit Tito në Jugosllavi. Nuk kishte asnjë dyshim për Britaninë që ta vështronte atë si një pikë kthese: kjo ishte pak a shumë një pasojë e pashmangshme e kursit që kishte marrë lufta në Shqipëri, siç po e pranonte Ministria e Jashtme në Londër me vonesë dhe me lëkundje. Lidhur me realitetin shqiptar, diskutimet e nxehta që bëmë në Bizë më 23 dhe 24 shtator ishin tërësisht anash thelbit, por me ato unë shijoja për herë të parë debate tejet të polarizuara rreth komunizmit dhe si duhej vepruar me të, gjë që vijoi pa u shuar në Britani gjatë gjithë 45 vjetëve prej atëhere e deri më 1989, kur regjimet komuniste në Europën Lindore nisën të shembeshin.

Kur ne u nisëm të iknim nga Biza, nuk kishim asnjë ide të qartë se si do ta rregullonim për të dalë nga Shqipëria. Qëllimi ynë i përgjithshëm ishte të arrinim në bregdetin e jugut të Shqipërisë dhe t'i bënim thirrje Barit për të na dërguar ndonjë lloj anijeje që të na merrte. Duke u mbështetur në përvojën e fituar, e kishim ndryshuar mënyrën e zakonshme të marshimit. Ne ngriheshim në agim ose para se të zbardhte, niseshim menjëherë dhe marshonim deri nga mesi i paradites, kur ndalonim për të ngrënë mirë. Italianët tanë ishin të zotët për të ndezur zjarr e për ta përgatitur ushqimin pothuaj në çfarëdo lloj moti. Kjo i jepte Elvixhit kohë për orët e caktuara të radiogrameve me Barin, ndërsa Ridelli dhe unë mund të bënim çfarëdo shifrimi e deshifrimi të nevojshëm. Pas drekës dhe një gjumi të shkurtër, ne e rinisnim marshimin pasdite dhe vijonim të ecnim deri sa muzgu na shtynte të kërkonim bujtje në fshatin më të afërt ose, po

të ishte nevoja, në koliben më të afërt., Gjatë gjithë kohës ecnim nëpër vise të kontrolluara nga partizanët. Sa më në jug shkonim, aq më të rënda dukeshin shkatërrimet, por mirëseardhja që na priste nga fshatarët bëhej gjithnjë e më e ngrohtë, me të shtruarra të tepruara duke pirë raki. Në atë moment të veçantë në historinë e Shqipërisë, ne e pamë veten duke lëvizur në një shoqëri propartizane, që ishte farkëtuar nga dhuna dhe terrori që kishin ushtruar pushtimi italian e gjerman.

Kur arritëm në Labinot, në fund të ditës sonë të parë të marshimit, gjetëm atje Liri Gegën që po priste Viktor Smithin. Liri Gega, si anëtare e Byrosë Politike të Partisë Komuniste Shqiptare, kishte pasur një mision shtegtues, në pjesën më të madhe duke ndjekur ose duke shoqëruar Mehmet Shehun, dhe Brigadën I e Divizionin I, ndërsa pasi u formua Korpusi I, duke u lidhur edhe me këtë formacion. Pas lufte ajo u martua me Dali Ndreun, komandantin e Korpusit I, dhe ata u likuiduan që të dy nga Enver Hoxha më 1956. Në kohën që e takuam ne, ajo ishte thirrur nga Enver Hoxha për t'u bashkuar me përgatitjet e Byrosë Politike për mbledhjet e rëndësishme të partisë që do të mbaheshin në Berat në tetor e nëntor. Sipas Enver Hoxhës, ai e kritikoi rëndë këtë herë se ishte pajtuar me ashpërsinë e zbatuar nga Mehmet Shehu (për «sektarizëm dhe aventurizëm të theksuar») në qëndrimet ndaj «nacionalistëve» dhe përgjithësisht ndaj atyre që nuk ishin me partizanët. Një nga kritikantët e Enver Hoxhës për Liri Gegën në shkrimet e tij ishte se ajo kishte marrëdhënie shumë miqësore me Viktor Smithin dhe se kishte qenë shumë e hapur me të. Ka mundësi që kjo të ketë qenë partizania pa emër, e cila i ngjalli një pakënaqësi të madhe Bill Tilmanit, kur e takoi me Mehmet Shehun në zonën në jug të Vlorës, në një fazë më të hershme të luftës.³ Ajo ishte llafazane e madhe dhe bisedat e saj gjithmonë kishin një përmbajtje të fortë marksiste.

Viktor Smithi erdhi të nesërmen më 26 shtator. Ai ishte në rrugën drejt jugut për të marrë në ngarkim misionin e kuartierit. Meqë ai dhe ne po largoheshim njëkohësisht nga veriu, nuk mbetej asnjëri në zonën e Korpusit I me një përvojë të gjatë në Shqipëri. Në sajë të italianëve, ne qemë në gjendje t'i jepnim Lirisë dhe Viktorit një kënaqësi më të madhe se sa u jepte zakonisht jeta partizane. Për fat të keq, koha ktheu me shumë lagështi e shtrëngata dhe për disa ditë kushtet u bënë të padurueshme. Duke kaluar lumin Shku-

mbin dhe rrugën që ndjek brezin e tij, ne u shkaktuan shumë telashe partizanëve lokalë, sepse gjermanët ende kishin postëroja dhe patrulla në atë zonë, por operacioni kaloi pa ndonjë incident përmes shiut të rëndë.

Në jug të lumit, më 27 shtator, ne takuam Brigadën VII dhe XV që ishin nisur drejt veriut. Takuam gjithashtu dy oficerë të misionit jugosllav në Shqipëri. Ata nuk i treguan emrat e vet. Koloneli Velimir Stojnić, i shoqëruar nga Nijazi Dizdareviçi, kishte ardhur në Shqipëri rreth kësaj kohe si ndërlidhës me Enver Hoxhën dhe kolegët e tij. Ka mundësi që ne të kemi takuar pikërisht ata. Të dy oficerët mbanin uniforma elegante, që binin tepër në sy dhe e bënë të qartë se ata i përkisnin një kulture superiore. Ata mbaheshin shumë më të madh për gradat e tyre, por u sollën miqësisht e këndshëm me ne. Na habiti injoranca e tyre e dukshme për ngjarjet në Shqipëri.

Shiu dhe shpejtësia e marshimit tonë nisën t'i kapisnin disa nga grupi ynë, por Harri na doli i fortë e i shkathët dhe ndihmoi shumë për ta mbajtur lart moralin. Çamë me vështirësi përmes Polisit të Madh, Gjinarit e Gramshit drejt Sotirës e Dobrenjës në luginën e Tomorricës, duke humbur mushkat e dërrmuara dhe ngarkesat me parashutat prej mëndafshi gjatë rrëshqitjeve teposhtë e përpjetë dhiareve me balatë. Nga lugina u ngjitëm lart në Visokë dhe, më 3 tetor, arritëm në misionin e kuartierit në Odrichan, duke e ndier atëhere se kishim kaluar një provë të rëndë fizike.

Alan Palmeri tashmë ishte larguar nga Odrichani për në Itali. Viktor Smithi, i cili kishte ecur më shpejt se ne, tashmë e kishte marrë detyrën me Markus Llajënin si ndihmës. Ata na dhanë mjaft lajme interesante të ndryshme. Partizanët pretendonin se e kishin kthyer Gani Kryeziun nga ana e tyre, gjë që zor se mund të besohej, meqë ata e pranonin gjithashtu se po e mbanin Toni Simkoksin nën kontroll. Bill Maklini po largohej përfundimisht nga vendi, por reshperimet e tij të kohëve të fundit me kolaboracionistë të ndryshëm të njohur, ishin një burim i vazhdueshëm fërkimesh me Enver Hoxhën dhe Shtabin e Përgjithshëm. Edhe Alan Hejri po largohej pasi kishte pasur ndoshta karrierën më laramane dhe raskapitëse nga të gjithë BLO. Forca 399 në Bari kishte vënë në dijeni se së shpejti do të bëhej një deklaratë politike, të cilën BLO me partizanët do ta gjenin të kënaqshme. Ndoshta ne do të shihnim se puna jonë e misionit Stables nuk kishte shkuar e gjitha kot.

Riçard Ridellin dhe mua më morën për t'i bërë një vizitë Shtabit të Përgjithshëm. Shefi i Shtabit, Spiro Mojsiu, na u duk se nuk e meritonte aspak pozitën e tij të lartë dhe ishte njeri i pakëndshëm në bashkëbisedime. Ndoshta kjo ishte arsyeja përse e kishte vënë aty Enver Hoxha. Koloneli Bedri Spahi u duk i zgjuar, por pak i doktrinuar. Frederik Nosi na u duk i fryrë; por pa qenë shumë i zgjuar. Vetë Enver Hoxha derdhte zgjuarsi e forcë joshëse, ndonëse dukej qartë se kjo forcë shuhej po ashtu si dhe mund të ndizej. Ai fliste një frëngjishte të shkëlqyer dhe bënte çmos që të dukej e qartë se ishte njeri i kulturuar dhe intelektual. Ai e falenderoi bujarisht Riçard Ridellin për punën tonë me partizanët dhe nuk e përmendi dimrin tonë mëkatar, duke ua lënë njerëzve më të vegjël, si Mojsiu dhe Nosi, për të prekur pikat e lëndueshme dhe për të nxjerrë ndonjë kundërshtim.

Ne takuam gjithashtu edhe Toni Stefanin, oficerin ndër-lidhës të SHBA me partizanët. Ai ishte nga prejardhja shqiptar dhe dukej se e kishte plotësisht në duar situatën në Shqipëri. Ndryshe nga oficerët anglezë në Shqipëri, të cilët e kishin si kusht që të mos shfaqnin interesim për politikën dhe ishin shpallur se përqendroheshin vetëm e vetëm në luftën kundër gjermanëve, Stefani fliste lirisht se merrte udhëzime nga Departamenti i Shtetit nëpërmjet Zyrës së Shërbimeve Strategjike. Kjo mënyrë e hapur nuk dukej që t'i kishte shkaktuar atij ndonjë vështirësi.

Kur ne u larguam prej tyre, Viktor Smithi ishte i mbushur deri në grykë me konfidencë dhe Markus Lllajeni po i ndihmonte të gjithë që ta shihnin gjithçka nga ana e këndshme. Ne u nisëm për marshim më 5 tetor, pa na mbetur gjë peng. Rruga jonë përmes baltës e shkëlqimit të diellit na nxori në Këlcyrë, ku hymë në një zonë tërësisht të shkretuar. Që aty e deri në Tepelenën e shkatërruar, ne kaluam përmes Grykës së bukur të Këlcyrës, duke pushuar pak çaste për t'i hedhur një vështrim përmendores dikur mburracake e tani patetike kushtuar Divizionit italian Ujku i Toskanë (Lupo di Toscana), një mbeturinë e pjesës së fillimit të luftës, kur Italia sulmoi Greqinë dhe pësoi disfatë të plotë. Më 6 tetor u ngjitëm në fshatin e lindjes së Harrit, Lekdush dhe e gjetëm të djegur deri në themel, por banorët e mëparshëm ishin kthyer përsëri dhe na pritën me gjithë ngrohtësinë e mundshme. Që atje zbritëm teposhtë në Kuç, në rrugën ndërmjet Vlorës e Sarandës. Ne e dinim se po kryhej një sulm me komando në afërsi të Sarandës dhe se Borshi në bregdet po përdorej si një bazë e operacionit. Kishim pasur

shpresë të gjenim një BLO në Kuç, por atje nuk kishte njeri dhe gjithë zona fshatare ishte shkretuar aq keq, sa nuk kishte asgjë as për njerëzit, as për kafshët. Ne ia dolëm mbanë që të hynim në kontakt me komandosët në bregdet dhe dy «katërshë» artilerie erdhën që të na gjenin me datë 7 dhe na zbritën ngadalë, duke na troshitur në një plazh të vogël, që shërbente si bazë furnizimi për një bateri artilerie përballë Sarandës.

Oficerët e artilerisë na trajtuan me kujdes e bujari, sikur të ishim detarë që na ishte mbytur anija ose si refugjatë të vdekur nga uria, apo si aventurierë të raskapitur. Ne qëndruam në plazh, bëmë një banjë dhe falenderuam fatin tonë të mirë që nuk kishim qenë të detyruar të vepronim në zonën bregdetare me gjermanët e me Ballin Kombëtar në rrugën gjatë bregdetit dhe në kepat e bregut. Pasi ra errësira, erdhi një anije zbarkimi dhe ne e ndihmuam që të shkar-konte ngarkesën me predha dhe me fletë llamarine të ndryshkura (për të ngritur strehët kundër shiut). Pastaj nisëm lundrimin për Itali, po më parë ndalëm në plazhin e komandos së pararojës që po bombardohej, për të marrë disa komandos të sëmurë e të plagosur. Nga mesnata ishim larguar prej Shqipërisë dhe po lundronim drejt Italisë në një det të qetë e fosforeshent.

Na u desh rreth një muaj në Bari për t'u shtruar në jetën normale ushtarake. U dhamë lamtumirën italianëve tanë sapo zbritëm në breg dhe me tetarin Elvixh u ndamë dy ditë më vonë. Shpejt na thithi jeta e Klubit të Oficerëve dhe e Hotelit Imperial, që ishte si han për të gjithë ushtarakët e forcave jo të rregullta të çdo lloji. Pas intensitetit të asaj bote të mbyllur vetëm për një çështje, në të cilën kishim jetuar, ne në fillim ishim të çoroditur nga mënyra se si qëndrimi miqësor i të gjithëve kundrejt nesh shoqërohej nga një mungesë e plotë interesimi për çështjen tonë. Raportimi ynë shpejt nisi të na dukej shumë më pak i rëndësishëm, se sa e kishim menduar se do të ishte. Pas nja dy ditësh, Riçardi dhe unë gjetëm një apartament të lirë në një ndërtesë të zënë nga disa FANY dhe u vendosëm atje, duke u marrë me një fanë, klubi për gjithë miqtë tanë. Shpejt pas nesh erdhi në Bari Toni Simkoksi, ndërsa aty ishin ende Majkëll Lisi dhe disa BLO të tjerë nga Shqipëria. Oficerët ndërlihdës britanikë kishin qenë me palë të ndryshme në Shqipëri dhe morën anë të ndryshme kur dolën jashtë prej andej, por të gjithë kishin marrëdhënie të mira njëri me tjetrin dhe hende ku

midis tyre ishte i vogël, në krahasim me hendekun ndërmjet të gjithë atyre kolektivisht dhe personelit të Seksionit të Shqipërisë. Kishte një prirje që të fajësohej personeli për gjithçka që nuk e miratonin BLO në mënyra të ndryshme për secilin. Asnjë nga ata të Seksionit të Shqipërisë nuk dukej të kishte ndonjë forcë ose zjarr. Oficerët e ulët, që ishin në postet e G3 për Politikën dhe Zbulimin, njiheshin si të majtë dhe prandaj si simpatizues të partizanëve por ata nuk ishin të informuar mirë për mënyrën se si ishin zhvilluar ose po zhvilloheshin ngjarjet në Shqipëri. Personeli mbante qëndrime sikur do të ishin ata që do ta bënin mbretin. Politika ishte më tepër një zgjerim i ideve (në pjesën më të madhe të meje) për Shqipërinë, se sa diçka e ndërtuar mbi një bazë të besueshme faktesh. Më në fund, të gjithë BLO i shkruan raportet dhe ia lanë personelit për t'i përcjellë. Me raportin tonë për misionin Stables, Riçardi dhe unë e varrosëm të kaluarën dhe iu kthyem gjërave të tjera e, në radhë të parë, jetës sonë individuale.

Në nëntor unë u largova nga Bari dhe vajta në Regjimentin IV të Husarëve të Mbretëreshës, i cili më kishte pranuar më 1943, kur u largova nga OCTU në Sandhërst. Regjimenti po pushonte në Monte San Vito, jo larg nga Ankona, pas një beteje në Vijën Gotike. Unë u bëra komandant trupash në Skuadronin B të tankeve Sherman. Skuadroni B qëndroi në Monte San Vito deri në krishtlindje dhe pastaj u nis deri në vijën e frontit në veri të Ravenës, në tokat kënetore të shkretuara gjatë lumit Senio. Në janar aty ne hyëmë në veprim, pastaj kaluam në prapavijën e Pezaros në shkurt dhe përsëri në vijën e frontit në mars.

Në mes të prillit, morëm pjesë në mësymjen përmes grykës së Arxhentës drejt Ferrarës dhe e përfunduam me një kalim të shpejtë në bregun jugor të lumit Po në Bargo, më 25 prill. Më 8 maj, kur mbaroi lufta në Europë, ne ishim në Padovë. Disa ditë më vonë, unë pata mundësinë të rregulloja një udhëtim në Venecie, që në atë kohë kishte mbetur një hije e vetvetes dhe atje kërkova familjen e kapitenit Menegaci për t'u dhënë lajme nga Shqipëria për të. Ky ishte veprimi im i fundit i lidhur me Shqipërinë. Nga fundi i muajit, regjimenti u zhvendos në Austri dhe që andej unë u ktheva në Britani nga fundi i verës për të bërë vitin e tretë në Oksford. Pas kësaj, në ditët e para të vjeshtës 1946, më pranuan në Shërbimin Diplomatik. Në atë kohë, në tetor, ndodhi incidenti i dytë i Kanalit të Korfuzit (i pari, duke

qëlluar anijet luftarake angleze nga bateritë bregdetare shqiptare, kishte ndodhur pak muaj më parë). Dy anije luftarake britanike kishin ndeshur mina dhe kishin pësuar humbje të rënda ndërsa po lundronin drejt jugut përmes ngushticës. Që atëhere e më pas, marrëdhëniet ndërmjet Shqipërisë dhe Britanisë e Shteteve të Bashkuara u prishën plotësisht dhe mbetën të prishura gjatë gjithë tridhjetë e gjashtë viteve të punës sime në Shërbimin Diplomatik dhe tetë viteve në pension. Ky libër, ashtu si edhe përpjekjet e tjera për të dhënë përvojën e drejtpërdrejtë nga Shqipëria është kështu një urë e hollë, e hedhur përmes një humnere shumë të gjerë e të thellë.

Shënimet

1. Shih shënimin 4 në kreun 2.
2. PRO, FO 371/43555.
3. Tilman (1946; 137).

Kreu 15

Jehona pas luftës

I

Kur mbaroi lufta me gjermanët, Shqipëria e gjeti veten me pavarësi të rivendosur në kufijtë e paraluftës, nën një qeveri të re, komuniste, e cila ishte pa dyshim e aftë të impononte vullnetin e saj. Kjo qeveri nuk ishte njohur prej asnjë-rës nga fuqitë aleate, por kishte marrëdhënie nëpërmjet misioneve ushtarake me Jugosllavinë, Britaninë, Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimin Sovjetik. Ajo kishte përballë detyrën e madhe të rindërtimit. Në teori ajo kishte nevojë të bënte miq, të tërhiqte ndihmën e huaj dhe të siguronte që të pranohej si fuqi fitimtare, ndërsa integriteti i saj territorial të mos vihej në pikëpyetje kur të hartoheshin traktatet e paqes. Në praktikë, ajo nuk bëri asnjërin nga këto gjëra ose, më mirë, u përpoq që t'i arrinte ato më tepër me anë të luftës se sa të bashkëpunimit. Kjo vinte pjesërisht si pasojë e përqaimit të dialektikës marksiste nga udhëheqësit e saj, pjesërisht nga instinkti i Enver Hoxhës për t'i zgjidhur problemet politike e të pushtetit duke i precipituar krizat, pjesërisht nga dyshimi i rrënjosur i shqiptarëve ndaj gjithë fqinjëve dhe gjithë fuqive të mëdha, pjesërisht nga varësia ekuivoke e Partisë Komuniste të Shqipërisë prej Partisë Komuniste të Jugosllavisë, dhe pjesërisht nga papjekuria e PKSH e nga shpejtësia dhe cektësia e revolucionit që PKSH kishte nisur t'i impononte vendit.

Në punët e brendshme regjimi i ri shpejt nisi një formë të ashpër të luftës së klasave, duke nisur me gjyqet publike të bashkëpunëtorëve dhe të «armiqve të popullit», me dë-

nimet me vdekje, duke i internuar familjet në kampe pune dhe duke shpronësuar pasuritë; më tej vijoi me eliminimin nëpërmjet taksave penale për këdo që mund të vështrohej si kapitalist, dhe kështu arriti në gusht 1945 në një reformë rrënjësore për tokën, që e fshiu gjithë klasën e vjetër të pronarëve të tokave. Partia Komuniste dhe Ushtria Nacional-çlirimtare nuk mund të jepnin të gatshëm një personel të përgatitur, të aftë për të drejtuar administratën kombëtare, por personeli i vjetër iu nënshtrua përndjekjeve. Ushtria, me Mehmet Shehun që siguronte një dorë të nekurt atëhere kur u duhej, veproi me ashpërsi kundër çdo shenje rezistence ndaj masave revolucionare. Problemet ekonomike të Shqipërisë u bënë edhe më të vështira, për shkak të ngutjes dhe të zbrazëtive me të cilat shtyhej përpara revolucioni. Me rritjen e krizës ekonomike, Enver Hoxha duke ndjekur si gjithmonë një *fuite en avant*, e shpejtoi zbatimin e masave «socialiste». Fati i popullit shqiptar u bë shumë i rëndë dhe kjo, nga ana e vet, u kthye në një motiv për më shumë represion dhe ndryshime sociale të pamëshirshme.

Në marrëdhëniet e jashtme, Shqipëria shpejt hyri në mosmarrëveshje me Britaninë dhe SHBA. Këto të fundit bënë thirrje për zgjedhje të lira e të drejta dhe për liritë që lidhen me to. Enver Hoxha dhe udhëheqja e PKSH, që kishin dështuar në formimin e një fronti kombëtar, të pranueshëm gjatë luftës kundër Gjermanisë, dhe që kishin treguar pak mëshirë kundër atyre që nuk kishin hyrë në lëvizjen partizane me kushtet e PKSH, kishin tani frikë nga pasojat po ta zbusnin diktaturën e partisë. Ata gjithashtu vazhduan të besonin se fuqitë perëndimore po kërkonin ta minonin revolucionin. Dhe Jugosllavia, mbrojtësja e Shqipërisë, nuk kishte arsye që ta shkuraonte aktivisht Shqipërinë për të pasur marrëdhënie të këqija me fuqitë perëndimore. Në dhjetor 1945, u bënë zgjedhjet me një listë të vetme, të diktuar nga PKSH dhe asambleja që doli nga këto zgjedhje, në janar 1946, e shpalli Shqipërinë republikë popullore dhe miratoi një kushtetutë të re sipas stilit sovjetik. Jugosllavia e njohu Shqipërinë e re zyrtarisht në prill 1945. Britania, SHBA dhe BRSS bënë po të njëjtën gjë në nëntor 1945, por Britania dhe Shtetet e Bashkuara nuk e pasuan me shkëmbimin e misioneve diplomatike me Shqipërinë, sepse Shqipëria nuk arriti të bënte zgjedhje që mund të quheshin demokratike. Misionet ushtarake të Britanisë dhe të SHBA në Tiranë e panë që gjithnjë e më tepër po u viheshin kufizi-

me dhe pengoheshin në përpjekjet për të mbajtur kontakte jashtë qarqeve më të ngushta qeveritare. Qeveria shqiptare dhe personalisht Enver Hoxha, kishin nxjerrë shumë pengesa për projektet e ofertat e ndihmës perëndimore, duke përfshirë edhe ndihmën nga agjencitë e Kombeve të Bashkuara ndonëse ndihma nga Administrata e Kombeve të Bashkuara për Ndihmë dhe Rindërtim ishte me rëndësi thelbësore për të përballuar krizën ekonomike të menjëhershme pas luftime. Sundimtarët komunistë të Shqipërisë e kundërshtuan veprimtarinë e huaj që dilte përtej shkarkimit të furnizimeve në port. Marrëdhëniet morën tatëpjetën me shumë fërkime dhe, gjatë vitit 1946, së pari Britania e pastaj SHBA i tërhoqën misionet e tyre ushtarake. Me incidentin e Kanalit të Korfuzit në tetor 1946, në të cilin u dëmtuan rëndë dy anije luftarake angleze nga minat, humbi çdo shans se mund të vendoseshin marrëdhënie diplomatike normale. Refuzimi i Shqipërisë për të pranuar përgjegjësinë për këtë ose për t'iu nënshtruar vendimit jo në interes të saj të dhënë nga gjyqi ndërkombëtar, i ka penguar që atëherë marrëdhëniet shqiptaro-angleze. Si pasojë edhe ari shqiptar i paraluftës ka mbetur nën kontrollin tripalësh të SHBA, Britanisë e Francës.

Marrëdhëniet e Jugosllavisë me fuqitë perëndimore u bënë të tendosura menjëherë pas luftime, për shkak të diskutimit për Triesten. Lidhjet e Shqipërisë me Jugosllavinë u thelluan dhe, në korrik 1946, midis dy vendeve u nënshkrua një traktat miqësie, bashkëpunimi dhe ndihme reciproke. Kjo i dha Jugosllavisë po atë lloj kontrolli mbi ekonominë e Shqipërisë, siç ia dhanë traktatet e po asaj natyre Bashkimit Sovjetik kontrollin mbi ekonominë e vendeve satelite të Evropës Lindore. Shqipëria dhe Jugosllavia i bënë zonat e tyre jugore të hapura si strehime dhe baza të sigurta për komunistët grekë gjatë luftës civile në Greqi, dhe kjo shkaktoi që Shqipëria akoma më tepër të kthehej në një shtet të shterisur përsa u përket Britanisë dhe SHBA. Ndërsa Shqipëria në këtë mënyrë u shkëput nga çfarëdo mundësie për ndihmë ose zhvillim nga ana e Perëndimit, lidhjet me Jugosllavinë nuk bënë asgjë për të lehtësuar varfërinë e vendit dhe kjo shkaktoi lindjen e tensioneve në marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave. Nga mesi i vitit 1947, Enver Hoxha vendosi kontakte me Stalinin, gjë që i dha atij një farë shprese për ta mbajtur larg edhe ca kohë kapërthimin nga Titoja, por Koçi Xoxeja, njeriu numër dy në PKSH dhe ministër i punëve të brendshme, punonte me gjithë qejf me jugos-

llavët. Data e caktuar që Shqipëria të hynte në një lloj federate me Jugosllavinë ose ndoshta me Jugosllavinë e Bullgarinë, dukej se do të ishte viti 1948. Koçi Xoxja i dha autoritetit të Enver Hoxhës një goditje, që dukej se do të ishte vendimtare, kur disa nga mbështetësit ose aleatët e Hoxhës u përjashtuan nga Komiteti Qendror në shkurt 1948, duke përfshirë edhe Mehmet Shehun, i cili e humbi postin e tij si shefi i shtabit të ushtrisë. Enver Hoxha vetë u detyrua të bënte autokritikë. Por koha nuk punonte për Xoxen. Më pas do të vinin mosmarrëveshjet ndërmjet Titos e Stalinit dhe, në qershor 1948, Titoja e Jugosllavia u shkishëruan nga Moska. Hoxhës iu dha mundësia të shkëpuste lidhjet me Jugosllavinë dhe të pastronte Xoxen e përkrahësit e tij.

Në vitet që pasuan menjëherë prishjen me Jugosllavinë, regjimi i Enver Hoxhës ra nën sulmet nga një krah tjetër, nga shërbimet sekrete të Britanisë e të Amerikës. Kjo faqe e përpjekjeve për destabilizimin është përshkruar në librin e Lord Bethelit «Tradhtia e madhe»¹. Aty dalin si aktorë emra të ndryshëm që nga 1944: Maklini, Smalji dhe Emeri, Hejri dhe Northropi. Teza e Bethelit është se skema e destabilizimit dështoi, sepse u tradhtua nga Kim Filbi. Ka arsye të plota për të menduar se ajo do të kishte dështuar, edhe po të mos ishte tradhtuar, e ndoshta edhe me një kosto më të lartë se sa ndodhi realisht, sepse do të kishte zgjatur më shumë. Kjo sipërmarrje ishte e mbështetur mbi vlerësimin e gabuar për balancën e forcave në Shqipëri. Pa asnjë dyshim, kushtet e popullit ishin të mjerueshme dhe Hoxha kishte armiq edhe në radhët e veta. Por revolucioni kishte fshirë cilindo që kishte qenë në gjendje të vepronte si udhëheqës jashtë kontrollit të partisë sunduese. Në këtë kuptim, Shqipëria ishte e ngjashme me vendet satelite të Evropës lindore. Ishte një shpresë e humbur të mendoje se pasuesit e mërguar të nacionalistëve, të cilët kishin dështuar më 1944, do të mundnin, pasi të stërviteshin nga Smajli dhe të depërtounin në Shqipëri, të ishin në gjendje të ngrinin njerëz kundër sundimit të hekurt të PKSH, pas gjashtë vjetësh dhune sociale drakoniane. Ajo skemë ishte menduar dhe u zbatua nga njerëz, të cilët nuk kishin arritur të kuptonin forcat revolucionare që i dhanë mundësi Hoxhës dhe PKSH të vinin në pushtet më 1944. E vetmja gjë që u arrit, ishte se vija propagandistike e përhershme e Hoxhës, për armiqësinë e fuqive kapitaliste dhe për qëllimet e tyre të poshtra që nga koha e luftës e këtej, doli në pah si më e pra-

nueshme dhe i dha Hoxhës një pretekst tjetër për të shtrënguar kontrollin «revolucionar».

Që nga 1950 e më pas, pozita e Enver Hoxhës dhe qëndrimi i Shqipërisë kundër Jugosllavisë u dobësuan nga vdekja e Stalinit, nga pajtimi i pjesëshëm që erdhi si pasojë ndërmjet Moskës e Beogradit dhe nga ngritja e «udhëheqjes kolektive» në kurriz të «kultit të individit». Këtu nuk është vendi për të gjurmuar me hollësi ndryshimet e aleancave të Shqipërisë gjatë viteve, nga Bashkimi Sovjetik të Republika Popullore e Kinës dhe gradualisht prapa të një pozitë e paangazhuar izolimi. Këto ndryshime mund të shpjegohen, në një masë të madhe, me faktin se Shqipëria gjithnjë e më tepër është identifikuar me Hoxhën dhe Hoxha nuk kishte aspak ndërmend të shtyhej mënjane nga ndryshimet në lëvizjen komuniste ose në bllokun sovjetik në favor të Jugosllavisë. Brenda Shqipërisë, duke pasur Mehmet Shehun si një krah të fortë mbështetjeje, ai e përforcoi autoritetin e tij duke ndjekur pa ndërprerë «shoqërizimin» në çdo sferë, duke e katandisur popullin shqiptar në një jetesë kolektive tepër të mjerë. Kjo përforcohej edhe me anë të spastrimeve të vazhdueshme në udhëheqje të atyre që herë pas here paraqisnin rezerva të vonuara për disa kthesa të reja të ashpra në luftën e klasave, ose për ndonjë kuturisje të re në polemikat ndërkombëtare, apo në rrahjet e gjoksit dhe politikën në prag të katastrofës për marrëdhëniet ndërkombëtare. Sa më e sigurtë bëhej dora e Hoxhës që kishte mbërthyer Shqipërinë, aq më pak ai kishte nevojë të gjente padronë të jashtëm. Nga fundi i jetës së tij, ai madje e ndjeu veten aq të fortë jo sa ta sfidonte Jugosllavinë, por sa të jepte një shenjë për të shkaktuar turbullira në Kosovë. Spastrimi i madh i fundit në periudhën e sundimit të tij, ka qenë «vetëvrasja» që iu imponua Mehmet Shehut nga fundi i vitit 1981, që ndoshta do të ketë ardhur për shkakun se vetë mbështetësi i hekurt, më në fund, kishte nisur të jepte shenja ligështimi, ndërsa militantizmi i Hoxhës vazhdonte në kursin e krisur por të llogaritur me djallëzi pas 40 vjetësh konfliktesh e krizash pa pushuar. Udhëheqësit e tjerë të ushtrisë partizane kishin rënë ose ishin flakur mënjane që prej shumë kohësh më parë. Kur më 1985 Enver Hoxha vdiq, brezi që bëri luftën dhe e solli komunizmin në Shqipëri, më në fund e la skenën.

Ekzistenca e Shqipërisë sot nuk vihet në diskutim. Shumë shpejt pas vdekjes së Hoxhës, u vendosën marrëdhënie diplomatike me Greqinë. Jugosllavia pësoi humbjen e maresha-

lit Tito, unifikuesit të saj të madh, pesë vjet më parë, dhe Kosova me popullsinë e saj shqiptare u bë një forcë shpërthyes brenda federatës jugosllave, në vend që të ishte një pretekst për planet jugosllave kundrejt Shqipërisë. Pasuesit e Enver Hoxhës mund të fillojnë të sillen siç mund të sillen normalisht sundimtarët e një vendi të siguar, duke zhvilluar marrëdhënie pozitive në vend të marrëdhënieve negative. Do të ishte një pikëpyetje, a do të kishte qenë Shqipëria po kaq e pavarur, e sigurtë dhe e pacenuar nga ana territoriale, siç është sot, nëse Enver Hoxha do të ishte rrëzuar gjatë luftës ose menjëherë pas saj. Por popullit shqiptar, atyre që ishin të rinj më 1944 e u grumbulluan nën flamurin e partizanëve dhe prindërve të tyre, iu desh të paguanin një çmim shumë të lartë për ta pasur Enver Hoxhën si udhëheqës. Ndoshta fëmijët e partizanëve dhe, aq më tepër, nipërit e tyre do të jenë më me fat.

II

Janë botuar disa libra rreth përvojës në Shqipëri më 1943 e 1944. Shumica e tyre nuk flasin me simpati për partizanët. Vetëm njëri, i Bill Tilmanit, me titullin «Kur takohen njerëzit dhe malet» (dhe vetëm pjesa që merret me Shqipërinë) e shtron çështjen në mbështetje të partizanëve². Libri i gjeneralit Dejvis «Aventura ilire» jep një paraqitje të gjallë për jetën dhe marrëdhëniet me Enver Hoxhën e kolegët e tij në fund të vitit 1943 dhe në ditët e fundit të katastrofës së misionit të Kuartierit, por ai mbulon një periudhë shumë të shkurtër të luftës partizane dhe përqendrohet më tepër në dështimin e vajtueshëm të partizanëve se sa në sukseset e partizanëve, që në fakt u dhanë atyre mundësinë të fitonin³.) Gjithë librat e tjerë janë shkruar nga oficerë që u zhgënjyen me partizanët dhe mbrojtën çështjen e bajraktarëve, të zogistëve, të BK e të «nacionalistëve» të tjerë në qendër dhe në veri të Shqipërisë. Asnjë nga oficerët që e kaluan dimrin e 1943-1944 dhe pranverën e verën e 1944 me partizanët në jug e sipas rastit, gjithashtu në qendër e në veri, nuk ka shkruar ndonjë libër. Si pasojë, literatura për luftën në Shqipëri është shumë e njëanshme dhe jep vetëm një tablo të pjesshme të ngjarjeve. Ndoshta ky libër do ta ndreqë pak balancën.

Për fat të keq, ata, librat e të cilëve përkrahin çështjen e nacionalistëve dhe mbështeten në aspektet negative të veprimtarisë së partizanëve, i përmbahen vijës së Shqipëria u lejua të binte nën sundimin komunist prej të metave dhe neglizhencave nga ana e oficerëve britanikë dhe e hartuesve të politikës britanike, të cilët për arsye të ndryshme, të palidhura me interesat më të larta të Britanisë, i armatosën partizanët dhe kështu i ndihmuan për të marrë pushtetin. Peter Kempin në «Pa ngjyra e pa kreshtë» ka një tufë fjalish, të cilat e sintetizojnë qartë këtë pikëpamje.

«Shqipëria... ishte një flijim plotësisht i panevojshëm që iu bë imperializmit sovjetik. Ishin iniciativa britanike, armët dhe paratë britanike që e ushqyen rezistencën shqiptare më 1943, ashtu siç ishte politika britanike më 1944 që u tërhoq dhe ia dorëzoi një fuqie armiqëore ndikimin tonë, nderin tonë dhe miqtë tanë»⁴).

Një nënçështje është se puna e oficerëve të virtytshëm që ishin me nacionalistët, u minua nga komunistët dhe majtistët në organizatën e SOE. Disa autorë më diskriminues e ngushtojnë këtë deri sa t'ia ngarkojnë njërit nga oficerët e personelit më të ulët në Seksionin e Shqipërisë në Bari, që ishte anëtar i Partisë Komuniste të Britanisë, një tjetri që kishte simpati për të majtët dhe Eliot Uotrousit, që kishte pikëpamje «përparimtare». Versioni më i keq dhe më hapur diskriminues i kësaj *canard* del në librin e Lord Bethelit «Tradhtia e madhe»:

«Disa nga oficerët e SOE, si shkrimtari Xhejms Kluzman, ishin anëtarë të Partisë Komuniste. Disa të tjerë, si Basil Davidsoni, Xhejms Ejri dhe Rexh Hiberti ishin njerëz të së majtës politike dhe kundërshtarë të vijës që mbanin Maklini dhe Emer. Maklini thotë për Eliot Uotrousin... Ai kishte pikëpamje shumë «përparimtare» dhe ne e ndienim se ai mbështeste kampin komunist kundër nacionalistëve në të gjitha nivelet». U mbeti «musketierëve» (Maklini, Smajlit dhe Emerit) dhe një grushti të tjerësh — Toni Nilit, Xhon Hiberdinit, Antoni Northropit, Peter Kempit dhe Toni Simkoksit — që të formonin një minoritet antistalinist në Seksionin e Ballkanit të SOE, gjë për të cilën ata e panë veten se po u vinin etiketën të tjerët si «spiunët fashistë»⁵).

Në këtë paragraf Betheli përçon thashethemet e pakontrolluara nga lagjja e përkrahësve të nacionalistëve: ai vetë,

që ka qenë vetëm gjashtë vjeç më 1944, nuk ka pasur ndonjë aftësi depërtuese brenda në lojën e personaliteteve të atij viti. BLO me nacionalistët në qendër e në veri ishin në fakt më të shumtë në numër se sa BLO me partizanët në jug: poza e tyre sikur janë trajtuar ashpër nga pakica, është e rreme. Është fiktive ndarja e BLO në dy grupime politike, të majtët që mbështetën partizanët dhe antistalinistët që mbështetën Kupin, krerët nacionalistë e Maklinin, ndonëse në vitet e mëvonshme disa nga ata që mbështetën nacionalistët janë prirur që ta pretendojnë për vete në mënyrë retrospektive nderin se kanë qenë pionierët e antistalinizmit.

Sër Aleksadër Glen i shton një njollë të pakëndshme historisë së përkrahësve të nacionalistëve në «Pikëmbështetje kundër një shakulline».

«Është pretenduar se komunistët u prishën mendjen burrave e grave me idenë e guximshme të shoqërisë së re që ata pikturonin. Kjo mund të ketë pasur një pjesë të së vërtetës në Jugosllavi, por unë besoj se pak ka pasur të bëjë në Shqipëri. Ato që i përcaktuan ngjarjet kanë qenë armët, të cilat iu dhanë Enver Hoxhës e partizanëve, veçanërisht pas kapitullimit të Italisë... kanë qenë krerët fisnorë dhe oficerët besnikë si Abaz Kupi, që kishin qenë miqtë tanë të besuar prej vitit 1940, dhe, në kundërshtim me gjithë përpjekjet e njerëzve si Bill Maklini dhe Xhulian Emeri, në fund të punës në bëmë shumë pak që t'ua shpërblenim besnikërinë e tyre. Në vend të kësaj, pa qenë nevoja ne lejuam që ata të mundeshin dhe disa të tradhtoheshin.

Kim Filbi prej kohësh i kishte futur mirë disa nga kolegët e tij në organizatat përkatëse».⁶⁾

Nënkuptimi i dy fjalive të fundit duket se është që fitorja e partizanëve në Shqipëri u arrit përmes tradhtisë nga ana e disa oficerëve, që merreshin me Shqipërinë në SOE, gjë që duhet të thotë se ishin oficerët në seksionin e Shqipërisë në Bari dhe/ose BLO me partizanët në Shqipëri. Kjo niollë e pahijshme del gjithashtu në parathënien e Patrik Laj Fermorit për librin e David Smailit «Misioni në Shqipëri»: ai shkruan për Maklinin e Smajlin:

«befas u kuptua se disa persona në seksionin e tyre të GHQ po punonin kundër tyre. Siç e dimë, aparati ynë sekret i kohës së luftës ishte herë pas here një lloj dadoje e paditur dhe e mirë për figura, që ecnin butë-butë në majë të gishtave nëpër shtegun e Filbit drejt

shiritave të gradave, posteve të larta dhe katedrave shkencore, ndërsa shpërblimi real i tyre duhej të kishin qenë Flamuri i kuq dhe daçat e rehatshme.7)

Përsëri si nënkuptim duket se del që ishte Filbi i palavdishëm, i paemër në aparatit e SOE, i cili ia grabiti Kupit dhe Maklini suksesin dhe ua dorëzoi Shqipërinë komunistëve. Ndoshta ky libër do të shërbejë për të treguar se sa absurde është kjo teori e konspiracionit në lidhje me Shqipërinë. Oficerët britanikë që e panë veten se po mbështesnin një palë humbëse, nuk duhet ta ndiejnë të domosdoshme që të lëshojnë akuza të papërcaktuara për tradhti, me qëllim që ta reklamojnë veten sikur janë Leonidha i ditës së fundit, që mbron trimërisht grykën me një tufë të vogël luftëtarësh kundër hordhive të komunizmit. Gjithë oficerët britanikë të angazhuar në operacionet e SOE në Shqipëri, ishin në atë kohë të angazhuar besnikërisht në përpjekjet për të luftuar kundër gjermanëve. Ata që ishin me partizanët ia dolën me sukses ta bënin këtë faktikisht.

Argumenti se Enver Hoxha u soll në pushtet nga furnizimet britanike me armë, meriton pak më shumë vëmendje se sa teoria e konspiracionit, por edhe ajo nuk i qëndron dot një shqyrtimi të hollësishëm. Gjatë paraqitjes që kemi bërë më sipër, është treguar se sasi të armëve dhe të pajisjeve që iu dërguan Shqipërisë kanë qenë relativisht të vogla, të pamjaftueshme në vetvete për të pushtuar një vend, por megjithatë kanë qenë me rëndësi në kohë dhe vende kyçe. Po kjo gjë është e vërtetë për floringjtë e dërguar në Shqipëri nëpërmjet BLO, ndërsa një përmbledhje e tyre jepet në Shtojcën 4 në fund të librit. Partia më e rëndësishme e armëve, municioneve dhe pajisjeve që iu dorëzua partizanëve gjatë gjithë fushatës ndoshta ka qenë, dhe në mënyrë mjaft ironike, pikërisht ajo që u sigurua nga Maklini dhe Smajli, kryeantistalinistët, më 1943. Kjo i dha mundësinë LNC që të armatoste Brigadën I nën Mehmet Shehun. Mund të diskutohet që pushteti i Enver Hoxhës u rrit nga armët e Brigadës I. Ishte mbijetesa e kësaj brigade në dimrin 1943-1944 që i siguroi bërthamën rigjallërimit dhe zgjerimit fenomenal të LNC dhe të ushtrisë partizane në pranverën e vitit 1944. Rasti i dytë me rëndësi thelbësore për furnizimet, ndodhi në fund të korrikut e në gusht 1944, kur Divizioni I partizan u rifurnizua gjatë betejës së Dibrës. Pa këtë ndihmë divizioni I ndoshta do të ishte detyruar të tër-

hiqej drejt jugut. Ata që përkrahin nacionalistët, e shohin këtë si faktori që vulosi vdekjen e nacionalistëve. Ata argumentojnë se Britania, ose më saktë kuartieri i Forcës Ajrore të Ballkanit në Bari, duhej ta kishte vazhduar ndalimin e fillimit të korrikut për furnizimin e partizanëve, me qëllim që të detyrohej Enver Hoxha të merrej vesh me Abaz Kupin. Kjo do të thoshte që me qëllim të pengohej një betejë kundër gjermanëve për të hapur një front kundër komunizmit. Nuk është aspak për t'u habitur që në rrethanat e mesit të vitit 1944, kuartieri i Forcës Ajrore të Ballkanit mori vendimin për të mbështetur betejën kundër gjermanëve. Ata që mbështetën Kupin dhe nacionalistët tani mund të veshin togën e antikomonizmit, por kjo nuk ishte një pikë në rendin e ditës të Ushtrisë Britanike më 1944.

Në rast se Brigada I nuk do të kishte ekzistuar në dimrin 1943-1944, kishte mundësi që LNC të ishte shkatërruar nga bashkërendimi i gjermanëve dhe ballistëve. Caqet brenda të cilave mbijetoi LNC ishin shumë të ngushta. Megjithatë, LNC kishte përhapur rrënjë të fuqishme organizative në pjesën më të madhe të jugut, ndërsa shkatërrimi i fshatrave dhe i shtëpive nga gjermanët e ballistët shkaktoi që një masë fshatarësh të dilte malit. Të rinjtë dhe shumë nga të rejat e kësaj mase të mbetur pa asgjë, ishin material i gatshëm për oficerët partizanë të rekrutimit. Mundësia ishte që zogu feniks partizan, sido që të ndodhte, do të ringjallej nga hiri në pranverë dhe, nëse nuk do të kishte qenë në dispozicion një sasi e konsiderueshme armësh britanike, partizanët do të përdornin armët që qenë në gjendje t'ua merrnin italianëve dhe i vunë mënjanë gjatë dimrit dhe pastaj do ta ngrinin forcën e tyre duke ua rrëmbyer armët armiqve. Do të kishte qenë më e vështirë të siguroheshin municionet. Lufta civile do të kishte pasur intensitet më të ulët, do të kishte zgjatur më shumë dhe ndoshta do të kishte qenë më e përgjakshme. Meqë nuk u bë një zbarkim nga forcat perëndimore (dhe duhet vënë në dukje se nuk kishte forca në dispozicion për këtë qëllim), duhej të pritej që më në fund të fitonin partizanët. Të njëjtat konsiderata janë të zbatueshme edhe për rastin hipotetik që të vazhdohej bllokimi i furnizimeve për Divizionin I në korrik e gusht 1944. Luftimet e brendshme do të kishin vazhduar më gjatë, partizanët do të kishin fituar në fund dhe gjermanët nuk do të kishin qenë të detyruar që ta çanin me luftë rrugën për të dalë nga Shqipëria.

Sër Aleksandër Glen hedh dyshime mbi përmasat, në të

cilat komunistët pushtuan mendjet e burrave e të grave në Shqipëri me idenë e guximshme të Shqipërisë së re që pikturonin. Ka shumë të ngjarë që burrat e gratë e Shqipërisë u zhgënjyen thellë nga ideja e guximshme e shoqërisë së re që nga viti 1945 e më pas, por nuk ka asnjë dyshim për entuziazmin popullor rreth saj gjatë disa muajve në mes të vitit 1944 në gjithë Shqipërinë e jugut dhe në gjithë zonat, në të cilat depërtuan njësitë partizane. Në Shqipërinë e vitit 1944 u çlirua një forcë revolucionare dhe ishte kjo forcë parësore që e solli Enver Hoxhën në pushtet. Revolucionet kanë një rrugë për të çuar në përfundime, të cilat njerëzit që në fillim i përkrahin, nuk i kuptojnë, por kjo nuk e pakëson fuqinë transformuese të revolucionit të gjallë gjatë kohës që ai vazhdon. Enver Hoxha dhe Partia Komuniste e Shqipërisë, shpërthyen revolucionin dhe e drejtuan atë me sukses, ndërkaq ata u ndihmuan shumë nga shkatërrimi i pamëshirshëm që u bë në të gjithë vendin në fillim nga italianët dhe pastaj në mënyrë më të egër e të papërmbajtur nga gjermanët, të ndihmuar nga ballistët. Më 1944 krerët nacionalistë e dinin se shkatërrimet e shkaktuara nga gjermanët, po kërcënonin që të nënshkruanin fundin e sistemit social nëpërmjet të cilit ekzistonin vetë krerët. Kjo ishte arsyeja fundamentale e dështimit të tyre për të lëvizur kundër gjermanëve: ata nuk mund të sodisnin shkatërrimin që do të vinte si pasojë dhe që do t'i fshinte ata vetë.

Kjo çon te teza, e parashtruar nga BLO që ishin pro Kupit e pro nacionalistëve, se aleatët duhet të kishin hequr dorë nga ndihma për partizanët, të cilët duke luftuar kundër gjermanëve ishin përgjegjës se provokonin shkatërrimet, të cilat rrënuan sistemin e vjetër shoqëror. Në vend të kësaj, argumentojnë ata, aleatët duhej të kishin pritur deri në kulmin final të luftës dhe atëhere duhej të kishin derdhur armët për nacionalistët, në mënyrë që ata të përftonin një kryengritje kombëtare, që nuk do të kishte lënë as kohë e as hapësirë që të realizohej shkatërrimi nga ana e gjermanëve. E meta e parë praktike e kësaj teze është se nuk ekzistonte një sistem siç kërkohet i hedhjeve ajrore, i aftë për një furnizim masiv, të menjëhershëm në orën e fundit dhe nuk mund të sajohet vetëm për t'iu përshtatur Shqipërisë. Kërkesa e nacionalistëve (me përjashtimin e nderuar të vëllezërve Kryeziu) ishte e pandryshueshme, që në fillim të vinin furnizimet e pastaj luftimet. Në praktikë kjo do të thotë se nuk

do të kishte rezistencë. Britanikët këmbëngulnin që të vinte rezistenca përpara furnizimeve. Në praktikë kjo do të thoshte rezistencë e partizanëve (të udhëhequr nga komunistët). As SOE dhe as BLO që angazhoi ajo, nuk e kuptonin këtë logjikë kur u morën në fillim me Shqipërinë. BLO që ishin me partizanët e kuptuan këtë logjikë në kohën që u larguan. Ata që mbetën me nacionalistët e kanë kamufluar dështimin e tyre për ta kuptuar atë, duke hequr zvarrë cironkën e tymosur të teorisë së konspiracionit dhe duke u krekosur se kanë luftuar komunizmin dhe jo gjermanët.

Partizanët luftuan me trimëri dhe efikasitet kundër gjermanëve më 1944. Kjo ishte ajo që kërkonin aleatët në atë kohë. Këtë ndihmoi SOE që të arrihej në Shqipëri. Nga ana ushtarake, kjo nuk ishte ndonjë gjë e madhe në perspektivën e luftës në tërësi, por gjatë luftës kishte vlerë edhe çdo gjë e vogël. Vendi i huaj që kontribuoi më shumë për komunistizimin e Shqipërisë nuk ka qenë Britania, por Gjermania. Kur makina luftarake shkatërrimtare gjermane u shkatërrua më në fund vetë, ishte komunizmi që mbeti prapa, i cili mori komandën mbi rrënimet e Shqipërisë. Ishte Hitleri dhe jo Uinston Çurçilli, që e solli komunizmin në Evropën Lindore. Ishin krerët nacionalistë shqiptarë, që e flakën tej shansin e tyre për të luajtur një rol të Shqipërinë e pasluftës me hezitimin e tyre për të luajtur një rol në luftën kundër push-tuesit gjerman. Mund të diskutohet se ishte ca si shumë t'u kërkohej atyre që të rrezikonin, duke shkatërruar strukturën e tyre sociale dhe vetveten, me anë të kundërshtimit të vendosur ndaj gjermanëve. Porse në qoftë se ata nuk mund ta bënin veten që të merrnin përsipër këtë rrezik, edhe Britania në rrethanat e vitit 1944 nuk mund të parandalonte që ata t'i përllante dallga komuniste.

III

Përvoja shqiptare ishte shumë intensive. Deri më sot Shqipëria është vendi më pak i njohur në Evropë dhe më i largëti nga pikëpamja e lehtësisë së komunikimit. Gjatë luftës ishte e mundur të hyje në vend, por ishte shumë e vështirë për të dalë prej andej. Nëpër malet ku BLO ishin të detyruar të bënin punën, pothuaj nuk gjendej dot asnjëri që

të kishte përvojë nga bota e jashtme ose që të merrte vesh nga punët e vendeve të huaja. Disa nga partizanët më të vjetër kishin kaluar nga pak vite jashtë shtetit, por ideologjia e tyre komuniste i bënte bashkëbisedues të vështirë e të ngushtë. Ata që hynin në Shqipëri e gjenin veten menjëherë të shkëputur nga gjithë elementët familjarë të jetës së tyre të mëparshme dhe të kufizuar me komunikimet nga më të brishtat nëpërmjet radios me kuartierin e tyre, në fillin në Egjipt e pastaj në Itali, që ishte e vetmja pikë e kontaktit të tyre me botën joshqiptare. Ekzistonte edhe një vështirësi e mprehtë e gjuhës, sepse asnjëri nga oficerët britanikë nuk e dinte shqipen dhe vetëm nja dy mund të flisnin italishten, që ishte gjuha e huaj më e zakonshme. Kjo e bënte të pashmangshme varësinë nga përkthyesit dhe shumica e atyre shqiptarëve të pakët që flisnin anglisht e që mund të gjendeshin, kishin telashet e veta. Ata që ishin partizanë, kishin urdhra të rrepta për të vepruar si mbikëqyrës e rojtarë. Ata që ishin pasues të këtij apo atij nga krerët, kishin prirje të sillehin si pjesëtarë të mafies.

Oficerëve BLO iu desh të jetonin në atë vend kryesisht duke i blerë gjërat e nevojshme (ushqimin, bujtjen, kuajt, mushkat) me lira flori dhe napolonë flori. Disa herë, kur punët e misionit ecnin mbarë, ata jetonin mjaft mirë, ndonëse në një mënyrë pak barbare e gjithmonë primitive; por kur një mision kishte telashe, siç ndodhte shpesh, ata detyroheshin të kufizoheshin me dietën e ashpër prej buke misri, fasulesh, djathi të bardhë (prej qumësht deleesh, dhish ose lopësh) dhe, kur rastiste, mish i ndonjë bagëtie të sapotherur. Alkoli gjendej gjithmonë lehtë në trajtën e rakisë së zier nga rrushi ose kumbullat, e ndonjëherë edhe verë, ndërsa kishte me bollëk duhan vendi në çdo stinë për cigare të dredhura me dorë. Nuk kishte fare pajisje higjienosanitare për t'u larë, porse një ujë i pastër rridhte nga burimet në çdo shpat mali. Gjatë dimrit të gjithë BLO, me përjashtim ndoshta të atyre në misionin e kuartierit, përdorën pjesë të veçanta nga rrobat e vendit, kryesisht sepse u mungonin rroba rezervë të tyre, kështu që e çuan deri në pikën e skajshme zakonin regjimental anglez për ta bërë uniformën sa më të ndryshme nga ajo e oficerit fqinjë. Shumicën e kohës teshat dhe sendet personale katandiseshin në vetëm atë që mund të mbante një çantë e vogël shpine ushtarake, ndonëse mund të ngarkoheshin mbi mushka disa sende të tjera plotësuese (kur shpëtonin nga sulmet e armikut dhe nga ndjekjet e grabitjeve

të miqve), nëse misioni ishte mjaft i madh dhe në një zonë mjaft të sigurtë. Materiale për të lexuar vinin me pakicë të madhe, me përjashtim të misioneve që kishin furnizime të bollshme ajrore në baza të sigurta dhe nuk dihej se çfarë libri do të na binte në dorë e në çfarë vendi. Madje edhe kur kishte diçka për të lexuar, ishte shpesh e vështirë për ta lexuar, sepse në shtëpitë shqiptare hynte pak dritë gjatë ditës dhe natën ndriçimi bëhej me lampa vajguri e me qirinj në rastet më të mira; kurse zakonisht nuk kishte gjë tjetër veçse pishtarë ose zjarr.

Këto rrethana i shtrënguan oficerët ndërlidhës britanikë të jetonin sipas mënyrës shqiptare — të hanin, të pinin, të flinin, të merrnin frymë e të mendonin sipas mënyrës shqiptare — sepse ditën e natën në jetën e tyre nuk kishte gjë tjetër veç Shqipërisë. Kjo pati një efekt të shënuar psikologjik mbi ta. Ata patën një prirje për të fituar një lloj ndjenje besnikërie lokale, gati fisnore, pothuajse po aq të tërbuar sa edhe ajo e vetë shqiptarëve. Ata që ishin me partizanët u bënë shumë propartizanë dhe ata me nacionalistët ose me zogistët prireshin të bëheshin shumë të lidhur ndaj krerëve me të cilët ishin personalisht në kontakt, si dhe shumë antipartizanë. Këto lidhje shpesh u theksuan nga ndjenjat e detyrimit personal. Pati shqiptarë të veçantë në të gjitha grupimet dhe lëvizjet e ndryshme, të cilët i ndihmuan dhe u shërbyen BLO të veçantë me besnikëri e bujari, dhe këta njerëz patën fatin të pësonin një trajtim të ashpër nga kundërshtarët politikë, kur fatet e luftës u kthyen kundër tyre. Kjo ndodhi veçanërisht me pasuesit e kampit të nacionalistëve, të cilët ranë në duart e partizanëve. Dhe kjo pati një ndikim të thellë mbi ndjenjat e BLO.

Kur ushtria partizane po i afrohej fitores më 1944, u bë gjithnjë e më i shprehur karakteri i saj komunist, ose më tepër nënshtrimi i saj ndaj udhëheqjes komuniste të pakompromis, të vendosur për të zbatuar politika doktrimore. Kjo i shtoi një mbiton ideologjik anësisë që ndienin BLO për njërën apo për tjetrën palë. Ata që punonin me partizanët dhe përkrahnin mbështetjen e plotë për partizanët (sepse partizanët e trenguan veten të aftë për të mobilizuar vendin kundër gjermanëve), e panë veten të akuzuar se po ndihmonin komunistin, ndërsa ata që punonin me zogistët e nacionalistët e panë të mundshme që t'ia hidhnin fajin për dështimin e klientëve të tyre dhe të çështjes së tyre jo të metave të vetë klientëve dhe paaftësisë së tyre për të përballuar dhunën

e ushtruar nga gjermanët, por një force të përcaktuar gabimisht si komunizmi sovjetik, shtrirja e mëtejshme e të cilit u lehtësua nga vetëkënaqësia dhe dritëshkurtësia e pothuaj kujtdo tjetër, vetëm jo të atyre vetë.

Në fakt, Bashkimi Sovjetik nuk luajti pothuaj asnjë rol për të sjellë fitoren e komunizmit në Shqipëri dhe Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik asnjëherë nuk ia arriti ta vinte Partinë Komuniste të Shqipërisë nën kontrollin e saj efektiv. Megjithatë, Shqipëria humbi pa diskutim për fuqitë perëndimore dhe një vend i humbur për perëndimin pranohej se ishte fituar nga Bashkimi Sovjetik. Konteksti shqiptar i revolucionit shqiptar në fillim u la pas dore dhe pastaj shpejt u harrua, kështu që u bë e modës të flitej për Shqipërinë sikur iu dorëzua komunizmit, sikur komunizmi kishte qenë një forcë e jashtme dhe jo e brendshme. Natyrisht, kjo është doktrina e pastër e nacionalistëve shqiptarë, të lidhur në mënyrë të pazgjidhshme me armiqtë e tyre ndaj fqinjëve sllavë. Ajo e shpërfill faktin e rëndësishëm se partizanët ishin shqiptarë dhe një lëvizje e rritur brenda në vend, dhe ajo nuk arrin dot të shpjegojë përse shqiptarët e rinj, jo komunistë, u bashkuan me mijëra e me entuziazëm me lëvizjen partizane më 1944, e kështu ua nënshtruan veten, dhe më pas, fëmijët e tyre disa dhjetëvjeçarë të sundimit komunist më të ashpër. Dobësia përfundimtare e argumentit se Shqipëria ishte «një sakrificë plotësisht e panevojshme që iu bë imperializmit sovjetik», është se ai nënkupton, gabimisht, që Britania kishte mundësinë që të vendoste se cila do të ishte e ardhmja e Shqipërisë. Britania dhe oficerët e saj ndërlihdën nuk ishin në gjendje ta bënin këtë. Forca që e ktheu Shqipërinë në komuniste ishte reagimi vendas revolucionar i Shqipërisë ndaj pushtimit italian e gjerman dhe dhuna e terrori me të cilat u imponua ai. BLO patën vetëm një ndikim anësor mbi rrjedhën e ngjarjeve. Vetëm një zbatim në Shqipëri i forcave të konsiderueshme të Aleatëve do të mund t'i detyronte ngjarjet të merrnin një kthesë tjetër.

Rezultati i luftës në Shqipëri ishte zhgënjyes për gjithë BLO, pavarësisht nga pala që përkrahnin. Zhgënjimi i atyre që ishin me nacionalistët që thjesht zhgënjimi nga disfata. Ai i BLO me partizanët që më i ndërlikuar. Në një kuptim, ata patën kënaqësinë që të ishin në anën e palës fituese, por në një kuptim tjetër, ata e ndien se, fitorja u bë e thartë edhe ashtu si u arrit. Marrëdhëniet me udhëheqësit partizanë asnjëherë nuk ishin plotësisht të shtruarra dhe u bënë edhe më

të ashpërsuara, kur Enver Hoxha dhe kolegët e tij nisën të nuhasnin fitoren dhe pushtetin. Diskutimi i gjatë mbi Kupon u përfundua shumë vonë dhe nuk mbeti ndonjë shans për marrëdhënie me qeverinë e Enver Hoxhës, që të niseshin nga një bazë mirëbesimi ose madje respekti. Forca joshëse e Enver Hoxhës u provua vazhdimisht se ishte një armë taktike afatshkurtër, lëvizjet e tij strategjike prireshin gjithmonë të ishin jo miqësore dhe të dëmshme. Ata që punuan me partizanët mbeteshin, në fund, me një ndjenjë se i kishin shfrytëzuar. Fitorja nuk ishte e tyrja; arritjet u cenosën; lufta kundër gjermanëve u transferua larg nga Shqipëria; Shqipëria asnjëherë nuk kishte qenë plotësisht një aleate dhe tani gjithnjë e më tepër u bë e huaj.

Njerëzve që shërbyen si oficerë ndërlidhës britanikë u mbeti një vulë nga Shqipëria, në kuptimin që të gjithë ata morën me vete ndjenja të forta nga ngjarjet në të cilat kishin qenë pjesëtarë. Fakti që Shqipëria relativisht nuk kishte rëndësi dhe izolimi që i imponoi vetes nga pjesa tjetër e Europës, nuk lejuan që të kishte kanale normale për shprehjen e atyre ndjenjave, ashtu siç kishin ekzistuar për ata që punuan me forcat e rezistencës në vendet e tjera. E megjithatë këto ndjenja të forta kanë mbetur të gjalla për mbi dyzet vjet dhe deri më sot ish BLO ndahen në ata që ishin me partizanët dhe ata që ishin me nacionalistët, ndërkajq ata i ruajnë të gjalla dallimet e tyre të vjetra.

Unë i kam provuar këto ndjenja dy herë në një mënyrë shumë të drejtpërdrejtë gjatë karrierës sime në shërbimin diplomatik. Më 1951 përgjegjësi i atëhershëm i Departamentit të Sigurimit në Ministrinë e Jashtme më pati thënë se ishte paraqitur një informatë kundër meje nga dikush, që më kishte njohur mua në Shqipëri, sipas së cilës unë kisha qenë komunist në atë kohë dhe se e kisha pranuar vetë se kështu kishte qenë. Mua më morën në pyetje siç duhej. Çështja u mbyll. Gjatë hetimit unë e kuptova se informuesi duhej të kishte qenë i nderuari Rouland Uin dhe, kur unë ia shpreha këtë hetuesit, ai e pranoi heshturazi. Siç e ka treguar ditari im, unë qeshë në kontakt me Uinin për tri ditë nga fundi i shtatorit 1944, pikërisht nga fundi i qëndrimit tim me misionin Stables. Uini kishte thyer këmbën kur u hodh te ne më 19 shtator dhe unë e ai diskutonim me tërbim, sa herë që unë i afrohesha, për të mirat dhe të këqijat e përkrahjes së partizanëve apo të nacionalistëve. Ai, me gjithë zellin e të sapoardhurit, na tha se ne e kishim gabim.

që mbështesnim partizanët. Unë, me dhjetë muaj qëndrim në Shqipëri prapa krahëve, i thashë se partizanët ishin të vetmit që e vlenë t'i mbështesje. Besoj se do t'i kem shtuar se, po të kisha qenë shqiptar, unë do të isha bërë partizan. Duke thënë këtë, unë duhet të kem qenë i vetëdijshëm se nga shtatori 1944 fjala «partizan» po bëhej sinonime me komunist. Siç duket, Uini më regjistroi si njeri të rrezikshëm. Më 1951, ai ishte kthyer nga një provë e rëndë me regjimentin e tij në Kore dhe dukej hapur se ishte i mbushur plot me frymën e kryqëzatës kundër komunizmit dhe atyre, që ai i zgjidhte me dyshimin se ishin shërbëtorë të tij. Uini dhe unë ishim takuar njëri me tjetrin herë pas here në raste ngjarjesh të ndryshme në Londër, duke përfshirë në mënyrë mjaft të papritur edhe nja dy mbledhje të regjimentit, pasi regjimenti i tij i vjetër, Regjimenti i 8-të i Husarëve, u shkri me timin, Regjimentin e 4-t të Husarëve, për të formuar Regjimentin Mbretëror Irlandez të Mbretëreshës. Ne shkëmbeu formula mirësjelljeje, por kurrë nuk kishim diskutuar për Shqipërinë ose për mendimet e tij kundër meje. Unë nuk e ngrita çështjen, meqë dijenia ime për hapin e tij ishte plotësisht e rezervuar, dhe kujtova se ai nuk e ngriti atë, sepse ai nuk e dinte që unë e dija.

Shumë vjet më vonë, në fillim të vitit 1980, kur unë isha ambasador në Paris, Zyra për punët e jashtme dhe të Komonuellthit më paralajmëroi se Rouland Uini (që tashmë ishte bërë Lord St. Osuold) edhe një herë tjetër po jepte informata kundër meje, këtë radhë te njerëz të njohur me influencë në Francë, duke përfshirë edhe kontin Mishel Ponnjatovskin (Michel Poniowski), bashkëpunëtorë shumë të ngushtë të presidentit të Republikës, z. Zhiskar D'Esten (Giscard d'Estaing). Me sa duket, ai u kishte thënë atyre për takimin që kishte pasur me mua gjatë luftës dhe për gjoja simpatitë e mia komuniste. Zyra FCO më tha se ata po ndërmerrnin hapa për t'i rikujtuar atij hetimin e kujdesshëm që ishte bërë për denoncimet e tij më 1951, të cilat ata i kishin parë se ishin të pabazuara, dhe për ta bindur që të hiqte dorë nga përhapja e tyre e mëtejshme në qarkullim. Mund të mendohet se është e jashtëzakonshme që një takim i shkurtër e i parëndësishëm në malet e Shqipërisë në vjeshtën e vitit 1944, do të vazhdonte të kishte një jehonë pothuaj dyzet vjet më vonë. Por për dikë që ka shërbyer në Shqipëri, kjo nuk është e habitshme. Ata që morën pjesë në ngjarjet e atyre viteve ende kanë ndjenja të forta lidhur me to,

dhe ata që u besonin teorive të konspiracionit në atë kohë; mesa duket u besojnë ende edhe sot. Shumica nuk do ta shtynin pasionin ose fanatizmin e tyre deri në ekstremin, sa të bënin denoncimin, ose të përpiqeshin të diskreditonin ambasadorin e vendit të tyre, por shumë prej tyre gjithçka që e quajnë si të keqen në botën moderne, e gjurmojnë deri te origjina në përvojën e tyre shqiptare. Kaq e gjallë ka qenë kjo përvojë dhe kaq efekt të zgjatur ka pasur tek ata që e kaluan atë.

Në realitet, procesi në të cilin ne qemë dëshmitarë në Shqipëri më 1943 e 1944 ishte, ashtu si shumica e proceseve historike, shumë kompleks dhe kështu fajet dhe/ose meritat për të kanë qenë të përhapura shumë gjerë. Oficerët ndërlidhës britanikë ishin figura të vogla në një skenë shumë të gjerë. Vetë Enver Hoxha në atë kohë nuk ishte një figurë e madhe. Ishin ngjarjet ato që ishin të mëdha. Fare pranë dhe brenda një hapësire shumë të vogël kohe ne pamë se si fati i një kombi do të ndërronte nga ndeshje të rastit, nga caqe të ngushta, nga shanse të humbura për fije dhe nga kthesa të jashtëzakonshme të fatit. Ngjarjet ishin të rëndësishme për Shqipërinë dhe tani mund të shihet se kanë qenë të rëndësishme për fqinjët e Shqipërisë. Oficerët britanikë që morën pjesë në to, ndoshta mund të përlligjen që pranojnë si të vërtetë, se një pjesë e përgjegjësisë për ta ishte vetë e tyre, dhe që vazhdojnë ta vështrojnë këtë përgjegjësi me seriozitet. Është e vështirë të mos e marrësh seriozisht diçka që e ke përjetuar aq intensivisht. Por mbetet fakt që ishin dhe janë vetë shqiptarët ata, që përcaktuan fatin e vendit të tyre nën tryshninë e ashpër që iu imponua atyre jo nga Britania, por nga lufta e Gjermanisë. Dhe, në fund të fundit, do të jenë shqiptarët ata të cilëve u takon të japin një gjykim vendimtar për rezultatin.

Shënime

1. Bethell (1984).
2. Tilman (1946).
3. Davies (1952).
4. Kemp (1958, 231).
5. Bethell (1984; 16).
6. Glen (1975; 157).
7. Smiley (1984; XI).

Shtoiçë 1: Parashtrësja e Muharrem Bajraktarit

Teksti i raportit që përgatiti Muharrem Bajraktari në shkurt 1944 dhe që iu komunikua misionit Stables për t'ia transmetuar Antoni Idenit e Uinston Çurçillit ishte një paraqitje tipike, por e hartuar jashtëzakonishtë mirë, e pikëpamjes «nacionaliste». Originali u shkrua shqip dhe unë e përktheva anglisht nëpërmjet përkthimeve me gojë frëngjisht e italisht.

Ndërlikimet e procesit të përkthimit dhe, në përgjithësi, të komunikimit ndërmjet misioneve britanike dhe mikpritësve të tyre shqiptarë, ndoshta mund të çmohen nga një vështrim mbi dy tekstet e letrave që morën Majkëll Lisi dhe Riçard Ridelli nga Muharrem Bajraktari.

Monsieur
Leutnate

Je vien de vous raconter d'aujourd'hui, si vous plait faire le contact de me attendre.

Salutation cordiale

(nënshkruar) Muharrem Bajraktari

Ujmisht le 18.1.1944

Mon tres cher
R. Riddell

Jé avai recui le letter du 24.3.1944
Jé suis bien informé que les allamande sont retirez de Si-
lova, apres qu ont bruller les maison de M. Ali Dika.
Nous somme tous jours en garde, pour sa jaustement nous
avons fikcé le patrulle.

Islam it eté vénu de Prizrend, il ne a'pa trouvaiz le
posibilite du change les argon qu vous avait doner, ekepte
troi, par $3 \times 26 = 78$ napulon papier albanais.

Il a donez quelque chosé des argenterie, si vous plaiseie, ce
par vous, après quelque jours nous pauvons rekomande les
outer.

Je vous priér, visez mois au ce trouve Kap Hands, et oci
fair svoiare les drektion qu vous prendera en nesečiti.

Monsier le Majr, akcepté mai salutation très cordiale, et
oci bi pér M. M. Simcox et Hebert.

Votre Amis

(nënshkruar) Muharrem Bajraktari

27.3.1944

Më poshtë jepet teksti i plotë i raportit të Muharremit:

Shkëlqesisë së tij

Të nder. imzot Antoni Iden, anëtar parlamenti,

Sekretar i shtetit për Punët e Jashtme

Londër.

Shqipëria ka qenë e pushtuar nga Perandoria Osmane
për shumë shekuj, por në shekullin e 19-të nisi një krye-
ngritje popullore, e shoqëruar me lëvizjen për të zgjuar
ndërgjegjen kombëtare dhe për të fituar pavarësinë.

Pas 448 vjetësh shtypjeje Shqipëria e fitoi lirinë e saj
më 28 nëntor 1912 me shumë vështirësi.

Lufta e vitit 1914 e çoi ekzistencën e saj drejt një fundi
shkatërrimtar dhe, mbi të gjitha të këqijat, rivalitetet ndër-
mjet fqinjëve të saj i shkaktuan popullit të saj shumë dëme
gjatë kësaj periudhe.

Nga fundi i kësaj lufte populli shqiptar u detyrua të

mbronte interesat e veta dhe rrëmbeu armët kundër Jugosllavisë, Greqisë e Italisë. Kur mbaruan ky gjak e këto sakrificat, që na u imponuan, të drejtat e një shteti të pavarur iu garantuan Shqipërisë në përputhje me dokumentet dhe vendimet e Konferencës së Ambasadorëve.

Kufijtë e këtij shteti nuk u bazuan aspak në parimet e drejtësisë etnike. Ky shtet i vogël bëri një jetë fatkeqe si nga pikëpamja ekonomike, ashtu edhe politike, sepse influenca jugosllave e drejtuar kundër tij është një burim turbullirash dhe një pengesë e pakapërcyeshme kundër saj në të gjitha qarqet diplomatike për përcaktimin dhe vendosjen e kufijve të tij.

Ky popull, të cilit iu mohuan të drejtat, jetonte herë mirë e herë keq gjatë 27 viteve të turbullirave të vazhdueshme dhe të një vargu të pafund incidentesh, që kanë qenë shkakuar nga Italia e Jugosllavia. Unë kam nderin të parashtroj më poshtë ngjarjet më të rëndësishme.

Shkëlqesia juaj,

Jugosllavia ka përdorur të gjitha marifetet dredharake të një dhelpre për të sunduar Shqipërinë. Zhvillimi i planeve të saj nga viti në vit është i dokumentuar shumë mirë.

Në një revolucion më 1924 Fan Noli mori pushtetin për një kohë të shkurtër dhe ishte e qartë se ai kërkonte ta bënte Shqipërinë një qendër për komunizmin në Ballkan, ku ai do të ishte në gjendje të bënte propagandën e përhapjes së komunizmit ndër shtetet e tjera evropiane. Ai u dëbua me forcë nga Shqipëria dhe për një kohë të shkurtër ideologjia komuniste këtu ra. Por dy vjet më vonë komunizmi nisi të organizohej sërish dhe vazhdoi përpjekjet e tij sistematike. Iniciatorë dhe propagandistë të kësaj politike ekspansioniste ishin grupet jugosllave.

Më 1924 diplomacia jugosllave u përpoq të merrte nga Zogu, që ishte atëhere kryeministër, të drejtat për rrugët drejt Durrësit e Vlorës dhe të drejtat për të ndërtuar baza detare në ato porte. Zogu refuzoi që t'i plotësonte këto kërkesa, pasi mori në dorë kontrollin e shtetit. Në një rast kur unë isha larguar nga vendi për arsye politike më 1935, këtë propozim ma përsëritën mua personalisht në Beograd. Jo vetëm u bënë këto kërkesa për të drejtat e rrugëve dhe bazat detare në Durrës e në Vlorë, por u shtuan edhe këto gjëra të tjera.

Si shpërblim për një marrëveshje ndërmjet shtetit shqiptar dhe Jugosllavisë, Jugosllavia do të ishte e gatshme t'i

jepte Shqipërisë gjithë territorin e Kosovës deri në kufirin që ishte përcaktuar përpara vitit 1912 ndërmjet mbretërisë serbe dhe perandorisë osmane, por kjo do të bëhej vetëm me kushtin që *policia, ushtria dhe financat e Shqipërisë do të kontrolloheshin nga Beogradi*. Të drejtat e tjera të natyrës administrative duhet t'i ruheshin mbretit të Shqipërisë. Nga ana ime, unë i refuzova këto propozime dhe menjëherë ika nga Beogradi. Kur Jugosllavia e pa se ishte e pamundur ta arrinte synimin e saj nëpërmjet manovrave të veta diplomatike për të marrë Shqipërinë dhe ndoshta edhe vende të tjera të Ballkanit, ajo e ndërroi sistemin e taktikave të veta. Ajo nisi të ndërtojë një komunizëm ndërballkanik, që do të thotë pansllav, programi i të cilit vazhdonte po në atë rrugë si gjithmonë.

Beogradi kishte filluar një organizim përgatitor në ushtrinë e vet që para lufte, me qëllim që ta shpallte Jugosllavinë automatikisht si shtet komunist. Pas një periudhe në të cilën do të mbarështrohej ky program dhe do të vihej në zbatim, grupi jugosllav u nda në dy pjesë, me qëllim që të bënte më mirë një manovër të dyanshme dhe kështu do të mund të kundërvepronte me përshtatshmëri më të madhe kundër çfarëdo përshtypjeje që do të bënte politika e saj në qarqet diplomatike të fuqive të mëdha.

Është fare e qartë dhe e sigurtë që po të realizohet ky projekt, komunizmi do të arrijë në brigjet e Adriatikut dhe të deteve përreth Greqisë dhe do t'i hapet xhadeja për përparimin e tij në Mesdhe. Mbetet për ta shqyrtuar nëse ka bashkëpunuar edhe BRSS për këtë program. Pa dyshim, përgjigja është që po, dhe ai ka për ta ndihmuar grupin sllav që ta arrijë qëllimin e vet.

Ne e kemi luftuar komunizmin në Shqipëri dhe ende vazhdojmë ta luftojmë, sepse ai absolutisht nuk u përshtatet interesave kombëtare dhe parimeve tradicionale të popullit të saj.

Shkëlqesia juaj,

Populli shqiptar gjithmonë ka shpresuar që të marrë ndihmë nga Britania e Madhe — *ndihmë politike, morale dhe materiale*, dhe ne e themi hapur se e kërkojmë këtë ndihmë pa asnjë rezervë.

Është e domosdoshme të na ndihmoni për të përgatitur një organizatë që të mbrojë të drejtat tona brenda kufijve tanë kombëtarë dhe etnikë. Për ta arritur këtë qëllim, ne shpresojmë që të hedhim themelet në luftë (një kryengritje ku-

ndër trupave gjermane që sot kanë pushtuar vendin tonë). Kjo ndoshta do të nisë në muajt prill dhe maj 1944. Operacionet do të zgjerohen në marrëveshje me misionet britanike që janë tani këtu, ose me të tjera, të cilave do t'u ngarkohet një detyrë e tillë.

Për ta vënë në lëvizje këtë kryengritje dhe për ta zhvilluar atë, ne kemi nevojë në radhë të parë për këto gjëra.

Materiale luftarake, armë, pajisje dhe para

1. Pushkë, municione e pajisje.
2. Automatikë, pushkë gjysmautomatike, mitralozë të lehtë e të rëndë, pushkë antitank dhe mitralozë kundërajrorë.
3. Artileri e lehtë, topa kundërtank e kundërajrorë dhe mortaja të lehta.

4. Bomba, granata, eksplozivë dhe specialistë për shkatërrime.

5. Forca ajrore: duhet të caktohet një njësi, që t'u japë mbështetje nga afër operacioneve tona taktike dhe strategjike. Bazat ajrore duhet të zgjidhen në pika të ndryshme në bregun italian përballë Shqipërisë dhe ato duhet të kenë komunikim shumë të afërt me komandën e forcave shqiptare. Kjo do të sigurohet nëpërmjet oficerëve ndërlidhës të caktuar posaçërisht për këtu.

6. Mjete komunikimi nëpërmjet misioneve dhe komandave brenda gadishullit të Ballkanit (radio),

7. Për të përballuar kërkesat tona dhe për t'u dhënë zemër njerëzve që do të luftojnë këtu, del një nevojë imperative për një shumë prej rreth 500.000 lirash deri 1.000.000 lira sterlina.

8. Ne shpresojmë se armët dhe pajimet do të na sigurojnë një forcë për rreth 40.000 deri te 80.000 burra, që do të organizohen në çeta dhe në njësi më të mëdha ushtarake për aksione kundër armikut. Këto aksione do të bëhen në lidhje me përparimin e ushtrive aleate.

9. Këto furnizime dhe para do të na jepen herë pas here në përputhje me kërkesat tona dhe me sukseset e operacioneve tona, të cilat do të raportohen nga misionet britanike në marrëveshje me komandën shqiptare.

Pasi të çlirohen portet dhe rrugët kryesore, dhe të konsolidohet përgjithësisht situata, ne do të kemi nevojë për mbështetje të rregullt me furnizime dhe para për të organizuar ushtrinë e shtetit. Kjo çështje mund të shqyrtohet dhe të diskutohet më vonë.

Duhet shtuar këtu se Greqia duhet të organizohet si një ba-

zë kombëtare dhe se ajo duhet të qëndrojë nga ana jonë në këtë projekt. Shqiptarët dhe grekët së bashku formojnë racën pellazge dhe së bashku ata duhet të bashkëpunojnë kundër kërcënimit të komunizmit. Këta dy popuj, që janë jashtë kufijve të sllavizmit, duhet të konsolidohen në mënyrë të qëndrueshme e të përhershme, duke iu ruajtur atyre të drejtat që ata kanë fituar. Përndryshe ata do të jenë në rrezik që të humbasin jo vetëm pavarësinë e tyre, por pa dyshim edhe gjuhët e tyre dhe rrënjët e tyre racore.

Konfederata e Ballkanit

Kjo federatë duhet të ndërtohet me ndihmën e kombeve aleate mbi bazën e nacionalizmit dhe në asnjë mënyrë mbi bazën e supremacisë sllave. Në mes të popullit shqiptar duhet të gjendet pikënisja për nacionalizmin në Ballkan dhe ky popull do të marrë iniciativën për zgjerimin. Ne mund të shpresojmë që të kemi sukses në arritjen e një rezultati vendimtar, nëse aleatët do të vendosin ta drejtojnë aksionin e tyre në përputhje me këtë politikë. Partitë nacionaliste të Serbisë e të Bullgarisë duhet të ndihmohen në mënyrë të matur dhe duhet të arrihet që të bashkërendojnë veprimet me komandën shqiptare dhe me misionet aleate, që do të kenë midis tyre përgjegjësinë për drejtimin e luftës.

Në rast se Serbia dhe Bullgaria nuk do të bashkëpunojnë por do të bëjnë ndryshe, atyre u duhet refuzuar ndihma, me qëllim që të mos u lihet atyre një mundësi për të guxuar që të marrin çfarëdo mase kundër interesave të popullit shqiptar. Rëndësia e kësaj politike do të kuptohet në të ardhmen, sepse interesat e Ballkanit përputhen plotësisht me ato të Kombeve të Bashkuara dhe kjo politikë do të na sigurojë një miqësi të vërtetë midis popujve. Ju lutem t'ia dërgoni këto mendime shkëlqesisë së tij, kryeministrit z. Çurçill.

Dhe së fundi, shkëlqesia juaj, ju lutem të pranoni nderimet e mia dhe përshëndetjet e mia shumë të respektuara dhe të përzemërta.

Koloneli
Muharrem Bajraktari

Shënim

Burimi i tekstit është një kopje e raportit që e kam në zotërim privat.

Shtojcë 2. Raport për gjendjen në Shqipërinë e veriut nga nënkoloneli Maklin dhe kapiteni Xhulian Emeri. me datën 18 qershor, marrë në Londër më 26 qershor 1944.

Raporti është riprodhuar me përpikëri siç del në dosjet e Arkivit Qendror të Shtetit (PRO, FO, 371/43551) i plotë bashkë me disa gabime të shifrimit e të transmetimit.

1. U bënë dy muaj që kur u ktheva në SHQ dhe me hapjen e Frontit të Dytë unë e quaj se ka ardhur koha për t'ju dhënë një vlerësim të kushteve, në të cilat Nacionalistët e Shqipërisë gege mund të luftojnë kundër gjermanëve. (Termi «Nacionalist» do të përdoret kudo për t'u dalluar nga LNC).

2. Është me rëndësi fundamentale për problemin që udhëheqësit nacionalistë, të cilët përfaqësojnë rendin shoqëror ekzistues, mund të bëjnë operacione në atë masë, sa ata kanë mundësi në mënyrën përkatëse të mbrojnë shoqërinë e tyre kundër raprezaljeve të armikut. Pamundësia për të siguruar mbrojtjen çon ose në flakjen e udhëheqësit prej shoqërisë, ose në modifikime rrënjësore në rendin shoqëror, në të cilin mbështetet pushteti i udhëheqësit. Meqë rrjetit rrugor i Shqipërisë lë vetëm fare pak limane natyrore të sigurta, ku do të mund të gjenin mbrojtje përkrahësit e nacionalistëve me pasurinë e tyre të luajtshme, del si rrjedhim që aksionet guerilje në shkallë të vogël nga nacionalistët janë të detyruara të jenë shumë më inferiore se ato të LNC. Meqë janë në kundërshtim me nacionalistët, udhë-

heqësit e LNÇ nuk e mbështesin pushtetin e tyre në rendin shoqëror ekzistues, por më tepër në shpërbërjen e tij dhe duke mos pasur përgjegjësi për influencë fisnore ose territoriale si kundërshtari, kanë avantazhin e lëvizshmërisë.

3. Nga ana tjetër, meqë nacionalistët e kanë nën kontrollin e tyre organizmin e gatshëm të shoqërisë ekzistuese, mund ta rrisin më lehtë kryengritjen e përgjithshme, duke e ditur që po të zgjasë dhe të gjejë sukses, ajo u siguron mbrojtje përkrahësve të saj, dhe pasi të ketë nisur, do të përkrahet automatikisht nga frika e disfatës. Në kundërshtim me revolucionin e LNÇ, që është rritur në një kryengritje të përgjithshme pjesërisht duke shfrytëzuar shpërbërjen e rendit shoqëror, të shkaktuar nga raprezaljet kundër aksioneve të tij të para në shkallë të vogël, kryengritja e nacionalistëve nëse do të materializohet, do të nisë afër kulmit të saj dhe, po të dalë pa sukses, do të bjerë në një luftë gueriljesh dhe në pasivitetin eventual. Prandaj del si rrjedhim që, pasi kryengritja e nacionalistëve fillon në kulmin e saj dhe mbështetet në një element befasie, vlera e saj ushtarake mund të pakësohet nëse do t'i përmbahemi në mënyrë shumë të rreptë parimit që nuk jepen furnizime përpara se të bëhen aksionet.

4. Dështimi i një kryengritjeje të nacionalistëve mund të sjellë shembjen e rendit shoqëror, që e ka përfutur, kështu që vetëm në rast se është i mundshëm suksesi i plotë, udhëheqësit nacionalistë ka të ngjarë të ngrihen, në qoftë se shpresat e tyre për mbështetje afatgjatë ose personale (duket për pushtetin) t'i justifikojnë rregullat.

5. Nacionalistët shqiptarë të të gjitha ngjyrave e pranojnë që gjermanët do të munden dhe e quajnë se LNÇ, si një trashëgimtar mbetës rival, do të jetë armiku i tyre kryesor. Kështu që nacionalistët ishin në favor të ruajtjes së forcave, përderisa hyrja e gjermanëve dukej relativisht e largët dhe kishte shumë veta që besonin në një konflikt anglo-rus, por me hapjen e Frontit të Dytë dhe duke vazhduar të mos ketë një prishje anglo-ruse, nacionalistët po bëhen shumë të vetëdijsëm për izolimin e tyre përballë armiqve të tyre tradicionalë, serbë e grekë dhe për rivalët e tyre për pushtet, LNÇ, që ata besojnë se kanë mbështetjen e Titos e të Ruisë. Të kuptuarit e kësaj po prodhon atë që mund të quhet një situatë revolucionare të së djathtës, në të cilën udhëheqësit do të ishin të gatshëm për t'iu drejtuar masave të dëshpëruara për ta thyer izolimin e tyre.

6. Anglia u duket atyre si i vetmi aleat i mundshëm në ngushticën ku ndodhen, por njëkohësisht ka një rënie mjaft të dukshme të besimit në qëllimet e Anglisë në Ballkan, për shkak se po rritet përshtypja sikur ne ia kemi shitur Rusisë interesat tona në Ballkan.

7. Në një vend më të përparuar, mungesa e këtij besimi mund të kapërcehet vetëm me një garanci dhe me deklarata publike lidhur me kufijtë dhe regjimin e ardhshëm dhe, në këtë kuptim, janë bërë kërkesat e mëparshme për një farë njohjeje publike të Zogut. Megjithatë udhëheqësit e tjerë, dhe në analizë të fundit madje edhe Kupi në veçanti në rast se do të marrë udhëzime private nga Zogu, janë të përgatitur për një varg motivesh që të marrin furnizime dhe para, si një alternativë për mungesën e dëshmisë së përkrahjes britanike për aspiratat e tyre. Nga kjo rrjedh se mungesa e tanishme e besimit, e cila (çon) mban prapa shumë nacionalistë, mund të kapërcehet pa ndërlikuar angazhime politike.

8. Prandaj unë vij në përfundimin që:

I. Një kryengritje e përgjithshme është një përdorim më i frytshëm i forcës nacionaliste se sa një aksion në shkallë të vogël.

II. Meqë një kryengritje fillon afër kulmit të saj, është me rëndësi që disa para dhe furnizime t'u sigurohen përpara aksionit.

III. Nga vëzhgimet e raportuara në mesazhet e mëparshme, mund të quhet se po të sigurohet mbështetja e Kupit, Muharremit, Gani Kryeziut dhe Markagjonit, pjesa tjetër e Shqipërisë gege do t'i ndjekë.

IV. Ekziston një situatë, në të cilën mund të nisë një kryengritje nacionaliste, por me rënien e tanishme të besimit në qëllimet britanike për Ballkanin, do të ishte një optimizëm i tepruar të priteshin rezultate, nëse paratë dhe të gjitha furnizimet do të ndaleshin përpara se të niste aksioni.

9. Përpjesëtimi i parave të kërkuara do të jetë në raport me armët e furnizuara, por unë e çmoj që me furnizime të vogla të topave, të mortajave dhe të municioneve, një revoltë nën udhëheqjen e përmendur më sipër do të vlerësohet rreth 25000 lira stërlina. Unë nuk e mendoj që nuk ka shumë rrezik se udhëheqësit do t'i fusin në xhep paratë dhe do të refuzojnë aksionet në këtë fazë të luftës, kur ata e kuptojnë se një veprim i tillë automatikisht do t'i damkoste ata si tradhtarë.

10. Si sipërmarrje ushtarake unë nuk kam asnjë dyshim se kryengritja do t'ia vlejë paratë e dhëna, por natyrisht ajo shtron çështje politike, për të cilat unë nuk jam kompetent që t'i gjykoj. Megjithatë do të guxoja të them mendimin se, në qoftë se nuk bëhet një kryengritje e nacionalistëve dhe nacionalistët nuk nxjerrin avantazhet materiale e morale që vijnë prej saj, ata do të kenë pak shanse për ta penguar LNÇ që të marrë pushtetin me forcën e armëve në luftën civile, të cilën pas thyerjes së gjermanëve vetëm një ndërhyrje e huaj mund ta shmangte.

11. Vendimi përkatës nëse do të mbështetet një kryengritje, duhet të arrihet sa më shpejt, meqë ka dëshmi të mjaftueshme nga raportet tuaja për propagandën e LNÇ dhe nga vëzhgimet e mia, se LNÇ mund të sulmojë Kupin dhe udhëheqësit e tjerë Nacionalistë me qëllim që t'i shtyjë ata të kërkojnë mbështetje nga qeveria dhe gjermanët, kurse ata po e kompromentojnë veten në mënyrë të pandreqshme përballë aleatëve dhe opinionit publik.

Shtojcë 3. Paraqitje e shkurtër e kapitenit Menegaçi për veprimet e baterisë së tij malore me Brigadën I Partizane.

I nderuari zoti major,

Siç kemi rënë dakord, po ju dërgoj një shënim të shkurtër mbi jetën dhe bëmat e baterisë. Ju lutem nxehtësisht që të këmbëngulni për dërgimin e predhave për *obuza 75/13 të modelit Skoda italian, të plota me gëzhajat dhe mbushjet.*

Do të ishte e përshtatshme që hedhja të bëhej në afërsi të Peshkopisë, meqë nesër ne do të zhvendosemi drejt atij lokaliteti. Ju shpreh mirënjohjen time për mirësjelljen e shfaqur në çdo rast ndaj meje dhe artilierëve të mi, dhe ju falenderoj përzemërsisht për sendet e jetës së përditshme që me aq bujari patët dëshirën të m'i jepnit dje. Uroj që në një ditë jo të largët të kem mundësinë (t'ju pres) ju dhe togerin në shtëpinë time në Venecie.

Ju lutem pranoni, së bashku me togerin Hibert, përsë-ndetjet e mia më të respektueshme e të përzemërta.

Juaji
Kapiten Vito Menegazzi

Pas armëpushimit të Italisë, bateria mori pjesë në betejën e Krujës, e përfshirë në Divizionin Firenze kundër gje-

rmanëve me qëllimin për të arritur në brezin bregdetar dhe për t'u bashkuar me forcat e tjera italiane, që besohej se ekzistonin në atë zonë. Duke qenë se ishte e pamundur të realizohej ky plan, bateria komplet me njerëzit e kafshët, u bashkua me Brigadën I partizane sulmuese të Shqipërisë dhe tashmë ka një vit që lufton në bashkëpunim vëllazëror me këtë njësi të lavdishme. Të gjitha aksionet më të rëndësishme të Brigadës kanë pasur mbështetjen e artilerisë italiane që, përmes vështirësish që shpesh dukeshin të pakapërcyeshme, në sajë të guximit e të vetëmohimit të artilerëve, u gjend gjithmonë e gatshme për të vepruar në vendin dhe në çastin e kërkuar. Beteja e parë u bë kundër kazermave dhe depove gjermane në fushën e aviacionit të Devollit, dhe kjo e shumë aksione të tjera u bënë më pas: beteja e Mallakastrës, e puseve të naftës në Patos; beteja e Dukatit, e Kurveleshit, e Velçës dhe Bolenës, e Skraparit, e Përmetit. I kemi përshkuar malet e Shqipërisë në të gjitha drejtimet nëpër dhiare, nën shirat e pambaruara të vjesh-tës dhe në palcë të dimrit, kur kafshët zhyteshin në dëborë deri në bark, gjithë lumenjtë e Shqipërisë i kemi kaluar në vah nga dy herë. Vështirësitë për të ushqyer mushkat, na kanë detyruar ta zvogëlojmë grupin deri në një top, dhe ndërsa një pjesë e artilerisë shndërrohej në këmbësorë të lavdishëm, duke kaluar pjesërisht në batalionin italian «Antonio Gramshi» dhe pjesërisht në batalionet shqiptare; katër prej tyre dhanë jetën në një aksion të guximshëm kundër garnizonit gjerman të Konispolit; topi vazhdoi të mbështeste aksionet e Brigadës së palodhshme të Parë. Krahi-nat e Gorës, Mokrës, Tomorit kanë dëgjuar zërin e topit kundër gjermanëve. Në pranverë brigada u nis drejt veriut, pas luftimeve të ashpra u pushtua Peshkopia. Jemi ngjitur dhe i kemi kapërcyer malet e Maqedonisë, që i kalojnë të 2500 metrat, për të rënë në befasi mbi Dibër, ku garnizoni gjerman u detyrua të mbyllej në kazermat e fortifikuara. Lufta e ashpër nuk ka mbaruar, ajo duhet të vazhdojë pa ndalesë deri në dëbimin e plotë të gjermanëve dhe në thyerjen e tyre përfundimtare.

Shtojcë 4: Dërgimi i floririt në Shqipëri. Prill 1943 deri në tetor 1944

Në pjesë të ndryshme të këtij libri është argumentuar që armët, municionet dhe pajisjet që iu dhanë partizanëve në Shqipëri, ndonëse ishin me rëndësi nga sasia, nuk mund të vështrohen si të mjaftueshme në vetvete për të shpjeguar fitoren e partizanëve. Shifrat nuk i mbështesin pohimet se Britania, pa qenë nevoja, e braktisi Shqipërinë në duart e komunizmit nëpërmjet një politike furnizimi me armë tepër dorëlëshuar e të papërgjegjshme.

Po kjo gjë është e vërtetë edhe për furnizimet me ar, që u dërguan në Shqipëri. Një letër nga kol. F. W. Deakin dërguar Philip Broad, më datën 29 nëntor 1944 (PRO, FO. 371/43554), përmbante një përmbledhje të arit që ishte kanalizuar për Shqipërinë nga SOE. Llogaritja është bërë me lira flori, ndonëse në praktikë ari arrinte te misionet në vend në formën e napolonave flori, po ashtu si edhe të stërlinave flori. Përmbledhja është kjo:

Gjendja e përafërt e arit që depërtoi në Shqipëri nga prilli 1943 deri më 31 tetor 1944

Stërlina flori të dërguara	76.200
Dhurata për UNÇSH për ushqime, veshje, armë, municione	31.900
Pagesa për krerët nacionalistë, duke përfshirë Gani Kryeziun	2.200

Pagesa për krerët e tjerë, duke përfshirë Kupin	4.900
Të humbura në hedhjet ose nga aksionet e armikut kundër kuartiereve të misionit	14.500
Të vjedhura nga misionet	1.500
Të futura në dhe dhe të pamarra	1.000
Të kthyerat financës për evakuimin e personelit	2.800
Paradhënie për personelin e misionit për udhëtime, rikonjicione etj., për agjentë të tjerë, për RAF dhe USAAF të pakthyerat	5.900
Mbajtja e misioneve, dmth ushqimi, fjetja, udhërrëfyesit, rojat, mushkat, tagjia, ryshfetet, agjentët informativë etj.	10.500
Bilanci që ka Field për t'u llogaritur	1.000
	76.200

Partizanët (Ushtria Nacionalçlirimtare Shqiptare ose UN-ÇSH) kanë marrë një subvencion shumë më të madh se kushdo tjetër. Nga 31.900 stërlina flori që kanë marrë ata, pikërisht më pak se gjysma (15000) u janë kaluar atyre nga gjenerali Dejvis në fund të vitit 1943 për t'u dhënë mundësi atyre që të blenin ushqime e të paguanin për ushqimet e gjetura më parë. Në prill 1944, 1000 stërlina u dhanë për fondet e partizanëve si ndihmë për civilët. 1000 sterlina të tjera u dhuruan më vonë për të ndihmuar ringritjen e spitalit në Korçë. Shuma të mëdha janë dhënë për t'u garantuar partizanëve që të merrnin në punë civilë. Një sasi e rëndësishme ari u dha për të ndihmuar Korpusin I partizan dhe Divizionin I për ta mbajtur veten në Shqipërinë qendrore gjatë betejës së Dibrës. Pas 10 tetorit 1944, nuk është dërguar fare ar në Shqipëri.

Ari që iu dha, pa dyshim, i ndihmoi partizanët që të mbijetonin në dy periudha kritike, gjatë ofensivës së dimrit të gjermanëve dhe gjatë betejës së Dibrës, por 32.000 monedha floriri vështirë se mund të vështrohen sikur e kanë blerë Shqipërinë për komunizmin.

Bibliografia

- Anon., (1981) *Rreth ngjarjeve në Kosovë*, Tiranë, Shtëpia Botuese «8 Nëntori».
- Anon., (Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste pranë KQ të PPSH) (1982) *Historia e Partisë së Punës të Shqipërisë*, botim II, Tiranë, Shtëpia Botuese «8 Nëntori».
- Alia, R., (1988) *Enveri ynë*, Tiranë, Shtëpia Botuese «8 Nëntori».
- Amery, J. (1948) *Sons of the eagle* (Bijtë e shqiponjës) London, Macmillan.
- Amery, J. (1973) *Approach march* (Marshi i afrimit), London, Hutchinson.
- Auty, P. dhe Clogg, R. (1974) *British policy towards wartime resistance in Yugoslavia and Greece*. (Politika britanike ndaj rezistencës në kohën e luftës në Jugosllavi dhe Greqi), London, Macmillan.
- Barker, E. (1976) *British policy in south-east Europe in the second world war* (Politika britanike në Evropën juglindore gjatë Luftës së Dytë Botërore), London, Macmillan.
- Bethell, N. (1984) *The great betrayal* (Tradhtia e madhe), London, Hodder and Stoughton.
- Churchill, W. S. (1951 dhe 1952), *The Second World War; Volume IV — The Hinge of Fate; Volume V — Closing the Ring* (Lufta e Dytë Botërore; Vëllimi IV — Çelësi i Fatit; Vëllimi V — Mbyllja e unazës) London, Casell.
- Davies, «Trotsky», (1952) *Illyrian venture* (Aventurë Ilire), London, The Bodley Head.

- Deakin, F.W.D. (1974) «*The myth of an allied landing in the Balkans during the second world war*», në Auty, P. dhe Clogg, R. (bot.), *British policy towards wartime resistance in Yugoslavia and Greece* (Politika britanike ndaj rezistencës në kohën e luftës në Jugosllavi dhe Greqi). London, Macmillan.
- Dedijer, V. (1949) *Yugoslovensko-Albanski odnosi 1939-1948* (Marrëdhëniet jugosllavo-shqiptare) Beograd, Borba.
- Djilas, M. (1962) *Conversations with Stalin* (Bisedime me Stalinin), London, Rupert Hart-Davis.
- Durham, E. (1985) *High Albania* (Shqipëria e Epërme), London, Virago.
- Foot, M. R. D. (1962) *Resistance* (Rezistenca), London, Eyre Methuen.
- Foot, M. R. D. (1984) *SOE*, London, Mandarin.
- Glen, A. (1975) *Footholds against a whirlwind* (Pikëmbështjet kundër një shakulline), London, Hutehinson.
- Griffith, W. E. (1963) *Albania and the Sino-Soviet rift* (Shqipëria dhe përçarja kino-sovjetike), Cambridge, Mass. MIT Press.
- Halliday, J. (1986) *The artful Albanian* (Shqiptari dinak), London, Chatto and Windus.
- Hoxha, E. (1982 a) *Rreziku anglo-amerikan për Shqipërinë*, Tiranë, Shtëpia botuese «8 Nëntori».
- Hoxha, E. (1982 b) *Titistët*, Tiranë, Shtëpia Botuese «8 Nëntori».
- Kemp, P. (1958) *No colours or crest* (Pa ngjyra e pa kreshtë), London, Cassell.
- Lloyd Owen, D. (1980) *Providence their guide* (Providenca udhërrëfyes i tyre), London, Harrap.
- Logoreci, A. (1977) *The Albanians* (Shqiptarët), London, Victor Gollancz.
- Marmullaku, R. (1975) *Albania and the Albanians* (Shqipëria dhe shqiptarët), London, Christopher Hurst.
- Myers, E. C. W. (1955) *Greek entanglement* (Ngatërresa greke), London, Rupert Hart-Davis.
- Pano, N. C. (1968) *The people's Republic of Albania* (Republika Popullore e Shqipërisë), Baltimore, Johns Hopkins Press.
- Pollo, S. Puto, A. (1981) *The history of Albania from its origins to the present day* (Historia e Shqipërisë që nga fillimet e deri më sot), London, Routledge and Kegan Paul.
- Prifti, P. R. (1978) *Socialist Albania since 1944* (Shqipëria socialiste që nga viti 1944), Cambridge, Mass. MIT Press.

- Quayle, A. (1945) *Eight hours from England* (Tetë orë larg nga Anglia), London, Heineman.
- Smiley, A. (1945) *Albanian assignement* (Misioni në Shqipëri), London, Chatto and Windus.
- Tilman, H. W. (1946) *When men and mountains meet* (Kur takohen njerëzit dhe malet), Cambridge, CUP.
- Vukmanoviç-Tempo, S. (1990) *Struggle for the Balkans* (Lufta për Ballkanin), London, Merlin Press.

TREGUESI TEMATIK

Ihënim:

Jëntitujt në tërësi janë vendosur
jo sipas alfabetit.

sipas rendit kronologjik dhe

AFHQ, Kuartieri i Forcave Ajrore
të Mesdheut (Allied Force Hed-
quarters) 198;
BAF Forca Ajrore e Ballkanit (Bal-
kan Air Force) krijimi në qer-
shor 1944 258;
përbërja e Komitetit Politik të
BAF 259, dhe e Komitetit të
Operacioneve të Posaçme 259;
vendimet e Komitetit Politik —
për ndeshjet ndërmjet partiza-
nëve e zogistëve 264, 309-10, për
kërcënimin e Hoxhës ndaj mi-
sionit Concensus II 303, 305, për
tërheqjen e misionit Concensus
II 305, 309-10, 314, për pritat e
vonuara të Kupit në rrugën Ti-
ranë-Shkodër 309-10; njësia aj-
rore sovjetike përdor lehtësitë e

BAF 307;
Balli Kombëtar
formimi në fund të vitit 1942 42;
natyra dhe programi i tij 42. 95.
98;
tensioni me LNC 44, 124, 180;
bashkëfajësia në masat kundër
partizanëve 102, 124; në takimin
e Mukjes 48, 92-3; urdhri për
shkatërrimin e tij 104, 115; li-
dhjet me Kupin 207; gjendja në
fillim të vitit 1944 190, 221; gra-
bitjet dhe plaçkitjet prej tij 184;
komentet e ndryshme për të —
nga Maklini 199-200; nga Stili
202, nga Kuejli 212; nga Ulleri
215, nga Liku 228; rënia e tij
282, 244; një pritë e vonuar nga
BK 308;

bashkëpunimi me gjermanët
211, 215-6, 221, 353, 365-6;

Bashkimi (Bashkimi i Rinisë Shqiptare) 28

Bashkimi Kombëtar 29;

Besa 153

Biza — pllaja si vendqëndrim i Misionit të Kuartierit Britanik 103, 109-10, 115; 121

ardhja e misionit Concensus II atje 193, 209, 226, 241; qëndrimi i fundit i misionit Stables 344-5;

Brigada I 193, 210, 228, 300, 342, 345; formimi nën Mehmet Shehun në gusht 1943 89; pajisja nga Maklini dhe Smajli 88, 89, 364; shpëtimi i Shtabit të Përgjithshëm 129; veprimtaria nëpër jug gjatë fillimit të 1944 183, 190; marshimi në Shqipërinë qendrore 191-92; goditja kundër BK në zonën e Seaview 211; njësi e zgjedhur e UNÇSH 191; përfshirja në Divizionin I 224; përfshirja në ofensivën gjermane të qershorit 231; ardhja në Peshkopi dhe kontakti me misionin Stables 240, 274-5; tërheqja në Maqedoni dhe pezullimi i furnizimeve ajrore 274-7, 284; kthimi për të sulmuar Dibrën 281; kalimi në Mat 281, 286, 289-92, 301; përdorimi për fazën finale, në Tiranë 308, 325, 331; hollësitë për furnizimet 284-5;

Brigada II

formimi në tetor 1943 102, 121; shpërndarja gjatë ofensivës gjermane të dimrit 126, 182, 189; riformimi në vjeshtë 1944 192;

Brigada II e Shërbimeve Speciale

Kuartieri i përdorshëm për Forcën 266 për inkursione në Adriatik 232; e ngarkuar për operacionin Komando kundër Sarandës 326-7;

Brigada III 122;

formimi në shtator 43 103-4; shpartallimi gjatë ofensivës gjermane të dimrit 126, 182, 189; rindërtimi në pranverë 287; kalimi në Divizionin II 287, 290-1; vendosja kundër Tiranës 308, 344; në Bizë 345; kalimi në Kosovë 323-4, 347; përfshirja në Divizionin V 323;

Brigada IV 186, 190-1, 228;

formimi në nëntor 1943 183; përfshihet në Divizionin I 231; përfshihet në ofensivën gjermane të qershorit 231; në betejën e Dibrës 274, 281, 287, 301; nënshtron krerët në luginën e Drinit 291, 345; merr pjesë në betejat përfundimtare rreth Tiranës 325, 347;

Brigada V 189-90, 228, 265, 346;

formimi në janar 1944 190; përfshirja në Divizionin I 231; në ofensivën gjermane të qershorit 231; në betejën e Dibrës 274, 281, 287-8, 291, 301; shtyp vëllezërit Kryeziu 312; kalimi në Kosovë 322-4; përfshirja në Divizionin V 323;

Brigada VI

formimi janar-shkurt 1944 184, 188; përfshirja në ofensivën gjermane të qershorit 231; caktimi për t'u futur në Divizionin II në veri 287, 290, 324; arritja në Bizë dhe kontakti me misionin Stables 344; merr pjesë në

betejat përfundimtare për Tiranën dhe Shkodrën 324;

Brigada VII

formimi në mars-prill 1944 198; përfshihet në ofensivën gjermane të qershorit 231; zëvendëson Brigadën III në Divizionin II 324, 351; merr pjesë në betejat përfundimtare për Tiranën dhe Shkodrën 324;

Brigada VIII

formimi në prill 1944 191; përfshirja në ofensivën gjermane të qershorit 231;

Brigada XII 327, 328;

formimi në dhjetor 1944 dhe përfshirja në Divizionin V 191;

Brigada XIV 327;

Brigada XV 351;

Brigada XVIII

formimi në Dibër, zona e Peshkopisë, gusht 1944 287; nevojat urgjente për pajisjen 290; lëvizja në veri të luginës së Drinit 346;

Brigada XIX 327;

Brigada XXII

formimi në shtator 1944 dhe zëvendësimi i Brigadës XVIII në Divizionin II 324;

Brigada XXV

formimi në dhjetor 1944 dhe përfshirja në Divizionin V 323;

Divizioni I 342, 364-5;

formimi në maj 1944 224, 249; përfshirja në ofensivën gjermane të qershorit 231; mësyn drejt veriut përmes lumit Shkumbin 231, 238, 240, 253, 262; depërton në zonën e Kupit në Mat 254, 263, 273; përballon gjermanët në Dibër 266-8, 273-5; Mehmet Shehu merr komandën

e tij 287; sulmon dhe merr Dibërën 281, 288, 342; udhëheq betejën përfundimtare për Tiranën 325, 331, 347;

Divizioni II 341, 342

formimi në gusht 1944 287; pranë tij vjen misioni Stables 289; 292-3, 345; kërkesat për furnizime 290, 341; merr pjesë në betejat përfundimtare për Tiranën dhe Shkodrën 325;

Divizioni V

formimi në dhjetor 1944 dhe kalimi në Kosovë 323;

Divizioni VI

formimi në dhjetor 1944 dhe kalimi në Kosovë 323;

Dukagjini, pllaja, shih Kosova e Metohia dhe Kosmeti

EAM/ELAS (Lëvizja e Rezistencës Kombëtare Greke dhe Ushtria e saj) 80-1, 246, 249, 268;

Epiri i Veriut, pretendimet greke për të 22, 56, 61, 66; shqetësimet britanike për pretendimet greke 56, 329;

Fluturimet e furnizimit Spillway 132, 182;

FNC, Fronti Nacionalçlirimtar (formuar nga LNÇ, shih më poshtë) 223; çështja e dërgimit të një delegacioni në Itali 261, 266; vlerësimet e ministrisë së Jashtme të korrikut 1944 268, të teoritit 1944 316-7;

Forca Ajrore Mbretërore (Royal Air Force)

Skuadrilja 148 82-3, 112, 135, 177; skuadrilja 624 83, 177; Regjimenti 334 83, 114, 135, 177, 329-30; Skuadrilja 267 177; Fluturimi 1586 (Polak) 177; aerodromi i Derna Main 82; aero-

- dromi i Tokrës 32; 135; aero-planët gjuajtës-bombardues në mbështetje të partizanëve 232-3, 266; sulmi me raketa me Beau-fighter në Dibër 289; dhe në Ti-ranë 327;
- Forca 133 110, 116, 133, 137, 185-91, 199-200, 259-60;
- krijimi në dhjetor 1943 80; pu-shon së qeni përgjegjëse për Shqipërinë 221;
- Forca 266 merr përsipër Shqipërinë nga Forca 133 221;
- nis të dyshojë për vlerën e al-ternativës së Kupit 228; bëhet përgjegjëse për inkursionet am-fibe në Adriatik 231; bën reko-mandime të vendosura jo në favor të Kupit 246; bëhet Ku-arteri i Forcave të Zbarkimit në Adriatik 259;
- Forca 399 296, 351;
- ngrihet në qershor 1944 dhe merr përsipër Shqipërinë nga Forca 266 259; përtërin perso-nelin e misioneve në veri të Shqipërisë 340, 346;
- Forcat Ajrore të Ushtrisë së SHBA (United States Army Air For-ces, USAAF) 329, Grupet për Transportin e Trupave 60 dhe 62 177;
- Forcat e Zbarkimit të Adriatikut, kuarteri
- formimi në maj 1944 259; ndër-merr operacione rikonjicioni dhe inkursioni në Shqipëri 326;
- Forcat gjermane
- tërheqja e njërive shkurt-mars 1944 183, 191; trupat e vendo-sura si garnizone (jo gjermane) futen 228, 191; taktikat shtypë-se kundër partizanëve të LNC 141, 181, 186, 221, 366-7; si off-icerë rekrutues për partizanët 221, 366; përforcimet me njësi të klasit të parë në qershor 1944 230; luftimet gjatë tërhe-qjes 293; vijat kryesore të tërhe-qjes 326; misioni Concensus II rekruton dezertorë nga trupat prej Azisë Qendrore 308;
- Furnizimet ajrore me anë parashu-tash
- hedhje furnizimesh për misionin Concensus në mes të vitit 1943 88; hedhje furnizimesh për mi-sione të ndryshme në vjeshtë 1943 97, 103, 112, 123; përmbledhje e hedhjeve të furnizimeve për vitin 1943 103; hopi sasior në aftësinë për furnizimet aj-rore në fillim të vitit 1944 177; partizanët e LNC bëhen marrësi kryesor 179, 193; rritja e furni-zimeve për partizanët nga maji 1944 232; pezullimi i furnizimeve për partizanët 254, 263-4, 274-5, 365; dhe rifillimi i tyre 266, 278-9, 282, 365; statistikat për furni-zimet nga qershori deri në gusht 1944 294-5; shtator e tetor 329-30
- furnizimet për Brigadën I dhe Divizionin II gusht/shtator 289, 341-2, 345; kërkesa e Hoxhës për kontrollin pa përjashtim mbi shpërndarjen 300-1; vlerësimi i kontributit me furnizime ajrore për mbijetesën dhe rritjen e par-tizanëve 294, 364;
- Gegët 17, 18, 57, 60, 118, 141, 159, 173, 227;
- Greqia
- interesimi parësor i Britanisë 55;

- qëndrimi ndaj Shqipërisë 59; suksesi kundër Italisë 56; pushtimi nga Gjermania 61, 79; mbreti i Greqisë 80; pretendimet e mundshme territoriale ndaj Shqipërisë 22, 56, 61, 63, 244, 216; lufta civile 358;
- Gjakmarrja 119
- Houndforce 327-8
- Incidenti i Kanalit të Korfuzit 232-234;
- Italia pushton Shqipërinë 33; sulmi kundër Greqisë dhe disfata 34, 56; hyn në luftë nga ana e Gjermanisë 55; kapitullimi dhe armëpushimi 99;
- Jugosllavia, qëndrimi ndaj Shqipërisë i qeverisë mbretërore të Jugosllavisë 61; përmbysja e Regjencës 79; Traktati i miqësisë; bashkëpunimit dhe ndihmës reciproke me Shqipërinë 358;
- Këshillat Nacionalçlirimtarë si vegla të pushtetit popullor 97; funksionet dhe të drejtat e tyre të përcaktuara nga Këshilli ANÇ në Berat 334; shih edhe LNÇ
- Këshilli Antifashist Nacionalçlirimtar (KANÇ)
zgjedhja në Kongresin e Përmetit dhe caktimi i Komitetit ANÇ të veprojë si qeveri e përkohshme 223; sesiioni II në tetor 1944 321, 334; shpallja e qeverisë së përkohshme si Qeveri Demokratike e Shqipërisë 334;
- Këshilli i Regjencës 105, 202; përbërja 105; mbrojtja e tij nga Margaret Hezllaku 105-6
- Komandoset 295, 352-3;
të gatshme si forca inkursioni në Adriatik 232; operacioni «Houndforce» në Sarandë 327-8
- Kominterni, Internacionalja e Tretë Komuniste 38, 41
formimi i grupit shqiptar në Moskë 29; Kongresi i saj VII, që kërkoi taktikën e frontit të bashkuar 30; mbrojtja e vetëvendosjes për popujt e Ballkanit 27;
- Komiteti i Bashkuar për Kosovën e Çamërinë 28;
- Komiteti i Ministrisë së Jashtme — SOE 249, 314;
- Komiteti i Operacioneve të Posaçme (Kajro) 202, 206, 211;
- Komiteti i Shefave të Shtabit 249, 260;
vendimet kundrejt Shqipërisë 245, 249; rekomandon të mos i jepet inkurajim partisë zogiste 248
- Komiteti Koordinues për Shqiptarët jashtë shtetit 77-8
- Komiteti Politik i AFHQ 297-8
- Komunikimet me radio 110, 121, 298
- KONARE (Komiteti i Çlirimit Kombëtar) 28-29
- Konfederata ose bashkimi ballkanik
ambicjet jugosllave 64; planifikimi në Londër për Greqi-Jugosllavinë dhe Poloni-Çekoslovakinë 64
- Korpusi I
formimi në gusht 1944 287; mungesa e municioneve në shtator 321; drejton betejën përfundimtare për Tiranën 331
- Kosmeti (Kosova dhe Metohia)
komiteti krahinor i PKJ 36; Komiteti i Përbashkët Nacionalçlirimtar PKJ-PKSH formohet 51-2, 142; rezoluta në favor të Shqipërisë 36, 143; hidhet po-

shtë nga PKJ 143; ngrihet komanda e përbashkët e partizanëve të Kosmetit 50; partizanët e Kosmetit dhe vëllezërit Kryeziu 251; arrestimi dhe shtypja e Kryezinjve 312

Kosova 18-22

shkëputja nga Shqipëria më 1912 11, 21; bashkimi me Shqipërinë më 1941 22; irredentizmi shqiptar 24; shtytjet e PKJ për të ndihmuar themelimin e PKSH 35; qëndrimet e PKJ dhe të PKSH për vetëvendosjen 49-51, 142-3, 314, 323; aspiratat shqiptare gjejnë inkurajim nga doktrina e Kominternit 27, 36; Vukmanoviç-Tempoja dhe problemi i Kosovës 46; aspiratat e PKSH zhgënjehen nga qëndrimi i PKJ 50, 142; problemi nënçmohet nga britanikët 57; Kosova si faktor në mbledhjen e Mukjes 92-3, dhe në Konferencën II të LNÇ 97; si faktor që prekte BLO në veri 142, 169, 236; gatishmëria e shqiptarëve për të luftuar kundër serbëve 157, 278; vështirësitë e Kempit 144, 162; garnizonet e kosovarëve në qytetet shqiptare 191, 228; komentet e Makliniit për të 199-200; kërkesa e Kupit për vetëvendosje 244; përmendja nga Zogu e Kosovës si territor shqiptar 207-8; rezistenca e vëllezërve Kryeziu 251-2, 312; marrëveshja e mundshme ndërmjet PKJ dhe PKSH për kalimin e njësive të UNÇSH në Kosovë 323-4, 349; natyra e patrajtueshme dhe e vazhdueshme e problemit të Kosovës 314-5, 360-1

Kuartieri Ndërlidhës Ushtarak i Aleatëve (Allied Military Liaison HQ) 229

Legaliteti, Partia Zogiste 115, 199-200, 226, 244, 273, 291

prishja me LNÇ 96; shpresat britanike për rezistencë nga lëvizja zogiste 228, 248; dyshimet për vlerën e tij 228, 236, 245; mëdyshjet për të zgjedhur ndërmjet LNÇ dhe zogistëve 254; FNÇ kërkon dënimin e zogistëve si bashkëpunëtorë 297; vlerësimi i FO i tetorit 1944 316

Lek Dukagjini, Kanuni 18, 57, 138

Lëvizja zogiste ose partia zogiste, shih Legaliteti dhe Kupi

Lidhja e Prizrenit (1878)-23

njoftimi për formimin e Lidhjes II në Kosovë më 1943 324

Limani Seaview 114, 117, 211, 216

varësia nga vullneti i mirë i BK 203; shpartallimi i BK në zonën e Seaview nga partizanët 187, 211

LNÇ, Lëvizja Nacionalçlirimtare 116, 203, 226

formimi në Konferencën e Pezës 39, 40, 344; mbledhja e Këshillit të Përgjithshëm në korrik 1943 45, 87; vendimi për formimin e UNÇSH (shih) 45, 86; Konferenca II 97-98; zgjerimi i Këshillit të Përgjithshëm 97; përkrah hedhjen poshtë të marrëveshjes së Mukjes 95; përjashton Kupin 122; goditet ushtarakisht e politikisht në qendër e në veri 131; në vështirësi serioze në jug 211; mbijetesa 152, 173-5, 184, 190; tensioni me BK

- 180; tehu terrorist 181; Enver Hoxha në vështirësi në mars 1944 189; Kongresi I Antifashist Nacionalçlirimtar, Përmet 194, 223; zgjedhja e Këshillit ANÇL 223; pretendimi për të formuar një qeveri të përkohshme 194, 223; paaftësia britanike për të pranuar pretendimet e tij politike 225; shndërrimi në FNÇ (shih) 223; vlerësimi i Makliniit për të 190-200; i Stilit 202, 209; i Kuejlit 212; i Tilmanit 214; i Uilerit 215-16; shih edhe Partizanët
- LRDG, Grupi i Shkretëtirës i Distancave të Largëta (Long Range Desert Group) 295; operacioni në Spile 214; patrulla të ndryshme në Shqipëri 326-9
- Lufta civile
shqetësimi i britanikëve për ta parandaluar 105, 116-7, 225, 227, 315; LNC vendos të shkatërrojë BK dhe Legalitetin 104; përkrahja e BK për ofensivën gjermane të dimrit kundër partizanëve 122, 124-5; komentet e Makliniit për të 199-200; referimi i Zogut për luftë civile 207; përpjekjet e Barit për të përballuar mësymjen e partizanëve drejt veriut 262; problemi siç u ndesh me të misioni Stables 236, 241, 275, 292, dhe Emeri 244; pikëpamja e gjeneralit Uillson 246; paralajmërimet për Enver Hoxhën 227, 268; pezullimi i furnizimeve për partizanët 254, 261, 274-5, dhe rifillimi 266, 282
- Lushnjë, Kongresi 21, 60
- M 16 315
shih edhe Seksioni D
- Maqedonia, popullsia shqiptare në zonën e Dibrës 46
Vukmanoviç-Tempoja dhe Maqedonia 46-9; Dibra si qytet shqiptar, jo jugosllav 238, 346
- Metohia, shih Kosova dhe Kosmeti, si dhe shën. 12 në fund të kreut I
- Mënyra shqiptare e jetesës 145-6
- MI (R) i Zyrës së Luftës 56, 58, 74-5
- Misioni Concensus dhe Concensus II 88, 109, 193, 209, 227, 249, 254-5, 262-3; 290-1, 308
frika nga rifillimi i furnizimeve për UNÇSH në korrik 1944 282; kërcënim i partizanëve për të arrestuar anëtarët e tij 303-4; çështja e tërheqjes së misionit nga Kupi 263, 268, 297-8, 302, 305, 308-9; vonesat në tërheqjen 309, 315, 342; Komandanti Suprem i Aleatëve urdhëron tërheqjen 318
- Misioni Pikuik (Pickwick) 178
- Misioni Primus 132, 178, 184
- Misioni Sapling 89, 114, 173, 182, 187, 212
- Misioni Sconce 89, 117, 118, 150
- Misioni Sculptor 89, 112, 114, 132, 173-4, 178
- Misioni Slender 89, 112, 132, 150-4, 164-6, 178
thithet nga misioni Concensus II 194-5, 242
- Misioni Spinster 89, 112, 136, 162, 178
- Misioni Stables 97, 118, 136, 140, 152, 178, 194, 251, 256, 274, 309, 342
takimi i parë me të 149; lëvizjet dhe pengesat në dimër 149, 153-4, 161-6; punët me krerët e luginës së Drinit 149, 157, 163, 168; përvoja me hedhjet ajrore

- për furnizime 148-9, 163, 168-9, 234, 279; fushimi në ajër të hapur në pranverë 234; kthehet në mision me partizanët 240; tërheqja në Maqedoni me Brigadën I 276-9; në Dibër dhe në Mat me Brigadën I 281, 286; radiogramet e ndryshme 285, 289-90; transferimi si ndërlihdës pranë Divizionit II 289, 242, 344; dyshimet në vlerësimet e Enver Hoxhës 292-3, 300; qëndrimi i fundit në Bizë 343-8; marshimi përmes jugut drejt bregdetit 349-50; hartimi i raportit në Bari 354
- Misioni Stepmother 89, 118-9, 150
- Misioni Swifter 132, 174, 178, 185, 190
- MO4, Zyra e SOE në Kajro 79-80, 109-10, 137, 198
- Mukje, mbledhja dhe marrëveshja 92, 96, 60, 202, 306
- Nacionalistët, qëndrimi i tyre ndaj partizanëve 96, 99, 105, 141-2, 154, 169-70, 259
- komente për ta nga Maklini 199-201, nga Kuejli 212, arsyet e dështimit të tyre 23, 293, 368; shtrëngesat për të ruajtur rendin shoqëror ekzistues 140-1, 369
- Ofensivat gjermane kundër partizanëve të LNC
- shtator 1943 (kapitullimi i Italisë) 180; tetor deri dhjetor 1943 në Shqipërinë qendrore 117-30; janar-shkurt 1944 në jug 183-4; shkurt 1944 në Veri 157; qershor 1944 në jug 230-1
- Oficerët dhe ushtarët italianë 100; batalioni Antonio Gramshi i UNÇSH 100; bateria malore me Brigadën I partizane 279-80, 384-5
- Oficerët Ndërlihdës Britanikë (BLO) prejardhja e tyre e rastit 88, 139; stërviçja e tyre 137; diferenca e shpërndarjes së BLO në veri e në jug 173-74; kufizimi në numër me partizanët në veri 290, 340, 348; ardhja e oficerëve të rinj në vjeshtë 1944 340; nxjerrja në periferi e BLO nga fundi i veprimeve luftarake 341; përkrahja nga BLO e pikëpamjeve të partizanëve ose të «nacionalistëve» 354, 370
- Operacionet e Posaçme për Mesdheun 258
- ngritja e kuartierit prill 1944 198, 221, 243; vlerësimi informativ i qershorit 1944 në favor të partizanëve 260; statistikat e furnizimeve ajrore 329-30
- Operacioni Underdone 162, 164
- Oportunizmi (deviacion komunist) 43, 303, 306, 331-2, 336
- në lidhje me marrëveshjen e Mukjes 94
- OSS, Zyra e Shërbimeve Strategjike e SHBA (Office of Strategic Services) 259, 352
- Pagesat me flori 104, 184, 285, 364, 386-7
- Partia Komuniste e Bullgarisë
- qëndrimi ndaj Maqedonisë 46, dhe ndaj Vukmanoviç-Tempos 50
- Partia Komuniste e Jugosllavisë (PKJ) 356
- e penguar në Kosovë, nxit formimin e Partisë Shqiptare 36, 37; Kongresi V, formimi i Komitetit Krahinor të Kosmetit 36, 37; favorizon vetëvendosjen për Kosovën 36; e kthen kundër vetëvendosjes 50, 142-3; qëndri-

- mi ndaj marrëveshjes së Mukjes 94-5; qëndrimi ndaj rezistencës në Kosovë nga vëllezërit Kryeziu 312-3; marrëveshja e mundshme me PKSH për kalimin e njësive të UNÇSH në Kosovë 323-4, 349
- Partia Komuniste e Shqipërisë (PKSH) 94, 214, 223-4, 370
 mbledhja themeluese 27, 37;
 konferenca e parë konsultative 38; kërkesa për njohje nga Kominterni 38; botimi i gazetës së parë të Partisë 39; Konferenca e Parë e Vendit 72-5, 273; zgjedhja e Komitetit Qendror dhe e Enver Hoxhës si sekretar i përgjithshëm 44; urdhrat për shpartallimin e BK 93, 104; strategjia politike 97; Plenumi I i KQ 195, 226; Plenumi II 321, 334-6
- Partia Komuniste Greke, KKE
 qëndrimi ndaj Maqedonisë 46;
 qëndrimi ndaj Vukmanoviç-Tempos 46, 49
- Partizanët, njësitë e para formohen 40; përbërja e njësive 41;
 shkatërrimi në qendër e në veri gjatë ofensivës gjermane të dimrit 117-130, 141, 157, 173, 190; mungesa e popullaritetit në veri 131, 141; mbijetesa në jug 173, 215-6; tehu terrorist 181, 212, 223; fshihen si të zhdukur nga Forca 133 133, 190, 217, 227; shenja të ringjalljes në mars 190, 221; rishfaqja në qendër e në veri 192-3; disiplina dhe morali 222; shih edhe UNÇSH dhe LNÇ
- Partizanët maqedonë 241, 274, 279-80, 283, 301
- Peza, konferenca (formimi i LNÇ) 68, 70, 110, 94, 199
- Pilotët amerikanë 238-9, 279-80
- Protokolli Dalmaco-Këlcyra 94
- PWB, Dega e Luftës Psikologjike e AFHQ (Psychological Warfare Branch) 259-60
- PWE, Drejtoria e Luftës Politike (Political Warfare Executive) 67, 211
- Qeveria e përkohshme 237
 Këshilli ANÇ shpall Komitetin ANÇ si qeveri të përkohshme 223; refuzimi britanik për ta njohur 225; kërkesa për njohjen politike hidhet poshtë në bisedimet ushtarake në Bari 297-9
- Rrugët e Shqipërisë së jugut, rëndësia e tyre për gjermanët 174-6
- SBS, Shërbimi i Veçantë me Anije (Special Boat Service) 328
- Seksioni D i Shërbimit Informativ Sekret 56, 58, 74-7, 314
- Sektarizmi (deviacion komunist) 30, 44, 47, 303, 331-3
 lidhur me marrëveshjen e Mukjes 94
- SOE, Drejtoria e Operacioneve të Posaçme (Special Operations Executive) 13, 72, 78-80, 88, 314, 364; formimi 76; veprimtaritë e para lidhur me Shqipërinë 76, 77; shkollat stërvitore në Lindjen e Mesme 137; argumenton kundër mbështetjes së Kupit më 1944 245; e vlerëson veprimtarinë e partizanëve të LNÇ 245; kundërshton caktimin e një limiti për Kupin 248; dëshitimet në përpjekjet për Kosovën 314; mbledhjet me FO 205-6, 248, 314

SO 2, nëndarje operative e SOE në ditët e para 78

Shërbimi informativ për Shqipërinë cilësia e dobët 78, 108-10, 138, 209-10; ndalimi nga Enver Hoxha për t'u komunikuar informata britanikëve 45-6, 90, 174, 180, 214, 234, 300; ngatërresa rreth identitetit të eminencës gri jugosllav 209

Shoqata e Motrave të Ndihmës së Shpejtë (First Aid Nursing Yeomanry, FANY) 111, 137, 353

Shqipëria, qëndrimi i Britanisë ndaj saj 55; njohja de facto e pushtimit italian 56; deklarata politike e Britanisë për këtë 55; mungesa e politikës ndaj saj 56-7, 67, 72, 217, 250-1, 260, 299; përshtatshmëria për luftën guerilje 57

Shqipëria e Madhe 22, 46; krijimi nga Italia e Gjermania 34; shovinizmi i Shqipërisë së Madhe 50; nën Këshillin e Regjencës 105

Shtabi i Përgjithshëm i Ballkanit ideja e Vukmanović-Tempos 47; mirëpritja e tij nga Enver Hoxha 47-8; hedhja poshtë nga Bullgaria e Greqia 48-9

Toskët 17, 57, 60, 121, 173

Traktatet

Traktati i Londrës (1915) 28; anulimi nga KANÇ i marrëveshjeve dhe i traktateve të jashtme të mbretit Zog 224; Traktati i miqësisë, bashkëpunimit dhe ndihmës reciproke me Jugosllavinë 358

UNÇSH, Ushtria Nacionalçlirimtare Shqiptare

formimi i njësive të para parti-

zane 40; përbërja e tyre (dhe roli i komisarëve) 41, 199, 216; luftimet e para me italianët 41; formimi i batalioneve partizane 44; krijimi i Shtabit të Përgjithshëm 45, 87; Zona I (komanda e zonës) 180, 184; formimi i Brigadës I 45, 61; formimi i Brigadës II dhe III 101-2; dëbimi i Shtabit të Përgjithshëm nga Shqipëria qendrore dhe tërheqja në jug 173-4; formimi i Brigadave IV, V, VI, VII, VIII dhe XII 184, 189-91; urdhri për ofensivën e përgjithshme 192; shpallja e ushtrisë së rregullt me grada ushtarake 194; forca e UNÇSH në data të ndryshme 41, 194, 221, 261, 330; morali dhe disiplina 222; formimi i Divizionit I 224, 231; mësymja në qendër e në veri 231, 237, 240, 254, 263 273; formimi i Divizionit II 287; zgjerimi i shpejtë i UNÇSH 221, 281-91, 330, 346; formimi i Korpusit I 287; delegacioni i UNÇSH në Bari 266, 298; Marrëveshja Ushtarake me UNÇSH 298, 300, 306, 343; misioni i përhershëm në Bari 298-9, 306; formimi i Brigadës XVIII 287; formimi i Brigadës XXV 323; formimi i Divizionit V dhe VI 323; njësitë e UNÇSH në Kosovë 323-4; Brigadat XIV dhe XIX në operacionin e Sarandës 328; nënshtrimi ndaj PKSH (komisarët) 41, 222, 369; subvencionet me flori 387; shih gjithashtu Partizanët dhe LNÇ UNRRA, Administrata e Kombeve të Bashkuara për Ndihmë dhe Rindërtim (United Nations Re-

ief and Rehabilitation Admini-
stration) 358.

Vendimet Strategjike 1943

Konferenca e Kazablankës dhe
e Uashingtonit, si dhe takimet
e nivelit të lartë në Kuebek dhe
Uashington 80; Konferenca e
Kajros dhe e Teheranit 100;
mungesa e forcave Aleate të
gatshme për Shqipërinë 283

Vështirësitë dhe mungesat e kom-
fortit në jetën e BLO 90, 91,
128, 217, 368, 369-70
në Veri 170; në jug 185; në fu-

shimin në ajër të hapur 233;
përmirësimi nga fundi i vepr-
meve luftarake 283, 292

Viadukti i Gorgopotamosit 70

Zëri i popullit, gazetë e PKSH 39,
109

Zjarri, lëvizja 30, 37, 39, 45

Zona I (komanda krahinore parti-
zane në jugperëndim)

ndërhyrja e shpejtë e gjërma-
nëve i prish përfitimet nga ka-
pitullimi i Italisë 180; ofensiva
gjermane e dimrit përcakton
rezultatit vendimtar 184

TREGUESI I EMRAVE

Shënim:

Nëntitujt në tregues janë renditur kronologjikisht dhe jo sipas rendit alfabetik.

Gradat që u shënohen oficerëve britanikë janë ato që ata mbanin në fund të qëndrimit të tyre në Shqipëri.

- Ajzenhauer, gjenerali Duajt (Eisenhower, Dwight) 198
- Aleksandër, gjeneral Sër Harold (Alexander, Harold) 162, 198
- Alia, Halil 119, 237, 240, 276
i shkakton dëme Brigadës I partizane 273; fshati i tij digjet nga Brigada V partizane 281
- Alia, Ramiz 191, 196
- Alim, Ali shih Popoviç, Miladin
- Arapi, Patër Anton, Regjent 105
- Atli, i nderuari Klement, deputet (Attle, Clement) 214, 226
- Baba Faja 102, 121, 131, 151, 199
anëtar i Këshillit të LNÇ 96;
udhëheqës partizan në zonën e Martaneshit 111; hyn në kontakt me misionin Stables në Bizë 344
- Barker, Elizabeta (Barker, Elizabeth) 58
- Bethell, Nikolas (Bethell, Nicholas) 359, 362
- Biçaku, Aziz 131
- Blekbërn, komandant i skuadriljes (Blackburn) 82-3
- Bogomolov, Aleksandër Jefremoviç 64
- Boksshall, major (Boxshall) 215, 227, 329
- Boulton, rreshter 346
- Brjus — Lokhart, Robert (Bruce-Lockhart, Robert) 68
- Broklëhërst, majori Çarlz (Brocklehurst, Charles) 229
- Broud, Filip (Broad, Phillip) 193, 228, 261, 265, 298-9, 300, 302, 318, 387
vë në pikëpyetje alternativën e zogistëve 228; i vakët për një

- mesazh bashkimi nga Zogu 244;
përkrah rekomandimin e Forcës
266 kundër Kupit 247; anëtar i
Komitetit politik të BAF 258
- Bruno, kapiteni 279
- Bulman, kapiteni J. M. 149-52
- Bullok, kapiteni R. J. R. (Bullock)
194
- Cuderos, Emanuel 61
- Çeshir, majori J. H. C. (Cheshire)
128, 131
- Çitaku, Ramadan 129, 184-6, 300,
305, 335
anëtar themelues i PKSH (nga
Grupi i Rinisë) 37; anëtar i de-
legacionit të UNÇSH në Bari
267; anëtar i Byrosë Politike të
PKSH 332; përjashtohet nga
Byroja Politike 333
- Çurçill, gjeneral-brigade Tom (Chu-
rchill, Tom) 327, 328
- Çurçill, i nderuar Uinston, deputet
(Churchill, Winston) 80, 83, 307,
318, 367
verdikti për situatën në Ballkan
nëntor 1943 100; dyshon me ci-
lën palë është Britania në Shqi-
përi 268
- Dafi, kapiteni Gerri (Duffy, Garry)
86
- Dalton, i nderuari Hju, deputet (Da-
lton, Hugh) 76
- Davidson, Basil 362
- Dedijer, V. 93, 129, 190
- Dejvis, gjeneral-brigade E. F.
«Trocki» (Davies, «Trotsky») 72,
110-2, 124-31, 129-33, 164,
172-4, 198, 202, 208, 217, 230, 255,
287-8, 361, 387
përgatitjet për ardhjen 102;
prish nocionin e misionit të Ku-
artierit 108; takimi i parë me
Enver Hoxhën 114; takimi i parë
me Kupin dhe udhëheqësit e BK
115; pikëpamjet për të zgjedhur
ndërmjet LNC dhe nacionalis-
tëve 124; përkrah mbështetjen e
plotë për LNC 125; shpërnda-
het misioni i kuartierit gjatë
ofensivës së dimrit 126; dësh-
ton në çarjen e rrethimit 128;
plagosja dhe kapja 131, 211;
kujtimet nënçmuese të Hoxhës
133-4, 204; lajmi për kapjen
arrin në Londër 133; rekoman-
dimi që favorizon LNC lihet
mënjanë nga Londra 203-4
- Dejvis tetari (Davis) 120, 149, 168,
233, 255
- Dema, Hynsi 273, 274, 286
- Dika, Ali 149, 151, 156, 161, 163
- Dikin, nënkoloneli Uilliam (Deakin,
William) 80, 387
Sekretar i Komitetit Politik të
BAF 259
- Dikson, Pirson (Dixon, Pierson) 62-4,
65, 67-71, 76, 159
- Dimitrov, Gjergj 29, 32
- Dine, Fiqri 154, 160, 344
udhëheqës i krerëve të Dibrës
118, 151; bën bisedime me Kupin
për të përmbajtur partizanët
269; bëhet kryeministër i qeve-
risë kolaboracioniste 269; dësh-
ton në përpjekjet për t'u afru-
ar me Aleatët me ndihmën e
Kupit 302
- Dishnica, Dr. Ymer 186, 335
anëtar themelues i PKSH 37; ta-
kohet me Maklinin dhe Smaj-
lin 87; në takimin e Mukjes
92
- Dizdareviç, Njazi 313, 333, 351
shih edhe Stojnić
- Dju, Armin (Dew, Armine) 248, 261,
299

- Durham, Edit (Durham, Edith) 57
- Dushanoviç, Ali shih Popoviç Miladin
- Dymulën, kapiteni Xhek (Dymoulin, Jack) 174, 182, 186
- Ejr, kapiteni Xhon (Eyre, John) 229, 362
- Ejtken, Xhek (Aitken, Jack) LRDG 327
- Elezi, Cen 119, 148-50, 154-6, 160-3, 276, 287, 307, 345
- Eliot, nënmareshali i ajrit Uilliam 266, 304, 306
- caktohet për të komanduar Forcën Ajrore të Ballkanit 258; shtyhet nga forca e ngjarjeve për të favorizuar partizanët 268
- Elvixh, tetari (Elvidge) 136, 233, 238, 292, 349, 353
- Emeri, kapiten Xhulian (Amery, Julian) 32, 56, 74, 84, 179, 209, 217, 241-4, 251-4, 264, 269, 305, 309, 314, 359, 362
- ndihmon për hartimin e raportit të Maklinit në dhjetor 1944 199; bashkohet me misionin Concensus II 166, 193, 208, bashkautor në raportin e Maklinit të qershorit 1944 255, 380-3
- Emeri, i nderuari Leo, deputet (Amery, Leo) 204
- Ensor, kapiteni Brajan (Ensor, Brian) 174, 185
- Ermenji, Abaz 309
- Filbi, Kim (Philby, Kim) 359, 363
- Fild, majori Xherri (Field, Gerry) 89, 98, 103, 114, 173
- ngarkohet të ngrejë një pikë furnizimi detare 114; zhgënjimi, plagosja dhe evakuimi 114
- Frashëri, Mehdi, kryetar i Regjencës 105, 160
- Frashëri, Midhat 115, 309
- Fundo, Lllazar 37, 335
- historia e tij si disident komunist 32; rival i Enver Hoxhës në Korçë 32; këshilltar për vëllezërit Kryeziu në Kosovë 251; përkthyes i Simkoksit 313; vrasja nga partizanët 32, 313
- Gega, Liri 129, 335
- anëtare themeluese e PKSH (nga Grupi i Shkodrës) 37; përfaqësuese e Shtabit të Përgjithshëm me Brigadën I 332; dhe me Divizionin I dhe Korpusin I në veri 350; kritikohet nga Stojniçi dhe përjashtohet nga Byroja Politike 333; përjashtohet nga Komiteti Qendror 333
- Geraldina, mbretëresha 55, 204
- Glen, Sër Aleksandër (Glen, Alexander) 56, 363, 365
- Gostivari, Ali shih Popoviç, Miladin
- Gostivari, Xhem 118, 277, 288
- Gubins, gjeneral-majori Kolin (Gubins, Colin) 215
- biseda me gjeneralin Dejvis në Kajro 110; kërkon mbështetje të plotë për LNÇ dhe jo për Kupon 260
- Gudier, tetari 233
- Guri, kapiteni Abdurrahim 167
- Gjilas, Milovan 143
- Gjinishi, Mustafa
- në Beograd 77; kthimi në Shqipëri 79; dënohet nga Enver Hoxha 39; në takimin e Mukjes 92; sukcesi në Arbanë 103; me Filip Likun 225; përfaqësues i Shtabit të Përgjithshëm me Divizionin I në veri 265, 286; lidhjet e tij me vëllezërit Kryeziu 311; vdekja (vrasja) e tij 306-7
- Gjonoviç, Jovan 74

- Harkourt**, nënkoloneli Lord (Harcourt, Lord) 297, 301
 caktohet komandant i Forcës 399
 258; dhe anëtar i Komitetit Politik të BAF 259
- Hauard**, Daglas (Howard, Douglas) 133, 208, 211
 hedh poshtë rekomandimin e gjen. Dejvis për përkrahjen e plotë të partizanëve 204
- Hejr**, majori Alan (Hare, Alan) 318, 326, 351, 359
 në Dibër me Kempin 118; sprova e Dimrit me Nikolsin 128-131; bashkohet me Sejmurin afër Tiranës 131; thithet në misionin Concensus II 194; kapet nga Divizioni I partizan 255; emërohet BLO në zonën e Pezës me partizanët 301
- Henz**, përgjegjës skuadriljeje Endi (Hands, Andy) 88, 112, 117-20, 140, 150, 157, 162-3, 178
 veprimtaria në Zonën e Dibrës 97; veprimtaria në veri të Drinit 135, 140, 142
- Herbert**, zonj. Obrej (Herbert, Aubrey) 61
- Hezllak**, Margaret «Fani» (Hasluck, Margaret, «Fanny») 86, 137, 209
 nxënëse e Edit Durhamit 57; në Athinë 76; specialiste e SOE për Shqipërinë në Stamboll dhe Kajro 79, 109, 111, 133; shënimet hyrëse për BLO 137; pjesë nga përmbledhjet e saj informative 106, 111, 133, 183, 188-90; ikën nga Seksioni i Shqipërisë 167, 229; komenton nga Kajroja listën e përkrahësve të Kupit 229
- Hiberdin**, kapiteni Xhon (Hibberdine, John) 136, 157, 162-3, 362
- Hitler**, Adolf 367
- Hoxha**, Enver 32, 96, 102, 174, 189-93, 196, 209, 217, 230, 253-4, 262, 265, 279, 287, 294, 307, 345, 364, 371;
 shkrimet e tij 13, dhe kulti i personit 13, 134, 360; vitet e para të jetës dhe kthimi në Korçë e pastaj në Tiranë 30, 33; roli si bashkërendues në themelimin e PKSH 35, 37; themelues i LNÇ 39; sekretar i përgjithshëm i PKSH dhe Komisar Politik i UNÇSH 44-5; marrëdhëniet me Tempon 46-8; marrëdhëniet me Maklinin 87, 90, 114; hedh poshtë marrëveshjen e Mukjes 93; prishja me Kupin 96, 122; deklarata për Kosovën 97, 142; urdhri për të shkatërruar BK 104, 202; në zonën e Tiranës shtator 1943 102; marrëdhëniet me «Trocki» Dejvisin 115, 121-31; Shtabi i Përgjithshëm i partizanëve në rrezik 128-32; rishfaqja në Shqipërinë e jugut 183-4; kryekomandant i UNÇSH 224; kryetar i Komitetit ANÇ dhe kryetar i qeverisë së përkohshme 223; urdhri për mësymjen e përgjithshme dhe shkatërrimin e BK 224, 231; hesapet politike në mes të 1944 223-6, 290; dyshimet për veprimtaritë e Nilit 235; hedhja poshtë e kërkesës për njohjen politike 297-9; kërkesa për të kontrolluar gjithë furnizimet e Aleatëve 299-300; kërcënimi për të arrestuar anëtarët e misionit Concensus II 303-4; vdekja e Mustafa Gjinishit 305; shtypja e vëllezërve Kryeziu 312-3; vrasja e Llazar Fundos 32, 33, 313; po-

- zita për «çlirimin» e Kosovës 323-4; marrëdhëniet e këqija me të në çastin e fitores 315-8; mosbesimi ndaj Jugosllavisë 12, 24, 50-1, 331-5; vështirësitë me Stojniçin 331-3; dhe në Plenumin II në Berat 40, 334, 350; pozita në ditën e fitores 337; qëndrimi ndaj LRDG Britanike dhe operacioneve Komando 328-9; përshlyetje personale për të 352; stili politik dhe politika pas luftës 357-61; përpjekja pas lufte për rrëzimin e tij 359
- Hoxha, Fadil 312
 caktohet për të komanduar forcat partizane të Kosmetit 48; udhëheqës në Komitetin Nacionalçlirimtar të Kosmetit 142
- Hoxha, Kadri 122-4
 anëtar themelues i PKSH 37; përgjegjës për misionin britanik të Kuartierit tetor 1943 111; kryetar i delegacionit të përherëshëm të UNÇSH në Bari 306
- Hoxha, Mehmet 312
 Komisar Politik i forcave partizane të Kosmetit 142; udhëheqës i Komitetit Nacionalçlirimtar të Kosmetit 143
- Hoxha, Salih Vuçiterni 207
- Hoxhson, Sër Robert (Hodgson, Robert) 60
- Iden, i nderuari Antoni, deputet (Eden, Anthony) 215, 244
 vizita në Moskë 62; interesimi për Bashkimin ballkanik 34; takohet me Maklinin në Londër 204; protokolle të ndryshme 64, 78, 206, 245, 263, 306, 311, 315; protokollu përmbledhës për gjëndjen në Shqipëri korrik 1944 263; protokollu i 8 shtatorit 1944 që i heq shpresat nga Kupi 306; protokollu i 5 tetorit që paraqet politikën e ndryshuar për Shqipërinë 315-6
- Iker, gjenerali, Forcat Ajrore të SHBA (Eaker) 177, 258
- Istvud, Stanlej, LRDG (Eastwood, Stanley) 326-7
- Ivanov, majori 305-7, 332
- Jakova, Tuk 293
 anëtar themelues i PKSH (nga Grupi i Shkodrës) 37; komisar politik i Divizionit I 287; caktohet në Byronë Politike të PKSH 336
- Jang, togeri J.A. 174, 185
- Jovanoviç, Blazho, i dërguar zyrtar i PKJ në Konferencën I të Vëndit të PKSH 41; Enver Hoxha e quan atë imponues 44
- Kaçaçi, Mustafa 292
- Kadogan, Sër Aleksandër (Cagodan, Alexander) 62, 67, 206
 i quan projektet shqiptare të kota 245, 248
- Kaloshi, Myftar 273
- Kaloshi, Ramadan (Dan) 119-20, 149-51, 154-6, 237, 250, 254, 276, 307, 345
- Kaloshi, Selim 119-20
- Kapo, Hysni 293, 336
 anëtar themelues i PKSH (nga Grupi i Rinisë) 37; komisar politik i Brigadës V 181; dhe i Korpusit I 287
- Kelmendi, Ali,
 i dërguar i Kominternit në Shqipëri 29-32; ndeshja me Lazar Fundon dhe vdekja në Paris 32
- Kemp, majori Piter (Kemp, Peter) 39-92, 101, 103, 117, 140, 142, 150, 154, 157, 162, 209, 314, 362

- Molotov, Vjaçesllav Mihajloviç 63
 Muço, Skënder 181, 211
 Mugosha, Dushan 129, 333
 i dërguar i PKJ në krijimin e
 PKS 37; kërkon njohjen e
 PKS nga Kominterni e Titoja
 38; kthehet me Jovanoviçin dhe
 letrën e Titos 41; misioni si kë-
 shilltar e stërvitës me Brigadën
 I dhe të tjera të reja të UNÇSH
 51; nisja nga Shqipëria 51; En-
 ver Hoxha e komenton duke e
 kritikuar rëndë 210
- Muharrem Bajraktari 78, 120, 144,
 148-51, 153-9, 164, 211, 236, 243,
 254, 307, 345
 raporti i tij për Çurçillin dhe
 Idenin 151, 157, 158, 250, 374-9;
 lëkundjet e tij 159-62, 166, 239;
 kontaktet e tij me Maklinin
 250, 239-40; përpjekjet e Smi-
 thit për ta pajtuar atë me par-
 tizanët 288
- Naj, gjeneral-lejtenant Sër Arçibald
 (Nye, Archibald) 246
- Ndreu, familja 119, 148-50, 155, 161,
 250, 288
- Ndreu, Dali 119, 265, 345, 350
 komandant i Divizionit I parti-
 zan 275, 281-2; komandant i Ko-
 rpusit I 287
- Ndreu, Esat
 komisar politik me Haxhi Lle-
 shin në Dibër 119; komandant i
 çetës partizane në zonën e Pe-
 shkopisë dhe në luginën e Dri-
 nit 151; rishfaqja pas dimrit
 194; zgjerimi i çetës së tij dhe
 lidhja me misionin Stables 233;
 kërkesat për shtimin e furni-
 zimeve 236-8, 273; nisja e ndër-
 likuar në betejën e Dibrës 273-4;
- thithet nga Brigada XVIII par-
 tizane 287
- Ndreu, Xhelal 149-51, 155-6
- Nikols, nënkoloneli Artur (Nicholls,
 Arthur) 109-11, 114, 121, 125,
 150
 prova e rëndë gjatë ofensivës
 gjermane të dimrit 128-31; arra-
 tisja pas kapjes së gjeneralit
 Dejvis 130, 152-4; sëmundja,
 vdekja, dekorimi pas vdekjes
 131, 152, 242; lajmi për vdekjen
 e tij vjen te BLO në jug 186
- Nikols, Filip (Nichols, Philip) 52, 116
- Nil, komandant regjimenti Toni
 (Neel, Tony) 88, 96-7, 100, 103,
 112, 132, 135, 140-1, 150, 157, 162,
 235, 289, 362
- Ninçiq, Momçillo 61
- Noel Bejker, Filip (Noel Baker, Phi-
 lip) 61
- Noka, Selim 160, 161-3, 346
- Noli, Fan 28, 29, 86, 96
- Northrop, kapiteni E. 174, 182, 185-6,
 231, 300, 359, 362
- Nosi, Frederik 90, 111, 123, 127, 226,
 267, 352
- Nosi, Lef, Regjent 105
- Nushi, Gogo 336
- Njuell, kapiteni C.L.D. (Newell) 174,
 185, 231, 300
- Olivej, kapiteni Xhon (Olivey,
 John) LRDG 326
- Oliver, majori J.F.P. 340-2, 347-8
- Ollkot, rreshteri Gregson (Allkot,
 Gregson) 119, 149
- Oukli-Hill, nënkoloneli Dejrell (Oa-
 kley-Hill Dayrell) 57, 76, 79
- Paleret, Sër Majkëll (Palairret, Mi-
 chael) 60, 78
- Palmer, nënkoloneli Alan 174, 178,
 182-3 192, 194, 216, 224, 230-1,

- 254, 263, 300, 303, 309, 318, 326, 329, 342-3, 348
- dërgohet nga gjen. Dejvis për të punuar në jug të Shqipërisë 133, 173; shkon te Ulleri në një mision të rastit të kuartierit me partizanët dhe e zëvendëson si kryetar i tij 192-3, 194; punët me Enver Hoxhën në krizën e korrikut 263-5; me delegacionin e UNÇSH në Bari 266, 297; marrëdhëniet me Enver Hoxhën për kërcënimin ndaj misionit Concensus II 305-6, 309; heq dorë nga misioni i Kuartierit 340, 351
- Pano, Nikolla 93
- Pavli, princi regjent i Jugosllavisë 79
- Peçi, Shefqet 181
- Pejxhet, gjenerali Sër Bernard (Paget, Bernard) 198
- Persi, Sër Xhoselin (Percy, Jocelyn) 77
- Peza, Myslim 60, 117, 190, 199, 344
udhëheqësi i parë i rezistencës 35; bashkohet me LNÇ 39, 96; i vjen Sejmuri 89; formohet Brigada III partizane në zonën e tij 102-3
- Popoviç, Miladin, ndryshe Ali Gostivari ndryshe Ali Alim, ndryshe Ali Dushanoviç 129, 186, 215, 335
sekretar i Komitetit Krahinor të PKJ 35, 36; me Mugoshën ndihmon në krijimin e PKS 37; afria me Enver Hoxhën 38, 43-4; pikëpamja për Kosovën 51; ngatërrimi për identitetin e tij 210; thirret në Jugosllavi 332; vdekja e tij 51, 332
- Previsi, gjenerali Prenk 302, 311
- Prishtina, Qazim 151, 167, 233, 238
- Radovicka, Islam 180-6
komandant i Zonës I partizane 180; bashkëpunon me forcën e komandove në Sarandë 328-9
- Rajan, Sër A. 67
- Rajt, kapiteni H. W. (Wright) 174, 300
- Rankin, kapiteni grupi D.S.O. 83
- Rendel, Sër Xhorxh (Rendel, George) 61
- Ridell, majori Riçard, kryetar i misionit Stables (Riddell, Richard) 97, 118-9, 132, 138, 144, 149-51, 157, 160-7, 195, 222, 236-40, 250, 273, 277-9, 281-93, 301, 341-51, 374
- Rous, Majkëll (Rose, Michael) 205, 227
- Rous, majori P.J.M. 174, 185-7, 231
- Sadherland, David (Southerland, David) 328
- Sarxhent, Sër Orme (Sargent, Orme) 59, 62, 66, 71, 206-7, 249-50, 299
skeptik për çfarëdo veprimi në Shqipëri 245; u bën presion Shefave të Shtabit për ta mbajtur të hapur alternativën e Kupit 245, 260; protokollin e shtatorit 1944 që pranon faktin e fitores së partizanëve 315, 348; rekomandimet për marrëdhëniet me Shqipërinë e re 315
- Sejmur, majori Xhorxh (Seymour, George) 89, 98, 101, 103, 131, 154, 189, 304, 305
me Myslim Pezën 89; misioni i tij sulmohet e shpërndahet 117; kontakti me Kupin gjatë dimrit 242-3; thithet nga Misioni Concensus II 194; evakuimi nëpër Malin e Zi 253

- Selborne, Lord, këshilltar personal
204, 215
- Sesil, Lordi (Cecil) 60
- Simkoks, majori Antoni (Simcox,
Anthony) 97, 144, 148, 151-7,
160, 165-6, 236, 289, 314, 351-2,
362
në misionin Stables në zonën e
Dibrës 119; dërgohet për punë
në Kosovë 166-7; caktohet BLO
me vëllezërit Kryeziu 251-2; ve-
primtaria me sukses e rezisten-
cës me Kryezinjët 311; arresti-
mi dhe heqja nga Kosova prej
partizanëve 312, 322, 349
- Skënderbeu, Gjergj Kastrioti 16
- Smajli, majori David (Smiley, Da-
vid) 72, 88-91, 100, 103, 111,
123, 173, 179, 208, 217, 226-7,
241-2, 252, 253, 264, 270, 304,
305, 308, 314, 342, 359, 363
ardhja në Shqipëri me Makli-
nin 45, nisja dhe kontributi për
raportin e Maklini 114, 198;
kthimi me Maklinin në misio-
nin Concensus II 166, 193; dy
aksione të shënuara për shka-
tërrimin e urave 102, 252-3
- Smith, rreshteri, RAF 131
- Smith, kapiteni F.G.W. 150-2
- Smith, majori Viktor (Smith, Vic-
tor) 174, 178, 182-3, 187, 191,
265, 287-90, 293-4, 306, 318, 345
dërgohet në jug të Shqipërisë
me Palmerin 133, 173; evakuimi
në Itali 230; hidhet në veri me
misionin e ndërmjetësimit 254,
262-5; BLO me Divizionin I par-
tizan 281-2, 301; zëvendëson
Palmerin si kryetar i misionit të
Kuartierit 340-1, 350-1
- Spahiu, Bedri 39, 86, 180, 305, 352
anëtar themelues i PKSH (nga
Grupi Zjarri dhe i Rinisë) 37;
komisar politik i Zonës I parti-
zane 180; anëtar i delegacionit
të UNÇSH në Bari 267; caktohet
në Byronë Politike të PKSH
336
- Spahiu, Hulusi 123
komandant i Brigadës III par-
tizane 103; lidhet me misionin
Stables në Bizë 225
- Spiro, Nako 189, 333-5
anëtar themelues i PKSH (nga
Grupi i Korçës) 37; anëtar i
Byrosë Politike të PKSH 333
- Stalin, Josif Visarionoviç 24
prishja me Titon 337; ngritja
e tij nga Hoxha 358; efekti i
vdekjes së tij 359
- Stefani, kapiteni Tom, oficer ndër-
lidhës i SHBA 187, 225, 305,
352
- Stil, Kristofer (Steel, Christopher)
209, 243
këshillon të mos mbahet anë në
Shqipëri 203; nuk pajtohet me
idenë e Maklini për t'u kapur
pas Kupit 204-5; diskuton anët
pro e kundër për të kundërshtu-
ar BK 211
- Stirling, koloneli Frank 77-9
- Stojnić, koloneli Velimir
kërkon dorëzimin e Kryezinjve
te Jugosllavia 313; ndërhyr në
punët e Byrosë Politike të PKSH
dhe kritikon Enver Hoxhën 331-
-3; dëbon Miladin Popoviçin
332-3; ndërhyrjet e tij në Ple-
numin II të KQ të PKSH 334-6
- Stouell, gjeneral-major (Stawell)
221, 259
komandant i Operacioneve të
posaçme për Mesdheun 198;
përkrah rekomandimet e For-

- cës 266 të pafavorshme për Kupin 247
- Shehu, Faik 120, 237-9, 272-3, 286, 289
kryeson Këshillin Nacionalçlirimtar për Zonën e Dibrës 238, 272
- Shehu, Mehmet 91-2, 102, 191, 291-2, 301, 332-4, 364
vitet e para dhe kthimi në Shqipëri 31; sekretar qarkori në Vlorë 44; komandant i Brigadës I partizane 45; shoqërimi me Mugoshën 51, 210; bëmat me Brigadën I në dimër 128, 183, 189, 190, 211; arritja në zonën e Dibrës-Peshkopisë 265, 273-4; tërheqja në Maqedoni 274-5; zëvendëskomisarja e tij e brigadës Fiqrete 277, 286; sulmi mbi Dibër 280; ngrihet komandant i Divizionit I 287-8; drejton betejën përfundimtare për Tiranën 325, 331, 347; kritikohet për ashpërsi dhe sektarizëm 332, 350; «vetëvrasja» e tij 360; Shehu si dorë e hekurt 357, 360
- Shou, majori J.C.H. (Shaw) 174, 301
Shtylla, Dr. 186, 215
- Tahiri, komandanti i Brigadës VI partizane 184; caktohet për të komanduar Divizionin II 344
- Talbot Rajs, nënkoloneli (Talbot Rice) 132, 203-4, 242, 267
- Tashko, Koço
në Moskë me Kelmendin 30, 32; kthehet në Shqipëri me mesazhin për «frontin e bashkuar» 33; dënohet nga Enver Hoxha 39; takon Maklinin dhe Smajlin kur vijnë për herë të parë 86
- Tilman, majori Bill 89, 103, 112, 132, 173, 180, 184-5, 191, 212, 216, 350, 361
ngre një bazë furnizimi në jug 98, 175; nuk i bëjnë aq përshtypje partizanët në fillim 113; njeriu çelës për furnizimet e dimrit të partizanëve 180; ikja nga Shqipëria 188; raporti informativ në Bari 214
- Tinker, Ron. LRDG 326
- Tito, Josif Broz, 44, 70, 80, 101, 157, 210, 215, 245, 249, 251, 261, 278-9, 285, 298, 318, 323-4, 331-2, 361
letra e tij për PKSHE shtatorit 1942 32, 41; përgjigjja negative për PKSHE ndaj aspiratave mbi Kosovën 50; çështja për të kërkuar ndihmën e tij që të bëhet më e prirur për bashkëpunim LNÇ 200, 204-5; prishja me Stalinin si momenti i «çlirimit» për Enver Hoxhën 24, 337, 358-9
- Tojnbj, profesor Arnold (Toynbee) 68
- Thornton, majori M.J. 340-2
- Uejvell, gjenerali Sër Arçibald; kryekomandant i Lindjes së Mesme (WaveH) 75-7
- Uiler, nënkoloneli Norman (Wheeler) 193, 218, 227, 230
pengohet të vijë te gjenerali Dejvis dhe arrin në jug 112, 132, 173; merr përsipër si epror BLO me partizanët 182-3; lidhet me Shtabin e Përgjithshëm të partizanëve 130, 185; peripecitë e përpjekjeve për të ikur nga Shqipëria që të raportojë 186-7; raporti informativ në Londër 215-6
- Uillson, gjenerali Sër Henri Meitland, Komandant Suprem Aleat i Mesdheut (Wilson, Henry Mait-

- land) 215, 249-50, 253, 315, 318; merr përsipër operacionet në Ballkan 193; direktiva për komandantin, Forca 226, për inkursione në Adriatik 232; skeptik për shanset e pajtimit LNÇ-Zogistët dhe vlerëson veprimtarinë e LNÇ 246; mesazhi i tij për Enver Hoxhën për luftën civile 266; mesazhi i tij për Enver Hoxhën për LRDG dhe grupet e inkursionit të komandove 328
- Uin, togeri i nderuari Rouland (Winn, Rowland) 341, 346-9, 371-2 mospajtimi për të mbështetur partizanët 347
- Uotrous, majori Eliot (Watrous) 330, 343, 348, 362 futet në Seksionin e Shqipërisë në Bari 229; komentet e tij për kritikën e «teorisë së konspiracionit» nga Seksioni i Shqipërisë 229; zëvendëson Likun si Kryetar i Seksionit të Shqipërisë 230
- Velebiti, koloneli 200-1
- Vinçani, Nexhip, komandant i Brigadës IV partizane 86, 182-3, 187, 192
- Vukmanoviç-Tempo, Svetozar 278, 330-1 vizitat e tij në Shqipëri 46-7; shqetësimet për problemin e Kosovës 46; propozimi për Shtabin e Përgjithshëm Ballkanik 48; hedhja poshtë e marrëveshjes së Mukjes ndërmjet LNÇ dhe BK 48-9, 94; kritikon Enver Hoxhën dhe Haxhi Lleshin për shovinizmin e Shqipërisë së Madhe 50
- Xoxe, Koçi 129, 186, 215, 324, 333, 336, 358 anëtar themelues i PKSH (nga Grupi i Korçës) 37; shoqëron Vukmanoviç-Tempon në Greqi 49; mbështet Tempon për marrëveshjen e Mukjes 93; anëtar i Byrosë Politike të PKSH 333; aspiratat e tij në Plenumin II të KQ të PKSH 335; spastrohet më 1948 359
- Xheb, Gladuin (Jebb, Gladwyn) 76
- Zogu, Ahmet, mbreti Zog 60, 65, 115-6, 124, 159, 242-4, 247, 268 ardhja në pushtet 21, 28, 29; rrëzimi nga Italia dhe mërgimi 55; vlerësimet greke dhe britanike për të 60-1; kontaktet e Maklinit me të në Londër — çështja e një mesazhi për Kupin 204-7, 242-4; ndalohet kthimi i tij në Shqipëri nga Këshilli ANÇ 224; propozimi i tij për të vepruar si ndërmjetës në Shqipëri hidhet poshtë 299; FO përpiqet ta mbajë të hapur alternativën zogiste 299, 317

Shënime për përkthimin

Autori i librit, Sër Rexhinald Hibert, ka lindur më 21 shkurt 1922. Më 1940 ai hyri në Kolegjin Uorçester të Oksfordit, ku studioi dy vjet për histori. Pas fillimit të Luftës II Botërore ai hyri në një kurs për oficer tankist në Repartin e Stërvitjes së Oficerëve Kadetë të Korpusit të Korracuar Mbretëror. Iu përgjigj thirrjes që të hynte vullnetar për detyra të posaçme dhe u dërgua në Kajro, që të njihej me Shqipërinë. U hodh me parashutë natën e 19-20 dhjetorit 1943 në Degë, përtej Drinit, në rrethin e sotëm të Tropojës, si oficer ndërlidhës britanik. U largua nga Shqipëria në mesin e tetorit 1944 dhe u kthye në Regjimentin e 4-t të Husarëve. Mori pjesë në luftimet në Itali dhe u bë komandant trupash tankiste të Skuatronit B të tankeve Sherman. Pas Luftës vijoi edhe një vit studimet për rakisht në Oksford dhe hyri në veprimtarinë diplomatike. Si diplomat ka qenë në Rumani, Austri, Guatemalë, Turqi, Belgjikë dhe më 1952 ishte i pari diplomat perëndimor me qëndrim të përhershëm në Ulan Bator të Mongolisë. Doli në pension më 1982 si ambasador i Britanisë së Madhe në Paris. Sot jeton në Uells. Në gusht 1992, vizitoi Shqipërinë për një javë së bashku me ish kryetarin e Misionit Stables, Ricard Ridell, dhe me oficerin tjetër Xhek Dymulën.

Përkthimi i është përmbytur me besnikëri origjinalit. Meqë ky është një punim historik, i mbështetur gjerësisht në dokumente, giatë përkthimit janë bërë nërpjekje për t'u lehtësuar lexuesve e studiuesve punën. Kështu, emrat e përve-

çëm, kur dalin për herë të parë në tekst, janë dhënë edhe në trajtën e shkrimit anglisht, dhe po ashtu janë dhënë në trajtën anglisht në shënimet në fund të krerëve dhe në treguesit në fund të librit. Shkurtime anglisht janë lënë të tilla në tekst dhe prandaj jepet lista e tyre në fund të këtyre shënimeve.

Shënimet e mëposhtme përfshijnë vetëm fjalë e shprehje në gjuhë të tjera, siç i ka origjinali, si edhe disa elemente, që kanë nevojë për sqarime që të lehtësohet kuptimi i tekstit.

- f. 15 *Pax Romana* lat. pàqja romake, paqja e imponuar nga romakët mbi të gjitha vendet që sundonte Perandoria Romake.
- f. 46 *maçédoine* fr. turli
- f. 55 *inter alia* lat. ndërmjet gjërave të tjera.
- f. 59 *une haine irréductible* fr. urrejtje e patundur.
- f. 60 *la plus cruelle déception* fr. zhgënjimin më të rëndë.
- f. 60 *Nous luttons non seulement pour notre existence mais pour les autres peuples Balkaniques aussi et pour la libération de l'Albanie,* fr. Ne luftojmë jo vetëm për ekzistencën tonë, por edhe për popujt e tjerë të Ballkanit e gjithashtu për çlirimin e Shqipërisë.
- f. 64 *entente* fr. antantë.
- f. 65 *cordon sanitaire* fr. kordon sanitar.
- f. 66 *Mbretëria e Bashkuar* Britania e Madhe.
- f. 66 *prima facie* lat. në vështrim të parë.
- f. 79 *Luftwaffe* gjerm. forcát ajrore luftarake (gjermane).
- f. 83 *Husky* angl. qen për tërheqje slitash në pol.
- f. 84 *Overlord* angl. kryelord.
- f. 84 *Liberator* angl. çlirimtari.
- f. 84 *Halifax* Halifaks, emër i një qyteti anglez në kontenë e Jorkshirit.
- f. 88 *concensus* angl. konsensus, marrëveshje.
- f. 89 *Spinster* angl. vejushë.
- f. 97 *Slender* angl. thatim.
- f. 117 *Stables* angl. stallat.
- f. 117 *Sconce* angl. qyp.
- f. 118 *Stepmother* angl. njerjë.
- f. 123 *Spillway* angl. kapërderdhës.
- f. 132 *Swifter* angl. i shpejtë.
- f. 132 *Primus* angl. furnela.

- f. 137 *CRUCIBLE* angl. sprovë.
- f. 148 *Brojgeli* Pierre Breughel (1530-1600) piktor flamand, i njohur për pikturat e gëzuara me pamje nga fshati. *Pol Nash* Paul Nash.
- f. 162 *Underdone* angl. i pabërë.
- f. 163 *en masse* fr. në masë, si grumbull i tërë.
- f. 173 *Sapling* angl. fidan.
- f. 174 *Sculptor* angl. skulptor.
- f. 177 *Flight* angl. fluturim.
- f. 189 *faits divers* fr. fakte të ndryshme.
- f. 191 *corps d'élite* fr. repart i zgjedhur. *Jaeger* gjerm. gjahtar, gjuajtës.
- f. 206 *bona fide* lat. në mirëbesim.
- f. 210 *persona grata* lat. njeri i pëlqyeshëm, i dëshiruar. *éminences grises* fr. këshilltar i fshehtë, i prapaskenës.
- f. 211 *fons et origo* lat. burimi dhe zanafilla.
- f. 221 *e kapërcen Rubikonin* bën një hap të pakthyesëm. (Shprehja lidhet me emrin e një lumi të vogël në Itali, të cilin Jul Cezari e kapërceu në vitin 49 para e.r.e dhe kështu u bë e pashmangshme lufta me Pompeun dhe Senatin).
- f. 231 *Spitfire* angl. i rrembyer.
- f. 237 *feux de joie* fr. batare festive.
- f. 242 *faute de mieux* fr. në mungesë të një më të mire.
- f. 243 *coup d'état* fr. grusht shteti.
- f. 251 *en route* fr. gjatë rrugës.
- f. 265 *force majeure* fr. forca madhore
- f. 275 *Florence Nightingale* (1820-1910) themeluese në Angli e trupave të infermiereve ushtarake.
- f. 306 *de facto* lat. në fakt.
- f. 308 *fait accompli* fr. fakt i kryer. *coup de grace* fr. goditja përfundimtare.
- f. 321 *de facto supremo* lat. faktikisht drejtuesi suprem.
- f. 327 *Houndforce* angl. forca e langonjve. *canard* fr. truk mashtrues.
- f. 357 *fuite en avant* fr. vrapim përpara
- f. 374 Dy letrat e M. Bajraktarit janë shkruar me një frëngjishte shumë të keqe, sa paraqesin vështirësi për t'u kuptuar. Autori i sjell në shtojcë pikërisht për të dëshmuar këtë gjë dhe prandaj përkthimi i tyre shqip jepet këtu, në shënimet:
«Zoti toger,

Do të takohem me ju nesër, nëse do të keni mirësinë
të më prisni.
Përhëndetje të përzemërta.

M. Bajraktari»

«Shumë i dashuri R. Ridell,
Kam marrë letrën e 24.3.1944.
Jam i informuar mirë se gjermanët janë tërhequr nga
Sllova, pasi dogjnë shtëpinë e z. Ali Dika.
Ne jemi gjithnjë syçelur, dhe për këtë kemi vendosur
patrullën.
Islami ka ardhur nga Prizreni, nuk ka gjetur mundë-
sinë të shkëmbente paratë që i keni dhënë ju, me për-
jashtim të tre, me 3x26=78 napolona letër shqiptarë.
Ai ka dhënë disa gjëra argjendi, nëse ju pëlqejnë, janë
për ju, pas disa ditësh ne mund t'ju rekomandojmë të
tjerë.
Ju lutem të më takoni atje ku është kap. Hendz. e
gjithashtu të më tregoni në çfarë drejtimi do të shkoni
në rast nevojë.
Pranoni zoti major përhëndetjet e mia të përzemërta
e gjithashtu për z. Simkoks dhe Hibert.

Miku juaj M. Bajraktari»

Shkurtime të anglisht

AFHQ	Kuartieri i Forcave Aleate (Allied Force Headquarters).
AOC	Oficer Komandant i Forcave Ajrore (Air Officer Commander).
BAF	Forcat Ajrore të Ballkanit, FAB (Balkan Air Force).
BBC	Korporata Britanike e Radiopërhapjes (British Broadcasting Company).
BLO.	Oficer Ndërlidhës Britanik (British Liaison Officer).
CB	Shok i Urdhrit të Bathit (Companion of the Order of the Bath).
DFC	Kryqi I Dalluar për Fluturime (Distinguished Flying Cross).
DSO	Urdhër për Shërbime të Shquara (Distinguished Service Order).
FANY	Vullnetarët e Ndhmës së Parë Infermiere (First Aid Nursing Yeomanry).
FCO	Zyra për Punët e Jashtme dhe të Komonuellthit (Foreign and Commonwealth Office).
FO	Ministria e Jashtme (Foreign Office).
FOTALI	Oficeri i Flamurit Detar të Tarantos dhe të Ndërlidhjes për Italinë (Naval Flag Officer Taranto and Liaison Italy).
GCMG	Urdhri i Kalorësit të Kryqit të Madh të Shën Majklit dhe të Shën Gjergjit (Knight Grand Cross of St. Michael and St. George).
GCVO	Urdhri i Kalorësit të Kryqit të Madh të Urdhrit Mbretëror Viktorian (Knight Grand Cross of the Royal Victorian Order).
GHQ ME	Shtabi i Përgjithshëm, Lindja e Mesme (General Headquarters, Middle East).
KBE	Kalorës Komandant i Urdhrit të Perandorisë Britanike


KCB	(Knight Commander of the Order of the British Empire). Kalorës Komandant i Urdhrit Bath (Knight Commander of the Order of the Bath).
KCMG	Urdhri i Komandantit të Kalorësve të Shën Majkllit dhe të Shën Gjergjit (Knight Commander of St. Michael and St. George).
LRDG	Grup i Shkretëtirës i Distancave të Largëta (Long Range Desert Group).
MC	Kryqi ushtarak (Military Cross).
MI(R)	Degë e Ministrisë së Luftës për të nxitur luftime të parregullta.
MO4	Dega e SOE në Kajro.
NCO	Nënoficer jo i karrierës.
OBE	Oficer i Urdhrit të Perandorisë Britanike (Officer of the Order of the British Empire).
OSS	Zyra e Shërbimeve Strategjike (Office of Strategic Services).
PRO	Arkivi Shtetëror Qendror (Public Record Office).
PWB	Dega e Luftës Psikologjike, DLP (Psychological Warfare Branch).
PWE	Drejtor i Luftës Politike (Political Warfare Executive).
RAF	Forcat Ajrore Mbretërore (Royal Air Force).
RHA	Artileria Mbretërore Kalorëse (Royal Horse Artillery).
RUF	Pushkatarët Mbretërorë të Olsterit (Royal Ulster Rifles).
SAC	Komandanti Suprem i Aleatëve (Supreme Allied Commander).
SIS	Shërbimi Informativ Sekret (Secret Intelligence Service).
SOC	Komiteti i Operacioneve të Posaçme (Special Operations Committee).
SOE	Drejtoria e Operacioneve të Posaçme (Special Operations Executive).
UNRRA	Administrata e Kombeve të Bashkuara për Ndhimë dhe Rinëdhim (United Nations Relief and Rehabilitation Administration).
USAAF	Forcat Ajrore të SHBA (USA Air Force).
WO	Ministria e Luftës (War Office).

Tirazhi 20.000 kopje

Formati 60x88/16

Stash: 3204-82

Shtypur në shtypshkronjën «A. Z. Çajupi» — Tiranë, 1993



I vetmi libër i botuar pas ngjarjeve të dhjetorit 1990, që e rishikon historinë e afërt të Shqipërisë në dritën e këtyre ngjarjeve.

Autori: Oficer i Shërbimit të fshehtë informativ anglez gjatë Luftës II Botërore, u hodh me parashutë në Shqipëri në dhjetor të 1943, doli në pension më 1982 si ambasador i Britanisë së Madhe në Francë, vizitoi Shqipërinë në gusht të 1992.

Libri: Mbi bazën e dokumenteve të arkivave ushtarake e të jashtme të Anglisë dhe të ditareve e të përvojës së autorit në Shqipërinë e kohës së luftës jep përgjigje të reja për pyetje të vjetra:



- Kush është përgjegjës për vendosjen e komunizmit në Shqipëri?
- Si erdhi në pushtet Enver Hoxha?
- Kush luftoi në Shqipëri dhe kush bashkëpunoi me fashistët e nazistët?
- Cili është roli i Kosovës në fatet e luftës dhe të politikës shqiptare si dje, dhe sot?

Një rivlerësim i gjithë botimeve të mëparshme. Libër që do të hyjë në fondin e qendrueshëm të burimeve të historiografisë shqiptare. Faqe që lexohen me pasion nga studiuesit, po edhe me kureshtje të pangopur nga çdo lexues, që gjen aty emra të njohur, familje e fshatra të vendlindjes.

«Për punët e kësaj bote, Shqipëria do të mbetet universiteti im,» shprehet autori.